

Xhevdet Kallaba

# Kallaba

*gjurmë në kujtesë*



Roganë, 2022





Xhevdet Kallaba

Kallaba *gjurmë në kujtesë*

Redaktor: Sulejman Dërmaku

Recensues: Naim Kryeziu

Dizajni: Granit Kallaba

Shtypi:

CIP:

*Xhevdet Kallaba*

# Kallaba

*gjurmë në kujtesë*

Roganë, 2022

## **Përmbajtja:**

Parathënie.....	9
<b>I - Biografi veprimtarësh nga familja Kallaba në Roganë .....</b>	<b>19</b>
Hafëz Shefki S. Kallaba (20.3.1889 – 21.03.1968) .....	22
Kujtime për Hafëz Shefki Kallabën.....	27
Specialist për drejtshqiptimin e alfabetit arab .....	28
Hosteni dhe incidenti me xhandarët bullgarë .....	31
Hafëz Kallaba në mbrojtje të pleqve e fëmijëve të pafuqishëm .....	35
Ndikimi i egrës .....	38
Aty ku merr dije nuk bën të mbjellësh urrejtje .....	39
Kujdes gjatë vizitës tek i sëmuri.....	40
Çdo tepri kalon në neveri.....	41
Largimi i shërbëtorit Mon.....	43
Kujtime për gjyshin tim.....	44
Haki Jashar Kallaba - njeriu i shtigjeve të luftës.....	59
Këmbëngulja për shkollim në akademi ushtarake.....	62
Pushtimi i Stalingradit.....	63
20 vjet me plumbin në fyt .....	64
Martesa e Hakiut me ukrainasen Anna.....	65
Jeta në Çikago .....	67
Faruza Kallaba - pilotja e parë shqiptare në botë.....	69
Fehmi Shefki Kallaba – një jetë dhe një mandat për fshatin Roganë .....	72
Shpend Qemajl Kallaba - Ambasador i Republikës së Kosovës.....	78
Foto e dokumente nga arkivi familjar.....	80
<b>II - Roli i familjes Kallaba në arsimimin shqip .....</b>	<b>87</b>
Tasin Kallaba - ishte njeri tejet human.....	126
Rrëfimi i Xhemail Kallabës për qëndrimin në njësitin “Skenderbeg” në Shqipëri....	135
Tefik Shefki Kallaba (10.8.1922 – 4.7.1984) .....	150
Mësuesi që u bë shembull .....	208
Kujtimi për një mësues të (pa)harruar .....	210
Foto e dokumente nga arkivi familjar.....	272
<b>III - Themelimi i SHKSHSH-së dhe i partisë Republikane në Kosovë.....</b>	<b>285</b>
Raport pune i Partisë Republikane të Dardanës prej 30.3.1991 – 17.2.1992.....	295
Qëndrimi zyrtar në Shqipëri prej 15 – 20 gusht 1991 .....	300
Apeli.....	305
Vizita e dytë e qëndrimit zyrtar në Shqipëri prej 23 - 29 qershor 1992 .....	309
Arkivi kombëtar .....	315
Pasojat nga vizita shtetit amë.....	318
Foto e dokumente nga arkivi familjar.....	329
<b>IV - Diskutime, shënime, referime.....</b>	<b>333</b>
Metush Krasniqi – kafshatë që nuk kapërdishej nga UDB-ja Jugosllave.....	335
Martirëve të fshatit dhe të kombit.....	341

Porosia e nënës shqiptare .....	344
<b>V - Të tjerët për Ekremin .....</b>	<b>347</b>
Ishte person afrues dhe unifikues .....	348
Idhulli im - Prof. Ekrem Kallaba.....	349
Profili i pedagogut të paharruar .....	353
Profesori që deshi më shumë nxënësit sesa vetveten.....	356
Ekremi mbeti pedagog i përjetshëm edhe pasi ia morën ditarin e shkollës.....	359
Ekrem zotnia.....	361
Ekrem Kallaba i kuptonte më së drejti ish-të burgosurit politikë.....	364
Ekremi ishte skalitës i harmonisë njerëzore .....	366
Profesor i aftë dhe guximtar.....	367
Pasionant i gjuetisë.....	369
S' di kujt t'i besoj.....	370
<b>VI - Telegrama dhe kujtime ngushëllimi me rastin e ndarjes nga jeta të Ekrem Kallabës .....</b>	<b>373</b>
Nekrologji për Ekrem Kallabën.....	374
Republika e Kosovës - Zyra e Kryeministrit .....	376
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – Zyra e kryetarit .....	378
Shoqata e Gjuetarëve “Pashtriku” Gjakovë .....	380
Letërngushëllim.....	380
Profesorit tim – Ekrem Kallabës .....	381
Kujtesë.....	383
Kur vitet kalojnë, e kujtesa ndalet në çastin e ndarjes së përjetshme.....	384
Përzemërsi e ndërsjellë mes profesorit dhe nxënësve.....	385
<b>VII - Rrëfime familjare nga nëna - Naxhije Kallaba .....</b>	<b>389</b>
Strehimi i Mulla Idris Gjilanit në sytë e një të reje.....	391
Djegia e Brahimve .....	392
Dalja e Hafëz Kallabës kaçak dhe strehimi i tij (1944-1945).....	395
Kthimi i Tefikut nga Tirana.....	398
Qëndrimi i Naxhijes në spital, në Beograd.....	403
Foto e dokumente nga arkivi familjar.....	413
<b>VIII - Retrospektivë që do harruar .....</b>	<b>417</b>
Një ngatërresë që nuk duhej të ndodhte .....	418
In memoriam: Hanumshahe Kallaba Masurica .....	421
<b>IX - Intervistë me vetveten - Xhevdet Kallaba .....</b>	<b>425</b>
Një protestë me rastin e viktimës - Islam Ruzhdi Morina .....	446
Kryesisë së KMDLNJ-së dega në Dardanë .....	447
Unë besoj në një bashkëpunim të mirë .....	460
Foto e dokumente nga arkivi familjar.....	464
<b>X - Pasardhësit e Hafëz Shefki Kallabës - Shkollimi dhe profesioni i tyre .....</b>	<b>477</b>
Shkurtesat.....	482
Terma të huaj .....	483
Shënime për autorin .....	484

*Në kujtim të prindërve të mi,  
Tefik e Naxhije Kallaba*



## Parathënie

Sa më shumë që po e njoh të tashmen, po e vërej se sa më mungon njohja e së kaluarës së familjes sime. Kështu, në një faqe të ditarit tim, qysh më 16 tetor 1985 qeshë zotuar të ndriçoja shumëçka nga e kaluara dhe e tashmja e familjes Kallaba, sidomos duke e zbardhur veprimtarinë e gjyshit dhe të babait tim. Lufta për mbijetesë, si fizike ashtu edhe kulturore e ekonomike, kishte shtyrë anash këtë projekt, që e kisha synuar shumë vite më parë. Duke qenë i vetëdijshëm se vetëm ajo që shënohet në letër, ka gjasa të jetojë më gjatë, si dhe duke e parë mangësinë e shënimeve nga brezat para nesh, atë zotim të viteve '80, këmbëngula ta përmbledh në këtë libër.

Nëse, gjatë leximit vërehet ndonjë zbrazje mllefi për situatat e pakëndshme që vijnë nga njerëzit për njerëzit, ky është preokupimi im i pasqyrimin të primitivizmit të njerëzit, në përgjithësi, dhe të ne shqiptarët, në veçanti.

Në ditët tona, shpesh ndodh që i dituri të dështojë në përparim për shkak të ngecjes së të paditurit, njësoj sikur druri i njomë që digjet pranë të thatit.

Që të jem gjithherë vetvetja, më kujtohet një anekdotë e babait tim: “Mos u lavdëro me babanë e vdekur dhe me mallin e humbur, por ndërto vetë autoritetin dhe krijo mallin tënd!”

Nga shumë ide për mënyrën e thirrjes së kujtesës sime, si dhe dokumenteve të arkivuara në bibliotekën time, vendosa që librin ta realizoj në formë të një interviste me vëllain tim, Ekremin. Me qëllim që në libër të përfshij, së paku, katër-pesë breza mësimdhënësish dhe veprimtarësh atdhetarë, të familjes së ngushtë Kallaba, vendosa që pjesën më të madhe të librit t'ia kushtoj drejtpërdrejt Ekremit, duke sjellë edhe shumë e shumë pjesë nga jeta dhe veprimtaria edhe e babait dhe gjyshit tim, si dhe të veprimtarëve të tjerë të familjes Kallaba. Këtu edhe nis fillimi i këtij libri, i cili, shpresoj, të përmbushë pritjet tuaja prej lexuesi!

Në praninë e Ekremit asnjëherë nuk denjova të flisja me të tjerët, madje edhe kur u bëra disa vjeç, derisa një ditë më barazoi me veten dhe me të pranishmit, duke më obliguar që edhe unë të merrja fjalën dhe të isha i përgjegjshëm për atë që flisja. Ky lloj edukimi, pothuajse, zotëronte në gjithë familjen Kallaba; më i madhi duhej respektuar, por secili duhej dinte të sillej mirë në shoqëri dhe

të merrte vetë përgjegjësinë për fjalën e thënë dhe veprën e bërë. Isha nëntë vjet më i vogël sesa Kema, kështu e thërrisja Ekremi gjatë tërë jetës sime. Patëm edhe dy vëllezër ndërmjet, Rexhepin (5 qershor 1948 – 2 janar 1949) dhe Nijaziun (10 shtator 1950 – 7 dhjetor 1952), që nuk i shpëtuan dhëmbit të kohës dhe vdiqën në moshën midis një e tre vjeç.

Mbaj mend shumë e shumë këshilla e udhëzime për mirësjelljen, për atdhedashurinë, për bamirësinë dhe për sakrificën që duhej bërë për familjen, të afërmit dhe kombin. Kujtoj shumë detaje nga jeta jonë rinore, por edhe të periudhës së moshuar, për çka do të shkruaj më vonë në këtë monografi për agën Kemë, siç e quaja unë dhe shumë të tjerë. E pyesja shpesh edhe për të kaluarën e familjes sonë, për trungun familjar, për heroizmat dhe për dobësitë e njerëzve tanë, për mënyrën e ruajtjes së dinjitetit njerëzor e kombëtar në konfrontim me qeveritë kuislinge, dhe me qeveri të huaja, që përpiqeshin të na mbanin në një letargji të përhershme të primitivizmit me forma të ndryshme shantazhuese, makiaveliste, madje edhe kërcënuese.

Mbase, kjo histori familjare mund të duket naive, mirëpo jam përpjekur që të formësoj realitetin e njëmendtë si dëshmi kohe, e që u kushtohet nipave, mbesave, stërnipave e stërmbesave të mia, dhe jo vetëm atyre.

Jam përpjekur që në këtë libër, në bazë të fakteve të studiuara me hollësi, të përshkruaj ngjarjet e vërteta, që do të jetojnë në kohë. Shpresoj që kjo të mos bëhet mollë sherri për ndonjërin nga brezat pasardhës. Çështë e vërteta, brezat pasues duhet ta shfrytëzojnë këtë përvojë si mësim të rëndësishëm për sjellje pozitive në shoqëri.

Njëkohësisht, ky dokumentar le të shërbejë për rritjen e kurajës qytetare ndër breza, pavarësisht nga fakti se kush do të qeverisë këtë rajon, dhe, siç do të përsëritet edhe ndonjëherë në këtë libër, kritikrat duhen të merren kryekëput si mbështetje dhe asnjëherë si ofendim.

Sidoqoftë, zhvillimi kulturor, arsimor e historik i familjes Kallaba, në rrethin ku ka jetuar e ka vepruar, ka ecur gjithëherë në vijën prijëse të kohës, duke dhënë gjithmonë njerëzit dhe mundin e duhur aty ku e ka kërkuar nevoja, koha dhe vendi. Madje, këta familjarë, duke qenë me ide përparimtare, shpeshherë kanë qenë të penguar edhe nga forcat vendnumëruese dhe frenuese konservatore

shqiptare dhe antishqiptare. Qëndrimi dinjitoz i çdo anëtari të kësaj familjeje nuk u është nënshtruar as edhe elozheve të herëpashershme, qoftë edhe kur ato kanë ardhur nga udhëheqje qeverish të ndryshme, por as edhe prapaskenave të regjimeve të ndryshme, duke qëndruar të vëmendshëm dhe të pathyeshëm para situatave të rastit ose të parapërgatitura.

Po përmend këtu telegrafikisht katër-pesë shembuj: Haxhi Ramadan Kallaba, diku nga mesi i shekullit 19-të, përpiqej ta shihte zhvillimin e njerëzimit përtej rrethit ku jetonte. Kështu, në një çast, vendosi t'i vizitojë vendet e shenjta, Mekën e Medinën, por edhe vende të tjera të Lindjes së Mesme. Kishte shitur rreth dy hektarë tokë pjellore të "Dheu i Bardhë", afër Domorocit, për të eksploruar për tre muaj rresht vende dhe shtete, nga Rogana e deri në Mekë e në Medinë, për t'u kthyer me thirrjen "Haxhi".

Përballë kësaj situatë po bëj një parantezë. Diku 100 vjet më vonë, në vitet '70 të shekullit XX, isha i lumtur kur babai im më jepte vetëm lejen për të eksploruar qytete e shtete, ndërkaq udhëtimet i bëja autostop, ose me fare pak shpenzime, për të vizituar shumë vende evropiane deri në fund të Sicilisë, në Spanjë, Angli, Poloni, dhe të mos flas për Evropën Qendrore.

Pastaj, djali i Haxhi Ramës, Salih R. Kallaba, kishte ndihmuar fuqishëm Idriz Seferin për çlirimin e Shkupit. Ai ishte pjesë e delegacionit, i udhëhequr nga Idriz Seferi<sup>1</sup>, bashkë me Bejtullah Beun, Ahmet Agën, Tahir Budrikën e Menduh Beun, për të negociuar autonominë e Shqipërisë para komisionit qeveritar osman, mbajtur në Prishtinë, më 29 korrik 1912; vazhdojmë më tutje: Hafëz Shefki S. Kallaba, pas një shkollimi rreth 12-vjeçar të mësuesit privatë e shtetërorë, më 1913 me dekret të Ministrisë së Arsimit në Beograd ishte emëruar mësues fetar në fshatin e vet, në Roganë<sup>2</sup>. I vetëdijshëm për obligimin ndaj vendit dhe popullit të vet, pas Luftës së Parë Botërore angazhohet vullnetarisht dhe regjistron të gjitha lindjet, vdekjet dhe martesat në rrethin e tij, në periudhën 1918-1921, punë kjo që është vlerësuar lart dhe, më vonë, këto shënime i kanë shërbyer shumë popullatës vendore. Pas vdekjes respektivisht helmimit të vëllait të tij, Mulla Ibrahimit (1925), vazhdon punën e ofiqarit. Veç kësaj, ai ka qenë kontribuuesi kryesor i mosshpërnguljes masive të rogasve për në Turqi; Ilmi Sh. Kallaba, djali i madh i Shefkiut, që shkolluar

---

<sup>1</sup> Mr. Aliriza Selmani: *Gjilani me rrethinë 1908-1912*, f. 251.

<sup>2</sup> Vërtetimi nga Ministria e Arsimit.

në medresenë “Isa Begu” në Shkup, dhe në ushtrinë mbretërore të Jugosllavisë së Vjetër kishte marrë gradë oficeri, por, diturinë prej shkollari dhe oficeri e zbaton në forcat e Shqipërisë Etnike të Mulla Idris Gjilanit. Madje, kishte qenë këmbëngulës edhe për zbatimin e gjuhës shqipe në administratë dhe në shkolla fetare e laike; edhe djali i Ilmiut, Muharremi, përveç që ishte arsimtari i gjuhës shqipe, që edhe ushtarak i shkolluar me gradë “Kapiteni”, ndërsa, dijen e tij ua dha edhe brezave të gjimnazistëve të Dardanës, shumë prej të cilëve e zbatuan edhe në luftën e fundit të UÇK-së (1998-1999). - I brumosur me ndjenjën e ushtarakut, Muharremi vazhdoi traditën, duke e shkolluar djalin e tij, Fisnikun, në Akademinë Ushtarake të ish-Jugosllavisë, që më vonë, u bë edhe piloti i dytë në familjen Kallaba, pas Faruza Kallabës. Ndërsa, Haki Jashar Kallaba që zënë rob lufte nga forcat naziste, si ushtar i Akademisë së Mbretërisë Jugosllave, dhe kishte luftuar për Hitlerin deri në Stalingrad, ndërkaq vajza e tij, Faruza, po ashtu ushtarake, ishte pilotja e parë shqiptare që mori pjesë në forcat amerikane për bombardimin e Serbisë, më 1999; pastaj Qemajl Musah Kallaba, qysh në rininë e tij, angazhohet në organizatën Nacionale Demokratike Shqiptare (NDSH), si edhe të tjerë që dëshmojnë për vetëdije të lartë njerëzore e kombëtare.

S’do lënë anash as edhe angazhimin e vëllezërve Sylejman e Salih Ibrahim Kallaba, ku në odën e tyre, më 13 e 14 nëntor 1944, u tubua paria e Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës Lindore, në krye me Mulla Idris Gjilanin, me qëllim që të hartohet plani për mbrojtjen nga sulmi i ushtrisë bullgare<sup>3</sup>.

Pas luftës së vitit 1999, edhe në fushën e diplomacisë, familja Kallaba dha kontributin e merituar në diplomacinë e jashtme për shtetin e Kosovës, ku ambasadori Shpend Qemajl Kallaba shërbeu si ambasador në Bullgari e në Hungari.

Bijtë e Hafëz Kallabës: Ilmiu, Sabrija, Fetija, Tefiku, Fehmiu, Faiku, Nazmiu, Zehra, Hyseni e Tasini, të frymëzuar nga babai i tyre për dije e për arsim, dhanë kontribut të pashoq që fëmijët e tyre të mbaronin shkolla të larta e të bëheshin frymëzues për shkollimin e fëmijëve të tyre, duke u bërë bartës të dijes nga brezi në brez, natyrisht pa dallim gjinie.

---

<sup>3</sup> Dr. Muhamet Pirraku: *Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941 -1951*, f. 132.

Me dhjetëra mësimdhënës e mësimdhënëse nga kjo familje punuan me entuziazëm të madh në arsimin shqip. Edhe në këtë pikëvështrim po e sjell në vijë vertikale - një pjesë të vijës arsimore: Hafëz Shefki Kallaba, imam (mësues), djali i tij Tefiku qe mësues dhe themelues i shkollës fillore në Busavatë të Kamenicës. Fëmijët e Tefikut: Ekremi, Xhevdeti, Selamiu e Drita, mësimdhënës të dëshmuar, tani edhe prej fëmijëve të mi, Blerina e Petriti, po ashtu mësimdhënës të përkushtuar.

Përgjithësisht, mbiemri Kallaba është sinonim i një familjeje përparimtare intelektualësh e atdhetarësh të devotshëm, thonë shumë njerëz që e njohin këtë familje. Prandaj, edhe kahu i kësaj monografie do të jetë në frymën e një interviste me Kemën, ku do të pasqyrohen të gjitha ato përgjigje që m'i jepte gjatë jetës e që trajtonin pikërisht përpjekjet për dije, për edukim dhe për arsimim. Do të pasqyrohen edhe shumë përgjigje të nxjerra nga dokumentet arkivore të Kemës, pastaj nga dokumentet arkivore të anëtarëve të tjerë të familjes Kallaba, nga bisedat me të tjerët për Ekremin si edhe nga përjetimet e mia të kohës.

Në këtë libër nuk do të merrem veç e veç me secilin intelektual të familjes Kallaba, prandaj kërkoj ndjesë nga ata, emri i të cilëve nuk përmendet në këtë monografi.

Kur u rrita, më interesonte fëmijëria e Kemës, domethënë periudha para ardhjes sime në jetë, pra, para moshës sime kur mund të shkruaja për historinë e familjes sime.

Fatkeqësisht, hëpërhë, mund të paraqes rreth nëntë breza dhe të hamendësoj edhe për nja dy të tjerë, por jo edhe për më shumë.

Në këto troje islamizimi i shqiptarëve qe pjekur aq shumë, saqë periudhën e mëhershme e kishte errësuar tërësisht. Dhe, ky presion ka lënë pasoja gjithandej popullit shqiptar në Anamoravë e në Kosovë.

Ne nuk duhet të turpërohemi, nëse themi se më parë kemi qenë shqiptarë të besimit të krishterë. Fundja, besimi është diçka që njeriu e zgjedh vetë, sipas bindjes së tij individuale. Të mos turpërohemi as edhe kur themi se para atij besimi ishim paganë, por gjithsesi duhet ta themi me mburrje se ishim pellazgë, ilirë, dardanë dhe jemi shqiptarë.

Ua zë për të madhe edhe paraardhësve të mi që nuk kanë lënë me shkrim një historik të familjes, por mbase edhe nuk duhet t'i fajësoj, sepse presioni nga sunduesit dhe lufta për ekzistencë ua ka topitur ndjenjën e krijimtarisë letrare; kujtoj që edhe “çekani” i pushtuesit nuk ua ka lejuar diçka të tillë. Shih vetëm fenomenin e trungut të familjeve shqiptare myslimane: sikur bota ka filluar para rreth 300 vjetësh, sepse askush nuk e vazhdon vijën gjenealogjike, ta zëmë, para Ibrahimit ose Selimit, etj., për të përmendur paraardhësit me emrin Nika, Toma, Marku, Shtjefni, Pali etj.

Sidoqoftë, sjellja, veprimtaria, bamirësia, respektimi i ndërsjellë e shumëçka tjetër, kanë bërë që autoriteti i familjes Kallaba të jetë model dhe temë dite në oda të ndryshme në Roganë e gjetiu.

Në vitet e fundit të jetës së babait tim, Tefikut (1922-1984) kishim filluar të përgatisnim një gjenealogji të trungut familjar, por ai u nda herët nga kjo botë, në moshën 62-vjeçare, dhe shumëçka mbeti në errësirë. Pikërisht, kjo edhe më ka nxitur që të merrem me regjistrimin e kohës së sotme, duke gjurmuar të kaluarën për aq sa arrij të marr shënime nga pleqtë e fshatit dhe nga ndonjë dokument bindës. Shi për këtë, më 2006 bëra regjistrimin e popullatës në fshatin tim, duke përfshirë ekonomitë familjare, pasurinë e lëvizshme (automjete, kafshë shtëpiake, etj.), pastaj regjistrimin e banorëve që jetojnë brenda dhe jashtë Roganës dhe shënime të tjera për t'i botuar në tre numra të periodikut “Inforogana”<sup>4</sup>. Po e përsëris: në njëfarë dore i kuptoj vështirësitë e paraardhësve të mi për regjistrimin e kohës dhe për mos-regjistrimin me shkrim të periudhës së tyre. Format e presionit, fillimisht turk e pastaj edhe serb, kanë ndikuar dukshëm në fshirjen e gjurmëve tona kombëtare.

Mbiemrin **Kallaba**<sup>5</sup> e gjejmë në fjalorin e Frang Bardhit (1635), si fjalë e barasvlershme me atë të latinishtes **rixa**, që në përkthim do të thotë: grindje, përleshje, luftim. Ndërsa në fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe nga autori Kolec Topalli gjejmë këto të dhëna: KALLABALLËK/KALLABLLËK m. “shumicë njerëzish, gjinde e madhe”. Pra, është huazim nga turq. kalabalik me të njëjtin kuptim. Format **kallabá** (tosk.) e **kallabë** (geg.), që përfaqësojnë trajtën më të vjetër të fjalës turke, thuajse kanë dalë nga përdorimi; por trajtën

---


<sup>4</sup> *Inforogana* nr. 1.

<sup>5</sup> *Rixa, Fjalor latinisht – shqip, Frang Bardhi, shtëpia botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1983, f. 217.*

gege e ka Ulqini dhe dëshmohet te Bardhi: kallabë “tumultus”, prej së cilës janë formuar emri kallabës “tumultuosus” e folja “me u kallabuem”-“rixari”. Prej turqishtes ka shkuar edhe në gjuhë të tjera ballkanike (skr., bullg., rum., etj).

Por, mbiemrin Kallaba e hasim edhe në shumë shtete në botë: Evropë, Afrikë, SHBA, etj. Në Gjermani, ta zëmë, për herë të parë mbiemri Kallaba është përmendur në vitin 1080 dhe ka këtë sqarim: mbiemri Kallaba është sinonim për forcë, për guxim dhe për vetësakrificë. Ata që mbajnë këtë mbiemër kanë prejardhje të pastër dhe fisnike. Mbiemri Kallaba ka pasur gjithmonë një nam të respektuar<sup>6</sup>.

Në defterët e regjistrimit turk, të vitit 1455, në Roganë ishin regjistruar tri shtëpi. Pleqtë thonë se në fshatin Roganë, fillimisht, kishte ardhur Geci, njëri nga katër vëllezërit e Roganës së sotme, që populluan këtë fshat, pastaj Kallaba, më vonë edhe Sinani (Kryeziu) e Rrudhani. Ata kishin marrë këto prona që ka sot Rogana. Madje, Geci e kishte ndarë pronën në dy pjesë; njëren pjesë e kishte marrë vetë dhe pjesën tjetër e kishte ndarë në tri pjesë për tre vëllezërit e tjerë. Tani për tani këto janë vetëm supozime, por shpresoj që historianët do të nxjerrin në dritë, jo vetëm të vërtetën rreth këtij mbiemri, por edhe për mbiemra të tjerë.



---

## KALLABA

*Që nga viti 1080*

Mbiemri Kallaba është sinonim për forcë, për guxim dhe për vetësakrificë. Ata që mbajnë këtë mbiemër kanë prejardhje të pastër dhe fisnike. Mbiemri Kallaba ka pasur gjithmonë një nam të respektuar!

---

<sup>6</sup> Përdorimi i mbiemrit Kallaba në Gjermani, foto.

Për mbiemrat e tjerë aktualë të rogasve, gjatë shekullit XIX/XX ka pasur po ashtu presione për ndërrimin e tyre, kështu, në defterë të ndryshëm regjistrimi ose në dokumente ekzistuese, rogasit i kanë regjistruar me mbiemra të ndryshëm, si: Ramadanoviq, Salijeveq, Jashareviq, Alijeviq, Salihu, Kalaboviq, Azemoviq, Sinanoviq, Pajazidoviq, etj. Mirëpo, më vonë, kryesisht, të gjithë e kanë kthyer sërish mbiemrin paraprak: Kallaba, Geci, Kryeziu ose Rrudhani.

Në fakt, te familja Kallaba, pasardhësit e xhaxhait tim, Tasinit, ende mbajnë mbiemrin Salihu dhe jetojnë në Ferizaj. Në Ferizaj jeton edhe familja e axhës Faik dhe mban mbiemrin Kallaba, ose kushëriri Arslani, që jeton në Sarajevë, mban mbiemrin Jashareviq. Ndërsa, në Sarajevë jeton edhe familja e kushëririt tim Veliut dhe mban mbiemrin Kallaba.

Edhe këtë temë e kemi trajtuar me agën Kemë, por edhe ai nuk ka pasur shënime të mjaftueshme. Aga Kemë, vdiq në moshën 64-vjeçare. Sidoqoftë, nga aga Kemë kam mësuar shumëçka që lidhet me të sotmen.

Nuk pretendoj t'ju bind se i di të gjitha, ose i kam thënë të gjitha, ose i kam parë a i kam dëgjuar të gjitha, por mund të them se kam mësuar diçka shumë të vlefshme nga aga Kemë: ku thoshte: “duaj të gjithë njerëzit, e sidomos ata që rrezatojnë përzemërsi”!

***Autori***







I

**Biografi veprimtarësh nga familja  
Kallaba në Roganë**

*(rrëfime, dokumente)*

“ Yni është ky vend,  
vetëm nëse jetojmë  
këtu ku jemi. ”

---

*Hafëz Shefki Kallaba*



**Hafëz Shefki Kallaba**  
20.3.1889 – 21.3.1968

## **Hafëz Shefki S. Kallaba (20.3.1889 – 21.03.1968)**

Shkollimin fillor e nisi në Roganë më 1895 te hoxhë Hasan Efendiu, ish-imam nga Dobërçani, tek i cili mësoi 4 vjet. Pas përfundimit të shkollimit fillor, vazhdoi mësimet në medrese, në Dobërçan, ndërkaq më 1899 filloi mësimin “Islam Sarf “ te myderrizi Jusuf Zijadin Efendiu nga fshati Tërrnoc, dhe arriti deri te “mulla xhamia”, të cilën me hafëzllëkun i përfundoi me sukses më 1903.

Shefki Kallaba merr mësimet “meharixhi huruf” nga Kurani, nga mësuesit Alim Kurdia dhe haxhi Hafëz Rexhepi në Prishtinë, në vitet 1904 – 1905; njëkohësisht ndjek edhe mësimet në “ilmi fikhu” te mulla Salihu në medresenë “Pirinaz” të Prishtinës.

Më 1906 kthehet në medresenë e Dobërçanit për të vazhduar thellimin e diturive në “mantik”. Në saje të interesimit dhe punës së suksesshme, ai arriti deri në “akaid”. Shefki Kallaba nga viti 1909 – 1912, ndërpreu shkollimin e mëtejme për shkak të luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë, ngaqë medresetë dhe shkollat qenë mbyllur.

Më 1913-1915 Shefki Kallaba, me dekret të Ministrisë së Arsimit në Beograd caktohet për mësues fetar në fshatin e tij, në Roganë. Me të filluar të luftës serbo-bullgare, gjatë viteve 1915-1917 mësimin fetar e vazhdon në një shkollë private. Nxënësit e tij vinin nga fshatrat përreth. Me ardhjen e pushtetit serb, më 1918, në Roganë vendosen punëtorët administrativë dhe mësuesit, kështu që Shefkiut ia pezullojnë vendin e punës. Megjithatë, me dekret të Ministrisë së Arsimit, ai vazhdon të punojë me gjysmë rroge deri më 1925.

Gjatë viteve 1918-1921 Shefkiu vullnetarisht angazhohet në regjistrimin e popullatës së kësaj ane dhe të Hashanisë, me theks të veçantë në lindjet, martesat dhe vdekjet që kishin ndodhur gjatë viteve të fundit e që si pasojë e luftërave nuk kishte pasur kurrfarë shënime. Këta libra ofiqarie, edhe sot e kësaj dite njihen si “Librat e Hoxhës” dhe deri vonë kanë qenë në Ofiqarinë e Muçivërcit. Gjatë luftës së vitit 1999, këta libra i ka marrë pushteti serb dhe ata ndodhen diku në Vranjë ose gjetkë në Serbi.

---

<sup>7</sup> *Data e lindjes është marrë nga Zyra e Ofiqarisë në Muçivërc.*

Pas fillimit të dialogut me Serbinë, në vitin 2010 (në kuadër të këtij dialogu) janë kthyer kopjet e librave të ofiqarisë në Kosovë, pra, edhe në Muçivërc të komunës së Dardanës.

Më 1925, me dekret të Ministrit të fesë në Beograd, zotit Hasan Rebac, Shefkiu caktohet për imam-ofiqar në xhematin e Roganës. Deri në vitin 1925 librat e ofiqarisë në komunën e Roganës i udhëhiqte vëllai më i madh i Shefkiut, Mulla Ibrahim, i cili pas një helmimi të qëllimshëm nga forcat e errëta antishqiptare vdiq po në atë vit.



Më 1928 kaloi provimin për imam-ofiqar (shkalla e tretë) para komisionit të përbërë nga Myderrizi Haxhi Jusuf Efendi Abdurrahmani dhe nga një profesor në gjuhën serbe.

Më 1933 në Gjilan, ndjek një kurs tremujor dhe, me të mbaruar të kursit, para komisionit Çirakoviq dhe Vlada, profesorë të gjuhës serbe, i nënshtrohet provimit për shkallën e dytë dhe e mbaron me sukses të shkëlqyeshëm. Kjo shkallë njohurie i jep titullin Imam-ofiqar i përhershëm shtetëror.

“Me qëllim që ta ndihmoj popullin, pa dallim, kam qenë i përzier edhe në politikë”, shprehet në një autobiografi të tij Shefki Kallaba, ku gjatë viteve 1937-1940 kishte qenë i zgjedhur zëvendësdeputet nga populli. Prej 1940-1944 me dekret të Ulema-mexhllisit të Tiranës, caktohet në po të njëjtin vend si imam-ofiqar.

Hafëz Kallaba ishte deputet i Kuvendit Kombëtar të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, i dalë nga zgjedhjet e 1 tetorit 1943, që njihet si organizata më e lartë politike e ushtarake shqiptare<sup>8</sup>.

*Nga 16.10.1943 deri 10.11.1943 u quajt Asambleja  
Kombëtare. Më 10.11.1943 merr emrin Kuvend  
Kombëtar (Parlamenti). Kryetar i Kuvendit Kombëtar,  
1943 ishte Lef NOSI.*

Hafëz Kallaba ishte deputet i Kuvendit Kombëtar nga Prefektura e Prishtinës. Atë kohë Gjilani ishte Nënprefekturë e Prefekturës së Prishtinës. Nga kjo Prefekturë ishin të zgjedhur këta deputetë: Abdullah HALILI, Adem IBRAHIMI, Adem RAMADANI, Aqif TETOVA, Bahtijar FAZLLIU, Bajrash SYLEJMANI, Banush SEDLARI, Daut Dr. MUSTAFA, Esat BERISHA, **Hafëz KALLABA**, Halim SHUKU, Haxhi SHABANI, Hysen PRISHTINA, Iljaz AGUSHI, Isa

<sup>8</sup> “Historia e shtetit shqiptar 1912- 2005”, f. 500-501; “Ligjvënësit Shqiptarë 1920 - 2005”/ përgatitur nga Diana Estrefi - Tiranë, 2005, f. 40-41.



REXHEPI, Islam MEHMETI, Ismail GORANI, Jakup KARAQEVA, Mexhit GJILANI, Mumin JAKUPI, Ramiz HALIMI, Riza ÇITAKU, Seid BUTRIKU, Selim REXHEPI, Zejnullah GRASHTICA, Zek IMERI

Prej 1944-1947 kishte vazhduar të punojë në po të njëjtin vend pune, në udhëheqjen e librave të ofiqarisë dhe gjatë kësaj kohe nga libri amzë jep edhe emrat e fëmijëve që duhet të fillojnë shkollimin fillor.

Më 1947 zgjidhet anëtar i Asamblesë Supreme të Vakëfit me seli në Sarajevë dhe anëtar i Kuvendit të Bashkësisë Islame në Prishtinë, me ç`rast merr pjesë në hartimin e Kushtetutës së fesë të Bashkësisë Islame për trojet e ish-Jugosllavisë.

Si imam i xhematit nga Rogana, Hodonoci, Dajkoci, Muçivërci, Krenidelli dhe Novo Sella, me punën e tij vullnetare dhe të xhematit nga këto fshatra, si dhe me ndihmën e Ulemasë nga Shkupi ka dhënë këto kontribute konkrete:

Në Roganë: Rrethimi i xhamisë, shtroja e dyshemesë, ndërrimi i dritareve të xhamisë. Ngritja e objektit për dy metra lartësi, ndërtimi i minares.

Në Hodonoc: Xhamisë ia ka organizuar shtrojën e dyshemesë.

Në Muçivërc: E ka organizuar bartjen e materialit të xhamisë nga Berivojca në Muçivërc. Me atë material është ndërtuar objekti i xhamisë në fshatin Muçivërc. Pas dhjetë vjetësh, me ndihmën e xhematit të këtij fshati, e ka ndërtuar edhe minaren.

Në Dajkoc: Ka organizuar ndërtimin e objektit të xhamisë pa minare, i cili ka shërbyer për 25 shtëpi.

Në Krenidell: Ka organizuar ndërtimin e objektit të xhamisë pa minare.



# Kujtime për Hafëz Shefki Kallabën

## Shkëputja nga besëtytnitë



*Rabit Rexhepi*

I njohur si Hafëz Kallaba, nga fshati Roganë i Dardanës, në kohën kur jetoi (1889-1968), sidomos në Anamoravën e Ulët, ishte ndër personalitetet më të dalluara të kohës. Si hoxhë e mësuesi i fesë që ishte, me aftësitë dhe virtytet e begata që kishte, gëzonte një respekt dhe admirim të veçantë, jo vetëm të bashkëfshatarët e vet, por edhe shumë më gjerë.

Ajo çka Hafëz Kallabën e dallonte nga hoxhallarët konservatorë të kohës, ishte shkëputja e tij nga besëtytnitë dhe nga shtresimi konservator që mbretëronte në trojet tona, si pasojë e robërisë shekullore. Si i tillë,

vazhdimisht ishte në vijën e parë të frontit në luftë kundër prapambetjes dhe angazhohej gjithmonë për emancipim.

Mësuesit e parë të shkollave fillore të trevës së Dardanës (Kamenicës), që nga viti 1945 e këndej të Hafëz Kallaba gjenin mbështetjen dhe përkrahjen e pakursyer për shkollimin e brezave të rinj, sidomos të vajzave fshatare. Në këtë drejtim, edhe nëpërmjet shembullit vetjak, pra, edhe me propagandimin e mençur dhe me ndikim të fshatarët, dha një kontribut të dalluar në zhvillimin e arsimit. Kishte një harmoni shpirtërore, qëndrim stabil, shoqëruar me një optimizëm, që ia shtonin peshën ndikimit të fjalëve të tij.

Në oda, në tubime, në xhami e gjetiu, Hafëz Kallaba, me fjalët e tij të zgjedhura e kuptimplotë, u hapte shtigje kaheve të mendimit dhe veprimit të njerëzve. Në takime me njerëz ishte i afërt, i dashur dhe gjithnjë i gatshëm për t'i ndihmuar. Thënë me një fjalë, Hafëz Kallabës i kishte hije vendi dhe kuvendi.

*(tregoi: Rabit Rexhepi, maj 2001, Prishtinë)*

## Specialist për drejtshqiptimin e alfabetit arab



*Hafëz Idriz Dërmaku*

Më 1946 Hafëz Kallaba hap një shkollë private për mësimin fetar, i quajtur “mejtep”. Unë më parë pata mësuar në Tërrnoc dhe, me qëllim që të jem më afër vendlindjes, u ktheva në Roganë për të ndjekur mësimet në leximin e Kuranit, te Hafëz Kallaba. Me ndihmën e tij, mësova dukshëm më mirë leximin e Kuranit, dhe mund të them se ai ishte një specialist për drejtshqiptimin e alfabetit arab. Mësimi zhvillohej në lokalet e xhamisë së fshatit dhe merrnim pjesë vetëm 7 nxënës. Isha unë (Idriz Dërmaku) dhe Mehmet Dërmaku nga Shipashnica e Epërme, pastaj Taip, Sinani dhe Ramadani nga Breznica, Hyseni nga Hodonoci dhe Hyseni tjetër nga Topanica.

Hafëz Kallaba punën e vet prej mësuesi e bënte me plot vullnet. Qëndrimi i tij prej mësuesi dhe hoxhe bënte që, jo vetëm në nxënësit e tij, por edhe vetë xhemati i tij mezi prisnim të takoheshim me të. Leximit dhe drejtshqiptimit të librit të shenjtë-Kuranit, ia kishin lakmi edhe shumë kolegë të tij në Anamoravë dhe më gjerë. Shkollimi fetar dhe jo vetëm ai fetar, për shqiptarët, për kohën dhe sistemin e atëhershëm, në njëfarë mënyre, ishte mollë e ndaluar. Prandaj, më 1946 Hafëz Kallabës i sugjerohet që ta ndërpresë zhvillimin e mësimin fetar. Pas insistimit të tij që të vazhdojë me mbjelljen e diturisë te brezat pasues, ai kërcënohet me burg. Kështu një ditë na mblodhi dhe me sy të përplotur na u drejtua: Djemtë e mi, ju kam dashur dhe ju dua shumë, por ja që pushteti është i atillë dhe nuk do që të na lejojë zhvillimin e mëtejshëm të mësimin.

Ky kufizim na preku të gjithëve, por më së shumti mësuesin tonë, Hafëz Kallabën. Pata gjashtë muaj që kisha filluar “hivzin” (leximin e Kuranit) te Hafëz Kallaba, pata përparuar mjaft në këtë lëmi, mirëpo, ndërprerja e mësimin, për mua, ishte si një krah i thyer për zogun fluturues. Në ndarje Hafëzi, pas një ofshame, si ato të prindit kur nuk mund t`u dalë

fëmijëve në ndihmë gjatë ballafaqimit me katastrofa elementare, më ndau anash dhe m'u drejtua: Idriz, ti do të vish fshehurazi tek unë dhe do të vazhdosh edhe një kohë mësimin. Këtë sakrificë të tij, për mua, nuk e kisha pritur, meqë isha i vetëdijshëm për pasojat që mund të kishte ai. Edhe pse vullneti im, talenti im, ishin një si mbulesë për sakrificën e tij për mua, ky gjest i Hafëz Kallabës ma shtoi edhe më shumë interesimin për mësim.

Ndonëse më parë banoja te një Haxhi Rasimi (me harxhime të tij), që të mos bie në sy, ndërrova vendin dhe shkova në Dajkoc, te Hamdi Dajkoci, dhe prej andej udhëtoja së bashku me nxënës, të cilët vijonin mësimet në shkollën e Roganës. Ç'është e vërteta, edhe nga ata nxënës pata mësuar shumë; rrugës, duke shkruar geramat në rërë, arrita ta mësoja edhe alfabetin shqip. Virtytin e Hafëzit prej pedagogu dhe udhëheqësi fetar e kuptova më vonë, kur u rrita dhe fillova t'i analizoja gjërat më drejt, e sidomos, kur takohesha me hoxhallarë, e më vonë edhe me kolegë të mi, të cilët me plot respekt flisnin për Hafëz Kallabën. Hafëz Kallaba gëzonte autoritet të madh, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, në rrethin e Bashkësisë Islame, ngase, për disa vite me radhë ishte anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame Fetare në ish-Jugosllavi, me seli në Sarajevë.

- Hafëzi që sëmure njëherë, dhe unë, paksa me vonesë shkova për ta vizituar. Punoja në Kopërnice dhe obligimet e përditshme në këtë fshat ndikuan që të vonohesha për vizitë, ndonëse e parashihja thujse çdo ditë. Megjithatë, një ditë, së bashku me Haxhi Shaqirin, Haxhi Zeçirin, Hamdiun, etj., shkua për ta vizituar. Aty gjetëm Mulla Mehmet Dobrosinin, Sylë Dajkocin, Metush Krasniqin. Gjatë qëndrimit tek ai, ma bëri një qortim të rreptë, me ç'rast u preka shumë. Zakonisht njeriu preket më tepër nga ai që e do. Sidoqoftë, unë mora leje prej tij që ta rrëfeja një tregim, rrëfen Hafëz Idrizi. – Urdhëro, më tha. Fillova tregimin- “Më 1956 fushën bukatore të rrethinës së Kumanovës e kishte mbytur breshëri. Fshatarët ishin tubuar dhe po qanin hallin e dëmeve që u kishte shkaktuar kjo e reshur e padëshiruar. Ajo anë njihej për kultivimin e duhanit dhe njëri syresh ishte shprehur me disfatizëm: - një pikë ekzistence që e kishim nga duhani, tani dështoi tërësisht. E pati puna jonë, ofshau fshatari. Pa përfunduar i pari, ia priti tjetri:- ore, lëre ti duhanin, se më me rëndësi është buka. Tani që mbetëm edhe pa bukë, si t'ia bëjmë? Prit, ore, se bukës i bëhet çareja dhe problemi zgjidhet, por çfarë t'u bëhet kafshëve që u shkoi kulloja. Një tjetër sikur desh i ngushëllonte pararendësit dhe u tha, edhe kjo çështje ka zgjidhje; ose blejmë ushqim për kafshë, ose ua japim kafshët atyre që kanë

ushqim të mjaftueshëm; fundja i therim ato dhe i hamë. E po atëherë, ku është halli, ndërhyri sërish bashkëbiseduesi i parë, dhe ai ia ktheu: nuk po e di, nëse Zoti e hoqi hidhërimin ndaj nesh me këtë breshër që na e lëshoi në tokën tonë, apo mbeti akoma i hidhëruar mbi ne”? Pas këtij rrëfimi Hafëz Idrizi iu drejtua Hafëz Kallabës. “A thua me këtë qortim që ma bëre a e lava borxhin, apo të mbeta ende borxh?” Me një ton autoritar dhe shumë burrëror, Hafëz Kallaba më tha: “Falë të qoftë!”

Kur vdiq Hafëz Kallaba, djali i tij, Tefiku, më autorizoi që ta udhëhiqja ceremonialin e varrimit. Me kënaqësi pranova. Për herë të parë deri në atë varrim më ka ndodhur që të shoh sesi arkivoli i një njeriu të bartet pa drunj. Pra njerëzit e pranishëm e dërguan në duar tabutin me trupin e Hafëz Kallabës. Shihej sikur ata njerëz donin ta preknin me duar tabutin e tij dhe, që të gjithë ishin me lot në sy. Gjatë jetës sime, deri në atë kohë, nuk pata përjetuar që dikush të kishte pasur aq shumë autoritet.

*(Hafëz Idriz Dërmaku, prill 1996, Shipashnicë e Epërme)*

## Hosteni dhe incidenti me xhandarët bullgarë

Ymer Latif Kallaba po lëvronte në një arë të veten në “Kanik” (në juglindje të fshatit Roganë). Lavra ishte paksa e vështirë dhe buajt mezi tërhiqnin plugun. Herë pas here Ymeri i therte me hosten, në majë të të cilit kishte vendosur një thumb të mprehtë. Pak më poshtë, dy xhandarë bullgarë po patrullonin zonën kufitare. Ishte viti 1917, kur kjo zonë kontrollohej nga mbretëria bullgare, e karakollët e bullgarëve shtriheshin nga Muhoci deri te varrezat e Breznicës së Poshtme. Njëri nga xhandarët ishte bërë kureshtar kur kishte parë se si buajt reagonin shpejt kur thumboheshin nga lavërtari. Lëshuan rrugën dhe u afruan te lavërtari Ymer. Puna e mbarë, i thanë lavërtarit. Mbarë paçi, ua ktheu Ymeri, paksa i habitur që xhandarët kishin lëshuar rrugën për t’u afruar tek ai.

Përse po kërcejnë buajt, kur po i prek me hosten, çfarë ka në majë të hostenit, pyeti xhandari?

Në majë të hostenit e kam vendosur një thumb të mprehtë, që t’i shpërthejë nga pak, sepse janë shumë të ngadalshëm, sqaroi Ymeri.

- Aha, - ma jep hostenin, iu drejtua xhandari Ymerit. Xhandari mori hostenin, po e sheh se sa i mprehtë ishte thumbi dhe iu drejtua Ymerit. Pasi qenka puna kështu, pse nuk e ke vendosur edhe një thumb në pjesën tjetër dhe, kur ta thumbosh ti buallin, ta thumbosh edhe dorën tënde këndeje. Kështu do ta kesh parasysh se sa fort po e thumbon kafshën.

- Paj, ashtu më dhemb dora, ia ktheu Ymeri, dhe filloi t’i dridhej paksa zëri.

Xhandari bullgar, drejtoi hostenin nga Ymeri dhe e shpërtheu disa herë. Pastaj, u egërsua edhe më shumë dhe e rrahu me hosten, duke e shtrirë përtokë.

“E, sega produlzhavaj otново da biesh bivolite, he mamkata ti ...! (e, tash vazhdo sërish t’i rrahësh buajt, he nënën...!).

Nga ky qytek Ymeri kishte qëndruar një javë i shtrirë në shtrat.

Katër ditë më vonë, mixha Qazim i Ajetit të rrudhanëve kishte mbrehur buajt në zgjedhë dhe kishte shkuar për të lëvruar te “Bregu i Linit”. Afër bregut kishte

qenë duke lëvruar edhe Shefkiu i Abazit, që ishte vetëm 15 vjeç. Një xhandar bullgar kishte urdhrin nga shtabi që të rekrutonte disa fshatarë për punë angarie (punë e detyrueshme pa shpërblim). Kur afrohet te Shefkiu, e vëren se ai ishte ende i njomë në moshë, kështu që vazhdon te lavërtari tjetër, që ishte në arën tjetër, vetëm disa metra më larg. Këto dy ara i ndante një mezhde gati dy metra e lartë. Mixha Qazë nuk i bindet urdhrin të xhandarit, gjë që pason një përleshje mes tyre. Qaza ishte i fuqishëm dhe e shtyn xhandarin në drejtim të mezhdës, i cili rrokulliset arës teposhtë. Pas këtij incidenti Mixha Qazim çmbreh buajt dhe ikën në drejtim të muhaxhirëve e pastaj ishte fshehur, deri në mbrëmje, te Zabeli i Madh.

Xhandari kthehet në shtab dhe informon për situatën e krijuar. Pas pak, rreth 30 ushtarë/xhandarë vërshojnë shtëpinë e Shefkiut. Xhandari i dëmtuar tregon se ky nuk ishte ai prej të cilit ishte lënduar. E pyesin për Qazën, por ai nuk u tregon se nga kishte ikur. Ia japin dy shuplaka dhe e marrin me vete që t'ua tregonte shtëpinë e Qazimit. Para dyerve të shtëpisë së Qazimit ishin ndalur buajt. Xhandarët hyjnë brenda, pyesin për të zotin e shtëpisë, por gratë u thonë se mixha Qazim me djalin janë duke lëvruar te bregu i "Linit". Ndërkohë në oborr mbliidhen edhe disa fshatarë. Krijohet një rrëmujë rreth sqarimit të situatës. Xhandarët e kishin marrë Faikun e vogël të mixhës Qazë, e kishin vënë në cung të druve dhe i kishin kërcënuar familjarët që, nëse nuk paraqitet Qazimi, do t'ia prisnin djalin. Në ato momente në oborr hyn imami i fshatit, hafëz Shefki Kallaba. Kërkon nga përgjegjësi i grupit që ta informojë për situatën. Ata ishin tërbuar me veprimin e mixhës Qazim dhe për ta shtendosur situatën, hafëzi kërkon nga xhandarët që ta lirojnë fëmijën dhe hyn dorëzanë (garant) se do ta dorëzojë Qazimin në shtab, por që i duhet ca kohë. Pas këtij garantimi, xhandarët kthehen në shtab. Ata nuk parapëlqenin të patrullonin natën, kështu që këtë mundësi e kishte shfrytëzuar mixha Qazim, i cili kthehet në shtëpi dhe organizohet me familje që të ikë për në Truqi, sepse nuk e ndiente tutje veten të sigurt në Roganë. Shkon te fqinjët e parë, te mixha Ramadan e mixha Mehmet, dhe i pyet nëse duan ta blejnë pasurinë e tij, duke u shpjeguar për ngjarjen me xhandarët. Ata i thonë se nuk janë të interesuar për të blerë tokë. Me gjasë nuk dëshironin që fqinji i tyre ta lëshonte vendin.

Pas faljes së akshamit, hafëz Kallaba shkon te mixha Qazim, prej të cilit mëson tashmë për qëllimin e tij. Prej aty shkon te Ramadani e Mehmeti dhe u lutet që ta ndihmojnë materialisht Qazimin që të largohet përkohësisht, sepse pasojat



do të jenë shumë të mëdha për Qazimin dhe familjen e tij. Që të dy i japin edhe hoxhës të njëjtën përgjigje. Atëherë, i ndodhur në një situatë të vështirë, Hafëz Kallaba ia jep nga xhepi i vet Qazimit tri lira, që të mund të largohet përkohësisht, sa më shpejt, nga shtëpia.

Hafëz Kallaba, që ishte rreth 28 vjeç, ishte njeri me autoritet, jo vetëm në rrethin ku jetonte, por edhe më gjerë. Mirëpo, zgjidhjen e këtij problemi nuk e shihte në nivel lokal, prandaj, që atë ditë, vendos të shkojë në Shkup. Shpejt shkon në shtëpi, vishet mirë, me kat teshash e me kravatë, e vesh edhe xhyben e zezë, organizon një çeze dhe nisat drejt Ferizajt. Prej Ferizajt rrugën e kalon me tren. Sapo arrin në stacionin e Shkupit, zbret nga treni, e paguan një pajton që ta dërgojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bullgarisë. Në ministri ua sqaron incidentin e ndodhur në fshatin e tij Roganë, duke i informuar edhe për sjelljen brutale të xhandarëve në terren dhe pengimin në punët e fushës. E kishin kuptuar shumë drejt Hafëzin dhe ia kishin lëshuar një vërtetim, me të cilin Qazim Rudhani lirohet nga ndjekja e mëtejme e xhandarëve.

Me të kthyer të Hafëz Kallabës në Roganë, ai kërkon të takohet me eprorin e xhandarëve në këtë terren. Ia dorëzon letrën e ministrisë komandantit të xhandarmërisë, i cili e lexon dhe i urdhëron xhandarët e tij që të mos e ndjekin Qazimin dhe të jenë më korrektë me fshatarët.

Prej shtabit, Hafëzi shkon edhe te familja e mixhës Qazim, por ai tashmë ishte rrugës për në Turqi. Sidoqoftë, fshatarët tashmë ishin të lirë t'i punonin tokat e veta. Në njëfarë dore Hafëz Kallaba bëhet sebeb që të pengohet edhe shpërngulja e mëtejme e rogasve për në Turqi.

Mixha Qazim me gruan dhe djemtë, Faikun e Sadikun, ishin vendosur në qytetin Yalova të Turqisë. Më vonë i kishin lindur edhe dy fëmijë, njëri prej të cilëve kishte arritur gradë të lartë oficeri dhe shërbente në Stamboll, kurse të tjerët kishin punëtori për riparimin e autobusëve.

Në vitet '80 familjen e mixhës Qazim e vizitojnë disa rogas, si: Shefket Rrudhani, Salih Shabi Rrudhani, Fehmi Kallaba etj. Ata i lusin kushërinjtë e tyre që të kthehen në Kosovë, por ata kishin vendosur të jetonin në Turqi, meqë ishin ambientuar e ishin integruar mirë.

Në fakt, i pari nga kjo anë që e kishte vizituar mixhën Qazim kishte qenë Idriz Beqiri nga Hodonoci, i cili nga presioni i aksionit të armëve, më 1956, emigron në Turqi ku edhe takohet me familjen e Qazimit.

*(Tregim i hartuar nga rrëfimi i Fehmi Sh. Kallabës /shkurt 2006/ dhe i vërtetuar nga Fehmi K. Kryeziu e Ramadan A. Kryeziu, Roganë - shkurt 2020)*

## Hafëz Kallaba në mbrojtje të pleqve e fëmijëve të pafuqishëm

Ishte viti 1979, unë punoja në Radiotelevizionin e Prishtinës dhe udhëtoja çdo ditë nga Koretini për në Prishtinë. Një pasdite kisha shkuar në Roganë te axha im, Hyseni. Në mëngjes hipa në autobusin e punëtorëve që shkonte për Dardanë dhe zbrita në Crep për ta pritur autobusin që mbante linjën Dardanë-Prishtinë. Derisa po prisja autobusin, aty dikush kishte ndezur një zjarr dhe po ngrohej. U afrova edhe unë, sepse mëngjesi ishte paksa i freskët. Ishte po ashtu një udhëtar rasti. E përshëndeta me “mirëmëngjesi”, kurse ai ma ktheu me “dobro jutro”. Biseda përfundoi me heshtje, derisa ai më pyeti se për ku po udhëtoja dhe prej nga vija. I thashë se jam nga Koretini, por me prejardhje nga Rogana. Më tha se udhëtonte për në Beograd, meqë atje punonte, por vinte nga fshati Kolloleq. Sërish heshtje, sërish ai më pyeti: the se ke prejardhje nga Rogana? Desha të të pyes diçka, nëse guxoj, më tha serbi nga Kolloleqi. - Po, patjetër, ia ktheva. A është gjallë një hafëz Kallaba dhe a e njeh? - më pyeti. Nuk i tregova se çka e kam, por e pyeta se çfarë e lidhte atë me hafëzin. “E kam një kujtim nga fëmijëria për atë njeri, prandaj po pyes.” Atëherë i thashë se Hafëz Kallaba ka ndërruar jetë qysh më 1968 dhe sapo desha t’i tregoja se ai ishte gjyshi im, serbi ia plasi vajit, bile filloi edhe të dëneste. Iu afrova dhe po i rrihja supin, për ta qetësuar paksa. I thashë se ai njeri ishte gjyshi im. Atëherë më përqafoi dhe më shtrëngoi fort. U stepa, nuk dija se si ishte puna, por e pyeta edhe një herë: Çfarë të lidh ty me Hafëz Kallabën? Prej nga e njeh? U qetësua pak dhe m’u drejtua. “Atij njeriu ia kam borxh jetën, jo vetëm unë, por shumë fëmijë, gra e pleq të Kolloleqit.” Isha kureshtar të dija më shumë. I thashë se do të ishte mirë të më tregonte në shpejtësi, sepse së shpejti vjen autobusi për Prishtinë. Atëherë ai kaloi menjëherë në temë. “Kam qenë fëmijë, por e di se ngjarja ka ndodhur në kohën e Shipnisë së Madhe, i thoshin atëherë. Burrat e fshatit Kolloleq kishin dalë në mal, disa ishin me çetnikë e disa me partizanë. Në gjithë fshatin kishin mbetur vetëm pleq e plaka, gra e fëmijë të vegjël. Kishin frikë të madhe nga ndonjë hakmarrje e shqiptarëve për shkak të sjelljes brutale të disa çetnikëve. Dikush prej pleqve tanë kishte kërkuar ndihmë nga imami i Roganës. Atëherë, imami kishte organizuar njerëz nga fshati i tij dhe na patën sjellë të gjithëve në xhaminë e fshatit Roganë. Aty na patën mbyllur për disa ditë, ose javë, tani s’më kujtohet bash mirë. Për çdo ditë na sillnin ushqim e ujë. Në hyrje të xhamisë ishin të vendosur dy burra, që bënin rojë me armë. Ishte e qartë se ata na ruanin që të mos sulmoheshim nga ndokush. Një ditë, për dritare pamë një kolonë ushtarësh. Nëna ime u shqetësua shumë dhe më mori

ngrykë; më përqafoi aq shumë, sa fillova të dridhesha nga frika. M'i përkëdheli faqet dhe më tha: mos ki frikë, biri im, se këtu jemi në shtëpi të zotit e nuk na gjen asgjë e keqe. U qetësova paksa, por e vëreja një shqetësim të gjithë të pranishmit. Një plakë afër nesh, përvajshëm tha: "kuku, lele majke, ima da nas ubijaju, to su albanski vojnici" (kuku nëna ime, tash do të na vrasin, ata janë ushtarë shqiptarë). E vërejtja se si nëna ime i tha të kishte kujdes që të mos frikësoheshin fëmijët.

Një plak u afrua te dera dhe po dëgjonte se ç'po flitej zhurmshëm përjashta. Dikush kërkonte nga roja që të hynte brenda dhe të na merrte. Roja u kishte thënë se ata duhet të drejtohen te Zyra e hoxhës. Të gjithë u bëmë sy e vesh. Se kush e hapi pak dritaren dhe biseda dëgjohej edhe më mirë. Pleqtë kuptonin shqip. Përjashta kishte ardhur një grup vullnetarësh dhe po e kërcënonin imamin e fshatit që, nëse nuk i dorëzon këta serbë, do të ketë telashe të mëdha. Hoxha ishte këmbëngulës në mbrojtjen tonë, saqë iu drejtua komandantit: Nëse do të luftosh me serbët, ata janë diku në male, shko atje dhe lufto e vrit sa të mundesh, porse këta janë të gjithë pleq, gra e fëmijë të vegjël dhe janë në mbrojtjen time në këtë shtëpi të zotit. Ju këta nuk mund t'i vrisni, pa më vrarë mua dhe gjithë fshatin, ia kishte kthyer rreptë Hafëz Kallaba, komandantit. Atëherë kolona e vullnetarëve ishte kthyer prapa. Kurse ne që ishim brenda iu gëzuam shumë këtij shpëtimi. Pas disa ditësh na kthyen në fshat, por unë këtë ngjarje nuk e harroj kurrë, prandaj ndjeva dhembje të madhe, kur dëgjova se ai hoxhë kishte ndërruar jetë, përfundoi serbi nga Kolloleqi këtë rrëfim rrëqethës.

Shumë interesant, ia ktheva unë këtij serbi dhe sikur e qortova: - Po ku ishit, pra, ju, serbët e Kolloleqit, kur po atij hoxhe, në fund të vitit 1944, serbët ia morën djalin kinse në bisedë informative dhe e masakruan, pa iu ditur varri as edhe sot; po ku ishe ti dhe serbët e Kolloleqit, kur serbët e Kamenicës e përjashtuan babanë tim nga arsimit më 1962, vetëm e vetëm pse ai donte t'i mësonte fëmijët shqiptarë në gjuhën amtare. "Eh, tako mi boga, vi ste bolji od nas, to mora da priznam, ali ja sam nemoćan ni da branim, ni da pomognem nekoga. Eto, i sam moram da radim u Beograd, jer ovde ne mogu da se zaposlim" (Eh, pasha Zotin, më duhet ta pranoj, ju jeni më të mirë se ne, por unë jam i pafuqishëm që të mbroj e të ndihmoj dikë. Ja, edhe vetë më duhet të punoj në Beograd, sepse këtu nuk mund të punësohem", përfundoi. Më erdhi keq që ndërkohë erdhi autobusi dhe u desh të ndahesha pa arritur t'ia mësoja as emrin.

Në mbrëmje, kur u ktheva nga puna në shtëpi, ia rrëfeva ngjarjen babait tim dhe e pyeta se kush ishte roja te xhamia? Ai, sikur deshi t'i shmangej këtij muhabeti, por, pas këmbënguljes sime, tha se ashtu kishte qenë. “Ndërkaq, rojë kemi bërë unë, Faiku e ndonjë kushëri tjetër. Sidoqoftë, më duhet ta pranoj se babai ynë ka pasur virtyte të larta njerëzore dhe gjithmonë ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta. Më duhet të them se ka qenë tepër i drejtë dhe atdhetar i vërtetë, e ka dashur shumë këtë vend. Prandaj, nuk ka dashur ta lëshonte për asnjë kusht”, tha aga Tefik për gjyshim tim, Hafëz Kallabën.

*(Xhevdet Kallaba, kujtim nga një takim rasti me një serb nga Kolloleqi)*

## Ndikimi i egjrës



*Muharrem Kallaba*

Një ditë, pasi hëngra bukë, e mora kalin për të dalë në Crepanë për ta pritur gjyshin (Hafëz Kallaba), i cili po kthehej nga një mbledhje në Sarajevë. Duke shkuar rrugës, hipur mbi kalë, kisha përshtypjen e një çekuilibrimi, kisha një lloj marramendje, por nuk isha i vetëdijshëm se çfarë po ndodhte me mua. Në Crep, kur erdhi gjyshi, ia dhashë kalin. Ai hipi mbi të, kurse unë ecja në këmbë.

Gjatë rrugës gjyshi m'u drejtua: "Çka po ecën ashtu, si të ishe i dehur?" Nuk e di, i thashë, hëngra bukë dhe u nisa për në Crep. Ai menjëherë konstatoi se mielli me të cilin ishte bërë buka ka qenë me egjër. Kur arritëm në shtëpi, vërejtëm se të gjithë anëtarët e familjes kishin qenë të ndikuar nga egjra.

*(Tregoi: Muharrem Kallaba, më 15 janar 2010, Roganë)*

## Aty ku merr dije nuk bën të mbjellësh urrejtje



*Selman Geci*

Baba Hoxhë (kështu e thërrisnin bashkëfshatarët) e pyet njëherë Selman Gecin: Ku je në shkollë? Jam duke mësuar te serbët, - i përgjigjet Selmani.

“Aty ku merr dije, nuk bën të mbjellësh urrejtje”, - i tha hoxha Selmanit.

Njëherë ishte sëmurrur Rama (Ramadan Geci) dhe kishte pasur ethe. Nëna e tij kishte shkuar te Hafëz Kallaba për t'i shkruar ndonjë hajmali. Ai i thotë se nuk shkruan, por hap një libër (qitap) dhe lexon diçka. E pyet gruan e Metushit (nënë e Ramës), nëse ka ndonjë dele, ose le ta blejnë një dele dhe ta therin. Menjëherë ta rrjepin dhe Ramën ta mbështjellin me lëkurën e deles për disa ditë.

Ashtu edhe ishte bërë. Pas këtij veprimi, Rama kishte shpëtuar pothuaj nga vdekja, sepse kishte qenë në gjendje shumë të rëndë shëndetësore.

*(Tregoi: Selman Geci, 21 janar 2016)*

## Kujdes gjatë vizitës tek i sëmuri



*Sejdi Kryeziu*

Axhën Hafëz e vizitonim shpesh, madje për shumë gjëra edhe konsultoheshim me atë. Në këshillat e tij kishte shumë pozitivitet, anise ndonjëherë ato ishin edhe me spec. Përvoja jetësore e kishte mësuar, kur duhet bërë kompromis, e kur jo. Kryesisht për vizitë shkoja bashkë me Metushin. Axha Hafëz ishte largpamës. Tehun e bisedës përherë e drejtonte kah arsimimi i popullit shqiptar. Shpesh thoshte se arsimi është bazë e fortë edhe për politikën.

Një ditë prej ditësh kuptova se ishte i sëmurë. Bashkë me Metushin i shkuam për vizitë. Kishte respekt të veçantë për angazhimin tonë arsimor e sidomos politik. Sëmundja e kishte

lodhur paksa, por iu gëzua vizitës sonë. Të etur për muhabet me axhën Hafëz sikur harruam se ai ishte i sëmurë. Megjithatë ai nuk jepte shenja se po lodhej nga qëndrimi ynë i stërzgjatur. Pas një kohe e zuri momentin për ta treguar një mesele pa dashur që të bënte presion te ne. “Njëri kishte shkuar për vizitë te një i sëmurë. Kur vizituesi kërkoi lejen për të shkuar në shtëpi, i sëmuri e porositi që ta bënte një lutje te Zoti për të sëmurin. Lutja do të ishte: “Allahu ia kujtoftë vizituesit sa me ndejt tek i sëmuri”. Kjo mesele fliste qartë për përfundimin e kësaj vizite. I kërkua falje dhe morëm leje për të shkuar. Buzëqeshi paksa, dhe megjithatë na tha: “Ju pres sërish për vizitë”!

*Tregoi: Sejdi Kryeziu, vitet '90*



## Çdo tepri kalon në neveri



*Gani Dervishi (Selmani)*

Daja Hafëz (kështu e thërriste Gani Dervishi Hafëz Kallabën), sa herë vinte në Koretin te daja Tefik unë e vizitoja.

Daja Hafëz ishte i këndshëm dhe shumë i arsyeshëm në bisedë, sidomos në konkluzione e në këshilla. Njëherë, kur u liruam paksa më shumë në një bisedë burrash, ndërpreu muhabetin tonë me një thënie: “Meraku është më i zi se gjaku, ndërsa sevdaja më e zezë se belaja”, prandaj asgjë nuk duhet tepruar, sepse çdo tepri të krijon neveri, pati thënë daja Hafëz.

*(Tregoi Gani Dervishi (Selmani) në Koretin, më 22 dhjetor 2008)*

## Largimi i shërbëtorit Mon

Duke pasur shumë punë të fushës, gjyshi kishte marrë një shërbëtor që e quanim Mon. Ai ishte me profesion kovaç, kështu që edhe e quanin Mon Kovaçi. Moni ishte një rom tashmë i vendosur në Roganë. Kishte dhe djemtë: Demiraliun e Ramadanin. Moni punonte fushën tonë, dhe, sipas nevojës, angazhonte edhe familjarët e tij, sidomos gjatë punëve verore (prashitje, korrje etj.). Pleqtë tanë ia kishin dhënë edhe një vend për ta ndërtuar një kovaçhanë, afër shtëpisë.

Babai, Tefiku, ishte i pasionuar pas buajve. Sapo kthehej nga shkolla, linte çantën dhe shkonte drejt në ahur për t'u kujdesur për ta. Me shërbëtorin (Monin) nuk kalonte aq mirë, ngase ai ia mundonte buajt. Disa herë ishte ankuar te babai, por nuk i kishin besuar. Një ditë prej ditësh, kur Tefiku ishte vetëm 9 vjeç, kishte shkuar për ta ndihmuar Monin në lavrën e ugarit.

Baba Hoxhë nuk kishte kohë të merrej me bujqësi, por përpiquej që shërbëtorit t'ia plotësonte kushtet e punës. Ai kishte blerë edhe një plug me plor të madh e të gjerë, i cili ishte më i rëndë se parmenda dhe aga Tefik kujtonte se me përdorimin e plugut po dërrmoheshin buajt. Kështu, duke lëvruar arën me Monin, e luste që të bënte kujdes për buajt; sapo e fuste Moni plugun pak më thellë në tokë, ai mendonte se këtë po e bënte me qëllim. Në fakt Moni ishte i vetëdijshëm për fuqinë e buajve, që ishin shumë të majmë, dhe ishte përqendruar në lavër e nuk preokupohej me brengën e Tefikut të vogël. Ai, shpesh u bërtiste buajve, madje ndonjëherë edhe i shpërthente me hostenin që në majë kishte një thumb. Situatat e këtilla Tefiku vështirë i përballonte dhe reagoonte ashpër ndaj Monit. Njëherë, me një ton paksa kërcënues i thotë Monit që edhe një herë të mos i thumbonte buajt. “Nëse edhe një herë ma thumbon buallin, dije se nuk të ndihmoj në lavër”, i drejtohet Tefiku Monit, ndërsa ky i fundit ia kthen: “Ec, more, ti ngrihi buajt aty, se nuk e di çka asht likura e bullit”, dhe ia fut edhe një herë thumbin e hostenit në vithet e buallit, saqë ai kërcen nga dhembja. Këtu qe fundi i durimit të Tefikut, i cili në dorë po ashtu mbante një shkop. Lëshon buajt dhe ia mëshon Monit me shkop në kokë, duke i thënë: - “A koka mirë kështu!” Moni kap kokën me dorë, sepse, sado që Tefiku ishte i vogël, kjo e goditur i kishte shkaktuar dhembje të madhe. I liron buajt nga plugu, ashtu me zgjedhë i çon në ahur dhe shkon drejt te Hoxha. Baba Hoxhë nuk ishte aq i rreptë me shërbëtorin, që e trajtonte pothuaj si të ishte anëtar i familjes. Moni, si pa frymë, i tregon Hoxhës se çfarë i kishte bërë biri

i tij, Tefiku. Babës Hoxhë i vjen shumë keq dhe i thotë se do ta diskutojë këtë çështje me Tefikun. Tefiku pas kësaj ndodhie ishte fshehur te të afërmit në lagje. Sidoqoftë, në mbrëmje, ai duhej të vinte në shtëpi.

Gjatë darkës, baba Hoxhë, që kryesisht hante veçmas nga anëtarët e familjes, kësaj radhe donte të hante darkën bashkë me gjithë familjen. Pasi hanë darkë, baba Hoxhë i drejtohet Tefikut: Tefik, çka ke pasur ti sot me Monin, përse ia ke mëshuar me hosten? Tefiku ende ishte i zemëruar në Monin, porse ishte i vetëdijshëm për gabimin dhe i përgjigjet: Vallahi, bre babë, unë e luta Monin që të mos i rrihte buajt, por ai, si për inat timin, vazhdimisht i shpërthente me hosten. Atëherë në një moment nuk munda të përmbahesha dhe, edhe unë i mëshova atij. Baba Hoxhë e dinte se sa ishte Tefiku i përkushtuar për buajt si edhe për punët e tjera të shtëpisë, mirëpo nuk e arsyetonte veprimin ndaj Monit, për më tepër kur fëmijët janë të gjithë të vegjël dhe kush do të punonte në fushë, nëse jo Moni. Megjithatë, ai i drejtohet Tefikut. “Po, mirë, bre Tefik, nëse ne e largojmë Monin, kush na i bën punët tona. Ti je i vogël, Ilmiu është në shkollë, në Shkup, fëmijët e tjerë janë edhe më të vegjël; a mund t’i kryesh ti të gjitha punët që Moni i kryen për ne?” Tefiku, i mllefosur me Monin, ia kthen: “More, unë i kryej të gjitha punët e fushës, vetëm nuk dua që ai të m’i rrahë buajt.” “Atëherë, pra, prej ditës së nesërme, ti do të merresh me punët e fushës, kurse shërbëtorin – Monin, do ta largoj nga puna.” Ashtu edhe ishte bërë, mirëpo Tefikut i mbetën të gjitha punët e fushës për t’i bërë vetë. Atij i ndihmonin Fehmiu e Faiku me Nazmiun, por të tjerët ishin edhe më të vegjël. Ky angazhim e kishte lodhur shumë Tefikun, por ishte i lumtur që Monin e kishte hequr qafësh.

## Kujtime për gjyshin tim

(Xh. Kallaba - nga Ditari im: 21 mars 1968)

Çështë e vërteta, kur gjyshi im ndërroi jetë, unë sapo isha bërë 15 vjeç. Ne jetonim në Koretin, ndërkaq ai në Roganë, dhe me të takohesha kur shkonim për pushime në Roganë. Sidoqoftë, në ditarin tim i kam përshkruar disa kujtime me gjyshin, por edhe ditën e ndarjes së tij nga jeta. Kështu që, në vazhdim po e jap këtë pjesë të ditarit.



*Koretin, qershor 1967 - Nga e majta: Elhamiu, Selamiu, Tefiku, Hafëz Kallaba, Naxhija, Drita, Xhevdeti, Reshati*

### Sa (s')e njoha gjyshin tim Hafëz Shefki Kallabën

Babai im, Tefiku, me familje jetonte në fshatin Koretin, ku punonte si mësues në shkollën fillore të këtij fshati që nga viti 1955. Prej vitit 1957-1960 u transferua për punë në Aligeraj të Preshevës dhe Pogradjë të Gjilanit, ndërkaq nga viti 1960 kthehet sërish për të punuar në Koretin.

Ndonëse, në Roganë shkonte shumë shpesh, sidomos gjatë fundjavës, në muajin mars të 1968-tës ai i kishte shpeshtuar vizitat edhe më shumë. Shkak

ishte sëmundja e prindit të tij, hafëz Shefki Kallabës. Babai, pothuajse për çdo ditë udhëtonte Koretin-Roganë. Nga fundi i shkurtit të '68-s Hafëzi ishte shtrirë në spitalin rajonal të Gjilanit për t'u kuruar nga një sëmundje e mushkërive. Kishte pasur një përkujdesje të veçantë nga mjekët Dr. Remziu, Dr. Zeqirjaja etj. Hafëzin, në spital e vizitonin shpesh edhe nipat e tij, Hysi, Mehmeti, Xhevati, Sabedini; mbesat, Sahadetja, Ismetja e Hasibja; bijat, Sabrija, Fetija e Zehra, pastaj dhëndurët, Refik Hoxha, Rabbit Rexhepi e Abdylaziz Veseli, si dhe shumë miq e dashamirës që jetonin në Gjilan. Rrallëherë i ndodhte ta merrte ushqimin e spitalit; vazhdimisht i përgatisnin të afërmit gjilanas në shtëpi dhe ia sillnin të freskët në spital. Mosha e shtyrë e Hafëzit, por edhe sëmundja, e kishin lodhur atë së tepërmi. Gjyshin e kishin sjellë në shtëpi. Ai po numëronte ditët e fundit të jetës së tij. Babai, tani e vizitonte për çdo ditë. Ai kishte blerë një biçikletë dhe kështu çdo ditë shkonte në Roganë, atje rrinte tërë natën dhe të nesërmen vinte në Koretin, mbante mësimin dhe sërish shkonte në Roganë. Ato ditë, që të mos ndiheshim vetëm, me ne, shpesh, rrinte daja Rasim, i cili edhe ashtu ishte me banim në Koretin.

Natën e 20 marsit 1968, daja Rasim, ishte njoftuar për gjendjen e përkeqësuar të Hafëzit. Me babanë, Tefikun, kishte shkuar edhe nëna ime, Naxhija, prandaj, daja Rasim kishte ardhur te ne më herët sesa zakonisht. Në mëngjesin e datës 21 mars 1968, derisa po bëja disa detyra shtëpie, iu drejtova dajës Rasim me pyetjen: pse je ende këtu e nuk paske shkuar në shtëpi? Ai, ditën zakonisht shkonte në shtëpinë e vet. - Ai më tha se do të rrinte edhe pak me ne fëmijët. Ishte më i mërzhitur se ditët pararendëse. Nga ofshama e tij e shpeshtuar, supozova se diçka kishte ngjarë dhe iu drejtova: dajë, ende nuk erdhën ata, duke aluduar në prindërit e mi, që kishin shkuar në Roganë. – Tash vijinë, ndoshta – ma ktheu dhe nxori kutinë e po e dridhte një cigare duhan. Derisa e dridhte, disa herë më shikoi. Sytë e tij flisnin mjaft, por unë isha i ri dhe nuk hamendja se diçka kishte ndodhur. Në momentin derisa po e lagte letrën e duhanit, duke e përshkuar nëpër buzët e lagura, m'u drejtua me fjalët: mos u mërzhit dajës, se hafëzi kishte ndërruar jetë. Në sytë e tij vërehej qartë një dhembje e thellë që po e përjetonte në ato çaste. Me hafëzin kishte një miqësi të dyfishtë; sepse hallën e vet e kishte pasur të martuar për hafëzin, por edhe motrën për djalin e tij, pra, për babanë tim, Tefikun. Në ato çaste dhomën e kishte kapluar një qetësi e zymtë. Skaj meje ishin edhe vëllezërit e mi më të vegjël, Elhamiu, Selamiu e Reshati si dhe motra - Drita. Më takonte edhe mua që t'i ngushëlloja këta. Sapo i kisha mbushur të 15-tat, por ndihesha disi i pjekur. Iu drejtova dajës Rasim

me kërkesën që ai të vazhdonte të qëndronte me fëmijët e tjerë në shtëpi, ndërsa unë do të nisesha për në Roganë që të merrja pjesë në ceremonialin e varrimit të gjyshit tim. – A nuk frikësohesh, m’u drejtua daja? Assesi, i thashë dhe me të shpejtë u bëra gati. Nuk kishte qarkullim automjeteve dhe rrugën prej afro 8 km e kalova shumë shpejt.

Me të arritur në Roganë, hapësira rreth tyrbes, ku edhe banonte gjyshi im, ishte nxirë nga njerëzit që kishin ardhur për t’i dhënë lamtumirën e fundit. Nuk mbahej mend që në atë kohë dhe në ato anë të kishte pasur më shumë pjesëmarrës në varrim. Kortezi, fillimin e kishte në xhaminë e fshatit, ku edhe varrosej Hafëzi, kurse fundin ende në oborrin e shtëpisë prej nga ishte nisur funerali. Sa i ri që isha, prania e gjithë atyre njerëzve sikur më kishte obliguar që nga ajo ditë të kisha respekt më të shtuar për të gjithë njerëzit. Fitoja përshtypjen se sa (s’)e njihja gjyshin tim, Hafëz Kallabën? Në fakt, nuk e njihja sa duhet gjyshin, sepse fare pak më kishte rënë të kontaktoja me të. Duke qenë se babai im ishte punëtor arsimit dhe në ato kohë mësuesve, shteti i atëhershëm, ua ndërronte shpesh vendin e punës, duke i transferuar nga fshati në fshat. Unë as që isha lindur në vendlindjen e babait tim, në Roganë, por isha lindur në fshatin Kopërnice, më 3 mars 1953, kur ai ishte me shërbim si mësues në atë fshat. Natyrisht, pushimet verore i kalonim në Roganë, por ishte një veçanti tjetër, që gjithashtu e pamundësonte njohjen më të thellë me gjyshin – qëndrimi fare pak me të, sepse ai kishte një zakon të rrallë të organizimit ditor; zgjohej herët në mëngjes, për të shkuar në xhami për faljen e namazit të sabahut, dhe kur kthehej bënte sërish një gjumë. Sapo zgjohej, hapte qitapët e tij dhe tërë kohën lexonte e shkruante mbi një tavolinë të ulët, që e quanin “rrahle”.

Gjatë verës kalonim pushimet, ne, nipërit dhe mbesat e tij, që vinim nga Koretini, nga Ferizaj, nga Kamenica e nga Gjilani dhe gjithsesi luanim lojëra fëmijësh, e herë-herë ia prishnim edhe gjyshit qetësinë. Por, asnjëherë nuk më kujtohet të na qortonte gjyshi. Me kureshtje të madhe, ndonjëherë, shkonim afër derës që, kur ia sillnin gratë kafënë ose bukën, ta vrojtonim duke lexuar në atë “rrahle” e ulët, pakëz mbi nivelin e gjunjëve të tij, ulur këmbëkryq. Të kontaktoje me të ishte një privilegj për ne nipërit e mbesat e tij. Kishte edhe shumë vizita nga hoxhallarë dhe njerëz të kohës së tij. Rrinte më shumë në odë, e ndërtuar enkas për mysafirë. Kishte familje dhe shoqëri të madhe, pra, kishte edhe shpenzime të mëdha.

Më kujtohet njëherë kur më dërgoi në dyqan për të blerë ca gjëra. Unë me kënaqësi shkova për t'i kryer shërbimin dhe me disa para të imëta nga kusuri bleva karamela për vete. Kur ia ktheva kusurin, e vërejti se po i mungonin 5 dinarë (të barabartë me nja 10 kokrra bonbone) dhe më pyeti përse nuk ia kisha kthyer gjithë kusurin. Kur i tregova se e kisha “qerasur” vetveten me 5 dinarë për shërbimin e bërë, duke qeshur, më qortoi me fjalët: ti je mësuar me babanë tënd që të mos ia kthesh kusurin tamam, por këtu tek unë ka rregull dhe tjetër herë të mos përsëritësh ky gjest. - Sa “tahmaçar”, thashë vetë me vete, duke mos analizuar se ai kishte një grumbull nipërisht e mbesash dhe se, nëse secili do të vepronte kështu, atij do t'i zbrazej kuletat. Sidoqoftë, kishte durim dhe nuk egërsohej kur, ndonjëherë, bënim zhurmë pranë dritares së dhomës ku ai lexonte. Sikur ushqehesh edhe me zhurmën e nipave e të mbesave, nga të cilët, sidomos gjatë pushimeve verore, i mbushej oborri.

Njëherë, derisa Sabedini (djali i vajzës së madhe, Sabrijes) po i bënte një fotoportret, u afruam unë dha djali i mixhës tim, Faruku, për t'u fotografuar së bashku me gjyshin. Që ta bënte të qeshte gjyshin, nipi tjetër (djali i vajzës së tij të dytë, Fetijes), Mehmeti, na u drejtua neve me fjalët: largohuni, ju, ore “qurranë”, mos ia prishni fotografinë gjyshit. Në atë moment ai qeshi dhe fotografia doli shumë e suksesshme. Në fakt, me babën Hoxhë, siç e quanim ne, nipat e tij, më tepër kisha ndenjtur kur vinte për vizitë në Koretin, edhe pse edhe atje kishte vizita të pandërprera nga miq dhe dashamirës koretinas, të cilët edhe sot e kësaj ditë flasin me admirim për Hafez Kallabën.



**Hafëz Shefki Kallaba**

foto e viteve '60

**Përmbajtja e letrës:** I dashtuni djali jem Teufik, me datë 21 VII 1966 mora një kartë prej jush. Shumë mirë mërdh si met pa me sy mu maru qefi, mora vesh qi ma mirë je.

Teufik per shpi mos u ban merak as pak se erdh Feta dhe Ekremi se paç me shku vet se unë jam kon i smut nja tri katër dita por në mujsha opet du me shku.

Teufik Faiku nuk o ardh hala s'ë ka marrë pushimin per neve në vetsh me familje shnosh e mir jam, merak mos u ban as pak.

Mora ket cop letër me ta shkru se mua mu bo merak se qorza ta kom shkru sa merakun me hjek makar me ja pi ..... Te fala zemrore pej tan familjes.

21. VII. 1966 / Shefki Kallaba



*U thanë gjithë këto fjalë të mëdha për hafëz Shefki Kallabën; edhe jetëshkrimi për të la shumë për të kuptuar; me siguri ka edhe shumë gjëra që nuk janë regjistruar nga vetë hafëzi, ose nga kronikët e kohës. Diçka që më ka bërë përshtypje, është një letër e tij shkruar djalit të vet, Tefikut. Letrën e kishte shkruar me alfabetin serb, cirilik<sup>9</sup>. Si mund të shpjegohet kjo dukuri?*

Kema: Për keqardhje, në mungesë të kujtimeve të shkruara për jetën e vet nga baba hoxhë (Hafëz Kallaba), mbetet shumëçka e pandriçuar. Fatkeqësisht, në kulturën tonë shqiptare kryesisht mungon mbajtja e ditarit; mbase ndonjëherë edhe me arsyen e rrezikut të konfiskimit nga pushteti dhe pasojat e mëvonshme. Duke pasur parasysh ndërrimin e shpeshtë të qeverive në ish-Jugosllavi, pa dyshim, Hafëz Kallaba e ka pasur të vështirë “të notojë” nëpër gjithë ato “ujëra të turbullta” të kohës dhe të mbajë detyrën e mësuesit fetar, të imamit ose edhe të anëtarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe në nivel të gjithë Jugosllavisë me seli në Sarajevë, e sidomos të delegatit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit.



Një jetëshkrim, i përpiluar në vitin 1956, i cili është përfshirë në këtë punim, shihet se është përgatitur me shumë kujdes dhe me shumë vetëcensurë; nuk janë paraqitur shumë aktivitete gjatë jetës së tij. Ky jetëshkrim, i shkruar nga vetë baba hoxhë, me gjasë është kërkuar nga regjimi i kohës. Dhe, duke pasur parasysh vitin 1956, vit i torturave të vazhdueshme mbi popullin shqiptar, vit i aksionit të armëve dhe grumbullimit të tepricave, domosdo, ka ndikuar që jetëshkrimi të jetë më i shkurtër dhe pa elemente aktivitete kombëtare, të cilat, në atë kohë, do ta rëndonin postin e Hafëz Kallabës, qoftë si imam fshati, qoftë si anëtar i Asamblesë Supreme të Vakëfit me seli në Sarajevë<sup>10</sup>.

<sup>9</sup> Letra dërguar Tefikut në alfabetin serb – cirilik, por me fjalë shqipe.

<sup>10</sup> Faksimile e jetëshkrimit.

Gjithsesi, ai ka qenë shumë inteligjent dhe në situata të turbullta që shumë i vëmendshëm edhe me kontaktet shoqërore. Më kujtohet kur gjyshja Sanije (bashkëshortja e hafëzit) tregonte se, kur hafëzi shkante për ndonjë takim me Mulla Xhemalin e Breznicës, ai na thoshte në shtëpi: “Shkova në Hogosht!”, ose kur kishte për të shkuar në Hogosht ose Shipashnicë, ai thoshte: “Shkova në Breznicë!” - krejt kjo për të humbur gjurmë, që i bie se vazhdimisht ka qenë nën vëzhgim të organeve të pushtetit.

Kurse për sa i përket letrës së shkruar në cirilikë, kjo është temë e gjatë. Sidoqoftë, po përpiqem ta jap një shpjegim. “Që nga shkëputja e Kosovës prej trungut të Vilajetit shqiptar dhe futja e Kosovës nën ombrellën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, gjuha shqipe ishte “mollë e ndaluar” për shqiptarët në Kosovë, në Sanxhak, në Maqedoni, në Mal të Zi e Çamëri. Brezat e kësaj periudhe, madje në numër të vogël, shkolloheshin në shkolla serbe, në gjuhën serbe. Një gjë të tillë e kishte bërë edhe Hafëz Kallaba (shih jetëshkrimin e tij). Madje, njëkohësisht propagandohej që shqiptarët të mos shkolloheshin fare as edhe në shkolla serbe, sepse do të bëheshin serbë, dhe se atyre do t’u mjaftonte ndjekja e një mejtepi arabisht te hoxha i fshatit.

Gjuha shqipe filloi të aplikohet në Kosovë vetëm pas plasjes së Luftës së Dytë Botërore. Mbase, fshehurazi edhe ka mundur të jetë përdorur edhe më herët në ndonjë vend, por fare rrallë dhe me rrezik të madh, sepse në Vilajetin e bashkuar para vitit 1913 ka pasur shkolla shqipe, por kryesisht në qytete më të mëdha. Dhe, ndihmesën kryesore për hapjen e shkollave shqipe në Kosovë, pa mëdyshje, e ka dhënë studiuesi dhe intelektual i njohur Ernest Koliqi (1903 – 1975) që më 1941 ishte edhe ministër i arsimit në Shqipëri.

Ernest Koliqi kishte angazhuar pedagogun e njohur gjirokastrit Ali Hashorva, një atdhetar dhe vizionar që do ta jetësonte programin e Rilindjes Kombëtare në drejtim të përhapjes së diturisë dhe ngritjes së ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

Kështu, në vitin shkollor 1941/1942 janë hapur 173 shkolla fillore, tri shkolla të mesme dhe disa gjimnaze të ulëta gjithandej Kosovës. Në nëntor të po këtij viti është hapur edhe shkolla normale në Prishtinë, ku, për vite të tëra, ka shkolluar shumë pedagogë shqiptarë në Kosovë. Fillimisht në Kosovë kanë ardhur 80 mësues, kurse më vonë numri i tyre ka arritur deri në 400, në vitin shkollor 1943/1944<sup>11</sup>.

---

<sup>11</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/misioni-i-ernest-koliqit-per-br-shkollat-shqipe-ne-kosove>

Ndër këta mësues kishte edhe ndonjë kosovar që kishte emigruar në Shqipëri vetëm e vetëm që të shkollohej, por që gjatë kësaj periudhe kishin ardhur në Kosovë për të dhënë kontributin e tyre në mësimdhënie. Po këtë vit, pra më 1941, ishte hapur edhe shkolla fillore në Hogosht, me mësues Fadil Hoxhën. Vetë Fadil Hoxha ishte kthyer disa herë në odën e Hafëz Kallabës për muhabet dhe këshillime. Bile, ai e këshillonte Fadilin që të bënte kujdes me komunistët serbë, sepse historikisht ata na kanë bërë gracka dhe në momente të caktuara na kanë hedhur në humnerë. Fadili i paskësh thënë hafëzit se puna e parë që duhet bërë është hapja e shkollave shqipe gjithandej Kosovës e pastaj shohim e bëjmë.

Baba Hoxhë, duke qenë admirues i madh i shkollës shqipe, admironte edhe Fadil Hoxhën. Se vërtet e admironte shkollën shqipe, shihet me rastin e hapjes së shkollës në Roganë.

Në Roganë (ish-Rogoçicë) mësuesi i parë i mësimit shqip ishte Xhevat Alia nga Gjilani, i cili e hapi shkollën në vitin 1945/46. Kur jemi te Xhevat Alia, më duhet ta rrëfej një tregim të dëgjuar nga mësuesi Remzi Morina i Hodonocit.

“Ishim nxënës të mësuesit Xhevat. Një ditë na ftoi mua dhe Jahiun e Sylkajve të Muçivërcit që t’i ndihmonim diçka. Krahas mësimdhënies, ai merrej edhe me zejen e këpucëtarisë. Mendova se po na thërret për t’ia pastruar lokalin ku punonte. Kur shkuam te shkolla, ai kishte mbushur dy valixhe të mëdha dhe kërkoi që ta ndihmonim për t’i bartur ato deri te sheshi i xhamisë. Kur e pyeta përse e kishte zbrazur shtëpinë me qira, ngase banonte në një dhomë të



*Xhevat Alia, mësuesi i parë  
në shkollën e Roganës 1945/46*

objektit të shkollës, ai tha se po e ndërpriste punën, sepse nuk kishte mundësi të punonte më tutje. Insistova edhe një herë ta kuptoja arsyen, por nuk e zgjati më shumë. Nejse, unë dhe Jahiu e kapëm arkën e madhe prej druri, kurse mësuesi

valixhen e madhe dhe një çantë dore. Pas pak, arritëm te xhamia. Ai priste në mos kalonte ndonjë kamion, që transportonte dru ose material tjetër në drejtim të Gjilanit. Ishte koha e namazit të pasdrekës (Iqindisë). Pas pak, nga xhamia, dolën xhemati e pas tyre edhe imami i fshatit, hafëz Shefki Kallaba. Mirëdita, zotni mësues, iu drejtua mësuesit Xhevat! Mirëdita, hoxhë efendi, ia ktheu mësuesi. - Ç'janë gjithë këto valixhe? - e pyeti axha Hafëz dhe e mori ngrykë (e përqafoi). Hoxha nuk priti përgjigje dhe nxori nga xhepi kutinë e cigareve e ia ofroi një cigare të fabrikës. E pa se mësuesi nuk ishte me humor të mirë, ndaj u përpoq sa më shpejt ta dinte se ç'hall kishte. Ne qëndronim plot kureshtje pranë valixheve. Mësuesi, sikur të ishte mbushur vaj, iu drejtua hoxhës: Hafëz Efendi, po më duhet ta lëshoj Roganën, nuk po mundem më tutje. Ka tri ditë që nuk kam ngrënë asgjë. Para kam, por ku të blej ushqime këtu. Hoxha u prek së tepërmi dhe ia rrahu krahët dhe e shtrëngoi ngushëllueshëm. I tha, a vetëm për këtë arsye po e lëshon fshatin? Po për nder, ia ktheu mësuesi Xhevat. Atëherë, pra, ktheni këto valixhe te shkolla, i tha mësuesit, por shikimin e drejtoi nga ne nxënësit. Shiko, zotni mësues, darkën e ke çdo ditë prej familjes sime, kurse për racionin e drekës do të kujdesem që ta organizoj me fshatin. Po, Hafëz Efendi nuk po dua të jem barrë juaja, sikur e kundërshtoi mësuesi. – U krye kjo punë, dhe u drejtua nga ne: - ndihmoni mësuesit t'i kthejë valixhet deri te shkolla. Kështu edhe u bë. Për çdo mbrëmje mësuesi Xhevat, ose ishte mysafir i Hafëz Kallabës, ose dikush nga djemtë ose nipat e tij ia dërgonte darkën te shkolla. Po ashtu, edhe drekën e kishte organizuar axha Hafëz me bashkëfshatarët”, e kishte rrëfyer, jo një herë këtë ngjarje mësuesi Remzi Morina nga Hodonoci.

*Po thua se hafëz Shefki Kallaba ishte anëtar i Asamblesë Supreme të Vakëfit me seli në Sarajevë, a nuk ka ndonjë shënim diku në arkiva lidhur me këtë aktivitet të tij?*

Kema: Po, si jo. Në revistën e atëhershme periodike të botuar nga Bashkësia Islame me seli në Sarajevë “Glasnik” ka disa raportime që vërtetojnë pjesëmarrjen e tij aktive në këtë forum, për disa vjet me radhë, madje ka edhe foto të publikuara<sup>12</sup>.

---

<sup>12</sup> Foto nga një takim pune në një nga mbledhjet e Asamblesë Supreme të Vakëfit. Në foto: Fahri Ilijazi, myderriz; Ismail Hakiu dhe Hafëz Kallaba, anëtarë të Asamblesë Supreme të Vakëfit.

*Ndër emrat e hoxhallarëve e të dijetarëve islamë shqiptarë, që bartën barrën e organizimit të luftës për mbrojtjen e Shqipërisë Etnike gjatë viteve 1941-1945 janë edhe: Mulla Shaqir Halili, Mulla Jakup Kamberi, Asim efendi Luzha, Mulla Hamit Bytyçi, Mulla Rexhep Krasniqi, Mulla Riza Osmani, Mulla Haki Sermaxhaj, Haxhi Muhamet efendi Gashi, Mulla Adem Ibrahim Maloku, Mulla Maliq Gashi, Hafëz Shefki Kallaba etj.*

*Mund të themi se një plejadë prej mbi 300 hoxhallarësh të viseve shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së vitit 1913 lanë gjurmë të pashlyera në historinë e popullit shqiptar në mbrojtje të Shqipërisë etnike, gjatë viteve 1941-1945<sup>13</sup>.*



Fahri Iljaz, muderis, Ismail Haki i Hafiz Kalaba, članovi Vrh. vakufskog sabora

<sup>13</sup> M. Pirraku, Mulla Idris Gjilani, *Dituria Islame*, nr. 49, f. 30.





Grup hoxhallarësh të Komunës së Dardanës në vitet '50



**Në këmbë nga e djathta:**

1. Raqip Leka – Krenidell
2. Adem Morina – Hodonoc
3. Esat Morina – Topanicë
4. Mehmet Dërmaku – Shipashnicë e Epërme
5. (???)
6. Ejup Shillova – Meshin
7. Sylë Krasniqi – Dajkoc

**Rendi i dytë nga e djathta:**

1. Hysen Osmani – Lisockë
2. Shaip Kastrati – Karaçevë e Ep.
3. Zeçir Murati – Lajçiq
4. Hafëz Shefki Kallaba – Roganë
5. Muharrem Masurica – Koretin
6. Mulla Idrizi – Poličkë
7. Mulla Muharremi – Karaçevë e P.

**Rendi i parë:**

- Hafëz Shaipi – Dobërçan  
 Haqif Sermaxhaj – Hogsht

*Është shumë me interes t'i përgjigjesh një pyetjeje lidhur me gjyshin tuaj hafëz Shefki Kallaba. Përse ai nuk shkoi për të jetuar në ndonjë qytet të madh, si Gjilani, Prishtina apo Shkupi, por u ndal për të jetuar në fshatin Roganë, kur dihet se çfarë personaliteti ishte, e ku edhe mund të jepte kontribut të madh në ndonjë vend urban?*

Kema: Pyetje shumë me vend. E kam thënë ndoshta edhe ndonjëherë tjetër gjatë bisedës: Hafëz Kallaba ishte një atdhetar i madh. Me qëndrimin e tij në fshat, donte të bëhej model edhe për shumë kolegë të tij që të qëndronin në vendlindjet e tyre, sidomos ata që ishin në zona kufitare me Serbinë. Ky ishte edhe amaneti i vëllait të tij, Mulla Ibrahimit, të cilin, në vitin 1925, e kishin helmuar forcat e errëta antishqiptare, bashkë me Mulla Rexhep Vranjën e Hogoshtit (vdiqën që të dy pas tri javësh), mbas një mbledhjeje që kishin pasur në Gjilan. Ai qëherthi e kishte kuptuar politikën hegjemoniste të Serbisë, prandaj heshtazi vepronte dhe ndikonte edhe te të tjerët për të qëndruar në trojet e veta. Këto veprime i bënë edhe bashkëkohanikët e tij, si: Hasan Masurica, Osman Aga i Muçivërcit, Sali Fejza i Hogoshtit, Mulla Xhemaili i Breznicës etj. Armiku, për ta realizuar qëllimin e vet pushtues, ose përpiqet të të dëbojë me dhunë, ose të josh në forma të tjera për të të larguar nga trualli yt. Te hafëz Shefki Kallaba nuk ndikuan as dhuna e as joshja, sepse ai ishte një largpamës si rrallëkush.

Po vërej së në familjen tonë, dhe jo vetëm tonën, paskësh pasur njerëz të përfshirë në lloje të ndryshme rrymash; dikush na ishte ballist, tjetri komunist, një i treti enverist, një me Xhafer Devën, tjetri me Kralin, një tjetër me Hitlerin etj. Si mund ta shpjegosh këtë realitet?

Kema: Mbase pyetjen do ta kisha formuluar pak më ndryshe: Si bëhet që pjesëtarë të familjes sonë të kenë qenë edhe afër, por edhe larg pushtetit?

Ka shumë gjëra në jetë që të imponohen dhe nuk mund t'u shmangesh. Dhe, prej dy të këqijave, detyrohesh të zgjedhësh atë më pak të keqe. Ka qenë e pamundur të jetosh në periudhën e Perandorisë Osmane e të mos jesh pjesë e ushtrisë së asaj perandorie. Shumë nga fshati ynë janë vrarë në luftë për ushtrinë turke, në Jemen, në Siri, në Turqi e gjetkë. Njëri prej tyre ka qenë vëllai i Jashar Kallabës, i quajtur Xhemail. Më vonë Jashari e ka përtërirë këtë emër, duke ia lënë njërit prej djemve të vet emrin Xhemail.



*Certifikatë notash të kl. IV e Tefik Sh. Kallabës nga viti shkollor 1937/1938*

E njëjta situatë ka qenë edhe në periudhën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Shqiptarët e mbetur brenda kësaj mbretërie (pa dëshirën e tyre) kanë qenë të detyruar t'i shërbejnë kësaj mbretërie. Dhe, nuk ka qenë vetëm ushtria. Ajo qeveri kishte ushtruar dhunë të vazhdueshme, duke shkelur të drejtat e shqiptarëve për shkollim. Shqiptarët, ose privoheshin nga e drejta për shkollim, ose detyroheshin që shkollimin ta bënin vetëm në gjuhën serbe. Vetë, aga Tefik, kishte vijuar shkollën fillore në gjuhën serbe në fshatin Hodonoc, që ishte i



banuar nga shqiptarë, përveç lagjes së serbëve - “Kërshlanët”, por kjo shkollë ishte paralele e ndarë e shkollës serbe të Domorocit<sup>14</sup>. Pastaj, ta duash e ta ndihmohesh popullin tënd e të mos marrësh pjesë në mbledhjet e organizuara nga pushteti komunal ishte e pamundur, ngase, vetëm nga brenda, mund ta mësosh gjuhën e mikut a të armikut. Por, ka situata kur nuk ke zgjedhje tjetër e që janë jetike - të jesh o të mos jesh. Dhe, është shumë me rëndësi që të jesh vetvetja, që kërrabën ta kthesh nga vetja e jo nga okupuesi. Këtë zotësi, besoj, e kemi pasur të gjithë si familje. Duke qenë inteligjentë, por edhe dashamirës të sinqertë të njerëzimit, përgjithësisht, dhe të kombit, veçanërisht, gjithsesi kemi qenë më të pranuar nga secili pushtues, paçka që nuk kemi qenë “të dëgjueshëm”, për ç’gjë gjithmonë kemi paguar tagrin.

Ta zëmë, axha Ilmi pas përfundimit të shkollimit në medresenë “Isa Begu” në Shkup, më 1936, ka shërbyer në armatën e atëhershme, në Vinkovci, ku edhe ka marrë gradën oficer, por në një situatë të caktuar ka shërbyer si oficer në organizimin ushtarak të ballistëve në Anamoravë, ose djali i tij, Muharremi, si oficer i Armatës Jugosllave me gradë “Kapiteni”, ka mbaruar edhe Akademinë Ushtarake në Beograd, por që dijen për organizim ushtarak e ka shpërndarë për vite të tëra te nxënësit e gjimnazit të Dardanës, duke i përkthyer vetë tekstet nga serbishtja në shqip, e që frytet e asaj dijeje, më vonë, disa i kanë aplikuar në terren, si pjesëtarë të UÇK-së. Rreziku më i madh për vetë pushtetin ka qenë kur nga popullata ka përzgjedhur njerëzit e ditur e inteligjentë; ndërkaq në momentin kur në radhët e veta pushteti ka rekrutuar njerëz të dëgjueshëm, por të paditur, ky pushtet ia ka zgjatur vetes edhe më shumë jetën.

Më sipër thashë se në jetë ka situata kur nuk ke nga ia mban. Po e marr shembullin e kushëririt tonë, Haki Jashar Kallaba. Më 1936 kishte shkuar në Beograd të Serbisë për t’u shkolluar në Akademinë Ushtarake. Pas pushtimit të ish-Jugosllavisë nga Gjermania (6 prill 1941), Hakiu zihet rob lufte (qershor 1941). Zgjedhja e tij ishte të vritej apo të luftonte për gjermanët. Ndonëse në kontekst të kohës ai kishte informata për rolin e Gjermanisë në trojet shqiptare, ai zgjodhi të mos bëhej “hero” i Serbisë, por ushtar i ushtrisë gjermane. Duke qenë edhe oficer i shkolluar, kontributi i tij ishte tejet i madh në ushtrinë gjermane, saqë atje kishte marrë edhe gradën ushtarake, për të udhëhequr më pas edhe toga e njësite lufte deri në betejën e famshme të Stalingradit, ku plagoset

---

<sup>14</sup> Dëftesë nga shkolla fillore në Hodonoc.

rëndë, ose më vonë, pas shërimit në Austri, merr pjesë në Betejën e Sarajevës, ku po ashtu plagoset rëndë (28 korrik 1943), por shpëton. Pas LDB-së Hakiu kishte emigruar në Siri (prill 1947), por edhe atje ishte dëshmuar në deminimin e zonave të minuara. Natyrisht, ikjen nga Siria në Amerikë ia kishin përgatitur punëtorët e ambasadës gjermane (29 mars 1959).

## Haki Jashar Kallaba - njeriu i shtigjeve të luftës

Në vitet '20 të shekullit XX Rogana kishte një lindshmëri relativisht të madhe. Edhe familjet, të cilat deri atëherë jetonin tradicionalisht bashkë, kishin filluar të ndaheshin, ndaj edhe ndërtimi i shtëpive kishte marrë një hov. Nga rreth 40 shtëpi, sa kishte Rogana në fund të shekullit XIX, çereku i parë i shekullit të 20-të e gjeti me rreth 150 shtëpi. Rogana kishte xhaminë e vet, në kuadër të së cilës punonte edhe mejtepi (shkolla), në të cilin hoxhallarët jepnin mësim fetar, por nuk mungonte as mësimi i atdhedashurisë. Prej vitit 1912 Rogana funksiononte edhe si komunë, me zyrë të ofiqarisë dhe infrastrukturë të kohës. Tani nuk është komunë, por gjithsesi një fshat mjaft i transformuar, që do t'i kishte hije edhe epiteti "komunë".

Më 15 maj (mars <sup>15\*</sup>) 1917 Jashar Kallabës i lindi fëmija i gjashtë. Ishte djalë dhe prindërit, Jashari e Mida, e pagëzuan me emrin Haki. Hakiu qysh si fëmijë ishte i dashur me moshatarët. Kishte edhe shkathtësi të theksuara psikofizike. Së shpejti ishte i pranishëm edhe në oda të familjes së gjerë Kallaba, ku kishte njerëz të shkolluar, si mulla Ibrahim Kallaba, hafëz Shefki Kallaba etj. Edhe pse i vogël, ai gjithnjë thithte nga muhabetet që bëheshin në odë, veçanërisht ato rreth shkollimit. Me kënaqësi u piqte kafe tërë mbrëmjen vetëm e vetëm që të ishte i pranishëm në odë. Kishte, sidomos, respekt ndaj Hafëz Kallabës, të cilin e kishte edhe mësues në mejtepin e fshatit. Kishte dëshirë të flaktë për shkollim. Atë kohë në fshatin Roganë nuk kishte fare shkollë të rregullt, porse fëmijët shkolloheshin në gjuhën serbe, në Hodonoc. Ndonëse Hakiu ishte bërë 14 vjeç, ai nuk ngurronte që për herë të parë të ulej në bankat e shkollës dhe kështu në vitin shkollor 1931/32 regjistrohet në klasën e parë, ndërsa në vitin shkollor 1934/35 kryen shkollën fillore, në Hodonoc, te mësuesi Bozhidar Jovanoviq.

Me shkollimin e tij ishte i kënaqur edhe prindi i Hakiut, Jashari. Shkollim më të lartë në afërsi nuk kishte, kështu që Hakiu mbeti në shtëpi për t'u kujdesur për bagëtinë dhe punët e tjera shtëpiake. Lakmonte kushëririn e tij, Ilmiun e Hafëz Kallabës, i cili kishte shkuar për t'u shkolluar në medrese, në Shkup.

E luste babanë që edhe ky të shkollohej diku, por nuk kishte guxim të ngulte këmbë, sepse Jashari ishte paksa i rreptë. Në vitin 1935 Akademia ushtarake

---

<sup>15</sup> E ka ndërruar datën e lindjes që të mund të regjistrohej në Akademinë Ushtarake në Beograd



*Jashar Ali Kallaba*  
(25.6.1879 – 29.5.1948)

e Petrovaradinit, afër Novi Sadit, kishte shpallur një konkurs për kadetë të Aviacionit. Konkurse të tilla, në forma pllakatesh muri, asokohe, por edhe më vonë, shpërndaheshin gjithandej vendit. Me të dëgjuar për këtë shkollim, edhe Hakiu kishte shfaqur interesim, kështu që një ditë i drejtohet babait që ta lejonte të konkurronte. Babai i tij nuk e kishte lejuar, ngase Novi Sadi ishte larg, por mbase edhe i ndikuar nga rrethi që paragjykonte shkollimin në një akademi ushtarake serbe. Vullnetin e tij për shkollim Hakiu ia kishte shfaqur imamit të fshatit, Hfz. Shefki Kallabës, që njëherësh ishte edhe kushëri i Jasharit. Hafëzi, një dashamir i flaktë i shkollës, me çdo kusht donte që Hakiu të shkollohej. Madje, një pasdite, me të kthyer nga namazi i iqindisë, kthehet në odën e Jasharit. Derisa Hakiu po u piqte nga një kafe, ata po diskutonin për nevojën e shkollimit të fëmijëve. Hafëzin nuk e kënaqte vetëm mësimi fetar që po bënin fëmijët te hoxha, pra te vetë ai; ishte mjaft i interesuar edhe për shkollën laikeshtetërore, e cila, fatkeqësisht, në atë kohë punonte vetëm në gjuhën serbe. Duke mos pasur mundësi shkollimi të lartë në Komunën e Roganës, fëmijët duhej të dërgoheshin më larg, në qendra të tjera shkollimi në Serbi ose në Maqedoni.

Jo gjithkush kishte guximin t`i lejonte fëmijët e vet që të shkolloheshin larg vendlindjes. Këtë problem e kishte edhe Jashari. Për shumëçka ndikonte edhe rrethi, kështu më së shumti pësonte brezi i ri. Pas një bisede të gjatë që kishte pasur hafëzi me Jasharin, ishte trajtuar edhe çështja e konkursit të Petrovaradinit. Hafëzi e kishte hapur këtë temë me shpresë që do të gjente mirëkuptim për dërgimin e Hakiut në atë shkollë kadetësh të aviacionit, apo edhe në ndonjë shkollë tjetër. Qëllimi i tij ishte që Hakiu të mos mbetej në shtëpi, i pashkolluar. Edhe pas atij diskutimi, Jashari kishte refuzuar dërgimin e djalit në Petrovaradin. Atëherë hafëzi, paksa i nevrikosur për atë këmbëngulje, i drejtohet Jasharit: - Jashar, djalin duhet ta dërgosh në shkollë, nëse nuk dëshiron që të mbetet edhe ai pa shkollë e “qorr” siç ke mbetur ti. Pas këtyre fjalëve Hakiun e kishte kapluar frika se mos bëhej mollë sherri që të ngatërrohej hoxha me babanë e tij, Jasharin. Mirëpo, ç`është e vërteta, Jashari kishte një respekt të jashtëzakonshëm për hafëzin dhe pajtohet që Hakiu të vazhdonte shkollimin. Kjo “po” e Jasharit për shkollimin e mëtejme të të birit e kishte bërë Hakiun që të “fluturonte” nga gëzimi.

## Këmbëngulja për shkollim në Akademi Ushtarake

Kështu, po atë mbrëmje vajti Hakiu me kushëririn e tij Fehmiun deri te këshilltari i fshatit, Bajram N. Rrudhani për ta marrë një vërtetim për shkuarje në Novi Sad, ku edhe i dorëzon dokumentet në shkollën e Aviacionit, por, për fat të keq, refuzohet me arsyetim se ishte ende i vogël (mbase ishte vetëm ndonjë pretekst për të mos u pranuar një shqiptar nga Kosova?!). Hakiu kthehet nga Novi Sadi i pikëlluar nga pamundësia për ta shfrytëzuar këtë mundësi të shkollimit, mirëpo, një vit më vonë, në konkursin e Akademisë Ushtarake të Beogradit, konkurren Hakiu dhe pranohet në shkollën e nënoficerëve për këmbësori, që kishte selinë në Dedinje të Beogradit, e që quhej “Shkolla e parë e nënoficerëve e ‘Kral Aleksandrit’” (Prva podoficirska škola ‘Kralja Aleksandra’). Aty kishte nxënës nga e gjithë Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene. Kishte edhe nga Maqedonia, Bosnja etj., dhe ishin gjithsej nja 6-7 myslimanë dhe Hakiu shqiptar. Atij i duhej shumë punë dhe angazhim që t’i mundte paragjykimet e mësimdhënësve serbë, që kishin ndaj nxënësve joserbë. Më 30 nëntor 1939 Hakiu përfundon shkollimin dhe prej aty rekomandohet që të shkojë në Sushak, në Komandën e Regjimentit të Dytë Malor (Drugi planinski puk). Prej aty menjëherë e transferojnë në Delnice. Hakiu, tashmë, kishte fituar gradën ushtarake nënkaptër aktiv (Aktivni Podnarednik). Në Delnice kishte qëndruar dy vjet. Sushaku njihej si qendër dhe batalionet e veta i kishte të shpërndara edhe në vende të tjera, si në Platak, Gerovo etj., kështu që Hakiun gjatë dimrit e dërgonin nga 2-3 muaj në qendra të skitarisë për të ushtruar skijimin, e sidomos aftësitë ushtarake mbi ski. Sulmi gjerman, më 1941, mbi mbretërinë e atëhershme Serbo-Kroato-Sllovene, Hakiun e gjen në Delnice. Që në prill të vitit 1941 Komanda i nënshtrohet shtetit të sapoformuar kroat. Hakiu mbetet edhe më tutje në Kroaci. Gjatë majit-qershorit të vitit 1941 formohet Legjioni kroat (Hrvatska Legija) për t’i shërbyer ushtrisë gjermane në luftë kundër Ruisë. Në këtë kuadër Hakiun e dërgojnë në komandën e plotë të Sarajevës (Popunidbeno zapovjedništvo u Sarajevo). Në këtë komandë mund të rekrutoheshin vetëm vullnetarë të moshës 21-35 vjeç. Prej aty fillon edhe rrugëtimi për në Rusi, mirëpo fillimisht ndalen në Shtokerao (Stockerao) të Austrisë, ku rreth 2 muaj duhej të vazhdohej me ushtrime speciale ushtarake. Më pastaj njësitë ku shërbente Hakiu nisën për në luftë, në Rusi. Ai njësit zbankon brenda kufirit rumuno-rus për t’i mposhtur ushtarët rusë që ruanin kufirin.



## Pushtimi i Stalingradit

Fitore pas fitoreje, Hakiu me shokë depërtojnë në Boltava, Harkovo e deri në Stalingrad, të cilin gjithashtu e pushtojnë. Me divizionin e Hakiut ishte edhe Regjimenti i këmbëtorisë i udhëhequr nga kroati Viktor Paviçiq. Këtë divizion rusët e quanin “çortova divizija” – “divizioni i dreqit”. Divizioni ku shërbente Hakiu i takonte Armatës së Gjashtë, që udhëhiqej nga gjenerali Von Paulus. Aty qëndron deri më 23 shkurt 1943, kur i duhet të lëshojë Stalingradin për shkak të disa plagëve që kishte marrë në këmbë dhe në dorë, nga disa (shapnella) pjesë të granatave. Deri në këtë kohë, Hakiu qe plagosur katër herë, një herë afër Harkovës. “Shpesh sulmoheshim nga minahedhëset ruse “Kaçusha”, të cilat gjuanin nga disa granata përnjëherë. Madje, njëherë një granatë e tillë ra midis togës sonë dhe vrau një ushtar e u plagosëm disa të tjerë, në mesin e të cilëve edhe unë”, kujton Hakiu ato çaste lufte të rreptë kundër rusëve.

Ushtarët që kishin mbetur gjallë nga ato luftime, së bashku me të plagosurit, u kthyen në Shtokerao; të sëmurët për t’u shëruar dhe së bashku për ta formuar një divizion që do të shërbente në Kroaci.



*Autori, Xhevdet Kallaba, në bisedë me Haki J. Kallabën, më 2 gusht 2006 në Roganë*

Hakui, pas një kurimi të shkurtër, derisa ende nuk ishte i aftë për luftë, shfrytëzon rastin dhe vjen për disa ditë në vendlindje, në Roganë. “Meqë isha i veshur me uniformë gjermane, por me vete kisha edhe Medaljen e luftës në frontin e Lindjes (Winterschlacht Medaile in Ostfront) të lëshuar nga Divizioni i njëqindtë luftarak – Regjimenti 369 (Hunderte Jäger Division, Regiment 369), nuk e kisha problem lëvizjen deri këtu, bile as te bullgarët, të cilët ishin stacionuar në këtë pjesë, ngase edhe ata ishin aleatë të gjermanëve”, kishte rrëfyer Hakui 89-vjeçar, gjatë një vizite në Roganë (gusht 2006).

## 20 vjet me plumbin në fyt

Pas një javë qëndrimi në Roganë, Hakui kthehet sërish në Shtokerao, ku i bashkohet Regjimentit 369. Me këtë Regjiment, si pjesëtar i batalionit të parë, shkojnë në aksion në Kroaci. Gjatë luftimeve të rrepta kundër partizanëve, Hakui plagoset rëndë në fyt, më 28 korrik 1943, në vendin e quajtur Turbe afër Travnikut. Prej aty komandanti kishte urdhëruar një lokomotivist që ta ngarkonte Hakuin në një vagon të vetëm dhe në përcjellje të mjekut ta bartte deri



*Plumbi i hequr nga fyti i Haki Jashar Kallabës, më 1963*



në Sarajevë, ku do të mjekohej Haki Kallaba, alias Alijeviq. Pas rreth dy javësh atë e dërgojnë për shërim të mëtejme në Vjenë të Austrisë. Mandej shërimi i tij vazhdon në Semering, Austri, në një spital ushtarak të quajtur “Militärspital bei dem Bahnhof” - spital ushtarak afër stacionit të trenit. Mirëpo, mjekët nuk kishin guxuar ta operonin, kështu plumbi i mbetet në fytyrë, të cilin do ta heqë më vonë, më 1963, në Çikago të Amerikës.

Pas hospitalizimit në Semering, kthehet në Shtokerao në një repart për rekonvaleshencë “Genesung Abteilung”. Aty për të përkujdeset një mjek boshnjak, me emrin Fadil Gjiniq. Pas një kohe, prej aty, dërgohet në një shkollë për oficerë “Kriegsoffizierschule” në Noj Cell am Ze (Neu Zell am See), ku qëndron prej shtatorit deri në fund të nëntorit 1944, për t’u kthyer sërish në Shtokerao ku i bashkohet sërish Regjimentit 369, që po operonte në luftrat në Kroaci. Aty kishte fituar gradën ushtarake Kapter (Oberfeldwebel).

Në maj 1945 dërgohet në Zagreb, tashmë në ushtrinë kroate, në Departamentin policor, që komandohej nga koloneli Brajkoviq. Ai e sistemon Hakiun në një zonë të Sllovenisë, mirëpo së shpejti Hakiu zihet rob nga armata angleze. Anglezët e dërgojnë në kampin për persona të zhvendosur “DP Cezenatica” në jug të Italisë. Prej aty e dërgojnë në kampin “Bagnoli” afër Napolit të Italisë. Duke u bazuar në aftësitë e tij ushtarake si dhe në njohjen e gjuhëve si: shqipen, serbishten, maqedonishten, gjermanishten, italishten dhe turqishten, në kampin anglez “Bagnoli” arrin të bëhet shef i policisë si dhe pas një kohe të shkurtër bëhet udhëheqës i një grupi ndërkombëtar të të zhvendosurve. Zakonisht, në kampin Bagnoli, të zhvendosurit arrinin t’i rregullonin dokumentet personale dhe prej aty transferoheshin në vende të treta.

## **Martesa e Hakiut me ukrainasen Anna**

Hakiu, gjatë qëndrimit në kampin “Bagnoli”, njihet dhe martohet me ukrainasen Anna Senkiewicz. Largimi nga ky kamp mund të bëhej për në shtetet latinoamerikane, si në Paraguaj, Uruguaj, Argjentinë etj. Por Hakiu nuk ishte i interesuar të largohej nga Evropa. Pas një kohe, me ndihmën e boshnjakut Shefki Muftiq, ish-shef i policisë në Mostar, kishte gjetur një mundësi për të ikur në shtetet arabe. Kështu, Hakiu, tashmë edhe me bashkëshorten Annen,

më 1947 me një anije udhëtuan për në portin e Bejrutit dhe pastaj vazhduan për në Damask të Sirisë.



*Nga e majta: Kroati, major M. Pavliçeviq dhe Haki Jashar Kallaba në kampin „Kunetra“ të Damaskut - Siri*

Në Damask qëndroi rreth 13 vjet. Gjatë qëndrimit të tij në Siri, së bashku me një kroat, majorin M. Pavliçeviq, ishte instruktor në stërvitjen e arabëve për

të fituar aftësi ushtarake në fushën e minimit dhe deminimit, në një kamp të ndërtuar nga anglezët, të quajtur “Kunetra”. Kjo punë që e rëndë dhe me shumë rreziqe. Ndërkohë, Hakiu e Anna kishin lindur katër vajza: Mersa (1949), Mida (1951), Remza (1955) dhe Faruza (3.11.1956). Ata nuk shihnin perspektivë të jetës në Siri, kështu Hakiu hulumton mundësinë e kthimit në Evropë ose në SHBA. Pas takimeve me një konsull gjerman në Damask, duke pasur parasysh aktivitetin e Hakiut në armatën gjermane, konsulli gjerman e ndihmoi Hakiun për të emigruar nga Bejruti për në Çikago të SHBA-ve.

## **Jeta në Çikago**

Në Çikago arrin më 29 mars 1959, me bashkëshorten Annen dhe katër vajzat. Aty ndërron mbiemrin nga Alijeviq në Kalaba, të cilin e mban, bashkë me familje, deri në vdekje. Duke qenë mirë i përgatitur për jetë, falë edhe gjithanshmërisë së tij, punësohet në një fabrikë “Diebel Manifactory”, aty punon për disa vite. Më vonë punësohet si superintendant në një ndërtesë në 1020 Nord Lake Shore Drive të Çikagos, ku edhe pensionohet më 1970. Në Çikago, më 1963 i lind edhe djali, Sinani. Po këtë vit Hakiu i nënshtrohet operimit tejet të rëndë për nxjerrjen e plumbit (3.5 cm), që i kishte mbetur në qafë, gjatë luftës në Kroaci. Për ta nxjerrë atë plumb duhej hapur që nga nënsqetulla. Megjithatë operimi kishte pasur sukses për mbijetesë, duke dëmtuar tejsat e zërit.

Gjatë qëndrimit në SHBA Hakiu synonte shkollimin e fëmijëve, kurse ëndërronte Kosovën, ku nuk guxonte të kthehej. Për herë të parë, pas Luftës së Dytë Botërore, Hakiu vjen në Kosovë verën e vitit 1968.

Që atëherë Xha Hakiu, së bashku me bashkëshorten Annen, ka vizituar Kosovën disa herë.

Në nëntor të vitit 2000 Forumi i Gruas i LDK-së kishte ftuar për vizitë Faruza Kallabën, vajzën e Hakiut, për ta bërë edhe më publike angazhimin e saj në Gardën Nacionale të Forcave Ajrore të Illinoisit (SHBA). Ajo në Kosovë vjen me prindërit, Hakiun dhe Annen. Këta ishin të vendosur në hotelin Grand dhe mbikëqyreshin nga ushtarët amerikanë të KFOR-it. Në këtë kohë Faruza pati një agjendë të ngjeshur të vizitave kushtuar personaliteteve dhe institucioneve

të rëndësishme kosovare, që nga presidenti Ibrahim Rugova e deri në instanca më të ulëta komunale. Me këtë rast, ajo, së bashku me prindërit, më 1 dhjetor 2000 vizituan edhe vendlindjen e Hakiut, Roganën, ku iu organizua një pritje madhështore nga rogasit dhe fshatrat përreth.

## Faruza Kallaba - pilotja e parë shqiptare në botë



“ Duke shikuar prapa, në 20 vjetët e mia në ushtri, krenaria ime më e madhe vjen nga shërbimi im në operacionet Desert Shield dhe Desert Storm të NATO-s, duke luftuar në misionet për mbrojtjen e popullit tim të mirë në Kosovë. Ishte nder të ndihmoja dhe ta mbroja popullin shqiptar dhe atdheun e babait tim.

”

---

*Faruza Kallaba*

Faruza Kallaba lindi më 3 nëntor 1956 në Damask të Sirisë. Më 1959 prindërit e saj, Haki dhe Anna Kallaba, transferohen nga Damasku në Çikago të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në shkollën publike të Çikagos. Faruza ka studiuar dhe është diplomuar për linguistikë në Universitetin verilindor të Illinoisit, në vitin 1989.

Faruza Kallaba është femra e parë në historinë e Gardës Nacionale të forcave ajrore të shtetit Illinois, SHBA, pjesë e së cilës u bë në vitin 1979. Më 1984

ajo u shpall femra e parë, anëtare e ekipit të fluturimit të këtij institucioni të lartë ushtarak amerikan. Më 1991 merr pjesë në intervenimin amerikan për mbrojtjen e Kuvajtit.

Në vitin 1999, kur forcat ajrore amerikane kishin vendosur të sulmonin caqet ushtarake serbe, në shenjë të mbrojtjes së popullatës shqiptare në Kosovë, Faruza Kallaba është paraqitur vullnetarisht për t'iu bashkuar operacioneve të NATO-s kundër Beogradit. Gjatë këtij operacioni ushtarak, që synonte mposhtjen e gjenocidit serb kundër shqiptarëve, Faruza ishte përgjegjëse për furnizimin me karburante të aeroplanëve bombardues, gjatë fluturimit. Nga ekspertët ushtarakë, kjo detyrë vlerësohet ndër më të përgjegjshmet në operacionet ushtarake ajrore të NATO-s. Gjatë luftës në Kosovë, Faruza ka marrë pjesë në mbi 30 operacione luftarake. Në Gardën nacionale amerikane ajo angazhohet në ekuipazhin e aeroplanit A KC-135 E, që ishte i destinuar për furnizim me karburante në ajër, të aeroplanëve luftarakë. Karrierën e saj ushtarake Faruza e ndërtoi me pjesëmarrjen e saj në misionet e guximshme në kuadër të operacioneve “Desert Shield” dhe “Desert Storm” të NATO-s.

Në nëntor të vitit 2000 Forumi i Gruas i LDK-së e kishte ftuar për vizitë Faruza Kallabën, për ta bërë edhe më publike angazhimin e saj në Gardën nacionale të forcave ajrore të Illinoisit (SHBA). Ajo në Kosovë vjen me prindërit Hakiun e Annen. Më 1 dhjetor 2000 ata vizitojnë edhe vendlindjen, Roganën, me ç'rast atyre u organizohet një pritje madhështore nga roghanasit dhe fshatrat përreth<sup>16</sup>.

Faruza Kallaba është e martuar me Herbert Hunter, ushtarak dhe pilot i United Airlines, i cili ka qenë pjesëmarrës në dy luftëra dhe është pensionuar në ushtri, më 1991. Jeton në SHBA me bashkëshortin dhe të afërmit e saj.

Faruza Kallaba veprimtarinë ushtarake e quan trashëgim nga babai i saj. Haki Kallaba ishte po ashtu ushtarak në kuadër të forcave gjermane dhe mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore.

---

<sup>16</sup> Mora pjesë në 30 operacione për ta shpëtuar popullin tim „Bota Sot“, 27- 28 nëntor 2000.





*Autori i librit gjatë një interviste me piloten Faruza Kallaba*



*Xhevdeti e Nexhmija me Faruzën dhe prindërit e saj: Hakiun dhe Annen*

# MORA PJESE NË 30 OPERACIONE PËR TA SHPËTUAR POPULLIN TIM

*Në momentin e veprimit në operacionin e parë kisha ndjenjën e një inkurajimi të fuqishëm, sepse po fillonte dëkja e mirë.- Është e vërtetë se unë po vij për herë të parë në Kosovë pas luftës dhe kam dy ndjenja njëkohësisht: si fitimtare e luftës, por edhe si pjesë e popullit shqiptar të Kosovës, që ka fituar lirinë dhe i cili tani është më i fuqishëm për realizimin e aspiratave të veto për pavarësinë e Kosovës.*

Krisi ditë Kosovë u ndërsa unë një vjetër si vajzë të një shqiptarësh-amerikanë, e cila gjatë 76 ditëve sa zgjati bombardimet e Aleanca Veriëndërkombëtare luftimeve mi-

siqulli luftave të këtyre misionit. Për motivet e këtyre angazhimit, për gjërat dhe për misionin e saj të tashmë në rrugë të reja Kallaba

misioni kam marrë detyrë, për këto detyra kështu një rëndësi të jashtëzakonshme, sepse këtu radhe rradhe në këto operacione për ta mbështetur misionin e hapësirës, nëkrahun për ta



*Faruza Kallaba në faqet e shtypit vendor të Prishtinës (Bota Sot – numri festiv 28-29 nëntor 2000), intervistuar nga Shefki Ukaj*

KALLABA, NËN FOTON E SHKRITJE MIVOND E VETËSIA SHQIPTARË NGA

## Fehmi Shefki Kallaba – një jetë dhe një mandat për fshatin Roganë

Në një intervistë të realizuar më 10 shkurt 2006, me rastin e përgatitjes së numrit të parë të periodikut për fshatin Roganë “Inforogana”, Fehmi Kallaba jep një pasqyrë të kontributit të tij për rritjen e fshatit Roganë.

(Intervista e plotë)

**Info Rogana:** *Fshati Roganë daton që nga mesi i shekullit të 15-të. Me sa shtëpi e keni gjetur Ju Roganën?*

**Fehmi Kallaba:** Unë kam lindur më 12 mars 1923, dhe është fare e natyrshme që si fëmijë të mos kisha pasur njohuri për numrin e familjeve të fshatit, mirëpo, në rininë e hershme, kur edhe kam pasur takime me të gjithë bashkëfshatarët, Roganën e mbaj mend me nja 200 shtëpi. I interesuar për të kaluarën e fshatit, e pata pyetur njëherë prindin tim për të kaluarën e fshatit. Babai im, hafëz Shefki Kallaba, që ka qenë edhe hoxhë fshati, më pati thënë sa ai e mbante mend Roganën me 35 shtëpi, e kjo do të ketë qenë rreth vitit 1900.

**Info Rogana:** *Në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të Rogana pati një shtim të theksuar në raport me një shekull më parë. Si e komentoni këtë dukuri?*

**Fehmi Kallaba:** Shikoni, përpara familjet tona kanë jetuar tradicionalisht në bashkësi familjare prej shumë anëtarësh, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore pasoi një ndryshim. Sa më shumë që shtrihej standardi jetësor ndër fshatarë, aq më shumë bëhej ndarja e familjes tradicionale, kështu që njerëzit, sapo martoheshin, ndërtonin shtëpitë e tyre dhe jetonin ndaras. Kjo bëri që shekulli i 21-të ta gjejë Roganën me rreth 450 shtëpi. Sigurisht se do të kishte edhe më tepër, mirëpo edhe gati po aq shtëpi janë larguar nga Rogana për të emigruar në pjesë të tjera të Kosovës ose edhe jashtë shtetit.

**Info Rogana:** *Rogana ka disa lagje dhe ju i takoni lagjes Kallaba. A keni banuar prej kohësh në këtë vend ku jeni sot?*

**Fehmi Kallaba:** Jo, të parët tanë kanë banuar në pjesën veriore të fshatit, por me shtimin e vazhdueshëm të banorëve, fshati ka bërë një shtrirje, sidomos në





*Autori (djathtas) gjatë një interviste me Fehmi Kallabën*

pjesën jugore të tij. Unë, në fakt, nuk e mbaj mend këtë zhvendosje, por sipas njoftimeve nga pararendësit e mi, gjyshi im, Salih Kallaba, me të vëllain, Aliun, janë vendosur në këtë pjesë të fshatit rreth vitit 1915.

***Info Rogana:*** *Cilat lagje e përbëjnë Roganën?*

**Fehmi Kallaba:** Rogana, përveç muhaxhirëve dhe tash së voni disa shtëpive ardhacakësh, është një vëlla i fisit Kryeziu. Ndarja nëpër lagje ka qenë vetëm një ndarje fizike e familjeve tradicionale, duke e ruajtur dashurinë dhe respektin ndaj njëri-tjetrit. Prandaj, roanasit nuk martohen mes vete, bile as me muhaxhirët dhe ardhacakët e mëvonshëm. Ne jemi të gjithë të fisit Kryeziu, por jo të gjithë mbajnë këtë mbiemër. Përveç mbiemrit Kryeziu, janë edhe mbiemrat Kallaba, Rudhani dhe Geci. Vetë fshati ka shtatë lagje autoktone: Geci, Kallaba, Rudhani, Veseli, Sinani, Hima dhe Syliqi. Çështje e vërteta, jo vetëm këto lagje e përbëjnë sot Roganën. Në një bashkëjetesë vëllazërore jetojnë edhe Lagjja e Muhaxhirëve, në perëndim, dhe Fshati i Ri, që shtrihet në juglindje të Roganës, e të cilin e përbëjnë dy lagje; Kallaba dhe Rudhani. Zaten, në fshat, aty nga gjysma e shekullit të 20-të, kanë ardhur edhe disa shtëpi nga Krenidelli, të cilët njihen me mbiemrat Qehaja, Thaçi dhe Lakna, kurse pas vitit 1985 në Roganë kanë ardhur edhe disa shtëpi nga Bilinica dhe Breznica, e që janë vendosur në Katushnicë.

**Info Rogana:** *Prej kur është vendosur këtu Lagjja e Muhaxhirëve?*

**Fehmi Kallaba:** Muhaxhirët, thuhet se kanë ardhur këtu para më shumë se 120 vjetësh, më saktësisht më 1878, kur serbët i kanë përndjekur nga Huruglica afër Vranjës, pas luftërave serbo-turke. Ata janë vendosur fillimisht afro një kilometër në veri të rrugës Roganë-Muçivërc, por pas vitit 1972, duke i blerë trojet pikërisht nga Lagjja Kallaba janë vendosur në të dy anët e rrugës prej Përroit të Mujës, që ndan Roganën prej Muçivërcit, e deri te Tyrbja.

**Info Rogana:** *Po, Lagjja e Katushnicës kur ka filluar të ndërtohet?*

**Fehmi Kallaba:** Kjo ka qenë fare vonë. Për herë të parë aty ka ndërtuar shtëpinë Sylejman Kryeziu, më 1972 dhe një vit më vonë edhe Ilmiu i Azem Kryeziut. Më kujtohet që deri vonë ato vende, sidomos rreth rrugës, kanë qenë të pabanueshme. Bile sefte në Katushnicë e ka pas ble një arë Myrtë Kallaba, e djemtë e tij, Agimi e Bashkimi, më vonë, e kanë ndërtuar shtëpinë. Prej Xhamisë e deri në Hodonoc, ai vend ka qenë shkret. Më kujtohet, kur kam shkuar në shkollën e Hodonocit, më 1934, udha ka qenë midis varreve, përskaj arës së Mullarexhepëve të Hodonocit (prej shtëpisë së Hasimit e nga tregu i sotëm) dhe ka dalë hej te vidhat, te njëfarë udhëkryqi i Kërshlanëve. Mirëpo, më vonë, Katushnica u bë një vendbanim me mjaft perspektivë e kjo u bë mirë edhe për vetë Roganën.

**Info Rogana:** *Sa ke qenë i lidhur për Roganën dhe çka ke mundur të bësh për fshatin tënd?*

**Fehmi Kallaba:** Unë, në fakt, jam rritur bashkë me Roganën, edhe pse kam punuar në Kamenicë si tagrambledhës prej pas Luftës së Dytë Botërore e deri në pension. Mirëpo, më 1985 kam qenë, një mandat, kryetar i Lidhjes Socialiste për fshatin. Nuk kam qenë gjatë, por në atë kohë pata marrë disa iniciativa për fshatin. Pata kërkuar, dhe isha këmbëngulës, që të ndërtohej një ambulancë e veterinars, çka edhe u bë. Pastaj, në atë periudhë, hasa në mirëkuptim edhe me një Osman Bilallin, që punonte në Elektrokosovë, dhe ma mundësoi që ta rregullonim rrjetin elektrik prej xhamisë e deri në Katushnicë, kështu që askush nuk ka paguar as për shtylla e as për tela e, madje, as për trafostacionin.

Më herët, derisa punoja në Kamenicë, udhëtoja për çdo ditë në këmbë, kështu

që ia dija edhe rëndësinë transportit rrugor. Kjo më shtyri që të bëja përpjekje të mëdha, dhe pata arritur, që ta vija në qarkullim linjën e parë të autobusëve. Më kujtohet, pata kërkuar prej një Milenkoviqit që ta lëshonte një linjë të autobusëve, por ai më tha se një gjë e tillë nuk bëhet dot. Me atë inat, hipa në një autobus të Vranjës dhe po e pyes shoferin se si është mundësia që të qarkullojë autobusi edhe në këtë pjesë të komunës e ai më tha se duhet të kontaktoj me drejtorin. Shkova në Vranjë dhe e takova drejtorin. Ai më priti shumë mirë, por më tha se kjo varet nga komuna, ku këta të Komunës së Kamenicës nuk pajtoheshin. Një ditë hipa në një autobus të Kumanovës dhe shkova e fola me drejtorin e asaj organizate. Ai më tha se kjo kërkesë duhet të vijë prej popullit, kështu që bëra disa procese me kërkesa, të cilat i organizova të nënshkruheshin nga banorë të 12 katundeve të kësaj ane, ua dorëzova në drejtori, në Kumanovë, dhe së shpejti u lëshua linja e parë. Mbjaj mend fare mirë atë kohë, sepse atë ditë të 21 marsit 1968 më pati vdekur babai (Hafëz Kallaba) dhe shumë njerëz, që kishin ardhur nga Bujanoci, Presheva, Kumanova e Shkupi, kishin udhëtuar me atë autobus dhe kishin arritur për varrim. Edhe diçka më kujtohet. Ishin vitet '70. Në një mbledhje të fshatit e pata përmendur se do të kërkoj që të vijë mjeku e të punojë në ambulancë. Të gjithë qeshnin me mua, duke më thënë: - diçka që nuk bëhet, mos e fol, ore! Mirëpo, pas tre muajsh doktori erdhi nga Vranja dhe punoi në Muçivërc. Këto i kam bërë, pra, për fshatin tim, natyrisht edhe me ndihmën e bashkëfshatarëve, të cilët shumë i respektoj.

***Info Rogana:** A ju kujtohet, kur ka filluar punën shkolla e Roganës në gjuhën shqipe?*

**Fehmi Kallaba:** Unë kam qenë në shërbim ushtarak, por kjo ka ndodhur më 1945/46 dhe mësuesi i parë ka qenë Xhevat Aliu. Me ardhjen e mësuesit shqiptar në Roganë sikur ka filluar një epokë e re për rogasit. Unë jam krenar me punën e mësuesve shqiptarë në këtë shkollë. Falë punës së tyre, por edhe angazhimit tim, kam arritur t'i shkolloj të gjithë fëmijët e mi.

***Info Rogana:** Cila është porosia juaj për gjeneratat e ardhshme?*

**Fehmi Kallaba:** T'ju them të drejtën, tani në këto ditë pleqërie, kur së shpejti do të hyj në vitin e 84-t të jetës, po më kënaqin vizitat e shumta të bashkëfshatarëve dhe miqve të mi. Kjo më bën nder dhe krenohem për respektin e ndërsjellë të rogasve. Prandaj, të rinjtë, pa dyshim, do t'i porositja që të shkollohen, ta

respektojnë dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin, të krijojnë kushte jetese këtu dhe të mos e braktisin vendin e vet.

Shëndet dhe pleqëri të lehtë! - ishin urimet e “Info Roganës” për plakun më të moshuar të fshatit, z. Fehmi Kallaba.



*“Ajo që shkruhet mrekullon në historitë - ajo që tallet harrohet ose anshmëkohet”, (fjalë të shprehura) Fehmi Kallaba më 10 shkurt 2006*

**Info Rogana:** Sa ka qenë i fortur për Roganën dhe çka ka mundur të bëjë për fshatin tënd?

**Fehmi Kallaba:** Unë në fakt jam rritur bashkë me Roganën edhe pse kam punuar në Kamenicë si tigranbleshë, prej pas luftës së dytë botërore e deri në pension. Mërho, më 1985 kam qenë kryetar i Lidhjes Socialiste për fshatin. Nuk kam qenë gjatë, por në atë kohë rrita rreth 400 tërheqës në fshatin

kuqitshet, pata kërkuar prej një Mienkoviq që ta lëshojë një lirisë për autobusive, por ai më tha se nuk vjen në shprehje. Në atë kohë hipa në një autobus të Vranjës dhe pa e pyes sholvën si ishte mundësia që të çarkulloje autobus edhe në këtë pjesë të komunës e ai më tha se duhet të kontaktoj me drejtorin Stikovi në Vranjë dhe e takova drejtorin. Ai më pyeti shumë mirë, por më tha se kjo varet nga Komuna, që që këtu të komunës së Kamenicës nuk pajtohetes. Ishte një mirë në një anëtarin të


do të kërkuj që të vijë mjeku e të punojë në ambulancë. Të gjithë qeshnin me mua duke më thënë: - diçka që nuk, lehtë mirë e foli bre! Mërho, pas tri muajsh doktorin erdhi nga Vranja dhe punoi në Maqverc. Mirë i kam bërë, pra: për fshatin tim, natyrisht edhe me ndihmën e çarkullo- vësive, të cilin shumë i respektoj.

**Info Rogana:** A ju kujtohet kur ka filluar punën shkolle e Roganës në gjatë shpër?

**Fehmi Kallaba:** Unë kam qenë në shkol- lën ushtarak, por kjo ka ndodhur më 1945-46 dhe mësuja i patë ka qenë Xhevit Aliu. Me ardhjen e mësuesit shqiptar në Roganë sikur ka filluar një epokë e re për roganësit. Unë jam krenar me punën e mësuesve shqiptarë në këtë shkollë. Fjalë për të: të tjerë, por edhe angazhimit tim, unë personalisht, kam arritur të shkolloj të gjithë fëmijët e mi.

**Info Rogana:** Cila është përvoja juaj për gjeneratat e ardhshme?

(Pjesë nga intervista me Fehmi Kallabën në “Inforogana” nr. 1, f. 4, shkurt 2006)



Hartë etnografike  
e vitit 1861  
publikuar nga  
Johan Georg von  
Hahn - Rogana  
quhej Rogoshnica



## Shpend Qemajl Kallaba - ambasador i Republikës së Kosovës



Shpendi ka lindur më 1 shkurt 1961. Pas diplomimit më 1985 në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Filologjisë - Departamenti i Gjuhës Angleze, ka punuar profesor i gjuhës angleze, në shkolla fillore dhe të mesme, në shumë komuna të Kosovës deri në vitin 2000.

Pas luftës së fundit, ai angazhohet këshilltar i Odës Ekonomike të Austrisë për Kosovë, në Zyrën e Odës Ekonomike të Austrisë, në Prishtinë (2000-2002).

Për një kohë ishte edhe zyrtar i lartë në Hekurudhat e Kosovës.

Që nga viti 2004 ka shërbyer në cilësinë e shefit të Divizionit për Çështjet e Protokollit në Zyrën për koordinimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe dialogut rajonal pranë Zyrës së Kryeministrit. Shpendi ishte gjithashtu i përkushtuar në vendosjen e praktikave të Protokollit të Shtetit dhe punoi në vazhdimësi në kabinetet e katër kryeministrave, në Qeverinë e Republikës së Kosovës (2004-2006).

Gjatë këtyre viteve, Shpendi ndoqi shkollimin e vazhdueshëm në Akademinë Diplomatike në Tiranë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, veçmas në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit. Përveç kësaj, përkushtimi i tij profesional u përqendrua në protokollin diplomatik, praktikën diplomatike, diplomacinë bilaterale dhe multilaterale në institutin diplomatik "Clingendael" të Hagës.

Gjatë vitit 2005-2006, fitoi edhe përvoja të drejtpërdrejta në institutin diplomatik, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bullgarisë.

Karriera e tij aktive politike filloi gjatë periudhës 2006-2010, si shef i Kabinetit dhe Protokollit në zyrën e Shkëlqesisë së tij, z. Behgjet Pacolli - kryetar i partisë politike të Aleancës së Re të Kosovës.

Në tetor 2010, Shpend Kallaba u emërua këshilltar për politikë të jashtme

në kabinetin e ushtruesit të detyrës së presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, z. Jakup Krasniqi, ndërsa, ka shërbyer edhe si këshilltar i politikës së jashtme në kabinetin e presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, z. Behgjet Pacolli, shkurt-mars 2011.

Në maj 2012, Shpendi mbaroi një trajnim për program të shkëmbimit të përvojave në SHBA, veçanërisht në Shkollën John C. Whitehead, të diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Seton Hall University, nën drejtimin e ambasadorit John K. Menzies dhe Robert L. Berry.

Nga prilli 2012 deri në qershor të vitit 2018 qe ambasador i Republikës së Kosovës në Republikën e Bullgarisë.

Në shenjë mirënjohje për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, më 26 qershor 2018, presidenti Republikës së Bullgarisë, Shkëlqesia e Tij, z. Rumen Radev, e dekoron Shpend Kallabën me Urdhrin e Kalorësit “Madara”.

Shpend Kallaba, në nëntor të vitit 2018, është emëruar ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë në Budapest - Hungari. Në këtë post është që nga janari 2019.



*Nexhmija e Xhevdeti gjatë një vizite Shpend Kallabës në Budapest të Hungarisë, më 18 qershor 2019*

## Foto e dokumente nga arkivi familjar



*Vendimi për sigurimin social që kishin të punësuarit në këtë periudhë*



*Përmendore e ngritur nga nipat e mbesat për gjyshin Hafëz Kallaba, më 24 dhjetor 2015*



*Letër e Mulla Qamil Rafunës për Hafëz Shefki Kallabën*





*Nga vizita e Ana Senkieviq Kallaba (bashkëshortja e Haki Kallabës) dhe vajza tyre Remza Kallaba - Theis në familjen e Xhevdet Kallabës (16.9.2000), gjatë një qëndrimi për vizitë në Kosovë*



*Një foto e përbashkët e Hakiut dhe Faruzës me familjarë gjatë një vizite në qershor të vitit 2009 në shtëpinë e nipit të tij Sylejman Muharremit (majtas), në Prishtinë*



*Koretin, më 1968 (nga e majta): Tefiku me djalin Reshatin, kushërirën - Ramizen, hallën - Hanumshahen, gruan - Naxhijen dhe vajzën - Dritën*



*Hafëz Kallaba me vajzën, Fetijen (majtas) dhe gruan e Ilmiut, Xhyheren, vitet '60*



*Gjilan, dhjetor 2005 Nga e majta – nipat nga Kopërnica: Xhevati, Hyseni e Mehmeti*



*Gjilan, 1973: Në këmbë (nga e majta): Tefiku, Kadrija, Shega, Mehmeti; (rreshti i parë) Murati, Xhevati, Nizaqetja dhe Vjollca*





*Koretin, qershor 1967 (nga e majta): Tefiku, Elhamiu, Musahu, Hafëz Kallaba, Naxhija, Selamiu, Drita, Gani Dervishi, Xhevdeti me Reshatin në prehër*



*Nga e majta: Xhevdeti, Nexhmija dhe Shpendi gjatë një vizite qytetit të Budapestit më 18 qershor 2019*





## II

# **Roli i familjes Kallaba në arsimimin shqip**

*(Intervistë me Kemën – Ekrem Kallabën  
16. 7.1944 – 11.12.2008)*

“ Mos u lavdëro me  
mallin e humbur dhe  
me babain e vdekur,  
ndërto pasurinë dhe  
autoritetin tënd. ”

---

*Tefik Kallaba*





Tefik Sh. Kallaba  
(10.8.1922 - 4.7.1984)  
mësuesi i parë nga fshati Roganë

I ballafaquar me realitetin e mungesës së shumë fakteve për të kaluarën e familjes Kallaba, një kohë të gjatë u kujtova për mënyrën e prezantimit të shumë historive në këtë libër, qofshin ato të familjes së ngushtë ose të gjerë. Kështu, një ditë, pa dashur që të bëja një intervistë me Kemën, e pyeta:

*A mund të më thuash diçka për jetën tënde të fëmijërisë së hershme? E ai, si në cilësinë e të intervistuarit, filloi:*

**Kema:** Çfarë të them, është vështirë të përfshihet e gjithë fëmijëria në një bisedë rasti e çasti. Përjetimet shpesh lidhen me situata të caktuara që i ndodhin njeriut. Ta zëmë, kur kujton një shok të fëmijërisë, të kujtohen ngjarje të përjetuara me atë shok; kur takon në rrugë ndonjë mësues, të kujtohen ndodhitë kur ai të ka dhënë mësim ose edhe kur e ke pasur koleg; me kolegët e punës është njësoj, e kështu me radhë. Por, tani po përpiqem ta kthej kujtesën sa më thellë në fëmijëri, për të rrëfyer ngjarje të ndryshme. Do të përqendrohem më shumë rreth arsimit, por do të shpalos edhe momente e situata nga jeta e përditshme. Dhe, natyrisht do të jem i gatshëm të të jap përgjigje për të gjitha pyetjet e tua.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në rrethin e Dardanës kishte fare pak mësues shqiptarë. Kështu, sipas rrëfimit të babait, Tefik Kallaba, prej 28 shkurtit e deri më 6 mars 1948, inspektori i Arsimit, Kasëm Caka, me prejardhje nga Korça, kishte organizuar një seminar njëjavor në lokalet e mejtepit të xhamisë, në Topanicë. Seminari kishte për qëllim aftësimin e disa mësuesve për të punuar me analfabetë moshash të ndryshme. Këto trajnime ishin realizuar nga mësuesi Ndue Zef Markaj, që punonte në shkollën e Karaçevës dhe nga Nazmije Kastrati, nga Karaçeva e që punonte në Topanicë. Mësuesi Ndue Zef Markaj ishte me prejardhje nga fshati Reç i rrethit të Shkodrës (më vonë shpërngulet në Lezhë). Në këtë seminar kishin marrë pjesë 12 seminaristë: Metush Krasniqi, Bejtullaj Mujaj, Tefik Kallaba, Fazli Mavriqi, Bajram Spahiu, Murat Shkodra, Shaban Zylfiu, Rrahman Sinani, Ismajl Doda, Fehmi Jakupi, Hysen Ibishi dhe Rexhep Himolli. Falë zgjuarsisë së tyre, por edhe entuziazmit dhe dëshirës për të punuar në arsim, ata dhanë kontributin fillestar, si dhe, krahas punës, vazhdueshëm ngritën kapacitetet e veta edukativo arsimore, duke ndjekur seminare për mësues gjithandej Kosovës.

Meqë po flasim për këtë kohë, të përmend disa nga mësuesit që punonin në shkollat shqipe të rrethit të Dardanës:

Në Roganë - Xhevat Alia nga Gjilani; në Zarbicë - Tahir Berisha, nga Verbani; në Karaçevë - Ndue Zef Markaj (Lezhë - Shqipëri); në Desivojcë - Fehmi Jakupi (Morina) nga Topanica; në Hogosht - Fehmi Sinella, nga Kavaja; në Koretin - Enver Gjerqeku, nga Gjakova; në Tygjec - Ukë Plaqiqi; në Topanicë - Hafëz Shaipi, nga Topanica; në Poliçkë - Bejtullah Muja, nga Hogoshti; në Busavatë - Tefik Kallaba, nga Rogana; në Strezoc - Nikë Deshpali; në Laçiq - Bajram Gjelili; në Shipashnicë - Metush Krasniqi, nga Dajkoci; në Krilevë - Qemajl Keka, nga Muçivërci; në Kopërnice - Murat Shkodra, nga Desivojca (e zëvendësoi pastaj Remzi Morina, nga Hodonoci); në Hodonoc - Nazif Isufi nga fshati Lloshkobare e Ferizajt etj.

Në dhjetorin e vitit 1947 babai im ishte caktuar për mësues në Busavatë, ku do të hapte për herë të parë një shkollë shqipe. Nuk kishte as objekt dhe as pajisje të nevojshme për zhvillimin e mësimit. Disa prindër as nuk kishin dashur t'i çonin fëmijët e vet në shkollë, kinse po u "prishen" e po u bëhen kaurë, vajzat sidomos, sepse kështu kishte vepruar propaganda serbe nëpërmjet disa shqiptarëve të paditur e naivë. Sidoqoftë, pas shumë e shumë sqarimeve, lutjeve dhe arsyeshmërive që ua shpjegonte busavatasve, arrijnë bashkërisht ta adaptojnë ish-objektin e mejtepit dhe t'i përgatisin dy dhoma mësimi si dhe t'i tubojnë rreth 80 nxënës moshash dhe gjinish të ndryshme, nga shtatë deri në 14 vjeç.



*Nga një seminar për mësues të viteve '50, (nga e majta ulur) Tefik Kallaba, Rrahman Sinani; (në këmbë) Bejtullah Muja, Nexhmije Pagarusha dhe Fehmi Morina*

Deri nga fundi i shkurtit 1948 edhe klasat ishin bërë gati për mësim. Ishte e pamundur të punohej në një turn me 80 nxënës. T’i seleksiononte dhe një pjesë t’i linte për vitin tjetër, nuk donte; nuk dëshironte që shtatëvjeçarëve t’ua humbte hapin, kurse më të moshuarit ta humbnin edhe një vit. Kështu i kishte ndarë në dy grupe dhe punonte me ta në dy turne, natyrisht gjithmonë për të njëjtën pagë. Veç kësaj, me dëshirën që ta zhdukte analfabetizmin në këtë fshat, në mbrëmje, mbante kurse mësimi me të rriturit. Nuk e di nga e merrte gjithë atë energji për punë. Nga 28 shkurti i vitit 1948 pati marrë edhe vendimin zyrtar për mësues në Busavatë. Çështje e vërteta, vendimin për punë në Busavatë e kishte mësuesi Bejtullah Muja, por u vendos që ai të punonte në Poliçkë, kurse Tefiku në Busavatë.



Prof. Halit Maliqi

Për figurën e babait tim dhe mësuesit më popullor të Anamoravës – Tefikut, më duhet të flas vazhdimisht gjatë këtij rrëfimi, sepse e kisha edhe si idhull prindi, por edhe idhull prej mësuesi. Dhe, jo vetëm unë, por shumë nxënës babain e kishin idhull.

Ja se si e përshkruan ish-nxënësi i tij, shumë vjet më vonë, vetë mësuesi dhe profesori i gjuhës dhe letërsisë shqipe, Halit Sylejmani – Maliqi.

*“Si tani më kujtohet dita e parë e shkollës. Kishin ardhur shumë fëmijë moshash të ndryshme dhe shumë fshatarë. Me padurim donim ta shihnim mësuesin tonë të parë. Nuk*

*kishim parë kurrë mësues. Dalja e tij para shkollëve të shkollës (dikur mejtep) u duartrokite nga prindërit dhe nga fëmijët. Edhe ai duartrokite. Ndryshe nga të tjerët, ai nuk kishte kapelë. Kishte flokë të krehur mirë, setrën dhe pantallonat e zeza, këmishën të bardhë dhe kravatën të kuqe! Dukej elegant, bukurosh e buzagaz. Disa dhjetëra e dhjetëra fëmijë e prindër ishin drejtuar nga ai, sikur donin ta fotografonin dhe ta incizonin çdo fjalë të tij.*

Fjalët e tij të para ishin:

“Të dashur nxënës, të dashur prindër, ju përshëndes nga zemra të gjithëve! Jam tepër i gëzuar që kam ardhur për mësues në këtë katund. Kam dëgjuar se këtu ka burra të njohur e trima! Kam dëgjuar për mikpritjen tuaj!” Vazhdoi pastaj me fjalë të zgjedhura miradije: “Sot, për ju, tha ai, është një ditë e madhe. Ditë feste e gëzimi. Sot, këtu po hapet shkolla fillore. Po hapen dritaret e dritës dhe të diturisë. Terri dhe prapambetja po ia lëshojnë vendin dritës dhe diturisë. Fëmijët tuaj do të shkollohen e do të arsimohen. Do të shoqërohen me botën e qytetëruar”, e shumë e shumë fjalë të tjera të zgjedhura. Por, kur tha: “Një dijetar i madh ka thënë: Aty ku hapet një shkollë, aty mbyllet një burg” - u duartrokoi gjatë nga të pranishmit. Ishin këto fjalë që më kanë mbetur në kujtim dhe më kanë shoqëruar tërë jetën.

Edhe sot më kujtohen rastet në kohë dimri, kur nxënësit që vinin nga mëhallët jashtë katundit në largësi 2-4 km, mësuesi i lejonte të afroreshin pranë koftorit për t’u ngrohur për ca minuta e pastaj e fillonte orën e mësimit.

...gjatë punës së punës së arsimit dhe për të mos  
e shumë punës të arsimit si i përparuar nga puna  
në vitin 1962, ishte edhe mësuesi Tefik. Nga vepër sa ka shprehur  
autoritetin dhe lavdinë. Populli ynë ka ditur të mbledhë  
lejt e vet të vërtetë.  
Ai mbet i pavarshëm si njëri, punëtor e mësues  
i vërtetë i popullit. Emri dhe vepër e tij prapë do të  
mbasin në kujtim ndër brezat e shumë që i mësues  
shkollor dhe edukoi. I gofta lavdi përherë!  
23 nëntor 2010  
Durrobani  
Nxënës i Tefik Sylejmanit,  
Halit Sylejman - Maliq

Faksimile e opinionit të Halit Maliqit- Sylejmanit për Tefik Kallabën

Mësuesi Tefik, sa më kujtohet mua, ndiente një dhembje për nxënësit e varfër, të cilët vinin në shkollë të veshur dobët, me opinga lëkure, me një këmishë e setër të hollë; shumë nxënës nuk kishin çanta, por librat i kishin futur nëpër do strajca,

e disa nën sjetulla. Kishte shumë raste kur mësuesi disa nxënësve të varfër ua blinte librat e fletoret, disave nga ndonjë çantë, disave diçka nga veshmbathja. Ishin vitet e pasluftës, vitet e robërisë dhe terrorit serbosllav, vrasjeve, burgosjeve dhe keqtrajttimeve që u bëheshin shqiptarëve. Prandaj, këto veprime e sjellje të mësuesit ishin një gjest e kujdes më shumë se edukativ; ishte një sjellje më shumë se humane; ishte një dashuri e ngrohtësi më shumë se prindërore; ishte ky një shembull i një mësuesi që ngrohtësisht e përqafoi profesionin e mësuesisë. Këto veprime e sjellje ia rritën autoritetin dhe shtuan respektin nga fshatarët, duke e çmuar si njeri, pedagog e humanist. Në fund të vitit shkollor, ne, nxënësit e klasës së katërt, na udhëzoi e na këshilloi që të vazhdonim shkollimin në progjimnazet, në Hogosht e në Gjilan.

Për fat të mirë, gjatë asaj vere të vitit 1950, në Prishtinë u hap kursi dymujor gjimnazial. Unë dhe dy shokë të klasës u regjistruam në atë gjimnaz. Ishin hapur dhjetë paralele të klasës së parë nga e gjithë Kosova. Pas dy javësh shokët e mi të Busavatës e lëshuan gjimnazin. Mbeta vetëm. Por, u angazhova seriozisht në mësim. Mbërrita rezultate më të mira sesa nxënësit e qyteteve Prishtinë, Mitrovicë, Pejë etj.

Dy-tri javë pa mbaruar mësimi, mësuesi Tefik, që ndiqte kursin pedagogjik në Prizren, kishte dëgjuar se disa nxënës nga Busavata janë në kursin gjimnazial në Prishtinë. Erdhi të na vizitonte. Më gjeti vetëm mua. Gëzim e përqaqim! Shkoi për



Ilustrim për lëndën e matematikës, punuar nga mësuesi Tefik Kallaba



të biseduar me kujdestarin e klasës, Muhedin Salihmixhiqin, që më vonë ishte neuropsikiatër i njohur në Kosovë. Bisedoi edhe me edukatorin Ndue Zef Neka, që atë vit shkollor erdhi për drejtor të progjimnazit në Hogosht. Mësuesi Tefik kishte dëgjuar fjalë të mira dhe i kishte parë të gjitha notat pesa në ditar! Erdhi tek unë buzagaz e tepër i gëzuar. Ishte krenar që nxënësi i tij, nga një fshat i varfër, kishte arritur sukses të shkëlqyeshëm. Më përgëzoi dhe m'i dha 100 dinarë, që ishin shumë. Ky ishte portreti i mësuesit tim.

Katër vjet më vonë, në vitin shkollor 1954/55, kur unë isha drejtor i progjimnazit në Hogosht, mësuesi Tefik shërbente mësues në Kopërrnicë. Kishim takime të shpeshta. Vinte në Hogosht dhe para punëtorëve arsimorë fliste me krenari për nxënësit e tij në Busavatë. Unë thosha se kjo është meritë e mësuesit Tefik, se ai është mësues i mësuesve të kësaj ane”<sup>17</sup>.



Mësues nga vitet '50 (nga e majta lart): Fehmi Morina, Tefik Kallaba, Ndue Z. Neka, Rrahman Sinani; (ulur) Ajdin Salihu, Murat Shkodra, Bejtullah Muja

<sup>17</sup> Halit Sylejmani – Maliqi: Letër përkujtimi në dorëshkrim për mësuesin Tefik Kallaba, 23 dhjetor 2010.

“ Kjo tokë e bekuar  
një ditë do ta ketë  
ushtrinë e vet. ”

---

*Tefik Kallaba*



Ish-nxënësi tjetër i tij busavatas, gazetari dhe krijuesi Daut Maliqi, në poezinë “Mësuesi im<sup>18</sup>”, e përshkruan mësuesin e vet, Tefik Kallabën:



*Daut Maliqi, mësues, gazetar e publicist*

### **MËSUESI IM**

Ishte njeri i mirë,  
Krenar pa masë.  
Zemra i buzëqeshte  
Kur hynte në klasë.

Shkëlqente me dije,  
Punë e atdhedashuri.  
Na donte të gjithëve,  
Si të ishim fëmijë të tij.

Na mësoi shkrim-lexim,  
Na edukoi drejt,  
Ta duam njëri-tjetrin,  
Ta madhërojmë atdheun.

Ishte gojëmbël,  
Udhërrëfyes, energjik.  
Mësuesi im i parë,  
Mësuesi ynë lapidar.

Shumë vjet më vonë, me rastin e formimit të Ushtrisë së Kosovës, 14 dhjetor 2018, Daut Maliqi rrëfen për një muhabet që e kishte dëgjuar në odën e tij, qysh kur ishte i vogël, e që lidhet me mësuesin e tij, Tefik Kallabën. Atë ditë, Daut Maliqi, në adresën e tij të fejsbukut (Facebookut) poston këtë shkrim:

---

<sup>18</sup> Daut Maliqi: “Nuk më doli ëndrra”, f. 71.

“I ndjери Tefik Kallaba, veteran i arsimit e veprimtar i mirënjohur i kauzës sonë kombëtare, qe njeri i urtë, i dashur dhe largpamës. Ishte mësues i parë i shkollës fillore katërklasëshe në Busavatë të Dardanës, fshatit tim të lindjes. Fati e deshi të jem nxënës i brezit të parë të kësaj vatre të dritës e diturisë, themelet e së cilës i vuri mësuesi im i dashur e i paharruar Tefik Kallaba. Ai na i mësoi shkronjat e alfabetit shqip, duke na i hapur edhe dyert e jetës në rrugëtimin tonë të dijes e të atdhedashurisë.

Vinte shpesh në shtëpinë tonë, në lagjen Jabukovicë, dhe në odën e babait tim, Asllan M. Maliqi, mblidheshin burrat e lagjes, me ç’rast, pos të tjerash, mësuesi Tefik u fliste për rëndësinë e shkollimit të djemve e vajzave për të ecur me hapa të sigurt përpara me popujt e tjerë.

Me kërkesën e tij, na ftonin në odë edhe ne fëmijëve për të recituar poezitë që na i mësonte në shkollë. Më kujtohet si sot një rast kur në bisedë më babanë tim, i cili kishte parë vdekjen me sy nga torturat në burgun famëkeq të Gjilanit, në atë kohë të trishtë, mësuesi Tefik i tha: - “Asllan, duhet të kemi durim e të punojmë me urti e mençuri dhe t’i shkollojmë fëmijët tanë për ditë më të mira.

Jam i bindur se do të vijë koha që kjo tokë e bekuar një ditë do ta ketë ushtrinë e vet”! Unë atëherë isha i vogël për ta kuptuar, por sot më 14 dhjetor 2018 e kuptova largpamësinë e mësuesit tim erudit.

- I dashuri baba, i dashuri mësuesi im Tefik Kallaba, biseda e mendimi Juaj dhe ëndrra shekullore e popullit tonë liridashës u bë realitet - Kosova u bë me ushtri!

Urime Kosovë - urime gjithë popullit liridashës!”

*Babai jetonte i vetëm në Busavatë apo me familje, pra, me ju?*

**Kema:** Meqë Busavata ishte larg Roganës dhe nuk udhëtohej për çdo ditë, babai kishte vendosur të na merrte me vete edhe mua dhe nënën Naxhije për të banuar në Busavatë. Banonim te Nebiu, ku shtëpinë e kishte afër xhamisë së fshatit. Si fëmijë i hoxhës që ishte, aga kishte shumë respekt te busavatasit.

Shpesh mbante edhe ndonjë ligjëratë fetare me temë nga edukata dhe arsimit, dhe kështu i bindte për rolin e mësimit dhe të dijes për fëmijët e tyre.

Unë, si fëmijë 4-vjeçar, kisha shumë privilegje. Fëmijët e fshatit më merrnin dorë më dorë. Kohën më të madhe e kaloja me Musahun e Nebiut, ngase aty dhe banonim. Me mua luanin edhe më të rriturit. Fshatarët e ftonin agën shumë shpesh në darka e në ndeja për t'ua "hijeshuar" konakun, kur kishin mysafirë. Ishte i mirëseardhur te të gjitha lagjet, por më i pranueshëm ishte te lagjja e Jabukovicës dhe tek ajo e Fetah Prekoroxhës. Si djalë të vetëm që më kishin, më merrnin gjithnjë me vete. Verës, si zakonisht, rrinim në Roganë, te gjyshi im. Baba Hoxhë, kështu e quanim gjyshin, më donte shumë edhe pse ai kishte edhe mbesa e nipa të tjerë. Gjyshja Sanije më donte edhe më shumë. Ajo "vriste" e "priste" për mua, nëse më qortonte ndokush nga axhallarët e mi ose gratë e tyre, ndonëse nuk ndodhte të më qortonin, sepse sillesha mirë; pastaj në Roganë kishim bagëti: buallica, lopë, qe e bile edhe kuaj. I përmenda kuajt, sepse baba Hoxhë kishte një çeze për të udhëtuar në mbledhjet e tij në Gjilan, Ferizaj, Prishtinë e Shkup. Ishte hoxhë me nam, por edhe zotëri, që i kish hije vendi e kuvendi. Ishte i njohur për gjithë kryesinë e Bashkësisë Islame të Jugosllavisë me seli në Sarajevë. Shpesh i vinin shokë-hoxhallarë nga Sarajeva. Halla Fatime (vajza e Mulla Ibrahimit) tregonte se si në vitet '35 – '40, në Roganë, vinin me familjet e tyre Hasif Efendija e Ibrahim Efendija nga Sarajeva, të cilët qëndronin nga një javë e më shumë. Po, për babën Hoxhë do të flas sërish!

### *Sa qëndrove në Busavatë?*

**Kema:** Në Busavatë, natyrisht me nënën dhe babanë, qëndruam deri në përfundim të vitit shkollor 1950. Gjatë verës erdhëm në Roganë, kurse aga, si zakonisht, ndiqte kurse pedagogjike, që organizoheshin në qytete të ndryshme të Kosovës. Kësaj vere më duket se kishte qenë në Pejë.

Drejtorja e Arsimit e Komunës së Dardanës, mësuesve shqiptarë ua ndërronte shpesh vendet e punës. Pra, nuk i linin kohë të gjatë të punonin në një shkollë. I transferonin nga një fshat në tjetrin, duke mos i lënë që të bëjnë "çerdhe". Nga shtatori i vitit 1950 agën e transferuan në Kopërnice. Banonim te Hamdi Hoxha. Aty, më 3 mars 1953, nëna e solli në jetë edhe vëllain tim, Xhevdetin. Familja

Hoxha ishte e mrekullueshme dhe arsimdashëse. Aty fillova edhe klasën e parë të shkollës fillore, në vitin shkollor 1951/52.



*Transferimi i Tefik Kallabës nga Busavata në Kopërnice.  
Vendim i lëshuar më 19 shtator 1950*

Në Kopërnice e kisha edhe hallën Fetë (Fetijen), të martuar për Murat Ismajlin, pastaj një hallë të nënës, që e quanin halla Bibë, si dhe një kushërirë të babait me emër Fatushe. Që të gjitha jetonin në lagjen Ismajli. Biba kishte disa djem, por njërin e kisha moshatar, Mehmetin. Meqë ra fjala për Mehmetin, më duhet ta tregoj një ngjarje që e kishte përmendur disa herë babai im. Vëllai i



*Tefik Kallaba ne mes, Jahja Vokshi (djathtas)  
dhe Rrahman Sinani, fotografuar në Pejë  
më 1950*

fëmijëve shqiptarë. U kishte shpjeguar shpesh edhe për pasojat e paditurisë së shqiptarëve gjatë shekujve dhe tendencat e secilit pushtues për ta lënë këtë popull pa shkollë e pa dije. Xhavitin e kishte mik shtëpie dhe kishte besim tek ai që t'i jepte sqarime të hollësishme. Por, Xhaviti kishte hallin e tij të ekzistencës dhe përpiquej që të dëshmohej për menaxher i mirë karshi konkurrencës që e kishte nga fqinjët e vet. Donte të kishte një pendë që të mirë, tri-katër lopë të mira qumështore, synonte që arat e tij të ishin më prodhueset me bereqet. E, krejt këto punë nuk arrinte t'i bënte vetë. Bile vetë ishte i angazhuar në tregti me kafshë, dhe ishte shumë i suksesshëm. Nga ana tjetër, Tefiku i shihte gjërat nga një tjetër perspektivë, - nga perspektiva e arsimit. Ai ngarendte që të nxirrte sa më shumë breza shkollarësh, si armën më të fortë drejt lirisë dha pavarësisë kombëtare. Prandaj, nuk lëshonte pe as edhe ndaj miqve të shtëpisë, siç ishte Xhaviti.

Kështu, duke mos u bindur ai që ta dërgonte Mehmetin në shkollë, i kishte dhënë edhe vërejtjen e fundit dhe e kishte kërcënuar me dënim. Xhaviti, nuk e

Mehmetit quhej Xhaviti. Xhaviti, pasi ishte më i rrituri në familje, kishte dhe përgjegjësinë për vëllezërit e tij. Kishin shumë bagëti dhe shumë punë fushe. Shi për këtë, Xhaviti kishte vendosur që Mehmetin ta ndalte krejt nga shkolla. Kur e kishte kuptuar këtë aga Tefik, ia kishte tërhequr vërejtjen Xhavitit. Ai ishte djali i hallës së nënës sime, dhe nisur edhe nga afërsia familjare i kishte thënë mësuesit. – “Pa lëre, o Tefik, se çka po i duhet këtij shkolla, i kam njëqind punë në shtëpi, tokë shumë, kafshë shumë, një prush vëllazëri, dhe mendtë n'krye s'i kam”, dhe kishte rezistuar ta dërgonte Mehmetin në shkollë.

Aga kishte biseduar disa herë me Xhavitin, por edhe me të tjerët, lidhur me rolin e shkollimit të





*Plani e programi i punës për kl. II dhe IV të shkollës fillore në Hogosht për periudhën 15 shkurt - 15 qershor 1952*

kishte besuar se ky edhe mund ta dënonte, por aga e kishte përdorur këtë rast “me një të rame - shumë të vrame” dhe e kishte dënuar Xhavitin me 50 banka, që ishin goxha para (mbase në vlerë të një deleje). Kur kuptoi fshati se Tefiku e kishte dënuar mikun e vet për mosdërgimin e fëmijës në shkollë, të gjithë të tjerët i dërgonin fëmijët dhe askush nuk guxonte të bënte mungesa.



*Ekremi (majtas) me shokët e fëmijërisë nga Kopërnica, në ditët e pleqërisë: Mehmet dhe Sali Ismajlin*

*Po, pse gjithë ai entuziazëm i agës Tefik për arsimin?*

**Kema:** Aga e donte shumë arsimin dhe arsimimin e brezave të rinj. Një gjysmëvjetor pati punuar edhe në Hogosht, dhjetor 1952 - shtator 1953. Gjatë kësaj kohe, përveç mësimit të rregullt, udhëhiqte edhe kurse shëndetësore për femra të rritura. Të tilla ishin organizuar në 49 qendra të rrethit të Dardanës.

Verës, mua dhe nënën na sillte në Roganë, kurse vetë shkonte në seminare për mësues, ku organizoheshin në Prizren, në Pejë, në Mitrovicë e në Prishtinë. Disa vjet me radhë vepronte kështu. Nga shtatori i vitit 1953 deri në janar 1954 punoi sekretar i Këshillit për Arsim e Kulturë në Dardanë dhe sërish iu kthye ditarit për të punuar në Koretin, nga fillimi i shkurtit 1954<sup>19</sup>.



*Vendim për emërimin e Tefik Kallabës sekretar i Këshillit për Arsim e Kulturë në Dardanë, i lëshuar më 19 shtator 1953*

Në Këshillin për Arsim e Kulturë në Dardanë arriti të mësojë shumë prapaskena që u bëheshin shqiptarëve. Kjo ia shtoi edhe më shumë egon për ta dhënë edhe atomin e fundit të fuqisë fizike e mendore drejt arsimimit të vajzave e djemve shqiptarë. Kur bija në gjumë, atë e lija duke lexuar e duke punuar për ditën e nesërme, por edhe kur zgjohesha në mëngjes, sërish e gjeja me libër në dorë ose duke vizatuar në një bllok vizatimi që i shfrytëzonte si mjete konkretizimi në klasë.

Kështu, klasën e parë dhe të dytë i kam kryer në Kopërnice, kurse klasën e tretë dhe të katërt në Koretin.

<sup>19</sup> *Vendimi për emërimin në detyrë të sekretarit të Këshillit për Arsim e Kulturë në Dardanë.*



*Vendimi për shkarkimin nga funksioni i sekretarit të Këshillit për Arsim e Kulturë në Dardanë, i lëshuar më 2 shkurt 1954*



*Mësues të shk. fillore në Hogosht më 1954/55 me drejtor Halit Maliqin (rreshti tretë në mes)*



*A mban mend diçka nga kjo moshë, në Koretin?*

**Kema:** Një kohë patëm banuar te Mulla Muharrem Masurica, që punonte imam në Koretin. Ai kishte për grua vajzën e axhës të babait tim, Islamit. Hanumshahe e kishte emrin, por ne e quanim dada Humë. Ishte një grua burrnore. E mbaj mend se si gjatë ditës mbështillte cigare për burrin e vet. Në fakt, duhanin e pinte edhe vetë.



*Nxënësit e kl. III të mësuesit Tefik Sh. Kallaba – viti shkollor 1955/56:*

*Rendi i parë nga e majta-mësuesit: Nexharije Llozana, Gani Selmani dhe Muharrem Bediu-Hashani. Rendi i vajzave nga e majta: 1. Lutfije (Ymer) Thaçi, 2. Ilmije (Shefki)*

*Kovani, 3. Sala-Cala nga Gjilani (mbesa e Ismet Hodës) 4. Ramize (Beqir) Kallaba, 5. Advije (Ramiz) Basha, 6. mësuesi Tefik Kallaba, 7. Saime (Agush) Haxhiu, 8. Zela-Zelije (Lufa) Canaj, 9. Ilmije (Hasan) Bugaçku, 10. Hazbije (Rrahmon) Berisha.*

*Rendi i djemve nga e majta: 1. Sabedin (Osman) Berisha, 2. Musa (Sefedin) Keqmezi,*

*3. Nusret (Qazim) Haxhiu, 4. Sylejman (Ahmet) Haxhiu, 5. Riza (Nexhip) Basha, 6. Ismet (Halil) Hoda, 7. Sejdi (Vesël) Berisha, 8. Ismail (Adem) Bugaçku (e ka zavendësuar babain e vet - Ademin, si punëtor teknik) dhe Bajram (Jakup) Dervishi.*

Më pas, gjatë vitit 1954, për disa muaj, në Koretin, na bëri konak Maliq Adem Bugaçku. Të them të drejtën baca Maliq më donte shumë, edhe pse unë bëja sherre të mëdha nëpër oborr. Dhe, kur gratë ankoheshin për ndonjë sherr, ai u thoshte: “Hajt, se i vogël është Ekremi, a mos po bëj unë sherr, - punë e madhe pse e paska thyer një rremb të lules”, thoshte baca Maliq dhe më kapte për dore.

Punën për vitin shkollor 1955/1956 babai e kishte filluar në Hogosht. Pas shtatë muajsh, që i bie nga një prilli 1956, ishte kthyer sërish mësues në Koretin, ndërsa unë po ndiqja mësimet në klasën e pestë, në Roganë.

Babai, nëna dhe Xhevdeti banonin në Koretin te Sherif Canaj, që ishte nip i Shaqirit të kallabëve. Një burrë me autoritet e që babanë e respektonte dhe e donte shumë. Shpesh e dëgjoja të thoshte, “Dajën Tefik e kam loçkë-dajë”, dhe vërtet me plot gojë i thoshte - daja Tefik. Disa muaj kishte banuar babai këtu, e më vonë kishte kaluar me banim në lagjen Basha, te mixha Ramiz.



*Mësuesi Tefik me nxënësit: Riza Basha (majtas) dhe Sejdi Berisha e Bajram Kovani (djathtas), Koretin - viti shkollor 1956-1957*

Unë mësoja në shkollën e Roganës dhe banoja te gjyshi. Në Roganë i gëzoheshin fort qëndrimin tim, sepse tashmë isha rritur paksa dhe isha i dobishëm për ruajtjen e bagëtisë. Në fakt, bagëtinë e ruanim bashkë me kushërirën time, Ismeten. Në lagje kishte edhe fëmijë të tjerë, që kujdeseshin për bagëtitë e tyre, dhe kjo ishte e mirëseardhur për lojërë të ndryshme. Me Ismeten shkonim shumë mirë, ajo ishte një vit më e re se unë. Bile, shpesh kërkoja që të më thërriste aga Kemi, ndërkaq kur ajo ndonjëherë përtonte për t'i pritur kafshët që të mos bënin ndonjë dëm, më drejtohej: po deshe të të them aga Kemë, atëherë shko e pritni buallcat që të mos hyjnë në kallamoq; ndonjëherë pranoja, natyrisht.

*A mund të shkëputësh ndonjë kujtim nga ruajtja e bagëtisë?*

**Kema:** Si jo! Bagëtinë e ruanim matanë lumit, që i bie nga Zabeli – në perëndim të fshatit Roganë. Kur korreshin grunajat e lëshohej fusha, bagëtinë e sillnin edhe nga mëhalla e epërme e fshatit. Kishim edhe buaj, por edhe qe të fortë dhe mirë të majmë. Kisha dëshirë t'i përleshja. Një bualli, që ishte shumë i vështirë në përleshje, ia pata mprehur edhe brirët. Kur njëherë e përmbodhi para vete një buall të mëhallës së epërme, e shpërtheu me brirët e mprehtë. Pronari kishte lajmëruar në shtëpi, kështu që gjyshi më dha vërejtjen e fundit.

Baba Hoxhë ishte shumë i respektuar nga bashkëfshatarët. I ndihmonte e i këshillonte sa herë që kishin ata nevojë. Ishte e pamundur të dëgjoje nga goja e tij që të fliste keq për ndonjë njeri. Gjithmonë gjente ndonjë argument për t'i arsyetuar edhe kur ndokush prej tyre bënte ndonjë gjest të pahijshëm në fshat. Kishte edhe mjaft njerëz me skamje. Njëherë, një bashkëfshatar, derisa po punonte në kopshtin e vet, baba Hoxhë po kalonte rrugës dhe e kishte përshëndetur me “Puna e mbarë”. Bashkëfshatari ishte ngushtuar, sepse nuk e kishte paguar hakun e hoxhës dhe i ishte drejtuar gjyshit. “Mbarë paç, aga Hoxhë, dhe më fal që nuk ta kam dhanë hakun për vitin e kaluar”. Hoxha e thërret atë deri te gardhi, skaj rrugës, nxjerr nga kutia një cigare të fabrikës e i thotë: – “Kalle një cigare, o kushëri!” Bashkëfshatari, i zënë ngushtë nga situata e krijuar, i ankohet hoxhës se si e ka mbuluar fukarallëku e nuk po arrinte as hakun ndaj hoxhës ta shlyente. Hoxha nxjerr shkrepësen nga xhepi ia ndez cigaren atij dhe për vete e i drejtohet: “A ke mundësi të m'i japësh nja dy fleta të

purrive (presh), që i paske në bahçe”? Bashkëfshatari i këput nja dy-tri fleta e ia sjell, ndërsa hoxha i drejtohet: “Kushëri, me këto fleta purrish (presh), ti ma lave borxhin për vitin e kaluar, e bile edhe për sivjet. Ti vetëm vazhdo e puno për familjen tënde”! Bashkëfshatari e falënderon përzemërsisht dhe kthehet në bahçe duke thënë vetë me vete, por zëshëm: “Eh, kollaj është kur ke punë me njeri të mençur, të çliron edhe ty, e çliron edhe veten”. Hoxhës i shkon paksa buza në gaz dhe vazhdon rrugën drejt xhamisë që ta falte namazin e iqindisë.

*Diçka tjetër të veçantë nga ajo periudhë e fëmijërisë?*

**Kema:** Po, verës mblidheshim në fushë shumë fëmijë të axhallarëve dhe kushërinjve të tjerë. Piqnim patate, kunguj e më së shpeshti shtalpakë. Më ra hise njëherë që unë të shkoja tek ara dhe të këpusja shtalpakë. U futa në arë dhe mbusha një krah me shtalpakë.

Sapo dola nga ara, andejpari kaloi babai.

- Ku i këpute këta shtalpa, m'u drejtua babai paksa me një ton më të ashpër?

Unë, fare qetë, i thashë: këtu, në këtë arën tonë.

E di ti se kjo arë është e Xhemailit, ma ktheu ai.

Po, dhe ani çka, kjo është jona, ia ktheva, dhe vazhdova të sqaroja se deri te ara e Hasanit janë tonat, kurse ato matanë janë të huajat, të mëhallës së epërme.

Kjo ngjarje u bë temë e mbrëmjes në shtëpi.

Në mbrëmje, fëmijët zakonisht rrinim veçmas, kurse të rriturit veçmas në një dhomë tjetër, ndërkaq baba Hoxhë në dhomën e vet, ku vazhdimisht lexonte dhe rrallëherë rrinte me anëtarët e tjerë, ngase ata nuk pinin duhan para tij dhe ai e dinte këtë. Nga e gjithë lagjja, vetëm baca Sylejman e pinte duhanin para babës hoxhë, ani se disa prej tyre kishin arritur në të dyzetat. Në dhomën e burrave, pothuajse çdo mbrëmje, mblidheshin burrat e gjithë lagjes sonë: baca Sylejman, baca Musah, baca Zijah, baca Ramë, baca Xhemail, baca Salih, baca

Fehmi, Axha Faik, Aga Nazmi, Aga Hysi, aga Bushi (Tasini), baca Ibrahim, baca Qemajl, baca Selim dhe shumë të tjerë, që ishin mbi të 30-tat. Në një dhomë tjetër ishim ne të brezit tim: Muharremi, Ruzhdiu, Vebiu, Skenderi, Isa, Alushi, Nusreti, Izeti e të tjerë edhe më të rinj e më të rinj. E çonim gjullurdi, duke luajtur letra, filxhanë, peshqir etj.



*Foto e vitit 1956: Nga e majta: Ekremi, Naxhija, Xhevdeti, Tefiku, Fehmiu, Shemsija, Imrija, Ismetja dhe Sahadetja*

Derisa ne po luanim, erdhi axha im, aga Hysi dhe më tha:

- Po të thërrasin te burrat.

Ngrita vetullat lart dhe brofa në këmbë; nuk e kisha idenë pse, mendova mos po më thërrisnin që t'ua recitoja ndonjë vjershë, ngase dija shumë vjersha. Në korridor, aga Hysi, kështu e quaja unë axhën tim Hysenin, më tha: more pizeveng, mos ke ba ndonjë sherr, sot?

- Jo, jo, - i thashë dhe u futëm brenda në dhomë. Në dhomë ndriçonin dy llamba me vajguri, por nga tymi i duhanit mezi shiheshin të gjithë. I përshëndeta me "mirëmbrema" - ashtu siç na kishte mësuar mësuesi në shkollë. Shumica prej tyre ma kthyen përshëndetjen, dhe, si në kor, kërkuan që ta shpjegoja rastin e shtalpakëve.

Unë, pa u hamendur u thashë:

- Pasha Zotin nuk i kam marrë në arë të huaj, por te ara e bacës Xhemail, dhe bëra me gisht nga baca Xhemail, i cili m'u duk paksa i mërrolur. Atëherë ai qeshi dhe tha: ashtu është, Ekremi nuk ka faj, sepse ne jemi një shtëpi; çdo mbrëmje jemi bashkë, prandaj ai për ara të huaja i konsideron vetëm ato të lagjeve të tjera. Qeshën të gjithë, qesha dhe unë. Nuk mora leje për dalje nga oda, sepse sikur ishte e vetëkuptueshme se ku e kisha vendin, pra, në dhomën e fëmijëve. Kur u ktheva në dhomë, të gjithë po më prisnin te dera, kurse Vebiu m'u afrua e m'i preku faqet, në mos m'i kishin skuqur me ndonjë flakësh. Më pas u ulëm dhe vazhduam lojën me letra, që i kishim bërë vetë nga disa kartonë.

*Edhe diçka tjetër nga fëmijëria?*

**Kema:** Si fëmijë kam shkuar edhe te daja Rasim, në Krenidell. I kisha merak qentë e gjahut, zagaret pra. Daja Rasim ishte specialist për t'i kapur lepujt në gjumë. Ai merrte një shkop, "hekraq" i thoshin, sepse shkopi i drurit mbante në majë një dado të madhe rreth katër centimetra. Me atë shkop daja i gjuante lepujt. Ai u afrohej aq shumë, sa mund t'i zinte edhe me dorë, sidomos kur kishte shumë borë. Për ta mësuar zagarin, ia plagoste me hekraq ndonjë lepur; e kapte dhe ia thyente një këmbë dhe e lëshonte; pastaj, kur lepurit hynte në pyll, ai ia lëshonte zagarin pas, i cili e kapte me lehtësi. Kështu i mësonte daja Rasim zagaret e vegjël. Ai njëherë e kishte kapur me dorë edhe një ujk, por, për këtë do të rrëfej më vonë.

*Po ti, bëje njësoj?*

**Kema:** Jo, në të njëjtën mënyrë, por, kur plagosja ndonjë lepur, ia lëshoja zagarin që ta ushtronte mirë nuhatjen e erës së lepurit.

Meqë jemi te daja Rasim, mund të evokoj një kujtim.

Si fëmijë edhe ai më angazhonte verës që t'ia ruaja kafshët. Ata kishin edhe



dhen. Kishin shumë kullosa të përbashkëta me bashkëfshatarët. Një ditë prej ditësh, derisa luaja me një moshatar të dajave, u ngatërrova me të, sepse ma shau nënën. E zura dhe e rrëzova përtokë. Nuk e rraha, porse ia mbusha kokën me zall, dhe e lëshova të shkonte në shtëpi. Ishte ankuar te babai i vet se e kam rrahur. Babai i tij, që ishte një kushëri i dajës Rasim, kishte ardhur te daja për të më denoncuar. Në mbrëmje, sapo i solla dhentë në torishtë, mora ibrikun, i lava këmbët dhe shkova në dhomë. Daja më qortoi, duke më thënë:

Pse e ke rrahur fëmijën e komshiut?

I thashë se ma shau nënën.

Daja m'u drejtua: po, ai është ende fëmijë dhe nuk di.

- E pasi nuk po ditka, pse nuk më tha - "ma kafsh nënën, por ta kafsha nënën".

Daja qeshi si në vete dhe nuk u mor më tepër me këtë temë, kurse unë shkova në kuzhinë te nusja dajës për të pirë dhallë, që ishte shumë i fladitshëm dhe kishte me bollëk.

Kur jemi te daja Rasim, më duhet të shpalos një rrëfim, që e tregoi shumë vjet më vonë në shoqatën e gjahtarëve "Thëllëza" në Dardanë. - Ja edhe tregimi:

### **M'u desh ta mposhtja ujkun!**

Në një sallë hoteli në Dardanë u mbledhën më shumë se 30 veteranë të klubit të gjuetarëve. Qëllimi i mbledhjes ishte informimi për pozitën e klubit të gjuetisë në Dardanë dhe nderimi i disa gjahtarëve të shoqatës, që ishin më të moshuar se 70 vjeç. Kishte një kritikë të fortë ndaj gjuetarëve të rinj, sepse ata vrisnin çdo ditë kafshët, pa kurrfarë kriteresh.

- Gjuetia duhet të kuptohet si një rekreacion dhe jo si menaxhim i mishit, paralajmëroi një 70-vjeçar. Nuk bën të vritet një lepur gjatë shtatzënisë së tij, kritikoi ai - "një gjë të tillë ne nuk e kemi bërë kurrë më parë".

- Po vriten edhe drerë, - u ankua një tjetër. Duhet më shumë investime për edukimin e gjuetarëve të rinj, rekomandoi një i tretë. Koha e takimit po kalonte



shumë shpejt me biseda rreth përvojës së gjahtarëve e në shoqërim të rakisë dhe birrës. U evokuan aq shumë përvoja të njëpasnjëshme. I pranishëm ishte edhe gjahtari 90-vjeçar, Rasim Shabani. Dikush që e njihte më mirë, e përshëndeti dhe e pyeti për të treguar përvojën me ujkun. Dhoma ishte e qetë. Z. Shabani, i cili me më dëshirë vetëm donte të dëgjonte, që i detyruar të rrëfente diçka. Ai që njeriu më i moshuar në sallë.

- Unë nuk mund të flas me zë të lartë, sikur deshi t'i shmangej fjalimit.

- Qetësi, - tha dikush me zë të lartë, si një shenjë që ai mund të fliste. I entuziazmuar nga nderimi që iu bë, rregulloi paksa plisin e bardhë, kryqëzoi duart, hodhi këmbën mbi këmbë dhe filloi të fliste me zë të ulët: “E po, kjo ishte shumë kohë më parë. Qysh si fëmijë isha shumë i dhënë pas gjuetisë. Si bari, unë isha në pyll çdo ditë. Shpesh më duhej t'i mbroja dhentë e mia nga ujqit. Me vete gjithnjë kisha dy qen të fortë. Ndonjëherë lija kopenë e dhenve vetë dhe vrapoja pas lepujve e dhelprave, pa pushkë, vetëm me një shkop të hekurt. Në fakt, hekuri ishte vetëm në pjesën e poshtme të shkopit, të cilin e hidhja goxha larg dhe mund të qëlloja shumë saktë. I thoshim „hekraq“.

Një ditë, duke ecur malit tatëpjetë, pashë një ujk që po vraponte drejt meje. Me gjasë ai ishte i frikësuar nga qentë e mi. Nuk kisha armë. Një gjuajtje me shkop e bëri atë edhe më të zemëruar. Shpejt unë hoqa pallton e dimrit dhe u përgatita për ta kapur atë. Nuk e kisha idenë se sa i vështirë duhej të ishte sulmi i tij. As britma ime - “largohu!” - nuk e frikësoi atë. Qëndrova i gatshëm si një toreador, do të thosha sot, dhe pallton e mbaja fort në duar, por ende shpresoja se nuk do t'më sulmonte. Një egërsirë kaq të zemëruar nuk e kisha parë kurrë më parë. Ai më kërcëu me të katër këmbët. M'u duk se mbi mua kishte rënë një lis. Derisa ishte në ajër, ia dola ta kap për qafe, dhe ashtu jemi rrokullisur rreth dhjetë metra teposhtë. Për fat të mirë, palltoja ishte mjaft e madhe. M'u desh një kohë që ta lodhja atë, por edhe vetë isha lodhur shumë. Pastaj thirra për ndihmë shokët e mi. I pari më erdhi në ndihmë shoku im Shabani, më vonë erdhën edhe Haliti e Metushi. Më dhanë një degë dhe më pas nxora edhe rripin nga pantallonat e mia për ta lidhur atë në qafë. M'u desh të prisja më shumë se një orë derisa erdhi ujku në vete.

Më pas ujkun e mora me vete në shtëpi. Atje u informova nga miqtë e mi se ujqit ma kishin mbytur një ka. Pjesën e mbetur të mishit e kemi sjellë në

shtëpi. Dy javë e kam ushqyer ujkun në shtëpinë time. Çdo ditë vinin për vizitë bashkëfshatarët e mi.

Një ditë mora kalin tim dhe së bashku me shokët erdha në Dardanë për ta dorëzuar ujkun në stacionin e policisë. Shpërblimi ishte një armë gjuetie. Isha më i lumtur se kurrë më parë”, rrëfeu historinë e tij për mposhtjen e ujkut Rasim Shabani. - Një gotë birrë për shëndetin e tij, - tha kryetari i shoqatës - Ekrem Kallaba dhe ftoi të pranishmit në një apero.



*Rasim Shabani me nipat e tij: Ekremi (majtas) dhe Xhevdeti*

*Po, në familje kishte ndokush gjuetinë pasion?*

**Kema:** Po, babai e kishte shumë pasion gjuetinë. Kishte një çifte të prodhimit të Kragujevcit. Vazhdimisht mbante qen të mirë gjahu (zagarë). Shpesh më merrte edhe mua në gjah, sa për t'ia bartur ndonjë lepur, kur e vriste. Ndodhte të vriste ndonjëherë edhe nga dy lepuj, por rrallë ndodhte që t'i sillte dy lepuj në shtëpi. Ua jepte gjahtarëve të tjerë ose ndonjë fqinji ku banonim. Vazhdimisht e lusja agën që të ma blinte edhe mua një pushkë gjahu. - Ende je i vogël, më thoshte, ndërsa unë gjithherë ia përsërisja këtë kërkesë.

*E, me mësim si ishe?*

**Kema:** Në shkollë isha shumë i mirë. Baba Hoxhë ishte shumë përparimtar. Gjithnjë interesohej për shkollimin tonë. Sidomos na rrinte gati mua dhe Ismetes, sepse e kishte merak edhe shkollimin e femrës shqiptare. Më vonë do të tregoj për shkollimin e femrës së parë të Roganës, Ismetes, e cila, me iniciativë të babës Hoxhë, kishte ndjekur shkollimin e mesëm në Gjilan për të punuar më vonë mësuese deri në pension.

*Ti thua se Hafëz Kallaba e mbështeti edhe përparimin e femrës shqiptare?*

**Kema:** Gjithsesi. Ai me kohë e kishte vërejtur se sa i rëndësishëm ishte arsimimi. Ndonëse, më herët vajzat e veta, e edhe ndonjë nga mbesat i kishte lejuar të shkonin në mejtep për mësim fetar ose vetëm deri në klasën e katërt fillore, në rastin e Ismetes kishte ndërruar mendjen.

Ja edhe rrëfimi i Ismetes për shkollimin e saj:

“Viti shkollor për klasën e katërt tashmë kishte mbaruar. Në orën e fundit mësuesi Faik Ibrahim Kryeziu na porositi që të nesërmen të gjithë nxënësit të vinin në shkollë me prindërit e tyre, sepse do të komunikojë suksesi. Të gjithë nxënësit tundën kokën në shenjë pohimi, e unë, disi, vetëm i lëviza buzët, pa e ditur as vetë se ç’desha të thosha.

Shokët e shoqet e dinin se isha nxënëse e shkëlqyeshme. Një shoqe ma kapi dorën për të më uruar për suksesin e arritur. Pa vetëdije ia shtrëngova dorën, por ia mbajta më gjatë sesa për një falënderim çasti. Pas pak u kthjella. Ia lëshova dorën, duke i thënë se do të shihemi nesër. Më pas erdha në shtëpi.

Në gjumë shkova më herët se zakonisht. Mbulova kokën dhe fillova të qaja, për faktin se unë nuk kisha babë që do të vinte nesër për ta dëgjuar suksesin tim. Atë ma kishin vranë serbo-çetniko-komunistët ende pa lindur unë. Vaji më kishte mbërthyer tej mase sa nuk e kisha vërejtur as nënën kur kishte hyrë në dhomë. Dënesja ime e kishte trishtuar nënën, në mos qeshë lënduar ndokund ose po qaja në ëndërr. Furishëm ma hoqi jorganin sa edhe u tremba. Më pyeti

se ç'kisha? E unë, duke u dënesur i thashë se mësuesi na ka porositur që nesër të shkojmë te shkolla bashkë me prindër. Po unë ku ta marr babën tim, që as nuk kam arritur ta shihja e ta njihja? Nëna u prek së tepërmi, por disi u përmbajt. Fli, bija ime, se këtë punë e zgjidhim nesër, mos u merakos! Pas pak, nëna Xhyhere kthehet në dhomën e gjyshit, i cili sapo kishte mbaruar së lexuari një libër arabisht. Ishte koha e faljes së jacisë, pas së cilës ai pinte një kafe dhe ia jepte edhe një rrebesh leximi të atyre shumë librave që i kishte në vitrinë.

Derisa ai po pinte kafënë, nëna po i thyente gishtat. Gjyshi ishte fort i mprehtë nga mendja dhe e kishte vërejtur nënën që kishte një hall.

- Hë, Xhyhere, çfarë halli ke?


- O babë, Ismetja sot e ka mbaruar mësimin për sivjet, dhe për nesër mësuesi e kishte porositur që në shkollë të shkonin me prindër, e ajo ishte merakosur dhe po qante, sepse nuk ka babë.



*Nga e majta: (ulur) Hamide Rudhani, Ferka Thaqi (në këmbë) Hajrije Geci, **Ismete Kallaba**, Mersije Thaqi, kl. VIII, Roganë, 6 maj 1959 (vetëm Ismetja ishte nx. kl. VIII, të tjerat jo)*

Kur dëgjon këtë baba Hoxhë, po ashtu, mërzhitet shumë. Kishte pirë gjithë kafën e mbetur në filxhan përnjëherë dhe kishte kërkuar një gotë ujë. Mos u merakosni, se e kryej unë këtë punë nesër, e kishte qetësuar Xhyheren.

Të nesërmen, më herët se zakonisht mori avdes dhe u nisëm bashkë për në shkollë. Në oborrin e shkollës unë u ndava nga gjyshi dhe shkova te shoqet e mia, kurse ai vazhdoi në klasën e improvizuar në oborrin e shkollës. Babës Hoxhë ia bënë një vend përpara. Mësuesi Faik ishte i përpiktë dhe në kohën e paraparë filloi komunikimin e suksesit. Kur erdhi radha tek unë, ai iu drejtua gjyshit tim: Axha Hafëz, unë mburrem që jam mësues i Ismetes. Ismetja është nxënësja më e mirë në klasë dhe ka të gjitha pesa. Prandaj, ajo sot shpërblehet me një libër. Baba Hoxhë ktheu kokën nga unë dhe, me atë mjekrën e bardhë e të krehur që e kishte, më buzëqeshi. Buzëqeshjen e vazhdoi edhe nga nxënësit e tjerë, sikur i përgëzoi të gjithë për suksesin e arritur. Mësuesi vazhdoi me komunikim të suksesit edhe për nxënësit e tjerë. Në klasë kishte edhe prindër të tjerë që u gëzoheshin suksesit të fëmijëve të tyre.



*Ismetja në ditët pas pensionimit në arsim, në moshën 75-vjeçare*

Pas komunikimit të suksesit, baba Hoxhë e mori fjalën dhe citoi diçka arabisht, për ta dhënë edhe komentimin shqip. Ai foli për rolin e shkollimit shqip, sidomos edhe të vajzave, të cilat sapo kryenin klasën e katërt ndaleshin nga shkollimi i mëtejshëm.

Pas komunikimit, vazhdova rrugën për në shtëpi. Kur kaluam nga dyqani i fshatit, baba Hoxhë u ndal dhe më bleu disa sheqerka. Rrugës për në shtëpi m'u drejtua: "Shiko, bija ime, meqë po mëson kaq mirë në shkollë, po të premtoj se ti do ta vazhdosh shkollimin, jo vetëm deri në klasën e tetë, por do të shkosh edhe në shkollën normale".

Kështu edhe ndodhi. Isha vajza e parë në Roganë që vazhdova klasën e pestë deri në të tetën dhe pastaj edhe në normale, ashtu siç isha edhe mësuesja e parë roganase".

*Sa seriozisht u kuptua roli i arsimimit të kuadrove në familjen Kallaba?*

“ Për dije e për atdhe, nuk  
pyetet si dhe pse! ”

---

*Musah I. Kallaba*

Veprimtaria e një numri atdhetarësh, por edhe konkretisht nga iniciativa e Hafëz Kallabës, ka ndikuar dukshëm në ngritjen e vetëdijes së njerëzve për shkollimin e fëmijëve të tyre, sepse, vetëm shkollimi mund të jetë arma më e përshtatshme për sendërtimin e aspiratave të rilindësve tanë nga shekulli i 19-të. Dhe, këtë e kanë bërë gjithnjë e më shumë prindër nga Rogana e më gjerë. Ta zëmë, babai i Qemajlit – Musahu, si dhe shumë të tjerë në familjen Kallaba, nuk kishin kursyer asgjë për shkollimin e djalit të tij të dytë – Isës. Ai, madje, kishte shitur edhe tokë vetëm e vetëm që Isa të shkollohej. Kështu, Isa, pas mbarimit të studimeve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Dega e Kimisë, në Prishtinë, më 1968, regjistron dhe i mbaron studimet pasuniversitare në Fakultetin e

Teknologjisë në Zagreb, për të fituar gradën Magjistër, në qershor të vitit 1978. Ishte magjistri i parë në familjen Kallaba.



*Musah Islam Kallaba:*  
(5.9.1910 - 14.10.1975)



*Mr. sc. Isa Musah Kallaba*

Dijen e fituar në fushën e kimisë e kishte jetësuar fillimisht si profesor i kimisë në Ferizaj e Dardanë, për të vazhduar pastaj me postin e drejtorit teknik në Fabrikën e Pllakave të Qeramikës në Dardanë e, më pas, edhe të ekspertit dhe të projektuesit kryesor në Fabrikën e Porcelanit, po ashtu në Dardanë. Me gjithë specializimet e shumta e të njëpasnjëshme, në Maqedoni (Veles), në Kroaci (Zagreb, në Itali (Bolonjë, Sakmi, Imolla dhe Firenze), si dhe në Pëllzen e Karlovi Vari të Çekosllovakisë, Isa, më 1982, për shkak të një teknokratizmi të udhëheqjes lokale në Dardanë, e lëshon fabrikën për t'u punësuar në Institutin Higjienik Krahinor në Prishtinë, për nevojat e të cilit, gjatë viteve 1982-1986, dërgohet jashtë Kosovës për t'u perfeksionuar në lëmin e bromatologjisë.

Nga masat e dhunshme të Serbisë ndaj Kosovës, si shumë shqiptarë të tjerë, edhe Isa e pëson me largimin e dhunshëm nga vendi i punës, më 1990.

E mora si shembull bacën Musah, por njësoj kanë vepruar edhe prindër të tjerë të familjes Kallaba, si: Tefiku, Fehmiu, Faiku, Nazmiu, Hyseni, Tasini, Qemajli, Muharremi, Xhemaili, Selimi, Salihu, Ibrahimimi, Ilazi, Vebiu, Alushi, Nusreti, Izeti, Hasani e të tjerë, duke i shkolluar fëmijët e tyre, prej të cilëve më vonë



dolën ekonomistë, mjekë, teknologë, pedagogë, gjuhëtarë, juristë, inxhinierë, piktorë, arsimtarë etj.

*Të kthehemi edhe njëherë te ti. Domethënë, ti më shumë qëndroje në Roganë, derisa babai yt transferohej në fshatra të ndryshme të Dardanës e më larg?*

**Kema:** Kjo ndodhi deri në përfundim të klasës së gjashtë. Në vitin shkollor 1957/58 babanë e transferuan në fshatin Aligeraj të Preshevës. Ky ishte edhe një lloj dënimi për babanë tim, ngase aktiviteti i shumtë i tij sikur e pengonte regjimin e kohës. Kështu kishin vepruar edhe me kushëririn e tij, Qemajlin, i cili nuk kishte mundur të punësohej në Kosovë, dhe kishte gjetur një vend pune në Strezoc të Preshevës. Ai ishte në shënjestër të regjimit si aktivist i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH).

Për transportin tonë dhe të shumë pajisjeve shtëpiake ishte kujdesur Metë



*Aligeraj, 19 qershor 1958:  
Prindërit Tefiku e Naxhija me  
fëmijët: Xhevdeti, Elhamiu  
dhe Selamiu njëmuajsh*

Morina i Hodonocit. Ai kishte një qerre që tërhiqej nga dy kuaj, dhe më duket sikur e ngarkuam gjithë shtëpinë në atë qerre që i thoshim “strem”, lloj qerreje me katër rrota, zakonisht e mbyllur.

*Dhe te Aligerajt, të mori me vete?*

**Kema:** Po, në Aligeraj, i thoshin edhe Geraj. Aty kishim marrë me qira një shtëpi pranë xhamisë. Aga ishte i përgatitur mirë edhe fetarisht, jo pse ishte djalë hoxhe, por lexonte vazhdimisht edhe literaturë fetare. Ndërkohë familja jonë e ngushtë u shtua. Atë vit, më 18.5.1958, erdhi në jetë edhe vëllai i vogël, Selamiu. Tashmë kisha edhe tre vëllezër të tjerë, përveç atyre dyve që kishin vdekur.



*Ekrem Kallaba në kl. VII në Preshevë, viti shkollor 1957/58  
(i treti nga e majta në rreshtin e dytë)*

*Përse aga lexonte literaturë fetare, kur ai ishte mësues dhe jetonte në një shtet laik?*

**Kema:** Jo të gjithë hoxhallarët predikonin fenë sipas parimeve të Muhamedit dhe sipas logjikës së shëndoshë. Kishte imamë ose hoxhallarë që për interesa personale ose grupe të devijonin nga interpretimi i drejtë i Kuranit. Pastaj kishte edhe situata kur nga shërbime antishqiptare depërtonin hoxhallarë me prejardhje nga Rusia ose atje të përgatitur që, përmes predikimit fetar, ta degradonin çështjen kombëtare shqiptare, sidomos nëpër qytete, si Prishtina, Prizreni, Shkupi, Tetova, Ulqini etj. Kështu, shumë shqiptarë të besimit islam i merrnin gjërat një për një, e disa edhe bënë “argatin e djallit” dhe ligjëratat e dëgjua në ndonjë xhami të Prishtinës t’i shpjegonin në ndonjë fshat, kinse ato i kanë dëgjuar nga një imam me famë.

Populli, për keqardhje, ishte kryesisht i pashkolluar. Shumë lehtë binin në grackat e njerëzve “të shitur”. Një predikues feje mbase merrte një shembull nga ndonjë doracak i edukatës islame, por për interesa personale e lëshonte si thënie të Muhamedit. Prandaj, mësuesi kishte edhe një obligim shtesë, jo të pengonte predikimin e fesë islame, por të parandalonte predikimin e rrejshëm.

*Ke ndonjë shembull ilustrimi?*

**Kema:** Shembuj ka sa të duash, por, po i marr vetëm disa, që nuk kanë lidhje me mendjen e shëndoshë. Ta zëmë, a nuk është e pakuptimtë të dëgjosh se, nëse shqiptari shkon në shkollë prishet – bëhet kaur; nëse nuk mban kapelë në xhami, të prishet namazi; nuk bën kurrsesi të shkollohet vajza shqiptare; nuk duhet luajtur me top, kinse luan me kokën e Muhamedit; nuk duhet të bësh jetë luksoze në këtë botë, me rëndësi është bota tjetër (ahireti); nuk duhet të shënosh varrin e prindit me pllakë përkujtimore, se ia rëndon shpirtin në botën tjetër; nuk duhet t’i japësh të drejta të barabarta femrës, ngaqë ajo duhet të jetë e robëruara e burrit, e të tjerë shembuj banalë.

*Dhe, mbetëm në fshatin Aligeraj...?*

**Kema:** Popullata e fshatit Aligeraj ishte shumë fetare. Pothuaj çdo mbrëmje e thërrisnin agën në ndeja. Bisedat e agës Tefik ishin interesante; ai merrte shembuj shumë praktikë dhe që lidheshin me përditshmërinë. Tehun e bisedës gjithmonë e drejtonte nga shkollimi i fëmijëve - vajza e djem. U shpjegonte se sa i rëndësishëm është shkrim-leximi shqip. - Kur ju keni një fëmijë që di të lexojë shqip, nuk ka nevojë dikush ta dërgojë letrën e djalit ushtar për ta lexuar në Preshevë, u thoshte.



*Mësuesi Tefik me kryetarin e shkollës, Asan Gjemailin dhe bashkëfshatarin Osman Ismajlin (19.02.1958)*

Aty kishte një shkollë vetëm deri në klasën e katërt. Unë udhëtoja për çdo ditë nga Aligeraj deri në Preshevë dhe anasjelltas, që duhet të jetë së paku 8 km. Nuk isha i vetëm. Kishte edhe të tjerë nga ky fshat. Vetëm një vit shkollor mësova në Preshevë, pra, në klasën e shtatë.

*E, pastaj?*

**Kema:** Në vitin pasues (1958/59) shkuam në Pogradjë, Komuna e Gjilanit. Një fshat me traditë më të madhe shkollore. Por, as këtu nuk mësova në shkollën ku punonte babai im.



*Tefik Kallaba, marrëveshja për punë - mësues në Pogradjë, 1958*



*Tefik Kallaba me zagarin – Balën, në malet e Pogradjës*

Meqë në Ferizaj punonte axha im, Faiku, klasën e tetë u regjistrova në Ferizaj. Banoja tek axha Faik. Ky ndërrim i shpeshtë i shoqërisë dhe i shkollave më kishte pjekur më shpejt në pavarësimin tim. Por, edhe ma kishte zgjeruar rrethin e shokëve. Axha Faik punonte në stacionin hekurudhor të Ferizajt. Më donte dhe kujdesej për mua sikur të isha djalë i ij.





*Fehik Kallaba (djathtas) me nxënësit e kl. III në shk. fill. "Liria" në Pogradje, 1959*

*Pse kishte shkuar axha Faik në Ferizaj? Pse nuk qëndronte në fshat, në Roganë?*

**Kema:** Çështje e vërteta, jo vetëm axha Faik, por edhe axha im më i vogli, Tasini kishin shkuar fillimisht në Beograd, për të punuar punë krahu.

Që të jem më i qartë, më duhet të rrëfej historinë e tyre të largimit nga Rogana.

Pas kthimit nga ushtria, Faiku angazhohet në Lidhjen e Rinisë së fshatit e të rrethit. Kishte qenë i sinqertë dhe shumë punëtor. Si kuadër i ri, pushtetarët komunalë e marrin me vete gjatë një aksioni për grumbullimin e tepricave. Ishte modest dhe punën e kishte marrë me shumë seriozitet, por edhe ishte i respektueshëm nga bashkëfshatarët, natyrisht respektin e kishte paksa edhe për hatër të babait, Hafëz Kallabës, që ishte imam në xhaminë e fshatit. Gjatë një aksioni për grumbullimin e grurit në mëhallën e epërme, një bashkëfshatar e dorëzon grurin, ndërkaq një SKOJ-ist serb (anëtar i Lidhjes së Rinisë Komuniste të Jugosllavisë), që i thoshin Zallk, kërkonte edhe më shumë grurë. Fshatari po arsyetohej se nuk kishte më tepër, ndërkaq Zallku e urdhëroi Faikun të shkonte dhe të shikonte në hambar. Faiku, te hambari e pa pronarin teksa po e fshinte me një krah pule vendin ku ishte deponuar gruri. Pra, fshatari, nga frika, e kishte zbratur tërë hambarin. Kur e kishte parë këtë Faiku, ishte tmerruar dhe e kishte pyetur fshatarin: "Ku e ke grurin?", e ai ishte përgjigjur: - "Pasha Zotin, e mblodhëm kokërr për kokërr dhe e dorëzuam, nuk kemi tjetër". I prekur

në shpirt, Faiku shkon te qerrja, që tashmë ishte mbushur nga “tepricat” e fshatarëve, merr një thes në krah dhe ia zbraz në hambar. Fshatari, sa habitet, aq edhe fillon të dridhet, sepse kishte përvojë të hidhur nga hera e fundit e dorëzimit të tepricave. Faiku i pasherr i thotë bashkëfshatarit “Ne po kërkonim vetëm tepricën e grurit, por jo edhe gjithë bereqetin e verës”. Kur kthehet te qerrja, Zallku e qorton Faikun për veprimin e bërë, ndërkaq Faiku i doli në ndihmë bashkëfshatarit dhe i drejtohet atij: “Sa të jem unë këtu, fshatarët do të japin vetëm tepricën, madje vetëm me dëshirën e tyre.” Aty fillon një zënkë mes Faikut dhe Zallkut, saqë e ndërpresin aksionin dhe shkojnë në Dardanë. Të nesërmen Faiku demonstrativisht refuzon angazhimin e tij në SKOJ (LRKJ). Më pas kishte qenë i kërcënuar dhe ishte detyruar ta lëshonte Dardanën, si vend i pashpresë për perspektivë pune. Një kohë shkon në Beograd, ku punon punë krahu, pastaj punësohet në Hekurudhën Jugosllave dhe më pas transferohet, si punëtor i hekurudhës, në Ferizaj, ku edhe vazhdon të punojë e të jetojë deri në pension.



*Faiku me nënën - Sanijen, bashkëshorten - Hatixhen dhe fëmijët (1958), nga e majta: Alija, Shyhretja, Fadili dhe Faruku*



Edhe axha, më i vogli fëmijë i Shefkiut, Tasini, kishte kërkuar perspektivë jashtë Roganës; fillimisht në Beograd, ku, krahas punës fizike, ishte regjistruar në një kurs daktilografie. Pas një kohe e kishte mbaruar kursin e daktilografisë. Më pas edhe ai kthehet në Ferizaj dhe punësohet si daktilografist në gjykatën komunale në Ferizaj. Pastaj, pa shkëputje nga puna, shkollohet dhe përfundon fakultetin juridik në Prishtinë dhe punon referent juridik në Kosovatrans të Ferizajt. Diku nga viti 1983 punësohet në ndërmarrjen “Magnohrom” në Dardanë, po ashtu referent juridik dhe punon deri në vdekjen e hershme, në moshën 52-vjeçare, më 13.12.1986.

## **Tasin Kallaba - ishte njeri tejet human**

*Rrëfimi i bashkëshortes së Tasin Kallabës (Salihut) – Feimes*

*Feimja ishte lindur më 1 prill 1938 në Hogosht. Në verën e vitit 1959 u martua për Tasin Shefki Kallabën (Salihun) nga Rogaçica. Pas martesës vetëm nëntë muaj kishte qëndruar në Rogaçicë, sepse Tasini më 1960 ishte punësuar në Ferizaj dhe e kishte marrë me vete. Rreth tre vjet e gjysmë kishin banuar, bashkë me vëllain Faikun, në Doganaj të Ferizajt.*

*Tasini, pasi që kishte kryer një kurs të daktilografisë në Beograd, me të kthyer në Kosovë, punësohet në Gjykatën komunale të Ferizajt.*

*“Më 1962 jemi ndarë prej Faikut dhe Hatixhes dhe kemi banuar te inxhja Zymkë, përkatësisht te Ilmi Bakolli i Pleshinës. Ata ishin pas shitur për të shkuar në Turqi, por kishin mbetur në Ferizaj. Tiba (gruaja e Ilmiut) Zymkën e ka pasur grua të dajës. Te Zymka kemi banuar vetëm tre muaj, pastaj kemi banuar te Ilmi Bakolli katër vjet”, kujton atë periudhë Feimja 76-vjeçare.*

*Më 1965 kanë ndërtuar shtëpinë në Ferizaj, në rrugën e Pleshinës. Aty u kanë lindur tre fëmijë: Selvetja, Bahriu dhe Basriu (vajza e parë Jalldezja kishte vdekur sa ishte foshnjë, në Doganaj).*

*Tasini ishte adhures i dijes e i leximit. Pas moshës 45-vjeçare, pa ndërprerje nga puna, kishte kryer Fakultetin juridik në Prishtinë.*



Tasin Kallaba  
(20.6.1934 - 13.12.1986)

*“Kur jemi martuar me Tasinin, ai ka qenë duke punuar në Beograd. Vinte për disa ditë dhe sërish kthehej në Beograd. Pas disa javësh ai u kthye nga Beogradi dhe me ndihmën e Faikut u punësua në Ferizaj, në Gjykatë. Ai shkonte me punë shpesh në terren, në fshatrat e Ferizajit. Ishte tejet korrekt me fshatarët, nuk dëshironte t’i dënonte vetëm pse ashtu donte dikush nga Gjykata. Ai thoshte: - si ta dënoj unë një fshatar i cili para vete ka vetëm një gomar. Ndonëse pinte alkool, në familje ishte përherë i qetë. Ndodhte të zhytej pas konsumimit të rakisë, por të nesërmen në punë ka shkuar në orar të rregullt e i pastër. Sikur unë ashtu edhe fëmijët e kemi dashtë dhe respektuar shumë, sa asnjëherë nuk e kemi pritur ulur”, rrëfen Feimja në pleqërinë e saj për Tasinin dhe fëmijët e saj të shkolluar e të mrekullueshëm.*

*Fatkeqësisht Tasini vdiq shumë i ri, në moshën 52-vjeçare, duke lënë pas vete një vajzë e dy djem.*

*Hedingen - Zvicër, 9 mars 2014*

*E, me dy axhallarët e tjerë, Nazmiun e Hysenin, çfarë ndodhi, a arritën edhe ata të shkolloheshin?*

**Kema:** Hëm, si ta shpjegoj këtë situatë. Baba hoxhë kishte një kallaballëk fëmijë, dhe me pagën e tij, sado që nuk ishte e ulët, nuk arrinte t’i përmbushte të gjitha kërkesat e fëmijëve. Pastaj kishte edhe shpenzime të mëdha për udhëtime të shumta, si dhe për vizitat e ndërsjella në rrethin e tij të gjerë shoqëror. Në raport me shokët, ishte goxha dorëlibër, kështu që ky veprim ndikonte dukshëm në shpenzimin e buxhetit familjar. Megjithatë, nga një shkollim elementar ua mundësoi të gjithëve, ndërkaq disa prej tyre vazhduan shkollimin gjatë punës. Një e vërtetë tjetër ishte se ai kishte edhe shumë tokë, që duhej punuar, e kjo barrë, një kohë, i kishte mbetur kryesisht Nazmiut, që ishte një djalë punëheshur, ndonëse, siç thoshte aga Tefik, ai ishte ndër nxënësit më të zellshëm në familjen

tonë. Aga Nazmi kishte ndjekur gjimnazin e ulët në Hogosht dhe ishte nxënësi më i mirë atje, por nuk pati mundësi të vazhdonte shkollimin e mëtutjeshëm në Gjilan ose në Prishtinë. Kështu edhe Nazmiu, por edhe Hyseni, më vonë u inkadruan në tregti dhe me të ardhurat e tyre arrinin t'i shkollonin fëmijët e vet. Nazmiu, deri në pension, punoi në një dyqan me mallra të përziera, në Roganë, dhe njihej si shitësi më i ndershëm në gjithë komunën.

Ndërkaq, Hyseni kishte kaluar në tregti me kërpudha dhe shitje të pajisjeve bujqësore. Te Hyseni, më duhet të bëj një parantezë, e që lidhet me një humor paksa satiriko-ironik. Gjatë një bisede, dhëndri ynë, Abdylaziz Veseli, që ishte, një kohë të gjatë, drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjilan, i kishte propozuar që të përgatitej dhe t'u nënshtrohej provimeve për shkollën e lartë, në mënyrë që të punonte diku në arsim. Hyseni ishte kujtuar një kohë të gjatë, por kishte refuzuar, duke thënë se tashmë i kishte kaluar moshja dhe se nuk do të mund të ishte i dobishëm për nxënësit. Pas një kohe, kur mësuesit nuk paguheshin nga shteti jugosllav, përveç ndihmave që i merrnin nga Këshilli për Financim i Kosovës, në vlerë prej rreth 40 markash në muaj, te Hyseni kishin ardhur mysafirë dhëndurët Avdylazizi e Rabiti. Për t'i respektuar mysafirët kishin ardhur plot kushërinj. Temë e mbrëmjes, veç të tjerash, ishte edhe gjendja financiare e arsimit paralel shqip në Kosovë. Në pikun e muhabetit, Hyseni e mori fjalën dhe iu drejtua Avdylazizit. E, more dhëndër, gati të të dëgjoja ty e të merrja shkollën e lartë privatisht, dhe t'i lija sakat edhe nxënësit, por edhe veten. Kështu, me këtë dijen dhe punën time, tash po fitoj sa njëzet mësues, madje po e jap edhe kontributin e kërkuar për financimin e arsimit shqip në komunë. Në odë plasi një e qeshur nga të gjithë të pranishmit; qeshi edhe Avdylazizi, duke i thënë se kësaj radhe mirë e ke, por kjo situatë është kalimtare, sepse Kosova do ta arrijë synimin e vet drejt pavarësisë, kur mësuesit do të paguhen arsyeshëm dhe do të bëjnë një jetë të dinjitetshme.

*Po, shkollimin e mesëm, ku e vazhdove?*

**Kema:** Arsimitarët në Ferizaj ishin të kualifikuar dhe shumë entuziastë. Atje arrita të përgatitesha mirë për vazhdimin e shkollimit. Falë kësaj përgatitjeje, pa vështirësi u regjistrova në klasën e parë të Shkollës Normale, në Prishtinë. Atje përfundova vitin e parë dhe të dytë. Babai më dërgoi për të banuar në një

shtëpi, në periferi të Prishtinës, në rrugë për në Podujevë. Ishte dikush nga Koretini, që kishte bërë atje shtëpi, dhe unë nuk detyroheshja të paguaja fare qira. Por ç'është do! Merre me mend se sa larg ishte Normalja; së paku nja 6 km, një drejtim!. Isha me fat që kisha shokë, të cilët banonin në qytet, kështu që shpesh flija tek ata. Dy vjet u torturova. Më dukej se po më plagosej dinjiteti, paçka që shokët kërkonin të banoja me ta, sepse u ndihmoja edhe në përvetësimin e mësimëve. Nga ana tjetër, e kuptoja edhe babanë, i cili me një rrogë të mësuesit duhej ta mbante gjithë familjen.

Atë vit, pra, në vitin shkollor 1960/1961, babai ishte transferuar për punë në Koretin të Komunës së Dardanës. Kishte marrë një banesë me qira te Hyseni i familjes Basha, e cila po ashtu duhej paksa të merremtohej për banim. Ishte banim i përkohshëm, derisa të bënim një zgjidhje të përhershme, pra, donim të ndërtonim një shtëpi. Po atë vit kishte blerë edhe një truall prej rreth 12 arësh.

Për ndërtimin e shtëpisë duhej bërë kërkesë në komunë. Komuna të jepte një formular për plotësim, i cili ishte i shtypur vetëm në gjuhën serbe, madje në cirilikë. Në atë formular jepeshin të dhëna personale si dhe afati kohor kur do të nisej dhe sa do të zgjaste ndërtimi i shtëpisë, pastaj të dhëna për tokën ku do të ndërtohej shtëpia, të dhëna mbi shtëpinë, hapësira, lartësia, thellësia etj., të dhëna për shtëpinë: kushtet higjienike-teknike, largësia nga rruga, largësia nga lumi, pastaj largësia nga bunari, nga plehu etj. për marrjen e lejes për ndërtimin e shtëpisë në fshat.

*Dhe, babai e mori këtë formular?*

**Kema:** Po, patjetër. Nuk e di nëse ky formular u kërkohej edhe të tjerëve për ndërtimin e shtëpive në fshat, por babait ia kërkuan dhe, aga e kishte plotësuar. Shtëpia duhej të ndërtohej nga data 15 prill 1961 deri më 15 nëntor 1962. Pastaj ishte përcaktuar edhe madhësia e shtëpisë (13 x 5 m) që i bie 65 metra katrorë<sup>20</sup>.


Kisha përshtypjen që këtë afat po ia caktonin, të bindur se me paratë që i fitonte babai në arsim nuk kishte mundësi të ndërtonte një shtëpi të tillë.

---

<sup>20</sup> Faksimile e formularit të paraqitjes për ndërtimin e shtëpisë.

Pse e pa të arsyeshme ta çekësh këtë element. Po më duket paksa i panevojshëm?

**Kema:** Jo, jo! E para, në Komunën e Dardanës shumica a banorëve ishin të kombësisë shqiptare, në Koretin po se po, kurse administrata udhëhiqej vetëm serbisht, ndërsa nga pushtetarët vazhdimisht trumbetohej për barazi dhe vëllazërim-bashkim. Bile edhe shkolla ku punonte babai quhej shkolla fillore “Vëllazërim-Bashkim”. E dyta, kisha përshtypjen se kjo i bëhej babait tim me qëllim që ai të mos bënte shtëpi, ngase, me gjasë, ishin mësuar që çdo dy-tre vjet ta transferonin nga fshati në fshat. Kështu, sipas tyre, parandalonin rezistencën e mundshme të babait, i cili, më vonë, me vështirësi do të pranonte të largohej nga Koretini. Dhe, siç thashë më sipër, ndërtimi i shtëpisë ishte një “kafshatë” goxha e madhe për një mësues.



Paraqitja për ndërtimin e shtëpisë në Koretin 1961

*Po, çfarë lidhje ka kjo, nëse ai do të qëndronte përjetësisht në Koretin?*

**Kema:** Më vonë e kam kuptuar se pushteti i Dardanës pandehte që sa më i dobët të jetë Koretini, aq më e fortë do të jetë Dardana, që, në atë periudhë, ishte kryesisht e banuar me serbë. Dhe, natyrisht, regjimi donte një Dardanë të fortë serbe, ndërkaq punonte vazhdueshëm që Koretini të ketë një arsim të brishtë dhe se mësimi për nxënësit shqiptarë të jetë sa më pak cilësor. Pastaj, në Koretin kishin filluar të vinin edhe familje shqiptare nga Malësia dhe Hashania e Dardanës. Ata blinin kryesisht shtëpi serbësh, shumë syresh ardhacakë të viteve 1920, të cilët shpërnguleshin në rrethinën e Nishit dhe të Beogradit, ndërkaq kjo dukuri, për regjimin, trajtohej si presion ndaj serbëve.

*Më ngadalë, të lutem! Shqiptarët, a i paguanin ato shtëpi, apo ua merrnin serbëve me dhunë?*

**Kema:** Jo, përkundrazi. Serbët, me shtëpitë dhe me pasuritë e veta që ua shisnin shqiptarëve në Kosovë, kur shkonin në Serbi, me po aq para blinin trefish më shumë. Madje, kishte prej tyre që, kur e shisnin shtëpinë, i thoshin blerësit: “Za pare ti ga prodajem, bez pare ponovo imam da ti ga uzimam”, që i bie: - “Me para po ta shes dhe pa para kam për ta marrë sërish”. Kjo i kishte ndodhur pikërisht dajës Rasim, dhe jo vetëm atij, i cili ua kishte blerë pasurinë tre serbëve në Koretin, më 1963/1964.

*Të kthehemi edhe një herë te ndërtimi i shtëpisë. A filloi ndërtimi i shtëpisë në afatin e paraparë?*

**Kema:** Po, si jo! Koretinasi e respektonin shumë babanë. E njihnin që nga hera e parë (1954-1956), kur kishte punuar në Koretin. E ndihmonin shumë, sidomos në bartjen e materialit ndërtimor: gurë, zall, dërrasa, dru etj. Për ndërtimin e shtëpisë aga kishte tërhequr edhe një kredi në bankë.

Tani, nuk mund të rrëfej më tutje pa e përmendur një fakt. - Një fundjavë shkova në shtëpi, në Koretin. Akoma banonim te Hysen Basha. Pyeta nënën se ku ishte



*Ekrem Kallaba në kl IV të shk.  
normale në Gjilan, më 1962/63*

babai, pasi koha e mësimit kishte përfunduar. Më tha se kishte shkuar te shkolla (atje ishte trualli i ri), ku pritej dikush t'i sillte trarët dhe krerët për kulmin e shtëpisë. U bëra kureshtar. Pas pak arrita te shkolla dhe, çfarë të shihja; nja shtatë a tetë qerre plot me dru të gjata ishin radhitur te trualli dhe sapo kishin filluar t'i zbraznin nga qerret. Të gjithë na ndihmonin, vullnetarisht. Drutë i kishin sjellë nga malet e Kikës. Sa më vinte keq për mundin që e kishin marrë ata njerëz, po aq më vinte mirë për gjithë atë respekt që e tregonin ndaj babait.

Vërtet isha i vetëdijshëm për gjendjen e dobët financiare të babait, kështu që



vitin e tretë u transferova nga Prishtina, dhe shkollimin e vazhdova në Gjilan. Banonim te një hallë më e largët e babait, po që e donim dhe e respektonim shumë, halla Nurë i thoshim. Ishte vajza e Bajramit të Mehmetit dhe motra e Sejdës (një kushëri yni më i largët). Bajrami ishte vrarë në luftrat e Jemenit më 1909. Aty banonim bashkë me kushërinjtë Isën, Vebiu, Skënderin, etj. Çdo fundjavë shkonim në shtëpi, në këmbë, natyrisht. Rruga ishte rreth 20 km, madje duke shfrytëzuar rrugët dytësore drejt kodrës së Përlepticës, nëpër Topanicë – Bllatë e në Roganë. Të dielën ngarkoheshim me bukë e gjëra të tjera ushqimore. Ndonjëherë na gatuante edhe halla Nurë në Gjilan, por ne ishim kallaballëk dhe nuk i përballonte dot nevojat tona. Lëndët mësimore i kishim serbisht. Në fillim shumëçka mësoja përmendsh dhe ashtu edhe e shpjegoja mësimin para profesorëve serbë.

*Çfarë ishin kushtet e banimit, dhe të mësimin?*

**Kema:** Të vështira, shumë të vështira. Flinim nga dy veta në një shtrat; dhomat ndarëse me banuesit e tjerë ishin pa derë, vetëm me një plaf. Ishim të gjithë normalistë dhe mandolina ishte instrument i obliguar. Nuk kishte natë që dikush nuk kishte ushtrime në mandolinë. Nuk kishim të gjithë mandolina, kështu që në dy mandolina ushtronim katër-pesë veta, derisa një ditë erdhi kërkesa nga profesori i muzikës, Selman Vokshi, që secili normalist detyrohej ta kishte mandolinën e vet.

*Po halli, si arrije të përgatiteshe për mësim?*

**Kema:** Te nxënësit e kësaj periudhe ekzistonte një entuziazëm i madh për mësim. Përveç vullnetit, ishim shumë ambiciozë për të mësuar. Kur kisha për t'u përgjigjur për notë, shpesh dilja dhe mësoja nën llambadarin e rrugës, që ishte aty afër. Kishte natë kur edhe bënte ftohtë, porse habitesha duke lexuar...



*Tefik Kallaba, mësues në Koretin 1960/61*

*Dhe, pas normales?*

**Kema:** Kur jemi te normalja, më duhet të rrëfej një situatë të rëndë të krijuar në familje.

Më 19 maj 1962 ma larguan babanë nga procesi arsimor dhe nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, me arsyetim se rrjedh nga një familje fetare, që ka ndikim të madh në rrethin e vet; pastaj se në familjen e tij ka shumë të dënuar për veprimtari kundër popullit dhe shtetit jugosllav. Po ashtu, në arsyetimin e përjashtimit kishin cekur se gjatë okupimit të Jugosllavisë kishte qenë në shërbim të ushtrisë shqiptare, përkatësisht të okupatorit<sup>21</sup>, pra, ushtar i Xhafer Devës. Te babai im, besimtarët kishin gjetur mbështetje, sidomos, ata me predispozita reaksionare. Nuk kishin lënë gurë pa lëvizur, vetëm e vetëm që ta largonin nga arsimi, të cilin aq shumë e donte. E donte, sepse i donte fëmijët, e donte rininë të arsimuar, e donte shpëtimin e shqiptarëve të Kosovës nga asimilimi gjuhësor.

Që ironia të jetë edhe më e madhe, babai im akuzohej se me rastin e ndërtimit të shtëpisë e paskësh thurur oborrin kinse të mos i dukej familja. E kishin akuzuar se shoqërohej me Metush Krasniqin, “armikun e shtetit”; se është në afërsi familjare me Qemajl Kallabën, anëtarin e NDSH-së, pastaj me Ali Kallabën, organizatorin e vrasjes së Shefki Gadimes (Shefki Oznës), bashkëpunëtorit të

mishëruar të Shërbimit të Brendshëm Shtetëror Jugosllav (UDB), se vinte nga një familje e besimit mysliman reaksionar<sup>22</sup> etj.

*Kur kam lindur unë, aga, që kishte qenë më parë ushtar i Xhafer Devës në Shqipëri, ishte kthyer në Kosovë dhe, nën ndikimin e partizanëve, ishte inkadruar në aradhet partizane të ish-Jugosllavisë.*

*Më vonë, kur i pata mbushur nja 20 vjet, e pata pyetur agën për atë periudhë të qëndrimit në Shqipëri. Rrëfente me krenari për angazhimin e tij si ushtar dhe intendent, sepse duhej mbajtur evidencë për hyrje-dalje të të gjitha mallrave në batalionin “Skenderbeg” në Tiranë, në periudhën 15 dhjetor 1942 gjer më 15 prill 1943. Ma agën ishte edhe kushëriri i tij, Xhemaili. Aktiviteti në aradhet partizane në Kosovë e Maqedoni sikur fshihte gjurmët e ushtarit të Xhafer Devës. Mirëpo, këtë sekret nuk e fshihte dot nga armata jugosllave, ngase ata i kishin të gjitha shënimet, bile më vonë ia kishin regjistruar në librezën e ushtrisë, shërbimin si ushtar në ushtrinë shqiptare.*

### **Rrëfimi i Xhemail Kallabës për qëndrimin në njësitin “Skenderbeg” në Shqipëri**

*U martova më 1942. Një vit më vonë më lindi vajza, Hysnija. Atë vit me Tefikun shkuam në Shkodër. Ne ishim më të rinjtë aty. Në Shkodër kërkohesh një depoist për mbajtjen e evidencës së ushqimit, teshave, municionit etj. Na bënë rresht dhe pyetën: Kush di të shkruajë. U paraqit Tefiku. - Hajde ti me ne, - i thanë. - Unë jam vetë i dyti, - ua ktheu ky. Tefiku nuk donte të ndahej nga unë, kurse ata thanë: - po a di ky të shkruajë? U thashë - jo, sepse atëherë nuk dija shkrim-lexim. - E po, ç'të bëjmë, - eja vetëm ti. Tefiku sërish u tha - jo. Nëse e marr edhe këtë, vij kur të doni, por pa këtë, nuk vij. Shkuan. Pas nja dhjetë ditësh, ishin sjellë andej-këndej dhe nuk kishin gjetur dikë që dinte shkrim-lexim, erdhën*

<sup>21</sup> Shih shënimet në librezën e ushtrisë.

<sup>22</sup> Shih vendimin për refuzimin e kundërshtimit të Tefik Kallabës ndaj vendimit të Këshillit për Arsim e Kulturë.

sërish, por Tefiku i refuzoi prapë. Madje, ky u shpreh me këmbëngulje: - hiç, - tha. - Nuk është e mundur të ndahem prej vëllait (ai u thoshte që mua më kishte vëlla). - Ne jemi dy vëllezër dhe kudo që shkojmë - shkojmë bashkë. U sollën e u sollën dhe erdhën për së treti herë, pas dy ditësh, e na thanë: hajde, le të vijë edhe ky. Hyni në magazinë e rrini aty! Ti e ke përgjegjësinë e ky le të rrijë aty, bëni çfarë të doni.



Xhemal J. Kallaba 1923-1999

Në Shkodër na ra edhe të luftojmë. Kur shkuam atje, ishte paraqitur një bandë komunistësh. Në fakt, ata u thoshin hajdutë. Ata ishin në Shkodër të Vjetër, kurse ne ishim në Shkodër të Re. Kishin vjedhur me pajtonë tesha të ndryshme për t'ua shitur komunistëve. Ata hynë në një kishë, kurse ne, të Regjimentit të Kosovës, e krisëm luftën kundër tyre. Ata ishin tetë veta, u ngujuan në kishë dhe luftonin kundër nesh. Unë dhe Tefiku i furnizonim me fishekë nga depoja. Luftuam gjithë

natën. Ushtria jonë e rrethoi kishën. Me ne ishte edhe një Bajram Hallaqi i rrethit të Dardanës. Madje, në një moment ai shau, kurse ata nga brenda na e kthyen: or kosovar, si e shan ti nënën tënde, o i poshtri i botës! Ishim fare afër njëri-tjetrit dhe dëgjohej mirë. Ata kishin qenë me përvojë. E vinin kapelën në tytë të pushkës dhe e afronin pranë dritares. Nga njësi ynë kishte edhe ndonjë ushtar naiv. Sapo shtinin në kapelë, ajo binte në tokë, ndërkaq dikush vraponte duke thënë - ja, e vrava. Sapo nisej në drejtim të kishës, ata e vrisnin. Ose ndodhte që ta nxirrte krahun në dritare. Dikush prej këndej gjuante, kurse ai e lëshonte krahun poshtë, kinse u vra. Dikush nga vija e rrethimit thoshte: ja e vrava dhe shkonte përpara, kurse ata e vrisnin nga brenda. Në atë luftim, deri nga mesnata, nuk arritëm t'i nxirrnim jashtë nga ai vend. Ata ishin komunistë. Kishte qenë një Nuhë Nuhi, që ishte vetëm me një dorë. Me dhëmbë e tërhiqte shulin e pushkës për ta mbushur me fishekë. Pas një lufte të gjatë, erdhi një njësit gjerman dhe donin t'i sulmonin me gjyle topi. Madje e spërkatën objektin me gaz. Një ushtar gjerman doli për t'i larguar njerëzit

*prapa kishës, por ky prej këndeje u ngut dhe shtiu me top. Në atë moment ai e vrau ushtarin e vet gjerman, i cili nuk kishte arritur të kthehej prapa. Pastaj u dogj ai objekt dhe ashtu luftuam tërë natën. Në fakt, neve na vinte shumë keq, sepse vriteshim ne shqiptarët, vëllezërit, ndërmjet vete, por ne ishim nën urdhrat e tjetërkujt.*

*Me mua e Tefikun ka qenë edhe Bislim Bajgora. Çështë e vërteta, të gjithë këta nga Mitrovica kishin qenë xhandarë të Nediqit; ishin të pajisur mirë me armë, kishin mauzerë e çka jo; nuk dinin shkrim-lexim, por të gjithë kishin qenë oficerë. Neve na thoshte Bislim Bajgora: hajt bacës, hajt, mos u frikësoni! Kur kriste topi gjerman, dridhej e gjithë shtëpia. Ne e kishim një toger të aftë, Kema Muja e quanim. Bislimi thoshte: Kemën po e lë për laps, kurse për pushkë jam unë këtu, prandaj mos u frikësoni, sepse s'ka çka na pret ne. Shtëpia pothuajse ishte djegur tashmë. Prej atyre tetë vetave, dikush ishte vvarë e dikush ishte plagosur. Ai Nuha, që ishte edhe udhëheqës i tyre, kishte qenë ende gjallë dhe donte të dilte ashtu barkas, i plagosur e i dërrmuar. Kjo luftë u zhvillua afër depos sonë. Dikur hynë për ta nxjerrë, ia ngjitën për këmbësh, kurse alltia i kishte mbetur në brez. Ashtu, duke e tërhequr barkas, një Shahin Gërdoci e nxori revolen dhe e vrau. Ai edhe ashtu pothuajse ishte i vdekur. Bashkë me Shahinin ishin edhe vëllezërit e tij, Hysen e Shaip Gërdoci. Ata kishin qenë 6 vëllezër, katër prej tyre ishin atje, në Shkodër. E vranë, pra, edhe Nuhën dhe u bënë aty tetë të vvarë. Me atë rast ne kemi pasur nga 12 napoleona shpërblim prej shtetit shqiptar, sepse ata u thoshin atyre hajdutë. Pra, të gjithë e kemi pasur nga një pagë. Pastaj, ne shkuam në depo, në Tiranë. Aty na treguan se pak pa mbërritur ne, kishte qenë aga Hafëz në një mbledhje në Tiranë, bashkë me një Limon Stanecin, për çështje të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Aga Hafëz, kështu e thërrisja unë, ishte babai i Tefikut. Më vonë na tregonin se si grupe shqiptarësh i kishin gjuajtur kosovarët me granata, derisa po mbanin mbledhje.*

*Më pas ne kujdeseshim bashkë për depon, por, dihet, Tefiku e udhëhiqte pjesën administrative. Çështë e vërteta, unë nuk kisha kurrfarë disipline. Vishesha mirë në depo dhe dilja në çarshi. Këta të ushtrisë më larguan, por Tefiku më jepte leje, kurse unë qëndroja kryesisht në Tiranë.*

*Më vonë na erdhi urdhri për të luftuar kundër komunistëve, në Vlorë. Një grup tashmë kishte vajtur. Në një luftim, që ndodhi atje afër Vlorës, u vranë nëntë ushtarë tanë. Ka qenë një Rasim Dajçi. Ai ka qenë në shtabin tonë, menjëherë pas Boletinit, që ishte adjutant, ndërsa vëllanë e kishte pasur kapiten te komunistët. Ai na informoi gabimisht, kështu që tanët u zunë.*

*Erdhi dita kur magazina duhej të transferohej në Vlorë. U ngarkuam mirë e mirë. Unë duhej të mbetesha aty, kurse Tefiku të shkonte në Vlorë. Në fakt, unë e pata mësuar paksa ecurinë e punës. Hipi Tefiku në kamion, hipa edhe unë. - Ku po shkon, bre, ti? - m'u drejtua togeri. - Ne kudo që shkojmë, shkojmë bashkë, - i thashë. - Jo, bre, tha, kjo s'është e mundur, kjo magazinë duhet të mbetet këtu, ky, tha, s'është në luftë. Tefiku m'u drejtua: - rri ti këtu, se unë nuk shkoj në luftë, mua më kanë treguar se edhe atje do ta udhëheq një magazinë, njësoj si këtu, u përpoq të më bindte Tefiku. Unë ngula këmbë dhe thashë: - jo dhe jo! Kudo që shkojmë, shkojmë bashkë. U kapa për kamioni dhe s'mundnin të më shkapnin. Çështje e vërteta, nuk ishte e mundur që ku të shkonte Tefiku të shkoja edhe unë, por unë insistoja që të mos ndaheshim. Megjithatë, Tefiku shkoi atje një muaj, brigadat tona luftuan, por nuk patën humbje, sepse na ndihmonin gjermanët. Kudo që ziheshin tanët në kurthe, gjermanët vinin me minahedhës dore e na çlironin.*

***Rrëfeu Xhemail Kallaba, Roganë, nëntor 1994***

*Po ti, si e përjetove këtë sulm ndaj babait?*

**Kema:** E po, çfarë të them. E vërteta ishte ashtu: Babai im ishte bir i një hoxhe shumë përparimtar, pastaj edhe ishte kushëri i Qemajlit dhe Aliut; ishte edhe shok i Metush Krasniqit, sikur që kishte qenë edhe ushtar i Xhafer Devës. Por, qëllimi nuk ishte ky. Qëllimi ishte që ta thyenin shpirtërisht babanë tim për punën vetëmohuese që e bënte me nxënës, ngase gjithandej nga shkonte, ai linte emër për të mirë, qoftë si mësues, edukator, qoftë edhe si njeri. Këtë e dëshmuam më vonë shumë karakteristika që ishin lëshuar nga banorë të vendeve ku ai kishte punuar, si në: Busavatë, Kopërnice, Hogosht, Geraj, Pogragjë, Koretin e gjetkë<sup>23</sup>.

<sup>23</sup> Karakteristikë e lëshuar nga Organizata e LKS-së të fshatit Geraj të Preshevës.



## E pastaj, ç'ndodhi?

**Kema:** Në fakt, atë kohë, kur një mësues largohej nga Organizata e Lidhjes Komuniste, pasojat ishin shumë të mëdha, sidomos për punësim. Pastaj, sapo e larguan nga puna, menjëherë edhe mua ma ndërprejnë bursën, që sapo e kisha fituar. Pra, ishte një përpjekje për thyerje shpirtërore të të gjithë familjes. Dhe një taktikë tjetër e regjimit ishte edhe tendenca për futjen e përçarjes mes shokëve, miqve dhe mësuesve, sepse, në të njëjtën kohë, kur mua ma ndërprejnë bursën, nuk ua ndërprejnë as Vebiu, djalit të Aliut, as Isës, vëllait të Qemajlit e as ndonjë tjetri, që regjimi e trajtonte si armik të shtetit. Mirëpo, më duhet të them se babai im ishte i mençur dhe i kishte kuptuar prej kohësh këto lojëra dhe nuk lejonte të binte në gracka të tilla.



*Pjesë të librezës ushtarake, lëshuar nga Ushtria Jugosllave: faqe 3: shënimet personale (shkruar në çirilicë); faqe 4 datëlindja, vendlindja, shkollimi etj.; faqe 5: periudha e kaluar në ushtrinë shqiptare (15.XII.1942 – 15.IV.1943) në gjininë ushtarake – këmbësori dhe grada – luftëtar. faqe 7: hyrja në ushtrinë jugosllave, në njësitë e shërbimit: Brigada III dhe I (Divizioni II), si dhe kursi i nënoficerëve për këmbësori I. VI-8. VIII 1945*





NARODNI ODBOR OPŠTINE  
KOSOVSKA KAMENICA  
KOMISIJA ZA SLUŽBENIČKE POSLOVE  
Broj: 01-2600/1  
Dana 13. oktobra 1962. godine

Na osnovu člana 1 stav 2 i 3 Zakona o izmenama i dopunama Zakona o javnim službenicima, Komisija za službeničke poslove rešavajući po prigovoru Kalaba Tefika izjavljenog protiv rešenja Saveta za prosvetu i kulturu NOO-e Kos.Kamenica, donosi

### R E Š E N J E

ODBIJA SE prigovor Kalaba Tefika izjavljen protiv rešenja Saveta za prosvetu i kulturu NOO-e Kos.Kamenica br. 01-2600/1 od 9 jula 1962. godine.

### O b r a z l o ž e n j e

Savet za prosvetu i kulturu ovog odbora donosio je rešenje kojim je Kalaba Tefiku otkazao službu honorarnog učitelja pri Osnovnoj školi u Koretinu.

Protiv ovog rešenja imenovani je izjavio prigovor u kojem navodi da je aktivno radio u društvenim i masovnim organizacijama učesnik i u rukovodstvu, bio prinudno mobilisan u neprijateljske redove i nije mu uspelo da pobegne, da je pomagao partizanski pokret, da ne može odgovarati za tuđi rad, da je samo jednom bio u lov, te pošto je otac petoro dece i bolesnu ženu neguje nije mogao biti aktivan i dr.

Po razmotrenju ožalbenog rešenja, navoda u žalbi kao i drugih spisa komisija je našla da je žalba neosnovana.

Komisija je cenila navode u žalbi, odnosno prigovoru, ali ti navodi su neosnovani, jer nije povredjen zakon na štetu žalioca.

Na izloženog valjalo je doneti rešenje kao u dispozitivu. Protiv ovog rešenja nije dopuštena žalba, rešenje je konačno čl. 1 stav 3 Zakona o izmenama i dopunama Zakona o javnim službenicima.

P R E D S E D N I K  
Komisije za službeničke poslove  
Peter Marković  
*Peter Marković*

*Vendimi ku refuzohet kundërshtimi i Tefik Kallabës ndaj vendimit të Këshillit për Arsim e Kulturë të Këshillit Popullor Komunal të Kamenicës së Kosovës, të datës 9 korrik 1962*

Na sahter TEFIK KALABA, iz Rogodice, Osnovna  
Organizacija S K selo Alidarec izdaje mu sledeće:

### K A R A K T E R I S T I K U

Drag Terik Kalaba, bivši učitelj u našem selu, priključio se  
našoj organizaciji kao član Saveza Komunističara septembra 1957 god.  
i radio do septembra 1958 godine. Na jednu godinu koliko je radio  
kod nas u našoj organizaciji bio je primeran član SK te kao takav  
vrlo disciplinovano izvršavao zadatke koje mu je organizacija posta-  
vila. Na sastancima bio je aktivan diskutant, te prilikom rasprav-  
ljanja svakog problema uvek je doprineo pravilnim sagledanjem i  
nastupanjem prevladanih odluka i zaključaka. Njegov doprinos u tom  
smislu bio je koristan jer je bio realan i objektivn, što ne može  
zaključiti njegovim namerno kritičnim istupanjem. Idejno - politički  
bio je usidren na savršenoj strani, često je održavao predavanja  
iz razne oblasti društvenog političkog života. Uvek je pomagao  
ostale društvene političke organizacije.

U svojim istupanjima na sastancima organizacije pravilno  
je objašnjavao namerno spolni i unutrašnji politički, i ovom pogledu  
bio je najaktivniji član naše organizacije.

Uživao je veliki autoritet u selu i kao takav vrlo je  
pozitivno uticao u ovoj sredini. Pošto naše selo spada u red  
onih selo gde je najvećerija uvišina, on je aktivno radio na  
suzbijanju sujeverija i verskih zabuda naročito kod mladine  
ovoga sela.

Članovi S K

1. Asan Ajdini
2. Terik Kalaba
3. Asan Ajdini

Na organizaciju S K selo  
Alidarec Sekretar SOKS  
Asan Ajdini

12-III-1963 god.

u Alidarec

Karakteristika

Karakteristikë për Tefikun, e lëshuar nga OLK në Aligeraj

*Si vajti puna më tej?*

**Kema:** Babai im doemos duhej të bënte një ankesë, fillimisht për kthimin në Lidhjen Komuniste e pastaj edhe për në vendin e punës. Kur dënoheshe nga partia, gjasat për punësim ishin minimale.

Sa u gëzuam që bëmë shtëpinë, pothuajse në oborrin e shkollës, në Koretin, dhe ja, e larguan të pafytyrët.

Largimi nga arsimi shumë ia lëndoi sedrën. Puna me nxënës ishte bërë vetë jeta e tij. Gjithçka tjetër ishte dytësore. Dhe, kurthet e ngritura në dëm të arsimit shqip e lëndonin shumë. Ishte lodhur nga gjithë ato ecejake nëpër shkolla dhe fshatra të ndryshme, për më keq që vuante edhe nga ulcera, sëmundje e stomakut. Tani ky largim ishte kulmi i mllefrit dhe, sigurisht, jo pa pasoja.

Ai, më 9 korrik 1962 kishte bërë një kundërshtim në vendimin për largim nga puna, por që më 13 tetor të po atij viti i kthehet vendimi ku refuzohet kundërshtimi i tij. Unë e vëreja brengosjen e tij dhe përpiqesha që të vija më shpesh në shtëpi, të paktën ta ngushëlloja, por edhe t'i jepja kurajë që të mos dorëzohej. Ai kishte besim të madh tek unë se, së shpejti, do t'i bëhesha krah i fortë, jo vetëm atij si fëmijë, por edhe popullatës si mësues.

Në pasditen e së hënës, datë 9 korrik 1962, erdha nga Gjilani në Koretin, me qëllim që të nesërmen ta ndihmoja babanë në kopsht. Nuk ma donte fort punën, por më herët aga më kishte porositur që, kur të vija herën e radhës, do t'i mbillnim disa fidanë. Trualli ku kishim ndërtuar shtëpinë ishte goxha një vend, diku rreth 12 ari kishte, kështu që mjaftonte për dhjetëra trupa pemësh.

Fundjavëve, zakonisht dilja për të kapur peshq, por kësaj jave isha i rezervuar për punë dhe s'kishte kuptim ta lija agën vetëm. Edhe ashtu lëngonte nga i thati në lukth, dhe kishte nevojë për ndihmë.

Sapo u zgjova nga gjumi, dola për të bërë një banjë. Ujë nuk kishim brenda. Nevojtorja ishte po ashtu përjashta. Para shtëpisë kishim një pus, por pikërisht para derës, te shkallët, edhe një pompë klasike uji, që e shfrytëzonim për ujitje të kopshtit dhe për pastrim duarsh. Mora peshqirin dhe furçën e dhëmbëve për të bërë banjën e mëngjesit. Para shtëpisë pashë nja dy lopata e një shat,

që do të ishin shoqëruesit e mi. Fërkoja dhëmbët, dhe me bisht syri shikoja lopatat, e në mendje kalkuloja mbjelljen e gjithë atij grumbulli fidanësh, nga më të ndryshmit. Kishte qershi, dardha, mollë, kajsi, pjeshkë e çka nuk kishte.

U vesha e u mbatha për punë. Dola në derën e poshtme nga ana e lumit. Në oborrin e shkollës, një grup fëmijësh të lagjes po luanin top, dhe pikërisht kur unë kalova andejpari, topi ra në kopsht. Ata filluan ta akuzonin njëri-tjetrin për gjuajtjen e gabuar. Kishin frikë se do t'ua merrja topin. U afrua njëri afër gardhit dhe m'u lut që t'ua ktheja topin, duke më premtuar se në të ardhmen do të kenë kujdes më të shtuar. Në fakt, topi nuk bënte ndonjë dëm, sa vetë fëmijët kur hynin në kopsht dhe, duke e kërkuar topin, shkelnin perimet e mbjella. Sidoqoftë, mora topin me kujdes dhe ua hodha përtej gardhit. U gëzuan shumë dhe më falënderuan. Vazhdova deri në fund të arës, që i bie deri te lumi. Në lumin e pastër e të thellë deri në gju, fshatarët kishin vënë duaj kërpi, ku më vonë e kam kuptuar se ai kishte qenë kanabis sativa, për t'u regjur mirë e mirë. E linin në ujë deri rreth 40 ditë që të ndaheshin fijet prej stapit, që shërbenin për të bërë litarë, thasë etj. Ishte një pjesë rreth 20 metra ku vendoseshin ata duaj kërpi e mbi ta disa gurë, në mënyrë që kërpi të ishte i tëri në ujë. Si fëmijë shpesh ecnim mbi të. Ishte vendi ku më së lehti i zinin peshqit me dorë. Silleshin si të trullusur, të droguar. Nejse, u ktheva, ngase nuk bëhej fjalë për peshq sot, as me grep e as me dorë. Më priste hapja e gjithë atyre gropave për mbjelljen e fidanëve.

Sapo hyra në oborr, nëna më pa dhe, trishtueshëm, më thirri të shkoja brenda. Hyri brenda dhe sërish shpejt doli jashtë. "Ec më shpejt, se aga yt është shumë i sëmurë"! Kështu shprehej, ngase i vinte disi turp t'ia thoshte emrin Tefik. Vrapova shpejt, dhe, kur hyra brenda, çfarë të shihja! Aga, sa shtrihej, sa tkurrej duke e shtrënguar barkun fort me dorë. Edhe më herët kishte raste kur i dhembte lukthi, por merrte një lugë sodë bikarboni dhe i ndalej. "Jepja një lugë sodë", i thashë nënës, kurse ajo ma ktheu se për një kohë të shkurtër i kishte marrë dy lugë sodë, që e përdorte nëna për gatimin e pogaçes.

Isha i ri dhe pak njerëz njihja në fshat, sepse unë më shumë isha jashtë fshatit; dy vjet në normalen e Prishtinës dhe këtë vit në normalen e Gjilanit. Nuk dija ku të kërkoja ndihmë! M'u kujtua shitësi i dyqanit të vetëm, që ishte në Koretin, baca Zenun i thoshim. Zenun Keqmezi ishte me autoritet në fshat. Nuk kishte shumë shkollë, por ishte i gjallë nga fjalët. Nga puna në dyqan arrinte të mbante

familjen dhe të kishte para në xhep më shumë se secili mësues. Ai vinte shpesh për muhabet dhe kishte shoqëri të mirë me agën. Kisha një besim tek ai. Mora guximin dhe vrapova deri në dyqan e i thashë: aga është shumë i sëmure, po vdes, i thashë. U prek shumë baca Zenun. Shpejt mbylli dyqanin dhe vrap erdhëm bashkë në shtëpi. Nëna e kishte bërë agën gati; ia kishte veshur pizhamet e ia kishte vënë në këmbë papuçet e shtëpisë. Aga vetëm dridhej, por nuk lëshonte zë. Kishte një moral të fortë, ndonjëherë mbase të tepruar. Me dorën e majtë shtrëngonte lukthin, derisa me të djathtën mbahej për tavolinën e punës. Iu afrova unë, i hyra ndër krahë dhe i thashë që të ngrihej. Nuk pati besimin e duhur dhe, kur më erdhi në ndihmë edhe baca Zenun, brofi në këmbë.

*Po, ku donit ta dërgonit, a arrite të porositësh ndihmën e shpejtë?*

**Kema:** Hm, jo ore. Në fshat nuk kishte askush telefon, bile as drejtoria e shkollës. Problemi ishte si të dilnim deri te rruga që lidhte Dardanën me Gjilanin; rruga rajonale ishte rreth treqind metra larg nga shtëpia.

*Dhe?*

**Kema:** Dhe, bashkë me bacën Zenun i kryqëzuam duart dhe ai u ul mbi to. Krahët na i zgjati pas qafe dhe ashtu ecëm deri në rrugë. Xhevdeti ishte i vogël dhe, krahas nesh, vinte me një shishe ujë dhe herë-herë ia lagte fytyrën, sepse dukej sikur po i binte të fikët.

Rruga Dardanë – Gjilan nuk ishte mjaftueshëm e qarkullueshme dhe kisha frikë se do të vdiste duke pritur ndonjë automjet. Vetëm një herë në ditë qarkullonte një autobus Dardanë – Prishtinë, bile “postë” e qanim, sepse çdo ditë dërgonte postën për në Prishtinë. Mirëpo, më shpesh qarkullonin kamionë që bartnin xehe nga xeherorja e Strezocit që e dërgonin diku në Serbi, më duket në Kralevë, ngase xehja e magnezit të papërpunuar është bartur një kohë të gjatë, derisa, në fillim të viteve tetëdhjetë është ndërtuar një repart fabrike në Berivojcë, në kuadër të asaj në Kralevë, me ç’rast bëhej hapi i parë i përpunimit dhe pastaj bartej në Kralevë.

Në rrugë prisnim ndonjë makinë dhe ishim të gatshëm të shkonim për në Dardanë ose për në Gjilan. Dhe, pas nja 10 minutash, për fatin tonë, u ndal një veturë. Ishte vetura e ndihmës së shpejtë, e cila me vete kishte një pacient që e kishte marrë në Gjilan dhe po e kthente për në Dardanë. E mori vetëm babanë, po për ne nuk kishte vend. Në ambulancë ishte edhe një teknik, që më bënte të ndihem më i sigurt. Ç'të bënim tani! E dija se mjeku i Dardanës nuk do ta ndalte në Dardanë. Baca Zenun vazhdoi në dyqan, kurse unë qëndrova edhe një kohë në rrugë. Vendi vend nuk më zihej. Nuk kaloi shumë kohë dhe dëgjova sirenën e ndihmës së shpejtë. Pas pak pashë edhe ambulancën e emergjencës me dritën e kaltër rrotulluese. Trupi më ishte rrëqethur i tëri. U nisa me vrap drejt shtëpisë.

Babai në shtëpi kishte një biçikletë “Herkules”. Nanë, shkova për në Gjilan, bërtita si i pakontrolluar. Nana shpejt doli e m'u drejtua. Prit, bile ta bëj pakëz bukë gati. Në fakt, unë vija në fundjavë dhe merrja me vete nja dy lakrorë, nja dy bukë tepsie e ndonjë kavanoz specia turshi, dhe kjo do të ishte e gjitha deri javën tjetër. Mirëpo, tani ishte kohë e pushimeve verore dhe nuk ishte e domosdoshme që të qëndroja në Gjilan. Jo, jo shkova dhe ndoshta kthehem sërish. Kështu, mora biçikletën dhe u nisa për në Gjilan. Nuk e di se sa kohë kam bërë për kalimin e atyre 25 kilometrave, por kam shkuar me një frymë. Çka ishte më e keqja, nuk kisha as para. U ktheva në dyqan te baca Zenun dhe i tregova. Nuk pati nevojë që të sqarohem shumë, sepse ai ishte në rrjedhë të situatës. Hapi syzën, që i thoshin fijokën e parave të pazarit ditore dhe m'i dha njëqind banka, që ishin barazi me bursën time dymujore.

Kur arrita në spitalin kirurgjik të Gjilanit, mjekët tashmë e kishin futur në sallën e operacionit. Lufta ishte për jetë a vdekje, sepse kishte pasur edhe gjakderdhje të brendshme. – “Fati e deshi dhe babai shpëtoi kësaj radhe”, më tha doktori që e kishte operuar, derisa po i hiqte dorëzat dhe me dorën e djathtë fshiu ballin e bërë qull nga djersët. Pas tij vinin edhe asistentët. Nuk më lanë ta vizitoja. Më thanë të vija kur t'i dilte narkoza. Më pas unë shkova në banesë për të pushuar paksa. Situata pas operacionit ishte goxha e rëndë. Aga kishte pasur gjakderdhje të madhe. Sidoqoftë operacioni kishte përfunduar me sukses dhe, ditë pas dite, aga po e merrte veten. Në spital qëndroi rreth pesë javë, pra deri më 7 gusht. Më pas vazhdoi shërimin në shtëpi deri më 15 shtator 1962.

Ndërkohë, nga 1 tetori 1962 u punësua në ndërmarrjen metalpunuese “Gromat”, në Dardanë<sup>24</sup>. Në ndërmarrje, tashmë ishte tjetër ritëm i punës. Ngrihej herët në mëngjes, shkonte me një biçikletë në vendin e punës, në Dardanë. I binte që çdo ditë të udhëtonte nga tetë kilometra dhe, natyrisht, orari i punës ishte tetë orë.

*Së fundi ta bëra pyetjen për rrjedhën e jetës tënde pas normales, e ti deshe gjithsesi ta ndriçoje këtë ngjarje të babait; pra, po i kthehemi edhe një herë pyetjes, - çka pas normales?*

**Kema:** Eh, nuk mund të dal aq lehtë nga kjo temë, sepse fati i babait tim ishte edhe pasqyrim për fatin e shumë mësuesve dhe sidomos arsimdashësve shqiptarë në Kosovë. Gjatë këtyre dy vjetëve pati edhe përjashtime të tjera nga arsimi, ta zëmë: Shaban Gecin, Mehmet Surdullin, Remzi Morinën; më herët e patën përjashtuar nga shkolla e Kopërnices edhe Murat Shkodrën. Kohë më parë patën burgosur Metush Krasniqin, Qemajl Kallabën, Sejdi Kryeziun e shumë të tjerë. Qartë, regjimit i pengonin mësuesit shqiptarë, i pengonte zhvillimi i mësimit shqip.

Mirëpo, megjithatë, vala e të shkolluarve shqiptarë sa vjen e shtohet. Normalja e Prishtinës dhe e Gjilanit, tashmë, ishin në vllugun e “prodhimit” të mësuesve. Gjatë verës, sidomos, organizoheshin kurse të vazhdueshme në Prizren, në Pejë, në Mitrovicë e në Prishtinë.

E ceka edhe më herët se babai bënte vazhdimisht ankesa tek organet kompetente, duke akuzuar disa servilë të verbër të regjimit aktual që i kishin “rënë” në qafë. Kthimi në arsim mund të bëhej vetëm përmes kthimit në Lidhjen Komuniste. Pra, një vend pune varej edhe nëse je ose jo anëtar i partisë. Një lutje për kthim në radhët e Lidhjes Komuniste nuk kishte bërë punë.

Komiteti komunal i LK në Dardanë, më 2 tetor 1962, kishte shqyrtuar ankesën e babait dhe kishte konstatuar se ankesa i refuzohej ankuesit.

---


<sup>24</sup> Vërtetim pune nga ndërmarrja “Gromat”, në Dardanë.





*Tefik Kallaba - vërtetim për shërim në spital prej 10.7. - 15.9.1962*

Më 3 shkurt 1963 Sekretariati i Organizatës Themelore të LK të Serbisë, në Koretin, kishte mbajtur sërish mbledhje ku në rend dite ishin vetëm dy pika: Shqyrtimi i lutjes së Tefik Kallabës për kthim në LKJ, dhe të ndryshme. Ishin dëgjuar diskutime të shumta nga ish-kolegët e arsimit, por edhe nga anëtarët e LKJ-së të fshatit Koretin. Pastaj në mbledhje ishin edhe të deleguarit e Komitetit të LKJ-së të Dardanës, Selim Bunjaku e Bajram Krasniqi. Shumica e kolegëve nuk ishin që Tefik Kallaba të largohej nga LKJ, megjithatë kur diçka vjen nga “lart”, atëherë është vështirë që të mos aprovohet. Prandaj edhe nga mbledhja e 3 shkurtit 1963 u vendos që babai im të largohej nga LKJ, bashkë me mësuesit Ruzhdi Thaqi, Hamid Kryeziu dhe shërbëtori i shkollës Sadri Berisha. Në diskutim kishin marrë pjesë: Ali Agushi, Gani Selmani, Voja Pavloviq, Zenun Keqmezi, Dushan Tasiq, Hevzi Krasniqi, Aziz Haliti, Hamid Kryeziu, Bajram Krasniqi, Haqif Canaj, Januz Sylja, Nikola Mladenoviq, Selim Bunjaku.



*Tefik Kallaba, vërtetim për themelimin e marrëdhënies së punës në organizatën punuese „Gromat“, në Dardanë*

*Dhe, përfundimisht u largua?*

**Kema:** Jo, pasoi një vendim tjetër, të cilin e kishte marrë Komisioni kontrollues i Komitetit Krahinor të LKS-së për Kosovë dhe Metohi, në mbledhjen e datës 27 qershor 1963.

Në vendim shkruante: Zhvleftësohet vendimi i Komitetit Komunal të LKS-së në Dardanën e Kosovës, i datës 2 tetor 1962, në bazë të të cilit ishte vërtetuar vendimi i OTH të LKS-së, në Koretin, mbi dënimin e Tefik Kallabës me largim nga LK, dhe se ai kthehet në LK pa dënim partiak. Në vendim jepej sqarimi se pse ishte dënuar babai im ku thuhet:

Tefik Kallaba është larguar nga Lidhja Komuniste me motivimin se rrjedh nga një familje, nga e cila, gjatë Luftës së Dytë Botërore, disa prej tyre kanë marrë pjesë në shërbim të okupatorit dhe se kanë vepruar armiqësisht, për çgjë, më vonë, disa janë përgjigjur dhe kanë qenë të dënuar; pastaj që një kohë edhe vetë ka qenë në shërbim të okupatorit. Ai ngarkohet se rrjedh prej një familjeje klerikësh, e cila në këtë rrethinë vepron me prapambeturi. Veç kësaj, ai ngarkohet se ka edhe vetë gabime dhe dobësi; se është pasivizuar në punë, si në organizata politike, ashtu edhe në detyrën e mësuesit.

Duke marrë parasysh ankesën si dhe gjithë materialin lidhur me dënimin e Tefikut nga LK, si dhe në saje të provave të vërtetuara, Komisioni Kontrollues i Komitetit Krahinor të LKS-së ka ardhur në përfundim që të zhvleftësohet vendimi për dënimin e tij - përjashtim nga LK, sepse ai vendim është i padrejtë. Kjo për shkak se z. Kallaba nuk është i detyruar të përgjigjet dhe të bartë pasojat për veprat që gjatë luftës i kanë bërë të tjerët, e as për kushërinjtë e tij, sidomos pasi për të gjitha këto LK ka qenë e njohur edhe gjatë pranimit në këtë organizatë, qysh më 1945. Nuk ka bazë që të dënohet as edhe për pjesëmarrjen e tij në shërbim të okupatorit, sepse edhe për këto ka informuar në dokumentet e tij partiake gjatë pranimit në LK. Edhe për lëshimet dhe dobësitë e tij, kinse është pasivizuar dhe ka ulur tempin e aktivitetit politik si dhe në gjithë punën dhe shërbimin, në bazë të hulumtimit të fakteve, është vërtetuar se gjërat janë hiperbolizuar dhe se mangësitë e tilla kanë mundur të eliminohen. Prandaj, në saje të këtyre provave mendojmë se nuk ka bazë për shqiptim të çfarëdo dënimi partiak, kështu që për këtë arsye dhe zhvleftësohet vendimi mbi largimin e tij nga LK, thuhej në vendimin e Komisionit Kontrollues të LKS për Kosovë e Metohi<sup>25</sup>.



*Tefik Kallaba, vendimi për zhvleftësimin e dënimit për largim nga LKS*

<sup>25</sup> *Vendimi për zhvleftësimin e vendimit për largim nga LK dhe nga puna i Tefik Kallabës.*

*Ç'rëndësi ka kjo të rrëfëhet meqë ai qenkësh kthyer sërish në parti?*

**Kema:** E përmenda për të sjellë faktin e kohës, se në rrethet rurale kishte individë që paditurinë e vet e mbulonin me autoritetin e partisë dhe deklasonin konkurrentët e tyre të mundshëm, çka shpesh viheshin edhe në shërbim të “nëntokës” shoviniste serbe, e cila assesi nuk dëshironte avancimin shkollor të popullit shqiptar në Kosovën e lënë, padrejtësisht, jashtë Shqipërisë.

*A ke mundësi ta japësh një biografi të përmbledhur për Tefik Kallabën?*

**Kema:** Po, patjetër!

## **Tefik Shefki Kallaba (10.8.1922 – 4.7.1984)**

Tefik Shefki Kallaba u lind më 10 gusht 1922 në fshatin Roganë, ish-Rogaçicë të Dardanës. Shkollën fillore katërvjeçare e kreu në Hodanoc, me mësim në gjuhën serbe. Kjo shkollë ishte paralele e shkollës popullore shtetërore të Domorocit. Shkollën fillore katërvjeçare e përfundoi (me sukses të shkëlqyeshëm) në vitin shkollor 1937/1938. Mësues i tij ishte Nikola V. Nikoliq, ndërsa drejtor T. Zejniq.

Duke parë rëndësinë e arsimit, që në moshë të re, shfaqti interesim që aktivitetin e vet ta orientojë në këtë drejtim. Shpeshherë shkonte te mësuesi i shkollës së fshatit, Ramadan Latifi, të cilin e luste që ta lejonte të prezantonte në orë të mësimi. Ç' është e vërteta, Ramadani, duke e parë vullnetin e tij të zjarrtë për arsim, e kishte pranuar dhe e kishte këshilluar për mënyrën e mbajtjes së orës mësimore dhe përgjithësisht rreth edukimit dhe arsimit të fëmijëve. Pasi kishte ushtruar disa kohë me Ramadan Latifin, rreth mbajtjes së mësimëve, Tefik Kallaba i paraqitet Mehmet Gjevorit në Prishtinë me një lutje për ta angazhuar në arsim. Mehmet Gjevori i kishte dhënë material për fillimin e punës dhe në dhjetor të vitit 1947 Tefiku e themelon, për herë të parë, një shkollë shqipe në fshatin Busavatë të Dardanës, ku kishte përfshirë rreth 80 nxënës, djem e vajza, moshash të ndryshme.



Vullneti për të dëshmuar pjekuri dhe sakrificë për përhapjen e diturisë të një brez, i cili për herë të parë në jetën e tij po ballafaqohej me mësuesin, me librin, me shkronjat që ishin krejt ndryshe nga ato arabe që i kishin hasur të hoxha i fshatit, bëri që mësuesi Tefik të ishte aktiv edhe me nxënës, edhe me prindër, e pse jo edhe në përgatitjen e objektit të shkollës. Përpilimi, gjithherë me kohë, i planprogramit mësimor si dhe zbatimi i tij i përhershëm, deri në pensionimin e mësuesit Tefik, do të jetë dëshmia më e mirë për atdhedashurinë dhe për kombëtarizmin e tij.

Mësuesi Tefik, së bashku me plejadën e parë të mësuesve të pas Luftës së Dytë Botërore, që nënkuptonte realitetin: një mësues – një shkollë, ishte njëri nga ata që po e demantonin mitin qindrvjeçar se në Kosovë po ekzistua vetëm alfabeti cirilik dhe arab ose turk.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në rrethin e Dardanës kishte fare pak mësues shqiptarë. Prej 28 shkurt deri më 6 mars 1948 në Toponicë, në lokalet e mejtepit të Xhamisë, është organizuar një seminar nga inspektori i Arsimit, Kasëm Caka për t'u realizuar nga mësuesit Ndue Zef Markaj, mësues në Karaçevë të Epërme dhe Nazmije Kastrati nga Karaçeva, mësuese në Toponicë. Seminari ishte i dedikuar për aftësimin e mësuesve për punë me analfabetë. Në seminar morën pjesë 12 seminaristë dhe me këtë rast u hapën 12 shkolla shqipe në rrethin e Dardanës. Njëra nga këto shkolla ishte, pra edhe ajo e Busavatës.

Si shumë të tjerë edhe mësuesi Tefik, më 1953 kreu kursin gjimnazial pedagogjik në Mitrovicë, kurse më 1954, gjatë muajve korrik-gusht, kreu kursin gjimnazial pedagogjik në Prizren, të vlefshëm për klasën e parë (I) të shkollës Normale.

Prej 2 korrik deri më 20 gusht 1956, Tefik Kallaba ishte dëgjues i rregullt i Seminarit pedagogjik në Prizren, që ishte organizuar me karakter të përgatitjes së mësuesve me korrespondencë për vitin e dytë të shkollës Normale. Drejtor i këtij seminari ishte Hasan Opoja.

Krahas punës në arsim vazhdimisht përgatitej për provimet e shkollës Normale. Pra, pushimet verore i shfrytëzonte për vijimin e kurseve dhe seminareve që organizoheshin në Gjilan, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë.



Në shtator të vitit 1963 kishte kryer Gjimnazin, kurse në gusht të vitit 1964 u diplomua edhe në shkollën Normale të Gjilanit.

Më 16.2.1965, Komisioni Krahinor i asaj kohe për çështje të punëtorëve arsimorë, i bazuar në rezultatet e tij në punën edukativo-arsimore me nxënës, dhe me kërkesën e shkollës fillore ish-„Vëllazërim Bashkim“, tani “Abdullah Presheva-Krashnica” të Koretinit, e liroi nga dhënia e provimit profesional për titullin „Mësues i klasit të tretë“ meqë kishte plotësuar kushtet sipas nenit 198 të Ligjit për punëtorët publikë, dhe të nenit 20 të Rregullores për dhënien e provimit profesional në lëmin e arsimit.



Tefik Kallaba, dëgjues i seminarit pedagogjik në Prizren, 2 korrik deri më 20 gusht 1956



## **Pra, në procesin arsimor si mësues punoi:**

Dhjetor 1947 – 19.9.1950, në Busavatë të Dardanës (me vendim prej shkurtit 1948)

19.9.1950 -5.12.1952, në Kopërnice

5.12.1952 – 20.9.1953, në Hogosht. Këtu, përveç arsimit, angazhohet edhe në mbajtjen e kursit shëndetësor për femra, të organizuar në 49 qendra të rrethit të Dardanës.

20.9.1953 – 31.01.1954 punoi sekretar i Këshillit për Arsim e Kulturë në Dardanë.

1.2.1954 – 31.08.1955, mësues në Koretin

1.9.1955 – 31.03.1956, mësues në Hogosht

1.4.1956 – 31.8.1957, mësues në Koretin

1.9.1957 – 31.08.1958, mësues në Geraj të Preshevës

1.9.1958 – 31.08.1960, mësues në Pogragjë të Gjilanit

1.09.1960 – 31.10.1974, mësues në Koretin (me ndërprerje të dhunshme nga pushteti, për punë në arsim, prej 19.05.1962 – 15.8.1963).

1.10.1962, punësohet në ndërmarrjen ndërtimore “Gromat”, në Dardanë, në vendin dhe detyrat e punës: futurist-kalkulator, përkatësisht arkëtar i ndërmarrjes, referent për punë dhe marrëdhënie pune, sekretar dhe administrator dygjuhësor i ndërmarrjes.

15.8.1963, pas disa ankesave të pareshtura që i kishte bërë në të gjitha nivelet e mundshme, për të kontribuar në arsimin shqip, më 15 gusht 1963 kthehet përsëri në Koretin ku edhe punon mësues gjer më 31.10.1974, kur, për shkaqe shëndetësore, pensionohet si invalid pune i kategorisë së parë (punoi 27 vjet e 7 muaj e 23 ditë).

Mësuesi Tefik Kallaba ishte krenar për rezultatet e arritura në arsim dhe se kulmi i krenarisë së tij ishte që, krahas një plejade të arsimuarish, pas vete la edhe fëmijët e vet të arsimuar dhe arsimdashës. Nga ky mësues, kanë dalë shumë e shumë intelektualë, si: profesorë, doktorë, magjistra dhe doktorë shkencash, deputetë dhe patriotë që tërë jetën ia kanë kushtuar çështjes kombëtare.

Më 27 shtator 1982, në takimin e parë të punëtorëve veteranë të arsimit të Kosovës iu nda Mirënjohje për kontributin e dhënë në përparimin e arsimit dhe të edukimit në Kosovë. Mirënjohja ishte e firmosur nga Sali Nushi, Ministër i Arsimit i Kosovës.

Si pensionist, aktivitetin e vet e orientoi në edukimin dhe zhvillimin e bletarisë, shoqatën e së cilës e themeloi më 15 maj 1976, duke punuar në këtë lëmë në mënyrë të vazhdueshme. „Zhurma e bletëve si dhe organizimi i punës me bletë, njësoj sikurse edhe me nxënës (përpilimi i planprogramit të punës i shtjelluar në plan vjetor, mujor, javor e ditor), ma hiqte mallin e punës me nxënës, të cilën për arsye shëndetësore nuk munda ta ushtroja edhe më tutje“, kishte thënë me një rast mësues Tefiku.

Tefik Kallaba, kudo që zhvilloi aktivitetin e vet edukativo-arsimor, kultivoi edhe dashurinë dhe respektin ndërnjerëzor dhe atë kombëtar. Me autoritetin që kishte, në odat e fshatarëve Tefiku ishte vazhdimisht i pranishëm, aq sa për ta begatuar me muhabet konakun, po aq edhe për t'i ndezur flakadanët e diturisë në masat e gjera popullore. Biblioteka e tij ishte në shërbim edhe të nxënësve të tij. Bile, ndonjë fundvit, kur shkolla nuk planifikonte shpërblimin e nxënësve shembullorë, mësuesi Tefik, nxënësit e vet i shpërblente me librat nga vitrina personale.

Me dijen, edukatën, zemërgjerësinë dhe vullnetin që e kishte, ai ishte gjithmonë dhe gjithkund ku ndodhte ndonjë ngatërresë ndërmjet fshatarëve. „Lodhja ime nuk mund të krahasohet me gjakun e ndonjë individi si pasojë e paditurisë ose mostolerancës së ndokujt“, arsyetonte shpesh angazhimin e tij të palodhshëm mësuesi Tefik. Ishte këmbëngulës deri në pajtimin përfundimtar të ngatërresave ndërnjerëzore.

Në oda dhe ndeja me kategori të ndryshme të arsimuarish ishte gjithmonë praktik dhe i arsyeshëm. Anekdodat, të cilat shpesh i sajonte aty për aty, por që gjithmonë ishin me karakter edukativ, ishin një brumë bindës për

bashkëbiseduesit. Ishte kënaqësi të ishte mysafir i tij ose ta kishe mysafir në shtëpi. Kur ndokush akuzonte tjetrin, ose ndonjë dukuri në shoqëri ai përpiqej t'ia zbuste zemërimin, duke ia treguar p.sh. një anekdotë si kjo: - Po i ankohej dërrasa gozhdës, duke i thënë: - pse moj gozhdë po më thumbon kaq fort, ndërkaq gozhdë ia kthente dërrasës: - ah moj dërrasë, po ta dije ti se çfarë çekani po më bie mbi kokë, nuk do të më fajësoje mua fare.

Mësuesi Tefik po ashtu tregonte edhe anekdota këshilluese si p.sh:

- \* Mos bëj vepra për të cilat do të turpërohesh t'i tregosh!
- \* Gjithkush është dikushi, veç i padituri është askushi!
- \* Dashuria ndaj prindërve është themel i të gjitha virtyteve njerëzore!
- \* Hiq dorë nga e keqja, që të hiqet e keqja nga ti!
- \* I padituri është një i vdekur që lëviz!
- \* I padituri është armiku yt, qoftë edhe nëse e ke prind!
- \* Secilit ia tepron sherri i vet!
- \* Mos u lavdëro me mallin e humbur dhe me babain e vdekur, ndërto pasurinë dhe autoritetin tënd!

Tefik Kallaba trashëgoi traditën e arsimit edhe nga paraardhësit e tij, ngase edhe babai i tij, Hafëz Shefki Kallaba ishte mësues fetar, imam në vendlindjen e tij si dhe përfaqësues fetar në nivelet më të larta të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe ish-Jugosllavisë. Si i tillë ai ishte edhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, mbajtur në shtator të vitit 1943. Por, edhe gjyshi i mësuesit Tefik, Sali Kallaba ishte një patriot e bashkëluftëtar i Idriz Seferit, Hasan Prishtinës e Isa Boletinit (shih librin e mr. Aliriza Selmani "Gjilani me rrethinë 1908-1912" faqe 251).

Mësuesi Tefik nuk parapëlqente braktisjen e tokave stërgjyshore dhe shpërnguljen në kryeqytet ose jashtë vendit. "Atdheu është aty ku banon qytetari

i tij, prandaj duhet ndërtuar një program kombëtar për politikën e migrimit brenda Kosovës”, i kishte thënë njëherë djalit të tij Xhevdetit i cili po punonte në Radiotelevizionin e Prishtinës. Kështu edhe e arsyetonte kthimin e tij nga Koretini në Roganë e jo shpërnguljen drejt Prishtinës. Dhe, në prill të vitit 1983, mësuesi Tefik u kthye për të jetuar në vendlindje (në Roganë), ku edhe pse ishte mësuesi i parë roganas, nuk pati rastin të punonte asnjë ditë në vendlindjen e tij. Pas një sëmundje të rëndë vdiq në moshën 62-vjeçare, më 4 korrik 1984 dhe u varros në fshatin e lindjes, në Roganë (Rogaçicë).

Modeli i punës së mësuesit Tefik Kallaba ishte dhe do të jetë pjesë e krijuesve dhe studiuesve të ndryshëm.

### **Angazhime të tjera gjatë jetës:**

Prej 15 dhjetor 1942 deri më 15 prill 1943 ishte ushtar në Ushtrinë shqiptare si kalorës – luftëtar.

Prej 1 qershor deri më 8 gusht 1945 ka ndjekur dhe përfunduar kursin e nënoficerëve për këmbësori.

Më 2 dhjetor 1952 është formuar Këshilli popullor për arsim në Kamenicë. Tefik Kallaba është caktuar udhëheqës i këtij Këshilli.

Më 25 janar 1954 është zgjedhur anëtar i Kuvendit të Entit për Sigurim Social në Kamenicë, duke e zëvendësuar Aleksandër Periqin i cili kishte kaluar me punë në tjetër rreth.

Më 1957 zgjedhet anëtar i Këshillit për Kulturë në Gjilan.

Më 12 janar 1954 i është kërkuar që ta dorëzojë revolen e tipit 6,65 me nr. 144 989, të cilën dhe e ka dorëzuar.

Prej 20 nëntor 1944 deri më 15 maj 1945 ishte pjesëmarrës në LNÇ-së (Lufta Nacionalçlirimtare).

SHOQATA E VETERANËVE TË ARSIMIT  
KAMENICË

*Me rastin e Ditës së Mësuesit -  
7 Marsit*

jep

**Mirënjohje**

z. *Tefik Hallaba*

nga *Bogocica*

*për kontributin e dhënë në edukimin  
dhe arsimimin e gjeneratave të reja*

Kamenicë,  
7 mars 2000



Kryetari  
Bejtulla Muja  
*Blleuja*

Plani global i gjuhës amtare  
 Fondi i orëve 221. Lëndë e re 143.  
 Përfundim e përsëritje 77

Gjysëm vjetori i parë

TEMAT MËSIMORE	Fondi i orëve afërsisht				
	Zhvillimi	Përcaktimi	Temat e reja	Përsëritje	Përsëritje
Lexim në prozë e poezi	18	20			38
Dramatizimi i copave të leximit	4	2	1		7
Ushtrime me gojë e me shkrim	27	-			27
Mësim mbi gjuhën	8	6			14
Rrecitime	10	9			19
Hartim me shkrim	2	2			4
<b>GJYSËM VJETORI I PARË</b>	<b>69</b>	<b>39</b>	<b>1</b>		<b>109</b>

Gjysëm vjetori i dytë

TEMAT MËSIMORE	Fondi i orëve afërsisht				
	Zhvillimi	Përcaktimi	Temat e reja	Përsëritje	Përsëritje
Lexim në prozë e poezi	21	19	-		40
Dramatizimi i copave të leximit	3	2	-		5
Ushtrime me gojë e me shkrim	25	-	-		25
Mësim mbi gjuhën	8	5	-		13
Rrecitime	14	6	2		22
Hartim me shkrim	3	3	2		8
<b>Gjysëm vjetori i dytë</b>	<b>74</b>	<b>35</b>	<b>2</b>		<b>112</b>
<b>Gjithsejt</b>	<b>143</b>	<b>74</b>	<b>3</b>		<b>221</b>

Modele të planprogramit, bërë me shumë përkushtim nga mësuesi Tefik



Plani global për matematikë  
Fondi i orëve 221. Lendë e re 89  
performim e perseritje 66

Gjysëm vjetori i parë.

TEMAT MËSIMORE	Fondi i orëve për afersisht			
	Zhvillimi i njohurive	Përkrahja tematike	Shtesëzimi i përgjithshëm	Përkrahja e përgjithshme
1. rrethet, zbritje, pjesë, sh. z. mbledhje v 100	1	1	-	2
2. Zaxerimi i vargut numerik deri me 1000	6	6	-3	13
3. sistemi numerik	6	5	1	12
4. Detyra rreth 4. veprimet aritmetike	2	5	3	10
5. mbledhje e zbritje deri me 1000	9	10	-	19
6. Supriza, tehu, pika dhe segmenti	2	2	-	4
7. Shumzimi e pjesëtimi me goj mbret	9	11	-	20
8. Detyra të kombinuara	9	11	3	23
9. Horizontale e vertikale	2	2	-	4
<b>Gjithsejt në gjysëm vjetorin e parë</b>	<b>46</b>	<b>53</b>	<b>10</b>	<b>109</b>

GJYSËM VJETORI I DYTË

TEMAT MËSIMORE	Fondi i orëve afersisht			
	Zhvillimi i njohurive	Përkrahja tematike	Shtesëzimi i përgjithshëm	Përkrahja e përgjithshme
1. Witrinat rreth 4. veprimet aritmetike	2	5	-	7
2. Katrori, kubi dhe kandi i dytë	6	4	-	10
3. Detyra për koordina	-	4	-	4
4. mbledhje e zbritje me shkrim mbret 1000	12	8	-	20
5. Shumzimi e pjesëtimi	8	3	-	11
6. Pjesëtimi me shkrim mbret v. 1000	6	3	12	21
7. Detyra të kombinuara	-	26	4	30
8. Shumzimi me shkrim mbrenda v. 1000	6	4	-	10
9. Pjesëtimi me shkrim nga materiale	2	2	-	4
<b>Gjithsejt në gjysëm vjetorin e dytë</b>	<b>43</b>	<b>56</b>	<b>10</b>	<b>109</b>
<b>Gjithsejt gjat tërësisë</b>	<b>89</b>	<b>109</b>	<b>20</b>	<b>208</b>

Modele të planprogramit, bërë me shumë përkushtim nga mësuesi Tefik



që të më lejoj të marr prezantim në orë të mënimut i cili më jepet  
 që më prezantim nëqë mbas unë e dinte nëvoren se duhet të bëjen  
 edhe shkollë por në mënyrë të masueshme shumë fjalë idin ja shkollë  
 shpreh her me thirrje në zyrën e vet de me ndihmonë që të përgatis  
 nga një orë mësimi. I ndihmo edhe të luftime 20 e 20 e mbajta një orë  
 mësimi bast si mësimi edhe për këtë lëshmë të cilat komandoni në  
 ndihmonë me përvojë. Kështu vajrë komandoni shumë her me një  
 që me përgjeronë që të vesnëq të emrohem për mësim që me mësor  
 edhe atë e hera të një fjalëve detirë. Ja paraqitë meqenat shpreh në  
 prishim me një lufte të no ato material për fletim e punës të me shpreh  
 1917. E kjoji shkollën në fjalë të Dëshmorët.

Dëshmorë ime për punë me fëmijë të fletë kështu për  
 shkollë vetëm 4 vites të kryerë për një lufte të diçkë të shkollë fjalë për  
 fëmijë i dorëzë shumë. Kështu një për punë as obligim për fëmijë me me  
 të përgjorë për punë të me me fëmijë për shumë e kam për orë  
 e mësimi që të më dëton e të shpreh i orë të fëmijë. Kështu punëva ja lufte  
 e merrë me të dësi me 1973/74 Kështu me kështu komandoni e e të me vjetër fletë  
 prej 1939 i kështu kështu komandoni komandoni, me komandoni komandoni  
 si të të ndëgjorë. Atëherë fletëva të bëj mësimi, ky të përgjorë për shumë  
 si të me at punë që bëjta me me komandoni të fletëva të fletëva komandoni  
 që duhet ja një mësorëq të se ja se në të kështu. Vendojë që të komandoni  
 komandoni e komandoni komandoni në punë me vend të të bëj një  
 komandoni si komandoni që të ja një komandoni të komandoni

Lërgim i një një fletëva kështu me qen vëdëq për të  
 si kështu të vjetër komandoni komandoni komandoni. Ja mbas komandoni  
 gjendat në oborin e shkollës, a shumë e një e një me vjetër si  
 me vjetër e vjetër në mënyrë me me komandoni shumë komandoni  
 shumë komandoni e një komandoni me një komandoni. Ja të për komandoni  
 komandoni që shpreh her me komandoni që të komandoni në me të komandoni komandoni  
 komandoni e komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni  
 komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni  
 komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni komandoni

Tefik Kallaba herë pas here shkruante për përvojën dhe synimet e tij në fushën e arsimit me fëmijë, dhe këto i diskutonte në kolektiv ose me kolegët e tij arsimdashës

## Puna me blat në muajin Gusht

10

Muaji Gusht është bazë për vlerën e arditshëm, e shpreh  
këtë ndihën anësra nga blatarët në në dimën kuja blatët me pakt  
mizëri. Te njëjtat anësra paraq, len edhe në praxhorë turr behet  
Kontrollimi djalat pronveror, e gati gjith hërs fujm i a qerim  
Amës, a xhalli turr ndalet ta kontrollon punën e vet në  
si an vet vepson me tër dhe sa gabime kanë qyt punës me të

Zej e li blatar duhet ta bëj një plan punë, e mos ma  
shum borë për ç'do shum të vilit

Diket mirë se muaji gusht është muaji me me rënd  
nandën për të gjith muajve në vit. Muaji turr është i punës  
me lloj llojve hullora për blat, a blatët qyt punës si tyre  
intenzive, ato edhe shum shpejt në shkurtorin jetën veti.

Në këtë kohë në të blatët qyjnë hullor të mirë, o turr shp  
në të fort, bëjnë edhe shum myall me tër, e turr zojnë  
anën dhe nurr llojve vend të zbrazet që të t'at vend turr  
anua të llojve vet, e ajo duhet të endet hoj me hojë  
të turr turr vend turr do të llojve vet dhe bor pakt ve, e  
turr moshum nurr vdeqin se në lindin. Kështu blata  
bosh turr duhet me qerë e fort ajo dureshit, dhe në dimen  
hynë me pakt shogëri, e shogëri e debët nurr mund të pakt  
dimrit ato mundet meu foru edhe pakt ushqim në  
boll. Nodje në të blata me turr nurr e ha nurr anën  
atës blatar duhet të turr turr qyt për të pakt gusht  
të kontrollon blatët. Ajo blat që e ka anën plaktë ore  
jo rentabile duhet t'ia ndroje, t'ia hjetim anën plaktë,  
e ato detyrohen vet ta mbrapin anën e re

Tefik Kallaba, njësoj sikur për nxënës, bënte planin vjetor, mujor e javor edhe për punën me  
blatë, të të cilat, pas pensionimit të tij, gjente zëvendësimin e punës me nxënës





*Të lutem, për së treti herë po pyes, çka bëre pas normales?*

**Kema:** Po, tani do të rrëfej. Me gjendjen aktuale materiale që e kishim në familje ishte e pamundur që të studioja. Lugetërit kundër babait tim ishin trazuar; ai nuk ishte njeriu që do të vihej në shërbim të regjimit për të keqen e popullit të vet; ndonëse kishte vlera të larta njerëzore dhe internacionaliste; ai, që herët e kishte kuptuar sherrin e sllavëve kundrejt shqiptarëve; edhe pse nënën e kishte nga një familje turke, nga Dobërçani, dhe gjyshen, nga ana e nënës, shqiptare nga Hodonoci, ishte mjaft i mllefosur edhe në Turqinë, që na kishte lënë kështu “kafshatë” për sllavët, të cilët punonin me programe akademike kundër shqiptarëve. Ende e kishte të freskët edhe likuidimin e vëllait të tij, Ilmiut, medresist i medresesë “Isa Begu” në Shkup, i cili në dhjetor të vitit 1944 qe marrë nga dy xhandarë në një rrugë të Gjilanit për një bisedë informative nga SPB në Gjilan dhe kurrë nuk u kthye në shtëpi, pa u ditur edhe varri i tij - vetëm e vetëm pse kërkonte që gjuha shqipe të ishte e barabartë me gjuhën serbe; që gjuha shqipe të përdorej në administratë; madje, gjuha shqipe të zbatohet edhe në predikimin e fesë nëpër xhamitë e Kosovës..., por për axhën Ilmi do të flas më vonë.

Pra, qëndrimi im në Prishtinë nuk ishte edhe i pakushtueshëm. Kështu vendosa...!

*Çfarë vendose?*

**Kema:** Vendosa të kërkoja punë. Kuptova se Drejtoria e Arsimit e Dardanës kishte shpallur konkursin për një vend pune në shkollën fillore të Desivojcës. U paraqita dhe më një shtator 1963 u pranova, ngase normalja kishte vlerë të madhe në Mësuesi. Ligjëroja lëndën Gjuhë shqipe. Nxënësit ishin të zellshëm dhe shumë të interesuar për të mësuar. Mora edhe një banesë me qira. Desivojca shtrihej në pjesën verilindore të Dardanës dhe, nga Koretini, ishte rreth 3-4 orë udhëtim më këmbë. Pas pak kohe bleva një pushkë të kalibrit të vogël me gojën për gjashtë fishekë. Isha i pasionuar edhe për gjuetinë, ku kaloja edhe kohën e lirë në mal.

Banorët e Desivojcës ishin dashamirës të flakët të arsimit. Kur unë u shpjegoja

nxënësve për rilindësit si: Naimi, Çajupi, Migjeni, Mjeda, Gurakuqi etj. fshatarët, kur më takonin, dëshironin që edhe atyre t'u flisja më tepër për shkrimtarët, për burrat e shqiptarisë, siç thoshte mixha Aziz Surdulli, të cilin e kishim edhe mik shtëpie, e i cili po ashtu kishte arritur t'i shkollonte dy nga disa nipërit e tij: Mehmetin dhe Izetin. Mixha Aziz nuk kishte shkollë, por ishte shumë i logjikshëm dhe trim i njohur i asaj ane. Ishte ushtar i dalluar i Mulla Idris Gjilanit. Me një rast, mllëfin për relacionin për “trimërinë” e serbëve e kishte shprehur: “Tri sende kisha pasur dëshirë t'i përjetoja nga njerëzit – shqiptarët e mi:

E para: - kam dëshirë ta pres një pastërma e t'i ngop njerëzit e shtëpisë me mish gjatë gjithë dimrit e t'i shoh në pranverë se sa po vyejnë kur të dalin për të prashitur në arë; e dyta: - kam dëshirë që arat t'i mbush me pleh e ta shoh se sa bereqet po më japin; dhe, e treta: - kam dëshirë t'i bëj gjithë shqiptarët tubë, kudo ku janë, e t'i shti që të luftojnë me serbë, e pastaj ta shohim ku jemi ne e ku janë ata, se gjithmonë na kanë ndarë e na kanë copëtuar, e pastaj na kanë ngrehë lehtë për hunde”.



*Ekrem Kallaba prej 1 shtatorit 1963 (në moshën 19-vjeçare) filloi punën – mësues i gjuhës shqipe. - Vërtetimi për punësim në Desivojçë*



*Ekrem Kallaba për herë të parë filloi të punojë mësues në shkollën fillore të Desivojcës, Komuna e Dardanës*

nxinin sa më shumë mësim nga unë. Gjatë shkollimit tim kisha lexuar shumë nga psikologjia, sidomos nga psikologjia për fëmijë, kështu, tani, doja ta zbatoja në praktikë me nxënësit, sidomos me ata të klasës së pestë, që sapo ishin ndarë nga mësimnxënia prej një mësuesi në shumë mësues. Tek ata vëreja se si po e ndërtonin një psikologji më vete ndaj mësuesve; për secilin mësues kishin qasje të veçantë; zbatonin rregullat e mirësjelljes tamam sikur shoferët e mirë në rrugët e metropoleve me trafik të dendur, pa shkaktuar incidente dhe njëkohësisht pa u përfshirë në to. Më mahniste intelijenca e nxënësve. Ata nuk ishin vetëm nga Desivojca. Kishte nga Laçiçi, Velegllava, Vriçeci, Tërstena; vinin edhe nga Krenidelli. Secili kishte karakter më vete, dhe ishin të ndikuar nga fshati prej nga vinin, sepse çdo fshat kishte historitë e veta, krenaritë e veta. Dhe, unë, pa dyshim, duke e njohur këtë terren, ruaja dinjitetin e secilit nxënës, dhe punoja në njëjtësimin e personalitetit, duke i sjellë ata në një ambient tjetër jetësor me synim parësor nxënien dhe daljen nga robëria shekullore e analfabetizmit si dhe nga çlirimi prej ndjenjës së “robotit”. Prandaj, me kënaqësi shpjegoja rilindësit, veprat e të cilëve kishin po këtë mesazh, mesazhin e atdhedashurisë, të arsimimit, të burrërisë, pra, mesazhin e të bërit vetvetja. Kishte nga ata që ishin më të ndrojtur, veçanërisht ata të klasës së pestë. Nuk përtoja t’u përshtatesha, të ulesha me ta në bankë dhe t’i trimëroja për shpjegim më të rrjedhshëm, për

Isha mësues fillestar, por isha rritur me mësues në shtëpi. Babai shpesh fliste për llojet e ndryshme të karaktereve të nxënësve, të cilat mësuesi duhet shpejt t’i përvetësojë dhe ta bëjë nxënësin për vete, në kuptimin që nxënësi të ketë besim të madh te mësuesi. Ligjërimi i gjuhës shqipe, për nxënësit, ishte edhe një ushqim shpirtëror. Mund të them se edhe unë isha i mishëruar me mësimdhënien, sepse dymbëdhjetë vjet vetëm mësim kisha nxënë, e tani kisha një rol tjetër në jetën time, dhe atë rol e doja shumë. Po të ma lejonte metodika, gjithë atë dituri që kisha fituar prej kohësh do t’ua dhuroja përnjëherë nxënësve, të cilët donin të



shprehje të lirë të mendimit, por edhe për të qenët korrekt ndaj shokut, ndaj mësuesit, ndaj prindit etj. Ishte përvoja e parë në arsim, prandaj dhe u ndala më gjatë në përshkrimin e kësaj periudhe.

Çështë e vërteta, disave nga këta nxënës pata rastin t'u jepja mësim, disa vjet më vonë, edhe në shkollën e mesme në Dardanë.



*Ekremi në ditët e tij të rinisë, pas mbarimit të normales (1963)*



*Ekremi (nga e majta - i dyti në rreshtin e dytë) me nxënësit e klasës së VI/2, viti 1965 në shkollën fillore "Skënderbeu" - Hogosht. (Foto e huazuar nga ish-nxënësi, Refik Beqiri)*



*Dhe, nga kjo punë a kurseve para për studime?*

**Kema:** Në fakt, unë fitoja mjaft para, sepse mësuesit që punonin larg qendrave urbane, sidomos në Malësi, paguheshin më mirë. Ishte një metodë e mirë e motivimit për punë në vendet rurale. Një shumë parash e kisha ndarë për blerje tekstesh për fakultet, por kisha edhe shpenzime të tjera, pastaj më duhej të ndihmoja edhe në shtëpi. Kënaqësia ime ishte se tani kisha paranë time. Në Desivojcë punova rreth dy vjet. Banoja në një ndërtesë të komunës, afër shkollës, që ishte dedikuar për banim të mësuesve dhe të një pylltari. Në fshat nuk kishte ndonjë gjelltoje, kështu që ushqimin kryesisht ma përgatiste zonja Pashije Bunjaku – bashkëshortja e Shabanit. Unë e furnizoja me miell, kurse ajo gatuante. Prandaj, me këtë rast edhe e falënderoj familjen e Shaban Bunjakut për atë përkujdesje që e bënte për mua, dhe jo vetëm, sepse edhe mësuesit tjerë të jashtëm po ashtu ushqeheshin me bukën që e përgatiste zonja Pashije. Shabani e Pashija e kishin edhe djalin Fehmiun të cilit i jepja mësim, madje edhe më vonë në shkollën e mesme në Dardanë i kam dhënë mësim dhe e kam trimëruar që të mësonte sa më shumë.

Pastaj u regjistrova në Fakultetin Filozofik, drejtimi i Pedagogjisë. Dy vjet shkova i rregullt, e pastaj vendosa që pjesën tjetër të studimeve ta bëja krahas punës. Kështu, me ndërprerje punova në Hogosht, në Topanicë, në Koretin, në Malishevë, në Strezoc.



*Ekrem Kallaba (i treti nga e majta – rreshti i parë) gjatë punës në shkollën fillore „Vëllazërim Bashkim“ në Koretin, në vitin shkollor 1965/66*

*Pse punoje me ndërprerje. Kishe probleme me vendim të punës apo si ishte puna?*

**Kema:** Thënë realisht, kisha mundësi të punoja gjatë gjithë vitit, por në vete kisha dy kërkesa njëkohësisht. E para, doja të punoja për të grumbulluar para për studime dhe, e dyta, doja ta përfundoja fakultetin sa më parë. Kjo ishte paksa e vështirë. Prandaj, zakonisht punoja në fillim të vitit shkollor dhe semestri në fakultet fillonte në tetor, por kisha hapësirë që herë pas here të shkoja në fakultet e të merrja shënimet nga materialet e përpunuara dhe diku nga shkurti shkoja edhe në ligjërata. Ose, ndodhte që të punoja në ndonjë shkollë në gjysmëvjetorin e dytë dhe kështu të përfitoja edhe pagat gjatë pushimeve verore, për të filluar pastaj i rregullt ose rregullisht me ligjërata që nga fillimi i vitit akademik.

*A nuk ishte kjo punë me ndërprerje e dëmshme për nxënësit? A gjendej zëvendësim i menjëhershëm?*

**Kema:** Çështje e vërteta, çdo vit dilnin kuadro të reja nga shkolla normale dhe gjithmonë gjendej dikush që vazhdonte menjëherë punën time. Pastaj edhe kuadrot nga gjimnazi ishin aktualë, edhe pse ata ishin më pak të kërkuar në arsim, për shkak të lëndës së Metodikës që gjimnazi nuk e kishte në programin arsimor, kjo ishte një mangësi e theksuar për arsimimin e nxënësve.

*Kur u stabilizove me vend pune?*

**Kema:** Po, në vitin shkollor 1967/1968 u pranova në gjimnazin “9 Maji” në Dardanë si profesor i lëndës së Marksizmit, por që ligjëroja edhe lëndët: Filozofi, Psikologji, Logjikë dhe Sociologji, varësisht prej vitit se cila lëndë ishte në program. Me këtë rast punova tërë vitin, nga 1 shtatori 1967 deri më 31 gusht 1968.

*Me studime çfarë bëre, i mbarove ato apo i le në gjysmë?*

**Kema:** U përpoqa t'i vazhdoja, por e kisha problem çështjen financiare. Nuk mund të llogaritja në ndihmën e babait, sepse edhe ai, me një rrogë të mësuesit, e kishte të pamundur ta mbante familjen tetanëtarëshe. Kështu, provova sërish të kërkoja një kredi nga shteti, por edhe aty kishte klasifikime.

ОБРАЗЛОЖЕНИЕ  
 ОБЪЯВЛЕНИЕ ЗА ДОПОЛНИТЕЛНИ ДОДАТОК ЗА ДОПОЛНИТЕЛНИ ДОДАТОК

№ ... Влада и Министерството на Народното Образование — Скопје

Дополнително: Калија/Терика/Крива

№ ... студент ... на Страна и Кооп. Агенција

№ ... Министерството на Народното Образование — Скопје

№ ... Министерството на Народното Образование — Скопје

№	ВИД НА ДОДАТОК	Датум	Износ	Дополнително
1.	За извршеност на задолжителноста			
2.	За извршеност на задолжителноста			
3.	За извршеност на задолжителноста			
4.	За извршеност на задолжителноста			
5.	За извршеност на задолжителноста			
6.	За извршеност на задолжителноста			
7.	За извршеност на задолжителноста			
8.	За извршеност на задолжителноста			
9.	За извршеност на задолжителноста			
10.	За извршеност на задолжителноста			

Вкупно додатоци: ...

№ ...

На име на ...

№ ...

Оваа документација е издадена со ...

Уверение на именуваниот издавач на ...

№ ...

1944

*Formulari i konkurrimet për bursë, i plotësuar nga Administrata e Komunës së Dardanës në gjuhën serbe (nga zyrtarë shqiptarë). Pra, edhe pas 23 vjetësh të luftës së përbashkët nacionalçlirimtare për çlirim, dhe synimit për vëllazërim-bashkim, regjimi i Jugosllavisë (Serbisë) vazhdonte me asimilimin gjuhësor dhe kombëtar të shqiptarëve.*

Meqë ra fjala e kredisë, më kujtohet rasti kur njëherë shkova në komunë për të kërkuar një kredi studentësh. M'u tha se duhej marrë një vërtetim se nuk kam pasuri, as unë e as babai im, që i nënshtrohet tatimit. U paraqita te referenti Avdyl Jusufi. Dardana ishte një vend i vogël dhe njiheshim pothuajse të gjithë mes vete. Avdylin e njihja personalisht. U angazhua që sa më shpejt të ma jepte atë vërtetim. Madje, më tha të ulesha aty në zyrën e tij dhe të prisja derisa ai ta plotësonte formularin. Isha kureshtar ta shihja se si shkruante me makinë. Mori një formë të formularit, që ishte në shkrimin cirilik, ndërkaq edhe unë, si kërkues, por edhe ai, si referent, ishim shqiptarë. Pastaj filloi të shkruante me makinë në rubrikat përkatëse. Shkruante serbisht, por me shkronja latine. Nuk thashë asgjë, sepse nuk e dija se kush do ta nënshkruante. Por, pas plotësimit të formularit, doli në një zyrë tjetër për ta vërtetuar me nënshkrim të shefit të sektorit të shërbimit të të hyrave.

Pas pak u kthye dhe ma dorëzoi. Edhe shefi ishte shqiptar, Hilmi Taši. Më kapi një sëkëlldi dhe iu drejtova: Avdyl, përse e plotësove formularin serbisht, derisa edhe ti, e edhe shefi jeni shqiptarë. Ai vetëm rrudhi krahët, dhe nuk tha asgjë. Pra, edhe shqiptarët e udhëhiqnin administratën në gjuhën serbishte. Bile, çka më nevríkosi edhe më shumë, shefi e kishte nënshkruar mbiemrin e vet Taši<sup>26</sup>, pra, me shkronjën (sh) serbisht. Ofshava dhe dola jashtë, duke folur vetë më vete, edhe sa shumë punë kemi për të bërë ne shqiptarët që të mendojmë, të shkruajmë e të flasim shqip. "O tempora, o mores" - O kohë, o zakone - m'u kujtua një thënie e Marcus Tullius Cicero (106 - 43 p.e.s.)!

*Të ndalemi pak te gjimnazi. A ka mundësi të japësh një historik të shkurtër të themelimit dhe të punës së gjimnazit?*

**Kema:** Unë nuk jam kompetent për një gjë të tillë, por mund të bëj një përshkrim, bazuar në atë që kam dëgjuar dhe kam përjetuar vetë.

Shkollimi i mesëm në Komunën e Dardanës ka filluar qysh në vitin 1960, me hapjen e një paraleleje të shkollës së mesme bujqësore, të përzier me nxënës shqiptarë e serbë, në kuadër të shkollës së mesme të Gjilanit.

---

<sup>26</sup> *Formulari për konkurrim për bursë.*

Pastaj më 1962/63 hapet një paralele e përzier e shkollës së mesme ekonomike të Gjilanit, ku mësimi kryesisht mbahej në gjuhën serbokroate.

Në vitin 1964, kryetari i Kuvendit të Komunes së Kamenicës së Kosovës, z. Shaban Zeqiri, bazuar në ligjin e shkollimit<sup>27</sup>, kishte nënshkruar vendimin e lëshuar më 17 qershor 1964 nga Këshilli Komunal dhe Këshilli i bashkësive punuese për themelimin e gjimnazit si institucion arsimor i pavarur me seli në Dardanë, me emër “4 korriku”. Me gjasë kjo nuk ishte lejuar, kështu që, me këtë rast ishin themeluar vetëm viti i parë dhe i dytë i gjimnazit në Dardanë, por si paralele të ndara të gjimnazit “Zenel Hajdini” nga Gjilani.

Pas dy vjetëve, që i bie në vitin shkollor 1966/67, për shkak të numrit të madh të nxënësve në Dardanë (130), shkolla amë “Zenel Hajdini” në Gjilan nuk kishte vend për përfshirjen e gjithë këtyre nxënësve, kështu që nxënësit e klasës së tretë vazhduan shkollimin në Dardanë, në gjimnazin “9 Maji”. Kështu, më 1966/67 pavarësohet gjimnazi, ndërsa, në vitin shkollor 1967/68, diplomon brezi i parë i gjimnazit.

Mësimdhënësit e parë shqiptarë që filluan punën në gjimnaz kanë qenë: Muharrem Krasniqi (Fizikë), Halil Dërmaku (Matematikë), Halit Maliqi (Shqip) dhe Jakup Puka (Edukatë fizike). Të gjitha lëndët e tjera mësimore zhvilloheshin në gjuhën serbokroate nga mësimdhënës serbë.


Vlen të theksohet se në vitin shkollor 1967/68 personeli arsimor shqiptar u katërfishua. Në këtë vit punuan 14 profesorë, madje edhe drejtori e sekretari ishin shqiptarë, pra, gjithsej 16 shqiptarë. Natyrisht, në vitet në vijim për paralelet shqipe të gjithë ishin shqiptarë, përveç lëndës serbokroate, ose ndonjëherë gjuha frënge ose latine, që zhvilloheshin në serbisht.

Sa për informacion, në vitin 1963 për herë të parë nis edhe shkollimi fillor në gjuhën shqipe në Dardanë, me ç'rast mësuesi i parë ishte Muharrem Kallaba.

Po ashtu, duhet cekur se në kuadër të gjimnazit “9 Maji” në vitin 1970 hapet paralelja e ndarë fizike në Hogosht, ndërsa nga viti 1979 edhe në Roganë, ish-Rogoçicë.

---

<sup>27</sup> *Vendimi për themelimin e gjimnazit në Dardanë (Rešenje o osnivanju Gimnazije u Kos. Kamenici).*



*Vendimi për hapjen e gjimnazit në Kamenicë, më 1964*

Meqë jemi te historiku i gjimnazit të Dardanës, e si rrjedhojë e demonstratave të pareshtura studentore, dhuna nga regjimi serbosllav në gjimnaz ishte tejte e egër ndaj mësimdhënësve dhe nxënësve shqiptarë.

Ta zëmë, në periudhën 1981-1989, për shkak të diferencimit ideopolitik, janë larguar nga puna 24 mësimdhënës; 22 nxënës janë përjashtuar nga shkolla; 4 profesorë dhe 7 nxënës janë burgosur; 8 profesorë dhe 23 nxënës janë rrahur e janë keqtrajtuar fizikisht; 11 profesorë e 22 nxënës janë marrë në biseda informative, e kështu me radhë.

Më 3 shtator 1990, pas një proteste kundër dhunës serbe, të gjithë mësimdhënësit, por edhe punëtorët e tjerë shqiptarë në organizata të ndryshme janë përjashtuar nga puna, ndërkaq, nxënësit shqiptarë nga objektet shkollore. Edhe në këtë çështje më duhet të rrëfej disa ngjarje të trishtueshme:

Në muajin mars 1990 bëhet helmimi i nxënësve shqiptarë, kur në tërë Kosovën helmohen rreth shtatë mijë nxënës, kurse në gjimnazin e Dardanës, nga helmimi, 45 nxënës/nxënëse patën pësuar trauma të rënda shëndetësore.



Më 1 janar 1991 është ndërprerë financimi i punëtorëve shqiptarë të arsimit shqip;

Më 10 mars 1991 nga regjimi serbosllav vendosen edhe masat e dhunshme në shkollë;

Më 26 gusht 1991 u është ndërprerë marrëdhënia e punës të punësuarve shqiptarë në shkollat shqipe;

Prej 1 shtatorit 1991, pas përjashtimit të mësimdhënësve dhe nxënësve shqiptarë nga objektet shkollore, shqiptarët organizuan mësimin e mëvetësishëm në shtëpitë private.

Në vitin shkollor 1992/93, më 9 maj 1992, gjimnazit iu ndërrua emri, nga “9 Maji” në “Ismail Qemali”. Ky gjimnaz edhe sot e kësaj dite mban këtë emër. (Shënimet e detajuara janë marrë nga Zyra e sekretarit të gjimnazit “Ismail Qemali” në Dardanë.)



*Ekrem Kallaba, kujdestar klase i kl. II4, në vitin shkollor 1969-70 në Dardanë*

*Unë nuk i kërkoja gjithë këto informata kaq të detajuara, pse i rrëfeve me kaq saktësi?*

**Kema:** Vitet 1981/1999 kanë qenë, sa emocionuse, po aq edhe të dhembshme për popullin shqiptar në Kosovë. Por, janë edhe vite kthese në historinë e popullit të Kosovës. Shumica e serbëve që jetonin në Kosovë tashmë kishin humbur arsyen, kështu që tendenca për një bashkëjetesë, ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, që ishte trumbetuar pas Luftës së Dytë Botërore, në emër gjoja të një “vëllazërim-bashkimi”, kishte dështuar tërësisht. Strukturat udhëheqëse serbe ushtronin një hegjemoni të paparë në gjithë ish-Jugosllavinë, sidomos ndaj shqiptarëve. Madje, kur ishte puna te çështja shqiptare, edhe oportunitizmi serb ndëshkohej nga regjimi serb. Ndikim më se të rëndësishëm kishte Kisha Ortodokse Serbe. Ajo vepronte “mbi tokë” e “nën tokë” për të ideuar programe e pogrome kundër shqiptarëve, dhe jo vetëm. Bashkë edhe me politikanë ditorë, por edhe me akademikë eminentë”, me seli në “Francuska 7”, në Beograd, luftonin për çdo pëllëmbë toke të uzurpuar ndër shekuj si dhe synonin uzurpime të reja drejt Adriatikut. Nuk kursenin vende as popuj të ish-Jugosllavisë, që nga Sllovenia e deri në Maqedoni. Megjithatë, kur takoja ndonjë ish-nxënës timin serb ose ndonjë ish-koleg pune, disa syrësh reflektonin po ashtu mospajttime me politikën shtetërore, dhe shprehnin pafuqinë e tyre për ndaljen e këtij hovi hegjemonist. Përvoja shekullore e bashkëjetesës në Kosovë si dhe përparimi internacionalist i individëve shkëndiste një dritë në fund të tunelit, por, siç ma tha njëherë një ish-nxënës - kishte skepticizëm gjithandej: “Kemo, kjo furtunë serbomadhe na përpin edhe serbët e vegjël, qytetarë të ndershëm, që duam ta mbrojmë fqinjin e parë shqiptar. Udhëheqësit politikë dhe ushtarakët qëllimisht krijojnë vetë banda paramilitarësh dhe pastaj arsyetohen kinse u kanë dalë nga kontrolli”, u shpreh Jugosllavi pasi pimë nga nja dy gota raki në lokalin tim.

*Thua që kishte edhe serbë që nuk donin të përfshiheshin në përndjekjet e shqiptarëve nga regjimi serb?*

**Kema:** Për shkak të korrektësisë njerëzore më duhet të them se kishte individë serbë në Komunën e Dardanës që donin ta ruanin bashkëjetesën e ndërtuar për dekada me radhë. Përvoja e tyre historike i kishte mësuar se, prapëseprapë, ata do të duhej të jetonin bashkërisht. Prandaj, ndonjëherë dëgjohej edhe maksima

se “uji ecën, kurse zalli mbetet”, që i bie se politika ndryshon, kurse populli sërish duhet të bashkëjetojë.

*Nejse, le t’ia lëmë këtë historisë. Të kthehemi ku mbetëm. Vazhdove të punosh në Dardanë edhe pas vitit 1968?*

**Kema:** Jo. Në vitin shkollor 1968/69 ishte shpallur një konkurs ku kërkohesh një profesor për lëndën e Marksizmit dhe për disa lëndë të tjera pedagogjike në gjimnazin “Ramiz Sadiku” të Rahovecit. M’u duk disi më atraktive, kështu që konkurrova dhe u pranova. Rahoveci më pëlqente gjithashtu edhe për pozitën e mirë që e kishte për gjueti. Atje shumë shpejt fitova simpatinë e rahovecasve. Nxënësit i mësonin me përkushtim temat që ua shpjegoja. Me mua ishte edhe vëllai im, Xheveti, ku ndiqte klasën e dytë gjimnaz.

*Sa punove në Rahovec?*

**Kema:** Ndodhi një e papritur. Zyra e Shërbimit Ushtarak në Dardanë më kishte dërguar një ftesë, me të cilën ftohesha me urgjencë që të shkoja në shërbim ushtarak. Provova ta shtyja për ndonjë afat tjetër, por ishte e kotë. Zyrtarët respektivë nuk patën konsideratë për kërkesën që ta shtyja, kështu që, me procedurë të shpejtë, shkova ushtar në një kazermë, në Muçiqi të Rijekës.



*Nxënës te Ekremit në Rahovec. Nga e majta: Avdi Gashi, Hysen Duraku, Hashim Zeka, Emin Kabashi*

*Çka ndodhi me Xhevdetin? Mbeti vetë në Rahovec?*

**Kema:** Po, ai pati mbetur vetë në Rahovec. Çka ishte më keq, në banesë ishte edhe pushka ime e gjuetisë e tipit “Bokericë” ruse. Disa ditë më vonë, kishte shkuar sekretari i shkollës Todor Krstiq për ta marrë pushkën që ta dorëzonte në milici, por Xhevdeti nuk ia kishte dhënë. Më pas, zyrtarë të Stacionit të Milicisë në Rahovec, kishin shkuar në banesë dhe e kishin konfiskuar armën. Të nesërmen Xhevdeti ishte paraqitur te një milic me prejardhje nga Dardana, Gani Jerliu, i cili e kishte udhëzuar Xhevdetin që të paraqitej babai dhe ta merrte pushkën. Ashtu edhe kishte ndodhur. Më 7 dhjetor 1968, babai shkon në Stacionin e Milicisë në Rahovec dhe, nga punëtori i atyshëm, Ahmet Dema, pranon pushkën e gjuetisë, “Bokericë ruse”, me dy tyta të kalibrit 12 mm, me numër KX 5145, të cilën e merr me vete në shtëpi.

*Pastaj, si rrodhi ngjarja?*

**Kema:** Unë nuk kisha vullnet të shërbeja në Armatën Jugosllave, kështu që simulova një paaftësi për shërbim dhe brenda 43 ditësh u lirova “përkohësisht i paaftë për shërbim ushtarak”. Ndërkohë Xhevdeti ishte kthyer në Dardanë për ta vazhduar klasën e dytë.

*E ti, vazhdove më pas në Rahovec?*

**Kema:** Në mungesën time, gjimnazi kishte pranuar një profesor të filozofisë, mirëpo ai kishte dorëzuar një diplomë false dhe natyrisht edhe lëndët nuk kishte arritur t’i shpjegonte fare. Kështu, drejtorja e shkollës shpejt e vëren dhe e largon atë nga procesi arsimor. Drejtori, Hasan Sharku, që kishte një respekt të madh ndaj meje dhe punës sime, më ftoi për të vazhduar mësimdhënien në gjimnazin “Ramiz Sadiku” të Rahovecit. Ashtu dhe ndodhi. E, me mua, sërish erdhi edhe Xhevdeti.


*Vazhdove edhe më tutje, pas atij viti shkollor, në Rahovec?*

**Kema:** Jo, në periudhën pasuese 1969 -1971 punova sërish në gjimnazin “9 Maji” në Dardanë. Ishte kënaqësi të punoje në një kolektiv ku kishte filluar gjithçka të frymonte shqip. Ishim rreth 20 profesorë shqiptarë. Imagjino, një kohë jepja mësim edhe në paralelet serbe, sepse ata kishin nxënës, por u mungonte kuadri. Dhjetë vjet më parë ishte krejt e kundërta. Mësimi zhvillohej vetëm serbisht, ndërsa shqiptarët ishin pjesë e klasave me mësim në gjuhën serbishte.

*Pate mundësi të ligjëroje edhe në gjuhën serbe, njihje mjaftueshëm gjuhën serbe?*

**Kema:** Patjetër. Fillimisht, edhe në shkollë të mesme, por edhe në fakultet, gjithë materialin mësimor e kisha përgatitur në serbisht, ngase material në gjuhën shqipe nuk kishim, përveç lëndës - Gjuhë amtare. Marrja e materialit mësimor nga Shqipëria ishte plotësisht e ndaluar. Ajo që më pëlqente në gjimnazin e Dardanës ishte fakti se shumica e profesorëve, pak a shumë, ishim të një brezi dhe shumë të lidhur mes vete. Kjo u pengonte udhëheqësve komunalë, sidomos për faktin se demonstratat e vitit 1968 kishin prodhuar shumë frymë kombëtare të shqiptarët, në veçanti të shtresa intelektuale. Ishte një zgjim shekullor i shqiptarëve. Familjet shqiptare bënë çmos vetëm e vetëm që fëmijët e tyre të shkolloheshin. Disa shisnin edhe tokë, të tjerë kishin marrë rrugën e kurbetit për ta ndihmuar ndonjë fëmijë, vëlla ose motër që të shkollohej.

Kjo frymë e re e këtij entuziazmi, sidomos në fushën e arsimit shqip, kishte vënë në lëvizje shumë mekanizma të politikës antishqiptare. Ndërkaq, duke pasur parasysh edhe masën e madhe të të interesuarve shqiptarë për arsimin, lindi nevoja edhe për ndërtimin e objekteve të reja shkollore. Së shpejti, në Dardanë u ndërtua objekti i ri, ku brezi i vitit shkollor 1970/71 kaloi në godinën e re.



Fletore e Ekremit me materialin e përgatitur në gjuhën serbe, i cili më pas është përkthyer dhe u është shpjeguar nxënësve shqiptarë në shqip

*Kush e drejtonte kolektivin, pra, kush qe drejtor shkollë?*

**Kema:** Qysh prej 1 shtatorit të vitit 1967 drejtor i gjimnazit “9 Maji” ishte Mehmet Surdulli.

*Pranonin profesorët serbë të udhëhiqeshin nga një shqiptar, meqë udhëheqësit emëroheshin nga Komiteti, apo mendonin se Mehmet Surdulli do të luante lojën e tyre?*

**Kema:** Mehmeti kishte studiuar gjuhën shqipe në Beograd; nga mesi i viteve ‘60 e kishin larguar dhunshëm nga procesi arsimor në Gjilan. Më vonë pati gjetur punë në Rahovec e në Gjakovë. Njëfarë dore ishte “regjur” dhe, duke e njohur mirë politikën arsimore të Jugosllavisë dhe nevojat e arsimit në Kosovë, për atë kohë, në Dardanë ishte njeriu më i duhur dhe harmonizonte shumë mirë proceset mësimore. Pastaj edhe demonstratat e 68-tës liruan paksa “lakun





*Prof. Mehmet Surdulli, drejtor i gjimnazit „9 Maji” në Dardanë*

serb” nga qafa e shqiptarëve. Shpresoj që për kontributin menaxherial dhe intelektual të Mehmet Surdullit do të shkruhet një libër i veçantë! Është obligim moral i gjimnazit “Ismail Qemali”.

*Po ti, çfarë ligjëroje në shkollë?*

**Kema:** Unë ligjëroja te paralelet shqipe dhe te disa paralele serbe lëndën e filozofisë, psikologjisë, logjikës dhe të sociologjisë.

*Kishte mjaftueshëm mësimdhënës shqiptarë për të gjitha lëndët mësimore në paralelet shqipe?*

**Kema:** Tashmë kishte ndryshuar dukshëm raporti i mësimdhënësve. Derisa në fillim të punës së gjimnazit të Dardanës (1964/65), te paralelet shqiptare ligjëronin shumë mësimdhënës serbë, në gjuhën serbe, tani kryesisht lëndët mësimore ligjëroheshin në gjuhën shqipe, përjashtoj ndonjëherë, përkohësisht, gjuhën frënge ose latine. Mund të them se ishte një përparim i dukshëm dhe pritej edhe më shumë, sepse universiteti i sapohapur, flas për vitin 1970, ishte në vllugun e nxjerrjes së profesorëve për të gjitha lëndët përkatëse mësimore, për shkollat të mesme.

*Megjithatë, zhvillimet politike nuk ishin në favor të mjaftueshëm për shqiptarët. Gjithçka që ishte me interes kombëtar, u nënshtrohej mekanizmave mbikëqyrës serbë. Sa ishit të përkushtuar në arsim, përveç mësimdhënies, a ishit të angazhuar edhe në ndonjë aktivitet politik legal ose ilegal?*

**Kema:** Është një pyetje paksa komplekse, kështu që edhe përgjigjja kërkon një sqarim më të stërholluar. Jo vetëm në Dardanë, por gjithandej Kosovës populli nuk mjaftohej me çlirimin e “lakut” nga qafa. Ne synonim një trajtim të barabartë në të gjitha fushat e jetës, si për serbët ashtu edhe për shqiptarët. Çështje e vërteta, ne ishim mbi 80%, kurse serbët vazhdimisht na trajtonin si qytetarë të rendit të dytë, gjithmonë duke u mbështetur në privilegjet që i gëzonin si qytetarë serbë. Prandaj, në Kosovë kishte një numër shqiptarësh që ishin të përбетuar të sakrifkoheshin për krijimin e kushteve të barabarta me popullin serb. Kështu, njerëzit si Metush Krasniqi, Adem Demaçi e të tjerë, më shumë mbaheshin dhunshëm në burgje sesa jetonin të lirë.

*Po ju, a ishit në shënjestër për punën që bënit?*

**Kema:** Regjimi kishte njerëzit e vet gjithandej. Ne ishim të vetëdijshëm për rolin që kishim si mësimdhënës. Përgjithësisht, vetëdija për një barabarësi ishte pjekur dukshëm, madje edhe tek ata që punonin në institucione të ndryshme komunale. Ne, një grup, ishim dhënë pas lojës së letrave, për çka merrja kritika të vazhdueshme nga babai im. Ai thoshte që kjo plejadë arsimtarësh nuk ka kohë për të humbur në letra e shah, përveç lojës sa për argëtim. Në fakt babai kishte të drejtë, sepse nga pak edhe e tepronim, saqë pothuajse na ishte bërë ves. Mirëpo, në këtë të keqe pati një të mirë. Regjimi nuk kishte alibi të na ndiqte për ndonjë veprimtari ilegale politike, përndryshe do të na largonin nga procesi mësimor. Pra, nxënësit merrnin në plotni programin sipas planit.

*Mendon se ky veprim ju arsyeton para brezave të ardhshëm, sepse shumë të tjerë kalbeshin burgjeve, ndërkaq ju luanit letra e shah. A s'është ky një lëndim kombëtar për veprimtarët politikë shqiptarë?*

**Kema:** Pajtohem me këtë “qortim” tëndin, por ideali ynë, megjithatë, ishte arsimimi i nxënësve dhe në ndeja të tilla trajtonim edhe tema të “nxeha” atdhetarie, që lidheshin me edukimin dhe me atdhedashurinë. Dhe, në këtë çështje ishim në rregull, madje edhe merrnim lëvdata.

*Si është e mundur? Ma thua një shembull!*

**Kema:** Po, ta zëmë në disa gara kuizi, nga fusha e Filozofisë dhe e Marksizmit, si dhe nga gjuha shqipe dhe muzika, e, që transmetoheshin dhe organizoheshin nga Radiotelevizioni i Prishtinës, nxënësit e mi, nga gjimnazi i Dardanës, zunë vendin e parë në shkallë Kosove. Dhe ky sukses u arrit pikërisht në prag të demonstratave të 1 e 2 prillit 1981.

*Nuk e di nëse është arsyetim i mjaftueshëm, por të shpresoj që brezat e ardhshëm të kenë mirëkuptim dhe t’ju kuptojnë më drejt. Ke edhe ndonjë atu që shpie në “falje”?*


**Kema:** Me modesti po e jap edhe një shembull. Më ka ndodhur, me vetëdije, natyrisht, që në ditarin e mësimit ta shkruaj njësinë mësimore ku është dashur të flas për “personalitetin e Titos”, kurse nxënësve u kam shpjeguar për “personalitetin e Ismail Qemalit”, dhe jo vetëm kaq, dhe jo vetëm unë, por shumica prej mësimdhënësve nxënësit i kemi mësuar dhe i kemi edukuar në frymën atdhetare, pa dyshim. Pastaj kemi pasur nxënës, prindërit e të cilëve kanë mbajtur poste politike, por ne i kemi trajtuar njësoj, saqë nga ato ose ata kemi bërë atdhetare e atdhetarë të devotshëm.

*Ke pasur pasoja për veprime të tilla?*

**Kema:** Po, si jo. Po kthehem disa vjet prapa. Si pasojë e veprimeve të tilla, në vitet 1972-1975 u detyrova ta lëshoja Dardanën e të punoja në Bujanoc. Këtë ma pati mundësuar drejtori i atëhershëm i gjimnazit të atjeshëm z. Mejdi Hyseni. Pastaj, nga viti 1977-1979 kam punuar përkthyes në Ndërmarrjen “Magnohrom” të Dardanës, ngase isha i larguar me dhunë nga arsimi, me dekret të Komitetit Komunal të Dardanës.

*Ç'vend kanë nxënësit në shpirtin dhe ndërgjegjen tënde?*

**Kema:** Duke u nisur nga bindja se nga mesi i atyre nxënësve do të dalin profesorë, mjekë, avokatë dhe burra shtetërorë, jam munduar që të mos përdor asnjë fjalë që fyen personalitetin e tyre. Pra, për secilin kam pasur respekt dhe konsideratë intelektuale. Sikur të më mundësohej edhe një jetë, do të bëhesha sërisht mësimdhënës, mbase edhe më i përkryer.



*Raporti ndaj nxënësve – një qasje filozofike e profesor Ekrem Kallabës, që do të vlente për të gjithë mësimdhënësit e të gjitha niveleve*

*Po shihet se babai ka qenë goxha i rreptë, duke i luftuar dukuritë negative të pedagogëve. Të ka qortuar edhe për diçka tjetër?*

**Kema:** Më duhet të jem i sinqertë. Ai gjithmonë kishte të drejtë. Asnjëherë nuk kritikonte pa arsye, por unë dhe shumë kolegë të tjerë ishim të rinj dhe sikur na mashtronte lakmia për letra, për ndeja në hotele, ose edhe për ndonjë veprim tjetër të moshës rinore. Meqë ra fjala, po e shpjegoj një rast kur babai im e kishte angazhuar axhën tim, Fehmiun, që të ndikonte tek unë që të largohesha nga rakia dhe jeta e natës nëpër kafene. Ndodhte që shpesh të shkoja në shtëpi ose në banesë të dehur nga rakia. Kjo e mundonte babanë, sepse ishte një njeri me autoritet, jo që vetë nuk e konsumonte alkoolin, por, dorën në zemër, ishte

shumë i matur, si me familjarë, ashtu edhe me bashkëfshatarë dhe kolegë ku punonte. Në një mbrëmje, derisa unë po pija raki në hotelin “Mineral” në Dardanë, rreth orës 21:00 e vëreja se në derë të restorantit u shfaq axha im, baca Fehmi. Për disa çaste u ndal te dera dhe po sodiste mysafirët në të gjitha tavolinat. Afër banakut ishte një grup muzikor dhe një këngëtare që këndonte herë shqip e herë serbisht, e, madje, herë pas here e përsëriste edhe këngën “Çajorije - shukarije” në gjuhën rome.

Vështrimi i bacës Fehmi arriti në tavolinën time. Isha vetë në tavolinën përplot meze dhe një shishe raki kumbulle. Sapo erdhi pranë tavolinës sime, u çova dhe ia ofrova një karrige që të ulej. Gjuha tashmë kishte filluar të më trashej, por nuk isha i dehur. E shërbeva me dy cigare përnjëherë dhe për vete nxora një nga pakoja e “Bozhurit”, të cilën e ndeza nga cigarja që isha duke e pirë. Pothuajse gjatë gjithë mbrëmjes nuk më nevojitej fare shkrepësja, sepse cigaret “i saldoja” njërën me tjetrën.



*Fehmi Kallaba, fëmija i pestë  
(nga njëmbëdhjetë) i Hafëz  
Shefki Kallabës (12.3.1923 -  
17.2.2006)*

Baca Fehmi e ndezi një cigare dhe m'u drejtua. “Ekrem, qe tri ditë nuk ke qenë në shtëpi dhe Tefiku është shqetësuar për ty. I kanë treguar se po konsumon shumë alkool dhe kjo po e brengos babain tënd. Në ma paç hatrin, çohu e shkojmë”. Po, baca Fehmi, i thashë, dhe për një çast kamerierja u afrua te tavolina. – Sillja një gotë, se edhe ky është mjeshtër i rakisë, - i thashë. Pas pak ia mbusha një gotë raki dhe i cakërruam gotat. Baca Fehmi, duke u përpjekur që të më merrte me të mirë, m'u drejtua: “Hajde, gëzuar, Ekrem, se ai që pi raki, nuk mendon keq për shoqni”. Dhe, kështu i cakërruam gotat për disa orë rresht,

derisa u bëmë tapë që të dy. E di se në orët e hershme të mëngjesit, një taksist na ka çuar në Koretin. Kemi hyrë në Odë dhe nuk më kujtohet asgjë deri nga ora 11:00 e ditës. Disi si përgjumshëm më kujtohet, kur aga e ka hapur derën dhe ka thënë: Eh, more Fehmi, unë të çova me marrë Ekremin, e ti qenkëshe bërë më “duduk” se ai.

Baca Fehmi kishte shumë respekt ndaj babait tim, ani se ishte vetëm gjashtë muaj më i vogël se ai (ishin vëllezër prej dy nënash). Kur u kthjellëm paksa, ishte bërë edhe koha e drekës. Aga, para racionit të drekës, gjithmonë e pinte nga një gotë raki “Mastika” për shkak të dhembjes së lukthit. Na ofroi edhe neve nga një gotë, por ne refuzuam. Madje, baca Fehmi tha: Tefik, na për sot e kemi mbushur kupën. Nuk tha asgjë, sikur deshi që qortimi i tij për mbrëmjen e kaluar të jetë vetë heshtja e tij. Në fakt, kjo metodë edhe filloi të funksiononte. Mora një vendim të prerë që alkoolin të mos e përdor më fare. Ishte një vendim i rëndë, por e fitova betejën kundër rakisë. Disa vjet me radhë nuk kam pirë fare raki.

*Të kthehemi tek arsimi. E praktikoje arsimin si pasion apo si mision?*

**Kema:** Edhe njërën, edhe tjetrën, gjithsesi. Si pasion, ngase isha i profesionalizuar, kurse si mision, ngase, përveç babait tim, gjithmonë e kisha parasysh edhe mësuesin dhe patriotin e paepur Metush Krasniqin.

Mburresha me përkushtimin e mësuesit Metush, me të cilin takohesha shpesh dhe diskutonim gjerësisht për rolin e arsimimit të popullit shqiptar në Kosovë.

Kur futeshe me Metushin në bisedë rreth arsimit ora të bëhej minutë, kurse entuziazmi për kontribut në arsim shtohet në maksimum. Ai jepte shembuj të pafund për nevojën e arsimimit të shqiptarëve të Kosovës. Vlerësonte lart intelektualët dhe arsimdashësit në përgjithësi, që punonin me vetëmohim në këtë drejtim. Ishte i mprehtë në vlerësim; veçonte aty-këtu edhe rolin e disa hoxhallarëve, të cilët në formën e tyre luftonin analfabetizmin në Anamoravë, por edhe kritikonte mjaft prej tyre që nuk ishin në nivel të detyrës. Tregonte se si, bashkë me Sejdi Kryeziun, shpesh e vizitonin Hafëz Shefki Kallabën, pra, gjyshin tim. Ata dhe konsultoheshin për shumë çështje të rëndësishme me gjyshin. Kishte një respekt të veçantë për Hafëz Kallabën si arsimdashës dhe patriot i flaktë.





*Metush Krasniqi, mësues dhe atdhetar  
model i Ekremit*

Baca Metush pati rrëfyer edhe për një rast kur ishte në burg, ku sillnin shumë dëshmitarë, ndonjëherë edhe të kërcënuar, që rëndonin akuzën për të, e që Metushi i mohonte si të pavërteta, qofshin ato edhe nga të afërm të tij. Mirëpo, kur njëherë kishte kuptuar se në ballafaqim do t'ia sillnin Hafëz Kallabën, Metushi në vete kishte vendosur që të pranonte atë që do ta dëshmonte axha Hafëz, siç e quante ai, sepse kishte një respekt të jashtëzakonshëm, dhe nuk mund t'ia kthente fjalën, qoftë edhe nëse do t'i kushtonte disa vjet burg. “Por, kur erdhi axha Hafëz në ballafaqim, me një gjuhë diplomatike tejkaloi

realitetin e bisedës sime dhe gjithë bisedën time e nxori në terren tjetër, duke thënë se unë gjoja brengosesha për kritikën që Kina e Shqipëria po ia bënin Jugosllavisë për mbylljen e shkollave shqipe në Kosovë, dhe se ai nuk i kishte kushtuar shumë kujdes bisedës sime. Lum ne që e kishim në atë kohë një njeri të mençur si axhën Hafëz. Të them të drejtën, kjo mençuri e axhës Hafëz më dha edhe më shumë forcë, dhe se për të tjerët nuk mërzhitesha se sa do të më rëndonin me akuza. Axhën Hafëz e nxorën jashtë sallës paksa me përbuzje për shmangien nga realiteti”, pati rrëfyer njëherë patrioti i madh Metush Krasniqi.

*Të kujtohet ndonjë episod tjetër i bisedës me Metush Krasniqin?*

**Kema:** Për bacë Metushin mund të flitet shumë. Besoj historianët do të shkruajnë libra të tërë për veprimtarinë e tij, porse unë mund të shkëpus vetëm disa fragmente që lidhen me edukimin tim dhe ndikimin e tij atdhetar tek unë. Tani po shkëpus edhe një detaj. Ai këmbëngulte për investim në arsimim, sepse “vetëm të arsimuar mund ta ruajmë vendin, ndryshe do të na dëbojnë çdo brez”, thoshte ai, dhe vajtonte gjithë ato shpërngulje gjatë shekujve. Madje, mbaj mend edhe një thënie të tij, që më vonë e vargova kështu:

*- Kur dëgjoja se ndokush është shpërngulur  
sytë më mbusheshin me lot  
buzët më mbusheshin shkrumb  
e, nga zjarrmia, edhe gjoksi më gufonte si vullkan.*

Natyrisht, kam edhe shumë e shumë kujtime për idhullin tim prej arsimitari dhe atdhetari, Metush Krasniqin.

Në vazhdim, ja edhe një fragment që flet për modestinë e tij.

Një ditë të acartë dhjetori e vizitova në Dajkoc. Ishte pasdite e hershme. Nuk parapëlqeja ta vizitoja natën, sepse i binte se po frikësohem, ngase ai ishte vazhdimisht në vëzhgim të UDB-së. Më tha se nesër do të shkonte për Prishtinë.

- Aha, edhe unë kam për të shkuar nesër për Prishtinë dhe vij të marr e shkojmë bashkë, edhe pse nuk e kisha në plan të shkoja, por ja që doja ta nderoja.  
- Jo, Ekrem, nuk dua të të bëj telashe, ma ktheu. - Jo, jo, mos u brengos për mua, fundja të kam pasur mësues, të kam shok edhe timin, edhe të babait tim.

Nejse, të nesërmen në mëngjes u “vizatova” para dyerve të shtëpisë, në Dajkoc. Doli te kapixhiku dhe për një moment u ndal, kishte për të marrë edhe diçka. Dhe, po në atë moment në kapixhik u shfaq edhe tezja Havishë, bashkëshortja e tij, me çantën e tij në dorë. E mori dhe u nisëm. Pas nja 300 metrash ishte lumi i Hogoshtit, i thoshim, ani pse rrjedhës teposhtë bashkohej edhe me atë të Desivojcës. I tëri ishte i mbuluar me akull. Kur erdha në Dajkoc, nuk pata vështirësi për ta kaluar, por tani, si për sherr, në mes të lumit, makina m’u ndal. Hyra me shpejtësi dhe me gjasë iu lagën kandelat.

- Dhe tash, çfarë të bëjmë?! - tha Metushi.

- Asgjë, ia ktheva.

- Po dal ta shtyj pakëz, sa për të dalë nga lumi.

- E, more Ekrem, aty ku mund të ketë rrezik, nuk hyhet shpejt si pa krye, sepse bie në grackë, i dha një humor me porosi kësaj situatë. Zbatha këpucët e çorapët dhe hyra në lumë për ta shtyrë pakëz makinën “Fiat 132”. Makina ishte e rëndë dhe ishte vështirë të lëvizet. U ndjeva shumë keq, kur pashë se edhe baca Metush kishte dalë nga makina. Filluam ta shtynim bashkërisht. Uji ishte i ftohtë akull. Vetëm në atë pjesë ku e kalonim lumin shihej uji, përndryshe pjesa tjetër e lumit ishte e mbuluar

me akull. Së shpejti ndjeva një mpirje këmbësh dhe u futa për një moment brenda në makinë, ndërkaq baca Metush qëndronte në ujë, sikur të ishte muaji maj. E luta që të hynte brenda dhe të ngrohej pak. “Jo, jo, provo ta ndezësh se këto këmbët e mia janë kalitur burgjeve me këso lloj temperaturash”, më tha.

Kishin kaluar rreth 20 minuta. I nxora kandelat dhe i pastrova, ndërsa ai ende vazhdonte të qëndronte në ujë.

Hyr brenda, i thashë, se tani do të provoj ta nis. Dhe, për fatin tonë, pas pastrimit të kandelave makina u nis. – Sa i madh është ky njeri, murmurita vetë me vete, ndërkohë që mallkova veten për këtë pakujdesi në kalimin e lumit. Ishte tepër inteligjent. Ishte i bindur se unë nuk kisha planifikuar përpara të shkoja në Prishtinë, porse këtë po e bëja vetëm për ta nderuar. Kur arritëm afër Crepit, m’u drejtua: Ekrem, ndale makinën në Crep dhe ti shko për Dardanë, sepse ke mësim, e unë do të vazhdoj me ndonjë autobus.

Në fakt, kështu edhe ishte, por i thashë: - jo, jo sot e kam të lirë, prandaj po shkojmë bashkë për Prishtinë.

Ashtu edhe u bë.

E shoqërova deri te Fakulteti Teknik dhe u ktheva menjëherë për Dardanë. Mezi zura orën e gjashtë dhe mësimin e pasdites. Orën e katërt dhe të pestë të paradites i zëvendësova një ditë tjetër.

“ Po të ishte gjallë Metush Krasniqi, ende do të ishte në burg si shenjë pakënaqësie me politikëbërjen. ”

*Ekrem Kallaba*

*Çka do të veçoje edhe diçka nga puna e brezit tënd në arsim?*

**Kema:** Ka shumë gjëra me të cilat mund të krenohemi, por po e marr një veprim që ishte me vend dhe i dobishëm për kohën.

Në fillim të viteve ‘70, për mungesë financash, shumë zyrtarë shqiptarë të

administratës komunale nuk kishin arritur ta përfundonin shkollimin e mesëm në kohë të rregullt, e me ç'rast u rrezikoheshin vendet e tyre të punës, të cilët shpejt mund të zëvendësoheshin nga punëtorë të nacionalitetit serb. Dhe, ne organizonim provime private. Kështu për një hark kohor prej tre-katër vjetësh arritëm t'i kualifikonim të gjithë ata zyrtarë, që me të ardhurat e tyre mbanin familjet dhe, fundja, nuk kishin nevojë të emigronin.

*Si shkoi puna me mësimdhënie, a u ktheve sërish në arsim?*

**Kema:** Kishin kaluar disa vite që kisha mbaruar provimet në Degën e Pedagogjisë pranë Fakultetit Filozofik në Prishtinë, përveç lëndës Histori e Pedagogjisë te profesori Jashar Rexhepagiq, me të cilin isha ngatërruar gjatë një kundërshtimi profesional. Ishte ndër i ofenduar dhe nuk më kalonte në provim, sidomos në pjesën gojore. Në fakt ai parapëlqente guximin tim qytetar dhe studentor, porse ishte inatosur tej mase në mua. Meqë unë, disa herë, provimin e kaloja me shkrim, por që nuk doja të përgjigjesha me gojë, atëherë kaluan shumë afate dhe nuk e paraqitja këtë provim. Dikur, kur diploma ishte e domosdoshme për pranim në punë, kërkova mundësinë që përmes një komisioni të veçantë t'i nënshtroheshja provimit, madje vetëm me shkrim. Kështu edhe u bë, dhe në rastin e parë që hyra në provim, përgjigjen e përgatita në më shumë se dhjetë faqe të formatit A4. Pra, në afatin e qershorit 1979 kalova provimin, me çka dhe, më 22-23 qershor 1979 përfundova shkallën e dytë në Degën e Pedagogjisë, të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Në konkursin e radhës, në gjimnazin e Dardanës, konkurrova dhe me vendim të Drejtorisë së Arsimit në Dardanë, nga 1 shtatori 1979 u pranova profesor i lëndës “Bazat e Marksizmit dhe Socializmit Vetëqeverisës” në QAMO (Qendra e Arsimit të Mesëm të Orientuar) “9 Maji” në Dardanë.

*Kishe ndonjë trajtim më të veçantë tani si i diplomuar?*

**Kema:** Jo, kjo nuk diskutohet. Diploma ishte vetëm një formalitet administrativ, ndërkaq unë isha po i njëjti; nuk kisha as më pak e as më shumë njohuri sesa para dy vjetësh. Çështje e vërteta, arsimin e adhuroja shumë. Falë familjes dhe njerëzve me të cilët rrethoheshja, sikur kisha edhe një obligim moral e patriotik

në ngritjen e nivelit arsimor në rrethin ku jetoja. Për shqiptarët në Kosovë, por edhe më gjerë, arsimi ishte arma më e fortë që i duhej këtij populli për ta zhdukur armikun shekullor – analfabetizmin.

*Shihet se arsimimin e nxënësve e keni pasur prioritet të prioriteteve. Cili ishte motivi dhe synimi juaj, si individë dhe si brez?*

**Kema:** Fare i qartë, synimi ynë ishte dalja nga robërimi shekullor nga turqit e serbët, si dhe çlirimi nga përpjekjet e tyre të vazhdueshme për asimilim dhe humbjen e identitetit tonë. Pastaj kishim edhe modelin e rilindësve shqiptarë, si: Naimin, Samiun, Çajupin, Kristoforidhin, motrat Qiriazi, Mjedën, Fishtën e shumë të tjerë, të cilët, edhe pse të penguar në përhapjen e arsimit shqip, ata nuk u ndalën së punuari. Mandej ishte mjaft brengosës fakti se një kategori e njerëzve, si rrjedhojë e paditurisë, lehtë binin në kurthe të regjimit. Ata mashtroheshin me karremin e vëllazërim-bashkimit të lancuar nga Lidhja Socialiste. Thënë realisht, ata ishin edhe pre e mendimit vetjak pozitiv për një të ardhme më të mirë. Mirëpo, kështu mendonin vetëm shqiptarët, kurse serbët bënë prapaskena, dhe çdo përpjekje për avancim kombëtar shqiptar e bllokuan ose e sabotuan në forma të ndryshme.

Njerëzit e regjimit, shpesh edhe shqiptarë, për një post ose ndonjë privilegj tjetër, spiunonin, e hera-herës edhe shantazhonin patriotët largpamës, sidomos njerëzit e arsimit nivelesh të ndryshme, që nga arsimi fillor deri tek akademikët. Kjo bënte që shumë energji të harxhohej duke u marrë me vetveten, domethënë me njëri-tjetrin. Prandaj, misioni i mësimdhënësit të fundshekullit të njëzetë ishte vijimësi e angazhimit të rilindësve të fundshekullit të nëntëmbëdhjetë. Në këtë vijë isha plotësisht i vetëdijshëm për rolin tim në arsim. Ndaj edhe isha i përkushtuar me tërë qenien time shpirtërore për arsimin.

Më kujtohet një rast gjatë punës në Desivojcë, kur me planprogram kisha për t'u shpjeguar nxënësve për jetën dhe veprën e Naim Frashërit. Aq mirë qeshë përgatitur, sa që nxënësit fituan përshtypjen se Naim Frashëri është aty diku pranë, në shkollë, dhe se “Bagëti e Bujqësia” ishte vetë fshati Desivojcë, me peizazhet e tij të bukura. Fundja, arsimimi është pjesë e zhvillimit të njerëzimit. Një botë e arsimuar dhe e qytetëruar reflekton një jetë më të shëndoshë e më të rehatshme për njerëzimin.

*Kishte aq shumë brumë për rilindësit në librat shkollorë?*

**Kema:** Natyrisht që në librat shkollorë rilindësit paraqiteshin në një version të shkurtuar, varësisht prej moshës së nxënësve. Për këtë më duhet të them se kishte edhe pak vetëcensurë nga përpiluesit e programeve mësimore. Mirëpo, unë hulumtoja materiale shtesë. Besa u jepja edhe shënime dhe gjatë diktimit më ndodhte në ndonjë fjali të përmendja edhe ndonjë presje. Po e cek këtë “presjen”, sepse nxënësit e “përpinin” gjithë mësimin, thuajse e mësonin përmendësh. Ishin të uritur për dije dhe kur përsërisnin njësinë mësimore ndodhte që ndonjëri ta shpjegonte mësimin dhe ta përmendte edhe “presjen”, që e kisha diktuar, krejt kjo për të më dëshmuar se me çfarë vullneti mësonin.

Në Desivojcë nxënësit ishin të shkëlqyeshëm. Kam punuar edhe me dekada të tëra më vonë, në shkolla të ndryshme gjithandej Kosovës, por sikur ata të Desivojcës rrallë kam hasur. Mbase ka ndikuar edhe fakti se unë isha për herë të parë me ditar në atë fshat dhe jepja maksimumin nga vetja, mirëpo edhe tek ata shihja frymëzimin e pashoq.

*Ishte brezi i parë apo shkolla kishte filluar më herët, në Desivojcë?*

**Kema:** Jo, jo, frymëzimin e gjeta aty, nuk ua solla unë. Nga ajo shkollë tashmë kishin dalë një numër i konsiderueshëm intelektualësh, siç ishin vëllezërit Mehmet e Izet Surdulli, Faik Shkodra, Sadri Shkodra, Rexhep Shkodra, Sherif Daku, Islam Daku e shumë të tjerë, që, më vonë, bënë tituj të lartë shkencorë. Mirëpo, periudha kur unë punova përfshinte numër shumë më të madh nxënësish, jo vetëm nga Desivojca, por edhe nga fshatrat dhe lagjet përreth. Ta zëmë, Nazim Qehaja dhe Nazif Selishta udhëtonin disa orë në ditë që të vinin nga Krenidelli në Desivojcë, e mos të flas për fshatrat Vriçec, Velegllavë, Poliçkë etj., që ishin më afër.

Është interesant se frytet e mia të investimit në shkollimin e nxënësve në Desivojcë i korra më vonë, në shkollën e mesme në Dardanë, në vitet 1967 - 1971. Shumë nxënës ishin regjistruar në gjimnazin e Dardanës dhe ata u dëshmuar edhe më tutje me entuziazmin e tyre për nxënie. Ishin të zellshëm dhe të shkëlqyeshëm në gjimnaz, p.sh. Zymber Beshtica, Haqif Surdulli, Shaban



Shkodra, Hasan Daku, Metush Shkodra, Sabit Shkodra, Gani Shkodra, Fehmi Bunjaku etj.

*Regjimi i kohës e kishte vërejtur këtë entuziazëm dhe synim tuajin, prandaj kishte marrë edhe hapat e pengimit, përjashtimin nga procesi mësimor. Pse ndodhi kështu?*

**Kema:** Po, sigurisht. Demonstratat e vitit 1981 shtuan edhe më tej dëshirën për arsim dhe mëvetësi e pavarësi, jo vetëm te nxënësit, por edhe tek arsimtarët. Kështu, shumë prej nesh ishim në shënjestër të “kujdestarëve” serbë dhe proserbë. Metodat provokuese ishin të shumëllojshme. Ata që nuk ishim në Lidhjen Komuniste kërcënoheshim me humbje të vendit të punës, kurse ata që ishin në LK kërcënoheshin me bashkëpunim në gjetjen e elementëve “nacionalistë” ose “irredentistë”, siç i quanin atëherë. Përmes njerëzve të vet shkruanin ndonjë parullë të tipit K.R. (Kosova Republikë) dhe pastaj torturonin nxënësit dhe arsimtarët. Filluan edhe me një fushatë të egër diferencimi dhe keqtrajtimi. Merrnin nxënës në Sekretariatit e Punëve të Brendshme dhe i keqtrajtonin psikikisht dhe fizikisht, ndërsa, profesorët i akuzonin për mashtrim dhe indoktrinim të nxënësve. Kështu fushnin edhe një urrejtje ndër profesorë, duke i etiketuar si shqiptarë “të ndershëm” dhe “të pandershëm”.

*Po ju, mësimdhënësit, si reagonit? Kishte ndokush guximin qytetar që t’u kundërvihet?*

**Kema:** Si të them, reagimi kishte edhe koston e vet, prandaj jo edhe secili merrte guximin të reagonte. Ishte viti shkollor 1981/82. Organet e Sigurimit të Brendshëm keqtrajtonin nxënësit tanë, por nuk kursenin as personelin arsimor. Sidoqoftë, ne ndiheshim edhe si prindër të nxënësve, prandaj në një mbledhje të Këshillit të Arsimtarëve bëra një reagim, madje, meqë në kolektiv kishte edhe profesorë serbë, vendosa që kundërshtimin ta shprehja në serbisht.

Thashë se kjo mënyrë e veprimit të njerëzve të Sigurimit nuk na shpie askund dhe se këto metoda nuk disiplinonjë nxënësit. Në momentin kur fëmijës i

ndalon diçka, ai zakonisht vepron të kundërtën, kështu që me kërcënime dhe me dhunë nuk arrihet asgjë. Fëmijëve u nevojiten këshilla të drejta, atyre duhet t' u thuhet se ende nuk ka ardhur koha për ta ngre gishtin (tërhequr këmbëzën), dhe akuzova Drejtorinë e shkollës që nuk më kishte dhënë kujdestarinë e një klase!

*A nuk ishte edhe nga ana jote një kërcënim për pushtetarët komunalë kjo përmendje e gishtit (këmbëzës)?*

**Kema:** Çështje e vërteta, regjimi serb kishte mjaft “vegla” - bashkëpunëtorë edhe brenda kolektivit tonë, dhe unë e kuptoja oportunitetin e disave, sepse njerëzit mbanin familjet me rrogën e tyre. Por, unë nuk mund t'ia falja vetes nëse nuk do të reagoja, ngase nxënësve vazhdimisht u shpjegoja për kurajën qytetare dhe asnjëherë nuk përdorja dhunë ndaj tyre, vetëm e vetëm që të mos pajtohen me dhunën, nga kushdoqoftë që vjen ajo. Dhe, duke qenë model për nxënësit, më duhej të sakrifikoheja për ta. Thënë realisht, do të ishte e pamoralshme për ne mësimdhënësit që nxënësit të na keqtrajtoheshin për çdo ditë, e ne të qëndronim të struktur në heshtje. Fundja, edhe nëse i kanë shkruar ato parulla, nuk po kërkonin diçka të pamundur. Kërkesa për Kosovën Republikë tashmë ishte publike. Po të ishim ne mësimdhënësit më unikë, duhej t'i bindnim së pari kolegët tanë serbë, e pastaj edhe pushtetin, se një kërkesë e tillë është legjitime. Për më tepër, kolegët tanë serbë i gëzonin frytet e një republike, e pse pra një gjë e tillë të ishte “mollë” e ndaluar për shqiptarët?

*Dhe, a pati pasoja për reagimin tënd?*

**Kema:** Fatkeqësisht, po. Vetëm disa muaj më vonë, më 20 shkurt 1983, më përjashtuan nga procesi mësimor me arsyetim se isha moralo-politikisht i papërshtatshëm për arsim. Më transferuan të punoja në organizatën punuese Miniera dhe Industria e Magnezitit “Magnohrom” në punët dhe detyrat e përkthyesit.

Në bazë të një shkrese të Komitetit Komunal të Lidhjes Komuniste të Dardanës,

nr. 36/83 të datës 22.02.1983, thuhet se Pleqësia e Shkollës, në mbledhjen e mbajtur më 23.02.1983, Ekrem Kallabës ia ndërpret marrëdhënien e punës në bazë të marrëveshjes, duke u arsyetuar kinse unë më 19 dhe 20 shkurt 1983 jam marrë vesh gojarisht me organin punëdrejtues të shkollës që të kaloj për të punuar në “Magnohrom”. Paradoksi i kohës! Pra, është tejet qesharake, sepse, nëse, sipas tyre, unë e kam humbur përshtatshmërinë moralo-politike për arsim me fajin tim, atëherë nuk ka pasur vend për kurrfarë marrëveshjeje gojore, dhe se për fatin tim është dashur të vendos unë vetë, e jo të tjerët. Kështu, Pleqësia e shkollës, natyrisht, e ndikuar edhe nga Komiteti Komunal i Lidhjes Komuniste, duhej të ma ndërpriste marrëdhënien e punës me procedurë disiplinore, ndërkaq mua më është ndaluar në mënyrë arbitrare hyrja në shkollë dhe puna me nxënës.

Se e gjithë kjo procedurë është me prapavijë politike shihet nga vendimi i marrë në mbledhjen e Komitetit të Mbrojtjes Popullore dhe vetëmbrojtjes komunale si dhe i Kryesisë së Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve të Kamenicës së Kosovës, të mbajtur më 18.1.1983, me nr. regjistrimi 35/83 ku është vendosur: që Ekrem Kallaba proesor i Qendrës së Arsimit të Mesëm “9 Maji” në Kamenicë të Kosovës të sistemohet në Ndërmarrjen Magnohrom “Strezovce” në vendin e punës – PËRKTHYES.



*Vendimi për sistemimin e Ekrem Kallabës, përkthyes në ndërmarrjen „Magnohrom“*

Më tej, në vendim thuhet se: lidhur me këtë të merren menjëherë masat së bashku me QAMO “9 Maji” në Kamenicën e Kosovës, në mënyrë që i njëjti të themelojë marrëdhënie pune në këtë organizatë. Vendimi është nënshkruar nga kryetari i KK të LK, Zhivko Jankoviq.

*Kishte Komiteti Komunal i Lidhjes Komuniste në Dardanë kaq shumë ndikim në shkolla dhe në organizata punuese për të bërë “loja” të tilla?*

**Kema:** Po, si jo! Ndikimi i partisë ishte një fantazmë që shtrihej gjithandej në çdo organizatë punuese, në çdo institucion shkollor etj. Sidomos e pësonim ne që nuk ishim anëtarë të partisë, por ndëshkoheshin edhe ata persona partiakë, që dilnin jashtë rrezes dhe lejes së veprimit të partisë.

Megjithatë, arsimimi shqip i brezave të rinj kishte një qasje më ndryshe nga brezat pararendës, një pjese të të cilëve, duke u shkolluar vetëm në gjuhën serbe, por edhe të ballafaquar me një sistem të ri, atë komunist, u ishte shpëlarë truri për të menduar shqip. Rinia studentore, e ndikuar nga pedagogë dhe patriotë të devotshëm, kishte kërkesa të vazhdueshme për barazi etnike me moshatarët e tyre serbë. Në vitet ‘70, pas ndryshimeve kushtetuese të RSF të Jugosllavisë (1974), ku Kosovës i jepej një autonomi e zgjeruar, nxënësit serbë në Kosovë duhej po ashtu ta mësonin gjuhën shqipe në shkolla. Pra, shqipja ishte futur si lëndë e obligueshme në shkollat serbe, njësoj sikur edhe serbishtja në shkollat shqipe. Pandehej për një barazi gjuhësore, por serbët e Kosovës nuk e përballuan dot këtë kërkesë dhe, nga ndikimi politik, mësimi i gjuhëve u kthye në mësim fakultativ, e më vonë u ndërpre të mësohet, ngase edhe shkollimi bëhej, tashmë, krejtësisht ndaras.

*Si rezultoi më vonë kjo trimëri jotja qytetare?*

**Kema:** Thënë realisht, që moti isha në shënjestër, por, pas dy-tri reagimesh publike në mbledhjet e Pleqësisë së gjimnazit, u bëra halë në sy për udhëheqjen komunale, e sidomos për zyrtarët nacionalistë serbë.

### *A ishin të gjithë zyrtarët serbë nacionalistë?*

**Kema:** Hmm, tema e të qenit nacionalist dhe e sjelljes nacionaliste do trajtim të veçantë. Një numër zyrtarësh komunalë kishin qenë edhe nxënës të mi. Me sjelljen dhe mësimin tim ata i kisha edukuar për një frymë internacionaliste, ashtu siç veproja edhe unë në raste të caktuara, përveç kur cenohej e drejta njerëzore dhe kombëtare. Por, serbët ishin të ndikuar edhe nga rrethi i tyre. Edhe disa prej tyre, pra, një numër i konsiderueshëm, ishin kundër sistemit komunist, kështu që edhe ata ishin në shënjestër të sistemit dhe përndiqeshin. Në fakt, në raport me shqiptarët ata ishin të bashkuar kundër shqiptarëve. Mirëpo, në takime individuale në qytet, në kafene, në gjueti, në treg ose gjetiu, të tillët parapëlqenin kurajën time qytetare, por edhe atë internacionalizmin tim. Te shumica e tyre nuk dallohej serbi me ngarkesa nacionaliste prej serbit me vlera njerëzore, ndërkohë që tek unë ngarkesa ime patriotike nuk e ngatërronte atë njerëzoren, prandaj unë e kisha më lehtë të komunikoja me ata, bile shpesh edhe t'i kritikojta shoqërisht për vesin e tyre të keq.

### *Edhe ndonjë shembull që lidhet me shprehjen e kurajës tënde në kolektivin e mësimdhënësve të gjimnazit?*

**Kema:** Po, gjatë një proteste të nxënësve në Dardanë, në rrugën afër shkollës, nga stacioni i autobusëve deri në rrugën kryesore, milicia dhe organet e Sigurimit keqtrajtuuan fizikisht disa nxënës e nxënëse, madje disa i morën edhe në paraburgim. Si zakonisht, Këshilli i Mësimdhënësve duhej t'i kritikonte nxënësit protestues dhe të merrte masa ndëshkuese ndaj tyre. Në këtë pikë edhe mësimdhënësit shqiptarë kishin presion të madh nga bashkëpunëtorët e sigurimit, kështu që ndonjë "i mjerë" u bashkohej profesorëve serbë, por kishte edhe mjaft që ishin oportunistë. Megjithatë, shumica e personelit arsimor shqiptar, tashmë, kishin humbur frikën dhe ishin në mbrojtje të kërkesave të kohës nga shqiptarët. Në fakt, tërthorazi, shumë prej tyre edhe i joshnin nxënësit për protesta, por dalja haptas ishte me pasoja. Sidoqoftë, në një mbledhje të tillë, ku kishte të pranishëm edhe zyrtarë partiakë, por që ishin ftuar edhe prindërit e nxënësve, unë mora fjalën dhe u shpreha kështu: "Unë, përveç profesionit të mësimdhënësit kam pasion edhe gjetinë, dhe, si gjahtar, kur zagarët e ndjekin ndonjë lepur të vogël dhe ma sjellin mua në pritë, nuk e vras, sepse ai është ende

i vogël, ia fal jetën, ndërkaq milicët dhe bashkëpunëtorët e sigurimit komunalë po na i torturojnë nxënësit, që ende janë në moshë të njomë, - kjo për mua është e papranueshme”. Natyrisht, edhe ky diskutim u fut në dosjen time të Sigurimi, e që nuk kaloi pa pasoja.

*Jetoje në bashkësi me prindërit apo kishe banesë më vete?*

**Kema:** Çështje e vërteta, kur u ktheva nga Rahoveci dhe fillova punën më 1969 në Dardanë, një kohë, banoja te prindërit në Koretin.

Më 12 korrik 1971 u martova me Fikrije R. Thaçin nga Muçivërci. Shtëpia e babait në Koretin kishte tri dhoma e një kuzhinë, por njëra dhomë shërbente si odë burrash, ngase babai kishte shumë shokë e miq dhe dëshironte që një dhomë të shërbente për atë destinim. Kjo shtëpi ishte e vogël për tetë anëtarë, sa ishim ne në këtë kohë. Kështu, gjimnazit ia parashtrova një kërkesë dhe, nga 23 shtatori 1971 komuna më dha një banesë njëdhomëshe në madhësi prej 32,84 metrash katrorë.

Më vonë, më 3 tetor 1974, me vendim të Shërbimeve Shoqërore të Kuvendit Komunal të Dardanës, m'u dha në shfrytëzim një banesë tjetër, po ashtu njëdhomëshe, por me hapësirë paksa më të madhe, prej 39,30 metrash katrorë, që ishte me lokacion afër gjimnazit. Kjo banesë ishte më e përshtatshme dhe me mundësi të shfrytëzimit edhe të oborrit prej 3,64 ari, që më vonë (17.05.1993) e kam pronësuar, duke paguar 2'095'149.00 (dy milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e nëntë dinarë).

*Martesa jote ishte martesë e aranzhuar nga prindërit, apo si?*


**Kema:** Jo, babai nuk parapëlqente martesat e aranzhuara. Lexonte shumë dhe kishte njohuri të mëdha nga kultura të shumta evropiane e më gjerë. Ai vetë ishte martuar me preferencën e prindërve, dhe kishte marrë për grua një femër pa shkollë, ndonëse një grua të mrekullueshme dhe nga një familje me edukatë të mirë. Përvoja e tij martesore kishte nxjerrë si rrjedhojë mësimin se një burrë



i arsimuar duhet ta ketë, mundësisht, edhe gruan të arsimuar, dhe anasjelltas. Ndryshe, në shumë aspekte, njëri do të bëhej barrë e tjetrit. Mirëpo, ky realitet ishte pjesë e kohës, sepse shqiptarët, sidomos në nga Kosova, sapo kishim filluar të arsimoheshim, dhe se mësuesi kishte autoritet të lartë në shoqërinë shqiptare. Kjo bënte që shumë familje të ngarendnin që vajzat e tyre të martoheshin me mësues.

*Dhe, ti, si veproje?*

**Kema:** Vazhdo më tutje, më me dëshirë nuk do të flisja për këtë temë.



*Vendimi, lëshuar Ekremit për shfrytëzimin e banesës shoqërore në madhësi prej 39,30 metrash katrorë, të cilën më vonë e ka blerë*

*Pse a nuk arrite ta bësh hapin e dëshiruar nga babai yt?*

**Kema:** Meqë po këmbëngul, atëherë po ta them se unë nuk bëra hapin e dëshiruar të babait, por bëra një hap më shumë se ai. Unë e njoha personalisht Fikrijen dhe e begenisa me vetëdashje, paçka se ajo nuk kishte ndonjë shkollim superior. Mirëpo, tek ajo shihja një grua dhe një bashkudhëtare të jetës, e cila do të më mbështeste në plotni. Dhe, një gjë e tillë u dëshmuua më vonë, kur unë mbeta pa punë dhe Fikrija u shndërrua në një kuzhinierë restoranti në ballafaqim me ekzistencën dhe mosshtrirjen e dorës armikut. Veç kësaj, Fikrija, ndërkohë, pati edhe probleme shëndetësore, duke e operuar njërën veshkë, dhe prapëseprapë ajo ishte krah për krah me mua në luftën për mbijetesë, nga restoranti që e kishim.



*Ekremi me bashkëshorten Fikrijen dhe prindërit Tefikun e Naxhijen, në ditën e martesës, më 12. 7.1971 në Roganë*

*Një kohë të gjatë nuk keni pasur fëmijë. Çfarë përjetimesh ke nga ajo periudhë?*

**Kema:** Vazhdimisht me ndjenja të përziera. Dëshira për të pasur fëmijë ka qenë jashtë normales, si nga unë ashtu edhe nga Fikrija. Në mungesë të fëmijës tim, dashurinë për fëmijët e kam plotësuar te fëmijët tjerë; tek ata të vëllezërve, të axhallarëve, por edhe më larg. Jam plotësuar kryesisht edhe si mësimdhënëse, ku kam harxhuar shumë kohë dhe energji për nxënësit. Pa dyshim, për këtë nuk pendohem, mirëpo, gjithmonë kam luftuar ta kem fëmijën tim, në mënyrë që gjithë diturinë time, të fituar nga psikologjia për fëmijë, nga pedagogjia për fëmijë si dhe nga përvoja jetësore, ta zbatoj te fëmijët e mi. Me këtë problematikë jam marrë me vite të tëra. Për dymbëdhjetë vjet radhazi kam konsultuar mjekësinë e kohës, të vendit e të rajonit, që të mund të bëhemi me fëmijë. Ky ka qenë, po aq, edhe vullneti dhe sakrifica e bashkëshortes sime. Prandaj viti 1983 ishte edhe viti i jetës sime, dhe i jetës sonë, kur më 14 dhjetor 1983 na lindi djali - Enlirati.



*Roganë, 12 korrik 1971: (nga e majta): Zehra me Muhametin në prehër, Hasibja (vajza e Sabrije), Sabrija (në këmbë): Shera (gruaja e Sabedit), Kadrija (gruaja e Mehmetit), Ylfetja (vajza e Fetijes), Ismetja (vajza e Ilmiut) etj.*

*Pse pikërisht këtë emër, e kishë menduar më herët këtë emër, dhe a ka ndonjë domethënie emri Enlirati?*

**Kema:** Më duhet të tregohem paksa më tradicional. Të paktën fëmija i parë kam pasur dëshirë të jetë mashkull. Për këtë kam pasur një emër të përzgjedhur shumë vjet më herët. Si term është thjesht një kompozitë dhe mund të shpjegohet fare lehtë, por si koncept në këtë emër kam një histori të gjatë. Po flas, pra, për një nocion me të cilin kam ndërtuar imagjinatën e ekzistencës sime dhe të popullit tim. Prandaj, duke qenë i etur për arsimimin dhe edukimin kombëtar, jam zgjuar dhe kam rënë në gjumë për fatin e shqiptarëve të të gjitha trojeve shqiptare. Pamundësia për ta njohur Shqipërinë nga afër, vazhdimisht ka shtuar kureshtjen time drejt atij vendi. Informacionet përmes Radio Kukësit dhe Radio Tiranës, që dikur i dëgjoja me ëndje dhe fshehurazi, ma kanë sforcuar gjithherë atdhedashurinë dhe respektin për ndërtuesit e saj, pra për Enver Hoxhën. Dhe në këtë rrafsh sigurisht që nuk jam i vetëm. Ndonëse njohuritë e mia më kanë mësuar që jo të gjithë udhëheqësit janë të përjetshëm, prapëseprapë kam pasur simpati të madhe për Enverin dhe dashurinë e tij për ta ruajtur Shqipërinë nga gllabërimi i shteteve përreth, saqë emrin e djalit tim e kam formuar nga fjalët: Enveri liroi atdheun = Enlirat.

*Por, dy vjet pas lindjes së Enliratit, shoku Enver vdiq, kurse disa vjet më vonë ai u akuzua rëndë nga brezi ri e nga populli për pengesën e zhvillimit krahas vendeve fqinje. Bile, atij ia rrëzuan edhe shtatoren në mes të Tiranës dhe u anatemua si diktator. A nuk është tani ky një zhgënjim për emërtimin e djalit tënd me emrin e tij?*

**Kema:** Parimisht, ndër shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë, duke e dashur shtetin amë, ne e kemi dashur dhe respektuar presidentin e vendit. Dhe, nëse presidenti dështon, e kjo mund të ndodhë gjatë historisë, kjo nuk do të thotë që ne të heqim dorë nga atdheu ynë, nga trojet tona etnike, nga kultura dhe nga trashëgimia jonë e begatë kombëtare. Por, njeriu nuk mund të udhëtojë përnjëherë nëpër të gjitha rrugët e mundshme. Dhe, ndonjëherë mund edhe të mos përzgjidhet rruga më optimale, e që shkakton vonesa ose qasje jo të dëshirueshme, por shumëçka duhet vlerësuar në kontekst të kohës.

Nga përvoja është dëshmuar se atij që punon mund t'i shohësh plot gabime, kurse atij që nuk punon fare nuk ia sheh asnjë gabim, përveç gabimit bazë që ai s'ka filluar asgjë. Analoge me këtë po marr një shembull tjetër; ta zëmë një çift

bashkëshortor ka lindur disa fëmijë dhe prej tyre ndonjëri ka qenë problematik, kurse çifti tjetër nuk ka bërë asnjë fëmijë. Çfarë ka ndodhur me këto dy familje? Ajo që nuk ka lindur asnjë fëmijë është shuar tërësisht, kurse kjo që ka lindur tetë fëmijë, dy prej të cilëve kanë qenë problematikë dhe, ta zëmë, kanë vdekur aksidentalisht, është shtuar dhe prej tyre është bërë një fshat i tërë. Kështu, unë parapëlqej që njeriu duhet të punojë dhe të bëjë më të mirën për familjen dhe për vendin e vet.

Sidoqoftë, unë mendoj se djali im, Enlirati, me veprimet e tij në jetë, do ta arsyetojë emrin e vet. Ai e ka më të lehtë se Enveri, i cili e ka pasur një popull të tërë përballë, kryesisht të paarsimuar dhe me virusin e armiqësisë vëllazërore të futur nga perandori respektive e të përcjellë ndër fise e bajraqe të ndryshme. Ishte në dorën time që Enliratin ta edukoja në frymën kombëtare, duke transmetuar kështu edhe amanetin e babait e të gjyshit tim për kultivim të arsimit, edukimit dhe atdhedashurisë. Si pedagog me profesion, jam i vetëdijshëm për kundërshtitë e brezave, prandaj me rëndësi është që fëmijëve tanë t'ua lëmë brumin e shëndoshë e pastaj ata do ta gatuajnë për shijen e tyre. Jam i lumtur që përjetova rritjen dhe martesën e Enliratis, ashtu sikur përjetova edhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Natyrisht, sytë më mbesin hapur për bashkimin e trojeve shqiptare, dhe jo vetëm bashkimin, por edhe fuqizimin e tyre ekonomik, arsimor, ushtarak e kulturor.



*Ekremi e  
Fikrija me  
djalin -  
Enliratin*





*Ekremi e Fikrija dhe pasardhësit: Enlirati dhe Edona me vajzat Nila e Henea*



*Mirë, besoj që njësoj ka vepruar edhe babai yt, duke lënë brumë për brezin tuaj. Çfarë mund të thuash tjetër për autoritetin e mësuesit Tefik Kallaba, siç e quanin koretinasit?*

**Kema:** Shumë! Aga Tefik ishte i mishëruar me popullin. Ishte një person që më parë parapëlqente suksesin e popullit sesa suksesin personal. Ishte edhe person tepër social. Urrente borgjezinë. Gjithçka dëshironte ta ndante me popullin, me nxënësin, me kolegun. Më kujtohet, njëherë kishte marrë një thes në krah dhe kishte dalë te xhamia e fshatit Koretin për të kërkuar ndihmë për shërbëtorin e shkollës Q.H., i cili kishte një prush fëmijë dhe i cili gjendjen materiale e kishte të vështirë. Kur e kishte vërejtur këtë vajza e kushërirës së tij, Byla, me vrap kishte shkuar në shtëpi, ishte shtrirë përmbys në kanape dhe po qante. Nëna e saj, që ne i thoshim dada Humë, kishte vrapuar për të parë se ç'kishte ndodhur. Byla, duke dënesur, i kishte treguar se si daja Tefik po kërkonte lëmoshë nga fshatarët; dikush i kishte sjellë fasule, dikush misër e dikush gjëra veshmbathjesh. Atëherë dada Humë, duke e njohur shpirtin bamirës të Tefikut, e qetëson vajzën e vet, duke ia sqaruar se ai këtë e bën për ndonjë të varfër e jo për veten e tij.

Ngjashëm kishte vepruar edhe disa vjet më vonë, kur një familje e varfër, e ardhur nga Gollaku i Dardanës, ishte në nevojë.

Kishte raste kur në fshat ndodhte ndonjë ngatërresë mes fshatarësh, e aga Tefik ishte i pari që vraponte për ta parandaluar belanë. Kështu, njëherë ishin ngatërruar Asllani i canëve me Bajramin e keqmezëve. Sapo kishte kuptuar aga, merr biçikletën dhe shkon te Ali Agushi. Kishte qenë herët në mëngjes. Pas një trokitjeje të gjatë (sepse dyert ishin larg shtëpisë) zgjohet Aliu dhe del të dyert. E vëren agën të brengosur dhe i lutet që të hynte brenda, kurse ai si pa frymë: - Ali, shko vishu, se kishte ndodhur një ngatërresë mes Asllanit e Bajramit. Aliu, paksa edhe për ta qetësuar, i kishte thënë. Po, lëre ore Tefik ti këtë punë se kjo është çështje jona, e bashkëfshatarëve, kurse ti je këtu ardhacak dhe mos u mërzhit fort për këtë punë. Mirëpo, aga kishte qenë këmbëngulës dhe pas disa minutash shkojnë së pari te Bajrami e pastaj edhe tek Asllani për ta qetësuar situatën.

Aga Tefik, veç të tjerash, ishte edhe një pedagog i shkëlqyer. Një vit kur i kishte rënë që të fillonte mësimin me klasën e parë, ai shkon te të gjithë ata

prindër, fëmijët e të cilëve do të nisnin klasën e parë. Atë kohë nuk kishte klasa parashkollore, prej ku do të rekrutoheshin nxënësit e klasës së parë. Dhe, pasi e kishte bërë numrin e duhur për klasën e tij, kishte filluar me mësim. Një ditë prej ditësh, një nxënës ishte ankuar se ia kishin vjedhur bojërat. Aga Tefik, për t'ia ruajtur secilit nxënës autoritetin, fillon dhe u shpjegon nxënësve: shikoni, nxënës të dashur, kini kujdes, se mund të ndodhë që ndokujt t'i bjerë lapsi, goma ose ngjyrat nga banka në tokë, nga banka në çantë, madje mund të ndodhë që ngjyrat ta pëlqejnë xhepin e dikujt dhe ato kërcejnë nga banka në xhep. Prandaj, para se të shkoni në shtëpi, kontrolloni xhepat ose çantat tuaja.

- Kështu, ai që ia kishte marrë shokut ngjyrat sikur ishte çliruar dhe, pa një-pa dy, i ishte drejtuar mësuesit: - shok mësues, ngjyrat e tij paskan kërcyer në xhepin tim, dhe nxjerr ngjyrat mbi bankë. Mësuesi u drejtohet nxënësve: a po e shihni, pra, nxënës të dashur, se si ngjyrat kanë kërcyer nga banka në xhep të kolegut tuaj, dhe e lut nxënësin që t'ia kthejë ngjyrat kolegut të tij, duke i kërkuar edhe falje. Kështu, e shpëtoi autoritetin e atij që i kishte marrë ngjyrat, e i cili kurrë, gjatë katër vjetëve të ardhshme, sa kishte qenë nxënës i tij, nuk e kishte përsëritur atë gabim.

Mund të them se aga ishte mjaft parandalues, por kur diçka ndodhte e pakthyeshme, atëherë veprimet e tij ishin shumë të matura. Më duhet patjetër ta rrëfej edhe një ngjarje.

Në kopshtin tonë aga kishte mbjellë shalqi, pjepra, domate, specat dhe perime të tjera. Njëherë vëllai im, Reshati, ishte fare i vogël, mbase tre ose katër vjeç. Asokohe, në Koretin, pra, në periudhën 1963 - 1967 pati ardhur të punonte drejtor shkolle kushëriri ynë Sadik Geci. Me banim nuk ishim më larg se pesëqind metra nga njëri-tjetri. Shumë shpesh bënim vizita të ndërsjella. Fëmijët i kishte të vegjël. Kënaqeshin kur vinin te ne. Sidomos Besniku, që ishte moshatar me Reshatin.

Njëherë Besniku me Reshatin kishin hyrë në kopsht. Shalqiri e pjeprat sapo kishin zënë të rriten, ndoshta sa një grusht ose pak më të mëdhenj. Reshati e Besniku i kishin këputur të gjithë shalqinjët e pjeprat dhe kishin bërë një rreth, duke imituar rrethojat e oborreve të shtëpive. Ndërkohë vijnë aga dhe baca Sadik prej shkollës në shtëpi. Aga Tefik i propozon Sadikut që t'ia tregojë kopshtin, e sidomos shalqirin që sa bukur e kishte punuar. Kur i dëgjojnë Reshati e Besniku

se ata po shkonin drejt kopshtit, ikin dhe fshihen prapa fshesave. Kur i sheh aga gjithë ata pjepra e shalqinj, kthen kokën nga kopshti dhe vëren se vërtet asnjë frutë që ka arritur të rritet sa grushti i dorës nuk kishte mbetur në lozët e shtrira e të punuara me shumë kujdes. Tashmë ishte i bindur se situatën nuk mund të kthente prapa. Këta e dinin se fëmijët ishin aty diku, dhe i thërrasin, por ata nuk përgjigjen. Pas pak, Sadiku i drejtohet Besnikut, që nuk e shihte: - Besnik, pse je fshehur aty, dil këtu! Besniku kishte menduar se vërtet ai e kishte parë, dhe që të dy kishin dalë prej fshesave, aty ku ishin fshehur. I thërrasin të vijnë para tyre. Sadiku i drejtohet Besnikut paksa me zë qortues: Çka keni bërë kështu? Ndërkaq, ata, pa bërë zë i drejtojnë gishtërinjtë nga kreacioni i tyre. Atëherë aga, me një gjuhë fëmijësh, u tregon atyre se kanë bërë një dëm goxha të madh, kurse mbi vete merr fajin që fëmijëve nuk u ka siguruar lodra përkatëse. Aga e kishte vërejtur qartë që Sadiku do ta rrihte Besnikun, i cili ishte ndoshta një vit më i madh se Reshati, porse asnjëri nuk kishte kaluar pesë vjet. Në atë moment i drejtohet Sadikut, duke e përgjëruar: - Sadik, nëse e qorton ose e rrah Besnikun, ta kesh me dije se kurrën e kurrës nuk guxon të më flasësh. Këtë përgjërime e kishte përsëritur disa herë. Dhe vërtet Sadiku, që kishte planifikuar ta ndëshkonte Besnikun, e mban fjalën dhe nuk i bërtet Besnikut, por një kohë të gjatë i kishte ngelur në mendje ky gjest i këtyre fëmijëve. Dhe, që të dy këta, pra, edhe aga, edhe Sadiku, që ishin edhe pedagogë me profesion, kishin nxjerrë një moral nga ky veprim i Besnikut dhe i Reshatit: fëmijët kanë botën e vet, dhe atyre u duhen plotësuar nevojat fëmijërore, ndryshe ata vetë zgjedhin mënyrën dhe mjetet e lojës, paçka që ato dhe mund të jenë ndonjëherë të dëmshme.



*Tefik Kallaba në Koretin 1966, përballë shtëpisë së Taip Keqmezit (djathtas). Në foto shihen edhe Zeqir Gagica me shat në krah dhe vogëlushi Ramadan Ali Haxhiu*

*Po, për fqinjët në Koretin, çfarë thua, si keni shkuar me ta?*

**Kema:** Çështje e vërteta, objekti i parë në afërsi të shtëpisë ka qenë shkolla. Kjo ka qenë edhe ideja e agës Tefik, që të banojë sa më afër shkollës. Mirëpo, në një largësi prej rreth 200 metrash kemi pasur, në jug mëhallën vendase Rexhiqi dhe në veri, familjen ardhacake Rexhepaj. Kemi shkuar shumë mirë me të gjithë. Ka qenë e pamundur që t'u vinte atyre ndonjë mysafir e të mos e ftonin agën për muhabet. Në veçanti kur banonim në Koretin, nuk ka ndodhur që të bëhej një dasmë, e koretinasit të mos e ftonin babanë në konak. Ndërkaq, me fqinjët e parë i kemi pasur përherë dyert të hapura. Kur them këtë, mund ta ilustruj me disa shembuj: kur kemi pasur për të punuar diçka në arë, aga ka shkuar te rexhiqtë, dhe aty ia kanë dhënë qerren, qetë, plugun e madje edhe një fëmijë ose vetë Dauti, Jakupi, Rexhepi, Sadriu, Nuhiu ose Salihu, pra, njëri prej tyre, kanë ardhur dhe na e kanë lëvruar arën. Ose këta të familjes Rexhepaj, përkatësisht Hima dhe Hasani, që nga mesi i viteve '60 kishin ardhur nga Kopërnica në Koretin, përkatësisht Hasani nga Duhla e Suharekës, ku kishte punuar si milic; ishin shumë fqinj të mirë. Ka ndodhur që atyre ose neve na ka ardhur ndonjë mysafir dhe në ato çaste nuk kanë pasur diçka të gatshme për darkë, i kemi ndihmuar gjithmonë njëri-tjetrit.

Më kujtohet, njëherë, aga, kishte një mbledhje në shkollë; ishte dimër dhe muaji i Ramazanit. Mbledhja kishte filluar pasdite, por kishte zgjatur deri në orët e vona. Kishte mësues edhe nga shkolla e Busavatës. Pas mbledhjes, aga i kishte ftuar mësuesit e Busavatës për konak te ne. Bashkë me ta kishin ardhur edhe disa mësues koretinas për muhabet. Kur nëna kuptoi se duhej gatuar edhe darka, ajo po i thyente duart se nuk kishte bukë të mjaftueshme për dhjetë mysafirë. Dyqane e markete atë kohë nuk kishte. Aga, vetëm ia kishte bërë me dije se duhej bërë bukë për nja dhjetë veta. Ky ishte një urdhër i prerë. Nëna hodhi shaminë në kokë dhe shkoi te Metihja, gruaja e Hasanit dhe iu ankua se ka mysafirë e nuk ka mjaft bukë. Ata sapo kishin ngrënë darkë dhe kishin përgatitur edhe një tavë fasule me mish dhe dy bukë mrome të tepsisë për syfyr. Metihja, pa pyetur kënd, ia jep nënës një mrome dhe tavën me fasule. Aty kishte qenë edhe Shaha, gruaja e Himës. Kur e dëgjon këtë muhabet, shkon në shtëpi dhe i thotë burrit të vet, Himës: te Tefik aga kishin ardhur disa mysafirë, e Naxhija nuk e kishte ditur fare që të gatuante darkë. Hima, e kishte parë se reja e tij, Ilmija, sapo i kishte gatuar për syfyr dy lakrorë, të cilët vetëm duhej të piqeshin. E thërret vajzën, Haxheren, dhe i thotë: “merre njërin lakror e çoje te Tefiku, se paska

mysafirë”. Tek oda e mysafirëve, tre mësuesit nga Busavata, bashkë me disa të Koretinit, e kishin shtrirë muhabetin, dikush me letra e dikush me shah. Rreth një orë më vonë darka ishte gati. Ata u habitën kur u shtrua sofrë e mbi sofrë një tavë fasule me mish e me mrume të nxehta e më pas dhe një lakror me lakra. Besa u habit edhe aga, ndonëse i kishte ikur menjëherë mendja se këtë ndihmesë e kishin bërë fqinjët e tij të mrekullueshëm.

## Mësuesi që u bë shembull



*Nuhi Kosumi, ish-nxënës i mësuesit Tefik Kallaba*

Shumë vjet pas vdekjes së Tefik Kallabës, ja se si e përshkruan këtë mësues, në një punim seminarik për shkollim pasuniversitar, ish-nxënësi i tij, Nuhi S. Kosumi:

Tefik Kallaba, ishte mësuesi dhe intelektual i denjë i çështjes së arsimit dhe asaj kombëtare, pishtar i dijes dhe i arsimit shqip në Komunën e Dardanës. Të shkruaj për një mësues si Tefik Kallaba, më bën të ndihem shumë i nderuar dhe i respektuar,

sepse ishte një mësues i madh, i cili ka punuar me përkushtim të madh në mbjelljen e farës së dijes, në Komunën e Dardanës.

“ Mësuesi që terrin e bëri dritë dhe pena e të cilit gjithherë mbolli farën e dashurisë me emrin e mirë të një shqiptari. ”

Gjatë kohës së pasluftës së Dytë Botërore, kur shqiptarët nuk kishin as bukë për të ngrënë, e le më për të menduar që të shkolloheshin, në mënyrën më bindëse dhe të drejtë, mësuesi Tefik Kallaba, mendoi për ardhmëninë e popullit dhe shtetit të Kosovës, duke e kuptuar mirë se të arsimuarit dhe të mësuarit është domosdoshmëri e kohës dhe e ardhmënisë për popullin shqiptar. Unë jam përpjekur ta kuptoj

dhe ta studioj sa më thellë filozofinë dhe veprimtarinë praktike e patriotike të mësuesit tonë të dashur Tefik Kallaba dhe kam arritur në përfundimin se ai ishte dhe mbetet personaliteti më i madh i arsimit dhe i kombit shqiptar në komunën e Dardanës që nga paslufta e Dytë Botërore e këndej.

Tefik Kallaba, bashkërisht me mësuesit e tjerë shqiptarë, arriti që për herë të parë në komunën e Dardanës, t'i bashkonte 36 shkronjat e alfabetit shqip rreth vetes dhe nxënësve shqiptarë, për ta jetësuar një program edukativo-arsimor që terrin e bënte dritë e që asokohe popullit shqiptar i mungonte drita dhe gjithçka tjetër. Në këtë arsye, ai krijoi lidhje dhe miqësi të qëndrueshme me nxënës, kolegë dhe në përgjithësi me arsimin shqip në Kosovë. Ai, me punën e tij të palodhshme, e luftoi sundimin dhe regjimin e analfabetizmit që ishte gjithandej Kosovës. Për këto arsye, mësuesi Tefik Kallaba mbetet personaliteti më i shquar në historinë e edukimit dhe të arsimit shqip në Komunën e Dardanës.

Tefik Kallaba mbetet edhe më tej model i frymëzimit dhe i mësimdhënies në komunë, por edhe në Kosovë. Mbetet arkitekti i arsimit shqip dhe themeluesi i shkollës shqipe në Dardanë. Prandaj, ndihem krenar që kam mundësi të plotësoj boshllëkun e krijuar për emrin e madh të këtij mësuesi shumë të dashur dhe të pashembullt në komunën e Dardanës, por edhe në Kosovë. Është më se i arsyeshëm respekti dhe nderimi i këtij mësuesi të shquar që zë vend të merituar në historinë e kombit shqiptar për arsimin dhe edukimin shqip në Kosovë. Gjithashtu jam i bindur se edhe mësuesit e tjerë pas tij, do të ndihen krenarë nëse e kanë ndjekur me fisnikëri rrugën e mësuesit tonë të dashur për të shkuar deri tek e vërteta, edukimi dhe arsimimi i popullit shqiptar.

Kam bindjen se me mijëra shkrime të tjera do të shkruhen për pishtarin e arsimit shqip në Kosovë, për mësuesin e madh Tefik Kallaba. Ndoshta u dashka që të kalojnë shumë kohë për t'i kuptuar vlerat e një mësuesi të madh si Tefik Kallaba, dhe sa më shumë kohë të kalojë, aq më shumë do të lartësohet figura, emri, personaliteti dhe vepra e këtij mësuesi.”



## Kujtimi për një mësues të (pa)harruar

Mësuesi Tefik Kallaba u lind në fshatin Rogaçicë të Komunës së Kamenicës, në vitin 1922. Pas shkollës fillore kreu shkollën Normale dhe Akademinë Pedagogjike në Gjilan. Arsimimin profesional e arriti pa e ndërprerë punën. Detyrën e mësuesit e filloi në vitin 1947 në fshatin Busavatë të Kamenicës, e pastaj punoi edhe në fshatrat Kopërnice, Hogosht, Geraj të Preshevës, në Pogradjë të Gjilanit dhe, vitet e fundit, në fshatin Koretin të Kamenicës.

Tefik Kallaba i përket asaj gjenerate të pishtarëve të arsimit tonë e cila i vuri themelet e arsimit në Kosovë, duke u dhënë shpirt fuqishëm të gjitha proceseve të përparimit dhe emancipimit të popullit që lëngonte nga prapambeturia që ia kishin shtresuar shekujt në robëri.

Tefiku u lind dhe u rrit në një familje fshatare përparimtare. I ati i tij, Shefki Hafëz Kallaba ishte një hoxhë përparimtar që diti dhe deshi ta luftonte dogmatizmin fetar, duke ushtruar ndikim progresiv në rrethin e tij familjar, në fshat dhe më gjerë në Anamoravë, për çka gëzonte autoritet të pakontestueshëm. Vëllai i madh i Tefikut, Ilmiu – sekretar i Imamatit të Gjilanit, gjatë viteve 1940 – 1944 kishte një vetëdije të lartë atdhetarizmi dhe ushtroi ndikim të fuqishëm në formimin e mësuesit të ardhshëm të popullit, Tefik Kallaba. Ilmiun e pushkatuan hordat çetniko-partizane në fund të vitit 1944, menjëherë pas Luftës së Gjilanit.

Në fshatrat ku punoi si mësues, sidomos në vitet e para 1947 – 1949 Tefiku punoi me një pasion të madh, si me nxënës të rregullt ashtu edhe me të rriturit, duke e luftuar kështu analfabetizmin nga i cili lëngonte mbarë populli.

Tefik Kallaba kishte një aftësi të lindur, një talent të rrallë për të ushtruar ndikim, jo vetëm te fëmijët, por, sidomos, te të rriturit dhe prindërit. Në personalitetin e Tij kishte diçka sokratiane. Këto veti, atëbotë, kishin vlerë të madhe ngase prapambeturia dhe konservatorizmi

/ NDERUARI DOK. KÆRDOET /

Kujtimin për të nderuarin, në këmbë tim të  
 çmuar e të udhëzuar e Babain Tënd, Tefikun e  
 kisha shprehur diku në kujtimet e mia intime dhe,  
 sikur pasqyruar pritjen që dëshirosh të më signalizojë  
 për të shfaqur, sepse ai e ka merituar qëmos  
 të gjat në harresë afsh si që fide vepruar  
 gjatani.

Pra, me porosi më ajo letjen, që ma ka  
 përcillur përmas Besimit, vetëm ja me ke nderuar!

Me respekt,  
 Nga Rahit

Prisht. 19. X. 97

dendur ishin shtresuar në vetëdijen e njerëzve gjë që pengonte vijimin e nxënësve në shkollë, sidomos të vajzave.

Dy vite shkollore kam punuar me mësuesin Tefik, në fshatin tim të lindjes, në Pogragjë (1958/59 dhe 1959/60). Më kujtohen mbledhjet e prindërve, bisedat në oda, në mbledhje të organizatave, në gazmende e takime zie, në të cilat Tefiku ishte një bashkëbisedues brilant. Kudo që ishte prezent, dominonte, jo imponueshëm, por spontanisht me qëndrime e argumente bindëse dhe konstruktive për çka gëzonte respekt të nxënësit, fshatarët dhe shokët e punës.

Me punën, sjelljet dhe aftësitë e tij krijonte besimin ndaj tij, admirimin ndaj personalitetit të tij dhe këto cilësi mbillnin ato fryte të ndikimit të tij në rrafsh më të gjerë në mjediset ku punoi.

Gjatë kohës që kishte punuar në Busavatë, në fillim të karrierës, rrëfente se në të gjitha klasat numri i djemve dhe i vajzave gati ishte

i barabartë, shënim ky me të cilin mund të krenohet rrallë ndonjë shkollë, bile edhe në ambiente më të zhvilluara urbane. Kështu ishte edhe në shkolla të tjera ku Tefiku punoi.

Në punën e tij me nxënës, rini dhe fshatarë, një nga objektivat e ndikimit të tij ishte edukimi patriotik, kultivimi i ndjenjave kombëtare. Gjatë mësimit, bisedave nëpër oda, në të cilat ishte mysafir vazhdimisht i ftuar dhe i mirëseardhur, gjithnjë fliste për të kaluarën e kombit dhe për nevojën e përpjekjeve të reshtura që me punë krijuese të pushtohen hapësira të reja të lirisë.

Dekadën e fundit të punës si mësues e kaloi në fshatin Koretin ku me shumë mund e sakrifica, me një rrogë modeste mësuesi kishte ndërtuar një shtëpi për familjen e tij tetantarëshe. Edhe këto vite, edhe pse i prekur nga sëmundja, punoi me të njëjtin intensitet dhe përkushtim, duke gëzuar respektin e nxënësve, prindërve dhe kolegëve, jo vetëm të shkollës ku punoi, por edhe më gjerë. Gjatë kësaj kohe, me shumë sukses, u mor edhe me bletari dhe ishte një ndër bletarët më të njohur të Anamoravës, dhe pati ndikim të madh në nxitjen e fshatarëve që të merren me kultivimin e bletarisë.

Sëmundja e rrëmbeu relativisht herët, më 1984, duke na obliguar që me pietet ta kujtojmë shembullin e tij.

Prishtinë, 19 dhjetor 1997

*Me respekt, Rabit Rexhepi*



*Tefiku, Rabiti (me Selamiun në krahë) dhe Muharremi. Pogragjë, 1959*

## **Atdhetari Sulejman Ibrahim Kallaba**

Sulejman Ibrahim Kallaba, ishte një atdhetar i flaktë dhe i palodhshëm në përpjekjet e tij të vazhdueshme për pavarësinë e atdheut të vet (Kosovës). Ai nuk pushoi kurrë së vepruari me fjalë e me vepra deri në momentin e fundit të jetës së tij.

Sulejman Kallaba lindi, u rrit e u edukua në një familje të madhe atdhetare të trungut gjenealogjik të vëllazërisë Kallaba të Roganës. Kjo vëllazëri kishte tradita të ndritshme liridashëse (ashtu siç kishte tërë Rogana e Anamoravës së Poshtme), duke u kacafytur me padrejtësitë. Ajo gjithmonë ishte në konflikt me robëruesit e huaj; turq, serbë e bullgarë, duke shkuar me ta lak e gjak, bëri luftëra të vazhdueshme për liri e pavarësi kombëtare.

Nga lagjja Kallaba, e cila sot është shtuar deri në rreth 80 shtëpi, dolën burra patriotë në zë, që zunë vend të merituar në historinë tonë kombëtare, duke filluar që nga gjysma e parë e shekullit të kaluar (XX). Kur populli shqiptar vuante nën zgjedhën e robërisë shekullore të Perandorisë Otomane, nga kjo lagje u dalluan luftëtarë të patrembur, të cilët, me trimëritë e tyre, mbillnin tmerr e frikë për pushtuesit.

Oda e burrave shërbente, jo vetëm për pritjen e miqve të shtëpisë dhe strehimin e udhëtarëve e të nevojtarëve të rastit, por ajo ishte shndërruar në një vend me frymë kombëtare e synim çlirimtar. Aty zhvilloheshin biseda dhe trajtoheshin çështje aktuale kombëtare nga krerët e Lëvizjes Kombëtare, si: Mulla Idriz Gjilani, Haki Efendi Sermaxhaj (Myderrizi) e shumë patriotë të tjerë të Anamoravës së Poshtme.

Sulejman Kallaba u pajis me tipare burrërore: besë, nder, burrëri, bujari e mikpritje, ndjenja patriotike, atdhedashës, që i drejtë dhe parimor, njeri i fjalës e i besës, guximtar, zemërgjerë, i prirë nën ndikimin e fuqishëm të institucionit të odës së burrave. Këto cilësi, që e stolisnin personalitetin burrëror të Sulejman Kallabës, ishin parakushte të lindura, të cilat i zhvilloi dhe i kultivoi nën ndikimin e edukatës së shëndoshë familjare.

Rogana, si fshat qendror në Moravën e Poshtme, kombit tonë i dha burra e patriotë të shquar, si: Sulejman Kallaba, Ibrahim Kallaba, Hafëz Kallaba, Salih

Kallaba, Ilmi Kallaba etj.

Ishte kjo rruga e trasuar nga i ati i Sulejman Kallabës - Ibrahim Kallaba, që në fillim të shekullit të njëzetë. Ishte kjo tradita dhe vazhdimësia patriotike tradicionale e shembullit të paraardhësve që, jo rastësisht, sendërtohet edhe nga trashëgimtari Sulejman Kallaba.

Falë kësaj pune vetëmohuese dhe angazhimit të vazhdueshëm, pa ndier fare lodhje, por gëzim e kënaqësi të veçantë, Rogana sot ka një numër të madh intelektualësh me kualifikime të larta shkollore, si: mësues, arsimtarë, profesorë, magjistra e doktorë shkencash të profileve të ndryshme.

Pema e mbjellë nga Ibrahim Kallaba dhe e kultivuar nga Sulejman Kallaba po jep fryte në ditët tona.

Shënoi: Sylë Krasniqi - Dajkoci

Dajkoc, tetor 1995





*Kthehemi edhe njëherë te pushimi yt nga puna, sepse të largohej një profesor nga procesi arsimor nuk ishte edhe pa pasoja për arsimin shqip, i cili sapo kishte lulëzuar në Kosovë. Çfarë ishte bindja e drejtorisë së shkollës për ty?*

**Kema:** Ende pa më larguar, e vëreja se diçka po zihej, ngase unë merresha edhe me aktivitete të tjera jashtëmësimore, sidomos në mësimin shtesë për nxënësit e dalluar, të cilët tashmë kishin arritur suksese në garat e diturisë, në shkollë Kosove.

Megjithatë, nga drejtori i shkollës, prof. Haqif Canaj, kërkova një karakteristikë personale. Kështu, më 3 nëntor 1982 QSHM “9 Maji” në Dardanë më lëshoi një karakteristikë, ku, ndër të tjera, thuhet se: “Ekrem Kallaba, është i punësuar në QSHM “9 Maji”, në Dardanë në vendin e punës profesor i Bazave të Marksizmit dhe Socializmit Vetëqeverisës prej 1.9.1979. Në procesin edukativo-arsimor, në organizimin e orës mësimore, përgatitjes me shkrim dhe përfilljes të të gjitha normave pedagogjike-didaktike, çdoherë ka shërbyer si shembull ndër më të mirët në kolektiv.



*Karakteristikë e lëshuar nga gjimnazi „9 Maji“ në Dardanë dhe e nënshkruar nga drejtori, Haqif Canaj*

Duhet theksuar se sa i përket ideshmërisë në mësim, në orët që kemi hospitar, kurrë nuk është vërejtur se ka dobësi, pasi çdoherë është munduar të aktualizojë përmbajtjet programore me arritjet në RSFJ.

Pos formave të rregullta në procesin edukativo-arsimor, gjatë vitit shkollor, ka punuar edhe në format tjera të të mësuarit, si: me nxënësit e talentuar ka mbajtur mësim shtesë dhe ka arritur rezultate inkurajuese. Sa i përket pedanterisë është shembull edhe për të tjerët. Duhet theksuar se e metë e shokut Ekrem është që planet mujore nuk i ka dorëzuar me kohë, por me vonësë dhe gjatë vitit shkollor ka bërë një numër të madh mungesash... për Ekrem Kallabën është njoftuar edhe OTH e LK, se nga ana e Kryesisë së KK të LK në Dardanë i është tërhequr vërejtja e fundit për përshtatshmërinë moralo-politike, meqë është thirrur në bisedë në KK të LK.

Vlen të theksohet se është mjaft kureshtar në aplikimin e inovacioneve në mësim dhe në pikëpamje profesionale në mënyrë të vazhdueshme perfeksionohet, duke marrë literaturë profesionale-pedagogjike në shkollë.

Nga kjo mund të konkludojmë se shoku Ekrem Kallaba ka aftësi organizative në organizimin e suksesshëm të procesit edukativo-arsimor”.

*Si e përjetove largimin nga arsimi, dhe çfarë ishte detyra jote në një ndërmarrje prodhimi?*

**Kema:** Të largohet me dhunë një mësimdhënës nga procesi arsimor është skandaloze. Lëndimi shpirtëror është i papërshkrueshëm. Në fakt, unë këtë akt të regjimit serb e pritja, sepse e kisha edhe shembullin e babait tim që e kishte përjetuar njëzet vjet më parë, kur e kishin larguar nga arsimi për ta dërguar në një ndërmarrje metalpunuese “Gromat” në Dardanë. Ai, megjithatë, pas disa ankesave deri në nivel qendror të Serbisë, arriti t’u kthehej nxënësve, ndërkohë që tani në Kosovë po sundonte një brez edhe më antishqiptar, brezi i Sllobodan Milosheviqit. Më vonë, njësoj ndodhi edhe me motrën time, Dritën, të cilën e kishin larguar nga procesi arsimor më 15 janar 1989, pra, në ditën e parë të gjysmëvjetorit të dytë, me akuzën: pjesëmarrëse e demonstratave studentore; kështu, çdo ditë e më tepër shtohet presioni ndaj intelektualëve, në veçanti,

dhe ndaj gjithë popullatës, në përgjithësi. Shumë të rinj ftoheshin në shërbim ushtarak të Jugosllavisë dhe pas disa muajsh i kthenin në arkivole. Arsyeimi, kryesisht, ishte – vetëvrasje. Në fakt, këta të rinj vriteshin me porosi nga oficerë serbë. P.sh., vetëm gjatë verës së vitit 1991 nga Komuna e Dardanës u vranë tre të rinj, që ishin me shërbim në Armatën Jugosllave. Këta ishin: Florim A. Kosumi, i vrarë më 5 korrik 1991; Muhamed R. Biçku, i vrarë më 29 korrik 1991 dhe Muharrem M. Robelli, i vrarë më 10 shtator 1991<sup>28</sup>.

Keqtrajtimet e të rinjve nuk kishin të ndalur. Ata, sidomos rinia studentore, ftoheshin në biseda informative, ndërkohë që, fshehurazi, po prej njerëzve të sigurimit, organizohej largimi i tyre jashtë atdheut.

Sidomos pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, më 23 mars 1989, pati filluar një luftë psikologjike ndaj popullit shqiptar në Kosovë.

Përpjekjet e shqiptarëve për të jetuar dhe për të mbijetuar paralelisht në Kosovë u shuan me gjak. Fill pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese për Republikën e Kosovës, më 2 korrik 1990, filloi një represion i paparë. Më 5 korrik u larguan me dhunë rreth 1300 punëtorë shqiptarë të Radiotelevizionit të Prishtinës. Dy muaj më vonë, më 5 shtator 1990, u ndalua edhe botimi i gazetës ditore “Rilindja”. Dy ditë më vonë, më 7 shtator 1990, në Kaçanik, delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës shpallën Deklaratën e Pavarësisë, që ishte akti më i lartë juridik – Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Më pas pasoi edhe largimi i punëtorëve nga institucionet e tjera punuese, arsimore, shëndetësore; na larguan edhe nga ndërmarrja “Magnohrom” në Berivojcë. Kosovën e kishte kapluar një kaos i vërtetë.

Qëllimi ishte që sa më shumë shqiptarë ta lëshonin Kosovën.

*E kishin pësuar largimin edhe mësimdhënës të tjerë të gjimnazit “9 Maji” në Dardanë?*

**Kema:** Pas suprimimit të autonomisë dhe mbylljes së shumë institucioneve

---

<sup>28</sup> *Xhemush H. Biçku – Një lapidar për tre ushtarë, f. 5.*

që udhëhiqeshin nga shqiptarët, pakënaqësia e shqiptarëve në Kosovë sa vjen e shtohet edhe më shumë. Kështu, më 3 shtator 1990 punëtorët shqiptarë gjithandej Kosovës organizojnë një protestë gjithëpopullore. Kjo protestë pati edhe pasojat e veta për punëtorët shqiptarë, fillimisht për udhëheqësit e tyre. Po të njëjtën ditë në Dardanë Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Dardanës kishte mbajtur mbledhje dhe kishte shqyrtuar, sipas tij, pasojat e kësaj proteste, ndaj edhe, bazuar në Organin zyrtar të RSS-së nr. 40/90, kishte marrë vendimin në vijim<sup>29</sup>:

a) të gjithë punëtorëve që kanë marrë pjesë në protestën e shqiptarëve dhe që nuk kanë punuar më 3 shtator 1990 t'u ndalen mëditjet për këtë ditë;

b) të gjithë punëtorëve që kanë marrë pjesë në këtë protestë dhe që kanë pasur ndikim te punëtorët e tjerë t'u zvogëlohen mëditjet dhe të nisë procedura disiplinore kundër tyre;

c) ndaj të gjithë udhëheqësve të organizatave punuese dhe drejtorëve të tyre që kanë marrë pjesë në protestë, udhëheqësit të ndërrohen ose të largohen nga detyra...

Ky vendim ka hyrë menjëherë në fuqi dhe qe nënshkruar nga kryetari i Këshillit Ekzekutiv, Selim Berisha.

*Pati edhe pasoja të tjera?*

**Kema:** Pasojat ishin të llojllojshme. Së shpejti filloi një jetë paralele e shqiptarëve në Kosovë, sidomos arsimit. Serbët kërkonin që shqiptarët, pas suprimimit të autonomisë të mësonin me planprogramet e Serbisë, çka asnjë drejtor shkolle nuk pranonte diçka të tillë, që rezultonte me largimin e nxënësve nga shkollat dhe mësimi vazhdonte nëpër shtëpi private ose në ato shkolla, nëpër fshatra, në të cilat nuk kishte nxënës serbë.

---

<sup>29</sup> Faksimile e vendimit të Këshillit Ekzekutiv të KK të Dardanës.

Izvršno veće Skupštine opštine Kosovska Kamenica, na svojoj sednici održanoj 3.09. 1990. godine, a posle razmatranja Informacije o posledicama štrajka Albanaca u Opštini Kosovska Kamenica i konkretnih kadsteka u vezi sa ovim štrajkom, shodno članu 262. Statuta opštine Kosovska Kamenica ( Službeni list SAPK" broj 19/76) je

### ŠTA K I J U Ő I D O

1. S obzirom da je ovaj štrajkom radnika Albanaca u Opštini Kosovska Kamenica, pored ostalog nastala i materijalna šteta to je u skladu sa Zakonom o radnim odnosima u posebnim okolnostima (Službeni glasnik SRS" broj 40/90) i Normativnih akata subjekata potrebno odmah preduzeti sledeće:

a) Svim radnicima koji su učestvovali u štrajku Albanaca i nisu radili 3. septembra 1990. godine, odbiti pripadajuću dnevnicu za ovaj dan,

b) Svim radnicima koji su učestvovali u ovom štrajku i imali uticaja i na ostale radnike takodje smanjiti dnevnicu i protivu istih proceniti i pokrenuti disciplinski postupak i izreći odgovarajuću disciplinarnu meru (suspenzija i isključenje iz radne organizacije),

c) za sve rukovodioce u radnim organizacijama i direktore radnih organizacija koji su učestvovali u štrajku pokrenuti postupak za njihovo smanjivanje sa ove dužnosti (od suspenzije do razrešenja).

2. Isto tako za sve starešine organa uprave i članove

2.-

B. Zaključak stupa na snagu danom donošenja.

-06-45/90

a Kamenica, 3. septembar 1990. godine,

IZVRŠNO VEĆE SKUPŠTINE OPŠTINE KOŠOVSKA KAMENICA

PRESEDNIK VEĆE  
Selim Beriše,

*Vendimi i Këshillit Ekzekutiv të KK të Kamenicës, që të gjithë protestuesve të 3 shtatorit 1990 t'u hiqen mëditjet, kurse ndaj udhëheqësve të tyre të fillojë procedura disiplinore*

*Çfarë ndodhi me QAMO-n në Dardanë?*

**Kema:** Ja, po e marr shembullin e drejtorit të gjimnazit të Dardanës, z. Rexhep Vranja. Me një vendim të Sekretariatit Krahinor për Arsim dhe Kulturë z. Vranja shkarkohet nga detyra e drejtorit të Qendrës së Shkollave të Mesme

dhe në vend të tij emërohet zëvendësi i deriatëhershëm Vladimir Stojanović. Arsyetimi për shkarkimin e z. Vranja ishte se nuk e ka siguruar zbatimin e planprogrameve mësimore të përgatitura nga Pleqësia e Arsimit e Serbisë, e të cilat prej vitit shkollor 1990/91 zbatoheshin në mënyrë unike në territorin e Republikës<sup>30</sup>.

*Si ishte gjendja e nxënësve në këtë periudhë në Dardanë?*

**Kema:** Në vitin shkollor 1990/91 numri i nxënësve ishte si vijon:

- 1.200 nxënës shqiptarë në 48 klasa
- 402 nxënës serbë në 21 klasa
- Shkolla amë në Dardanë kishte 891 nxënës shqiptarë, prej tyre 226 femra 402 nxënës serbë, prej tyre 146 femra
- Paralelja në Hogosht (4 paralele) 233 nxënës, prej tyre 46 femra asnjë serb.
- Paralelja në Roganë (2 paralele) 76 nxënës, prej tyre 20 femra asnjë serb.



*Rexhep Vranja,  
vendim për shkarkim  
nga drejtori*

<sup>30</sup> *Vendimi i Sekretariatit Krahinor për Arsim dhe Kulturë për shkarkimin e drejtorit Rexhep Vranja.*



*Të kthehemi edhe njëherë në periudhën e largimit tënd nga procesi arsimor. Pate parashtruar ankesë ligjore?*

**Kema:** Natyrisht se po. Pleqësia e Arsimit pranë gjimnazit “9 Maji” në Dardanë, më 3 mars 1983 kishte marrë vendim për ndërprerjen e marrëdhënies sime të punës pranë kësaj shkolle, bazuar në procesverbalin e datës 23 shkurt 1983.

Pas një ankese në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, kjo gjykatë ma lëshoi një vërtetim se shqyrtimi publik sipas aktpropozimit të Ekrem Kallabës Mp-nr. 558/83, i datës 20 qershor 1983, është mbajtur dhe është mbyllur më 14 qershor 1984. Në bazë të vendimit të kolegjit gjyqësor është marrë vendimi për aprovimin e aktpropozimit, për anulimin e vendimit nr. 161/83 të datës 3 mars 1983 dhe për detyrimin e Qendrës së Shkollave të Mesme “9 Maji” në Dardanë për kthimin e Ekrem Kallabës në punën e mëparshme, me të gjitha të drejtat.

Vendimi i Gjykatës ende nuk ishte hartuar me shkrim. Kjo punë do të bëhej jo më larg se 15 tetori 1984. Vendimi nuk është i plotfuqishëm, thuhej në atë vërtetim të përpiluar më 14 shtator 1984 e të nënshkruar nga kryetari i Kolegjit – gjykatësi Enver Nimani<sup>31</sup>.

*Dhe, iu ktheve sërish arsimit?*

**Kema:** Fatkeqësisht, jo. Vendimi i sipërshtënuar nuk u bë i plotfuqishëm dhe, siç thuhej atëherë, në bazë të qëndrimeve të Komitetit Krahinor nuk m'u mundësua të kthehem në arsim.

*Dhe, ju qëndronit duarkryq?*

**Kema:** Çështje e vërteta, ne, një grup aktivistësh qysh më 14 shkurt 1990 patëm themeluar Shoqatën për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova. Për veprimtarinë time në SHKSHSHK dhe në Partinë Republikane do të flas në një kapitull më vete, duke përfshirë edhe vizitën e disa anëtarëve të kryesisë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim të një bashkëpunimi më të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes shqiptare në Kosovë.

---

<sup>31</sup> Vërtetimi i lëshuar nga Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në Prishtinë.

GJYKATA THEMELORE E FUNDS SE BASHKUAR  
NE PRISHTINE

Dt. 14 shtator 1984

Kp-nr. 558/83

Ne lidhje me aktproponimin dt. 20 qershor 1983 te Ekrem Kallabes nga Kamenica, te evidencuar ne Gjykatën Themelore te Funks se Bashkuar ne Prishtine me Kp-nr. 558/83, Gjykata e leshon keto

V E R T E T I M

Ghqyrtimi publik sipas aktproponimit te Ekrem Kallabes Kp-nr. 558/83 eshte mbejtur dhe eshte mbyllur me 14 qershor 1984. Mbi bazën e keshillimit dhe votimit te kolegjit gjyqesor eshte marrë VENDIMI mbi sprovimin e aktproponimit, mbi anulimin e Vendimit nr. 161/83 dt. 3 mars 1983 dhe mbi detyrimin e Qendres se Shkolleve te Resme "9 Shtet" ne Kamenice per kthimin e Ekrem Kallabes ne punet e perparme me te gjitha te drejtat.

Vendimi i Gjykatës ende nuk eshte përpiluar me shkrim. Kjo nene do te behet jo me larg se 15 tetori 1984. Vendimi nuk eshte i plotefuqenem.



Shefkatari i kolegjit - gjykatasi

Enver Himani

*Enver Himani*

*Ekrem Kallaba, vërtetim nga Gjykata themelore e PB në Prishtinë*

*Më herët e përmende edhe largimin e motrës sate, Dritës, nga procesi i arsimit. Mund ta japësh një biografi të shkurtër të saj?*

**Kema:** Po. Drita ishte vajza e vetme në shtëpinë tonë dhe dorë e djathtë e nënës sonë, në punët e shtëpisë.



*Drita Kallaba*

E brumosur me atdhedashuri dhe me kulturë arsimore, Drita, pas mbarimit të shkollës së mesme, vazhdoi studimet për pedagogji, në Universitetin e Prishtinës. Demonstratat e vitit 1981 Dritën e gjetën në Prishtinë, si të gjitha studentet e studentët e tjerë. Edhe ajo përkrahte kërkesat studentore. Në atë kohë ajo banonte në konviktin e studentëve në Prishtinë. Meqë unë atë kohë jetoja dhe punoja në Dardanë, tani po jap në formë të fragmentuar versionin se si ajo më kishte rrëfyer për largimin e saj nga procesi arsimor.

Në vitin shkollor 1988/1989, Drita, ishte pranuar mësuese në shkollën fillore “16 Nëntori” në Dardanë, respektivisht në Busavatë; në fshatin ku babai ynë kishte hapur për herë të parë këtë shkollë, para plot 40 vjetësh, më 1948.

Tani po shpjegoj një për një, në vetën e parë, rrëfimin nga vetë Drita: “Më 15 janar 1989, pra, në ditën e parë të gjysmëvjetorit të dytë, zëvendës drejtori i shkollës, Ibrahim Thaçi, i shoqëruar edhe nga një arsimtar rasti, Rexhep Gashi, kishte ardhur në shkollën e Busavatës. Isha në mësim me nxënësit e klasës së katërt, dhe sapo kisha filluar njësinë mësimore.

Një trokitje paksa e parëndomtë ra në derë!

Hyr, - thashë, dhe u përpoqa që nxënësve t’ua ruaja përqendrimin në njësinë mësimore. Në derë u shfaq një burrë i madh e i mrrolur sa s’bëhet. Nxënësit u ngritën të gjithë në këmbë dhe përshëndetën mysafirin me – mirëdita! Derisa,

unë nxënësve u thashë që të uleshin, mysafirrit as që i bëri përshtypje kjo përshëndetje e këtyre vogëlushëve. Të paktën, t'ua kishte kthyer përshëndetjen, për mirësjellje. Ky ishte zëvendësdrejtori i shkollës, Ibrahim Thaçi. – Dhe, kur shpreha mirëseardhjen e tij me “Mirëdita”, ai mbërriti te tavolina ime e punës, kapi ditarin e mësuesit në dorë dhe më tha: – ec përpara! U nisa duke shikuar në drejtim të nxënësve. Në fytyrat e tyre pashë shqetësimin sikur korbi t'ua merrte nënën zogjve. Desha të ndalesha dhe ta caktoja një nxënës që të mbante qetësinë derisa të kthehesha, por ai sërish m'u drejtua: - dil në korridor! Ashtu dhe ndodhi. Në korridor ishte shoqëruesi i tij Rexhep Gashi, arsimtar i edukatës fizike. Më përshëndeti paksa habitshëm, ndërkohë, unë e përshëndeta për dore. Ndërhyri me vrazhdësi zëvendësdrejtori Thaçi dhe tha: - Je e pushuar nga puna, sepse ke marrë pjesë në demonstrata.

Dhe, tani? - pyeta unë. Tash do të vish me ne në Dardanë.

– Atëherë më lejoni të përshëndetem me nxënës dhe t'u them se për këtë ditë ka përfunduar mësimi.

Jo, nuk bën; nuk e humb dot unë punën për ty.

Nuk më lejoi të përshëndetem as me kolegët e punës. Për një çast m'u kujtua një film shqiptar i kohës së okupimit fashist, kur mësuesi pushohet me dhunë nga puna. Më duket se quhej “Tinguj lufte”. Sikur të kisha pasur edhe unë mundësi t'u shpjegoja nxënësve të mi se kush janë këta që ua nxjerrin mësuesen nga klasa, vetëm e vetëm që do t'ua mësojë shkrimin shqip; t'ua mësojë gjuhën dhe historinë shqiptare, t'ua mësojë këngën “Ty flamur të duam shumë”; ah, i mjerë populli ynë. Duke dalë korridorit, sytë m'u mbushën me lot për këtë lloj ndarjeje nga nxënësit, por shpejt mora veten që të mos dorëzohem para kësaj sjelljeje prej kuislingu të zëvendësdrejtorit. Më urdhëroi të hyja në makinë, pronar i së cilës ishte arsimtari Rexhep. Kur u nisëm, arsimtari Rexhep iu drejtua zëvendësdrejtorit: Ibrahim, pse nuk më tregove arsyen e ardhjes në Busavatë? Ti më the se po shkojmë për një vizitë të zakonshme. U drejtua nga unë dhe tha: më fal, Dritë, po ta dija nuk do ta kisha shoqëruar zëvendësdrejtorin. Rrugës për në Dardanë, nuk nxirrja fjalë nga goja. Ata ishin ulur përpara, kurse unë prapa. As ata nuk flisnin gjë, sepse Rexhepi ishte po ashtu i inatosur për pabesinë e Ibrahimit. Ndërkaq, mua m'u kujtua një rrëfim i vëllait tim, Ekremi, kur tregonte se si, po këtij Ibrahimit, ia kishte përgatitur temën e diplomës.

Ofshava dhe mblodha edhe më shumë forcë për mosnënshtrim, pavarësisht se çfarë po më priste në Drejtorinë e shkollës.

Rruga nga Busavata në Dardanë ishte e paasfaltuar dhe, në kushte të dimrit, me shumë gropa. Pas nja rreth 40 minutash arritëm në Dardanë. Ibrahimimi u fut i pari në zyrë. Aty ishin tri karrige. Në njërin u ul Rexhepi, në tjetrën Ibrahimimi, ndërsa në të tretën vendosi këmbët e veta, si të ishte kauboj. Unë mbeta në këmbë. Pastaj, me një përbuzje, m'u drejtua: "me pas nejtë urtë, ishe tu punue, por s'ke nejtë urtë, tash shko te shpija". Ndërkohë pati ardhur edhe drejtori i shkollës, Pera Naskoviq. Pasi më dha letërlargimin, drejtori Naskoviq më tha: "bori se za sebe i za svoja prava, prijatno!" - lufto për vetveten dhe për të drejtat e tua, mirupafshim!. Kështu, mbeta në shtëpi, derisa më është hequr ndalesa për punë, pas nja dy vjetësh".

*Ishte ky i gjithë rrëfimi biografik për Dritën, apo ka ende çfarë për t'u thënë?*

**Kema:** Po, si jo. Ka për t'u thënë shumë, sigurisht. Të kthehemi prapa në vitet e protestave studentore. Për shkak të origjinalitetit të përshkrimit, sërish po e jap rrëfimin në vetën e parë, të shprehur nga vetë Drita.

"Gjatë demonstratave të 26 marsit 1981 isha në Prishtinë. Si të gjithë studentet e studentët, edhe unë iu bashkova masës. Në një moment, grupin ku isha unë, na kanë ndjekur milicia, duke na hedhur edhe gaz lotsjellës. Me disa shoqe arritëm të afrohemi te konvikti nr. 5, që ndodhej në ndërtim e sipër. Sërish një mjet shpërthyes me gaz ra në hyrje të konviktit. Ashtu nëpër tym disi u ngjitëm shkallëve. Dësh plasa nga tymi i gazit. Ashtu gjysmë e alivanosur arrita në katin e dytë. Ndërtesa ende ishte pa dritare. Shkuam drejt pjesës së pasme dhe detyrimisht kërcyem nga kati i dytë, ku toka ishte më afër se në pjesën e përparme. Ashtu e rrëzuar përtokë, kapa disa gurë në dorë, por kur desha të ngrihesha, vërejtja se i kisha lënduar të dy këmbët. Nga gazi lotsjellës më ishte ënjtur fytyra, sytë më lotonin vazhdimisht. Për fat, aty takova kushëririn tim, Shpendin, i cili më ndihmoi deri te turma. Më tha se diku këtu ishte edhe aga Xhexhë, kështu e quaja unë vëllain tim, Xhevdetin. Ecja me vështirësi, por s'kisha zgjidhje tjetër.

Afër mensës së studentëve e takova vëllain, Xhevdetin, i cili, edhe pse ishte i

punësuar në RadioTelevizionin e Prishtinës, ishte solidarizuar me studentët.

E thirra. Shpejt vrapoi tek unë. Provoi ta ndalte ndonjë makinë që të më shpinte në spital. Njerëzit kishin frikë edhe të ndaleshin. Për një çast vëreja se një makinë u ndal para këmbëve të Xhevdetit. Ishte një kolege e tij e punës, këngëtarja Shpresa Gashi. Më dërguan në spital dhe pas ndihmës së dhënë, shkuam në banesën e Xhevdetit, që banonte privatisht te një zonjë boshnjake, e martuar për shqiptar, në lagjen e Muhaxhirëve. Ajo ishte teta Hana dhe kishte edhe motrën e saj, teta Tima. Erdhën shpejt në dhomë dhe filluan të më sillnin lecka të bardha, të mbushura qull me kos. M'i vendosnin pandërprerë në fytyrë. Isha e rraskapitur. Dikur më kishte zënë gjumi, derisa ato kishin shkuar, ndërsa në dhomë, kur u zgjova, pashë se kishte ardhur edhe Nexhmija, vajza me të cilën shkonte Xhevdeti. Disi edhe ajo kishte arritur t'i shmangej ndjekjes nga milicia, ngase edhe ajo banonte në konvikti.



*Drita (ulur majtas) gjatë studimeve me motrat Nexhmije e Jalldeze Hoti*

Më vonë pasuan edhe demonstratat e 1 dhe 2 prillit 1981. Sërish tollovi dhe kolonë studentësh nga mensa drejt fakulteteve dhe qendrës së qytetit. Vinin nga të gjitha qytetet e Kosovës. Poshtë, në drejtim të Fushë-Kosovës, shiheshin minatorë të shumtë me helmata. I gjithë populli i bashkohej turmës së studentëve. Fundja edhe ne ishim të këtij populli. Secili kishte një të afërm të vet. Nga zyrat e Fakultetit Juridik e Ekonomik sodisnin profesorë të shumtë, ose ishin zyrtarë të SPB-së, nuk guxoj të paragjykoj. Aty-këtu, nga zyrat dikush fotografonte ose xhironte... Shërbimi sekret kishte vëzhguar vazhdimisht lëvizjet e studentëve.

Një ditë maji të vitit 1981, organi i komisionit disiplinor në Universitet më kishte ftuar të paraqitem në Katedrën e Pedagogjisë. Të pranishëm në sallë ishin profesorët Neki Juniku dhe Islam Krasniqi, si dhe zyrtarët e SPB-së.



Në pyetje më morën zyrtarët e SPB-së. Me ata ishte edhe një femër e quajtur Drita. Pyetja bosht ishte pjesëmarrja ime në demonstrata.

Nuk e mohoja dot. U thashë se kam marrë pjesë për mbrojtjen e të drejtave tona, për Kosovën Republikë.

Ata m'u vërsulën, duke më kërcënuar dhe tentonin të më bindnin se jetonim në kushte të mira. Ndërkaq, unë iu drejtova: atëherë më bindni ju se pse Kosova nuk ka nevojë për Republikë. Sërish m'u vërsulën si të tërbuar dhe iu drejtuan profesorëve: përgjigjuni ju studentes suaj, pse Kosova nuk ka nevojë për Republikë. Ata mbetën të nemitur; profesori Islam iu drejtua prof. Neki Junikut që të ma parashtronte pyetjen, por ai nuk nxori fjalë nga goja.

Pas kësaj bisede unë mora dënimin: parapërdjashtim nga Fakulteti dhe gjatë tre vjetëve të ardhshëm nuk kam pasur të drejtë t'u nënshtrohem provimeve pa nënshkrimin e dekanit të fakultetit. Këtë rregull e respektonin të gjithë profesorët, përveç, profesorit të Historisë së Pedagogjisë, Hajrullah Koliqit, i cili më ka pranuar pa nënshkrim, duke më thënë: - "Për lëndën time unë jam këtu dekan".

Në hall ishin edhe profesorët! Në njërën anë kishin dhembshuri për studentët, në anën tjetër trysni nga sigurimsat...

Më kujtohet një rast kur shkova te referenti për ta paraqitur një provim. Atij ia kishin dërguar një fletë me emrin tim, ku duhej të shënonte çdo detaj rreth meje që do të vinte nga komuna prej nga vija, pra, nga Dardana. Kështu, këto fletëdosje tonat u jepeshin për kontroll në çdo moment, kur kërkonin, zyrtarëve të SPB-së. Referenti, Asllani nga Mitrovica, kishte dëgjuar shumë për mbrojtjen time gjashtorëshe para komisionit disiplinor, dhe kur ia dhashë fletëparaqitjen për provim, shfletoi fletëdosjet e studentëve që ishin nën vëzhgim, më shikoi me dhembje, si të isha vajza e tij, dhe m'u drejtua: Dritë, unë po e shqyej fletëdosjen tënde, me një kusht, që të mos më dekonspirosh për këtë veprim, ndryshe do të më mbeten 5 fëmijë pa bukë. Unë i thashë që ai të mos rrezikonte, por ai ishte i vendosur në vendimin e tij dhe bëri atë që tha.

Pra, profesorët e nderuar, Islam Krasniqi, Neki Juniku, Avni Presheva, Hajrullah Koliqi dhe referenti Asllani, nuk më kujtohet mbiemri, sheshazi më

mbështetnin dhe kishin besim tek unë, sidomos pas marrjes 6-orëshe në pyetje nga zyrtarët e SPB-së e në prani të shumë profesorëve të katedrave të tjera të Universitetit, dhe paluhatshmërisë për bindjet e mia.

Dhe, vazhdimisht isha nën vëzhgim. Kështu, në korrik të vitit 1982 punëtori i sigurimit, Ali Vllasi, kishte ardhur në Koretin, ku jetoja unë me prindërit. Aliu e njihte babanë tim. Ata kishin punuar së bashku në vitet '70 si mësimdhënës në shkollën e Koretinit. I tha se duhej të më merrte e të më dërgonte në SPB në Dardanë për një bisedë informative. E, babai e pyeti për arsyen e marrjes, ndërkaq Aliu ia ktheu: lidhur me pjesëmarrje në demonstrata. I tha edhe diçka me zë të ulët, por nuk arrita ta kuptoja. Çështë e vërteta, Aliu dhe familja e tij kishin respekt për babanë tim si veteran i arsimit, dhe babai nuk dyshonte se do të më bënin diçka të padrejtë. Pas dhjetë minutash arritëm në SPB, në Dardanë. Aty më kanë mbajtur 24 orë në paraburgim. Gjatë gjithë qëndrimit më kanë marrë në pyetje punëtorët e SPB-së, Naser Shevelli, Ramadan Sermaxhaj, disa zyrtarë serbë dhe së fundi edhe Ali Vllasi. Torturat ishin llojesh të ndryshme. Më shumë psikike-psikologjike. Njëherë kinse me të mirë dhe me gjentilencë, pastaj Ramadan Sermaxhaj më solli një letër të pastër, ku do të denoncoja pjesëmarrës të tjerë të demonstratave dhe kur unë nuk shkruaja asgjë në letër, atëherë ai bëhej nervoz. Për të tretën herë, kur pa se nuk kisha shkruar asnjë emër në letër, Sermaxhaj u bë nervoz dhe mori kërbacin të më mëshonte në kokë. Në atë moment hyri Ali Vllasi, i cili e ndërpreu, duke i thënë: tani Drita është rasti im. Unë do të merrem me të. Aliu u tha të tjerëve se ai më kishte marrë nga dora e babait tim dhe se tani do të më kthente personalisht në shtëpi. Në dalje nga dhoma e marrjes në pyetje iu drejtua kolegëve të tij me fjalët: “ju, po të doni, sërish nesër mund ta merrni dhe të bëni ç’të doni me Dritën, por sot kjo do t’i dorëzohet babait të saj”. Ashtu dhe ndodhi. Nuk e di përse veproi Aliu kështu. Mendja më iku nëse kjo do të jetë vetëm një taktikë e tij për të më përvetësuar, por jo, pas dhjetë minutash unë isha në shtëpi.

Pas një muaji, sërish kanë ardhur në Koretin Naseri dhe Ramadani, më kanë marrë dhe më kanë dërguar në SPB të Gjilanit. Atje më ka marrë në pyetje Refik Thaçi. Për nja tri orë rresht, inspektori Refik, kërkonte informata nga unë, por unë nuk pranoja asgjë. Përdorte lloj-lloj metodash. Njëherë më tha: “veç kam ngrënë shumë bukë në odën e babait tënd, sa isha mësues në Koretin, se përndryshe do ta kishe pësuar rëndë ti, Dritë”. Ndërkaq unë ia ktheva: prandaj, nuk e thotë më kot populli: “buka jote të vret”, çka edhe e egërsoi shumë Refikun.

Më pas nuk pata probleme. Fitova përshtypjen se Ali Vllasi do ta kishte mbyllur dosjen time, ndërsa unë vazhdova studimet deri në mbarim të plotë”.

*E të tjerët nga familja, u përfshinë në aktivitete të çështjes kombëtare?*

**Kema:** Natyrisht, secili në mënyrën e vet, por më i ekspozuari ishte edhe Reshati.

Shkurtazi po jap një kronologji të pasojave nga Sigurimi Shtetëror Jugosllav për shkak të aktiviteteve të Reshatit, të deklaruara nga vetë Reshati.



*Reshat T. Kallaba*

Maj 1982: - Ishin ditët e fundit të shkollimit të mesëm, kur policia arriti në oborrin e shkollës me “NIVËN” dhe me një “Zastavë 101”, të cilëve u printe inspektori Ramadan Sermaxhaj, me disa policë të tjerë dhe kërkuan që unë të shkoja me ta, mirëpo, falë vendosmërisë së profesorëve dhe turmës së maturantëve, i shpëtova vizitës së padëshiruar.

Nëntor 1983: - Po i njëjti inspektor, në rrugë mes shkollës “9 Maji” dhe stadiumit të qytetit më ndali dhe prej meje kërkoi që unë asnjëherë të mos kaloja kësaj rruge, si dhe të mos sillesha rreth shkollës, veçanërisht pasi të errësohej, sepse po që se më zë edhe një herë, do të më çojë në birucë.

Mars 1986: - Isha i detyruar të largohesha nga banesa si dhe nga shtëpia, për shkakun që nga policia më është thyer tri herë banesa dhe është bërë bastisje pa praninë time dhe të asnjë banuesi tjetër, nga inspektorët Ramadan Sermaxhaj dhe Naser Shevelli.

Shkurt 1988: - Isha duke shkuar rrugës Roganë – Muçivërc për ta përgëzuar një shok për fejesë. Inspektorët Ramadan Sermaxhaj e Naser Shevelli papritmas ndalen me një veturë, por unë me një shok vazhduam të ecim. Vetura kthehet

prapa dhe ndalet para këmbëve tona. Prej nesh kërkohet që të hymë në veturë dhe na dërgojnë në stacionin e policisë, rreth orës 21:30 gjer në 2:30. Gjatë kësaj kohe, nga torturat, tri herë e kam humbur vetëdijen. Lëndimet më të mëdha i kisha në qafë, ku pas disa ditësh më është dashur t'i nënshtrohem operacionit të bajameve; marrjet në pyetje vazhduan edhe javët në vijim – dy herë në javë. Të gjitha marrjet në pyetje ishin të vështira dhe me keqtrajtime psikofizike.

Shkurt 1990: - Më arrestuan dhe më sollën SPB (Sekretariati i Punëve të Brendshme) ku qëndrova nga e hëna, 12 - 14. 2. 1990, prej orës 8:00 gjer të mërkurën në orën 12:30. Gjatë kësaj kohe kam përjetuar tortura nga më të ndryshmet – kërcënim me likuidim; disa herë më është futur në gojë tyta e automatikut nga disa inspektorë serbë. Inspektorët serbë nuk i njihja, por këta shqiptarë i njihja shumë mirë. Me gjasë këta inspektorët shqiptarë sikur kishin trysni nga eprorët e tyre serbë që të mbillnin frikë te ne, prandaj na torturonin së tepërmi. E kujtoj milicin Xhavit Basha, i cili nga unë kërkonte të tregoja organizatorin dhe më sillte këmbëve me kërbaç, me sa kishte fuqi. Shtatëmbëdhjetë herë më ra në pjesën mbi gjunjë. M'u duk se m'u këput këmba nga dhembja. Keqtrajtimet nuk mund t'i rikujtoj, sepse më krijojnë vështirësi psikike për të gjitha ato poshtërsi që më janë bërë.

Këto keqtrajtime të vazhdueshme më janë bërë kryesisht për shkak se unë kisha bërë anëtarësimin e qytetarëve në Lidhjen Demokratike të Kosovës, në janar 1990.

Gjatë qëndrimit në burg, nuk jam keqtrajtuar fizikisht, ndërsa pas daljes nga burgu sërish më kanë kërkuar, por unë kam ikur një muaj. Pasaporta më është marrë qysh në muajin shkurt dhe nuk më është kthyer. Në burg kam qëndruar dy muaj e dy ditë.



*Vendimi për konfiskimin e pasaportës së Reshatit*



*Vendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Dardanë, dënoi Reshat Kallabën me 60 ditë burg, për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata më 28 dhe 29 janar 1990*

*Ishte edhe dikush tjetër në burg për aktivitete politike në periudhën e fundit?*

**Kema:** Po, Fadil Faik Kallaba ka qenë aktivist i palodhshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Dega në Ferizaj, dhe nga modestia, pas luftës, asnjëherë nuk ka kërkuar ndonjë post ose as edhe ndonjë vend pune. Familjen e ka mbajtur duke punuar natë e ditë si axhustator, profesion ky që e mësoi nga nevoja për mbijetesë, pas largimit nga vendi i punës në fabrikën e ujtive, në Ferizaj qysh në vitin 1981. Gjatë bombardimeve nga forcat e NATO-s, më 25 maj 1999, Fadili arrestohet nga policia serbe, dhe në Gjilan, gjyqi i ashtuquajtur serb, bashkë me



Sabit Hoxhën dhe Nijazi Hajdarin, po ashtu nga Ferizaj, i nxjerr para gazetarëve me akuzë se kanë spiunuar në favor të NATO-s, dhe se me veprimet e tyre kanë ndihmuar mjetet telekomunikuese të NATO-s për të goditur caqet ushtarake serbe në Kosovë. Pas këtij gjyqi, Fadili dërgohet në mbajtje të dënimit në Vranjë. Pas intervenimit të Kryqit të Kuq ndërkombëtar, por edhe angazhimit të familjes së tij, duke paguar edhe para, pas afro tre muajsh lirohet nga burgu, mirëpo i dërrmuar nga keqtrajtimet psikofizike të policisë serbe. Nga pasojat e burgut, Fadili, pas disa vjetësh, vdes në moshën 61-vjeçare.



*Në ballinën e gazetës „Bota Sot“ të datës 26 maj 1999, i pari nga e majta Fadil Kallaba*



*Fadil Faik Kallaba  
19.5.1951 – 30.3.2012*

Po ashtu, edhe vëllai i tij, Faruku u dënua me tetë muaj burg nga regjimi i Serbisë, për padëgjueshmëri në vendin e tij të punës, në Hekurudhat e Kosovës; sidomos pas insistimit dhe veprimit të tij që dërgesat nga Ferizaji në drejtim të republikave të tjera të ish-Jugosllavisë të bëheshin në gjuhën shqipe, ose të paktën serbokroatisht, por në alfabetin latin e jo në cirilikë. Për të shmangur mbajtjen e burgut, Faruku u detyrua të largohej nga Kosova dhe të emigrojë në Gjermani në vitin 1992.




*Faruk Faik Kallaba*





Shtypi serb shkruan për rastin e Faruk Kallabës



Vendimi për largim nga LKJ dhe dënimi me burg prej dy muajsh. Më pas gazeta serbe shkruan se Faruku ishte dënuar me tetë muaj burg.

Edhe kushërinjtë Nusret dhe Bajrush (Xhemail) Kallaba janë dënuar me nga 60 ditë burg për kundërvajtje, për shkak të protestave të janarit 1990. Nusreti dënimin e ka vuajtur në burgun e Dubravës nga 9 shkurti 1990, ndërsa Bajrushin në burgun e Gjilanit nga 6 marsi deri më 5 maj 1990, ndonëse dy ditë i kishte kaluar në paraburgim në Dardanë e ku ishte keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht. Ky ishte një përjetim i rëndë për babanë, Xhemailin, por, siç thoshte edhe

vetë baca Xhemail: - lirinë asnjëherë nuk na e kanë falur, porse është dashur gjithëherë ta paguajmë shtrenjtë“.

PAGESA E ANËTARËSISË			
Viti	Data	Pagoi	Nënshkrimi
2002			
2003			
2004			
2005			
2006			
2007			
2008			
2009			
2010			
2011			
2012	01.20.12E		

Nusret Kallaba u dënua dhe e vuajti burgun prej 60 ditësh në burgun famëkeq të Dubravës, në Istog

Nr. \_\_\_\_\_  
 Ik. \_\_\_\_\_  
 05.05.1990 viti.  
 Gj. i. i. u. -  
**FLETA E LESHIMIT — ODPUSNA LISTA**  
 Bajrush Kallaba nga fsh. Rogosicë KK-ës Mënenicë e Kosovës  
 05.05.1990 viti.  
 Dënimin e ka shpallur prej 05.05.1990 për 60 ditësh.  
 Kashti i shpallur prej 05.05.1990  
 Dënimin e ka shpallur prej 05.05.1990 për 60 ditësh.  
 Kashti i shpallur prej 05.05.1990

Fletëlëshimi i Bajrush Kallabës për vuajtjen e dënimit prej 60 ditësh në Burgun e Qarkut, në Gjilan

*Po, vëllezërit e tjerë, patën telashe me pushtetin e kohës?*

**Kema:** Në aspektin politik - jo, sepse Xhevdeti nuk punonte që nga viti 1990 në Televizionin e Prishtinës, porse, nga nostalgjia për Televizionin, shpesh organizonte dhe incizonte manifestime të ndryshme kulturore, politike e sportive në Roganë dhe në rrethinë. Në fakt, ai ishte një kronist kohe dhe përpiquej të regjistronte sa më shumë manifestime që bëheshin brenda komunës së Dardanës. Nuk kishte ndonjë kamerë të veten, por, kur i jepej mundësia, siguronte nga miqtë e tij. Natyrisht, në arkivin e tij sot ka me dhjetëra, madje me qindra videokaseta të periudhës para dhe pas luftës së vitit 1999. Ai ishte dëshmitar edhe i një rrethimi që i ishte bërë shtëpisë sonë më 31 mars 1992, ditë e martë. Prandaj, ja edhe rrëfimi i tij në vetën e parë:

***Xhevdeti:** Ishte ditë e martë e 31 marsit 1992. Nexhmija ishte zgjuar më herët se zakonisht dhe po i kontrollonte disa detyra shtëpie të Granitit. Që të dy ende ishim në shtrat. Isha zgjuar, por më dukej se ende kisha nevojë për gjumë, ngase kisha lexuar deri vonë pas mesnate librin e sapodalë nga shtypi “Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve”, botuar nga Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova, anëtar i së cilës isha edhe vetë; një libër tejet përmbledhës për shpërnguljet e shqiptarëve: në Turqi, Greqi, Hungari, Zarë, Istrië etj., përgatitur nga një grup autorësh dhe me dr. Pajazit Nushin, kryeredaktor.*

*Rreth orës shtatë të mëngjesit dikush trokiti në derë dhe menjëherë edhe në dritaren pranë derës së hyrjes të katit të tretë. Nexhmija u shqetësua, lëshoi librin e matematikës dhe më preku në krahë. Zgjohu, Xhevdet, një milic është te dritarja. Ktheva kokën nga dritarja, ndërkaq kur milici e vërejti se unë e pashë atë, më dha shenjë me gishtin tregues që të dilja jashtë. U ngrita shpejt e shpejt. Nuk e kisha idenë se për ç’arsye kishin ardhur. Mendja më shkoi te incizimi që ia kisha bërë ceremonisë së varrimit të Muharrem Robellit, që ishte vrarë në armatën jugosllave, në shtator të vitit 1991. Me të shpejtë vesha tutat e poshtme e mbi to edhe pantallonat. Pranë shtratit i kisha një palë çorapë, por i thashë Nexhmijes që t’m’i gjente edhe një palë, sepse, siç po shihet, nuk po më shkruhet mirë. Nga njëra prej syzave të vitrinës nxori një palë çorapë dimri dhe m’i ofroi. I mbatha edhe ato, pastaj një këmishë, e sipër saj një xhemper të leshtë dhe një pardesy prej stofi. Pa u vonuar, dola përjashta. Para derës po priste një milic rreth një metër e tetëdhjetë*

*i gjatë, me një trup atleti. - Duhet të vish me ne, - tha, dhe, sapo dola te shkallët e katit të tretë, ku banoja unë, pashë një grumbull prej nja shtatë-tetë milicësh, të shpërndarë nëpër oborr. Një tjetër, që nuk ishte i uniformuar, kishte shkuar te qeni, që ishte nën hajat të plemes, dhe po e ledhatonte. Ishte i racës autoktone të Sharrit. U habita kur e pashë se si nuk e kishte sulmuar. Nejse, kur arrita në pushimoren e katit të parë, e dëgjova një civil tjetër, duke iu drejtuar milicit që po më shoqëronte: “da je nešto politički, onda bi verovao, ali za ovo što smo mi došli, ne verujem da je on prava osoba“ (Sikur të ishte diçka politikisht, do të besoja, por për këtë që ne kemi ardhur, nuk besoj të jetë ky personi i duhur). Ne po e kërkojmë Elhamiun, m’u drejtua inspektori i SUP-it (MPB). Ndërkohë një milic tjetër tashmë doli nga kati i dytë bashkë me Elhamiun, kurse një tjetër me Selamiun, i cili banonte në katin përdhës, të cilit ia kishin konfiskuar një pushkë gjuetie.*

*Para dyerve të oborrit ishte një furgon i milicisë. Derisa erdhën Elhamiu e Selamiu, në pikën ku isha unë, inspektori më tha: kemi informacionin se në këtë oborr është shkarkuar një kamion me armë, prandaj ne jemi sot këtu dhe se personi që akuzohet është Elhami Kallaba. E solla kokën dhe me një buzëqeshje paksa ironike i thashë se kjo nuk është e vërtetë, ndërkaq inspektori më tha se nuk mund ta mohosh një gjë të tillë. Në atë çast pranë nesh milici e solli Elhamiun, duke i thënë inspektorit: ja, ky është Elhami Kallaba, të cilin po e kërkojmë. Atëherë ai iu drejtua Elhamiut: duhet të na tregosh ku janë armët, kurse Elhamiu fare qetë e gjakftohtë ia ktheu: Këtu nuk ka armë! Po, mirë atëherë, a e njeh ti Xhemini e Topanicës? Po, i tha Elhamiu. - E revolja, që ta ka shitur ai, ku është? Nuk është e vërtetë, vazhdoi Elhamiu qetë-qetë rrefimin rreth asaj revoleje. - E vërteta është kështu, dhe vazhdoi Elhamiu: Një mbrëmje kemi luajtur bixhoz dhe unë ia kam zënë njëqind marka. Xhemi ma ka ofruar një revole që t’ia blija për të vazhduar lojën e bixhozit. Unë nuk kam pranuar. Jam mjaftuar me ato 100 marka. -Do të tregosh ti pastaj, kur të ballafaqojmë në Gjilan, - u shpreh egër inspektori dhe ia tregoi rrugën drejt furgonit. Njësoj këtë rrugë ia tregoi edhe Selamiut milici tjetër, i cili po e mbante në dorë pushkën e gjuetisë, të cilën Selamiu e kishte pas lënë pas dere, pas kthimit nga gjahu dy ditë më parë. Njëri nga milicët e kishte vërejtur nga dritarja dhe ishte futur brenda në dhomë, ku e kishte marrë pushkën, por edhe Selamiun. Ndërkaq, mua m’u drejtua inspektori me këto fjalë: “Ja sam Srdjan Djordjević, ako hoćeš da znaš gde su ti braća, javi se u SUP Gnjilane, kancelarija broj 22” (Unë jam Sërgjan Gjorgjeviq, po deshe ta dish se ku i ke vëllezërit, paraqitu në SPB Gjilan, zyra numër 22). Elhamiun e Selamiun i futën në furgon dhe vazhduan në drejtim të Lagjes së Muhaxhirëve. Më vonë, në fshat*



*kishin marrë edhe të tjerë, me pretekstin e kërkimit të armëve dhe që të gjithë i kishin dërguar në Gjilan.*

*Për këtë veprim milicët nuk kishin paraqitur kurrfarë fletarresti. Nga shqetësimi, as mua nuk më ra ndër mend t'ua kërkoja.*

*U ktheva në dhomë, mora çelësat e veturës dhe shkova në Dardanë tek Ekremi. I tregova se ç'kishte ndodhur në atë mëngjes. Bashkë me të shkuam për në Gjilan. Në hyrje të stacionit të milicisë, e takuam Ramadan Sermaxhën, të cilit i treguam për rastin. - Shkoni pritni në hotelin "Kristal", që ishte përballë SPB-së, dhe unë do ta shoh se si është puna. Hymë në "Kristal", porositëm nga një kafe dhe po prisnim. Pas nja 15 minutash, erdhi Ramadani, i cili dikur kishte qenë edhe nxënës i Ekremit e i tha: Profesor, po përpiqem që ta liroj njërin nga vëllezërit, sepse që të dy nuk ka mundësi, dhe sërish u kthye në ndërtesën e SPB-së. U mërzitëm duke qëndruar në restorant dhe dolëm jashtë me shpresë të takonim dikë që do të na informonte për gjendjen brenda. Më vonë, në shesh, e takova Haqifin e Rudhanëve, që sapo ishte liruar nga inspektorët e SPB-së. Nuk e dija se edhe ai kishte qenë brenda. U ndal, më foli nga afër, por nuk ma zgjati dorën, sepse që të dyja i kishte të ënjtura nga goditjet me kërbaç, që ia kishin shkaktuar brenda, në stacionin e milicisë, në Gjilan. - I pashë edhe vëllezërit tuaj që i sollën brenda, - më tha. - Gjejeni dikë që të intervenojë, se mos vet për ta, - shprehu brengën Haqifi dhe u përshëndet duke më shpjeguar: Më duhet të shkoj në shtëpi, sepse janë merakosur familja ime, - tha dhe vazhdoi rrugën drejt kazermës ushtarake, ku ndaleshin autobusët ose taksistët për në Roganë.*

*Pritja në shesh të Gjilanit ishte e bezdisshme. Ishim të dy në ankth për fatin e Elhamiut dhe të Selamiut. Selamiu ishte më hall lig, dhe gjasat për ta rrahur ishin më të mëdha, ngase, në shtëpi, ia kishin gjetur një pushkë njëtytëshe pa leje. Një çifte, që ishte trashëgimi e agës Tefik, e që e mbante Selamiu, sepse ai merrej me gjueti, ia kishin konfiskuar pothuajse një vit më herët për shkak të pjesëmarrjes së Reshatit në protestën e fundvitit 1990 në Roganë.*

*Në pritje e sipër, Ekremin e përshëndeti një mesoburrë serb. U largova nja dy-tri metra nga ta, porse bisedën e dëgjoja. Serbi kishte qenë një ish-pronar restoranti në Crep, të cilin Ekremi e kishte frekuentuar me qindra herë. Bisedonin për gastronomi si dy pronarë restorantesh. Ekremi nuk ia përmendi fare arsyen pse po priste para hotelit Kristal. Ora tashmë ishte rreth 15:30. Pavetëdijshëm isha duke*

bërë disa hapa para e po aq edhe prapa, kur para meje po vinte një njeri gjysmë i buzëqeshur, i shoqëruar edhe nga një person tjetër. Në momentin e fundit e njoha se ishte Sërgjani. Ishte nisur tek unë, kurse unë desha ta drejtoja nga Ekremi, si vëlla më i madh që ishte. Jo, jo, - më tha, - ty po të drejtohem: Këtë radhë fitove ti, vëllezërit do të lirohen pas pak, mbase deri nga ora 17:00. Ekremi nuk e njihte Sërgjanin. U nda nga kolegu i tij i gastronomisë dhe iu bashkua bisedës sonë. Po, mirë, zoti Sërgjan, e kush do të japë llogari për shqetësimin që më është bërë sot në mëngjes, - i thashë me një gjysmë buzëqeshjeje. - Mos bëj shaka tani, zoti Kallaba, duhet të jesh i kënaqur që vëllezërit nuk kanë hëngër dajak si shumë të tjerë nga Rogoçica. Nuk e zgjati më shumë bisedën, u përshëndet dhe shkoi drejt ndërtesës së SPB-së.

Paksa më të relaksuar, por jo edhe plotësisht të sigurt për atë që na tha inspektori, bashkë me Kemën u futëm sërish në restorantin e hotelit Kristal. Zëmë një vend te dritaret, me pamje nga SPB-ja. Morëm nga një pije dhe po prisnim. Rreth orës 17:00 Elhamiu e Selamiu kaluan rrugën drejt oborrit të hotelit. Brofëm dhe dolëm nga restoranti. Bashkë u nisëm drejt veturës "Opel Kadet", që e kisha parkuar para shtëpisë së mallrave, e cila ishte rreth 150 metra larg hotelit.

Nuk nxirrnin fjalë prej gojës. Në fytyrën e tyre ende vërehej ankthi që kishin përjetuar brenda. Çështë e vërteta, ata nuk kishin hëngër dajak, por i kishin përjetuar rëndë torturat që u ishin bërë bashkëvendësve tanë.

Pasi u futëm në makinë, filluan të rrëfenin për përjetimin e tyre në stacionin e milicisë.

### **Rrëfimi i Elhamiut: Ishim pre e dezinformatave për shkarkimin e një kamioni me armë në oborrin tonë.**

Si zakonisht, zgjohem herët në mëngjes. Edhe atë ditë isha i zgjuar, kur në derë trokiti dikush. Hapa derën dhe pashë një milic të uniformuar. Në ish-sistemin komunist as që guxonim milicit t'i thoshim polic. - A je ti Elhamiu? - m'u drejtua me korrektësi milici, por nuk më paraqiti ndonjë fletarrest. - Ty po të kërkojmë, eja pas meje, - më urdhëroi. Sapo dola në qosh të shtëpisë, pashë një grumbull milicësh. Nuk hamendja shkakun e pranisë së tyre. Sapo zbrita në fund të shkallëve,



*pashë Xhevdetin që po bisedonte me njërin prej tyre, e që ishte në rroba civile. Ma mori mendja se ishte inspektor, por nuk e njihja. - Aha, ju jeni Elhamiu a, - m'u drejtua inspektori. Shkaku që jemi këtu është zbrazja e një kamioni me armë te ti. Më erdhi të qeshja, por u përmbajta. Ata nuk ishin në humor të mirë, prandaj nuk është mirë të bëja ndonjë provokim, - i fola vetes. - Nuk është e vërtetë, - i thashë. - Për këtë do ta shohim më vonë, tani futu në furgon, - më tha inspektori dhe u kthye për të folur diçka me Xhevdetin.*

*Bashkë me Selamiun na futën në furgonin e errët. Kur na dërguan në Gjilan, na thërrisnin një nga një brenda për të na marrë në pyetje. Secilin veç e veç. Brenda ishin Ramadan Sermaxhaj, Sërgjani dhe një inspektor tjetër, i cili po mbante në dorë një shkop bejzbolli. Atmosfera ishte tejet e nderë. Inspektori ma tregoi një fotografi. - A e njeh këtë person? - më pyeti Sërgjani? - Po, - iu përgjigja. - Është Xhemi nga Topanica, kështu e quajmë, - i thashë. - Keni luajtur bixhoz me këtë person? - ishte pyetja e radhës. - Po, ndonjëherë, - i thashë. Dhe a i ke zënë para, foli inspektori me një gjysmë buzëqeshjeje, kurse unë ia ktheva, po ashtu me buzagaz: po, besa, madje shpesh edhe e kam terë. Kam luajtur rrallë dhe mençur, mund të them. Kurrë nuk kam humbur paratë e mia, por edhe nuk kam synuar fitime të mëdha. Jam mjaftuar me pak. Pata mbetur pa punë, kështu që ndonjëherë edhe loja me letra ishte një lloj plotësimi. Më patën larguar nga fabrika e xeherores "Karaçeva" në Berivojcë.*

*Të jem i sinqertë, gjatë marrjes në pyetje nuk më torturuan. Me gjasë, e kishin kuptuar qëllimin e dezinformimit rreth armëve. Vetëm një herë më morën në pyetje dhe më liruan, porse duhej të prisja edhe të tjerët. Kur dëgjoja britmat brenda, derisa prisja në korridor, lutesha që të mos isha në lëkurën e tyre. Me këtë rast m'u kujtua një thënie e babait tim, Tefik Kallabës: "Secilit ia kapërcen shërrin i vet"!*

### **Rrëfimi i Selamiut: Mëngjesi më i trishtë në jetën time**

*Nga gjumi më zgjuan krismat e pazakonta të derës së hyrjes. Nuk e dija ç'po ndodhte, por ishte diçka e pazakontë. Hapa sytë dhe shikova nga dritarja. Pashë dy milicë. Atëherë e kuptova se diçka po ndodhte. Mendja më iku menjëherë te pushka e gjuetisë, që e kisha pa leje, sepse atë që e kisha më herët, me leje, ma patën*

konfiskuar milicia për shkak të Reshatit, që ishte organizator i demonstratave të vitit 1990, në Katushnicë. Ishte e qartë se pushkën mund ta kishin parë nga dritarja. Shpejt dola në korridor dhe hapa derën e hyrjes. Jashtë qenë katër milicë të tjerë. Pa ndonjë prezantim paraprak, më pyetën: - A ke armë? - Po, - u thashë. - Atëherë, na e sill. Hyra brenda dhe e mora pushkën njëtytëshe, e cila ishte e vjetër, por me të e hiqja merakun e gjuetisë, dhe ua dorëzova. Milici më shikoi vëngër dhe m'u drejtua. - Jo, jo këtë. Çështë kjo pushkë kështu, si një auspuh i veturës?! - më tha, dhe e hodhi në korridor. - Sille automatikun, - foli me kërcënim! Nuk kam tjetër, u fola bindshëm, kurse ai më tha që të bëhesha gati për të shkuar me ta. Milicët flisnin serbisht. Derisa unë po vishesha, njëri syresh më tha: Vishu pak më trashë, se nuk i dihet. U vetëkuptua se më dha edhe pak më shumë kohë, kështu që i veshja edhe një palë tuta, pastaj edhe pantallonat dhe dola pas tyre në oborr. Në oborr ishte edhe një grumbull tjetër milicësh, që gjithsej ishin nëntë. Derisa po shkoja drejt tyre, njëri milic më kapi për krahu dhe, sikur duke më marrë me të mirë, më tha: - Shko sille automatikun, sepse nuk ia vlen ta dorëzosh me dhunë. Sërish, me po të njëjtin ton bindës, i thashë: Nuk kam tjetër armë. Ai vazhdonte të më mbante për krahu dhe përdori një metodë që, tashmë, ishte e njohur prej dekadash ndër shqiptarë: - Shko sille armën, sepse ai fqinji yt na ka treguar. Çështë e vërteta unë nuk kisha armë tjetër, prandaj për këtë as që ndryshoja zërin e as thënien. I thashë, mbase e kanë parë këtë pushkë, sepse është njëtytëshe dhe ka mundur t'i dukej diku si pushkë automatike, por unë këtë e kam dhe nuk e kam mbajtur fshehtë nga fqinjët; kam dalë haptas në gjueti, duke qenë edhe anëtar i rregullt i Shoqatës së Gjahtarëve. - Ti di, por mos ha dajak pa nevojë, - shprehu milici "dhembjen" ndaj meje. Derisa unë po bisedoja me të, të tjerët merreshin me Xhevdetin, e, më pas, edhe me Elhamiun.

Pas pak na futën në një furgon të mbyllur hermetikisht, pa dritë. Furgoni u nis, por ne nuk e kishim idenë se në çdrejtim. Pas pak ndaloi, dera u hap dhe brenda e futën Adilin, një komshi nga Lagjja e Muhaxhirëve. Prej aty vazhdoi, për ne gjithmonë në drejtim të panjohur. Në furgon ishte qetësi. Askush nuk nxirrte fjalë nga goja. S'vonoi pak e furgoni sërish u ndal. Sërish u hap dera dhe brenda e futën bashkëfshatarin tjetër, Haqifin e Rudhanëve. Pak më vonë edhe Idrizin me djalin e tij. Me gjasë i kishin mbledhur të gjithë që i kishin në listë nga Rogana. Tani, furgoni po shkonte me një shpejtësi më të madhe dhe nuk u ndal për afro gjysmë ore, derisa arritëm në Gjilan, para burgut të qarkut. Nga furgoni dolëm nja tetë ose nëntë persona. Nga dera e përparme, bashkë me milicët, zbriti Mehmetaliu, të cilin e kishin marrë po ashtu për armëmbajtje pa leje, por edhe për t'ua treguar

shtëpitë e njerëzve të kërkuar. Kur më pa mua, më pyeti habitshëm: - E ti, çka po lyp këtu?. - Unë asgjë s'po lyp, por këta më morën, - iu përgjigja. - Për Elhamiun e kam ditur, e për ty jo, më shikoi habitshëm Mehmetaliu, i cili, me gjasë, kishte qenë më herët i informuar për listën e të akuzuarve.

Të gjithëve na drejtuan nga objekti i stacionit të milicisë. Pasuam milicin, i cili na drejtoi drejt katit të dytë. Ndaluam në fillim të një korridorit të gjatë. - Pritni këtu, - na tha njëri nga milicët. U ulëm në bankat e gjata prej druri. Në skajin tjetër të korridorit ishte zyra ku na merrnin në pyetje. S'vonoi shumë dhe filluan të na thërrisnin me radhë. Trishtimi sa vinte e shtohet edhe më tepër. Përfundoi raundi i parë, por mua nuk më morën në pyetje fare. Pas pak, filloi faza e rrahjes. Torturat nuk ishin aq të ashpra, tregonin ata që dëlnin. Në raundin e dytë torturat ishin më të ashpra. Nuk kishte nevojë askush të tregonte; britmat dëgjoheshin që nga brenda, edhe pse ishim në fillim të korridorit. Përfundoi edhe raundi i dytë, kurse mua, sërish, nuk më ftuan. Trishtimi sa vinte e shtohet më shumë. Isha i gatshëm ta provoja edhe unë. Në raundin e tretë torturat ishin edhe më të ashpra; britmat, sigurisht, dëgjoheshin edhe në rrugë e le më te ne në korridor, që ishte afro 30 metra larg.

Më në fund më erdhi radha edhe mua. Nga zyra doli inspektori Ramadan Sermaxhaj. Me gishtin tregues të dorës së djathtë ma bëri me shenjë që të shkoja tek ai. - A po e sheh, pra, më mirë është kur njihemi. Me këtë shprehje ai deshi të ma kujtonte një histori të mëhershme, në një ditë gjahu në Kamenicë. Pata shkuar për gjah me Kemën, kurse atij i ishin lutur që të na bashkoheshin edhe Halim Hajdari e Ramadan Sermaxhaj, punëtor të SPB-së. Ekremi, Ramadanin e kishte pasur dikur nxënës, kurse Halimin koleg arsimit. Unë isha ulur përpara, kurse ata, ndërkohë, u ulën prapa në veturë. Halimin e njihja qysh më herët, kur punonte arsimtar në Koretin, në fillimvitet '70. E kisha pasur arsimtar të lëndës së gjeografisë në shkollën fillore dhe e përshëndeta. Por, Ramadanin nuk e përshëndeta. Në fakt, e njihja, por nuk parapëlqejta ta përshëndesja për shkak të keqtrajtimit që ia kishte bërë Magbules, vajzës së dajës tim. Ai nuk më njihete, kështu që rrugës e pyeti Kemën: Ekrem, s'më tregove prej nga e kemi këtë shok? - Është vëllai im, - i tha Kema. Unë në kokë mbaja një kapelë me mbrojtës të veshëve, që të mos kisha të ftohtë në mal. Nuk e pata hequr fare, kur hipa në veturë. - Pa hiqe atë kapelë e njihemi, - m'u drejtua shoqërisht Ramadani. Nuk kisha pasur dëshirë fare të të njoh, por çfarë të bëj, - ia ktheva unë me një shpërfillje. Kemi mundur diku të rrihemi e të mos e dija se është vëllai yt, Ekrem. - Jo, s'ka mundësi

*unë të zihem me ty, sepse, nëse vjen puna deri aty, ti vetëm mund të më rrahësh, ngase je organ, e unë s'kam çfarë të bëj, - i thashë pa më shkuar fare ndër mend se mund të vinte kjo ditë, kur fati im do të ishte në mëshirën e tij.*

*Sa ishim në korridor, më tha që të mos e flisja asnjë fjalë, kur të më merrte në pyetje milici brenda. Ti vetëm ia dorëzon letërnjoftimin, kurse të tjerat i kryej unë, - shprehu superioritetin e tij pushtetar Ramadani. Pikërisht ashtu edhe veprova. Në zyrë, ai që duhej të më merrte në pyetje, ma kërkoi letërnjoftimin. Filloi të më pyeste, por unë nuk përgjigjesha. Në vend timin, përgjigjej Ramadani. Kjo sikur e nevríkosi njërin nga milicët, i cili rrinte pranë një dore të një zyre tjetër, me një shkop bejzbolli në dorë. Dan, largoja dorën nga supet, pse po e mban ashtu? Tash ia tregoj unë qejfin. Më shikonte mua me një shikim kërcënues, ndërkaq po e prekte pjesën e trashë të shkopit. Në atë moment Ramadani ia ktheu: - Jo, këtë askush nuk do ta prekë me dorë, kurse ai ia ktheu Danit: - Nuk ka mundësi të dalë askush nga kjo derë pa ia dhënë një grusht. Megjithatë, Ramadani ishte i prerë në vendimin e tij. - Nëse askush nuk ka dalë nga kjo derë pa dajak, ky do të jetë i pari. Ashtu edhe ndodhi. Nuk më preku kush me dorë.*

*Më pas vazhdoi procedura e dhënies së shenjave të gishtërinjve deri rreth orës 17. Për armëmbajtje pa leje, më dënuan me 306 marka gjermane.*

*Falë Ramadanit, shpëtova pa dajak, por për mua ishte dita më e trishtë në jetën time. Sidoqoftë, mua më takon ta falënderoj për këtë sjellje korrekte.*

*Shihet se femra në familjen Kallaba ka një vend meritor, gjithsesi falë aktivitetit të saj. Po, nga nuset e familjes Kallaba, ka ndonjë aktiviste që duhet veçuar?*

**Kema:** Pyetje me vend. Secila femër, qoftë vajzë ose nuse e familjes Kallaba, ka luajtur një rol të rëndësishëm në shoqërinë kosovare. Me shkollim superior ka qenë bashkëshortja e Xhevdetit, Nexhmija. Ajo është dëshmuar edhe si nënë e mirë, por edhe si aktiviste e denjë krah për krah me botën mashkullore. Nexhmija rrjedh nga një familje bujare e fisit Hot. Flitet se banorët e parë të fshatit Muçivërc ishin pikërisht nga familja Hoti. Babai i saj, Ramush Hoti, ishte një luftëtar i denjë për të drejtat e njeriut, sidomos për të drejtën e shkollimit të femrës shqiptare. Qysh nga prilli i vitit 1941 ishte zënë rob lufte nga forcat

ushtarake gjermane, pastaj u transferua në kampin famëkeq të përqendrimit “Dortmund 6/D” të Gjermanisë. Pas dy vjet vuajtjesh në atë kamp ia del të arratiset, bashkë me një shok nga Malisheva (Feriz Azizi), dhe t’i bashkohet një organizate internacionale partizane në Belgjikë.<sup>32</sup>



Fejtoni i gazetarit Nebil Duraku kushtuar Ramush Hotit dhe aktivitetit të tij (bashkë me Feriz Azizin) në Gjermani e Belgjikë

Nexhmija, në shkollën fillore dhe të mesme, shquhet për suksese shembullore. Drejtoria e atëhershme arsimore e kishte shpërblyer me bursë për studime, duke dashur që pas studimeve ta ketë edhe kuadër të vetin profesional në Komunën e Dardanës. Studioi ekonominë dhe u bë ekonomistja e parë shqiptare e diplomuar nga Dardana.

Komuna jonë kishte nevojë për sa më shumë femra shqiptare të shkolluara. Kështu do të avancohej edhe më shumë femra shqiptare në këtë pjesë të Kosovës. Pra, do të përparojë femra, do të përparojë komuna etj. Mirëpo, qëndrimi ynë për avancimin e femrës, për



Ramush Hoti 1919 - 1996

<sup>32</sup> Rilindja, 29 prill 1964 “Dielli i vendlindjes”, fejtoni i Nebil Durakut kushtuar Ramush Hotit.



përparimin e komunës, për respektimin e vlerave u kundërshtua nga vasalët politikë të kohës. Vetë përgjegjësit shqiptarë në komunë nuk e pranuan në ndonjë punë të rregullt, qoftë në administratë, qoftë në arsim. Megjithatë, kjo nuk e demoralizoi Nexhmijen, sa ajo të dorëzohej ose të lejonte të përbuzej nga disa pseudointelektualë provincialistë me poste përgjegjëse në strukturat komunale. Sidoqoftë, ajo punon, me ndërprerje, në fushën e arsimit dhe angazhohet maksimalisht në jetën politike-shoqërore, edhe pse nuk shihej me sy të mirë nga pushteti i atëhershëm serb. “Me femrën e arsimuar dhe të emancipuar do të kemi shoqëri të përparuar”, pati thënë njëherë aga Tefik, njeri me përvojë të madhe prej veterani të arsimit.

Më 1981 u martua në familjen Kallaba. Ishte një martesë nga dashuria dhe jo martesë e aranzhuar; gjithsesi në pajtueshmëri me të dy familjet. Nexhmija është angazhuar tej mase në Forumin e Gruas së LDK-së qysh nga vitet 1990 me qëllim të avancimit të femrës shqiptare në shoqëri. E inspiruar në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, edhe pse e diplomuar për ekonomi, ajo regjistron Shkollën e Lartë Pedagogjike – drejtimi klasor, të cilën e përfundon në afat rekord, me qëllim që t’i përshtatet shkollës fillore në Roganë, por vasalët e shtetit okupator sërish ia mohuan të drejtën e punësimit. Mjerisht, ndër këta vasalë pati edhe shqiptarë me vizion dritëshkurtër. Sidoqoftë, Nexhmija



*Nexhmija në vendin e punës zv.kryetare e Komunës së Dardanës 2002 - 2007*



qëndroi stoikisht përballë sfidave të kohës. Për gjithë këtë aktivitet ajo pati edhe mbështetjen e pakursyer të bashkëshortit, Xhevdetit. Si nënë e pesë fëmijëve, ajo iu përkushtua edhe më shumë jetës shoqërore-politike, për të dëshmuar rolin e nënës së arsimuar.

Ajo do të shërbejë për vite të tëra si model i një gruaje politikanë për shumë femra të komunës së Dardanës. Vlerat profesionale dhe politike të Nexhmijes arrin t'i zbulojë administratorja e parë amerikane në Dardanë, zonja Margarita Roy, e cila më 1999 ia dha shansin Nexhmijes që të dëshmohej për sinqeritet politik dhe ekonomik. Kështu, prej vitit 2000 Nexhmija bëhet zëri i intelektualës shqiptare për Dardanën dhe Kosovën. Ajo u zgjodh këshilltare komunale qysh në mandatin e parë, pas luftës.



*Nexhmije Kallaba gjatë një përirimi të një projekti të përbashkët me KFOR-in*

Me një këmbëngulje tejet luftarake, gjithnjë e dëshmuar në vepër, Nexhmija në vitin 2002 zgjidhet zëvendëskryetare e Komunës së Dardanës, për ta dhënë kontributin e saj deri më 2007. Ishte edhe zëvendëskryetare e Kolegjiut të zyrtarëve komunalë për Integritim Evropian, e zgjedhur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Interesin shoqëror e vuri gjithmonë mbi interesin personal, virtyt ky që çmohej nga të gjithë intelektualët me vlera atdhetare.

As edhe largimi politik i përkohshëm, si rrjedhojë e kusurritjeve partiake, pavarësisht nga dy fakultete dhe nga gjithë dija e përvoja, nuk e dekurajoi Nexhmijen që, me mjete politike dhe paqësore, të luftojë për të drejtat e grave, për të drejtat e të papunëve dhe të skamnorëve të shumtë të komunës. Ajo, në postin e këshilltares, gjithnjë ngriti zërin e arsyes kundër çdo parregullsie në udhëheqjen komunale.

Në maj të vitit 2009, Nexhmija, organizon një vizitë studimore në Zvicër, duke i përfshirë gratë parlamentare të të gjitha subjekteve politike në Dardanë. Ajo dhe koleget e saj, nga Zvicra, sollën përvojën e parlamentareve zvicerane në dobi të demokracisë direkte dhe të zhvillimit lokal, përvojë kjo më se e domosdoshme për komunën shumëkombëshe të Dardanës.

Është karakteristikë që duhet vlerësuar shumë, se Nexhmija asnjëherë nuk iu frikësua garës politike edhe në mesin e burrave. “Shoqëria e shëndoshë ndërtohet dhe përparohet vetëm në bashkëveprim të grave dhe të burrave”, është një moto jetësore e saj. Falë angazhimit të saj, u certifikua në mbi njëzet trajnime që lidhen me udhëheqjen e komunës dhe me integrimet evropiane. Sinqeriteti politik dhe ekonomik e bëri të njohur gjithandej Kosovës, duke marrë pjesë në emisione të shumta televizive.

Krahas punës, ajo ka mbaruar arsimimin e mëtutjeshëm për Integrimi Evropiane, për të vazhduar pastaj disa vjet me radhë, zyrtare për Integrimi Evropiane në Dardanë. Veç të tjerash, ajo vijoi dhe u certifikua në programin për udhëheqje (leadership) RIT Kosova, pranë Universitet Amerikan në Kosovë. Po ashtu, si trajnere e certifikuar, Nexhmija ka qenë e angazhuar edhe si ligjëruese në Akademinë Policore të Kosovës në Vushtrri, si njohëse e mirë e integrimi evropiane dhe të sigurisë në komunitet. Aktiviteti i saj i vazhdueshëm kombëtar bëri që Nexhmija të jetë e respektuar, si në familjen Kallaba, ashtu edhe në gjithë Kosovën.

Nga vullneti i madh i Nexhmijes për përparimin e Komunës së Dardanës, ajo merret me hulumtimin e mundësive zhvillimore në drejtori dhe sektorë të ndryshëm të administratës së Komunës. Kështu, më vonë, pas përfundimit të provimeve të magjistraturës, në temën e masterit, trajton menaxhimin e financave publike në Komunën e Dardanës.

“Politika buxhetore dhe fiskale paraqesin mekanizma të rëndësishëm, me të cilët përcaktohet piramida e përgjegjësive dhe e kompetencave në qeverisjen e rrjedhave financiare në ekonominë e vendit, duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat strategjike të ekonomisë, popullsisë dhe të shtetit”, shkëput Nexhmija një paragraf nga fillimi i temës së masterit, për të vazhduar: “Shteti si subjekt kryesor për realizimin e funksioneve publike, tubon dhe formon mjete të caktuara, menaxhon dhe, për këtë arsye, të gjitha aktivitetet e lidhura me këto veprime të shtetit njihen si ekonomi publike, ndryshe nga ekonomia private”. Kështu, pa shkëputje nga puna, Nexhmija, në vitin 2017 mbaron studimet master dhe vazhdon të kontribuojë në administratën komunale në Dardanë.

Fushat e saj më të preferuara janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë të drejtat e grave; barazia gjinore; buxhetimi gjinor si dhe financat publike.

Më 17 qershor 2021 administrata komunale e Dardanës organizoi një ceremoni lamtumirëse me rastin e pensionimit të msa.ecc. Nexhmije Kallabës, duke e falënderuar atë për kontributin shumëvjeçar në komunë dhe më gjerë.

Nexhmija e Xhevdeti jetojnë në Roganë dhe aktualisht kanë dy djem e tri vajza, që të gjithë të shkolluar, si dhe pesë nipa e tri mbesa.



*Pjesë e familjes së Xhevdetit e Nexhmijes në ditën e martesës së Petritit me Yllka Malajn (24.8.2018)*



Foto familjare nga takimi lamtumirës i Nexhmijes me rastin e pensimit të saj, organizuar më 17 qershor 2021

Nga e majta: Petriti me vajzën - Ema, Yllka, Diella, Graniti, Xhevdeti, Mali, Rroni (përpara), Nexhmija, Era (përpara), Liza, Dafina me djalën Drenin, Drenusha dhe Blerina. Nga familja e ngushtë në këtë ceremoni mungonin Rexhepi e Guri si dhe dhëndurët: Betimi, Fidani e Ardiani



Certifikatë e lëshuar nga AUK për Nexhmije Kallabën





*Nexhmija me koleget deputete para Parlamentit Nacional të Zvicrës, më 28 maj 2009*

### *Çfarë do të thotë për ty aktivitet kombëtar?*

**Kema:** Secili që është në krye të një detyre, e cila është në të mirë të kombit, është një aktivitet kombëtar, siç është puna e përditshme në arsim, në fabrikë etj., pra, në punët e organizuara institucionalisht. Edhe punët private në bujqësi janë aktivitet kombëtar, sepse është një hallkë e zinxhirit që forcon mirëqenien ekonomike kombëtare.

Mirëpo, ka individë ose grupe individësh që tejkalojnë këtë lloj aktiviteti dhe merren, si të thuash, më specifikisht me çështjen e kombit. Ata bëjnë programe të aktiviteteve kombëtare. Në kushte të rëndomta të një shteti kombëtar, kjo nënkupton themelimin e partive politike ose organizatave joqeveritare dhe angazhimin e tyre për çështje kombëtare, kurse në situata kur një grup etnik ndahet dhunshëm nga trangu i atdheut, siç është rasti i trojeve shqiptare të ndara padrejtësisht nga Kongresi i Berlinit (1878), ose Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1913, atëherë kjo situatë nxit individë ose grupe individësh që të angazhohen

ilegalisht për çështjen kombëtare. Këso organizimesh, detyrimisht, prodhoi copëtimi i trojeve shqiptare në dobi të Greqisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Pra, individë të tillë sakrifikojnë veten e tyre, duke vepruar ilegalisht, për ta zgjuar vetëdijen qytetare për çlirim kombëtar. Në rastin e Kosovës në vazhdimësi ka pasur grupe të tilla, të cilat shpesh janë asgjësuar nga pushtuesi, duke i burgosur ose edhe duke i likuiduar aktivistët e tillë.

*A kemi raste të tilla në familjen tonë?*

**Kema:** Po, si jo! Axha ynë, Ilmi Kallaba, u likuidua në dhjetor (24/25) të vitit 1944 pikërisht për faktin se doli haptas me kërkesën e tij që gjuha shqipe të zyrtarizohej dhe të zbatohej në Administratën e Kosovës, paçka që, pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova mbeti pjesë e Serbisë dhe e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

*A mundesh më gjerësisht të japësh një jetëshkrim për axhën Ilmi?*

**Kema:** Natyrisht! Axha Ilmi që lindur më 1916 nga nëna Hana prej Krenidelli dhe babai Shefkiu nga Rogana. Ishte fëmija i parë i babës Hoxhë. Meqë nëna i kishte vdekur qysh kur ishte fëmijë (10-vjeç), ishte bërë edhe fëmija më i përkëdhelur në familje, ani se më vonë baba Hoxhë ishte martuar dhe, nga dy martesat, kishte gjithsej 11 fëmijë, tetë djem dhe tri vajza.

Baba Hoxhë, pra, Hafëz Shefki Kallaba, i takonte brezit të parë të mësuesve të besimit islam, pas tërheqjes së perandorisë turke, i cili qysh në vitin 1913 ia kishte filluar punën si mësues i mësimit islam në Roganë. I vetëdijshëm për rëndësinë e shkollimit i kishte shkolluar të gjithë djemtë, ndërkaq vajzat kishin marrë vetëm mësim fetar. Mosdërgimin e vajzave në shkollë e kishte korrigjuar me mbesën Ismeten, për të cilën ngul këmbë që të shkollohej, duke u bërë shembull edhe për bashkëfshatarët e tjerë.

Në mbretërinë serbe ishin vetëm dy mundësi të shkollimit: serbisht, në shkolla serbe, ose te ndonjë hoxhë, ku mësimet po ashtu bëheshin në gjuhë të huaj,



pra, në arabishte, por që në bisedë të lirë flitej shqip. Ilmiu, pas përfundimit të shkollës fillore, regjistrohet në medresenë “Isa Begu” në Shkup. Në shkollë kishte qenë shumë i afërt dhe i pranueshëm nga shokët e klasës. Atje diplomohet në vitin 1937. Me të kthyer në Roganë Ilmiu punon si mësues i Mejtepit të Roganës (Sibian Mejtep), i cili punonte në oborrin e xhamisë. Ilmiu, krahas mësimeve fetare, ilegalisht dhe individualisht me nxënësit e vet zhvilloi edhe mësimin e Abetares shqipe, të cilat i kishte sjellë nga Shkupi. Ato i kishte marrë nga administratorët e Konsullatës Shqiptare në Shkup, sa ishte atje mederesant. Si mësues i Mejtepit (Sibian Mejtep) punoi deri në mars të vitit 1938, për ta vazhduar më pas, këtë punë, babai i tij, Shefkiu - Hafëz Kallaba. Më pas i nënshtrohet shërbimit të obligueshëm ushtarak, në Vinkovci të Kroacisë. Më 1 prill 1938 i lind djali, Muharremi. Po të njëjtën ditë Ilmiu nis për në shërbim ushtarak në Vinkovci të Kroacisë. Në ushtri fiton gradën ushtarake kapter (nëntoger). Pas mbarimit të ushtrisë, ia filloi punës së administratorit (nëpunës, ofiqar) në zyrën e ofiqarisë në Roganë, të cilën më parë e kryente babai i tij, Hafëz Shefki Kallaba. Nga viti 1941 punon si mësues-hoxhë në fshatin e lindjes – Roganë (Rogaçicë), mandej në Mireshe (Dobërçan) dhe në Petrit (ish-Petrovc), fshatra këto të rrethit të Anamoravës.

Nga prilli i vitit 1941 Rrethi i Gjilanit, ku përfshiheshin edhe Komuna e Dardanës dhe e Vitisë, ishin Nënprefekturë e Prefekturës së Prishtinës. Aty përfshiheshin: Gjilani, Ferizaj, Prishtina e Prizreni, si nënprefektura, të bashkuara me shtetin shqiptar nën ombrellën e Mbretërisë Shqiptare. Në këtë periudhë Nënprefektura e Gjilanit kishte komunën e Dardanës, në kuadër të së cilës u formuan edhe Komuna e Roganës dhe ajo e Hogoshtit. Gjatë kësaj periudhe kryetar i Bashkësisë Islame të Gjilanit ishte patrioti dhe revolucionari Mulla Idris Hajrullahu, ndryshe quhej edhe Idris Gjilani, nga Velekinca e Gjilanit, kurse sekretar Ilmi Shefki Kallaba, që të dy medresistë të Shkupit.

Me ardhjen e ushtrisë gjermane në Gjilan e në Kosovë, më 6 prill 1941 Ilmiu, bashkë me shumë shqiptarë, doli në pritje duke u shprehur gjermanëve gëzimin e tyre çlirimtar nga serbët. Ai në dorë mbante flamurin shqiptar në Roganë dhe në Gjilan, duke i prirë turmës së madhe të qytetarëve shqiptarë. Madje, ushtria italiane arriti deri në Hodonoc dhe turma e madhe e popullit shqiptar e pritën me brohoritje e duartrokitje si ushtri çlirimtare e jo okupuese. Ilmiu ishte organizatori kryesor i shumë tubimeve që u mbajtën atë ditë në Roganë, Hodonoc, Domoroc (atëherë Bajram Curr). Në këto tubime ishte dominues gëzimi



*Ilmi Sh. Kallaba*  
(1.7.1916 - 23/24 dhjetor 1944)

kombëtar shqiptar, këndoheshin këngë patriotike, recitoheshin vjersha patriotike, vallëzonin dhe filluan të shpërndareshin Abetare shqipe<sup>33</sup>.

Gjatë viteve 1942-1943 në Atikxhami të Gjilanit punonte shkolla fetare – Medreseja e Gjilanit. Gjatë një mbledhjeje të Këshillit të Bashkësisë Islame, që e kishte ftuar Ilmi Kallaba, në marrëveshje me Mulla Idrisin, e ku merrnin pjesë të gjithë imamët e xhamive të rajonit të Anamoravës, shqyrtohej propozimi i Ilmiut për përfshirjen e mësimin të gjuhës shqipe dhe të lëndës së Historisë kombëtare shqiptare në Medresenë e Gjilanit. Ky propozim shkaktoi përçarje brenda të pranishmëve, ngase, përveç Mulla Idrisit dhe efendi Haki Sermaxhajit, të cilët u pajtuan me këtë propozim, të tjerët e kundërshtuan përdorimin e alfabetit shqip në Medrese. Ky gjest i shumicës së hoqxhallarëve të rajonit ishte konservator e i prapambetur, dhe la pasoja të mëvonshme shumëvjeçare.

“ Gjuhë shqipe dhe Histori kombëtare të ligjërohen në Medresenë e Gjilanit, ndërkaq Administrata në Gjilan të udhëhiqet në gjuhën shqipe! ”

*Ilmi Kallaba*

Mulla Idrisi i kushtoi rëndësi të madhe bashkimit të tokave shqiptare nën administrim, qoftë ai edhe i huaj, italian, si hap të sigurt për çlirim kombëtar të Shqipërisë Etnike si tërësi. Fillimisht, një kujdes të posaçëm ia kushtoi shqiptarizimit të mejtepeve dhe të medresesë Atik. Duke e vënë me kërkesa para vetes sekretarin e Myftnisë, patriotin Ilmi Kallaba, ku në dhjetor 1944 u pushkatua nga partizanët, dhe duke e ndihmuar atë fuqimisht, e futi mësimin

<sup>33</sup> Prof.dr. sc. Abdylaziz Veseli: *Shkollat dhe arsimit shqip në Prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941-1944 II*, f. 324.



*Medresantët e Shkupit 1936*

*Ilmi Sh. Kallaba në mesin e medresantëve të Shkupit më 1936*



*Ilmi Kallaba me nxënësit dhe profesorët e "Isa Beg Medresës" të Shkupit në vitin shkollor 1936/37*

*Ilmi Sh. Kallaba me nxënësit dhe profesorët e medresesë „Isa Beg“ të Shkupit në vitin shkollor 1936/37*

shqip në Medresenë Atik, ku e kishte emëruar, që më parë, për “myderriz” ithtarin e tij të flaktë, Haki Efendi Taip Sermaxhajn, i cili vdiq në Kazamatin e Mitrovicës së Sremit, më 27 janar 1948.

Në një moment, në Myftni, kur disa hoxhallarë, ithtarë të mësimin tradicional fetar turko-arab, në medrese kundërshtuan rreptësisht kërkesën që shtroi Ilmi Kallaba, Mulla Idrisi, me një urti të shenjtëruar, mori krahun e luftëtarit të shqipes. Foli vetëm me anë të disa sentencave të dijetarëve e me anë të synnetit: “Ai i cili i mëson të tjerët, merret me detyrë të madhe, të rëndësishme dhe me përgjegjësi” – ka thënë El-Gazaliu, u tha të pranishmëve dhe vazhdoi: Po, a nuk ka thënë Muhamedi a.s.: “Dija është gjallëri e zemrës prej vdekjes së padijes...!”, dhe iu drejtua Ilmiut: “Ti thua se, nëse ne nuk e mësojmë gjuhën shqipe, - gjuhën tonë, kush do ta mësojë...?! - e iu drejtua të tjerëve, dhe veçanërisht Mulla Shaipit të Cernicës, i cili më vonë do të bëhet myfti: Po a nuk ka thënë Pejgamberi se “kur të flisni, thojeni të vërtetën!” Ky djalosh e tha të vërtetën, dhe atë që ia ndien shpirti dhe që e detyron feja, e vërteta. Beja më e madhe me Kuran është: - Pasha kohën!” E përmylli bisedën me një uratë për Ilmiun: “Të paçim, o bir, se ti po flet me Kuranin azimushan e me Synnetin e Pejgamberit!”

E nxori prej xhepit të brendshëm të xhybes revistën “Kultura islame” dhe hoxhallarëve ua vuri mbi tavolinë. Pak me zë të lartë, si duke urdhëruar, u tha: “Lexojeni, o mualimë të urtë, sa e mirë dhe sa e kuptueshme është feja islame kur shpjegohet shqip, në gjuhën e Zotit për shqiptarët...!” dhe me zë edhe më të lartë ua kujtoi ajetin: O ithtarë të Dijes, mos e teproni në besimin Tuaj, dhe për Zotin thojeni vetëm të vërtetën...!”

Anën e Ilmi Kallabës e të Mulla Idrizit fuqimisht e morën edhe dy mualimë patriotë, që ishin aty: Shaban Efendi Livoçi dhe Mulla Sylja i Smirës, i cili, para Luftës së Dytë Botërore ishte imam në Atik Xhami të Gjilanit, kurse tashti mualim, e më vonë mësues i shkollës kombëtare shqipe.

Sidoqoftë, Mulla Idris Gjilani insistoi që të realizohej propozimi i Ilmi Kallabës dhe Medreseja të fillonte sa më parë zbatimin e gjuhës shqipe dhe, po në atë tubim, me pëlqimin edhe të myderrizit të medresesë Atik, Haki Efendisë, për ligjërues të mësimin të shqipes u vendos mësuesi nga Shkodra, Malo Beci<sup>34</sup>.

---

<sup>34</sup> Dr. Muhamet Pirraku: *Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951*, f. 36.




*Ilmi Kallaba me bashkëshorten Xhyheren dhe fëmijët: Muharremi, Habibja (26.3.1941 – 26.6.1943 ka vdekur prej fruthit), Sahadetja dhe vajza e kushërirës – Nurijes - Mejreme Jonuzi (foto:1943)*

Ilmiu, duke qenë edhe sekretar i organizatës Balli Kombëtar, gjatë luftës për mbrojtjen e trojeve shqiptare, lë postin e sekretarit të Myftnisë dhe i bashkohet frontit të luftës, për të dhënë kontributin e tij si oficer me gradë “toger”. Pra, ai deri në korrik 1944 punoi si sekretar, mirëpo, meqë në korrik filloi lufta e Kikës, Ilmiu e lëshoi zyrën dhe kapi pushkën për të udhëhequr me ushtrinë kufitare të





*Sylejman I. Kallaba (25.5.1909 - 2.6.1995)  
pjesëmarrës i luftës së Ushit, Kikës e të  
Bujanocit*



*Salih I. Kallaba (2.2.1917 -16.1.1984)*

Shqipërisë Lindore. Për çdo ditë udhëtonte me një kalë të bardhë nga Rogana në Hogosht. Atje kishte zyrën ku punonte me kapitenin Sahit Basha nga Shqipëria dhe u radhit në ushtrinë sistemore të Shqipërisë. Gjatë asaj vere ai qëndroi pranë centralit telefonik që ishte i vendosur në Hogosht, për lidhjen me komandën e Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës Lindore. Pas kapitullimit të Bullgarisë (shtator 1944), lidhja telefonike nga Qarri u vazhdu në Kijevë, afër Ramnabuqës. Ilmiu bashkë me babanë e tij Hafëz Kallabën marrin pjesë në mbledhjen e zgjeruar të Shtabit Operativ për transformimin e Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës në ushtri partizane Nacional Çlirimtare. Aty morën pjesë kryetarët e komunave të Nënprefekturs së Gjilanit, si: Xhavit Podina, Mumin Jakupi etj.

Më 13 e 14 nëntor 1944, në shtëpinë e Sylejman Kallabës është mbajtur mbledhja e zgjeruar e Shtabit të përgjithshëm për mbrojtjen e Kosovës Lindore, ku të tubuar rreth Haki Efendisë krerët dhe autoritetet e atëhershme duhej të merrnin vendim të prerë rreth tërheqjes së forcave të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës nga kufiri i Kosovës Lindore, të cilat pak para kësaj mbledhjeje ishin tërhequr nga fshati Qarr. Më 14 nëntor 1944, ushtria shqiptare është tërhequr nga kufiri dhe nga Gjilani për të udhëtuar për në Shqipëri. Ilmiu, pas mbledhjes së Roganës dhe tërheqjes së Ushtrisë Shqiptare nuk kishte pse të qëndronte në Hogosht. Pra, ai iu bashkua ushtrisë shqiptare dhe bashkë me kapitenin e ushtrisë shqiptare Sahit Basha, me të cilin kishte bashkëpunuar gjatë gjithë



kohës sa qëndroi në Hogosht, si drejtues i centralit telefonik për kufirin e Kosovës Lindore, vazhdojnë udhëtimin për në Shqipëri. Ilmi Kallaba dhe Sahit Basha, nga Peja në Prizren arritën më datën 17 nëntor 1944, ku patën rast të takoheshin me Fadil Hoxhën. Në atë takim Ilmiu zhvilloi bisedë me Fadilin, i cili e udhëzoi që të kthehej në Roganë dhe e siguroi që nuk do të ketë ndonjë hakmarrje për qëndrimin e tij në ushtrinë shqiptare. Ai i përforcuar nga ato premtime krijoi iluzionet e veta dhe vendosi të kthehej në Gjilan. Madje, me datën 18 e 19 nëntor kishte shkuar edhe në zyrën e Vakëfit në Gjilan. Më 20 nëntor 1944 Ilmiu erdhi në Roganë dhe aty qëndroi deri pas luftës, përkatësisht pas sulmit euforik të Gjilanit, më 23 dhjetor 1944.

Të nesërmen, më 24 dhjetor, ishte duke ecur me mikun e tij Raif Keka dhe në qendër të qytetit është kapur dhe është arrestuar nga dy ushtarë serbë. Ai e kishte porositur Raifin që t'i tregonte babait të tij, Hafëz Kallabës për arrestimin në Gjilan. Vëllai i Ilmiut, Fahmi Kallaba, tregonte se të hënën, më 25 dhjetor 1944, nëpërmjet një serbi, që quhej Stojan Jeftiq, të cilin e kishte pasur shok të klasës nga shkolla fillore në Domoroc, takohet para ndërtesës së burgut. Stojani ishte me uniformë ushtarake dhe ia mundësoi Fehmiut që të afrohej deri te dera e burgut. Stojani posa e hapi derën e burgut, ku ishin rreth 300 veta brenda, kishte pyetur nëse ishte aty Ilmi Kallaba. Dikush i kishte thënë se një ditë më parë Ilmiun e kishin dërguar në Prishtinë. Nga kjo përgjigje lë të nënkuptohet se Ilmiun e kishin likuiduar që më 24 dhjetor 1944. Sipas disa indikacioneve Vlada Popoviqi, duke e pasur me dije se forcat shqiptare gjatë sulmit do t'i lironin të burgosurit, kishte dhënë urdhër që të likuidoheshin paria më e shquar shqiptare e Gjilanit, midis të tjerëve edhe Ibrahim Orana, Ismail Kurteshi, Ilmi Kallaba etj<sup>35</sup>.

Vlen të theksohet se Ilmi Kallaba ishte po ashtu promotor i përhapjes së revistës “Kultura islame” në rajonin e Anamoravës, e cila botohej në Tiranë.

Për keqardhje për fatin e Ilmiut familja nuk kuptoi kurrë se ku e si ishte vrarë e masakruar. Shteti i Kosovës, i pas luftës së vitit 1999, nuk i dha vendin e merituar këtij patrioti, si personi i dytë pas Mulla Idris Gjilanit, përveç emërimit të një rruge periferike dhe skalitjes së emrit të tij në përmendoren te Kodra e dëshmorëve në Gjilan.

---

<sup>35</sup> Prof.dr. sc. Abdylaziz Veseli: *Shkollat dhe arsimi shqip në Prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941-1944 II*, f. 331.



*Ilmi Kallaba me bashkëvendësin Arif Salihu (ulur) dhe vëllain e tij të uniformuar Beqir Salihu - Suliqin*

*Ka pasur edhe të tjerë nga familja e gjerë Kallaba që kanë qenë të angazhuar për çështje kombëtare?*

**Kema:** Natyrisht që ka pasur. Duke qenë edhe ithtarë të flaktë të arsimit e të diturisë, natyrisht kanë qenë edhe atdhetarë, por ndonjëri është angazhuar më shumë për çështjen kombëtare, siç ka qenë vetë Sali R. Kallaba, pastaj Mulla Ibrahim Salih Kallaba, Musah Islam Kallaba, Sulejman Ibrahim Kallaba, Salih Ibrahim Kallaba, Tefik Shefki Kallaba, Fehmi Shefki Kallaba, Qemajl Musah Kallaba, Ali Jashar Kallaba, Ramadan Jashar Kallaba etj., pra, dikush me pushkë e dikush me penë. Është e pamundur të përfshihen të gjithë në një libër, por shpresoj që brezat e ardhshëm, domethënë pasardhësit e tyre të drejtpërdrejtë, do të merren me publikimin e biografive të prindërve të vet.

Megjithatë, unë po e marr shembullin e Ali Jashar Kallabës, i lindur më 1906. Ai e pagoi me kokë angazhimin e tij, duke u bërë kurban i ruajtjes dhe shpëtimit të jetës së shumë atdhetarëve të kësaj ane nga bashkëpunëtorët e OZNA-s famëkeqe, “Organizatë e Mbrojtjes Popullore, e themeluar më 13 maj 1944 në nivel të Jugosllavisë nga Aleksandar Ranković”. Ky formacion shfarosës për shqiptarët, në Kosovë u themelua më 1 shtator 1944<sup>36</sup>.

<sup>36</sup> Wikipedia: <https://sq.wikipedia.org/wiki/OZNA>



*Ali J. Kallaba 20.6.1906 – 22 qershor 1946*

Ali J. Kallaba kishte qenë burrë sypatrembur, pedant dhe tejet vigjilent. Ai i takonte grupit të vullnetarëve për mbrojtjen nga sulmet çetnike, që rrezikonin jetën e popullatës së kësaj ane, kur, siç dihet, gjatë pushtimit fashist, Rogana gjendej në zonën kufitare mes “Bullgarisë së Madhe” dhe Serbisë fashiste. Shtëpia e Ali Kallabës ishte çerdhe dhe strehë e patriotëve, si: Sylë Zarbica, Lotë Vaku, Xhepë Shipashnica, Lam Breznica, Taip Dajkoci etj. Duke e parë angazhimin e OZNA-s drejt shtypjes mizore të popullit shqiptar e sidomos të patriotëve të shquar,

Aliu, bashkë me këta burra, i kishin vënë pritë bashkëpunëtorit të OZNA-s, Shefki Gadimes, të cilit disa herë i ishte tërhequr vërejtja për sjelljen e tij të keqe ndaj bashkëkombësve të tij në Anamoravë dhe Malësi të Dardanës, ku edhe e kishin vrarë në Hodonoc të “Guri i Shpuem”, në pritën e Taip Dajkocit, Xhepë Shipashnicës dhe të Hamdi Behës. Pas këtij akti, Aliu merret në polici dhe nga fundi i qershorit 1946, në rrugë për në Ferizaj, vritet nga policët shoqëruar, në tentim arratie, bashkë me bashkëvuajtësin e burgut hetues, Pajazit Bojkun nga Muçivërci<sup>37</sup>.

Në shenjë nderimi për veprimtarinë atdhetare të Ali Jashar Kallabës, pasardhësit e tij, të mbështetur edhe nga familja e gjerë Kallaba nga Rogana e Gjilani, si dhe nga familja Bojku, i ngritën një lapidar në dalje të fshatit Dardani, në drejtim të Sojevës, të komunës së Ferizajt. Në lapidar është edhe figura e Pajazit Bojkut, i cili, në të njëjtën ditë u vra bashkë me Aliun nga OZNA jugosllave.

---

<sup>37</sup> *Ali Jashar Kallaba nga Rogaçica, atdhetar e luftëtar i devotshëm i Shqipërisë Etnike, “Bota Sot”, 31 korrik 2001, A. Canaj.*



*Lapidar i ngritur më 13 korrik 2010 nga familjarët Kallaba dhe Bojku*





*Familjarët Kallaba e Bojku në përrurimin e lapidarit të Ali J.Kallabës dhe Pajazit A. Bojkut, më 13 korrik 2010, në Dardani - Ferizaj*

Një shembull tjetër i një brezi më të ri është rasti i Qemajl M. Kallabës. Ai ishte djali i madh i Musahut, i cili, me pushkë në dorë, kishte luftuar për çlirimin e trojeve shqiptare. Plagosja e Musahut në luftën e Ushit, afër



*Qemajl M. Kallaba  
12.6.1928 – 29.9.2001*

Vranjës, kishte lënë vrugë të pashlyeshme në shpirtin e Qemajlit<sup>38</sup>. Si rrjedhojë e këtij presioni psikologjik, Qemajli me përkushtim rreshtohet në aktivitete atdhetare. Kështu, më 1945 ishte aktivizuar në Komitetin e Rinisë në Gjilan, ndërsa më 1946 zgjidhet sekretar i Rinisë së Rrethit të Dardanës. Mirëpo, fryma patriotike e tërhiqte në një vijë tjetër të frontit të luftës, ideali i së cilës ishte çlirimi kombëtar dhe bashkimi i trojeve etnike shqiptare. Më konkretisht, ai ishte i angazhuar në lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH) bashkë me Metush Krasniqin, Sejdi Kryeziun, Gjon Serreçin, Mark Gashin, Sadri Shipashnicën, Metë

<sup>38</sup> *Ishte idealist i papërmirësueshëm, "Rilindja", 30 tetor 2001.*

Dërmakun-Nuredinin, Mehmet Ajetin etj. Kjo organizatë drejtohej nga Metush Krasniqi dhe kishte për synim bashkimin e trojeve shqiptare me Shqipërinë amë. Për këtë bashkëveprim Qemajl Kallaba u dënua më një vit e gjysmë burg të rëndë, nga 21 nëntori 1958. Në burgun e Ferizajt kishte përjetuar tortura çnjerëzore nga udbashët serbë. Pos burgut të Ferizajt, ai kishte përjetuar edhe burgun e Prishtinës, ku kishte përjetuar tmerret më të trishtuara – pushkatimin e 60 shokëve të tij, anëtarë të NDSH-së, në mesin e të cilëve ishin Gjon Serreçi, Osman Bunjaku, Ilmi Zariqi, Hamdi Beha, Xhepë Shipashnica etj.

Pas mbajtjes së burgut, Qemajli punoi mësues në Strezoc e Rahovicë të Preshevës, por që nuk iu mundësua të punonte në vendlindje ose diku në Kosovë.

Më 1986 u pensionua dhe u shpërngul me familje në Prishtinë. Vdiq më 29 shtator 2001 dhe u varros në vendlindjen e tij, në Roganë.





*Cila është rruga që aktiviteti kombëtar të përfshijë sa më shumë individë, duke rritur kështu edhe vetëdijen e përgjithshme kombëtare?*

**Kema:** Në shtetet kombëtare është më lehtë, sepse, siç e ceka edhe më lart, krijohen mekanizma shtetërorë funksionalë, si: partitë, organizatat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, klube të ndryshme kulturore e sportive etj. Dhe, të gjithë këta mekanizma funksionojnë papengueshëm nga aparati shtetëror. Ndërkaq, në vendet e pushtuara është më vështirë. Atje gjithçka funksionon në mënyrë të tërthortë, ngase aparati shtetëror mbikëqyr çdo segment të jetës publike. Dhe kjo rrugë, gjithsesi, është më e gjatë dhe më e rrezikshme. Në situata të tilla, p.sh., në rastin e Kosovës, rol të rëndësishëm kanë luajtur mësuesit, hoxhallarët, gazetarët, shkrimtarët etj. Pra, ata që kanë drejtuar masat e gjera popullore ose që kanë pasur qasje të drejtpërdrejtë me popullin, si, p.sh., berberët, rrobaqepësit, tregtarët, taksistët, zejtarët e ndryshëm etj.

*Si ka qenë e mundur një gjë e tillë, kur dihet agresiviteti i pushtuesit, i secilit pushtues?*

**Kema:** Kjo varet nga zhdërvjelltësia dhe aftësia intelektuale e individit. Fillimisht aktivistët e tillë duhet të jenë njerëz me autoritet dhe të krijojnë besimin e plotë te qytetarët; mësuesi te nxënësit, imami te xhemati i tij, drejtori te punëtorët, udhëheqësi i shtetit te qytetarët etj. Dhe, çështja e besimit është filozofi më vete. Besimi është pasuria më e madhe shoqërore dhe kulturore; ai hap dhe mbyll të gjitha dyert e mundshme. Imagjinoje një shoqëri, në të cilën plotësisht mund t'u besohet njerëzve; kjo prodhon një cilësi të lartë jetese dhe veprimi, ose e kundërta e saj, një shoqëri ku askush nuk i beson askujt, kjo do të nënkuptonte një shoqëri me vlera tejet të dobëta të jetesës dhe të zhvillimit të shoqërisë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që personat publikë të krijojnë besim te populli dhe ta ruajnë atë besim.

## Hafëz Shefki Kallaba - një jetë në shërbim të kombit dhe të fesë islame

### Kadrush Sylejmani

Shefki Sahit Kallaba, i njohur në popull si Hafëz Kallaba, u lindi më 1899 në fshatin Roganë, komuna e Dardanis. Ai rrjedh nga familja e madhe Kallaba e Anarotavës, e cila nxori luftëtarë atdhetarë: Musa, Ramadan dhe Sylejman Kallabën në mbrojtjen e kufrit të vjetër për të vitet 1876 midis Kosovës dhe Serbisë, nga Onyq e Kongullit deri në Malet e Ushit, në Shtë, Krah Gur i Bardhë e Kapollë. Medvegjës më vitet 1941-1945, si dhe distronin e krahut, Aë Kallaba. I cilësi misioner në organizimin e shkollimit të azhrit gjakatar Shefki Beut, i njohur me nofën Shefki DZH-e nga Gëdërja e Uqjanit më 1945 në afërsi të fshatit Hodonoc, të ish-rezitit të Kamenicës, sot Dardane. Familja Kallaba sot ka dhjetëvjehtë intelektualë me universitet e dua magistra profeshionistë ndryshe, që arsimin shpesh japin krahas të rritës tani e pesëdhjetë vjet. Nga gjini i kësaj familjeje të madhe doli luftëtarja e shquar Firduze Kallaba, e cila gjati Luftën e Kosovës 1999, i kurizorë me karrierë avonë amerikane të luftës gjatë fatumit në lartësi prej pesë mijë metrash që të bombardonit çagël ushtrake serbe në Kosovë, Serbi e Mal të Zi.

Shkollën filor, Shefki Kallaba e filoi në Roganë më 1899 te hoxhë Hasan Efendi, ish-imam nga Mirshin, ish-Dobërpani, tek i cilë mësuesi për 4 vjet rresht. Ai pas përfundimit të shkollës filor, vazhdoi mësimet në medresa ndërkrah më 1899 filor



Më Shefki Kallaba

mësimit "Islam Sarf" te mësuesi Jusuf Zjadin Efendi, nga fshati Tërnoc, dhe arsimi deri te "molla xhamia", të cilën me hakishtësinë i përfundoi me sukses më 1903. Shefki Kallaba mori mësime "meharibit huruf" nga Kur'ani nga mësuesi Ruzica dhe haxhi Hafëz Ruzhaci në Prishtinë në vitet 1904-1905; njëkohësisht ndjek edhe mësimet në "limi fiku" tek mulla Seifu në medresenë Frenuz të Prishtinës. Ai kthesh në Medresenë e Dobërpanit më 1906, që të vazhdojë mësimin e diturisë në "manëk". Në shtëpi të interesimit dhe punës së suksesshme, ai arsimi deri në "akaid" më 1908. Shefki Kallaba nga vitet 1909-1912, nëpërmjet shkollimit e mësimit për shkollë të luftës të shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë, sepse medresetë dhe shkollat qendrë mbyllur.

Shefki Kallaba, me dekret të Ministrisë së Arsimit në Beograd, caktohet mësues i fesë islame në fshatin e tij, në Roganë, ku shërbeu nga viti 1913 deri më 1915, ndërkrah gjatë luftës serbo-bulgarë në vitet 1915-1917, mbaqi mesime private në mesin letar. Me themelimin e Jugosllavisë Mbretërore Serbe, Kroate dhe Slovene, më 1918, në komunën e Roganës filloi nga puna administrata në gjuhën serbe, dhe u emëruar mësues serbë me pagë shtesë, kurse Shefki Kallaba i pushoi vendi i punës. Megjithatë, me dekret të Ministrisë së Arsimit të Jugosllavisë, ai vazhdoi të punojë mësues i fesë islame me gjysmë pagë, deri më 1925. Te rikupërimi së gjatë viteve 1918-1921, hafëz Shefku, që angazhuar vullnetarisht të bënte regjistrimin e popullsisë shqiptare të komunës së Roganës dhe të Hashimisë. Ai kreu vullnetarisht punën e rëndësishme duke bërë regjistrimin e lindjeve, martesave dhe vdekjeve të popullsisë. Libri e libri të ofqarisë edhe sot e kësaj dite rrijen si "Libri të Hoxhës", të cilët deri tani janë ruajtur në Dfiparinë e Muguçitit.

Me dekret të Hasan Rebasit, Ministër i Fesë në Beograd, Shefku caktohet për imam-efqar në xhaminë e Roganës, që përthinte edhe fshatrat Hodonoc, Muguçit, Dajkoc, Kroide (ish Kranidë), më 1925. Hafëz Kallaba i nënshtrohet provimit për imam-efqar (shkalla e tritolë) para komisionit të përthënë nga mësuesit haxhi Jusuf Efendi Aburrahmani dhe një profesor për gjuhën serbe, në Gjilan më 1925, pasaz njëzet kur-

*A mund të përmendësh ndonjë rast konkret?*

**Kema:** Ta zëmë, unë te nxënësit e mi, gjatë shpjegimit të njërive mësimore, kam arritur të krijoj një simpati për figurat kombëtare. Dhe, në një rast, kur, sipas planprogramit nga lënda e Marksizmit, është dashur të shpjegoja një njësi mësimore për figurën e ndonjë udhëheqësi jugosllav, në ditarin e punës e kam shënuar temën e paraparë, kurse në realitet nxënësve u kam shpjeguar për figurën e Ismail Qemalit ose të ndonjë figure tjetër të rëndësishme kombëtare shqiptare. Kështu, nxënësit kanë menduar që kjo është në kuadër të programit mësimor, kurse në ditar, për administratën e shkollës ka figuruar realizimi i programit të paraparë.

Ose, rasti i gjyshit tim, Hafëz Shefki Kallaba. Në vitet 1950, kur kishte marrë hov nisma për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi, ai, si imam fshati, kishte shumë autoritet te xhemati i tij. Në një mbledhje të fshatit, ku kishte të pranishëm edhe figura aktivistësh të jetës politike komuniste, mori fjalën dhe iu drejtua një serbi të pranishëm, më duket se ka qenë një aktivist serb i Roganës, Jova Milenkoviç. “Mirë, bre zotni, po përse ne duhet të shkojmë për në Turqi? A nuk luftuam bashkërisht për ta çliruar vendin dhe për të jetuar në trojet tona. Bile dhamë edhe dëshmorë”, kishte thënë hoxha në prani të qindra rogasve. Aktivisti serb mbeti pa fjalë dhe miratoi mendimin e hoxhës, duke thënë “tako je” - ashtu është. “Pra, a po shihni, vllazni, ne nuk kemi nevojë ta lëshojmë vendin tonë dhe të shkojmë në Anadoll”, kishte thënë para masës Hafëz Kallaba. “Pas atij fjalimi të agës Hoxhë, vendosëm që menjëherë t’i shqyejmë kërkesat e bëra për viza “visika”, e të cilat i kishim bërë në emër të disa lagjeve të Roganës në Shkup dhe vendosëm që të qëndronim këtu”, ishte shprehur me një rast bashkëfshatari Bala i Muhaxhirëve. Kështu, Rogana shpëtoi nga shpërngulja masive për në Turqi, dhe kjo krejt falë zhdërvjelltësisë së imamit të fshatit, Hafëz Shefki Kallabës.

*Kush ishte në të vërtetë Hafëz Shefki Kallaba?*

**Kema:** Shefki Salih Kallaba, i njohur në popull edhe si Hafëz Kallaba<sup>39</sup>, lindi më 20 mars 1889 në fshatin Roganë, Komuna e Dardanës. Ai rrjedh nga familja

<sup>39</sup> Kadrush Sylejmani: *Dituria Islame*, nr. 158, viti XVIII – shtator 2003, f. 51.



*Hafëz Shefki Kallaba, respektues dhe i respektuar nga populli i Anamoravës e më gjerë*

e madhe Kallaba e Anamoravës, e cila nxori luftëtarë-atdhetarë: babanë Salihun, bashkëluftëtar i Idriz Seferit në çlirimin e Shkupit, Musah, Ramadan dhe Sylejman Kallabën, në mbrojtjen e kufirit të vjetër turk të vitit 1878 midis Kosovës dhe Serbisë, nga Gryka e Konçulit deri në Malet e Ushit, Shën Ili (Sitili), Kikë, Guri i Bardhë e Kapi të Medvegjës, në vitet 1941 – 1945, si dhe dëshmorin e lirisë, Ali Kallaba, i cili mori pjesë në organizimin e likuidimit të oznistit gjakatar Shefki Beqiri, i njohur me nofkën Shefki Ozna nga Gadimja e Lipjanit, në qershor 1946, në afërsi të fshatit Hodonoc, të ish-rrethit të Kamenicës, sot Dardana. Për këtë atentat, më 22 qershor 1946, në viset e Sojevës së Ferizajt, nga forcat e OZNA-s, u pushkatuan Ali Jashar

Kallaba nga Rogana dhe Pajazit (Zitë) Ahmet Bojku nga Muçivërci.

Familja Kallaba sot ka dhjetëra intelektualë me universitet e disa magjistra profilesh të ndryshme, që arsimit shqip i japin krahë e rritë tani e pesëdhjetë vjet. Nga gjiri i kësaj familjeje të madhe doli luftëtarja e shquar Faruza Kallaba, e cila, gjatë Luftës së Kosovës më 1999, i furnizonte me karburante avionët amerikanë të luftës gjatë fluturimit, në lartësi prej pesë mijë metrash, që bombardonin caqet ushtarake serbe në Kosovë, Serbi e Mal të Zi.

*Çfarë mund të thuash për besimin dhe besimtarët shqiptarë?*

**Kema:** Besimi është një nocion i gjerë dhe vështirë është të zbërthehet me një koment, e madje as edhe me një libër të vetëm. Fatkeqësisht, ndër breza, njeriu është keqpërdorur nga vetë njeriu. Dhe, në këtë pikë mund të them se besimi

është bërë një armë shumë e fortë. Çështë e vërteta, besimi është edhe një armë e fortë, por varet se për çfarë qëllime përdoret ose keqpërdoret. E kam thënë edhe ndonjëherë tjetër: kur humb besimi në një shoqëri, ajo shoqëri rezulton të degradojë, sepse sinqeritetit i del përballë hipokrizia, e vërteta luftohet nga gënjeshtria, punëtori shantazhohet nga papunëtori, dijetari topitet nga i padituri etj., etj. Pra, besimi kthehet në dogmë, pikëpamje kjo që merret verbërisht nga besimtarët për t'u bërë pastaj e detyrueshme për ta. Kjo më së miri vërehet te besimet fetare, por së fundmi edhe te partitë politike. Të dyja palët dëshirojnë që besimtarët e tyre të jenë gjithçka tjetër, por jo edhe vetvetja. Krejt kjo, që të mund të qeverisen më lehtë nga një individ ose grup individësh; për më keq kur institucione të tilla nuk shkojnë në hap me kohën, nuk reformohen.


*Në çfarë pike ndodhet tani besimtari shqiptar?*

**Kema:** Kam përshtypjen se shoqëria shqiptare ndër shekuj ka ecur një hap përpara e dy prapa. Me gjasë, tani kemi hyrë në dyhapëshin e ecjes prapa, në vend që të eliminohet fare ecja prapa. E, kjo po ndodh pikërisht si rrjedhojë e humbjes së besimit të njerëzimit e zgjedhur dhe mos reformimi i elitës, qoftë asaj fetare qoftë politike. Udhëheqësia e shtetit duhet të hulumtojë praktikatat më të suksesshme nga shtetet e zhvilluara, t'i konvertojë ato konform kushteve ekzistuese; pastaj ta shkollojë nxitimthi një plejadë njerëzish që të profesionalizohen edhe fetarisht e sidomos kombëtarisht, në mënyrë që të ndalet dyhapëshi prapa. Fatkeqësisht, besimtari i sotëm shqiptar ndodhet si shigjeta në hark, por që harkëtari është i panjohur dhe nuk dihet se në ç'drejtim do ta hedhë shigjetën.

*E ke lexuar Kuranin dhe sa është në funksion të çështjes shqiptare?*

**Kema:** Po, e kam lexuar dhe e kam studiuar, njësoj sikur lëndët filozofike që ua shpjegoja pastaj nxënësve në shkollë. Parapëlqej që çdo shqiptar t'i lexojë librat e shenjtë, sidomos Kuranin e Biblën, dhe ta krijojë vetë bindjen për besimin, që të mos bjerë prapë e keqpredikuesve të këtyre librave. Të vlerësohet drejt dhe të jetësohet aspekti i tyre edhe pedagogjik, edhe didaktik, edhe moral, ekonomik etj. Kam frikë se me trendin aktual të besimit verbërisht dhe të mos studimit mirë të librave të shenjtë, ne do të mbetemi gjithmonë shigjetë në harkun e të huajve. E, kjo do të jetë e dëmshme për kombin shqiptar<sup>40</sup>.

<sup>40</sup> *Pamje nga shënimet dhe komentet nga leximi i Kuranit.*



Ekrem Kallaba - Shënime e komente nga Kurani

*Ndërmjet kombit dhe fesë, cilës i kishe dhënë përparësi?*

**Kema:** Çështje e vërteta këtë pyetje do ta ndërtoja duke pyetur se cila ka më shumë peshë: kombi apo feja? Dhe, natyrisht, unë do të thosha se kombi ka më shumë peshë sesa feja, sepse kur je kombëtarisht i fortë e i qëndrueshëm, atëherë mund ta zgjedhësh cilindo besim që ty të plotëson.

*Atëherë, çka është kombi sipas teje?*

**Kema:** Mbase mund të jem i ndikuar nga lënda e marksizmit që u shpjegoj nxënësve, por, megjithatë, mendoj që përkufizimi më adekuat i një kombi do të ishte një përkufizim marksist: Një komb është një bashkësi etnike e madhe, komplekse që formohet si në kapitalizëm ashtu edhe në socializëm dhe bazohet në zotërimin e territoreve, gjuhës letrare - si një mjet kombëtar i përgjithësisë, unitetit të biznesit ekonomik në formën e interesave ekonomike kombëtare dhe ekonomive kombëtare, në organizimin dhe integrimin politik.



*Gjatë luftës së fundit ke qëndruar në Dardanë, apo je larguar jashtë Kosovës?*

**Kema:** Gjatë luftës kam lëvizur ndërmjet Dardanës dhe Roganës, por kryesisht kam qëndruar në Roganë me vëllezër dhe kushërinj. Atje, madje, edhe kemi organizuar rojë, si në shumë vende të Kosovës. Ajo kohë ka qenë një periudhë me shumë tensione e shqetësime. Rreziku ka qenë, jo vetëm nga formacioni i rregullt ushtarak serb, por, sidomos, nga formacionet paramilitare, ndërkohë ne nuk kemi qenë të organizuar ushtarakisht.

*Dhe, pas luftës, a ke punuar në arsim apo gjetiu?*

**Kema:** Është për keqardhje se si në shoqërinë shqiptare, sidomos në ndërrimin e pushteteve, nuk ka kujdestarë zyrtarë që të kujdesen për njerëzit me aftësi dhe me merita të veçanta. Duke e pasur gjithë atë përvojë në arsim, pastaj gjithë atë kundërshtim ndaj ish-sistemit, pikërisht për shkak të përpjekjeve për devalvimin e shkollës shqipe në Kosovë, Departamenti i Arsimit i Komunës së Dardanës nuk e pa të udhës që të më mundësojë, ose thënë më mirë të shfrytëzojë përgatitjen dhe përvojën time në arsim për të më angazhuar në procesin arsimor në Dardanë, me gjithë kërkesat e mia për punë. Dhe, në pamundësi për një punë të drejtpërdrejtë në arsim, ose në Departamentin e Arsimit, unë u detyrova edhe më tutje ta bëja punën e kamerierit, sa për ekzistencë.

Megjithatë, falë njerëzve të instancave më të larta, të cilët ishin më të vetëdijshëm për angazhimin e kësaj kategorie, siç isha unë, në prill të vitit 2005, në Qeverinë Haradinaj, m'u mundësua që të lidhja marrëdhënie pune në Zyrën Administrative të Kryeministrit, në postin e zyrtarit të lartë gjuhësor për përkthim shqip-serbisht dhe anasjelltas.

Në këtë institucion Ekremi ishte në marrëdhënie pune deri në momentin kur, për shkak të sëmundjes së kancerit në mushkëri, ndërroi jetë më 11 dhjetor 2008, në orën 11:15 minuta.

Ekremi la pas vete bashkëshorten Fikrijen, djalin Enliratin, i cili sapo ishte martuar me Edona Fejzullahun.

Enlirati dhe Edona tani kanë një mirëqenie solide. Ata kanë dy vajza të mrekullueshme, Nila dhe Henea, të cilave u mungon gjyshi, por jo edhe kujtimet për gjyshin Ekrem, kujtime që do t'i marrin nga rrëfimet e prindërve dhe, sidomos, nga ky libër.



*Enlirat dhe Edona Fejzullahu – Kallaba me vajzat Nilën (djathtas) dhe Henean*

## Foto e dokumente nga arkivi familjar



*Nëntor 1944 - Ilmiu e Xhyherja me fëmijët:  
Muharremin, Sahadeten dhe Ismeten  
(ende pa lindur)*



*Tefiku më 28 dhjetor 1979*



*Vajzat e Hafëz Kallabës (nga e majta): Sabrija (2.5.1918 -19.9.1989),  
Fetija (7.2.1920 - 26.8.1984) dhe Zehra (25.7.1924 – 20.3.1990)*





*Tefik Kallaba gjatë një pushimi në Banjën e Prollomit, në Prollom, më 26. 7. 1963*



*Roganë, gusht 1970 (foto Xh. Kallaba te Tyrbja e Kallabve): Nga e majta: Tefiku, Zijahu, Elizabeta, Musahu, Shemsija, Hamdiu (mysafir nga Adana e Turqisë) dhe Sylejmani*



*(ulur - nga e majta): Irfani, Adnani, Shehidja: (në këmbë): Besimi, Maliqja, Sabrija, Fehmiu, nëna Maliqe, Fatimja*



*Naxhija (e Salihut), Mukadezja, Tevidja (e Salihut), Besimi, Imrija, Hanumshahja, Nexhati (i Nazmiut)*



*Fehmiu me Besimin (përpara), Mukadezja, Imrija me Hanumshahen në krah*



*Kolektivi i arsimtarëve në shkollën fillore “Vëllazërim Bashkim” në Koretin, në vitin shkollor 1973/1974*



*Nga një vizitë çasti te baba Fehmi, më 31 dhjetor 1984, për t'ia uruar Vitin e Ri 1985: (nga e djathta: Xhevdeti me Granitin në prehër, Nexhmija, Imrija, Fehmiu, Ema, Hanumshahja, Liria, Besimi, Mukadezja dhe Xhelali*





*Mysafirë të pranishëm në „Qelimen“ e organizuar në përkujtim të Fehmi Kallabës*



*Disa nga meshkujt e lagjes Kallaba në një festë Bajrami (1990): Nga e majta (në këmbë) Fehmiu, Hyseni, Xhemaili, Nazmiu, Ibrahimimi, Hasani, Selimi, Selamiu, Agroni, Xhevdeti; (ulur): Nusreti, Elhamiu, Visari, Graniti, Reshati, Nexhati, Besimi, Esati, Muzafëri dhe Fatmiri*



*Për Bajram - Roganë, 26.02.2004: nga e majta (në këmbë): Vetoni, Esati, Ardiani, Flakroni, Liridoni, Hasani, Petriti, Muzaferi, Fatmiri, Elhamiu, Herolindi, Agimi, Ibrahim, Selimi, Nexhati (ulur): Xhevdeti, Driloni, Loriku, Besimi, Lirimi, Blendi, Florenti, Taulanti dhe Kujtimi*



*Për Bajram te Xhevdeti, 28.7.2014 (nga e majta): Besimi, Muzaferi, Nexhati, Skenderi, Graniti me Gurin, Fatmiri, Jashari, Elhamiu, Flakroni, Rexhepi, Ardiani, Egzoni, Arbri, Hekurani, Petriti, Agimi; (ulur): Xhevdeti, Lorioni, Visari, Arti (përpara Visarit), Florenti, Andi, Taulanti, Ylli, Blendi, Herolindi dhe Liridoni*



*Për Bajram te Xhevdeti, 24.9.2015: nga e majta (në këmbë): Esati, Muzaferi, Xhevdeti, Ardiani, Nusreti, Elhamiu, Albi, Nexhati, Lorioni, Besimi, Xhelali, Agimi, Petriti, Lirimi, Driloni, Flakroni, Lindi, Selamiu; (ulur): Loriku, Kujtimi, Blendi, Ylli, Florenti, Taulanti me djalin e Xhelalit, Eridonin dhe Visari*



*Nga e majta: Sabrija me djalin Sabedinin, mbesa Fetija, Bahrija (gruaja e Rexhë fotografit nga Gjilani) dhe vajza Hasibja*





*Nga e majta: Hanumshahja, Haxhija dhe Sabrija*



*Drita në ditën e martesës, më 2 qershor 1996, në Roganë; nga e majta: Fikrija, Selamiu, Drita, Ekremi, Naxhija, Nizaqetja; (ulur): Elhamiu dhe Blerina*



*Drita në ditën e martesës. Nga e majta: Selamiu, Drita, Blerina, Ekremi, Nexhmija me Drenushën në dorë.*



*Nga e majta: Hyseni, Rasimi, Arianiti dhe Abdylazizi. Koretin, më 20 shtator 1981*



*Salih I. Kallaba (djathtas) me nipin Mulla Mehmet Dërmakun*



*Bijat ishin të privileguara dhe me kënaqësi bënëin t'panin në familjen Kallaba (nga e majta): Selvija, Zejnija (gruaja e Balë Hogoshtit) dhe Hanumshahja*





*Xhevdeti (majtas) me Farukun e Nagipin, në dasmën e Farukut, në Ferizaj, më 2 tetor 1983*



*Takim rasti me mikun e shtëpisë dhe ish-drejtorin e gjimnazit – Prof. Mehmet Surdullin, në Prishtinë më 25 prill 2002*



*Një ndejë me Vebi Kallabën (majtas) - Besimi, Xhevdeti, Muzaferi, Elhamiu, Nexhati, Roganë 1988*



*Nga e majta: Remzi Morina, Ekrem Kallaba, Halit Maliqi, Gani Dërvishi, Tahir Berisha dhe Sinan Dërmaku në takimën e veteranëve të arsimit në Prishtinë, 6.3.2002*



### III

## **Themelimi i SHKSHSH-së dhe i partisë Republikane në Kosovë**

“ Mosangazhimi dhe përtesa jonë sot,  
nesër do të jetë vonë për ankesa. ”

---

*Ekrem Kallaba*





Ballafaqimi me gjithë këto padrejtësi ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, si dhe përpjekja e vazhdueshme që me metoda tejet tinëzare të ndikohet në shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet tona, na imponoi që me urgjencë ta themelonim një shoqatë që do të merrej jo vetëm me pengimin e shpërnguljes, por edhe me kthimin e atyre shqiptarëve të shpërngulur në kohë dhe rrethana të ndryshme nga Kosova.

Kështu, një grup aktivistësh, më 14 shkurt 1990 themelojnë Shoqatën për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta (SHKSHSH).

Selia e kësaj shoqate u bë në Pejë, me synim zgjerimi edhe në rajone të tjera të Kosovës.

### Themelimi i SHKSHSH-së

Më 14 shkurt 1990, në Pejë u themelua Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova me ç'rast, nga afro 500 pjesëmarrës, në tubimin themelues u zgodh Këshilli Nismëtar në përbërje:

1. Reshat Nurboja - kryetar. meqenëse ishte edhe ideator, iniciator dhe hartues i statutit dhe programit të kësaj Shoqate, 2. Zejnullah Luta - sekretar, 3. Jahja Lluka - anëtar, 4. Myhedin Sylqa - anëtar, 5. Ali Çeku - anëtar, 6. Gzim Morina - anëtar, 7. Mahir Muhaxheri - anëtar, 8. Hadi Doda - anëtar, 9. Rexhë Krasniqi - anëtar, 10. Seit Luta - anëtar dhe. 11. Musa Nikqi - anëtar

Brenda disa muajve u formuan 22 degët e Shoqatës anekënd Kosovës:

1. Në Kamenicë, me kryetar prof. Ekrem Kallaba
2. Në Gjilan, me kryetar prof. Saqip Ramizi
3. Në Ferizaj, me kryetar Ramadan Kupina
4. Në Prizren, me kryetar prof. Muhamet Shukriu
5. Në Mitrovicë, me kryetar prof. Ahmet Vatovci
6. Në Podujevë, me kryetar prof. Nexhmi Ganiu
7. Në Kaçanik, me kryetar dr. Mustafë Thaçi
8. Në Viti, me kryetar Adem Murati
9. Në Vushtrri, me kryetar prof. Shefqet Popova
10. Në Malishevë, me kryetar Mulla Xhevat Kryeziu
11. Në Prishtinë, me kryetar Ramiz Kukleci
12. Në Shtime, me kryetar prof. Hysni Bahti
13. Në Fushë Kosovë, me kryetar Ibrahim Ademi etj...

Më 25 nëntor 1990 në kuvendin zgjedhor, që u mbajt në Pejë, Jahja Lluka u zgjodh kryetar i Shoqatës dhe që nga atëherë, me plot sukses e sakrificë, e ka udhëhequr dhe zhvilluar SHKSHSH-në



Fotot janë nga kuvendi zgjedhor 1990

Natyrisht, veprimi i shoqatës nuk ishte edhe pa vështirësi, sepse shoqata duhej të regjistrohej edhe tek organet shtetërore, e që i bie, në Sekretariatën Federativ për Drejtësi dhe Administratë në Beograd. Dhe, kjo u bë më 1991<sup>41</sup>.

*Çfarë mund të bënit përmes kësaj shoqate, a mund ta ndalnit represionin serb mbi shqiptarët?*

**Kema:** Kuptohet që nuk mund të bënim shumë, por të paktën ishte një nismë zyrtare e kundërshtimit të shtetit, si dhe dhënies së kurajës qytetare që të mos bënim “amin” për gjithçka. E para punë që filluam ta bënim ishte regjistrimi i të shpërngulurve që nga viti 1912, pastaj i të humburve, i refugjatëve, si dhe regjistrimi i të kthyerve në trojet e veta, secili për komunën e vet. Shënimet e përmbledhura nga puna jonë për Komunën e Dardanës janë botuar në revistën periodike “Inforogana, nr. 2”<sup>42</sup>.

Shoqata, pra, ndërmoi shumë aktivitete, nga të cilat do të veçoja themelimin e çmimit “Hasan Prishtina”, në vitin 1997, i cili u jepej personave për merita të veçanta në pengimin e spastrimit etnik të trojeve shqiptare dhe krijimin e kushteve për kthim. Çmimin e parë “Hasan Prishtina” ia dedikuam nënës shqiptare, e cila historikisht nuk u dorëzua para asnjë armiku, duke qenë ruajtësja më e fortë e gjuhës, traditës e sidomos natalitetit shqiptar. Për simbolikë të kësaj, shoqata përzgjedhi një grua të familjes Shala, në fshatin Shkabaj afër Prishtinës, e cila kishte lindur 16 fëmijë e që të gjithë po jetonin në Kosovë, pavarësisht nga skamja që i kishte kapluar.

<sup>41</sup> Faksimile: Savezni Sekretarijat za Pravosuđje i Upravu 2/3-112/3 1991-03.

<sup>42</sup> Inforogana, nr.2, f. 6-7, shtator 2006.

*Si shoqatë sa kishit guxim që të vepronit haptas në gjithë Kosovën?*

**Kema:** Ne llogarisnim se edhe mund të pengoheshim në veprimtarinë tonë, por frikë nuk kishim aspak. Fundja, ne shoqatën e patëm regjistruar tek organet përkatëse. Madje, sa herë që na jepej mundësia ne edhe e promovonim atë nëpër manifestime të tjera gjithandej Kosovës, gjithmonë duke u thirrë në vlerat e shoqatës.

*Si e komenton çështjen e shpërnguljes së pjesës intelektuale?*

**Kema:** Njerëzit e dijshtëm duhet të qëndrojnë gjithsesi në atdhe, përndryshe me të paditurit dhe dritëshkurtët politikë do të luajnë pastaj të gjithë – edhe të huajt, por edhe matrapazët tanë. Prandaj, qeveritarët tanë patjetër duhet t'i motivojnë intelektualët që të qëndrojnë në atdhe dhe ta japin kontributin në fusha përkatëse. Kjo është detyrë parësore edhe e SHKSHSH-së.

*Cili ishte roli i themelimit të Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta?*

**Kema:** Themelimi i shoqatës kishte rëndësi teorike dhe praktike.

## **Pesha teorike**

Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve ishte plagë që vazhdimisht pikonte gjak.

Problemi i shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e veta është një nga problemet më të rënda dhe më trishtuese të kombit tonë, i cili për nga gjeneza e vet është i lashtë; për nga përmasat është tepër i madh, sepse me këtë tragjedi historike, shekuj me radhë, rropatet më tepër se gjysma e kombit tonë, ndërsa nga aktualiteti është më aktual se kurrë më parë. Pra, aktual, sepse vetëm brenda

këtyre dy vjetëve të fundit, para themelimit të shoqatës, nga trojet tona janë shpërngulur me mijëra shqiptarë. Prandaj, themelimi i një institucioni të posaçëm, që do të merrej me hulumtimin e gjenezës historike të shpërnguljes sonë nga trojet tona etnike, me shkaqet, rrethanat, të cilat e nxisin dhe e motivojnë këtë shpërngulje, me mjetet, mënyrat dhe metodat e pakësimit ose eventualisht të pengimit të kësaj të keqeje historike ishte dje, është sot, dhe do të jenë gjithmonë në të ardhmen tonë - domosdo e kohës.

Tani angazhimi i secilit prej nesh, në këtë detyrë të shenjtë kombëtare, shpreh gatishmërinë dhe vendosmërinë tonë në realizimin praktik të përcaktimeve dhe synimeve tona shekullore. Kjo është detyrë qytetare dhe patriotike e secilit prej nesh.



*Autori i librit (i pari nga e majta) në shoqërim me anëtarët e Kryesisë së SHKSHSH-së, Prishtinë, shkurt 2005.*

Fakti që më tepër se gjysma e kombit tonë ka jetuar jashtë kufijve të shtetit amë, flet mjaft për dimensionin e këtij problemi. Pushteti serbomadh gjithmonë e ka shkaktuar dhe e ka nxitur shpërnguljen tonë nga trojet tona. Kjo shpërngulje i ka pasur gjatë kohëve të ndryshme edhe trendët dhe intensitetin e ndryshëm. Shpërngulja, herë-herë ka qenë më intensive e ndonjëherë më e qetë. Por, në esencë ka qenë një proces historik, që vazhdimisht është zhvilluar.

Në pranverën e vitit 1981, kur rinia studentore, ajo e shkollave të mesme dhe pjesa dërrmuese e popullit, doli me kërkesën e hapur për të drejtën kombëtare - Republikën e Kosovës, pushteti i atëhershëm komunist shpiku çështjen e shpërnguljes së serbëve dhe malazezve nga Kosova, me qëllim të internacionalizimit të çështjes së popullatës serbomalazeze dhe gjoja vuajtjeve të tyre nga shqiptarët. Pra, nuk është hera e parë e as e fundit që fajtori e akuzon viktimën, kur natën likuidon fqinjin shqiptar e ditën e vajton me lot krokodili. Vazhdueshëm ishte një përpjekje e tyre për mashtrimin e opinionit ndërkombëtar, gjoja se serbët në Kosovë gjithmonë paskan qenë të torturuar dhe me dhunë qenkan detyruar që ta braktisin vendlindjen e tyre, - gënjeshtër e kulluar, gjithsesi!

Qëllimi kryesor i armiqve të kombit tonë ishte ndërrimi i strukturës etnike të trojeve tona kombëtare. Për fat të keq, edhe sot ka njerëz edhe nga radhët tona që për interesa personale janë në gjendje të nxisin shpërnguljen e vëllezërve të vet.

Detyra e shoqatës sonë është që çdokujt t'ia komunikojë të vërtetën, se askush askund nuk e ka më mirë sesa në vatrën e vet. Pra, siç thotë proverbi popullor: në vendlindje është më e ëmbël balta, sesa në mërgim mjalta!

## **Pesha praktike**

Shoqata, që nga themelimi i Kuvendit zgjedhor, që ishte shumë madhështor, e gjer më sot, është preokupuar që të realizojë programin e vet. Ajo, mbledhjet e veta të kryesisë, plot një vit, i ka mbajtur nëpër degët e themeluara në tërë Republikën e Kosovës dhe të kryesive të degëve, ku edhe rezultatet ishin evidente.

Në kuadër të kryesisë së shoqatës janë themeluar seksione përkatëse me qëllim që punët të jenë të ndara dhe frytdhënëse. Fizionomia e kryesisë përbëhet prej një strukture profilesh të ndryshme profesionale që nga punëtori i krahut e deri te akademikë shkencash. Marrëdhëniet ndërnjerëzore në kuadër të kryesisë së shoqatës janë për çdo lakmi, e që e dëshmon prania e të gjithë anëtarëve të kryesisë në çdo mbledhje. Këto mbledhje janë realizuar dy herë në muaj,

fillimisht në Pejë e më vonë në Prishtinë. Në çdo mbledhje gjithherë është diskutuar për çështje që e preokupojnë shoqatën e kurrë nuk jemi marrë me vetveten. Dëshmi konkrete për punën e shoqatës është nxjerrja në dritë të librit “Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve”, pastaj botimi i revistës “Agimi” si dhe përgatitja e dorëshkrimit të veprës “Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë viteve 1953-1957” me një vëllim prej 987 faqesh.

Kryesia e shoqatës, si asociacion demokratik shqiptar, si në Kosovë, ashtu edhe kudo jashtë saj, e ka përfaqësuar anëtarësinë e vet të gjithmbarshme.

Sa për ilustrim për punën konkrete të Kryesisë së Shoqatës do të numëroja si vijon:

- Vizita e delegacionit të Kryesisë së Shoqatës në Turqi, në krye me Dr. Skënder Rizën;
- Promovimi i librit “Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve” në Shkup dhe në Tiranë;
- Vizita e delegacionit të Kryesisë së Shoqatës, në krye me kryetarin Jahja Lluka, Prof. dr. Pajazit Nushin, Prof. dr. Masar Rizvanollin, Prof. Ekrem Kallabën si dhe Kamber Avdiun, kryeredaktor i revistës “Agimi”, që i bëri shoqatës simotër “Trojet tona” me seli në Tiranë. Gjatë kësaj vizite këta veprimtarë u takuan me përfaqësues të 17 institucioneve shtetërore e civile të Shqipërisë. Me këtë rast këta i priti dhe i përshëndeti edhe presidenti i Shqipërisë Dr. Sali Berisha, i cili aktivitetin tonë e mbështeti me fjalët: “...kudo që gjenden shqiptarët, në gjakun e tyre duhet ta fusim shkronjën shqipe...”.
- Vizita e delegacionit të Kryesisë së Shoqatës në krye me Prof. dr. Pajazit Nushin në Tiranë dhe pjesëmarrja në simpoziumin ndërkombëtar “Shqiptarët dhe Amerika”.
- Më 24 nëntor 1992, një delegacion i kryesisë, i udhëhequr nga kryetari Jahja Lluka, mori pjesë në simpoziumin ndërkombëtar - “80-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë”, i mbajtur në Tiranë. Ndërkaq, më 28 nëntor të po atij viti (1992) po ky delegacion ishte i pranishëm në manifestimin e ngritjes



së flamurit në Vlorë dhe po të njëjtën ditë u takua me kryesinë e Lobit Shqiptaro-Amerikan, të udhëhequr nga z. Xhozef Diogardi.

Porosia e këtij raporti është: **mos angazhimi dhe përtesa jonë sot, nesër do të jetë vonë për ankesa!**



Ekrem Kallaba e Jahja Lluka dy prej anëtarëve të kryesisë së SHKSHSH-së, të cilët i dhanë jetë shoqatës në trojet shqiptare



Aktiviteti në shoqatë na e shtoi guximin qytetar, saqë më 30 mars 1991 themeliam Degën e Partisë Republikane në Dardanë. Natyrisht, këtij themelimi i parapriu edhe entuziazmi, vullneti, dëshira dhe aktiviteti i Këshillit nismëtar të një grupi intelektualësh, të cilëve u priva unë si kryetar i zgjedhur. Në praninë e shumë anëtarëve edhe nga parti dhe organizma të tjerë u zgjodh Kryesia prej 13 anëtarësh, kryesisht intelektualë fushash dhe profilesh të ndryshme. Takimi u bë në shtëpinë tonë në Roganë (ish-Rogoçicë) më 30 mars 1991.

## **Raport pune i Partisë Republikane të Dardanës prej 30.3.1991 – 17.2.1992**

Themelimit të Partisë Republikane të Kosovës, Dega në Dardanë, i parapriu entuziazmi, vullneti, dëshira dhe aktiviteti i Këshillit nismëtar të një grupi të vogël të intelektualëve të paraprirë nga Prof. Ekrem Kallaba, i cili njëherësh edhe zgjidhet kryetar i parë i Degës së Partisë Republikane. Aktin solemn të themelimit të PR të Kosovës, Dega në Dardanë dhe zgjedhjen e kryesisë prej 13 anëtarësh, kryesisht intelektualë të të gjitha profileve, e bënte edhe më madhështor pjesëmarrja e përfaqësuesve të të gjitha partive politike, mysafirëve të shumtë, kryesisht të burgosur politikë të ndërgjegjes ose anëtarë të familjeve të tyre. Mu për këtë, akti i themelimit – 30 marsi 1991, është akt historik për Partinë Republikane në Dardanë.

Gjatë punës së Partisë Republikane, Dega në Dardanë, po sikurse edhe gjatë themelimit të saj, u shfaqën një varg vështirësish:

Orvatja e pushtetit okupues serb në Kosovë, që, me gjithë ngushtimin e fushë veprimtarisë së elementeve të tyre, të vëzhgojë edhe më tutje aktivitetin politik të çdo shqiptari, te një numër i njerëzve paraqiste pengesë angazhimit në PR të Kosovës, si parti radikale në pikëpamje të programit, statutit, kërkesave dhe mjeteve me të cilat parashihte realizimin e aspiratave shekullore të shqiptarëve në Kosovë dhe më gjerë;

Veprimi bukur i gjatë kohor i LDK-së si parti politike më masive e shqiptarëve, e cila në gjirin e vet kishte përfshirë pothuajse pjesën dërrmuese të popullatës shqiptare, që në ato rrethana e shfrytëzoi fazën kalimtare nga një monizëm politik në një monizëm tjetër.

Te një numër i simpatizantëve dhe adhuruesve të programit dhe të statutit të PR të Kosovës, vetëdija se me kalimin nga një parti politike në tjetrën dëmton autoritetin individual dhe përshkruhet si pavendosmëri, po ashtu paraqiste pengesë për anëtarësim dhe angazhim në PR të Kosovës, Dega në Dardanë.

PR e Kosovës kërkesën për regjistrim ia ka bërë Kuvendit të Kosovës, meqë vetëm këtë organ e konsideron legal dhe legjitim.

Mbledhjet e PR-së, Dega në Dardanë, janë mbajtur në lokale private dhe në shkolla, si për shkak të mungesës së lokaleve, ashtu edhe për shkak të konspiracionit dhe të sigurisë.

Si kurore e punës së deritashme të PR të Dardanës janë themeluar nëntë nëndegë me dy këshilla nismëtarë, me një numër prej 1300 anëtarësh të PR të Kosovës.

Kontaktit me bazën partiake i është kushtuar vëmendje dhe rëndësi e duhur, por megjithatë aktiviteti në bazë ka qenë mjaft i zbehtë. Bashkëpunimit me partitë e tjera politike i është kushtuar kujdes i duhur, ndonëse kemi qenë mjaft të matur në vlerësime, deklarata dhe bisedime me partitë politike në shkallë komune. Po këtë qëllim e ka pasur edhe shkresa jonë dërguar partive politike për një mbledhje të përbashkët të kryesive. Kësaj shkrese pozitivisht i është përgjigjur Partia Parlamentare e Dardanës.

Jemi munduar që në mbledhjet e Kryesisë të shqyrtohen këto çështje, të cilat paraqesin preokupim të anëtarësisë së gjerë; prandaj temë qendrore e mbledhjeve tona ka qenë angazhimi për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare.

Kushtet materiale kanë qenë, e, edhe tani janë, pengesë për një aktivitet më të dendur të PR të Kosovës, Dega në Dardanë. Për shkak të mungesës së burimeve të rregullta të mjeteve materiale, sigurimi i mjeteve për punë është mjaft modest dhe vullnetar.

Në kuadër të bashkëpunimit me partitë politike të Shqipërisë ishte vizita e delegacionit të PR të Kosovës, në përbërje të të cilit ishte edhe kryetari i Degës sonë, në cilësinë e anëtarit të Kryesisë së PR të Kosovës dhe kryetarit të Degës në Dardanë. Për këtë vizitë është referuar para kryesisë, e cila vizitën e vlerësoi pozitivisht.

Në mbledhjen e Kuvendit jemi ballafaquar me disa kërkesa për tërheqje nga Kryesia e Degës. Arsyetimet ishin kryesisht për shkak të obligimeve të punës ose të angazhimit partiak apo shoqëror në parti dhe shoqata të tjera. Kemi bërë përpjekje që kjo të mos i dekurajojë anëtarët tanë, por megjithatë është hetuar një ngecje në punën tonë.

Prej themelimit të Partisë Republikane e gjer më tani Kryesia është takuar 13 herë. Në çdo takim kemi bërë përpjekje që vlerësimet tona politike të mos jenë konfuze, sipërfaqësore, me premtime që lehtë mund të dështojnë dhe njëherësh të mos lejojmë komoditet, ngecje dhe oportunitizëm në punën tonë.

Të ballafaquar me mungesën e mjeteve për rezistencë aktive ndaj pushtetit okupues serb, rastet e shkeljeve të të drejtave, qoftë individuale qoftë kolektive të shqiptarëve i ka denoncuar me gjykime politike përmes mjeteve të informimit, si p.sh. radios ose shtypit.

Është punuar në masivizimin e partisë me anëtarë të rinj. PR e Kosovës, Dega në Dardanë, si parti politike, lufton për pushtet, por në rend të parë për pushtet kombëtar. Synon që të vihet pushteti shqiptar mbi Kosovën. Çështjen e ndarjes së këtij pushteti kombëtar në atë individual e konsideron të dorës së dytë dhe krejt të lehtë. Mu për këtë PR në Dardanë nuk e pengon, por përkundrazi e nxit puna dhe aktiviteti i partive politike shqiptare në komunë dhe ato i konsideron krahe të fortë në sendërtimin e aspiratave kombëtare shqiptare.

Të vetëdijshëm se për çështjen kombëtare më së miri mund të kontribuohet duke i kryer secili punët dhe detyrat e punës në mënyrë sa më cilësore, kemi bërë përpjekje që koha e mbledhjeve të mos i marrë askujt kohën e çmueshme të punës dhe se mosardhja në mbledhje për shkak të punëve dhe obligimeve të punës plotësisht është arsyetuar nga ana e Kryesisë.

Kemi bërë përpjekje që brenda kryesisë të kultivojmë raporte të shëndosha si parakusht për punë cilësore. Vetes gjithmonë i kemi parashtruar po aq detyra sa edhe mund t'i realizojmë, të vetëdijshëm se prestigji dhe autoriteti mund të fitohen vetëm me punë.

Si punë konkrete, në të cilën një numër i anëtarëve tanë është angazhuar, pa u preokupuar fare se kush e organizon atë aksion, por që vetëm të jetë aksion që

shkon në dobi të çështjes kombëtare shqiptare, janë:

- Organizimi i mbajtjes së referendumit për Kosovën shtet të pavarur.
- Ndhimat rreth vetëfinancimit të arsimit si dhe organizimi e angazhimi për gjetjen e lokaleve, ku do të zhvillohej mësimi.
- Ndhimat rreth grumbullimit dhe shpërndarjes së ndihmave materiale për më të rrezikuarit në komunën tonë dhe jashtë saj.
- Ndhimat rreth organizimit, thirrjes dhe mbajtjes së tryezave të rrumbullakëta për problemet aktuale, si me karakter komunal, ashtu edhe republikan.



*Prof. dr. Pajazit Nushi me bashkudhëtarin e SHKSHSH-së Prof. Ekrem Kallaba*

Ka pasur raste që anëtari ynë u ka ndihmuar ushtarëve shqiptarë rreth ikjes nga kazernat e ushtrisë jugosllave dhe krijimit të vendit për sigurinë e tyre personale.

Në trupin koordinues të partive politike, që funksionon pranë Komunës së Dardanës, përfaqësohet edhe Dega e Partisë Republikane dhe, pavarësisht nga disa tendenca për të nënçmuar PR-në dhe për të majorizuar LDK-në e Dardanës, kërkesat tona të pareshtura për bashkëpunim vëllazëror dhe të sinqertë po krijojnë gjithnjë e më tepër bindje të përfaqësuesit të partive politike se fjala është për një parti serioze, që të vetmin qëllim ka zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Prandaj, parim dhe moto e punës së PR-së është që, nëpërmjet punës së ndarë, të realizojmë qëllimet e përbashkëta.



SHKSHSH jep Çmimin “Hasan Prishtina” për zyrtaren e lartë të SHBA-së zonj. Medlajn Ollbrajt (Madline Allbright)

*Në raportin e punës suaj në Partinë Republikane, Dega na Dardanë, u tha se keni marrë pjesë në një vizitë pune në Shqipëri. A keni mbajtur shënime dhe a janë ato publike?*

**Kema:** Po, si jo. Ka qenë një vizitë e ngjeshur me parti dhe individë të rëndësishëm të jetës politike në Shqipëri. Çështje e vërteta, ne kemi bërë dy vizita në Shqipëri. E para ka qenë prej 15 – 20 gusht 1991 dhe vizita e dytë, një vit më vonë, prej 23 – 29 qershor 1992. Kanë qenë vizita të domosdoshme për



kohën me qëllim të bashkërenditjes së veprimeve me shtetin amë për fatin e mëtejshëm të Kosovës. Gjatë tërë kohës jam përpjekur të mbaj shënime nga këto takime.

## **Qëndrimi zyrtar në Shqipëri prej 15 – 20 gusht 1991**

15 gusht 1991

Ora 6:33 në kufi të Shqipërisë, Kapshticë, Greqi.

**Tiranë, 15 gusht 1991, ora 18:00,**

Ora 18:00 u takuam në lokalin e Partisë Republikane të Shqipërisë, me kryetarin e PRSH-së – Sabri Godon dhe me nënkryetarin Vangjush Gambeta, pastaj nënkryetarin Zef Bushatin, njëherazi aty ishin të pranishëm edhe Çerçiz Mingomataj, shef i Sektorit të marrëdhënieve me jashtë, Skënder Kërçuku, anëtar i komunitetit drejtues dhe shef i Sektorit ekonomik, Tamara Luarasi, anëtare e komunitetit drejtues; kryetari i Degës së PR-së të Shkodrës, Xhevat Repishti; kryetari i Degës së Tiranës, Maksim Haviari dhe me kryeredaktorin e gazetës “Republika”, Petro Dhimitrin.

Fjalën hyrëse në kuvendin e PR-së e mori Sabri Godo, kryetar. “Ne, fatkeqësisht dimë fare pak për fatin e Partisë Republikane të Kosovës. Asnjë parti nuk ecën pas njerëzve, por njerëzit ecin pas nesh-partisë. Partia duhet të mbahet moralisht e pastër dhe në parti të mos na futen elementë të dyshimtë.

Është kërkesë e kohës që krerët e Shqipërisë dhe Kosovës t'i bashkojë interesi kombëtar. Lypset që po të dy kryesuesit e partisë të takohen jashtë vendit dhe të bisedojnë për shumë gjëra, jo për shkak të frikës, por për shkak të domosdoshmërisë së kohës. Sot, kur kërcënimi është i hapur, ne duhet të ngremë zërin bashkërisht dhe bota ta shohë se ne vetëm si të bashkuar e mendojmë jetën: “Fëmijën pa qarë, nuk e merr nëna”.

Ne kemi nevojë që të formojmë një qeveri të përbashkët, e cila do të marrë vendime dhe do t'i zbatojë ato. Pa u mënjanuar komunistët nga pushteti, ne nuk mund të ngrihemi në këmbë. Ata organizojnë djegie, krijojnë banda të ndryshme për të abuzuar punën e partive të reja.

Partia Socialiste është një faktor negativ. Ne jemi një parti e urtë dhe ecim me hapa të sigurt. Por, kur rrezikohet jeta e popullit, ne përdorim edhe forma të tjera. Atëherë kur ndihemi më së keqi, atëherë duhet të vetorganizohemi dhe të mbliidhemi rreth boshtit kombëtar.

Një takim që pata me partitë politike shqiptare të Jugosllavisë në Nju-Jork, vëreja se ata ishin të përçarë. Ne duhet të mundohemi të zbulojmë se çfarë fati është përgatitur nga Ballkani për Shqipërinë dhe Kosovën! Në kohë rreziku shqiptarët do të jenë të bashkuar, si të varfrit ashtu edhe të pasurit. Unë besoj se kufijtë do të jenë të hapur dhe ndihma do t'u ofrohet kosovarëve.

Serbia mund të përdorë dy metoda: - Me anën e fushatës dhe në mënyrë individuale.

Po s'u thyen shqiptarët, Serbia kurrë nuk do ta rrafshojë, nuk do të mund ta shkatërrojë Kosovën. Ne do të jemi krah vëllezërve kosovarë. Çdo gjë që ndodh në Kosovë është ndodhi e Shqipërisë. Të dy palët të mendojmë me kokën tonë. Evropa nuk mund ta ndalë punën e Milosheviqit, këtë mund ta vendosin vetëm fuqitë e mëdha. Ne aspirojmë për bashkim kombëtar". (Biseda përfundoi në orën 20:25).

### **Krujë, 16 gusht 1991, ora 13:00**

Vizitua Muzeun e Krujës. Vizitën e organizoi Dr. Xhevat Repishti - kryetar i Partisë Republikane, Dega e Shkodrës.

Të pranishëm ishin: Dr. Xhevat Repishti, Rezear Xhaxhiu, Shpëtim Dani, Reshat Nurboja, Jahja Lluka dhe Prof. Ekrem Kallaba.

Këtu zhvillua biseda zyrtare me kryetarin e Partisë Republikane të Shkodrës – Dr. Xhevat Repishtin, doktor i shkencave historike, me Shpëtim Danin dhe Rezear Xhaxhiun. Bashkërisht diskutua për zgjidhjen e çështjes gjithëkombëtare shqiptare. Këta i mundon edhe problemi, jo vetëm i gjendjes në Shqipëri, por edhe në Kosovë (vizita përfundoi në orën 15:24).

**Tiranë, 16 gusht 1991, ora 18:00**

Takimi me Ramiz Alinë

Ramiz Alia – presidenti i shtetit shqiptar, bëri pyetje se me çfarë mjetesh mendoni ta zgjidhni çështjen e problemit të Kosovës? Secila parti dëshiron ta zgjedhë nga një president. Në Jugosllavi ka përleshje të mëdha, nuk dihet se çfarë do të ndodhë me Jugosllavinë! Kosova dhe shqiptarët jetojnë në një vend të caktuar, prandaj është e domosdoshme që të bëni analiza me kokën Tuaj!

Në qoftë se flitet për marrëdhëniet në mes nesh, është e domosdoshme të ndjekim zhvillimet e ngjarjeve. Personalitetet historike dalin në kohë historike.

Shpallja e Kosovës Republikë është kërkesë e drejtë. Programi kombëtar duhet të punojë në mënyrë unike. Zgjidhja e problemit të Kosovës është problem i madh edhe për Shqipërinë. Kosova dhe Shqipëria kanë një fat të përbashkët. Në qoftë se zhvillimi i ngjarjeve në Jugosllavi vazhdon me përleshje dhe luftëra, atëherë edhe në Kosovë do të pëlcasë lufta. Problemi i Jugosllavisë nuk mund të zgjidhet pa praninë e shqiptarëve. Serbia i mori nëpër këmbë të gjithë interesat e shqiptarëve në Kosovë.

Gjendja ekonomike në Shqipëri është tejet e rëndë: e para, për shkak të mbështetjes në forcat e veta, dhe, e dyta, për shkak të lindjes së partive të reja.

Transformimi në ekonomi dhe politikë i ka sjellë njerëzit në një dembellëk të madh si dhe ka shkaktuar papunësi enorme. Kjo gjendje e rëndë ekonomike ndikon edhe në situatën politike e sociale.

Bashkimi i të gjitha forcave të partive politike mund ta nxjerrë popullin nga kriza. Ndihma është punë lypësish dhe, për shqiptarët, krejtësisht e pandershme.

Nuk mund të përparohet vendi duke u munduar për t'ia nxjerrë sytë njëri-tjetrit. Partitë politike duhet të punojnë për qetësimin e popullit. Bashkimi i kombit sot e ka shansin e fundit, këtë mundësi nuk e ka pasur kurrë (Takimi përfundoi në orën 19:50.)

**17 gusht 1991, ora 11:00**

Takim rasti me Ajet Haxhiun – shkrimtar me prejardhje kosovare.

Një takim rasti me shkrimtarin me prejardhje nga Kosova, z. Ajet Haxhiu shtoi krenarinë tonë. Biseda e shkurtër, por e përzemërt dhe vëllazërore, nguliti në kujtesën tonë porosinë dashamirëse të tij: “Të punoni vetëm për të mirën e kombit, pa u ndalur në ndasitë politike dhe ideologjike. Pra, vetëm puna në të mirë të kombit mund të na sjellë bashkimin gjithëkombëtar”.



*Nga vizita e delegacionit të SHKSHSH-së në Lezhë. Nga e majta: Hazir Shala, Pajazit Nushi, Ekrem Kallaba, Xhevdet Gashi, Jahja Lluka, Ismet Ferizi, Kamber Avdija dhe Ibrahim ...(?)*

**Durrës, 17 gusht 1991, ora 18:35**

Në Kalanë e Durrësit rastësisht u takuam me delegatët e Kuvendit të Kosovës, që kishin në dispozicion veturat e Presidencës së Ramiz Alisë.

### **Shkodër, 18 gusht 1991, ora 12:30**

Këtu u takuam me kryetarin e Komitetit Ekzekutiv, dr. Ali Spahiun, përfaqësues i Partisë Demokratike, mjek i respektuar dhe patriot i dalluar.

Ai tha se jemi të vendosur që çdo ndihmë t'ia japim, për arsye se ne jemi një komb “Ose të ekzistojë edhe Kosova edhe Shqipëria ose asnjëra”, shpresojmë se së shpejti do ta zbatojmë ligjin e ndarjes së tokës. Ndarja e tokës do të ndihmojë edhe në unitetin kombëtar. Kosovën dëshirojmë ta shohim zonjë të vetvetes.

### **Lezhë, 18 gusht 1991, ora 16:33**

Këtu u takuam me Skënder Drinin –shkrimtar nga Kosova, me qëndrim në Shqipëri.

Gjatë bisedës ai shprehu besim të madh tek intelektualët e Kosovës, për të cilët shfaqte admirim, duke shfaqur gjithashtu nostalgji për vendlindjen e vet. “Shpresoj se intelektualët kosovarë do të mundohen me mish e me shpirt për të mirën e Kosovës. Unë mendjen time e kam në Kosovë dhe shumë shpejt do të kthehem atje”, u shpreh shkrimtari ynë i nderuar, z. Skënder Drini, me të cilin bashkërisht vizituam varrin e Skënderbeut në Lezhë dhe bëmë një fotografi të përbashkët.

### **Tiranë, 19 gusht 1991, ora 9:40**

Vizituam selinë e Partisë Social Demokrate. Bëmë një takim vëllazëror dhe u njohëm reciprokisht me ecurinë e punëve të të dyja partive.

Kryetari Skënder Gjinushi na njoftoi për rrjedhën e punës së kësaj partie që nga themelimi e gjer më tani. Tani kemi një krizë të madhe ekonomike, që godet me të madhe tërë Shqipërinë. Partia e punës, me një injorancë të pashoqe, mashtrroi fshatarësinë dhe shkaktoi një gjendje të rëndë ekonomike. Pa investime të huaja është vështirë ta stabilizojmë gjendjen ekonomike, pra, ajo do ta zhblokonte këtë kolaps ekonomik.

Po të njëjtat forca janë prapë në pushtet, por me një formë më të modernizuar. Forcat politike janë shumë më të forta se Partia e Punës. Është i domosdoshëm një bashkërendim i opozitës për ta shkatërruar Partinë e Punës.

Demokracia e Ramiz Alisë është fare hipokrite. Asnjë parti si e vetme nuk mund ta mbajë pushtetin, por vetëm si unike mund t'i ndihmojmë kombit. Është i natyrshëm koalicioni ynë me Partinë Republikane dhe atë Demokratike. Opozita më kompakte do ta fitojë pushtetin.

**Tiranë, 19 gusht 1991, ora 12:15**

Vizitua Drejtorinë e Drejtorisë së Diasporës Shqiptare në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Dr. Hasan Muçostena.

Mërgata shqiptare, si gjithmonë, është një plagë e rëndë, sa për Kosovën, po aq edhe për Shqipërinë. Përderisa ne në Kosovë, në mungesë shteti, kemi vetëm një shoqatë për kthimin e të shpërngulurve nga trojet e veta, në Shqipëri ekzistonte Drejtoria e diasporës shqiptare. Prandaj, në agjendën tonë kishim vizitën me drejtorin e Drejtorisë së Diasporës pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Dr. Hasan Muçostena.

I respektuar për vizitën që i bëmë, ai na u drejtua me këto fjalë: “Ju keni bërë punë të madhe që keni ardhur si shqiptarë, si vëllezër e posaçërisht për ndriçimin e situatës së emigracionit shqiptar kudo që gjendet. Drejtoria e mërgatës u drejton një apel të gjithë shqiptarëve që gjenden në diasporë”.

## **Apeli**

“Shqipëria tani është shtëpi e tyre, ta njohin atdheun e vet, të ndihmojnë vëllezërit dhe atdheun, tash kur kanë më së tepërmi nevojë”. Shqiptarëve u mundësohet që të kenë dy pasaporta. Shqiptarët të kontribuojnë me mendjen e tyre; këta duhet t'i bashkojë shqiptaria. Të gjitha partitë duhet të kontribuojnë për bashkimin e kombit. Emëruesi i përbashkët i të gjitha partive duhet të



jetë: ruajtja e Shqipërisë etnike me të gjitha tokat shqiptare. Këtë ndryshim në Shqipëri e bëri populli e askush tjetër. Shqipëria nuk vuan që nuk ka njerëz, por duhet si të bashkuar të veprojmë, duhet t'i shërbejmë ecjes përpara. Duhet t'i thërrasim mendjes, që duhet të jemi të bashkuar, se vetëm kështu mund ta ruajmë Shqipërinë. Intelektualët duhet ta japin maksimumin e vet shkencor për të mirën e Shqipërisë, p.sh. shteti izraelit u krijua nga izraelitët që ndodheshin në diasporë. Rreth 70% të shqiptarëve i takojnë moshës së re.

Unë nuk i takoj asnjë partie, sepse kam vetëm ideal dhe mendim që t'i ndihmoj me punë dhe mençuri unitetit kombëtar. Ne, nëse merremi me vetveten, nuk do t'i ndihmojmë ecjes përpara.

Gjithë të dënuarit duhet të rehabilitohen, t'u gjejmë punë dhe ta gëzojnë jetën e lirë.

Me shqiptarët jashtë Kosovës dhe jashtë Shqipërisë nuk guxojmë të formojmë parti. Ata duhet t'i bashkojë "Flamuri kombëtar" dhe të veprojmë nën hijen e tij.

Ne duhet të forcojmë lobin shqiptar, i cili do të ndërkombëtarizojë çështjen shqiptare. Partitë politike në diasporë nuk guxojnë të funksionojnë. Rexhep Qosja është intelektual i parë që herët ka hetuar se partitë do të pengojnë zgjidhjen e çështjes kombëtare. Pra, duhet të themelojmë: "Kuvendin e mendjes shqiptare" e jo kuvendet e partive. Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, programin antishqiptar e kanë bërë me shkollë, me platformë.

Problemi shqiptar mund të zgjidhet vetëm me Kuvendin shqiptar.

"Varfëria nuk duhet të ndikojë që të harrojmë atë që është e rëndësishme për popullin".

Duke e përshëndetur këtë takim, Jahja Lluka tha se shqiptarët e Kosovës presin që në sytë tanë të shohin të gjithë vëllezërit e Shqipërisë. Njëherazi, ai shtoi se në Kosovë djepat e fëmijëve tanë do t'i përkundim me këngën e bashkimit të tokave shqiptare.

Illir Qakalli – shef i seksionit të kulturës në Lushnje ia fali dy piktura kryetarit të PR-së të Kosovës, Reshat Nurbojës.

## Tiranë, 19 gusht 1991, ora 17:00

U takuam me kryetarin e Partisë Demokratike, Dr. Salih Berishën. Ai pohoi se gjendja ekonomike është shumë e vështirë. Këtu është harruar të punohet. Punëtorët nuk kanë ku të punojnë, ka vështirësi të mëdha për jetesë. Pa u zgjidhur problemi i Shqipërisë, nuk mund të zgjidhet problemi i Kosovës. Jemi popull që më së paku i kemi gëzuar të drejtat në Evropë. Situata më bën të shqetësuar dhe nuk mund të rehatohem në një situatë të këtillë.

## Lushnje, 20 gusht 1991, ora 11:10

Në zyrën e komitetit drejtues të Partisë Republikane u takuam me të gjithë anëtarët e kryesisë së partisë: Shpend Qallaku – kryetar i Degës së PR-së, Tasim Rakipi, Rrapi Hajdari, B.D. (Bekdash Dervishi), Andon Kushi, Viktor Shella, Shkëlqim Këmbova, Gëzim Hajdari, Skënder Kërçuku – pedagog në Fakultetin Ekonomik.

Pastaj shkua në Shtëpinë e kulturës, ku ishin tubuar mbi 150 qytetarë, shumica ishin emigrantë nga Kosova, Medvegja, Bujanoci dhe Presheva. Ata me lot për faqe bënë pyetje të llojllojshme. Ne iu përgjigëm të gjitha pyetjeve dhe mbetën të kënaqur.

Pas mbarimit të takimit, vëllezërit e Lushnjes na shtruan drekë në manastirin e Ardenicës. Takimi mbaroi në orën 14:10.



Ekremi mbante shënime nga të gjitha takimet në Shqipëri



*Mikpritje e përzemërt nga vëllezërit shqiptarë të delegacionit të SHKSHSH-së nga Kosova*

## **Vizita e dytë e qëndrimit zyrtar në Shqipëri prej 23 - 29 qershor 1992**

*Gati një vit më parë ishit për vizitë zyrtare në Shqipëri, tani sërish keni shtruar kërkesën për një vizitë të dytë, cila është arsyeja?*

**Kema:** Vizita e dytë e delegacionit të SHKSHSH-së në Shqipëri, brenda një viti, ishte si rrjedhojë e shumë ngjarjeve që zhvilloheshin në Kosovë, ku shqiptarët e Kosovës dëmtoheshin nga politika dhe shteti serb. Keqtrajtimit ndaj shqiptarëve sa vjen e shtohen gjithandej Kosovës; rreth 90 ushtarë shqiptarë, që ishin në shërbim të Armatës Jugosllave, ishin kthyer në arkivole, gjithmonë me arsyetimin zyrtar nga APJ për kinse vetëvrasje, çka në fakt nuk ishte e vërtetë. Mijëra ushtarë shqiptarë nga Kosova që shërbenin, sidomos në Kroaci, Slloveni e Bosnjë Hercegovinë, sapo u jepej mundësia, dezertonin nga APJ, sepse nuk donin të bëheshin vrastarë të atyre popujve që donin lirinë dhe pavarësinë e vet. Edhe vetë SHKSHSH në Kosovë ishte në shënjestër të Sigurimit shtetëror serb dhe pengohej në kryerjen e detyrave. Me qëllim të bashkërenditjes së punëve të Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta ndërmjet degës në Shqipëri dhe kësaj në Kosovë, SHKSHSH e Kosovës vendosi për një vizitë simotrës së saj në Shqipëri. Dhe, kjo vizitë u realizua në javën e tretë të qershorit 1992.

### **Tiranë, 23 qershor 1992, ora 10:05**

Në agjendën e punës tashmë kishim në orar vizitën në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Tiranë. Pas një pranimi të përzemërt, një fjalë përshëndetëse për të pranishmit e mbajti Ismet Ferizaj, kryetar i Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta – Dega në Shqipëri. Ai elaboroi programin e kësaj shoqate në Shqipëri, e themeluar me iniciativë të kryetarit të shoqatës nga Kosova, z. Jahja Lluka.

Ismet Ferizaj pohoi se ata bashkëpunojnë me të gjitha shoqatat që i kanë të njëjtat qëllime dhe se kjo është shoqatë atdhetare që punon në të mirën e atdheut. Z. Ferizaj bëri të ditur se selia e shoqatës do të jetë në Tiranë, ndërkaq lidhur me veprimtarinë e shoqatës janë dhënë informata publike përmes medieve të shkruara dhe elektronike.

Jahja Lluka informoi të pranishmit për historikun e formimit të kësaj shoqate. Librezat e anëtarëve të shoqatës, në shkallë kombi, duhet të jenë identike. Për rëndësinë e shoqatës folën edhe: Dr. Pajazit Nushi, Dr. Masar Rizvanolli, Dr. Zyri Bajrami dhe Rrustem Gjata, jurist.

Ata ishin po aq të brengosur sa edhe vetë ne për zhvendosjen e popullit të Kosovës dhe shprehnin gatishmërinë e tyre për ndihmë konkrete. Përveç delegacionit nga Kosova, në takim kishte edhe pjesëmarrës të tjerë, të cilët, me nënshkrimet e tyre, dëshmuuan praninë, e që ishin: Rrustem Gjata, jurist – kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; Prof. dr. Kristaq Prifti, drejtor i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; Prof. dr. Lazër Radi, anëtar i Kryesisë së shoqatës “Trojet tona”; Prof. Hazir Shala, përfaqësues i Këshillit Koordinues i Lëvizjes Demokratike të Bashkimit të Shqiptarëve; Ismet Ferizaj, kryetar i Shoqatës “Trojet tona”; Dr. Kristaq Kume, anëtar i Kryesisë së Shoqatës “Trojet tona”; Tefta Rexha, anëtare e Shoqatës “Trojet tona”; Sokol Turani, anëtar i Shoqatës “Trojet tona”; Flamur Gashi nga PSHDK në Pejë; Xhevdet Osmani, nga Drejtoria e Bashkëpunimit ndërshqiptar dhe Diasporës në Ministrinë e Jashtme; Qazim Radoniqi; Doc. Zyri Bajrami, nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Tiranë; Xun Çetta, gazetar i pavarur nga Komuna e Istogut.

### **Tiranë, 23 qershor 1992, ora 12:30**

Vizituam Akademinë e Shkencave dhe aty u takuam me: Hekuran Mara, zëvendës drejtor i Akademisë dhe Luan Omari, sekretar i Akademisë së Shkencave.

Në kuadër të delegacionit nga Kosova ishim: Jahja Lluka, kryetar, Dr. Pajazit Nushi, anëtar i kryesisë, Dr. Masar Rizvanolli, anëtar i kryesisë, Prof. Ekrem Kallaba, anëtar i kryesisë, Kamber Avdiu, gazetar dhe Ismet Ferizaj, nga Kavaja – kryetar i Shoqatës në Tiranë.

**Tiranë, 23 qershor 1992, ora 15:30**

Vizitua Agjencinë Telegrafike Shqiptare. Këtu u takua me drejtorin e ATSH-së, Ilir Shita. Ai tha se jemi duke punuar që informimi i ATSH-së të depërtojë kudo ku ndodhen shqiptarët në botë.

**Tiranë, 24 qershor 1992, ora 10:30**

Vizitua Drejtorinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme për diasporë. Këtu na priti drejtori i Ministrisë Xhevdet Osmani, profesor, i cili edhe e hapi takimin.

Të pranishëm ishin: Xhevdet Osmani – drejtor, Jahja Lluka – kryetar i shoqatës,

Dr. Pajazit Nushi, Dr. Masar Rizvanolli, Riza Halimi, Preshevë, Prof. Ekrem Kallaba, Ismet Ferizaj, Kamber Avdiu – gazetar, Behlul Behluli, Preshevë, Rexhep Hasani, Preshevë, Petraq Sima dhe Fahri Balliu.

**Krujë, 24 qershor 1992, ora 14:10**

Drejtori i Ministrisë së Jashtme, Xhevdet Osmani na shtroi drekë në Krujë. Ai na mundësoi që ta vizitonim Muzeun kombëtar “Skënderbeu”.

**Fushë-Krujë, 24 qershor 1992, ora 16:30**

Këtu vizitua anëtarin e kryesisë së shoqatës Ibrahim Gashin, profesor i matematikës, i cili na informoi për punën e Shoqatës për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta.



### **Tiranë, 25 qershor 1992, ora 9:30**

Në Selinë e Partisë Republikane u takuam me kryetarin e kësaj partie, Sabri Godon, me të cilin biseduam shumë çështje që janë në interes të kombit.

### **Tiranë, 25 qershor 1992 ora 11:00**

Në pallatin e Muzeut Kombëtar u organizua mbajtja e promovimit të librit të Shoqatës “Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve”. Këtu morën pjesë mbi 150 qytetarë, kryesisht intelektualë.

Takimin e hapi Ismet Ferizaj, kryetar i Shoqatës “Trojet tona”, Tiranë.

Fjalën hyrëse e paraqiti Dr. Pajazit Nushi.

Për rëndësinë e këtij libri folën edhe: Dr. Kristaq Prifti, Dr. Zami Shtylla, Dr. Masar Rizvanolli etj.

### **Tiranë, 26 qershor 1992, ora 8:42**

Me ftesë zyrtare nga drejtori Dr. Kristaq Prifti, vizituam Institutin e Historisë dhe të Letërsisë. Fjalën hyrëse për diskutim dhe për bisedë vëllazërore e filloi Dr. Pajazit Nushi.

Diskutuan edhe: Dr. Jorgo Bullo, drejtor i cili kërkoi që të mbahet një simpozium me titull “Diaspora shqiptare dhe kultura shqiptare”, Dr. Masar Rizvanolli, Jahja Lluka, kryetar i shoqatës, Dr. Zyri Bajrami dhe Dr. Kristaq Prifti, i cili deklaroi se tre milionë shqiptarë jetojnë në Turqi.

Jahja Lluka propozoi që të bëhet një regjistrim i mirëfilltë i të gjithë shqiptarëve që ndodhen jashtë trojeve të veta etnike.

Dr. Kristaq Prifti, duke përmbyllur takimin tha: “Ne do t’i lëmë dyert të hapura

gjithmonë për gjithë vëllezërit nga Kosova, e në veçanti për studentët kosovarë që dëshirojnë të studiojnë në Shqipëri.”

**Tiranë, 26 qershor 1992, ora 12:00**

Vizituar Institutin Pedagogjik në Tiranë. Këtu na priti drejtori i Institutit, Dr. Kozman Grillo.

Jahja Lluka – kryetar: “Ju falënderoj nga zemra për mikpritje dhe respekt.

Unë rrëshqitazi do t’ju njoftoj për ecurinë e punës sonë, pikërisht për mërgatën si plagë shekullore. Kemi bërë një hulumtim shkencor për të shpërngulurit, të humburit dhe refugjatët në tërë territorin e Kosovës.

Kemi themeluar degë edhe në Luginën e Preshevës – Medvegjë, Bujanoc dhe Preshevë. Kemi bërë kërkesë për shfuqizimin e Konventës jugosllavo – turke.

Dr. Pajazit Nushi: - “Programi i shoqatës sonë përkon me çështjen e mërgatës sonë. Ne duhet të kemi parasysh se do të ndodhë asimilimi i fëmijëve tanë në diasporë. Prandaj jemi të interesuar që të bëjmë një planprogram unik për arsimin fillor”.

Dr. Kozmo Grillo: - “Edhe ne kemi ide mjaft konkrete për një program unik për arsimin në mërgatë. Jemi të interesuar që nga Kosova të na vijjnë intelektualë për të fituar tituj më të lartë, përkatësisht të vazhdojnë shkollimin superior”.

Dr. Pajazit Nushi: - “Ne në tetor do të shënojmë 100-vjetorin e “Shkollës së vashave shqiptare” në Prizren, që është identike me “Shkollën e cucave” të Korçës.

Temë bosht do të jetë shkollimi i femrës shqiptare në Kosovë. Luteni që edhe ju të prezantoni me punimet tuaja”.

Ismet Ferizaj: - Kjo shoqatë do të ketë edhe karakter arsimor – shkencor. Mendojmë që shumë probleme t’i zgjidhim në nivel gjithëkombëtar.

Dr. Masar Rizvanolli: - “Ne kemi edhe seksionin arsimor në kuadër të shoqatës”.

Dr. Petrit Muka: - “Shumë probleme që shtrohen nga Kosova përputhen me këto të Shqipërisë. Ne si shtet kemi për detyrë që t’ju ndihmojmë. Çdo material që ne kemi në institut do t’jua dërgojmë”.

### **Tiranë, 26 qershor 1992, ora 13:20**

Në Pallatin e Kongreseve u takuam me: Dr. Arben Puto – kryetar i Këshillit për të drejtat dhe liritë e njeriut në Shqipëri.

Shqipëria për herë të parë është një vend pa të burgosur politikë. Kjo organizatë është themeluar në baza vullnetare. Kemi marrë kërkesa nga opinioni që ta heqim dënimin me vdekje. Kemi bërë një buletin që është botuar me vonesë, për shkak të vështirësive financiare. Një ekzemplar iu dhurua kryetarit, Jahja Llukës. Kemi propozuar që edhe në shkolla të futet mësimi për të drejtat e njeriut.

Dr. Pajazit Nushi: - “Ju përcjell përshëndetjet e shokëve të Këshillit për të drejtat e njeriut në Kosovë, edhe pse unë kam ardhur në cilësinë e delegacionit të Shoqatës për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta. Pra, duhet të gjendet një mundësi që të formohet një program i përbashkët në nivel gjithëkombëtar për të drejtat dhe liritë e njeriut, duke pasur parasysh edhe shqiptarët në diasporë. Ne kemi dorëzuar një libër në shtyp për liritë dhe të drejtat e njeriut, ku ndihmën më të madhe na kanë dhënë zejtaret dhe mërgimtarët”.

**Tiranë, 27 qershor 1992, ora 9:00**

### **Arkivi kombëtar**

Këtu na priti drejtori i Arkivit Kombëtar, Dr. Gazmend Shpuza, i cili përshëndeti përzemërsisht ardhjen tonë.

Jahja Lluka, kryetar, shpjegoi historikun e formimit të shoqatës dhe arritjet e saj gjer më tani dhe për punën e mëtutjeshme.

Dr. Pajazit Nushi: - “Puna jonë është e pandarë prej arkivit, për atë edhe vendosëm që të bëjmë një kontakt të obliguar.

Ne jemi të interesuar që i tërë dokumentacioni të derdhet këtu, por gjendja jonë e vështirë, vështirëson mundësinë e realizimit të këtij qëllimi.

Puna jonë është me interes kombëtar dhe mundohemi që të ndriçojmë të vërtetën e shpërnguljes në periudha të caktuara”.

Dr. Gazmend Shpuza: - “Unë shpreh kënaqësi ndaj vëllezërve kosovarë, të cilët me punë të palodhshme dëshmojnë punën e tyre patriotike.

Në këtë arkiv ruajmë vlera të mëdha që nga shekulli VI, që dëshmon edhe punën tonë të palodhshme.

Në shtator, në Beograd u mbajt mbledhja e Arkivit në nivel ballkanik. Ne aty protestuam kundër marrjes së arkivit nga Prishtina e që është dërguar në Beograd”.

**Tiranë, 27 qershor 1992, ora 10:00**

Vizita në Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë

Këtu na priti kryeministri i Shqipërisë Aleksandër Meksi.

Ai tha: - “Unë kam dijeni për punën e shoqatës suaj dhe se ju interesoheni për gjendjen e shqiptarëve kudo që ndodhen.

Unë theksoj se të gjithë shqiptarët e kanë të njëjtin gjak dhe si të tillë një ditë do t’u realizohet qëllimi i tyre shekullor – bashkimi kombëtar”.

Ismet Ferizaj: - “Bashkëpunimi në mes të dy shoqatave është në një nivel të duhur. Pra, të dy shoqatat duhet të punojnë për një emër dhe librezat duhet të jenë të njëjta”.

**Tiranë, 27 qershor 1992, ora 11:10**

Takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Këtu na pritën Ministri i Punëve të Jashtme Alfred Serreqi dhe Bashkim Kopliku, zëvendësministër i Punëve të Brendshme.

Jahja Lluka, kryetar, shpjegoi për historikun e formimit të shoqatës, rëndësinë dhe arritjet e kësaj shoqate.

Diskutoi edhe Dr. Pajazit Nushi.

Alfred Serreqi, ministër – “Çështje primare është zgjidhja e çështjes mbarëshqiptare.

Ne duhet që përmes informimit të mundësojmë që çdo shqiptar, kudo që ndodhet, ta ndiejë veten shqiptar dhe të mbetet shqiptar“.

Diskutoi edhe Bashkim Kopliku, nga Ministria e Rendit.

**Tiranë, 27 qershor 1992, ora 14:00**

Drejtori i Akademisë së Shkencave, Dr. Hekuran Mara, na shtroi një drekë në hotelin “Arbëria” në Tiranë. I pranishëm ishte edhe sekretari i ASH-së, Luan Omara dhe drejtori i Institutit të Historisë, Dr. Kristaq Prifti.

**Tiranë, 27 qershor 1992, ora 18:00**

Këtu na pritën ministri i Punëve të Jashtme Alfred Serreçi dhe Bashkim Kopliku, zëvendësministër i Punëve të Brendshme.

Jahja Lluka, kryetar i Shoqatës, foli për historikun e formimit dhe të punës së Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta, rëndësinë dhe arritjet e saj. Diskutoi edhe Dr. Pajazit Nushi. Alfred Serreçi, ministër, tha se primare është zgjidhja e çështjes mbarëshqiptare. Ne duhet që, përmes informimit, të mundësojmë që çdo shqiptar, kudo që ndodhet, ta ndiejë veten shqiptar dhe të mbetet shqiptar. Diskutoi edhe Bashkim Kopliku, nga Ministria e Rendit.

**Berat, 28 qershor 1992 ora 13:00**

Instituti i Historisë organizoi që të vizitojmë qytetin historik Beratin, aty edhe drekuam. Kjo vizitë u bë me iniciativë të Dr. Kristaq Priftit dhe Muharrem Dezhgiut.

Dr. Kristaq Prifti, shpjegoi për vjetërsinë e Kështjellës së Beratit dhe tha se vjetërsia e saj është që nga shekulli VI para erës sonë.



**Tiranë, 29 qershor 1992, ora 13:00**

Në Presidencën e Shqipërisë na priti presidenti shqiptar, Dr. Salih Berisha.

Të pranishëm ishim: Jahja Lluka, kryetar, Ismet Ferizaj, kryetar i shoqatës “Trojet Tona”, Dr. Pajazit Nushi, Dr. Masar Rizvanolli, Prof. Ekrem Kallaba.

Me këtë rast Dr. Salih Berisha, president, tha se çmon lart dhe me interes punën e kësaj shoqate. “Diaspora shqiptare nuk ka kurrfarë qëllimi nacionalist. Shqiptarët kudo që janë duhet të bashkohen rreth flamurit kombëtar.

Dyshtetësia do të zgjidhë një problem me rëndësi për shqiptarët.

Shoqata juaj duhet t’i çojë shkronjën dhe fjalën shqipe kudo gjakut shqiptar.

Pa u zhvilluar Shqipëria, çështja shqiptare nuk mund të zgjidhet lehtë. Do të keni gjer në fund përkrahjen time”.

**Tiranë, 29 qershor 1992, ora 17:30**

Para se të ktheheshim për në Kosovë, na u mundësua të merrnim pjesë në punimet e mbledhjes të Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Ishte një përjetim dhe kënaqësi e veçantë.

## **Pasojat nga vizita shtetit amë**

*Pate ndonjë pasojë nga pushteti për këtë vizitë?*

**Kema:** Çështje e vërteta, pas zhvillimeve demokratike në Shqipëri, Shqipëria kishte hapur kufijtë me shtetet fqinje. Njerëzit, megjithatë, kishin frikë nga pasojat, kështu që bënë vetëcensurë. Shumë shqiptarë nga Kosova, Mali i Zi e Maqedonia dëshironin ta vizitonin Shqipërinë, por nuk guxonin. Sidomos mërgimtarët kosovarë me kënaqësi do ta vizitonin Shqipërinë, porse kishte raste

kur pas vizitës në Shqipëri shfaqeshin probleme në kufijtë veriorë të Serbisë, për shkak të vulës hyrëse që u figuronte në pasaportë. Prandaj, shumica, kur vizitonin Shqipërinë, kërkonin nga autoritetet kufitare shqiptare që të mos u vinin vula në pasaportë, ndonëse që të kesh një vulë shqiptare në pasaportë ishte kënaqësi më vete.



*Anëtarë të SHGJ „Thëllëza“ nga Dardana pas mbledhjes së Këshillit Drejtues të FGJ të Kosovës, mbajtur në Dardanë, më 2 prill 2002*

Megjithatë, pas kthimit tim nga vizita në Shqipëri, më 1 shtator 1991 Shërbimi i Milicisë në Dardanë ma konfiskoi pushkën e gjuetisë, të tipit “Beretta”, të kalibrit 12 mm, me nr. 51127 dhe 05553, e të cilën e pata blerë legalisht në përfaqësinë e “Berettës”, në Tehnometal – Vardar, në Shkup, më 31 janar 1989, dhe e kam mbajtur me lejen për armëmbajtje deri më 1 shtator 1991, kur më është konfiskuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme në Gjilan - Sektori i Punëve të Brendshme në Dardanë. Organi i sipërpërmendur, më 3 dhjetor 1992 më ka lëshuar një vendim për konfiskim, me të drejtën që në afat prej një viti prej kësaj dite, pushka të shitet ose të tëhuajësohet, në të kundërtën ajo do të mbetet në pronësi të organit të sipërpërmendur. Pushka më është marrë me arsyetim të ruajtjes së sigurisë së qytetarëve të tjerë, përkatësisht të sigurisë së rendit dhe qetësisë publike. Paradoks i kohës! Pushka kishte vlerën 3’108’000.00 dinarë ose 642.79.- dollarë amerikanë. Pas konfiskimit parashtrova ankesë në Gjykatë. Procesi gjyqësor për këtë pushkë rezultoi me një odise disaveçare.

Më 20 shkurt 1993 e gjeta blerësin Ristić Vlastimir, të cilit ia shita pushkën në vlerë prej 4'000.- dinarë të rinj dhe mora një kapar prej 1'000.- dinarësh në prani të Ilmi Kryeziut dhe Dragolub Menkoviqit, që të dy punëtorë të Gjykatës komunale në Dardanë. Vlastimirit ia bëra me dije se pushka gjendet në Sekretariatit e Punëve të Brendshme në Dardanë. Një vit më vonë, më 10 mars 1993 Sektorit të Punëve të Brendshme, personalisht kryeshefit, në Dardanë ia parashtrova një kërkesë që pushka e gjuetisë t'i dorëzohet blerësit, të cilin më kishin detyruar ta gjeja. Por, kur u paraqita në SPB në Dardanë, ata më thanë se pushka nuk ekziston dhe se duhet t'i drejtohem Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Më 10 tetor 1994 bëra një padi kundër SPB-së të Serbisë me qëllim që të më kompensohet dëmi në vlerë prej 4'000.- dinarësh të rinj. Që të mos zgjatem, pas shumë ankesave e gjyqeve, unë fitova gjyqin, por jo edhe pushkën ose dëmshpërblimin. Kështu është kur “kadia të akuzon, kadia të gjykon”!



*Gjahtarë të shoqatës “Thëllëza” në Dardanë në një ditë gjahu (dhjetor 2006). Nga e majta: Astrit Shabani, Rizah Shabani, Ekrem Kallaba, Salih Shabani dhe Selami Kallaba*

*Çfarë do të thotë për një gjahtar të pasionuar t'i konfiskohet pushka e gjuetisë?*

**Kema:** Konfiskimi i pushkës së gjuetisë nuk nënkupton edhe shuarjen e pasionit tim për gjuetinë. Në këtë rast ky konfiskim nuk ka të bëjë me pasionin,

por me fobinë e shtetit serb nga shqiptarë të armatosur, qoftë edhe me vetëm një pushkë të gjuetisë. Dhe, kjo dukuri për ne shqiptarët është e njohur qysh nga aksioni famëkeq i armëve, gjatë viteve 1955-1956. Tashmë ishte një metodë më e sofistikuar e aksionit të tillë. Dhe, ky aktivitet i milicisë më asocionte në përgatitjen reale për një luftë të radhës. E, kjo edhe ndodhi më 1998/99.

*Meqë jemi te gjuetia. Si lindi pasioni i gjuetisë dhe në ç'masë ke qenë i pushtuar nga ky pasion?*

**Kema:** Nëse në kohët e lashta gjuetia ka lindur si domosdo e sigurimit të ushqimit, në kohët tona kjo nuk përkon me atë nevojë. Gjuetia si art sportiv, pa dyshim, është e shtrenjtë, dhe jo secili mund ta përballojë si të tillë. Te ne shqiptarët gjuetia është edhe si rrjedhojë e dëshirës për të qenë më afër armës e me këtë edhe më afër një sigurie personale dhe familjare. Konkretisht, tek unë, megjithatë, ka lindur si pasion, por edhe si sport i trashëguar nga brezat pararendës, qoftë nga ana e babait, qoftë nga ana e nënës. Kur kam shkuar te dajat, pjesa dërrmuese e muhabetit ka qenë e lidhur me gjueti; jo në kuptimin se sa mish ka sjellë dikush nga mali, porse është folur për mënyrën e gjuetisë, për përjetimet me zagarët, stilin e gjuetisë etj. Në familjen tonë, çështje e vërteta, para gjuetisë ka dominuar arsimit dhe edukimi familjar, ndërsa gjuetia vërtet është trajtuar si sport dhe rekreacion. Ta zëmë, në familjen e ngushtë me gjueti është marrë nga Tefik, unë dhe Selamiu, ndonëse edhe të tjerët janë marrë me gjueti, por më tepër kanë qenë gjuetarë pasivë. Një ditë gjahu kryesisht është dukur kështu: Në mbrëmje e kemi futur zagarin në dhomë, afër shporetit. Në mëngjes jemi zgjuar së paku një deri dy orë pa lindur dielli, kurse nëna gjithmonë është zgjuar edhe më herët për të gatuar për ne. Varësisht prej stinës së gjahut, kemi përgatitur municionin përkatës. Me vete kemi marrë enët për përgatitje të çajit, gotat, sheqerin si dhe ndonjë lloj mishi, zakonisht suxhuk ose mish i tymosur. Terrenin e kemi paracaktuar më herët bashkë me shokët e tjerë gjahtarë. Grupet kanë qenë kryesisht 5-6 veta, por ka ndodhur që në mal të takojmë edhe ndonjë shok tjetër. Lindja e diellit na ka gjetur gjithmonë në vendgjahishtë. Pas gjetjes së vendstartimit të përshtatshëm, nga Tefik e ka caktuar një vend për ndezjen e një zjarri. Prej atij vendi i kemi lëshuar zagarët. Ne kemi lëvizur në një perimetër prej tre-katër kilometrash, kurse nga kryesisht pesë-gjashtëqind metra dhe është kthyer për ta ndezur zjarrin. Pas nja dy orësh të gjithë kemi ardhur te zjarri, sepse nga tashmë e ka bërë çajin gati. Ndërkohë zagarët kanë hulumtuar gjurmët e egërsirave. Më i kërkuari ka qenë lepuri, por

ka pasur periudha kur dhelprat kanë bërë dëme, kështu që gjuetia e tyre ka qenë e subvencionuar për shkak të lëkurës.

Më kujtohet një rast kur zagaret po e ndiqnin një egërsirë dhe brofëm në këmbë për të shkuar në pjesën ku lehnin zagaret. Aga, tha të ndalemi, sepse “prandaj i kemi zagaret që ta ndjekin gjahun, kurse ju shijojeni lehjen e tyre”. Dhe vërtet ishte mrekulli. Aga kishte përvojë të gjatë në gjueti. Ashtu siç ishte duke pirë çajin, la gotën mënjanë, kapi çiftin dhe e drejtoi drejt një çeltire. Ne shikonim habitshëm dhe me zë të ulët e me pak humor thamë se aga po e pret lepurin të vijë për të pirë çaj me ne. Ai ktheu kokën nga ne për të kërkuar qetësi maksimale dhe, vetëm pas disa sekondash, krisi pushka. – Shko Selami merre lepurin, iu drejtua Selamiut, si më i riu i grupit. Dhe, vërtet, sikur ta kishte ndjekur me metra lëvizjen e lepurit. Edhe pak kohë vazhduam me çajin e ushqimin, duke diskutuar edhe për situatën e përjetuar, pastaj ndërruam vendgjahishtën për ta kaluar një ditë relaksimi në rajonin “Çuka e Kolloleqit”.



*Ekremi është rritur me pasionin për gjuetinë*

Unë vërtet kam qenë tepër i pasionuar pas gjuetisë, por po aq edhe pas zagareve të mirë. Njëherë kuptova se në Rahovec, një gjahtar e kishte një zagat të mirë për shitje, por po e mbante shtrenjtë. Mora veturën dhe shkova në Rahovec. Mezi u mora vesh që zagarin të ma shiste për tre mijë marka gjermane, që ishin



*Ekremi duke dëgjuar zagarët apo...?*





nja katër paga të mira mujore në gjimnaz. Zagari quhej “Balë”, sepse kishte një baloshe të bardhë në ballë. Ishte ngjyrë kafe drejt së kuqes, korpulent dhe vërtet mirë i ushtruar për gjueti. Ende nuk ishte hapur gjuetia. Shoqata kishte edhe rojën e gjahut. Në shoqatë kishte gjuetarë shqiptarë dhe serbë. Për rojë ishte angazhuar një serb, ish-milic i pensionuar, i cili merrte rrogë për atë punë. Për sherr, atë ditë unë dola pikërisht në atë terren ku kishte qenë pikërisht ky rojtar. Zagari sapo kishte trazuar një lepur dhe po lehte pandërprerë. Në faqen e shpatit përballë pashë rojtarin teksa e kishte drejtuar pushkën në drejtim të lehjes së zagarit me qëllim që ta vriste. Kur e pashë, më rrëmbeu paniku dhe vrapova edhe nja dyqind metra drejt tij. Zëri i zagarit afrohej gjithnjë e më pranë tij. Për një çast jam ndalur dhe jam kollitur me sa zë kisha dhe e drejtova pushkën në drejtim të tij, që, nëse ma vret zagarin, ta vrisja edhe unë rojtarin. Fati i tij dhe imi e ka kthyer kokën në drejtim timin dhe më ka vërejtur. Më hetoi se kush jam dhe u nis drejt meje. E pa se isha prishur në çehre. Ekrem, çka ke që je zbehur dhe pse e pate pushkën të drejtuar nga unë, m’u drejtua habitshëm. Buza më dridhej prej sikleti. I thashë që të shkojmë ta pimë nga një gotë raki, sepse sot shpëtuam që të dy. Pse, më pyeti? I tregova se unë ka dhjetë vjet që jam martuar dhe fëmijë nuk kam, dhe se në zagari e bëj investimin më të madh e të cilin sapo e kam blerë tre mijë marka, kështu që po të ma kishe vrarë zagarin, e pata ndër mend unë të të vrisja ty. E po, pasi qenka kështu puna, atëherë po shkojmë ta pimë nga një gotë raki, por nuk është mirë që ta kuptojnë anëtarët e shoqatës, sepse ti e di, bile edhe vetë ke votuar që të ruhet gjuetia jashtë stinës së gjuetisë. - Ashtu është, i thashë dhe i kërkova falje që isha afektuar nga ajo situatë.

Gjatë atij dimri i gjithë rajoni i Anamoravës kishte kuptuar për atë zagari që e kisha paguar aq shtrenjtë. Ngado që shkoja, e merrja me vete, në makinë. E ushqeja më mirë se vetveten. Ishte rritur në terren tjetër dhe ndonjëherë vonohej derisa kthehej tek unë.

Një ditë gjuetie ndërrova terrenin dhe shkova në malet e Konçulit. Dikush më kishte vëzhguar dhe më ishte vënë pas, që të ma vidhte zagarin. Pas disa orësh gjuetie, në një terren të hapur mes Maltërrnocit dhe Konçulit u ndërpre lehja e tij. Mendova se i ka humbur gjurma e gjahut dhe se është në kërkim të gjurmëve ose është kthyer prapa. Prita edhe një kohë të gjatë, por kisha një parandjenjë të keqe. Isha pothuajse i dashuruar me Balën. Fillova ta thërrisja, por kot. Dilja sa në atë kodër, sa në tjetrën. Thërrisja me sa zë kisha. Shtiva edhe disa herë me

pushkë përpjetë në mos vinte tek unë. Dikur, zuri edhe të errësohej. Shpresa që ta gjeja gjithnjë e më shumë zbehej. Vonë, krejt vonë, dola në rrugë ku e kisha lënë veturën dhe shkova në shtëpi. Isha bërë vrer nga mërzia dhe mllëfi që më kishte kapluar. Të nesërmen, sërish shkova në atë rajon për ta kërkuar, por kot. Porosita gjithë shokët e mi gjahtarë në mos i binin në gjurmë. Humbi pa shenjë. Mallkova vjedhësin e zagarit deri në qiell. Dhe, mbase më mirë që nuk i rashë në gjurmë, sepse një zot e di se si do të isha ndarë me atë hajn që ma kishte “plagosur rëndë” pasionin tim.

*Dhe, e le gjuetinë, apo vazhdove më tutje?*

**Kema:** Jo, assesi. Mirëpo, pas demonstratave të vitit 1981 dhe padëgjueshmërisë qytetare ndaj regjimit, mua më larguan nga puna, fillimisht nga arsimi, më 1983, dhe më vonë edhe nga ndërmarrja “Magnohrom” më 1991. Sidomos pas vizitës, në kuadër të Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta, që i bëra Shqipërisë në verën e vitit 1991, punëtorët e Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Gjilan, Sektori i Punëve të Brendshme në Dardanë, më 1 shtator 1991 ma konfiskuan pushkën e gjuetisë të markës “Beretta”<sup>43</sup>.



*Ekrem Kallaba gjatë një diskutimi në Federatën e Gjahtarëve të Kosovës, në Prishtinë, më 22 nëntor 2001*

<sup>43</sup> Faksimile e vërtetimit nga SPB në Dardanë për konfiskimin e pushkës „Beretta“.

Natyrisht, edhe kjo situatë ishte një sulm i rëndë për pasionin tim ndaj gjuetisë. Siç e kam cekur edhe më lart, pushka nuk m'u kthye kurrë, kështu që më vonë kam blerë një pushkë tjetër dhe kam vazhduar pasionin e gjuetisë.

Bile, më vonë, nga viti 1999, kam qenë aktivisht i përfshirë edhe në shoqatën "Thëllëza", në cilësinë e kryetarit, por edhe në kryesinë e Federatës së Gjahtarëve në Prishtinë, ku kam kontribuar në kultivimin dhe ruajtjen e gjahut në Kosovë. Kam qenë edhe iniciator për themelimin e një reviste mujore për gjuetinë, si organ i Federatës së Gjahtarëve të Kosovës, e cila është botuar deri më 2008.

*Më vonë, a vazhdove edhe më tutje me aktivitete në kuadër të SHKSHSH-së?*

**Kema:** Sigurisht që po. Vizita në Shqipëri, më 1991 dhe 1992, na trimëroi edhe më shumë, sepse jo vetëm shoqata simotër, por edhe kreu politik dhe partitë politike në Shqipëri tumirën veprimtarinë tonë të SHKSHSH-së. Kryesia e Shoqatës takohej shpesh, kryesisht në Prishtinë, por edhe në qendra të tjera. Pastaj anëtarët e kryesisë bënë hapa të vazhdueshëm në rajonet prej nga vinin. Unë më tepër isha i angazhuar në Anamoravë, me synim të angazhimit edhe në Kosovën Lindore, Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Çështje e vërteta, shpërngulje të madhe kishte edhe nga Kosova Lindore dhe kjo, pa dyshim, ishte një vragë që na brengoste.



*Vendimi për konfiskimin e armës 'Bereta'*



*Vëllezërit, Reshati e Ekremi në manifestimin 'Dita e kthimit', më 18 qershor 2002 në Prishtinë*

*Kishit takime në Kosovën Lindore, ju lejoheshin takime të tilla nga policia e atjeshme?*

**Kema:** Takimet ishin gjithmonë gjysmilegeale. Por, në Kosovën Lindore në vazhdimësi kishte aktivitete patriotike për çlirim, të paktën, kulturor. Kishim korrespondenca të vazhdueshme me kryetarët e partive politike shqiptare, si dhe me njerëz autoritativë. Intenca jonë ishte krijimi i klimës për mosshpërngulje si dhe mundësia për kthimin e të shpërngulurve. Për ta pasur situatën në dorë, duhej themeluar degë të shoqatës gjithandej, pra, edhe në Kosovën Lindore, në Preshevë, në Bujanoc dhe në Medvegjë. Kështu, pas themelimit të SHKSHSH-së në Preshevë e Bujanoc, themeluam edhe Degën në Medvegjë, më 5 shtator 1997. Kjo degë u themelua gjatë një tubimi të realizuar në lokalet e shkollës së Lebanës, e ku ishim të pranishëm anëtarët nga Kryesia Qendrore: unë, Saqip Ramizi dhe Hevzi Matoshi. Me këtë rast paraqita programin e punës, Saqipi foli për aktivitetin e Shoqatës, ndërsa Hevziu prezantoi statutin e Shoqatës. Në këtë tubim themelues u zgjodh Kryesia e Shoqatës dhe kryetari i SHKSHSH-së të Medvegjës, z. Ramadan Behluli, profesor i gjuhës shqipe<sup>44</sup>.

<sup>44</sup> Faksimile nga themelimi i shoqatës në Medvegjë – shënim gazetari.

Më kujtohet një takim që e ndërmora më 2 korrik 1997. Ishte ditë e theksuar – Shënimi i Ditës së shpalljes së Deklaratës për Kushtetutën e Kosovës. Sidoqoftë, unë, në emër të Kryesisë Qendrore dhe Saqip Ramizi, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së Gjilanit, me disa bashkëpunëtorë, shkuam për një vizitë pune në Bujanoc. Delegacionin tonë e priti kryetari i Degës së Shoqatës së Bujanocit, Agim Hasani, me aktivistë të tjerë. Biseduam për rolin e shoqatës dhe detyrat e saj në të ardhmen, në Bujanoc dhe në gjithë Kosovën Lindore<sup>45</sup>.



<sup>45</sup> Faksimile nga takimi i delegacionit të SHKSHSH-së në Bujanoc – shënim gazetari.



## Foto e dokumente nga arkivi familjar



*Ekrem Kallaba gjatë një diskutimi në kuvendin e kinologëve në hotel "Victoria" në Prishtinë, më 22 dhjetor 2003*



*Anëtarët e Kuvendit të SHGJ „Thëllëza“ në Dardanë pas takimit të mbajtur më 17. 4. 2004*





*Tefik Kallaba (majtas) dhe Fehmi Morina (Jakupi), bashkërisht e kishin mision arsimin, por pasion – gjuetinë. Nga ky gjah e kanë marrë nga një lepur për vete dhe të tjerët ua kanë dhënë shokëve të tjerë që kanë gjuajtur atë ditë.*



*Dardanë, prill 2004: Ekremi me zagarët e vet*



*Ekrem Kallaba (majtas) deri në ditët e fundit të jetës së tij ishte aktiv në Federatën e Gjahtarëve të Kosovës. Pamje nga një takim me Rizah Hotin, kryetar i SHGJ të Mitrovicës dhe Qazim Krasniqin, kryetar i Federatës së Gjahtarëve të Kosovës. Prishtinë, më 18.6.2008*



## IV

### **Diskutime, shënime, referime**

“ Guximi qytetar është forcë e individit që nuk duhet të struket në mendjen e tij. ”

---

*Ekrem Kallaba*



**Diskutimi i Ekrem Kallabës në manifestimin “Takimet e vendlindjes”, mbajtur në shtëpinë e kulturës në Roganë, më 1 maj 1994, para disa qindra pjesëmarrësve**

Motra dhe vëllezër,

në emër të Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta dhe në emrin tim personal, i përshëndes të gjithë të pranishmit e në veçanti ata që kontribuan në organizimin e këtij takimi.



*Diskutimi i Ekremit në Roganë, më 1 maj 1994*

Rrallë mund të gjesh në Evropën e sotme një popull si shqiptarët që gjatë historisë së tyre shumëshekullore të kenë pasur migrime aq të shpeshta e të pakthyeshme nga atdheu i tyre dhe në këtë shekull të qytetërimit t’u jenë nënshtruar shpërnguljeve aq masive e me dhunë. Shqiptarët përbëjnë sot një komb, masa e të mërguarve të të cilit, në krahasim me trungun etnik, është më e madhe se e popujve të tjerë. Pra, populli ynë ka përjetuar migrimet dhe shpërnguljet herë pas here në formën e një hemorragjie të madhe kombëtare,

për t'u kthyer më pas në një fenomen të përhershëm kronik. Sikur Evropa e forcave kundërshtare të përmirësojë gabimin e vet, atëherë Shqipëria e njësuar, me të gjitha pjesët e veta, do të jetë e vetmja shtëpi, atdhe i lirë e vullnet i vlerës sonë në mendjen dhe trupin tonë.

## **Metush Krasniqi – kafshatë që nuk kapërdihej nga UDB-ja jugosllave**

**Diskutimi i Ekrem Kallabës me rastin e katërbëdhjetëvjetorit të shkuarjes në amshim të Metush Krasniqit, organizuar nga SHKSHSH, dega në Dardanë, 14 tetor 2000**

Me rastin e dhjetëvjetorit të ekzistimit të saj, Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta (SHKSHSH), më 14 dhjetor 2000 organizoi takim publik me qytetarët e Komunës së Dardanës (ish-Kamenica). Takimi u bë në lokalet e Shtëpisë së Kulturës në Dardanë, duke filluar nga ora 11. Për punën dhjetëvjeçare të Shoqatës foli kryetari i saj, z. Jahja Lluka, kurse Ekrem Kallaba referoi për atdhetarin Metush Krasniqi dhe ndihmesën e tij në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e veta e që lidhet me 14-vjetorin e vdekjes së tij nga torturat serbosllave me temë: “Kafshatë që nuk kapërdihej nga UDB-ja serbosllave”.



*Metush Krasniqi në moshë të re*

Në mesin e qindra të pranishmëve, mysafir i këtij tubimi ishte atdhetari dhe i pathyeshmi Hysen Tërpeza.



“Kur dëgjoja se ndokush është shpërngulur  
Sytë më mbusheshin me lot  
Buzët më mbusheshin shkrumb  
E nga zjarrmia edhe gjoksi më gufonte si vullkan”.

Atë mbrëmje kur dielli perëndoi më vonë se kurdoherë tjetër, e nga gëzimi edhe nata u bë ditë, në shtëpinë e Asllan Krasniqit lindi një foshnjë e paemër – si të gjitha foshnjat e tjera. Por, shumë shpejt, e më herët se qindra mijëra foshnja të tjera, i mori dy emra Metush dhe Atdhetar. Emrin Atdhetar nuk e bleu me para, as me peshë, sepse ishte shëndetlig, por me mençuri dhe me sakrificë, që i kushtuan me jetë. Shumë herët shpirtin e tij e kaploi një zjarr i pashuar – dashuria për kombin dhe nënën Shqipëri, e këtë zjarr nuk mundën t’ia shuanin as tradhtarët e kombit, as kriminelët më të përsosur të UDB-së jugosllave.



*Diskutimi i Ekremit më 14.10.2000, në Dardanë*

Rruga drejt idealit kombëtar dhe drejt bashkimit të popullit shqiptar, më në fund, është rrugë e drejtë. Mundësia që të jetë i barabartë me popujt e tjerë është rrugë drejt përparimit, mirëqenies dhe lumturisë.

Jam i vetëdijshëm se sa e vështirë është kjo rrugë, por jam i vetëdijshëm se asgjë madhore në të mirë të kombit nuk bëhet lehtë.

Atij zemra i pikonte gjak, se në Kosovë dhe në trojet e tjera etnike shqiptare mbretëronin dhuna, burgjet, rrahjet dhe persekutimet e papara. Pra, kishte marrë hov shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi. Iknin shqiptarët nga ndjekja e persekutimi, nga plaçkitja e varfërimi dhe i linin trojet e veta zbrazur. Kësaj dukurie i ndihmonin edhe organet e shtetit serb, si: naçellnikët e poreznikët, policët dhe njerëzit dritëshkurtër, që i terrorizonin shqiptarët sipas programit të Çubrilloviqit.

Me dhjetëra e qindra familje shqiptare, me pak rroba nën sqetull e me lot për faqe, po largoheshin nga trojet e veta, për ta shpëtuar kokën, e kryesisht nderin, dhe po kërkonin shpëtim në Turqi. Ata donin që të shkonin edhe në Shqipëri, por Shqipëria nuk i pranonte, sepse nuk dëshironte që Kosova të zbrazej nga shqiptarët.

Pasojat e kësaj dukurie, mësuesi im, Baca Metush, i dinte më mirë se shumë të tjerë dhe thoshte: “Një vendbanim emërtohet në bazë të gjuhës që flitet aty”. E tërë kjo e motivoi që më 1950, në Shipashnicë të Epërme ta themelonte organizatën ilegale me emër: “Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë”.

Puna themelore e kësaj partie ka qenë vazhdimësi e veprimtarisë së Partisë Nacional Demokratike Shqiptare, e udhëhequr nga atdhetari i shquar, profesori Gjon Serreqi. Edhe pse u torturua, u burgos dhe u dënua me 18 vjet burg të rëndë, ai u mbeti besnik programit të partisë dhe bashkëpunuesit të vet gjer në vdekje.

Pra, bashkëpunuesit dhe bashkëpunuesit e tij edhe sot e kësaj dite e kujtojnë me pietet dhe me dashuri si shok e mik besnik, si udhëheqës të urtë dhe si vizionar të organizatës politike shqiptare ilegale.



*Hysen Tërpeza - për hir të shtetit e të kombit duhet të bëjmë edhe compromise mes vete*

Më 15 tetor 1986 pushoi të mendojë dhe të veprojë një herë e përgjithmonë mësuesi dhe atdhetari që la emër në historikun e Lëvizjes atdhetare shqiptare, Metush Krasniqi.

Mbetem me shpresë se në kujtesën e çdo shqiptari atdhedashës ky emër do të zërë vend të merituar. Fushëveprimi dhe qëndresa e tij e bënë atë të pavdekshëm në lëmin e atdhedashurisë. E bënë atë të pakapërdishëm për UDB-në jugosllave.

Të rrallë janë ata njerëz, që, kur bisedonin dhe rrinin me të, të mos ndërronin në fizionomi dhe në ideologji, pra, t'i bindeshin qëndrimit të tij për çështjen kombëtare.

Qoftë i pavdekshëm Metush Krasniqi!



*Hysen Tërpeza evokon kujtime nga veprimtaria e tij atdhetare*



*Gjatë një diskutimi të Adem Muratit nga Vitia, më 14.10.2000 në Dardanë*

Pas tubimit me qytetarë, kryesia e SHKSHSH-së, bashkë me disa mysafirë dhe me atdhetarin Hysen Tërpeza vazhduan me një tryezë diskutimesh rreth rrugëtimit të çështjes sonë kombëtare.

Të pranishmit u bënë sy e veshë për të dëgjuar rrëfimet e herëpashershme të Hysen Tërpezës. Ndonëse në moshë të shtyrë, me fjalimin e tij, ai trimëronte të pranishmit për punën që duhet bërë për atdheun, pandërprerë, qoftë edhe duke bërë kompromise me njëri-tjetrin për mospajtimet eventuale ideologjike, gjithmonë duke i lënë vendin parësor shtetit dhe kombit shqiptar.



*Një kujtim familjar me Hysen Tërpezën nga takimi në Dardanë, më 14 tetor 2000. Nga e majta: Blerina, Nexhmija, Hysen Tërpeza, Petriti, Xhevdeti dhe Ekremi*

Në një rast, ai tha: “Politikan nuk jam, por një e di, bota nuk pajtohet. Kur t’mbarojë një luftë, kush e merr detin, ai e ka fituar luftën... unë isha në mal dhe e kisha vendosur: - me vdekë po, po pa luftue nuk dojsha... tri vjet e kam mbajtur Fadilin dhe ma në fund u prisha me të, por prapë më kanë kthyer shqiptarët. Tashti e kam dhënë fjalën. Sot kam pas të takohem me atë, por e lamë për të hënë. Dua ta takoj e t’ia jap dorën e pajtimit... Me thënë të drejtën, na e kemi shpresën sot tu Amerika...”, tha mes të tjerash atdhetari Hysen Tërpeza.



Më pas, Selman Vokshi recitoi vargje nga poema kushtuar mësuesit të tij dhe atdhetarit Metush Krasniqi, ndërkaq, me diskutimet dhe praninë e tyre, tryezën e begatuan edhe Saqip Ramizi, Adem Murati, Ekrem Kallaba, Jahja Lluka, Gjylije Ramizi, Fahri Buçinca, Hevzi Matoshi, Bejtullah Muja, Kadri Qehaja, Ramadan Gashi, Hasan Ramabaja e të tjerë.



*Nga e majta: Saqip Ramizi, Adem Murati, Hevzi Matoshi, Hysen Tërpeza, Selman Vokshi, Ajshe Vokshi dhe Gjylije Ramizi pas manifestimit në Dardanë*



*Hysen Tërpeza në mesin e anëtarëve të SHKSHSH-së dhe qytetarëve të tjerë në Dardanë, më 14 tetor 2000*

## Martirëve të fshatit dhe të kombit

*Diskutimi i Ekrem Kallabës para mërgimtarëve, më 5 shtator 2004*

**“O Zot, falu atyre lavdi në botën e amshueshme, e neve na e kthe dashurinë ndaj gjakut dhe kombit tonë!”**

Unë sot nuk kërkoj që ata trupërisht të jenë të pranishëm në mesin tonë, por kam të drejtë të pyes: ç’u bë kujtimi magjik i tyre që duhej të shkëlqente me tërë kuptimin e fjalës në pasqyrën e ndërgjegjes sonë kombëtare? Komunizmi i mbuloi në harresë, demokracia, me siguri, do t’i ngrrejë në pedestalin e historisë së kombit.



*Ekremi gjatë një diskutimi para bashkatdhetarëve, më 5 shtator 2004*

Pra, me qëllim mirënjohjeje të veprës së tyre, trimërisë dhe sakrificës që kishin bërë për komb gjer në zhdukjen totale fizike, fshati, sot, me të gjithë bijtë e vet të penës e të pushkës, përkujton heroizmin tuaj dhe qëndresën stoike ndaj armiqve të kombit tonë.

Ne, bijat dhe bijtë tuaj, do të jemi krenarë dhe faqebardhë kudo ku gjendemi dhe ju betohemi se pushtetin e ri demokratik shqiptar nuk do t’ua lëmë në duar atyre që virgjërinë shpirtërore dhe rininë ia falën komunizmit, ndërsa rrudhat dhe eshtrat e stërmbrushura do t’ia falin demokracisë.

Ata, për shkak të ideologjisë, na lanë pa atdhe, pa familje; na i burgosën motrat dhe vëllezërit tanë mu në lulen e rinisë; u distancuan nga kërkesat e studentëve, të intelektualëve dhe të mbarë kombit. Ata, me kundërshtarin e vet politik flisnin nëpërmjet grykës së pushkës ose të dritareve të qelive të burgjeve. Kërkonin të flisnim siç mendonin ata ose të heshtnim si peshku.



Mjerisht, edhe një numër simbolik i intelektualëve me përgatitje shkollore superiore u zhytën në ndyrësitat e ideologjisë komuniste edhe pas lëvizjes gjithëpopullore të vitit 1981, madje u vendosën në poste të larta të partisë dhe villnin helm nga goja e tyre ndaj kolegëve; sulmonin çdo gjë që ishte progresive dhe revolucionare. Pra, ia kthyen shpinën kombit dhe rinisë, e sot, kur gjenden para aktit të çmendurisë, të lindur për të udhëhequr vallen e tradhtisë thonë:

“O kombi im, të qofsha falë  
më fut në gjoksin tënd,  
se të kam nënë e më ke djalë.

Jo! je vonuar o i marrë  
se rininë e bijve të mi  
armiqve ua ke falë”.

Martirëve të fshatit tim dhe të mbarë kombit u betohemi se për arkitekt të pushtetit të ri demokratik shqiptar do t'i zgjedhim ata bij të kombit që nga fëmijëria e patën gojën plot demokraci e atdhetarizëm dhe që rininë e kaluan nëpër burgjet famëkëqija të Serbisë, ku edhe aty, me lot mallëngjimi e gjak të mushkërive, çimentuan kufijtë e rinj të shtetit kombëtar shqiptar me 9 milionë e 647 mijë banorë dhe me 57 km katrorë.



*Nga një aktivitet i SHKSHSH-së në shkallë komune, më 5 shtator 2004 (nga e majta): Ekrem Kallaba, Kadri Qehaja dhe Jahi Zubaku*

## **Diskutim i shkurtër i Ekremit në Preshevë, në emër të Partisë Republikane – Dega në Dardanë**

Motra e vëllezër,

në emër të Partisë Republikane të Kosovës dhe në emër të të gjitha motrave dhe vëllezërve të pjesës Perëndimore përshëndes këtë tubim madhështor që po mbahet në Kosovën Lindore, pikërisht në Preshevën e Abdullahut, Skënderit, Ali Aliut - Kelmendit, Haxhiut e plot e plot atdhetarëve të tjerë. Gjaku juaj është gjaku ynë; gjuha juaj është gjuha jonë. Pra, do të mashtrohen gjakpirësit se malet e Karadakut do t'i ndajnë në dysh fëmijët e një nëne.

Jam mirënjohës për ndihmën që po na e ofroni në këto çaste shumë të rënda, për vargjet që po i shkruani, për lotët që po i derdhni.

Por, në dashtë Zoti: me lotët tuaj dhe me lotët tanë, me gjakun tuaj dhe me gjakun tonë, do t'i zgjerojmë kufijtë e Kosovës nanë!

Partia Republikane e çmon lart praninë tuaj fizike dhe psikike për zgjidhjen e çështjes gjithëkombëtare shqiptare.

*Preshevë, vitet '90.*

## Porosia e nënës shqiptare

Zemra e shqiptarit nuk është gatuar me brumë balte, por është gatuar me brumë baroti. Pra, me forcën e zemrës, me djersën e ballit dhe çarkun e pushkës çrrënjoset e keqja, mundet armiku, e jo me lot.

Gjithmonë nënat shqiptare i bekonin djemtë e vet, duke u thënë: haram gjirin do t'jua bëjmë, o djem, nëse në luftë nuk do të shkoni! Haram e paçi bukën e çerepit, haram i paçi teshat e arnuara, nëse nuk suleni me trimërinë shqiptare – gjallë a vdekur, truallin për ta mbrojtur e për ta çliruar. Pra, tërë forcën e gishtit dhe të mendjes duhet ta vini në shërbim të gjenit dhe të gjakut shqiptar. Ndërsa ne, nënat, që nuk mund të marrim pjesë në beteja, mungesën tonë do ta mbulojmë me pjellën tonë mashkullore.

Unë mendoj se poenta e aleancës është: mjerë ajo nënë që ka bërë fëmijë që vjellin helm ndaj vëllezërve, ndaj kombit dhe ndaj nënës Shqipëri!



*Ekrem Kallaba gjatë një diskutimi rreth arsimit në Roganë, më 7 mars 1997*





V

## Të tjerët për Ekrem

“ Ekrem Kallaba ishte person  
afrues dhe unifikues. ”

---

*Jahja Lluka*



## Ishte person afrues dhe unifikues



*Jahja Lluka, kryetar i SHKSHSH-së*

Profesor Ekrem Kallabën e kam takuar për herë të parë në mars të vitit 1990, në Dardanë, me rastin e themelimit të Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova. Që nga ajo ditë kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm, në baza ditore, rreth aktiviteteve të shoqatës. Ai ishte njëri ndër bashkëpunëtorët e mi më të afërt, për një kohë të gjatë, sidomos pas zgjedhjes në kuvendin e parë zgjedhor të vitit 1990, ku unë u zgjedha kryetar i shoqatës, ndërsa Ekremi anëtar i kryesisë.

Profesor Ekremi ka luajtur rol të rëndësishëm në zgjerimin e Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve, e posaçërisht në punën disamujore për unifikimin e dy shoqatave, meqenëse në Kosovë u themelua edhe një shoqatë tjetër. Ai me largpamësinë e tij dhe me angazhimin e vazhdueshëm ka dhënë kontribut të çmueshëm për bashkimin e këtyre dy shoqatave.

Pas themelimit të SHKSHSH-së në Kosovë synim yni ishte zgjerimi i shoqatës edhe në Republikën e Shqipërisë. Kështu, realizuam dy vizita në Shqipëri. Në vitin 1991 u ftuam nga Partia Republikane e Shqipërisë, nga kryetari i saj z. Sabri Godo, ndërsa një vit më vonë (1992) patëm një detyrë të veçantë për themelimin e SHKSHSH-së në Shqipëri. Pas themelimit të asaj shoqate për kryetar u zgjodh ish-deputeti i Partisë Demokratike në Shqipëri, z. Ismet Ferizi. Nga kjo vizitë realizuam edhe një takim me ish-presidentin e Shqipërisë, z. Ramiz Alia, me ç'rast u bisedua edhe për luftën e mundshme për çlirimin e Kosovës. Në këtë takim z. Ramiz Alia u zotua se Shqipëria do ta kryejë detyrën e vet për ta ndihmuar Kosovën me armatim dhe me njerëz.

Vlen të ceket vigjilenca e Ekremit, i cili vazhdimisht ma tërhiqte vërejtjen që të

jemi më të kujdesshëm, ngase kemi hyrë në luftë kundër projekteve serbe për shfarosjen e popullit shqiptar.

Mund të them se Ekremi, por edhe e gjithë familja e tij, kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Mikpritja dhe bujaria e familjes Kallaba janë për çdo lëvdatë dhe respekt. Ndaj, ndihem krenar që Ekremin e kisha, përveç bashkëpunëtor të ngushtë, edhe mik shumë të afërt.

Qemajl Kallaba, prof.

### **Idhulli im - prof. Ekrem Kallaba**

Baba im, Shefki Bajram Kallaba (1922-1985), i cili kishte kaluar nëpër të gjitha krahurat e ish-Jugosllavisë, kishte përjetuar masakrat e Tivarit, kishte luftuar bashkë me kushërinjtë e tij, Sulejman e Musah Kallabën dhe shumë të tjerë kundër hordhivë fashiste serbosllave, të ardhura nga Karpatet, në Kikë e në malin Ush të Breznicës, ku plumbat e armikut ia përshkuan tejprtej trupin e tij të njomë dhe, pas shumë peripecish, u shërua, por me gjurmët e këtyre plagëve u përcoll në banesën e tij të fundit, më fliste me admirim për familjen fisnike e patriotike të hafëz Shefki Kallabës, gjyshit të Ekremit.



*Prof. Qemajl Kallaba*

Por, jo vetëm kaq, edhe në aksionin famëkeq për grumbullimin e armëve, në vitin 1956, u detyrua ta blinte dhe ta dorëzonte armën që nuk e kishte.

Në mënyrë telegrafike i shënova këto pak të dhëna për të treguar se njeriu që e do atdheun, e di se atdheu mbrohet jo vetëm me armë, po edhe me dije, me arsimim të popullit. Babai im, në moshën time të djalërisë, më fliste me admirim të veçantë për bashkëmnakun e tij, hafëz Shefki Kallabën, i cili ishte shkolluar për fe dhe kishte arritur autoritet të madh, jo vetëm në Kosovë, po

edhe jashtë saj; djemtë e nipat e tij kishin ndjekur shkolla të ndryshme të larta dhe shërbenin si shembull për rrethin ku jetonin e punonin. Djalit të tij, Ilmiut, për shkak të veprimtarisë patriotike, as sot e kësaj dite nuk i dihet varri, Tefiku, bashkëmoshatari i babait tim (1922-1984), veteran i arsimit, ishte ndër mësuesit më të dallaur të kësaj ane, Muharremi, djali i Ilmiut, nipi i Hafëz Kallabës, që kishte mbaruar Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në Beograd, nderohej nga të gjithë për pedanterinë në punë, motra e tij, Ismetja, ishte femra e parë që kishte kryer shkollën normale...

Në vitin 1944, kur hienat e zbritura nga Karpatet ia humbën çdo gjurmë Ilmiut, vëllait të Tefikut, nënë Naxhies e mësues Tefikut u lindi djali i parë i tyre, të cilin e pagëzuan Ekrem. Ky u rrit dhe u edukua në frymën patriotike. Pasi kreu shkollën fillore në vendlindje, shkollën normale e mbaroi në Gjilan dhe Fakultetin Filozofik, Dega e Pedagogjisë, në Prishtinë, iu përkushtua me tërë qenien e tij edukimit të brezave të rinj në Desivojcë, Rahovec, Dardanë etj.



*Ulur nga e majta - Avdyl Krasniqi, Vebi Kallaba, në këmë. Qemajl Kallaba, Lati Ismajli, Ekrem Kallaba*



*Ekremi, dikur profesor i Qemajlit, tani kolegë në gjimnazin „9 Maji“ në Dardanë*

Në vitin shkollor 1964/65 në Dardanë, ish-Kamenicë, u hap gjimnazi, si degë e ndarë e gjimnazit “Zenel Hajdini” të Gjilanit. Mësimdhënësit e parë shqiptarë numëroheshin me gishtat e një dore. Dy vjet më vonë, në vitin shkollor 1966/67, gjimnazi i Dardanës u mëvetësua dhe, nga viti në vit, numri i nxënësve dhe i mësimdhënësve shqiptarë rritej gjithnjë e më tepër. Edhe pse ka kaluar një gjysmë shekulli nga viti shkollor 1967/68, kur do të diplomonte brezi i parë i maturantëve të këtij gjimnazi, të cilit i përkisja edhe unë, më kujtohet fare mirë dita kur para nesh u prezantua profesori i ri i filozofisë, me flokë kaçurrel e me vetulla të trasha, me veshje elegante, me kravatë ngjyrë flamuri kombëtar, të lidhur hollë, që e bënin aq karizmatik. Me artin e tij pedagogjik, na dukej enciklopedik në mendime, i matur, i edukuar, i përkushtuar për mësimdhënie dhe për edukim. Kishte tipare burrërore. Ligjëronte lëndën e filozofisë, po e donte shumë edhe letërsinë. I kushtonte shumë rëndësi gjuhës. Citonte shpesh thëniet e Naimit: “Vetëm dritë e diturisë përpara do na shpjerë” dhe “Punë, punë, natë e ditë, që të shohim pakëz dritë”. Dashurinë ndaj gjuhës, ndaj kombit, ndaj atdheut dinte ta përcillte te nxënësit vetëm një pedagog i mirëfilltë, siç ishte profesor Ekremi.

Pata fatin dhe kënaqësinë të punoja dhe të bashkëpunoja disa vjet si koleg pune me prof. Ekremin në gjimnazin e Dardanës. Do ta veçoja me këtë rast vitin 1981, kur përgatishim grupin e nxënësve për pjesëmarrje në kuizin e diturisë nga gjuha dhe letërsia shqipe, nga filozofia dhe nga kultura muzikore. Për çdo javë, prisnim me padurim, ta shikonim TV Prishtinën, që kishte regjistruar këtë kuiz disa javë rresht. Nxënësit tanë zunë vendin e parë në Kosovë. Krenoheshim bashkërisht për rezultatet e arritura. Mësues i mirë dhe i ndërgjegjshëm, më thoshte shpesh prof. Ekremi, është ai që u jep nxënësve jo vetëm njohuri të diturisë, por u jep edhe edukatë morale, familjare e kombëtare. Mësues i mirë është ai që nxjerr nxënës më të mirë se vetvetja, ai që është shembull i përkushtimit në orën mësimore, i organizimit të orës së mësimi, i përgatitjes për orën e mësimi, i përvetësimit të plotë të njësisë mësimore nga nxënësit, i aftësisë për të shpjeguar mësimin, i kënaqësisë që ndiejnë nxënësit për të dëgjuar mësimin prej tij për shkak të sjelljes dhe qëndrimit të tij ndaj nxënësve. Duke dëgjuar me vëmendje fjalët e prof. Ekremit, më kujtoheshin edhe fjalët e profesorit tim të nderuar, poetit, përkthyesit e pajtimtarit të gjaqeve, Anton Çetta, me rastin e një interviste që kisha patur me profesor Çettën për revistën shkollore “Dituria” të gjimnazit “Ismail Qemali” të Dardanës, i cili, ndër të tjera, pati thënë: “Do të na mbesë një dorë mbi varr nëse brezat që vijnë pas nesh, nuk shkojnë një hap para nesh”.

Para se të vinte me punë në Prishtinë, me admirim më fliste për takimet që kishte pasur në Shqipëri me figurën e ndritshme, me shkrimtarin e mirënjohur shqiptar, me prejardhje nga Kosova, që jetonte e krijonte në Shqipëri, me të madhin Sulejman Krasniqin, i cili kishte botuar më se 21 vepra. Nga andej më kishte sjellë për lexim veprat më të njohura të tij: “Mic Sokoli”, “Oso Kuka”, “Pushka top, Bajram Curri” etj. Pothuaj e tërë krijimtaria e tij artistike, si romanet historike, novelat, dramat dhe tregimet e shumta lidhen kryekëput me Kosovën dhe me qëndresën e popullit shqiptar. Personazhet dhe heronjtë e tij gjithnjë kanë qenë burim frymëzimi. Ato nuk kanë qenë as legjenda e as personazhe të trilluara. Ato kanë qenë protagonistë realë, të cilët shkrimtari me penën e tij i ka bërë të flasin e të fluturojnë në qiell, pa u thyer asnjëherë para armiqve të popullit shqiptar. E tërë veprimtaria e Sulejman Krasniqit ka qenë në shërbim të lirisë, të emancipimit dhe të frymëzimit atdhetar të shumë brezave, prandaj edhe është vlerësuar lart nga profesori im i nderuar, Ekrem Kallaba.

Dhe, krejt në fund, nuk mund të mos e përmend edhe një gëzim të madh të jetës së tij. Pas 12 vjet martesë, lindi djali i vetëm i tij, të cilin e pagëzoi me një emër karakteristik ENLIRAT (**En**veri e **li**roi **at**dheun). Nuk do koment.

Sado që përpiqem të gjej virtytet më të mira që meriton të thuhet për Ekremin si profesor, si prind, si bashkëshort, si vëlla, si mik e si njeri, çdo virtyt më duket i zbehtë para personalitetit të tij.

Profesor Ekremi që dhe mbeti idhulli im. I përjetshëm qoftë kujtimi për të!

Zymer Beshtica, prof.

## **Profili i pedagogut të paharruar**

Ndër mësimdhënësit e parë dhe të paharruar nga kujtesa ime është profesor Ekrem Kallaba, i cili ishte mësimdhënës imi edhe në shkollën fillore të vendlindjes në Desivojcë, e më vonë edhe në shkollën e mesme, në gjimnazin e Dardanës.

Duke shfletuar kalendarin e kujtimeve të kohës, kur isha nxënës i klasës së pestë të shkollës fillore, shoh veten, shokët, disa shoqe të klasës dhe mësimdhënësit; ndër ta shoh edhe arsimtarin e gjuhës shqipe, arsimtar Ekremin. Dukej se ishte në fillim të karrierës në arsim. I ri, me flokë të zinj e të dredhur, ashtu ia kishte falur natyra, gjithherë dukej fytyrëçelur, shtatdrejtë, i veshur mirë, ashtu siç visheshin edukatorët më të mirë.



*Prof. Zymer Beshtica*

Ishte fillimi i viteve '60 të shekullit të njëzetë, kishim kryer klasën e katërt, e kishim dalë në të pestën. Në klasën e pestë nuk e kishim vetëm një mësimdhënës, por kishim thujse për secilën lëndë mësimore nga një arsimtar të veçantë. Në klasë kishte nxënës të familjeve të ndryshme, madje edhe të fshatrave të tjera, që kufizoheshin me Desivojcën. Nxënësit kishin karakteristika të ndryshme, po arsimtari i gjuhës shqipe për secilin nxënës kishte një mënyrë të veçantë të sjelljes dhe të të folurit. Me disa nxënës të ndruajtur sillej me takt pedagogjik. Atyre, me urtësi e butësi u jepte këshilla për nxënie.

Fillimi i klasës së pestë më është skalitur në kujtesë, atëherë nuk e dinim mënyrën e mirëfilltë se si duhej të mësonim nga libri. Ai, pasi na e shpjegonte përmbajtjen e njësisë mësimore, kërkonte prej secilit nga ne që ta lexonim nga një pjesë të njësisë mësimore dhe, pasi e lexonim, kërkonte nga ne që t'ia shpjegonim kuptimin e pjesës së lexuar. Na porosiste, na bënte me dije se përmbajtjet mësimore duhet t'i mësojmë pjesë-pjesë dhe, kur t'i mësojmë të



gjitha pjesët e saj, atëherë e përsërisim të tërën. E kur e përsërisim bukur tërë temën, konsiderohej se e kemi mësuar. Secilën njësi mësimore që e mësonim, kërkonte që në fletoret tona të gjuhës ta shënonim përmbajtjen e saj në pika të shkurtra: pjesën hyrëse, pjesën kryesore dhe përfundimin. Ashtu sikur na i kontrollonte përgjigjet me gojë, na i kontrollonte edhe fletoret, po sidomos detyrat e shtëpisë.

Nga ai kemi mësuar se si ta përdorim dhe kur duhet ta përdorim theksin logjik. Theksin logjik e përdorte kur ne nxënësit ishim në gjendje ta përvetësonim mësimin. Shpeshherë, kur e kërkonte nevoja, theksin logjik e zëvendësonte me theksin emocional-poetik. Theksin poetik e përdorte për të ngjallur te nxënësit emocione të caktuara, ndjenjat për kombin, për lirinë dhe për atdheun. Dhe, natyrisht, me shprehjet artistike dhe me thekset emocionale që përdorte gjatë shpjegimit, me më lehtësi e përvetësonim mësimin. Përherë na jepte sqarime plotësuese për gjërat që i kishim të paqarta. Prej tij kemi mësuar ligjërimin me anë të përshkrimit. Na tregonte se gjatë përshkrimit theksi duhet të bazohet në vërtetësi, në mënyrë që të përshkruhen ngjarjet dhe dëshmitë sa më besnikërisht. Shpjegimi i tij ishte shembull për ne, sepse gjatë shpjegimit përdorte shembuj të përshtatshëm, përmes të cilëve e shtjellonte lëndën mësimore.

Te disa nxënës të turpshëm, që ngurrnin për të folur publikisht, ulej në një bankë me ta dhe i nxiste me kujdes që të ushtronin dhe të dilnin para të tjerëve, duke u ndihmuar që t'i eliminonin ndjenjat e pakëndshme dhe vështirësitë e tjera.

Gjatë shtjellimit të lëndës mësimore përdorte metodat, të cilat i përgjigjeshin natyrës së leksionit. Veç metodës parafolëse, me shumë sukses ka përdorur edhe metodën e bisedimit (bisedimit katetik dhe heuritik), metodën e punës me tekste, të demonstrimit, të bindjes, të nxitjes dhe të pengimit.

Detyrat me shkrim, pasi na i kontrollonte dhe na i vlerësonte, bënte korigjimin e përgjithshëm në mbështetje të përmbajtjes mësimore, gabimeve gramatikore dhe stilistike. Gjithashtu na jepte sqarime plotësuese për të na aftësuar në të shprehurit me shkrim.

Metodat mësimore i realizonte me shumë sukses.

Metodën e bindjes e realizonte me këshilla të drejtpërdrejta, me shpjegime të mirëfillta të fakteve, të dukurive, të ngjarjeve, dhe me shembuj nga jeta e përditshme.

Metodën e nxitjes e realizonte përmes vlerësimit të drejtë e parimor me notë, sipas kriterëve pedagogjike, sipas meritës. I lëvdonte nxënësit, jepte shembuj përkatës nga përditshmëria.

Me shumë shkathtësi përdorte edhe metodën e pengimit, përmes së cilës eliminonte dukuritë dhe gabimet te nxënësit, por gjithherë duke ruajtur dinjitetin e nxënësit.

Puna edukative-arsimore e profesor Ekrem Kallabës, pati ndikim të madh në formimin, në edukimin dhe në arsimimin e brezit tim, por edhe të brezave të mëvonshëm.

Unë dhe shumë nxënës të tjerë të brezit tim e çmonim si pjesëtar të plejadës së pedagogëve të Rilindjes së Shqiptarëve të Kosovës. Me idetë e tij përparimtare dhe me veprimtarinë e tij arsimore-edukative në dobi të kombit e të shkollës shqipe, ai fitoi dashurinë dhe respektin e të gjithë nxënësve të brezit tim.

Përmes njësive mësimore të veprave të shkrimtarëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, profesor Ekremi shfaqte pikëpamjet për ruajtjen e identitetit kombëtar, për njësimin e gjuhës shqipe, për pavarësinë e shkollës shqipe, sepse në radhë të parë kishte parasysh - se shkolla shqipe i bashkon të gjithë shqiptarët e të gjitha besimeve.

Ai, përmes mësimëve të rilindësve, te nxënësit mbillte farën e diturisë, farën e dashurisë për gjuhën shqipe, për kombin dhe atdheun, për lirinë dhe pavarësinë tonë kombëtare.

Puna edukative-arsimore e profesor Ekrem Kallabës, për shumë breza të nxënësve të tij, ishte dhe mbeti model i pedagogut dhe i njeriut shumë të dashur e shembullor.

Ahmet Maliqi, ecc. i dipl.

## Profesori që deshi më shumë nxënësit sesa vetveten



*Ahmet Maliqi, ekonomist*

Për prof. Ekrem Kallabën, kisha dëgjuar qysh si nxënës i shkollës fillore, sepse atëherë ai punonte profesor në gjimnazin e atëhershëm “9 Maji” në Dardanë.

Asokohe sapo kishte filluar shkollimi i shqiptarëve në komunën e Dardanës dhe ishte i vogël numri i shqiptarëve me fakultet të mbaruar, prandaj edhe njiheshin shumica prej tyre.

Por, në vitin 1983, kur fillova të punoja në XIM “Strezoc” – Magnohrom, pata fatin që të njihesha shumë më tepër me të, sepse ai atëherë punonte në Magnohrom si pedagog, meqë ishte përjashtuar nga

procesi edukativo-arsimor si i papërshtatshëm politikisht, kinse nuk paska pasur qëndrim kritik për demonstratat e vitit 1981.

Edhe pse na ndante një moshë relativisht e madhe, diku prej 15 vjetësh, ishin shumë çështje të cilat na afronin dhe krijonin një komunikim të përhershëm, gati për çdo ditë pune. Unë, si i ri në moshë dhe fillestar në punë, kisha nevojën e komunikimit, por edhe të këshillimit me dikë që ka një moshë më të madhe, përvojë në punë, por edhe një ngritje profesionale, cilësi të cilat i kishte prof. Ekrem Kallaba.

Te prof. Ekrem Kallaba gjeta njeriun i cili, përpos që kishte përvojën e mësuesit, arsimtarit, profesorit, pedagogut, përvojës në një kolektiv me rreth 420 punëtorë, mbi të gjitha e karakterizonte atdhedashuria, respekti për njerëzit e kombit të vet dhe si një njeri që pjesën më të madhe të jetës së vet e kishte kaluar në procesin edukativo-arsimor, kishte një respekt të posaçëm për njerëzit e shkolluar, pa marrë parasysh moshën e tyre.

Njëherë më pati thënë se një mësues nuk mund të kryejë me sukses detyrën e mësuesit, nëse, kur del para nxënësve të klasës së parë, nuk e sheh veten duke dalë para mjekëve, ekonomistëve, inxhinierëve, juristëve, akademikëve të ardhshëm. Kjo thënie e tij, e cila del prej një mendjeje të hollë, kurrë s'më hiqet prej kokës.

Më është ngulitur në mendje edhe ajo se si profesori Ekrem e bënte dallimin ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Thoshte se ne kemi urrejtje individuale ndaj tyre, sepse themi se filan serbi është i keq, ndërsa ata kanë urrejtje kolektive ndaj nesh, sepse thonë: të gjithë shqiptarët janë të këqij.

E dinte se ishte politikisht i etiketuar, prandaj nuk shkonte në zyrat e të tjerëve, meqë e dinte se edhe ata që shkonin tek ai për të biseduar, në njëfarë mënyre ishin nën vëzhgimin e shërbimit sekret.

Në vitin 1990 në Dardanë themelohet Dega e Partisë Republikane të Kosovës, kryetar i së cilës zgjidhet Ekrem Kallaba. Vlen të theksohet se tërë aktivitetin politik dhe partiak të kryesisë së Partisë Republikane të Dardanës materialisht e ka mbuluar-financuar personalisht prof. Ekrem Kallaba.

Ishin të shumta udhëtimet që pati thujse nëpër të gjitha fshatrat e Dardanës, në selinë e Partisë në Prishtinë, në Kuvendin e themelimit të organeve të Partisë në Pejë, në një mot të vështirë me ngrica dhe acar.

Në cilësinë e kryetarit të Partisë Republikane, Dega në Dardanë, aga Kemë udhëtoi zyrtarisht në vitin 1991 në Shqipëri, ku pati takime me z. Sabri Godo, kryetar i Partisë Republikane të Shqipërisë dhe z. Ramiz Alia, kryetar i Shqipërisë, takime për të cilat kryesinë e Partisë Republikane, Dega në Dardanë e informoi në detaje.

Aktivitet të ngjeshur ka zhvilluar edhe në Shoqatën për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta, e cila selinë e kishte në Pejë, me kryetar z. Jahja Lluka, në takim me të cilin isha edhe unë.

Kishte një bashkëpunim të ngushtë me Akademik Pajazit Nushin. Madje pas një mbledhjeje të mbajtur në fshatin Koretin patëm një takim dhe bisedë shumë të gjatë në restorantin e tij, takim prej të cilit përfituam mjaft shumë nga një mendjendritur siç ishte atë kohë Prof. dr. Pajazi Nushi.

Për çudi, sepse nuk thuhet kot se jeta është me plot rastësi, edhe ne, jo rastësisht, u përjashtuam të njëjtën ditë nga puna më 13.09.1991, së bashku me dy juristët: Ruzhdi Selimin dhe Zijadin Spahiun - ish-i dënuar politik.

Prapë në vitin 1999, pas luftës, filluam të punonim bashkë në XIM “Strezoc”, diku deri në vitin 2003, kur unë fillova të punoja në ZKM (Zyra e Kryeministrit) në Prishtinë.

Nuk thuhet rastësisht se rasti është mbreti i botës, prandaj në vitin 2005 edhe Prof. Ekrem Kallaba filloi të punojë në ZKM, Prishtinë, në cilësinë e përkthyesit, prandaj prapë ishin kontaktet dhe bisedat tona shumë intensive, sepse pas bisedave dhe takimeve në punë, ne udhëtonim bashkë në relacionin Dardanë - Prishtinë dhe anasjelltas.

Në tetor të vitit 2007, unë fillova të punoja në Dardanë si Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Inspeksion.

E vëreja se i mungoja unë atij mu sikur ai mua, sepse për çdo ditë me thirrjet e tij telefonike ai shprehte edhe gëzimin e tij për emërimin tim në atë post, por edhe përkrahjen dhe besimin e tij për profesionalizmin tim.

Kjo më bënte përshtypje jo për atë se ai kishte mendim dhe bindje të mirë për mua, porse atë e gëzonte suksesi i secilit.

Kontaktet tona vazhduan deri në dhjetor të vitit 2008, kur edhe pushoi së rrahuri zemra dhe shpirti i tij, por mbetën kujtimet më të mira për të si një mësues, arsimtar, profesor, pedagog, por mbi të gjitha si një shok i mirë.

## **Ekremi mbeti pedagog i përjetshëm edhe pasi ia morën ditarin e shkollës**

Me të ndjerin, z. Ekrem Kallaba, ose “Pedagogu”, siç njihej nga të gjithë ne, atë kohë, më ka lidhur raporti familjar, sepse ai ishte dhëndër i familjes sonë - familjes Thaçi.

Çështje e vërteta, në kohën kur ne ishim miqësuar unë vazhdoja shkollimin akademik dhe nuk kisha rast ta takoja aq shpesh e ta njihja nga afër. Më vonë, bazuar në këtë raport familjar, në vitet '80, kur punoja si kryeshef i policisë së rajonit të Prishtinës, filluan takimet tona më të shpeshta dhe njohja nga afër me Ekremin, si pedagog, si njeri, si atdhedashës, si intelektual dhe si pishtar i arsimit në trevën tonë - trevën e Dardanës.



*Destan Thaçi, kolonel në Policinë e Kosovës*

Në fakt, në atë periudhë, Ekrem Kallaba tashmë ishte larguar nga sistemi arsimor i Kosovës, sepse si intelektual, si njeri me virtyte të larta zombëtare, si një njeri që arsimimin e brezave të rinj e shihte si mjet edhe për realizimin e aspiratave kombëtare, ishte halë në sy për sistemin shtetëror të asaj kohe.

Kjo dhe kishte ndikuar që Ekremi të diferencuhej e të stigmatizohet nga udhëheqja e kohës e Komunës së Dardanës, duke e larguar me përbuzje nga procesi arsimor.

Bazuar në qëndrimin korrekt e dinjitoz të Ekremit, duke mos llogaritur pasojat që do të mund t'i kisha unë personalisht, vendosa t'i afrohesha dhe ta mbaja edhe më afër vetes, edhe pse, që të dy, e dinim se ishim nën vëzhgim 24-orësh.

Takimet e mia me të ishin të shpeshta. Mbështetja ime për Ekremin, nga unë dhe dashamirës të tjerë korrektë të Ekremit, ishte më se e nevojshme. Kështu, ky



shoqërim imi me të, tanimë jo vetëm si mik i familjes, por edhe si një shok dhe mik imi personal, ia lehtësonte vuajtjet e tij të shkaktuara nga politika ditore antishqiptare dhe konservatore. Megjithatë, në sytë e Ekremit lehtë mund të vërehej vuajtja të cilën ai po e kalonte dhe po e përjetonte si pasojë e largimit të tij nga sistemi arsimor, nga arsimi, nga pedagogjia, nga profesioni që ai e donte me gjithë zemër, profesion që i ishte përkushtuar gjatë gjithë jetës, edhe pse i larguar me dhunë nga ai.

Ishte kënaqësi për mua, e për Ekremin kënaqësi edhe më e madhe, kur njerëzit e përshëndesnin duke i thënë pedagog, ndërsa ish-nxënësit e tij e quanin edhe më tutje profesor. Në çdo takim me mua dhe me shokë të tjerë Ekremi temën e arsimit dhe të arsimimit e kishte primare në bashkëbisedime.

Ekremin e njihja si një person që kishte pasion leximin. Paleta e librave të tij të lexuar e të studiuar ishte mjaft e gjerë, që nga librat me vjersha për fëmijë e deri te Kurani e Bibla. Ishte kënaqësi për mua ta dëgjoja duke biseduar e duke debatuar, duke interpretuar shumë çështje që lidheshin edhe me arsim, edhe me shkollim, edhe me edukim, me politikë, me fe e me shumë fusha të tjera të jetës. Me një fjalë, fjala dhe mendimi i tij dëgjoreshin me vëmendje dhe interesim nga të gjithë. Ishte një njeri i gjithanshëm dhe ai mund të bisedonte edhe me një fëmijë, edhe me një plak, me një bujk, me një mjek, inxhinier, por edhe me një student arti, filozofie, me një hoxhë-imam etj.

Profesionin që e dëshoi me gjithë zemër, sistemi ia ndërpreu; e ndau në këtë rrugëtim, por ai kishte edhe një pasion tjetër, pasion të cilin asnjë sistem nuk mundi t'ia shuante ose t'ia ndalonte, - pasionin e gjuetisë.

Në këtë kontekst, më duhet ta rrëfej një rast lidhur me Ekremin, të cilin ma kishte rrëfyer miku i tij, Reshat Thaçi, pra, djali i mixhës tim, e që flet për pasionin e tij të flaktë për gjuetinë:

Ekremi po shkonte në Rahovec dhe, rrugës, kishte pasur një defekt të vogël në makinë, me ç'rast rrota komplet i kishte përfunduar në lumin Drin. Ekremi, duke e kërkuar rrotën mbërrin te lumi dhe, duke menduar se në lumë kishte shota, ai e drejton pushkën në shënjestër. Reshati i thotë: - o Ekrem, nuk është shotë, por është rrota e makinës sate. Ekremi i përgjigjet: "O, e harrova rrotën, o Reshat miku, desha të gjuaja shota".

Miqësia ime me Ekremin zgjati deri në vdekjen e tij, dhe bisedat e tij me plot pasion në shoqërinë tonë të përbashkët mungonin, na mungonin edhe në familjet tona e në fshatin tonë. Në shoqërinë time ende vazhdojmë t'i evokojmë kujtimet dhe këshillat porosidhënese të Ekremit që i kushtoheshin kryesisht arsimit dhe edukimit atdhetar të popullit shqiptar.

Me respekt të lartë e kujtojmë emrin dhe veprën e tij.

I lehtë i qoftë dheu i Kosovës! Lavdi!

Azem Zogaj, mr. prof., Prishtinë

(nga një bisedë telefonike me Azemin)

### **Ekrem zotnia**

Kur u punësova, e gjeta në mungesë Ekrem Zotërinë. Për Ekremin dëgjoja shumë të flitej nga kolegët e punës. E kishim koleg të përbashkët Selman Sylejmanin, i cili e ka ndihmuar shumë Ekrem Zotërinë, - kështu do ta quaja unë, sepse z. Ekrem i thonë të gjithë, por ai ishte më shumë, pra, ishte Ekrem Zotnia. Për Ekremin fliste edhe zonja Mentore, që ishte një punëtore e hershme në atë zyrë, dhe të gjithë flisnin në superlativ. Kjo më bënte shumë kureshtar që ta takoja atë njeri sa më parë.

Dhe, fati e deshi që ai, pas një gjendjeje jo të mirë shëndetësore, të përmirësohej, dhe të vinte sërish në zyrë. Jo që i plotësoi ato parashikimet e mia, por i teproi, dy-trefish, i teproi me korrektësinë e tij që e ka pasur, me karakterin e tij, me përvojën dhe njohuritë e tij të mëdha jetësore.

Edhe pse ishte pedagog me profesion, ai dinte shumë nga letërsia - sepse kishte lexuar shumë, dinte nga politika - sepse ishte veprimtar politik; ishte veprimtar i kulluar politik dhe, për çudinë time, dhe të Ekremit, kishim shumë miq e të njohur të përbashkët si në Kosovë, ashtu edhe në mërgatë. Kjo na bënte të ndiheshim edhe më mirë.



*Azem Zogaj gjatë një vizite tek Ekremi, në Roganë, tre muaj para vdekjes së Ekremit*

Në zyrë unë isha lektor dhe gramatika e gjuhës shqipe as nuk ishte e domosdoshme në atë zyrë ku unë isha i autorizuar për lektorim. Gjithashtu edhe Ekremi ishte përkthyes nga gjuha serbokroate. Edhe gjuha serbokroate sikur edhe gramatika ime e gjuhës shqipe shkonte duke u lodhur, kështu që zyra për ne dy nuk kishte nevojë të domosdoshme; edhe për t'i lënë kolegët në qetësi për të punuar, edhe ne për të biseduar natë e ditë; ne qëndronim kryesisht në bife ose në mjedise të lira. Kur ishte e domosdoshme, normalisht, ne i përgjigjeshim punës. Mund të them se Ekremi ishte një promotor i vërtetë në zyrën tonë.

Kam pasur fat dhe fatkeqësi: fat që ta takoja Ekrem Zotërinë, por fatkeqësi që më ra të punoja shkurt me Ekremin, d.m.th. gjithsej disa muaj. Sëmundja e tij u ripërsërit në mënyrë edhe më agresive dhe e rrëmbeu z. Ekremin nga zyra jonë, për ta shpërngulur atë në vendbanimin e përhershëm.

Unë me kolegët e mi kemi bërë vizitë për ngushëllime në familjen e tij në Roganë, e cila na ka bërë një pritje të jashtëzakonshme. Krejt familjen e mbaj në mend,

ndërsa ty, Xhevdet, të kemi pasur vazhdimisht si orientim, sepse lidheshe si temë e përbashkët, unë si ish-koleg yti nga Radiotelevizioni i Prishtinës (vitet '70 - '80) dhe mandej edhe koleg me Ekremin. Por, edhe me djalin e tij, Enliratin kemi pasur shumë kontakte miqësore dhe të ngrohta.

Unë e kujtoj me kënaqësi shumë të madhe një çast të miqësisë, një miqësie shumë interesante. Për Ekremin mund të flas aq shumë sa edhe libra të shkruaj që ta shpërfaq atë karakterin e tij të fortë, seriozitetin e tij, të flas për përkushtimin e tij për çështjen kombëtare, në përgjithësi, si dhe për Kosovën, në veçanti. Tek Ekremi unë e gjeta një bashkëmendimtar timin, që Kosovën e kishim mbi të gjitha; prioritet mbi prioritete, sepse çështja shqiptare Kosovën e ka strumbullar të vetin. Kur është Kosova stabile dhe e fortë, krejt çështja shqiptare ka rrugë më të mbarë. Kur është Kosova në krizë e kur ka qenë në krizë, krejt çështja shqiptare ka lënguar.

Kjo nuk nënkupton se me Ekremin nuk kemi pasur edhe biseda të buta jetësore. Ishte dashamir i së bukurës dhe i të bukurave, ishte dashamir i zjarrtë i bukurisë estetike - i estetikës së bukurisë. Ka qenë i këndshëm, ka qenë i papërsëritshëm.

Tash, duke folur për Ekrem Zotërinë, më vjen të qaj, kështu që, të lutem, më kurse nga qarja. Unë do ta mbaj përjetë kujtimin e tij dhe mezi pres që monografinë kushtuar Ekremit dhe familjes Kallaba ta kem në dorë dhe kështu Ekrem Zotërinë ta kem afër, në tavolinën time të punës, për aq kohë sa edhe unë jam këtu në këtë "tramvajin" e quajtur jetë, për arsye se nuk janë edhe shumë vjet kur edhe ne duhet të shkojmë tek Ekremi.

Qoftë i përjetshëm kujtimi i Ekrem Kallabës!

## **Ekrem Kallaba i kuptonte më së drejti ish-të burgosurit politikë**



*Shefik Sadiku, i burgosur politik*

Profesorin Ekrem e kujtoj si një pedagog që dijen dhe përvojën që ua jepte nxënësve, por edhe në bashkëbisedim me shokë, e begatonte me ngjyrim filozofik dhe patriotik. Kisha dëgjuar për një fjalim të tij para kolektivit, të mbajtur më 1982, që kishte qenë me përmbajtje të lartë filozofike e patriotike, saqë i kishte kushtuar me diferencim politik dhe me përjashtim nga puna e pedagogut në gjimnazin e Dardanës.

Ai e vlerësonte lart veprimtarinë e të burgosurve politikë shqiptarë në Jugosllavi, duke filluar që nga Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH) me në krye Gjon Serreçin, Rexhep Dajkocin, Haki Efendinë, Metush Krasniqin me shokë, Adem Demaçin me shokë etj. Gjatë ndonjë bisede kur kishim, teshun e bisedës gjithmonë e drejtonte te çështja kombëtare. Kur biseduam njëherë për demonstratat e vitit 1968 dhe 1981 e këndej, ai u bëri demonstratave një zbërthim tejet profesional filozofik, sociologjik e politik, saqë, vërtet, nga ky aspekt, e kam vlerësuar lart karakterin e tij shkencor, me një qasje tejet profesionale ndaj proceseve politike, në veçanti, dhe fenomeneve shoqërore e kombëtare, në përgjithësi.

Kontributi politik i Ekrem Kallabës gjatë viteve '90 për disa nuanca e zgjeroi mozaikun e koloritit politik, jo vetëm në Komunën e Dardanës, por edhe më gjerë. Sidomos, ishte bindja e tij politike se nuk mund të çlirohemi me fjalë nga regjimi i Milosheviqit, gjë që e kishin edhe në programin politik të Partisë Republikane të Kosovës, Dega në Dardanë, kryetar i së cilës ishte vetë profesor Ekremi. Pra, Ekremi, ishte pedagogu që udhëhiqej nga pragmatizmi politik dhe filozofik i proceseve të viteve '90.

Ndërkaq, paraqitja në skenë e UÇK-së, si forcë çlirimtare e atdheut, e kishte përplotësuar edhe më shumë atë, duke e ballafaquar me realitetin se përfundimisht do të çlirohej një pjesë e atdheut, përkatësisht Kosova do të lirohet nga zgjedha shekullore e shovinizmit serb, nga regjimi i Beogradit.

Personalisht më ka çmuar shumë, por edhe unë kam bërë përpjekje ta respektoj Ekrem Kallabën. Vlen të përmendet që nga ky respekt i ndërsjellë ai më kishte ftuar mysafir nderi me rastin e themelimit të Degës së Partisë Republikane në shtëpinë e tij në Roganë, e ku i pranishëm ishte edhe Reshat Nurboja nga Kryesia qendrore e kësaj partie. Në këtë frymë, më 1996, mua dhe Ali Hoxhës, po ashtu i burgosur politik, na dhuroi nga një libër “Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi”, të botuar nga Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta, në kryesinë e së cilës ishte vetë profesori Ekrem.

Është fat i mirë që kolektivi i gjimnazit të Dardanës, nëntë vjet pasi e patën diferencuar Ekrem Kallabën, u distancuan edhe vetë nga politika shoviniste serbo-jugosllave.

Profesori Ekrem nuk ka qenë hakmarrës politik; karakteri i tij do t'i falte në çdo kohë, të gjithë ata që nuk kanë pasur qëndrim kombëtar në kriza të politikës kombëtare-shqiptare. Këtë dhunti do ta lakmonin shumë veprimtarë politikë e shoqërorë.

- Gjithmonë e kam në kujtesë një pedagog të rrallë të trevës sonë, më thoshte vëllai im Taipi, me të cilin kishin punuar bashkë, për një kohë të caktuar, në ndërmarrjen “Magnohrom” të Dardanës.



## **Ekremi ishte skalitës i harmonisë njerëzore**



*Skender Jahiri*

Me Ekremi jam njohur që nga viti 1981. Nuk ishte vështirë ta bëje shok Ekremi, por ishte vështirë ta mbaje shok. Kishte diapazon të gjerë njohurish, sidomos në fushën e pedagogjisë dhe të filozofisë. Ishte njeri i papërshkrueshëm, tejet dinamik. Ishte i respektueshëm, por edhe respektonte. Njeri më të “madh” nuk kam parë.

Ekremi e patën larguar nga arsimi dhe e sollën në ndërmarrjen “Magnohrom” në cilësinë e pedagogut. Si profesor që ishte, e në mungesë të nxënësve, ai pati vazhduar me inercinë e ligjërimit. Jo të gjithë guxonin të shkonin në zyrën e tij, sepse ishte nën

vëzhgim të sigurimsave. Sidoqoftë, kur shkoja unë ose edhe ndonjë tjetër, ai fillonte me ligjërata sikur të ishim nxënësit e tij. Ligjëratat ishin gjithmonë në frymën atdhetare, por edhe njerëzore; ndikonte drejtpërdrejt në afrimin mes kolegëve të punës. Parapëlqente harmoninë mes njerëzve, shpesh pa dallim nacionaliteti. Kur ishim me Ekremi, disi, ndiheshim më të sigurt.

Ndonëse i përndjekur nga politika serbe dhe struktura udhëheqëse komunale, shumë serbë, ish-nxënës të tij e kolegë tanë, e vlerësonin dhe e respektonin maksimalisht. Këtë autoritet Ekremi e kishte arritur për vite të tëra, nuk e kishte blerë “të premtën” në pazar. Ai kishte aftësi të mëdha ndikimi; me gjasë e kishte të trashëguar nga babai i tij. Gjatë një vizite te prindi i tij në Roganë, babai i Ekremi, baca Tefik, na e mbajti një ligjëratë. Aq fort na e sforcoi ndjenjën kombëtare, sikur të kishim qenë në një trajnim njëmuor.

Shkuarja e Ekremi nga Dardana në Prishtinë kishte lënë zbrazëti të madhe në mesin e shokëve në Dardanë. Ndërkaq, vdekja e tij e parakohshme ishte një krater vullkani te ne shokët e tij, sidomos tek unë. Më duhet të jem i sinqertë,

kur kuptova se kishte ndërruar jetë Ekremi, nuk mund të përmbahesha prej dhembjes. Për dy javë rresht, në mbrëmje shkoja në dhomën time dhe qaja për humbjen e Ekremit; më vinte keq që para fëmijëve të mi të qaja, mirëpo ajo më ishte bërë një terapi çlirimi nga dhembja që ndjeva për humbjen e shokut e mikut tim Ekrem Kallabës.

Nëse ka një botë tjetër, njeriun e parë që do të doja ta takoja, pa dyshim, është profesori i nderuar e shumë i respektuar Ekrem Kallaba.

Lavdi jetës dhe veprës së Ekremit!

Sabri Morina, prof.

## **Profesor i aftë dhe guximtar**

Evokim nga një diskutim i Ekrem Kallabës në një mbledhje të Këshillit të Arsimitarëve në gjimnazin “9 Maji”, tash Ismail Qemali, në Dardanë.

Kujtoj një veprim të tij në vitin shkollor 1981/82. Atëbotë kishte filluar një fushatë e egër diferencuese dhe keqtrajtuese politike e psikologjike! Për çdo ditë në karrige a tavolina shkollore shkruheshin parulla me përmbajtje të “papranueshme” sipas pushtetarëve, si: “Kosova Republikë” ose vetëm shkurtesat “KR”. Pati shumë nxënës të keqtrajtuar edhe në milici. Në një mbledhje të Këshillit të arsimtarëve, pas urdhrin nga drejtorja e shkollës, që i gjithë inventari të pastrohet dhe të fshihen të gjitha shkronjat, sepse “armiku” i frymëzuar nga nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar po i indoktrinon fëmijët tanë, pasoi reagimi fort kundërshtues dhe i vendosur nga prof. Ekrem Kallaba! Po mundohem ta parafrazoj, sepse përmbajtjen nuk e kam harruar fare, tha:



*Sabri Morina, prof.*

“Po flas serbokroatisht, që ta kuptojnë edhe ata më mirë dhe e drejtoi dorën drejt serbëve” dhe vazhdoi menjëherë: “Ovakav naçin neçe nas odvesti nikud, ama ne možemo ništa postići! Čim deci na nešto skreneš pažnju da ne treba i ne valja, oni će misliti i uraditi suprotno, jer sa pretnjama i silom ne možemo ih ubediti! Deci trebaju pravedni saveti i to im reći i ubediti ih, da još nije došlo vreme za upotrebu prsta! Tako da garantujem da nijedno dete neçe pisati po stolicama! Meni kao uprava ne verujete, jer niste mi dali da vodim jedno odeljenje. Dajte meni odeljenje a ja garantujem da na nijednoj stolici neçe biti ništa pisano, ne samo parole! - “Kjo mënyrë nuk do të na çojë askund, dhe asgjë nuk mund të arrijmë! Në çastin kur fëmijës ia tërheq vëmendjen dhe ia ndalon rreptësisht, ai do të veprojë të kundërtën, sepse me kërcënime dhe me dhunë nuk mund të arrihet asgjë. Fëmijëve u nevojiten këshilla të drejta, atyre duhet t’u thuhet se ende nuk ka ardhur koha për ta ngre këmbëzën (ngriti gishtin lart)! Mua si drejtori nuk po më besoni, sepse nuk ma keni dhënë asnjë klasë ta udhëheq. Ma jepni një klasë ta udhëheq, ju garantoj se në asnjë karrige nuk do të shkruhet asgjë, as edhe parulla!”

Ky guxim kaq i madh e ndryshoi kahen e mbledhjes, por edhe e shkurtoi! Pas mbledhjes, bashkë me profën dhe Nexhatin, vazhduam me veturën e tij deri në Topanicë, ku unë u ndala për të kaluar natën te Nexhat Rexha, porse, derisa arritëm u shfrymë, biseduam për të ardhmen tonë krejt hapur, por edhe duke pasur frikë për fatin e Ekremit! Edhe ashtu ndodhi. Pas disa muajsh, unë isha në shërbim ushtarak, kur në “Rilindje” lexova lajmin e hidhur se, ne mesin e të larguarve nga puna ishte prof. Ekrem Kallaba! Njeriu rron sa ia ka caktuar Zoti, por unë ndihem me fat që pak kohë dhe pata rastin ta kem koleg prof. Ekrem Kallabën!

*(Marrë nga Facebook, më 14 dhjetor 2017)*

Rexhep Bugaçku, Koretin

## **Pasionant i gjuetisë**

Me Ekremin më ka lidhur miqësia familjare, të cilën babai im e ka pasur me babanë e Ekremit, mësuesin e popullit, Tefik Kallaba, gjatë punës së tij si mësues në Koretin. Në pranverën e vitit 1954 babai im, Maliqi, ia lëshon, për 6-7 muaj, një dhomë me qira mësuesit Tefik, derisa të akomodohej në një banesë më të madhe. Mirëpo, miqësia mes familjeve tona kishte vazhduar gjithmonë, sa që në vitet '70 fillova edhe unë të shoqërohesha me agën Kemë, siç e quanim shumë shokë të tij. Fillimisht më ka lidhur gjuetia dhe dashuria ndaj zagarëve. Ka pasur rast kur aga Kemë ka paguar për një zagar edhe deri në tre mijë marka gjermane. Ka qenë gjahtar shumë i pasionuar.



*Rexhep Bugaçku*

Më vonë, ndonëse në moshë jo të barabartë, kemi qenë edhe shokë të mirë. Në një rast, derisa po e drejtoja veturën, nga kasetofoni lëshova një kasetë me këngë patriotike shqiptare, ku ndër të tjera i këndohej edhe Enver Hoxhës. –“Prej këtij momenti jemi dosta të vërtetë”, më tha dhe kërkoi që t’ia jepja atë kasetë, kurse pas disa ditësh edhe ai më dha disa kasete të regjistruara nga Radio Kukësi e që unë nuk i kisha. Kështu kemi vazhduar për një kohë të gjatë shkëmbimin e kasetave, por sidomos shoqërimin në fushën e gjuetisë. Madje, nga viti 1999 e deri në vdekjen e tij kemi vepruar aktivisht në shoqatën e gjahtarëve “Thëllëza” në Dardanë si dhe në Federatën e Gjahtarëve të Kosovës.

Mund të them me plot gojë se aga Kemë ka qenë pedagog i shkëlqyeshëm, këtë e kanë vërtetuar gjithmonë nxënësit e tij. Bisedat gjithmonë i ka orientuar në rrafshin e edukimit kombëtar.

Pas largimit nga puna, më 1990, ka përjetuar çaste të vështira ekonomike, sa që është detyruar, nga profesioni i profesorit, të kalojë në kamerier. Kështu, në

vjeshtën e vitit 1991 e ka improvizuar një lokal të vogël para banesës së tij në Dardanë, për të shitur byrekë dhe çaj si dhe pije freskuese për nxënësit dhe qytetarët e tjerë. Për këtë veprimtari organet kompetente i kanë lëshuar edhe vendim pune nga data 25 tetor 1991. Por, kurrsesi nuk ka pranuar që të punonte në organet paralele të qeverisura nga strukturat e dirigjuara nga Beogradi.

Si profesor dhe patriot i pathyer ka qenë shumë herë i shantazhuar nga organet komunale, por edhe nga shqiptarë e serbë besnikë të pushtetit serb.

Jam me fat që jetova në kohën e tij dhe nga ai mësova se si duhet atdheu.

Ramadan Beqiraj, prof.

### **S’di kujt t’i besoj...**



*Ramadan Beqiraj, prof.*

“S’di kujt t’i besoj! Nga armiku di të ruhem, por s’di si të ruhem nga miku” - thoshte ndonjëherë profesori Ekrem.

Si çast karakteristik gjatë përvojës sime në arsim kam veçuar vitin 1981/1982, kur punonim bashkë me profin, siç e quanim ne, Aga Kemë. Në atë kohë pati filluar diferencimi dhe keqtrajtimi i punëtorëve arsimorë, kur patjetër bëhej rojë nëpër shkolla e sidomos kontrollimi i klasave, e posaçërisht kur gjenim diçka të shkruar nëpër banka dhe karrige me inicialet “K.R.” e Aga Kemë na thoshte: “mos i lajmëroni se kjo nuk është asgjë, kanë mundur ta shkruajnë në kuptim tjetër...”, edhe ku t’i gjeni të shkruara prishni e mos i lajmëroni”: E ka pasur një thënie: “S’ di kujt t’i besoj...”!

Të shkruash dhe të flasësh për pedagogun dhe intelektualin Ekrem Kallaba është nder dhe kënaqësi e madhe shpirtërore.

Ekrem Kallaba, në radhë të parë, ishte njeri i ndjenjave të atdhedashurisë, ishte i brumosur me ndjenja të larta kombëtare, që i kishte mësuar më herët, e tani na udhëzonte me metodat e veta pedagogjike. Gjimnazi në atë kohë ishte nën vëzhgim të madh, meqë punonim bashkë me serbët.

Këshillat dhe udhëzimet e agës Kemë në atë kohë kishin ndikim të madh, sepse lehtë mund të bije në kurth dhe të humbje vendin e punës.

Aga Kemë, nuk frikësohej kurrë, si në biseda, po edhe në mbledhje të këshillit të profesorëve, sepse kishte aftësi profesionale dhe guxim.

Aga Kemë, s'diti kurrë të lodhej dhe të kursehej për nxënës. Tërë jetën ia kushtoi çështjes së edukimit dhe formimit të drejtë e të shëndoshë të nxënësve. Ndihem krenar që në atë kohë të vështirë punuam bashkë.

I qoftë i lehtë dheu!





## VI

# Telegrame dhe kujtime ngushëllimi me rastin e ndarjes nga jeta të Ekrem Kallabës

“ Kujtimi pas vdekjes është jetësimi i  
përjetshëm i vlerave për së gjalli. ”

---

*Xhevdet Kallaba*

## Nekrologji për Ekrem Kallabën

Të nderuar vëllezër e motra, të nderuar bashkëfshatarë, miq dhe pjesëmarrës të këtij ceremoniali mortor.

Sot, me dhembje të thellë po ndahemi nga vëllai, miku, kolegu dhe profesori ynë i nderuar Ekrem Tefik Kallaba. Prania juaj kaq masive është dëshmia më e mirë për respektin që mbolli Ekremi te farefisi, shokët, miqtë, te kolegët.

Sot, Ekremi i tuboi shokët nga e gjithë Kosova, nga Kosova Lindore e nga Maqedonia. Fatkeqësisht, ai sot nuk do të mund të komunikojë me ju, dhe kjo është krejt e natyrshme. Mirëpo, për ditën e sotme, Ekremi la një porosi: “M’i ftoni të gjithë dashamirësit në këtë ceremoni mortore dhe thujuni se ua kam bërë hallall të gjithëve, përveç atyre që ma torturuan e ma ndanë kombin tim”.

Ai kërkoi që edhe ju ta falni, t’ia bëni hallall!



*Fjala lamtumirëse e Xhevdetit me rastin e varrimit të Ekremit në Roganë, më 12.12.2008*

Pjesëmarrës të nderuar,

Ekrem Kallaba lindi më 16 korrik të vitit 1944 pikërisht këtu në Roganë të Dardanës. Shkollimin fillor e nisi në Kopërnice, për ta vazhduar në Koretin, në Roganë, në Preshevë dhe në Ferizaj. Më 1963 përfundoi shkollën normale

dhe Gjinnazin në Prishtinë e në Gjilan, ndërkaq në vitin 1968 kreu fakultetin filozofik – Dega e Pedagogjisë në Prishtinë. Krahas studimeve u punësua që në moshën 19-vjeçare arsimtar në Desivojcë, por punoi edhe në Hogosht, në Koretin e në Strezoc të Dardanës.

Me hapjen e gjinnazit në Dardanë, Ekremi, që nga viti 1967, punoi profesor i lëndëve: Filozofi, Psikologji, Logjikë dhe Sociologji. Pastaj ditorinë e shpërndau edhe në Rahovec e në Bujanoc, që për kundërshtëpërblim zgjeroi rrethin e tij shoqëror.

Nga regjimi i kaluar nuk u pa me sy të mirë, kështu që, më 1977, me urdhër të Komitetit të atëhershëm komunal të Dardanës largohet nga procesi arsimor.

Dy vjet i kalon në Ndërmarrjen “Magnohrom” dhe sërish kthehet në arsim në gjinnazin e Dardanës ish-Kamenica, ku, veç lëndëve të grupit të Filozofisë, ligjëron edhe lëndën e Marksizmit. Sa për ilustrim, në vitin 1981 nxënësit e përgatitur nga Ekremi zunë vendin e parë në shkallë Kosove, në lëndën e Filozofisë marksiste, në kuizin e ditorisë të organizuar nga Radiotelevizioni i Prishtinës.

Duke e parë angazhimin dhe suksesin e tij te nxënësit, pastaj guximn qytetar për ta shprehur mendimin individual, qoftë edhe kur nuk i pëlqente pushtetit, Komiteti i atëhershëm komunal sërish intervenon dhe, në vitin 1982, me polici e nxjerrin nga ora e mësimt.

Ekrem Kallaba nuk lindi mësimdhënë, por sikur ishte i lindur për mësimdhënë - për pedagog. Shumë nxënës të tij të asaj kohe ende ruajnë kujtimet për profesorin Ekrem. Mbase shumë prej tyre gjenden edhe sot në këtë ndarje me profesorin e tyre të nderuar.

I nxitur nga ndjenjat kombëtare, por edhe i inspiruar nga patriotët e kohëve të ndryshme, Ekremi merret edhe me aktivitete patriotike. Kështu, qysh nga viti 1990, bashkë me Jahja Llukën, Reshat Nurbojën, Fahri Buçincën e shokë të tjerë angazhohet në Shoqatën për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga trojet e veta. Në këtë shoqatë ka qenë aktiv deri në vdekje.

Me qëllim të çuarjes së proceseve përpara, ai më 1990 themelon edhe Degën e Partisë Republikane në Dardanë, ku u zgjodh kryetar i saj dhe anëtar i Kryesisë në shkallë Kosove.

Si dashamirës i faunës dhe gjahtar i pasionuar, më 1999 u zgodh kryetar i shoqatës së gjahtarëve “Thëllëza” në Dardanë, kurse nga viti 2004 edhe kryetar i Këshillit drejtues në Federatën e Gjahtarëve të Kosovës.

Prej vitit 2004 ka punuar në Qeverinë e Kosovës, në Zyrën e përkthimeve pranë Kryeministrit.

Prandaj, le t’i ruajmë kujtimet më të mira për vëllain, prindin, shokun dhe pedagogun e nderuar Ekrem Kallaba!

I lehtë i qoftë dheu i Kosovës!

**Xhevdet Kallaba, Roganë 12 dhjetor 2008**

## **Republika e Kosovës - Zyra e Kryeministrit**

Prishtinë, 11. 12. 2008

E nderuara familje Kallaba

Me pikëllim morëm lajmin për vdekjen e Ekremit, zyrtar në Divizionin gjuhësor të Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës. Vdekja e Ekremit është humbje për Ju, familje e nderuar Kallaba, miqtë dhe kolegët e tij dhe institucionin ku punoi.

Shëmbëlltyra e tij do të kujtohet me respekt nga të gjithë ata që punuan me të. Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në emrin tim Ju përcjell ngushëllimet më të sinqerta.

Sinqerisht,

Hashim Thaçi, kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria -Vlada-Government*  
*Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister*

---

**Telegram ngushëllimi**

*Prishtinë, 11.12. 2008*

E nderuara familje Kallaba,

Me pikëllim morëm lajmin për vdekjen e Ekremit , zyrtar në Divizionin gjuhësor të Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Vdekja e Ekremit është humbje për ju familje e nderuar Kallaba, miqtë dhe kolegët e tij dhe institucionin ku punoi.

Shëmbëlltyra e tij do të kujtohet me respekt nga të gjithë ata që punuan me të.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në emrin tim ju përcjell ngushëllimet më të sinqerta.

*Sinqertësisht,*

*Hashim Thaçi,*

*Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës*



## Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – Zyra e kryetarit

12.12.2008

Familjes Kallaba, Dardanë

E nderuara Familje Kallaba

Me keqardhje mora lajmin për vdekjen e atdhetarit të shquar dhe veprimtarit të palodhshëm të çështjes kombëtare, profesor Ekrem Kallabës.

Në këto momente dhimbjeje jua përcjell ngushëllimet e mia më të sinqerta juve, të afërmve tuaj, bashkëveprimtarëve të profesorit dhe të gjithë të pikëlluarve të tjerë.

Profesori do të kujtohet nga të gjithë ne me respektin më të thellë për humanizmin e tij, guximin e lartë intelektual dhe kontributin e madh në shërbim të kombit dhe të Kosovës, në të gjitha fazat e përpjekjeve dhe të organizimit tonë për lirinë, pavarësinë dhe shtetin që po e ndërtojmë.

I lehtë i qoftë dheu i Kosovës, profesor Ekrem Kallabës!

Lavdi jetës dhe veprës së tij!

Sinqerisht me ju,

Ramush Haradinaj, kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës



ALIANCA PËR ARDHMBËNË E KOSOVËS  
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO

Zyra e Kryetarit / Office of the President

Prishtinë, 12 dhjetor 2008

Familjes Kallaba,  
Dardane

E nderuara Familje Kallaba,

Me këqandje mora lajmin për vdekjen e anëtarit të shquar dhe veprimtarit të palodhshëm të çështjes kombëtare, profesor Ekrem Kallabës.

Në këto momente dhimbjeje jua përcjellë ngushëllimet e mia me të sinqerta juve, të afërmit tuaj, bashkëveprimtarëve të profesorit dhe të gjithë të përkohshme të tërë.

Profesori do të kujtohet nga të gjithë ne me respektin më të thellë për humanizmin e tij, gjuhën e lartë intelektuale dhe kontributin e madh në shërbim të kombit dhe të Kosovës, në të gjitha fazat e përparimit dhe të organizimit tonë për liri, pavarësi dhe shtet të qendrueshëm.

I lehtë i qofte dhe i Kosovës, profesor Ekrem Kallabë!

Larë ditës dhe veprës së tij!

Sinqerisht me juve,

*Ramush Haradinaj*

Ramush Haradinaj,

Kryetar i Aliancës për Ardhmësinë e Kosovës

## Shoqata e Gjuetarëve “Pashtriku” Gjakovë

12.12.2008

Zotëri Xhevdet Kallaba

Pranoni ngushëllimet e përbashkëta, të miat personale dhe të familjes, të të gjithë gjuetarëve të Shoqatës sonë, të cilët kanë pasur nderin ta njohin personalisht Ekremin e ndjerë. Ju lutem që t’ua përcillni familjes ndjenjat tona të respektit më të thellë për punën dhe veprën e Tij, si në arsimimin e brezave nëpër mote, e në veçanti në përparimin e gjuetisë kosovare të pasluftës.

Me respekt,

Halim Çarkaxhija, kryetar i Shoqatës “Pashtriku” – Gjakovë

### Bahtijar Kryeziu

#### **Letërngushëllim**

Bashkëvendësi e profesori im, një penë e mendje e hollë, profesor e pedagog i shkëlqyer, bujar e atdhetar, i urtë e i dashur si rrallëkush, i respektuar nga të gjithë, dashamirë i së drejtës, por edhe i pa kompromis ndaj së padrejtës – na iku, ashtu heshtas, siç ishte i heshtur edhe vetë.

U nda nga kjo botë kur familjes e vendit ju desh e ju duhej prore, kur kishim nevojë ende për mësimet e këshillat e Tij. Porse, “Ajo gjë që quhet arsye për të jetuar, është njëkohësisht një arsye edhe për të vdekur” - thotë Kamy. Rrugë tjetër nuk ka.



Ngushëllime, Ty Xhevdet, për vëllanë e shtrenjtë, familjarëve e farefisit të gjerë, bashkëvendësve, ish-nxënësve, shokëve e miqve të shumtë që kishte.

Bëhuni të fortë edhe në këtë ditë të rëndë në përballimin e mërzisë e të mallit që keni e që kemi, si bashkëvendës e vëlla tonin që e kishim.

Qoftë i përjetshëm kujtimi për profesor Ekremin!

Lamtumirë bashkëvendësi im! Lamtumirë aga Kemi!

*Bashkëvendësi Ilmi Hysen Kryeziu, ish-punëtor në Gjykatën Komunale në Dardanë, por dikur edhe nxënës i Ekremit, përjetimin e tij për ish-profesorin e kishte dhënë përmes një shkrimi dhe një poezie me titull “Kujtesë”.*

## **Ilmi Hysen Kryeziu**

### **Profesorit tim - Ekrem Kallabës**

Jeta është fluskë sapuni. Përjetimet në data të ndryshme shënojnë ngjarje që nuk harrohen kurrë.

E nderuara Familje Kallaba, kudo që ndodheni!

Është vështirë të shkruash për njeriun që më ka dashur dhe e kam dashur si vëllain. Vështirë është në një shkrim përkujtimor të përmenden të gjitha vlerat, meritat dhe arritjet e prof. Ekrem Kallabës, ngase ato janë të shumta e të veçanta.

Në fushën e mësimdhënies ishte një shembull që flet, kishte energji, kishte vullnet të zjarrtë për çdo punë e veprim që merrte, e kryente sipas planprogramit mësimor.

Personaliteti i profesor Ekrem Kallabës si punëtor i arsimit, profesor, edukator humanist dhe njeri me tipare të një burri të pjekur, njeri i zemrës që inspiroi të gjitha gjeneratat e nxënësve, të cilëve u dha mësim.



*Nga e majta:  
Ilmi Kryeziu dhe  
Ekrem Kallaba*

Pa dyshim, është një emër domethënës në rajonin e Dardanës e më gjerë në fushën e arsimit dhe edukimit.

Ky arsimdashës dhe intelektual i devotshëm kujtohet me admirim të veçantë nga ish-nxënësit e gjimnazit “9 Maji”, në Dardanë, në mesin e të cilëve isha edhe unë.

Ekrem Kallaba nuk ishte vetëm profesor i mirë, por ishte edhe një intelektual i mirëfilltë me dije dhe aftësi nga fusha të ndryshme.

Po e përmend një aforizëm që i përshtatet punës dhe veprës së profesorit. “Fama e njerëzve të mëdhenj do vlerësim gjithmonë sipas mënyrës që e kanë arritur”.

Ekremi është marrë edhe me sportin e gjuetisë. Mbas çlirimit të Kosovës nga okupatori serbosllav, në Komunën e Dardanës e ka formuar shoqatën e gjuetarëve me emrin “Thëllëza”, ku disa vjet ka qenë kryetar i shoqatës, e pastaj ka punuar edhe në Kryeministrinë e Qeverisë së Kosovës para se të ndërronte jetë.

Secila vdekje me vete sjell lot, pikëllim dhe tronditje, jo vetëm për të afërmit, farefisin e ngushtë e të gjerë, por si rrufeja i godet edhe shpirtrat e zemrat e atyre që e kanë njohur.

(shkurt 2017)

## Kujtesë

(Prof. Ekrem Kallabës)

Frymëmarrja zbrazë e mbushë  
Për dashurinë e kërkuar  
Sa shumë dritë jep jeta  
Kur ndalesh për të kujtuar.

Sot jam zhytur thellë në mendime  
Jeta më duket e pavlerë  
Se vdekja të rrëmbeu  
Një perde e zezë na ndau për jetë.

Ishe një dhuratë e madhe  
Për ëmbëlsirë ia kalove edhe mjaltit  
E, kush nuk të kishte ty për zemër  
Sot flitet për tëndin emër.

Ty të donte gjithë shoqëria  
Buzëqeshja jote të bënte për vete  
Çdo gjë jotja ishte e vërtetë  
Shkëlqeve si yll kur erdhe në jetë.

Edhe në momentet më të vështira  
Ty gjithmonë të qeshte fytyra  
Sa të doja të kisha pranë  
Veprat tuaja të gjalla janë.

*Ilmi Kryeziu, mars 2021*



## **Kur vitet kalojnë, e kujtesa ndalet në çastin e ndarjes së përjetshme**

Përkujtimi i mëposhtëm ripërsëritet nga viti 2015, dhe në raport me të, përveç kohës së kaluar pa më të dashurin tonë, nuk kam fare çfarë të shtoj; e njëjta dhembje, e njëjta krenari, i njëjti zotim, i njëjti përkushtim për atdheun dhe njerëzit që më rrethojnë, i njëjti respekt për të gjithë ata që e respektuan Ekremin dhe familjen Kallaba. Kështu, vazhdojnë ngushëllimet për familjarët, shokët, nxënësit e kolegët e tij dhe gjithë dashamirësit e vëllait tim, Ekrem Kallaba.

Si sot, para 9 vjetësh u nda prej nesh, nga kjo botë, vëllai im i dashur e shumë i respektuar Ekrem Kallaba. Kaluan 9 vjet nga ndarja, kurse kujtesa për vëllain sikur u ndal po atë ditë dhjetori, të parin dhjetor të Pavarësisë së shtetit të Kosovës (2008). Tani bashkëjetesën me vëllain e përjetoj kur takoj shokë, miq, ish-nxënës të tij, kolegë dhe të afërm të tjerë, me të cilët evokojmë çaste nga koha kur ai ishte në mesin tonë.

Ekremi u nda nga kjo botë me mallin e jetesës në shtetin vetjak, me mallin e bashkimit kombëtar, me mallin e përjetimit të mbesave e nipave të shumtë që lindën në këtë meskohë; u nda me brengosjen se si do të ecë zhvillimi i shtetit të Kosovës, u nda me dhembjen për mosshijimin e shtetit vetjak të shumë brezave para tij, të cilët kishin shkuar në amshim me “sy çelë” për fatin e Kosovës.

I gjithë ky mallëngjim i tij shkoi bashkë me të, për të na lënë ne si dëshmitarë për ngjarjet pasuese, si dëshmitarë të të mirave shtetërore, por edhe si dëshmitarë të të këqijave që po i ndodhin Kosovës për papjekuri politike, menaxhuese e shtetformuese. Kështu me mallëngjim e kujtoj vëllain tim, jo vetëm në përvjetorët e tij të ndarjes, por në vazhdimësi, duke u përpjekur që të vazhdoj t'i jetësoj këshillat e tij për atdhedashuri, për sjellje njerëzore, për kontribut të vazhdueshëm në dashurinë vëllazërore, për kontribut në vetëdijesimin e brezave të rinj në ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore e shkencore, për respektimin deri në qiell të familjes, të mësimit e të mësuesit.

Dhe, derisa kam frymë vazhdoj t'i realizoj porositë e tij. I lehtë i qoftë dheu i Kosovës, vëllait tim, mësuesit e pedagogut, Ekrem Kallaba!

**(Xhevdet Kallaba, 11 dhjetor 2017)**

## Dr. Safete V. Maliqi – Qormemeti

### **Përzemërsi e ndërsjellë mes profesorit dhe nxënësve**

Post mortem - Prof. Ekrem Tefik Kallaba

Ishte viti shkollor 1979/80 kur isha nxënëse e vitit IV të gjimnazit “9 Maji”, tash “Ismail Qemali” - drejtimi Kimi-Biologji, në Dardanë. Prof. Ekrem Kallaba na eligjeronte lëndën e Marksizmit. Në klasë ishim 35 nxënës. Moshë na ndihmonte që gjërat t’i perceptonim fare qartë. Madje, disa prej nesh, që shquheshim për zgjuarsin, lexonim shumëçka edhe mes rreshtash, kur një gjë të tillë na e mundësonte ndonjë profesor. Profesori Ekrem ishte pikërisht njëri nga ata, që mes rreshtash na ligjeronte për një të ardhme më të ndritur kombëtare, larg, shumë larg realitetit aktual të qeverisjes së vendit nga politikëbërësit e asaj periudhe. Prandaj, unë dhe brezi im e mbajmë mend si një profesor të përkushtuar në profesionin e tij prej prindi dhe pedagogu.



*Dr. Safete Maliqi - Qormemeti*

Natyrisht, profesori Ekrem i takonte një brezi që edhe prindin e kishte mësues, veteran të arsimit shqip, i cili kishte lënë gjurmë në komunën tonë. E quanin Tefik Sh. Kallaba, që i pari hapi shkollën shqipe në vitet 1947/48 në fshatin Busavatë. Një biografi më të ndriçuar për mësuesin Tefik e kisha trashëguar prej kohësh nga babai im, Veli Maliqi, që ishte bashkëveprimtar dhe shok i mirë i mësuesit Tefik. Arsimi dhe edukata tashmë kishin lëshuar rrënjë në familjen Kallaba. Me gjasë kjo dhe ndikonte te profesori Ekrem që me lehtësi të depërtonte në shpirtin tonë të njomë prej nxënësi, duke mbjellë te ne atdhedashurinë.

Më vonë e kam kuptuar përkushtimin e vërtetë të profesorit Ekrem për arsimimin tonë të drejtë, dhe se lënda e Marksizmit për të ishte më shumë një mbulesë ilustrative dhe assesi ideologji e tij. Duke marrë shembuj nga

shkrimtarë të Rilindjes kombëtare profesori na fliste, mes rreshtash, për një ideologji të së ardhmes, për të qenë të vëmendshëm se nga duhet të ecnim. Kështu, ai na e trasonte rrugën e ndryshimeve në të mirë të popullit e të kombit që i përkisnim.

Prof. Ekrem T. Kallaba ishte tejet i vëmendshëm që të mos binte në sy të regjimit jugosllav dhe shërbëtorëve të tij dritëshkurtër shqiptarë, të cilët paarsyeshëm diferenconin dhe njollosnin profesorët atdhetarë dhe arsimdashës të viteve '80. Përmes ligjërimeve, ai na i afronte fare pranë frytet e atdhetarëve pararendës, duke bërë të ditur, gjithmonë mes rreshtash, se ideologjia e Marksizëm-Leninizmit nuk përkon me iluzionin për të ardhmen e çlirimit tonë nga robërimi. Ishte largpamës për ndryshimet që do të ndodhin së shpejti, kur ne do të jemi zot në shtëpinë tonë, në një shtet ku do të flitet e do të frymohet shqip. Pa dyshim, largpamësinë e tij e bazonte te ne, nxënësit e tij, te të cilët shihte një potencial të bollshëm për ndryshime. Te nxënësit e klasës sonë ai shihte lëvizjet e para për ndryshime, të cilat ishin edhe rezultat i tij dhe i disa profesorëve të tjerë atdhedashës.

Ah, profesorin Ekrem e mbaj mend si njeri me plot kuptimin e fjalës. Ishte pedant, i respektuar dhe respektues. Unë kisha respekt të veçantë ndaj profesorit, sepse ishte edhe raporti i ndërsjellë familjar që kishte babai im me babanë e profesorit Ekrem.

Pas mbarimit të shkollës së mesme, unë vazhdova studimet për mjekësi në Prishtinë. Ishte kohë e lëvizjeve të përgjithshme studentore të vitit 1981. Demonstratat e pareshtura të pranverës së '81-shit u bënë edhe oda jonë e pjesëmarrjes si dhe e pjekjes, por edhe e pikëpjekjes studentore. Kjo e gëzonte atë, sepse teoria për çlirim kombëtar po jetësohej në praktikë.

Takimet e mëvonshme me profesorët tanë kanë qenë kolegiale dhe të përzemërta.

Me profesorin dhe familjen e tij pata rastin dhe kënaqësinë të bashkëjetoja në Prishtinë. Ishim në hyrjen e njëjtë në "Kurriç" të lagjes Dardania. Kur nisesha për në punë, e takoja pikërisht te hyrja nr. 11. Profesori, ndonëse me moshë jo edhe aq të madhe, tashmë kishte një gjendje të rënduar shëndetësore. Brengosej për fatin e djalit të tij të vetëm, Enliratit. Dëshironte që sa më parë të shihte

trashëgimtarë tek ai. E kishte pikë të dobët. Dëshironte ta shihte zot të vetvetes.

Bashkëshortja Fekrija dhe djali Enlirati më folën për gjendjen e tij shëndetësore dhe fillimin e trajtimit të tij mjekësor nga një sëmundje shumë e rëndë. Parashikimet ishin të këqija, porse ai nuk dorëzohej. Sillej si gjithmonë, gjentil dhe këshillues. Ishte unik si individ, i papërsëritshëm; të paktën unë kështu do ta kujtoj gjithmonë profesorin tim të nderuar Ekrem Kallaba.

Për herë të fundit e takova në Qendrën Klinike, ku punoja unë. Iu afrova për ta pyetur për gjendjen e tij shëndetësore, duke i ofruar edhe ndihmë. I kishte humbur shpresat dhe me mimikën e tij sikur më tha, “nuk mund t’i shpëtoj vdekjes”. Fitova përshtypjen se po i numëronte ditët e fundit; i kishte humbur edhe ai pak optimizëm që e kishte për triumf. U ndjeva shumë keq për gjendjen e tij shëndetësore. Nuk gjeja fjalë të duhura për ta ngushëlluar. Nuk dija nëse duhet, t’i thosha “ditën e mirë” ose “mirupafshim”. Nuk na doli asnjë fjalë nga goja. U larguam duke e përcjellë njëri-tjetrin vetëm me një shikim mallëngjyes. Përnjëherë m’u kthye filmi shumë vjet prapa, kur profesori reflektonte entuziazëm, mësimdhënie e këshilla praktike për jetë dhe atdhedashuri. Një plogështi ma kaploi gjithë trupin dhe fillova të pëshpërit më vete: sa i fortë e sa i pafuqi është njeriu, njëkohësisht.

Disa ditë më vonë mësova për ndarjen e profesorit Ekrem T. Kallaba nga kjo botë, duke përkujtuar shpejtazi biografinë e tij prej pedagogu dhe atdhetari të devotshëm.

Ne, ish-nxënësit e tij, do të jemi krenarë me profesorin Ekrem. Lavdi dhe u prehtë në parajsë ish-profesori ynë i dashur! I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

*(Prishtinë, më 31 maj 2019)*



## VII

### **Rrëfime familjare nga nëna - Naxhije Shabani Kallaba**

“ Arti i rrëfimit të një gruaje  
analfabete. ”

---





*Naxhije Shabani – Kallaba*  
12.9.1921 – 3.1.2001

*Po, nëna, a ka qenë e shkolluar? Më shumë fole për babanë. A nuk është kjo sjellje një reflektim i një pabarazie gjinore?*

**Kema:** E kam cekur diku se babai mori për grua një femër të pashkolluar, por që rridhte nga një familje e mirë e bujare. Madje ajo ishte rritur nga gjyshja e saj, Ramizja, sepse nëna (Kadirja) i kishte vdekur kur kjo kishte qenë fëmijë. Më duhet të pranoj se nëna nuk dinte shkrim-lexim, por gjërat i regjistronte si magnetofon. Kur dikush kishte durim të dëgjonte, ajo ishte e gatshme të rrëfente ngjarje të periudhave të ndryshme dy-tri orë pa u ndalur fare.

Madje, ishte e gatshme të rrëfente si një profesoreshë me përvojë, duke i prezantuar situatat sikur të kishin ndodhur një ditë më parë, e jo para 30 - 40 vjetësh.

Në vazhdim po jap fragmente nga një bisedë e saj, e regjistruar nga “kamera e fshehtë” më 14 mars 1996, nga Xhevdeti, derisa rrëfimi kishte të bënte me periudha të para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

## **Strehimi i mulla Idris Gjilanit në sytë e një të reje**

1.

Si e vogël, kam shkuar shpesh te dajat në Gjyrishec. Kënaqësi e pafund ka qenë qëndrimi atje. Dashuria për nipa e mbesa nga dajat e gratë e tyre ka qenë ushqim për ne. Nëna më ka lënë të vogël, kur pati ndërruar jetë, mezi e mbaj mend. Mungesën e dashurisë amnore e kompensoja kur shkoja te dajat në Gjyrishec. Daja Emin e daja Ajet ishin moshatarë tanë, kurse unë e baci, vëllai im i vetëm, Rasimi, kënaqeshim kur në Gjyrishec in piktoresk qëndronim nga një javë e më shumë. Ne, çikat, edhe pse ishim goxha të mëdha, ende luanim lojëra fëmijësh, që na e shtonin kënaqësinë. Nuk mungonte as loja e “çelikut”, të cilin me një shkop thane (një copë druri thane ose tjetër rreth 15 cm, i mprehur në të dy anët) e gjuanim edhe nga njëzet metra larg; as edhe loja “komkaqel” – lojë e kutive katrore, që i vizatonim ngjitas nga shtatë a tetë sosh me ndonjë shkop, ndërsa nga ndonjë qeramidhe bënim copa të rrumbullakëta të përshtatshme për

t'i hedhur sa më në mes të katrorëve. Me një këmbë kërcimthi arrinim te pllaka e qeramidhes, e merrnim dhe, pa e lëshuar këmbën tjetër, ktheheshim në fillim, e kështu me radhë. Aq gjatë luanim, sa gratë e dajave shpesh mërzhiteshin duke na thirrur nga disa herë radhazi për të ngrënë drekën a darkën bashkërisht. E, po, nuk na kursenin as edhe kur kishte ndonjë punë fushe. Sa gëzoheshin dajat kur u ndihmonim që shpejt e shpejt ta mblidhnim sanën e tharë para ndonjë shtrëngate që na e sillte era "prishtina".

Kishte edhe situata serioze kur kishim frikë të flisnim edhe gojë më vesh. Ishte kohë kaçakësh, kurse dajat tanë, si burra të fjalës, edhe strehonin ndonjë, për disa ditë e, pse jo, edhe më gjatë. Madje, edhe vetë dilnin kaçakë. E kujtoj kohën kur te dajat ishte strehuar Mulla Idrisi. Më vonë e kam kuptuar se kush kishte qenë ai. E kanë pasur dajat një krua, e kur kalonim andej, fëmijët flisnin mes vete e thoshin këtu rri Salih (vëllai i Sylës). Ai ka qenë një trim i madh. S'ka pasur si ai. E pati vra një njeri i pushtetit. Në qerre e kanë vrarë. Nuk ishte i vetmi që e kish vrarë pushteti serb me dorën e shqiptarit. Edhe djalin shtatëmbëdhjetëvjeçar të dajës Sadik e kanë mbytur.

Edhe një tjetër e kanë pas torturuar me dajak, që s'kish treguar se ku janë burrat e as Mulla Idrisi. Dajën Sadik e kanë pas nxjerr përmes tavanit. Derisa Mulla Idrisi po strehohej te dajat, të gjithë burrat kishin dalë në mal për të humbur gjurmë. Eh, sa e dhimbshme. Tre prej një shtëpie qenë vrarë prej një dore, madje edhe në Krenidell nga dy të tjerë. Nusja e dajës Selim ka qenë gjallë kur kanë ndodhur të gjitha këto vrasje... po më duket ti po më incizon... mos, të lutem, se kjo punë nuk është bash e lehtë, - më tha nëna ime, ndërkaq unë ndërrova temë për ta shpërqendruar nga syri i kamerës së fshehur. ...

2.

## **Djegia e Brahimve**

*A e mban mend kur i kanë djegur Brahimtë, - kalova temën nga Gjyrisheci në Krenidell?*

- Jo, unë s'kam qenë e lindur atëherë. Thuhet se baci (vëllai - Rasimi) ka lindur

atë ditë. Shkaku i djegies së Brahimëve ka qenë një martesë e Ilazit të Brahimëve, që e ka pas marrë për grua një bullgare. Pra, bullgarët i kanë djegur në shenjë hakmarrjeje për nusen e bacës Ilaz - bullgaren. Atë ngjarje e tregonte shpesh Dada Madhe. Ajo thoshte: kur kishin arritur në rrafshin e fushës së Stërlllocit, kishin dalë ylfijet (ushtria). Në Stërllloc, një kojshi më i largët, që kishte një urrejtje patologjike për fqinjët e vet, i drejtohet ylfijes: - Si ta lini edhe vetëm një knues që të këndojë në shtëpinë e tyre, ata sërish do të kenë sjellje të njëjta.

*Po, kujt po i thua ti Dada Madhe?*

- Bashkëshortes së Jasharit, pra nënës së Lalifes e Ramadanit, i kemi thënë Dada Madhe. Në ato çaste të rrethimit axha Hasan nuk kishte mundur të ikte. Ferizi, Salihu e Hyda kishin ikur në mal. Pra, gjithë Brahimtë kishin ikur. Në shtëpinë e kushëririt – Jasharit, kishte mbetur vetëm Hasani i Reshitit, që ishte rreth 22-23 vjeç, dhe gjyshja e tij. Për ta gjetur një shpëtim, ajo shpejt merr dy çarçafë të bardhë. Njërin ia shtron kurse me tjetrin e mbulon Hasanin, ndërkaq mbi të dy çarçafët derdh një sasi të madhe mjalti, kinse po e shëronte Hasanin nga sëmundja e lisë së madhe - një sëmundje ngjitëse dhe e rrezikshme për gjithë popullatën. Pushteti nuk kishte hyrë tek ato familje, ku ishte përhapur kjo sëmundje. Më pas në dhomë kishte hyrë një njeri i madh, kishte qenë doktori, që do ta kontrollonte Hasanin. E kishte rrotulluar andej e këndej.



*Naxhija duke rrëfyer të kaluarën familjare*

Çështë e vërteta, Hasani kishte qenë plotësisht i shëndoshë. Këtë ia kishte thënë edhe doktori:

- Oj hallë, gjë s'ka djali, hiç mos e lyej me mjaltë. Po ti rri e qetë, sepse ty s'të prekim fare. Doktori shpejt kishte dalë përjashta dhe u ishte drejtuar ushtarëve: Vetëm nëse një hu gardhi i digjet kësaj shtëpie, ju do të pushkatojeni. Ishte çuar ushtria dhe rreth e për qosh kishin vënë copa të leshta. Madje i kishin lagur ato, që të mos digjeshim ne, sepse shtëpitë ishin njëra pranë tjetrës. Ata i kishin djegur krejt, me dru e me kafshë. I kishin pas bërë hi e pluhur.

*Cilat shtëpi?*

- Shtëpitë e Jasharit - të Brahimëve. Dadën e Madhe (gruan e Jasharit) me dy fëmijë, si dhe nënën Halime dhe plakun (Brahimin), që i kanë gjetur në shtëpi, i kanë marrë jesir (rob). Plakun e kanë pushkatuar në Livoç, kurse gratë i kanë dërguar rob në Shumen të Bullgarisë, ku i kanë mbajtur rreth tre vjet.

*Kë e dërguan në Shumen?*

- Shoqen e Jasharit - Dadën madhe, e Vishën-plakën, këto kanë qëndruar rob në Shumen të Bullgarisë. Atje Dadës Madhe i ka vdekur një djalë; Rizah e kish pasur emrin.

*E Lalifja si ka shpëtuar?*

- Krejt i kishin marrë, ndërsa kjo kishte ikur. Kur kishte dalë te Dardha Madhe, në sokak, ishte kapur për dardhe dhe kishte thënë: unë s'jam e Brahimëve, po jam e Hydës, e ata nuk i kishin marrë, as të Hydës, as tanët. Kjo kishte mbetur në vend të Hydës. Pastaj gjyshja e kishte marrë dhe e kishte shtrirë në grazhd të kalit. Ktyneherë grazhdi ka qenë i lartë. Lalifen e kishte shtrirë në grazhd dhe e kishte mbuluar me kashtë. Plot shtatë vjet Dada Lalife kishte qëndruar te

gjyshja. Shumica e burrave të Brahimëve ishin strehuar diku, që t'u shmangeshin bullgarëve. Vetë Qazimi me bashkëshorten dhe dy djem kishin qëndruar në dhë, në fshatin Zhujë. Sipër kishte çataj druri e misri, kurse ata strehoheshin në dhë. Zhujasit, vëllezërit e hallës Hanife, i kishin furnizuar në vazhdimësi me ushqime.

Kishin qenë kohë të vështira gjatë okupimit bullgar. Be bënte babai im, derisa tregonte një rast kur kishte ardhur ushtria bullgare dhe na kishte rrethuar në kërkim të axhës Qal (Jashar). Atëherë, e kishte marrë babai im dhe, për ta shpëtuar, e kishte futur nën jorgan, ku kishte qenë duke fjetur me nënën time, sepse Jasharin e kërkonin për ta pushkatuar, njësoj siç kishin bërë me babën e tij - Brahimin, në Livoç. Kur e kishin hapur derën dhe kishin pyetur se kush ishte në dhomë, gjyshja (Ramizja) u kishte thënë: Djali im po fle me gruan. Meqë ne nuk na merrnin, atëherë ishin larguar, tregonte babai im për mënyrën e shpëtimit të Jasharit nga pushkatimi i sigurt.

Kur ishin kthyer ato prej Shumenit, tashmë këtë vend e kishte okupuar Serbia, ndërkaq Brahimtë ishin lidhur me Veliçk Domorocin, i cili u ndihmonte. Prej Sedllarit, prej Pribocit, prej Zarbicës, krejt drutë e gurët në krahë i kanë sjellë për t'ua rindërtuar shtëpinë e djegur nga bullgarët. Kishin ndërtuar shtëpi të mirë për atë kohë, sa një kala. S'kishte pasur si shtëpia e Brahimëve. Unë kam lindur më vonë, më 1921. Babai im ishte i butë dhe shumë bamirës.

3.

## **Dalja e Hafëz Kallabës kaçak dhe strehimi i tij (1944-1945)**

(sipas rrëfimit të Naxhije Kallabës)

Gjashtë javë ka qëndruar te ne në Krenidell. Tri javë krejtësisht në fshehtësi - tinëz. Dy javë ka qëndruar në Breznicë, te njëfarë Murati - stërnip i Rogoçicës. Prej aty, pasi e kishin diktuar partizano-çetnikët, kishte ardhur në Rogoçicë, te Sylja i Jetës (Sylë Kallaba), ku ishte fshehur dy javë. Kishte fjetur e kishte qëndruar gjatë ditës në të njëjtën dhomë ku flinin gratë. Më pas ishte zbuluar



nga një serb i Shipashnicës, Vasa, që kishte qenë komandant. Situata ishte vështirësuar shumë, saqë Sylja kishte shkuar te baba Hoxhë e i kishte thënë: Baba Hoxhë (ashtu e thërriste) brenda 24 orësh duhet të humbësh prej këtu, sepse të kanë zbuluar - po dyshojnë.

Partizanët i vendosnin shtabet ku u pëlqente atyre, ata nuk të pyesnin fare ai pranon ti apo jo. Njësoj ishin vendosur edhe në Krenidell (v.Xh.K)

Atëherë, çohet baba Hoxhë prej aty, por kishte qenë në dilemë ku të shkonte? E kishte marrë Sylja dhe e kishte çuar në Krenidell, te ne. Te ne kishte qenë i stacionuar shtabi i ushtrisë. Axha Hasan e kishte futur në një dhomë babën Hafëz, kurse në tjetrën kishte qenë ushtria. Ditën, nganjëherë e kishte marrë Jashari herët në mëngjes dhe kishin shkuar në Shavarinë, një mal i shpeshtë, ku kishin qëndruar shpesh edhe natën aty.

Një ditë axha Hasan çohet dhe e pret një buallicë, që të mos diktohet hafëzi. E pret buallicën dhe mishin e bën copa-copa, të cilin e var përmbi shporet, kinse për t'u tharë. Kështu, baba Hoxhë, i veshur si kaçak, strehohej poshtë mishit që po thahej. Aty, thoshte hoxha, unë rrija në atë dhomën e hallës Hasanit (kështu e thërrisnim bashkëshorten e axhës Hasan). Një ditë prej ditësh, baba Hoxhë kishte pasur nevojë për t'i ndërruar teshat. E kishte porositur Arifin e Dalipit: shko thuj Sanijes (bashkëshortes së vet) ose Naxhijes (resë së tij - pra, mua), tjetër njeri të mos e kuptojë fare, që të m'i dërgojnë një palë ndërresa dhe alltinë.

Një pasdite erdhi Arifi e po më thotë: oj Naxhije, kështu e kështu ka porositur hoxha, por po kuptoi ushtria, ne, krejt mëhallën, na djegin, por edhe juve, po ashtu. E mori aba Sanije alltinë dhe ndërresat, i mbështollëm mirë e mirë dhe ia dhamë Arifit të Dalipit, pa mos e ditur kurrkush as prej krenidellëve e as prej kallabëve. Pra, vetëm Hafëzi, axha Hasan, Arifi dhe ne dyja. Ia çoi teshat e ai ndenji tri javë e disa ditë.

Ndërkohë, me gjasë, partizanët kishin kuptuar se Hafëzi po strehohej aty, kështu që katër-pesë ditë pa u ardhur urdhri për të dalë ai grup prej aty në brigadë, kishte ardhur njëri prej komandantëve e u kishte thënë: ose dorëzoheni hoxhën, ose me krejt anëtarët e familjes keni për t'u djegur. Në mal, si kaçak, ishte edhe djali i Hafëzit - Tefiku.

“Atëherë hyra te komandanti, tek i cili kisha respekt për mikpritjen që ua bënim e po i tregoj: - Po, këtu e kam hoxhën, por si t’ia bëj?” - tregonte më vonë axha Hasan. Ai ia kishte kthyer: - Përpiqu që ta strehosh edhe dy ditë. Por, një mëngjes hynë ushtarët dhe me thika e shponin kashtën në mos ishte i fshehur Hafëzi diku në kashtë. Për fat, ai ishte në “Shavarinë”.

*A e kanë ditur që Hafëz Kallaba është atje?*

Po, e kanë kuptuar një javë para se të formoheshin aradhet. Hafëzi nuk e dinte se ushtarët kishin kuptuar që ai po strehohej aty. Hasani ishte miqësuar me komandantin, prandaj edhe kishin besim në njëri-tjetrin, që të flisnin në besim. Hafëzi ishte dhëndër i Hasanit. Por, tashmë edhe unë isha martuar për djalin e tij, Tefikun. Në mëngjes Jashari kishte shkuar në dhomë, e kishte marrë Hafëzin dhe kishin shkuar në Shavarinë, aty ku Hafëzi shpesh e kalonte gjithë ditën. Ia kishte sqaruar krejt situatën; i kishte treguar se komandanti tashmë kishte kuptuar se ai po strehohej te Brahimtë. Hafëzi, përveç që ishte mik shtëpie, nuk ishte njeri dosido. Ai gëzonte autoritet të madh në gjithë Anamoravën si dhe në Malësinë e Hashanisë. Duke shkuar në Shavarinë, e kishte diskutuar gjithë situatën me Hafëzin dhe e kishte pyetur si t’ia bënte. Po ashtu, e kishte njoftuar se komandanti i kishte pas thënë Jasharit se edhe dy-tri ditë brigada ka për t’u hapur për të gjithë. I kishte thënë: nëse hoxha dëshiron të hyjë në brigadë, le të hyjë aty, le të përzihet me partizanë të tjerë, kështu s’mund ta marrë vesh kurrkush se ai ka qenë kaçak.



*Naxhije Shabani – Kallaba 1921 – 2001  
(foto e vitit 1955)*

Ishte një veprim me rrezik, por edhe një shans për Hafëzin, kështu që pranon dhe futet në brigadë. Pas tri ditësh, kishte ardhur urdhri që ai grup ushtarësh ta

lëshonte atë pozicion dhe të shkonte për Prizren. Me atë brigadë kanë shkuar për Prizren. Atje diku është takuar me Tefikun, sepse edhe ai prej kaçakut kishte hyrë në brigadë. Atje, pra, janë takuar babë e djalë.

Hafëzi nuk kishte qëndruar gjatë në brigadë; mbase më pak se dy muaj dhe është kthyer në shtëpi, kurse Tefiku kishte mbetur në brigadë rreth tre vjet. Dhe, për tre vjet vetëm një natë ka qëndruar në shtëpi. Madje, një kohë, rreth nëntë muaj, nuk e ka ditur askush se ku është. Baba Hoxhë brengosej shumë. Ai thoshte: njëri më shkoi (fjala është për Ilmiun, të cilin e kanë ftuar në bisedë informative në Gjilan dhe, nga fundi dhjetorit 1944, nuk është kthyer kurrë i gjallë), tash edhe tjetri.

Për ndihmesën që i kishte bërë axha Hasan, baba Hoxhë ishte shumë mirënjohës. Ai thoshte se, përveç Hasanit, kush nuk e ka bërë një gjest të tillë, pra të më mbante mua në një dhomë si kaçak, kurse në dhomën tjetër pjesëtarët e brigadave partizane, këtë, vërtet, kush s'e ka bërë. Pra, Hasani e kishte futur kokën në gërshtë për dhëndër.

Por, edhe Arifi Dalipit, në rastin e babës Hoxhë, e ka ruajtur fshehtësinë. Arifi ka qenë korrier në komunën e Roganës dhe disa herë ka qenë i angazhuar nga Hafëzi, por kurrë, deri në vdekje, nuk ka treguar për angazhimin e Hafëzit si kaçak ose për veprime të tjera patriotike.

Komuna ka qenë në Rogoçicë, por stacioni i xhandarmërisë në Karaçevë.

4.

## **Kthimi i Tefikut nga Tirana**

Aga Tefik, në krye të tre ose katër muajve pas martesës, ka shkuar në Tiranë. Motmot s'ka ardhur fare në shtëpi. Ka shkuar para Shëngjergjit, kur ka ardhur në pushim tri javë para Shëngjergjit, pas motmoti.

Kur erdhën, te Zabeli krisën pushkët. Kishte qenë me Xhemailin. Në Tiranë kishte qenë shumë në rrezik. Thoshte se e kishte shpëtuar Xhemaili, sepse për

asnjë moment ai nuk ishte ndarë nga ai. Atje kishte marrë një punë me përgjegjësi. Tregonte se si Xhemali kishte qenë shumë i lidhur me Tefikun; thoshte: “Ai edhe kryet do ta jepte për mua”.

Pasi ka hyrë regjimi komunist, Tefiku është kthyer nga Tirana. Një kohë ai kishte qëndruar diku përtej Gjilanit, afër gjashtë javë. Nga Tirana ishte kthyer bashkë me Durakun e Rexhepit dhe Hasan Shaban Dërmakun. Atë natë kishte ardhur edhe Ilmiu, që ishte nëntoger i ushtrisë, por prej aty e kishin hequr dhe e kishin transferuar në Hogosht, te Mulla Idrisi. Ekremi i kishte bërë një pesë-gjashtë muaj, sepse ai kishte lindur gjashtë javë pas Shëngjergjit (korrik 1944), ndërsa kjo ngjarje ishte dy javë pas Shëmitrit.



*Tefik Sh. Kallaba 1922 - 1984*

Në mëngjes, kur erdhi Tefiku me Durakun, sapo kishte rënë një flluskë bore. Ata kishin hyrë në odë, që të mos vëreheshin fare nga kojshitë e tjerë, madje as nga kushërinjtë. Erdhi poshtë, ku rrinim ne anëtarët e tjerë të familjes. Ilmiu, po bëhej gati për të shkuar në Hogosht. Nëntoger i ushtrisë ka qenë, nuk ka pasur asi njeriu; e kish qit atë farë pallte krahëve, një pallto italiane, pa krahë fare. Baba Hoxhë ishte në njërin dhomë e në tjetrën Ilmiu. Në një moment ia behu Tefiku në korridor, Duraku kishte mbetur në odë, sepse po priste që të dilnin në mal, kaçakë. Tefiku hyri te baba, e përshëndeti. Në atë moment hyri edhe Ilmiu, që ishte bërë gati për të shkuar në Hogosht. “O babë”, iu drejtua Tefiku babës Hoxhë, “edhe ti e edhe Ilmiu duhet të dilni në mal, sepse në Gjilan kishte hyrë ushtria. Dje, ne na arrestuan disa ushtarë dhe na futën në burg. Shpëtuam falë një korrieri, që e kishte prerë telin dhe na tha që të shkonim në filan vendin e të iknim, se ndryshe në mëngjes do të na pushkatonin, si ushtarë të Tiranës që ishim. Unë desha ta shpëtoja bacën Ilmi, që të mos qëndrojë në Hogosht.” Ilmiu përpiqej ta bindte Tefikun se ajo ushtri ishte e Mulla Idrisit, që ka ardhur nga Tirana. Tefiku i tregonte Ilmiut se si atë e kishin burgosur bashkë me Durakun dhe Hasan Shaban Dërmakun. “Unë, bacë, po të them kështu, të lutem, mos shko”! Në atë moment kishte ardhur Emini i Syliqëve, me të cilin

kishin banuar me një shtëpi. “A po e sheh, Emini po shkon për t’i marrë teshat në Gjilan”, - i tha Ilmiu babës Hoxhë. Baba po i thotë: “Mos, bre, se Tefiku e di më mirë, sepse paska qenë në këtë zjarr, mos shko”.

“Jo, s’ka çka më bën mua asgjë kurrkush; s’i kam bërë kurrkujt kurrgjë. U çua Ilmiu e s’futi bukë në gojë e as kafe s’piu; ndoshta vdekja e kishte tërhequr. Vetëm nja dy vezë m’i ziej, më tha. Ia zjeva e ia qërova. Doli shpejt te dyqani dhe kishte blerë një thes me dardha ujëse, të cilat na i ndau të gjithëve. U nis drejt lumit për në Gjilan. Me shikim e përcollëm deri te zabeli. Të nesërmen na erdhi lajmi se Ilmiu ishte burgosur. Lajmin na e solli Jakup Karaçeva dhe një i Velegllavës. Erdhi baba e tha: “Oh, Ilmi s’kam më”. Si sot më kujtohen ato fjalë, derisa po pinte kafe, dhe sërish përsëriti: “Oh, Ilmi s’kam më”.

Atë ditë gatuam bukë dhe i mbushëm një palë duqe; Nazmiu ka vuajtur shumë i gjori. I mori duqet dhe ashtu nëpër “zjarr” e nëpër brigada ka shkuar në Gjilan për t’ia dërguar bukën në burg. Bashkë kishin qenë edhe Alush Hogoshti, Ahmeti i Velegllavës dhe një i Karaçevës. Kur ia kishte çuar atë ditë bukën Ilmiut, roja e kishte pranuar për t’ia dhënë pastaj Ilmiut, ndërsa Nazmiu nuk e kishte parë fare vëllanë. Të nesërmen sërish u desh t’i dërgohej bukë. Në fushë po fshinin grurë spahinjë: Muharrem Kopërnica e Sylë Kopërnica. Pra, ne gratë të nesërmen sërish gatuam për Ilmiun. Sërish Nazmiu e mori bukën dhe u nis për në Gjilan. Kur e kishte çuar atë ditë, sërish ia kishin pranuar ushqimin. Të tretën ditë, ata e kishin pas mbytur. Kështu, kur e kishte çuar bukën, ata të burgut i kishin thënë Nazmiut që të shkonte hoxha vetë, se do ta lironin Ilmiun. Në fakt ata kishin dashur që ta likuidonin edhe babën Hoxhë. Erdhi Nazmiu e po i thotë babës se duhej të shkonte ai, ashtu i kishin thënë ata të burgut. Baba Hoxhë nuk kishte pranuar të shkonte, duke qenë i vetëdijshëm se çfarë kurthi po i përgatitej. Xhyherja (gruaja e Ilmiut) po qante, krejt po qanim, shpresonim që do të shkonte baba për ta nxjerrë nga burgu. Por, babën nuk e zuri as akshami në shtëpi. Shkoi në mal dhe dy muaj nuk erdhi fare në shtëpi.

Pas rreth një jave na rrethuan një grup ushtarësh. Poshtë e kemi pasur kuzhinën verore. Unë shkova atje, kurse të tjerët ishin krejt lart. Ne nuk kishim asgjë të plaçkës, por islamajt e patën sjellë një sharrë. Nona Sanije kishte frikë se do ta gjenin sharrën e do të na nxirrnin probleme. Çështje e vërteta, ata kishin ardhur për ta kërkuar Tefikun. Me ta kishte qenë edhe kushëriri, Aliu i Jasharit, dhe njëfarë Toza. Aliu, më duket ka qenë udhëheqës i fshatit. Kur na rrethuan, Aliu

dhe Toza na thanë: Mos lëvizni! Në kuzhinë ishim vetëm unë dhe Zehra duke gatuar; të tjerët ishin të gjithë lart. E vura një bukë në çerep dhe doja t'ia hedhja pak prush. Ndërhyri Aliu: vetëm një kaci prush! Kështu, pra, ia kam hedhur çerepit një kaci prush dhe, bashkë me Zehrën, jemi mbështetur njëra pranë tjetrës. Aliu dhe Toza na thanë: mos bëzani, nuk kemi ardhur për të kontrolluar nëse keni plaçkitur gjë, por këta po i kërkojnë Hoxhën dhe Tefikun. Zehra u shastis nga frika. Lart, në katin e dytë, ishin fëmijët dhe Nona Sanije. Më i madhi djalë, që kishte mbetur në shtëpi, ishte Faiku, të tjerët patën ikur në mal. Ushtarët hynë gjithandej. Me thika të vendosura në pushkë shponin gjithçka e gjithkrah: në dërrasa të odës, në dhomën time, në miell e ku jo. Kërkuan edhe në oxhak. Ushtarët ishin pozicionuar në çdo cep të oborrit. Njëri me një mashinkë ka qenë te dyert e oborrit; një tjetër te bunari. Pak më andej ishin edhe dy mashinka në gatishmëri. Njerëz kishte gjithandej, shumë njerëz në oborr kishte. Unë dhe Zehra mbetëm poshtë, të tjerët lart. Zehra ishte e fejuar, kurse unë isha nuse e re, ende pa i bërë dy vjet. Nona Sanije ishte shqetësuar tej mase. I harruam të vdekurit, na hyri frika për të gjallët. Në fakt, atë ditë na pati informuar dikush, Aliu apo nuk e di kush, i kishte thënë Zehrës: vetëm diçka të Tefikut nëse gjendet; ndonjë shkrolë a fotografi, apo çfarëdo dokumenti, kanë për t'ju djegur të gjithëve. Gjithçka që ishte e Tefikut; fotografi, tesha, e deri te ndërresat e fjetjes i patëm djegur. Zehra pati arritur, duke rrezikuar shumë, ta fshihte vetëm një fotografi në këpucën që e mbante mbathur. Tefiku, si ushtar i Xhafer Devës që ishte, nga Shqipëria pati sjellë tesha të mira, të prodhimit italian. I dogjëm të gjitha, përveç asaj fotografie. I njoftuam edhe Jasharët dhe gjithandej nga kishim akraba që t'i digjnin fotografitë e Tefikut, sepse, nëse vetëm një fotografi gjendej, e pësonim keq. Më vonë kanë ardhur edhe një herë për të na kontrolluar, dhe më pas nuk kanë ardhur. Toza na tha: mos u brengosni, se juve nuk ju bëjnë asgjë, nëse nuk gjejnë diçka nga Tefiku, pasi ju anëtarët e tjerë nuk jeni gabim.

Baca Ilmi humbi, e mbytën apo nuk e di çka u bë me të, tash edhe Tefikun po e kërkojnë!? Zehra e unë u bëmë dhë. Edhe baba Hoxhë humbi. Ai fshihej sa në Breznicë, sa te Sylja i Jetës në Rogoçicë ose te miqtë në Krenidell. Më pas erdhën për ta kërkuar edhe Fehmiun. Humbi edhe Fehmiu, edhe atë e morën apo nuk e di çka u bë.

Kur e ka marrë Faikun narodna ordbrana (ushtria popullore) na u ka dhimbsur shumë. Disi e kanë grabitur. Kanë ardhur te dyert, veç ia kanë hedhur një ranac



(çantë shpine) në shpinë dhe e kanë marrë me vete. Ai i shkreti ishte me do done të holla e të konopta, që i përdorte edhe si pantallona. Bashkë me Faikun dolën për kapixhiku. Atë ditë në Krenidell është plagosur Sahiti Agushit edhe është vrarë Zuka i Agushit. Këta të ushtrisë popullore e kishin vrarë.

Një mbrëmje, pak para se të praronte dielli, erdhi Aliu, ai ecte me ata, e i tha nonës Sanije: Oj Sanije, mos ia çelni derën askujt. Ne nusët mbetëm me tre djemtë e vegjël: Nazmiun, 14-15 vjeç, Hysenin e Tahsinin e vogël dhe Zehrën. - Bukë mos i jepni kujt, përveç meje dhe Tozës, na thanë edhe një herë, ngase ne i gatuanim nga 10-15 bukë dhe i linim te dyert. E kemi pasur një dritare të vogël. Erdhi Aliu e po thotë: Si të mundeni deri në mëngjes t'ia bëni gati Faikut një palë done, një këmishë e një palë çorapë, sepse nesër ai kalon me këta të mbrojtjes popullore, ndërkaq unë flas me Faikun dhe ai, kur të kalojë këtëjpari, i merr. Mos dilni ju për t'ia dhënë, vetëm ia lini ndër dyer.

Tërë natën punuam për t'ia bërë gati ato tesha. E çelëm një këmishë të Tefikut, e prishëm një mbulesë për t'ia qepur një palë done, pastaj për gryke të këmishës i futëm do çorapë, e krejt ato në një strajcë prej kërpi (t'konoptë). E zhytëm strajcën që të mos bjerë në sy.

Aliu i tha nonës Sanije që, kur të kalojë këndej brigada, ata kthehen, e marrin bukën te dyert, e ti shpejt e lë edhe strajcën. Në kohën e caktuar, që ishte marrë vesh me Aliun, doli nona Sanije dhe e la bukën. Pasi ata e morën bukën, shpejt e shpejt e futi strajcën ndër dyer. Ishte situatë shumë e vështirë. Ja, ka ardhur evlati, e ka marrë strajcën te dera e shtëpisë, kurse nëna as që ka guxuar ta shihte e le më të fliste me të, sepse kishte frikë që do të vinin e do t'i merrnin edhe këta të tjerët.

*Ju, për kë gatuanit?*

Për shkiet (serbët).

*A me zor ata ju shtinin të gatuanit?*

Po, në çdo katund, secila shtëpi duhej të gatuate. Kështu vinin dhe e merrnin bukën të cilën ua dërgonin partizanëve. Dhe jo vetëm bukë. Ata merrnin edhe dimi, këmishë, shami e çka jo. Lahore (lloj pëlhure për gra), kanë marrë lahore. Në brigadë ata kanë pasur edhe partizane. Atyre u kanë vënë vathë, lira, rruaza e gjithçka.

Më pas nuk dëgjuam gjë për Faikun. Humbi edhe ai. Një kohë të gjatë nuk e kemi ditur se nga kishte shkuar. E kishin pas mobilizuar dhe e kishin dërguar në Nish. Ai kishte qenë i angazhuar në njësitin e sanitarëve, për të dhënë injeksione. Kur e pati lëshuar ushtrinë, i pati sjellë të gjitha pajisjet e veta për dhënien e injeksioneve.

Më vonë erdhi në Gjilan. U begenis me Hatixhen e u martua. Nuk e di çfarë ndodhi, këtu nuk mundi të gjente ndonjë punë, kështu që u detyrua të shkonte për punë të përkohshme në Beograd. Faiku ka bërë jetë të vështirë në Beograd. Më kujtohet kur njëherë më rastisi të shkoja në Beograd, për shërim të djalit - Nijaziut dhe të flija një natë në banesën e Faikut. Edhe ahuri ynë i kafshëve ishte më i rregulluar sesa banesa e tij. Aty banonin edhe Aliu i Muhaxhirëve (vëllai i Ilazit), një Sherifi i Breznicës e ndonjë tjetër.

5.

## **Qëndrimi i Naxhijes në spital, në Beograd**

Gjatë pushimeve verore Tefiku shkonte në kurse pedagogjike, që organizoheshin në qytete të ndryshme të Kosovës, si: në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan etj. Ai donte të aftësohej sa më shumë që ishte e mundur për profesionin e mësuesisë. Aktualisht ishte mësues në Busavatë, por pritej që nga 19 shtatori 1950 të fillonte punën në Kopërnice. Gjatë verës unë qëndroja kryesisht në Rogoçicë. Sidomos javët e fundit të shtatzënisë i kaloja në Rogoçicë. Në fshat nuk kishte ndonjë mami që ta ndihmonte lindjen, por gratë e moshuara e kishin atë përvojë, sa për ta ndihmuar lindjen. Tashmë prisja ditët e fundit të lindjes së radhës. Fëmija i fundit, Rexhepi, më kishte vdekur pas nja gjashtë muajsh jetë, kështu që bëja kujdes të shtuar për këtë shtatzëni. Nuk e dija nëse ishte femër apo mashkull. Sidoqoftë lutesha që ai/ajo të lindte normalisht dhe pa komplikime.



*Naxhije Kallaba duke rrëfyer për qëndrimin në spitalin e Beogradit*

Të martën e 10 shtatorit 1950, në mesditë, lindi një fëmijë. Ai ishte djalë. Këtë gëzim dikush prej burrave e kishte shprehur me krismë pushke. Familja Kallaba u shtua edhe me një anëtar të ri. Pas pak erdhi edhe vjehri im, baba Hoxhë i thosha, i cili kishte qenë në xhami për ta falur namazin e drekës. I ishte gëzuar tej mase sihariqit që e kishte marrë nga bashkëshortja e tij, Sanija, për fëmijën e sapolindur. Djemtë, Fehmiu, Nazmiu e Hyseni (të tjerët nuk ishin hëpërhë në shtëpi) sapo kishin sjellë në oborr disa duaj misri, tramakët e të cilëve duhej të qëroheshin e të hidheshin në koshin e punuar enkas për misër, që ishte jo fort larg bunarit. Ishte një verë e thatë, pa shira të mjaftueshme. Kunatat dhe fëmijët e rritur ndërprejnë qërimin e tramakëve. Muharremi dymbëdhjetëvjeçar ishte përkujdesur që të ndante anash disa shtalpakë misri. Aty ishin edhe Sahadetja, Ekremi e Ismetja. Dhoma ku isha e shtrirë, tashmë u mbush me gra. Nga dhoma doli Lalifja, që kishte luajtur rolin e mamisë. Sapo ia lidhi kërthizën djalit të vogël. Burrat rrinin veçan në një dhomë tjetër, por gëzimin gjithsesi e shfaqnin hapur. Që më parë ishte planifikuar edhe emri për fëmijën e sapolindur. Emrin Nijazi e kishte miratuar edhe baba Hoxhë, por e kishin pëlqyer edhe të tjerët. Djali i madh, Ekremi tashmë kishte mbushur gjashtë vjet dhe do të regjistrohej në klasën e parë. Krenarinë e tij për vëllanë e vogël shkoi për ta shprehur te kushërinjtë e tjerë. Jeta në bashkësi nuk ishte edhe aq e lehtë. Familja ishte e madhe, kurse ne nuset e reja kishim goxha angazhime për të pritur e për të përcjellë mysafirët e shumtë. Pastaj edhe punë fushe kishte mjaft. Tefiku, pas kursit veror në Pejë, ishte i zënë me transferin nga Busavata në Kopërnice. Te dyert e oborrit kishte dalë Ekremi për t'ia dhënë sihariqin për Nijaziun. Madje edhe ia kishte kërkuar shpërblimin për këtë sihariq. Nga xhepi i vogël i pantallonave kishte nxjerrë një pesëdinarësh, ia kishte lëshuar në dorë dhe e kishte përqaftuar. Më pas kishte shkuar në odën e babës Hoxhë, për t'ia uruar nipin e pastaj erdhi edhe tek unë. Urimet për Nijaziun kishin vazhduar edhe nga kushërinjtë. Udhëtimi disajavor Rogoçicë - Kopërnice i ishte mërzhitur, kështu që në Kopërnice zë një banesë me qira dhe vazhduam të jetonim atje.

Pas nja dy vjetësh u sëmura. Nuk ndihesha mirë me shëndet. Kisha probleme me një gisht dore, i cili më kullonte vazhdimisht gjak. Nuk kisha lënë ilaç pa përdorur. Madje i kisha hedhur edhe helm gjarpri, sepse kështu më kishte thënë dikush.

Në vjeshtën e vitit 1952 Nijaziu ishte sëmurrur. Përkushtimi i Tefikut për mësimdhënie, duke punuar, jo vetëm në shkollë, por edhe me kurse për analfabetë

dhe kurse shëndetësie për femra, kishte lënë paksa anash përkujdesjen ndaj familjes. Mosdërgimi me kohë i Nijaziut te mjeku i kishte kushtuar fëmijës me sëmundje. Disa kontrollime në Gjilan e Prishtinë nuk kishin dhënë rezultate. Nga mesi i nëntorit, Tefiku kishte marrë leje nga Drejtoria e arsimit për ta dërguar fëmijën për shërim në Beograd. Po atë ditë të së hënës së 10 nëntorit Tefiku kishte marrë nga mjeku një udhëzim për shërimin e Nijaziut në spitalin për fëmijë, në Beograd.

Në mbrëmjen e 11 nëntorit udhëtuam gjithë natën me tren, nga Bujanoci deri në Beograd, për t'u paraqitur sa më herët në spital. Nuk më kujtohet si quhej ai spital. "Nuk dija shkrim-lexim; nuk dija as të flisja serbisht". Në spital më pranuan mua bashkë me djalin – Nijaziun. Më caktuan në një dhomë me disa pacientë - fëmijë të tjerë që shoqëroheshin nga nënat e tyre. Tefiku mori fletëpranimin dhe librezën e shëndetësisë e m'i futi në një kasetë afër shtratit. Në korridor foli edhe një herë me doktorin e u kthye sërish tek unë. U foli serbisht edhe shoqeve të dhomës. Asgjë nuk kuptova. Ato vetëm buzëqeshën kur ky u tha: dovigjenja. Nuk e dija kuptimin as edhe të kësaj fjale.

Tani mjekët u morën disa ditë me analizat e sëmundjes së djalit. Uroj të bëhet mirë, lutesha unë!

Mua më duhet të kthehem në punë, e kam një prush nxënësish të vegjël që më presin në shkollën e Kopërnicsës, më tha Tefiku. Isha duke i dhënë gjë Nijaziut, për ta qetësuar paksa, kur Tefiku e puthi djalin në ballë dhe doli në korridor. Hapat e tij i dëgjova deri te shkallët, në fund të korridorit. Ajo jehonë e hapave më shoqëroi edhe dy-tri ditë të tjera. Ku më la kështu e si më la vetëm, ishte mendimi i cili do të sillej në kokë javët në vijim.

Isha e lodhur nga udhëtimi. Gjumi më kishte zënë duke i dhënë djalit gjë. Si në ëndërr dëgjova një zë kumbues: dobar dan, pastaj edhe një herë: dobar dan. Hapa sytë. Në fund të shtratit një grua e veshur në të bardha, korpulente e me flokë të rregulluar, mbante në dorë letërpranimin e vendosur mbi një pllakë të alumintë. Nga fjalët që m'i foli, e kuptova vetëm fjalën injeksion (injekciju). Me gjasë Nijaziut do t'i japin injeksion, kujtova! Nga xhepi nxori një termometër, të cilin u afrua dhe ia futi djalit nën sqetull. Hapi dorën dhe, duke m'i treguar pesë gishtat, më tha se duhej ta mbante pesë minuta. Po, ia ktheva shqip. Ajo vazhdoi te gratë e tjera, që ishin në dhomë. Mallkova veten që s'dija së paku

disa fjalë të gjuhës së tyre; mallkova edhe Tefikun, që më la në këtë gjendje. Në radhën time ishin edhe tre shtretër me pacientë. Përballë ishin edhe katër të tjerë. Më shikonin çuditshëm, apo ndoshta vetëm mua më dukej ashtu. Pas gjidhënies, edhe Nijaziu u qetësua paksa. Infermierja u fut sërish në dhomë. Isha e para në shtratin majtas, te dera. Nga nënsqetulla e Nijaziut nxori termometrën dhe shënoi diçka në letrën e varur në fund të shtratit. Nga lëvizja e kokës së saj kuptova se djali nuk kishte temperaturë. Ajo vazhdoi më tutje, kurse unë ia shtrëngova edhe pak lidhësen e çarçafit mbështjellës, brenda të cilit kishte edhe një pelenë. Fëmija ishte hafif. Vetë u tërhoqa pak prapa, për t'u mbështetur për muri. Qëndrimi ulur më kthjelloi paksa. Sikur kisha nevojë për ndonjë komunikim. Të njëjtën gjë e vëreja edhe te shoqet e dhomës. Njëra nga shtrati përballë më foli diçka, por vetëm e shikova dhe rrudha krahët. Kureshtja theu edhe një herë qetësinë. Flisnin diçka ndërmjet vete, kurse unë vetëm i shikoja. Dhe, kështu disa ditë. Të gjitha atyre u vinte dikush në vizitë, vetëm unë nuk kisha askënd. Mërzitesha tej mase. Mjekët na vizitonin çdo ditë, por nuk ndërmerrnin asgjë. Nuk e kisha as idenë se ata e kishin marrë mostrën e gjakut të djalit dhe po prisnin analizat.

Pas nja tri javësh, erdhi infermierja me një grua tjetër. Kishte qenë italiane, por kuptonte nga pak shqip.

*- Fole një gjuhë, më tha.*

S'di, ia ktheva.

*Po, qysh ti burrin uçitel (mësues) e mos me ditë një gjuhë me folë?*

Po, s'di, ia ktheva sërish.

*Prej nga je me familje nga babai?*

Prej Krenidelli.

*Çfarë qyteti është ai?*

Vetë me vete thashë: po ta dije ti, ai është qytet krejt me lisa.

Disi u lirova me të, e i thashë: emri, mbiemri Kallaba.

*Po, ulica?*

Jo, vallahi, ulicë s'dimë atje.

Vetëm ajo italianka fliste.

*E si quhet ai vend që ta thërrasim me telefon?*

Pasha Zotin atje te na nuk ka telefon, i thashë. Ajo infermierja i tha diçka dhe sikur fjala i mbeti në gjysmë, ndërkaq kjo italianka përktheu: nesër do të vijnë

me ta marrë djalin, me ta pre, se jetë nuk ka. Duhet të vëmë gjithqysh kontakt me burrin tuaj.

Ti je shqiptare dhe gjuhën s'po e di, se po të ishte puna për ne ose po ta dije ti gjuhën, s'na kishin pyetur fare. Sidoqoftë, shiko atë ndërtesën pesë-gjashtëkatëshe matanë. Atje do të dërgojnë, tha italianka. Pastaj më tha: - ja, ajo vajza shqiptare, që ishte po ashtu në dhomë dhe po vuante nga saraxha (sëmundje e gjëndrave të qafës, të cilat ënjten, hapen plagë dhe kullojnë) di të flasë shqip. Ishte nga Shipashnica e Epërme, mbesa e Ismet Dërmakut. E kishte dhe një motër të martuar në Muhoc, kuptova më vonë.

Tek ajo ndërtesa do të dërgojnë nesër, por djalin mos ua lë. Më thuaj edhe një herë ku të punon burri uçitel? Thashë, numrin nuk po e di, në Kopërnice, po m'u kujtua Hogoshti e i thashë: kërkoheni në stacionin e milicisë në Hogosht.

E kërkuan përmes stacionit të milicisë, por ai kishte qenë në Busavatë; po i martohej një shok - Veli Busavata (Maliqi).

O Zot, ai paska shkuar në dasmë, kurse gruan e ka lënë, bashkë me djalin xhenaze, në spital.

E desha djalin. Në trup e kishte një rend hajmali të lidhura në pe. Kur i pa një pastruese, m'u afrua e më tha: hiqi, se po vjen dikush e po t'i vjedh këto para që t'i paska lënë burri. Hm, vetë me vete thashë: këto s'janë para, por hajmali. Edhe një vath më mungonte në vesh. M'u pat këputur sa isha në shtëpi, por, e brengosur për djalin, e kisha harruar mungesën e vathit. - Po vathin, mos ta ka këputur ndonjë nga gratë këtu, shfaqiq brengën e saj, pastruesja. Jo, më është këputur në shtëpi, i thashë. Atëherë, hiqe edhe këtë tjetrin, por fshihi edhe ato para që t'i ka lënë burri! I mbështolla mirë e mirë dhe i futa nën jastëk. Sakaq erdhi doktori, një njeri trupmadh e me sy të mëdhenj. E mori e po e kontrollonte djalin...

Pas pak, prej jashtë rrethojës së spitalit, po thërret një njeri. O Zot, nuk e njihja fare kush ishte ai njeri. Një serbe ia kishte dhënë një mantel të bardhë që të mund të futej brenda rrethojës. Kishte qenë një Sadik Maliqi i Busavatës. Edhe ai po jetonte e po punonte në Beograd. Kishin qenë bashkë me Tefikun në dasmë te Velii. Atë e kishte porositur që të më vizitonte dhe të më porosishte që t'i dërgoja një telegram në stacionin e Hogoshtit.



I thashë, as telegram në stacion e as kurrëgjë, por po vij me ty dhe po të lutem që të më dërgosh në Rogoçicë. – Jo, nuk mundem, më tha! Isha tejet e shqetësuar. Thënë realisht, sa për Tefikun isha e gatshme që të udhëtoja me atë njeri nga Beogradi për në shtëpi, por, disi, më kaploi një frikë nga baba Hoxhë. Pa e përfunduar unë mendimin, ai ma preu: Me mua janë këtu tu punue edhe Faiku, Salihu e Aliu, të gjithë nga Rogoçica.

- Çka, këtu është Faiku, a? Shih ti shih, thashë më vete, si nuk i ka treguar vëllait të vet, Faikut, që jam në spital. Më kaploi një sëkëlldi e madhe e iu drejtova Sadikut: - për dhjetë minuta të ma sjellësh këtu Faikun!

S'vonoi shumë dhe erdhën Faiku e Salihu bashkë. Ua shpjegova gjithë situatën rreth sëmundjes së djalit. Edhe ata ishin të mendimit që djali të operohej dhe të shihej se çfarë sëmundje kishte në kokë, por...

Faik, iu drejtova kunatit tim: për riza të Zotit, më ço në shtëpi, se nuk dua të qëndroj këtu. Kisha edhe një problem me dorën time; gishti tregues i dorës së djathtë më kullonte gjak në rrënjë ku ngjitet me shuplakën. Ndërkohë erdhi doktori. Në një legen hodhi tri lloje materialesh, nuk e di nëse ishte gur kali apo çka. Pastaj djalin e ktheu përmbys dhe po e inhalonte.

Faiku i tha doktorit se kjo kurrsesi nuk po dëshiron të qëndrojë këtu. Po thotë se ka për ta mbytur veten dhe nuk rri më shumë këtu.

Doktori e pa se dora më kishte shpërthyer dhe gjaku rridhte vazhdueshëm. Atëherë ma pastroi plagën e ma lidhi mirë e mirë. M'i dha edhe disa ilaçe e më tha: mos ke frikë, do të shërohet. Ma përgatiti edhe fletëlëshimin, të cilin e kam ruajtur deri vonë, ngado që kemi shkuar me Tefikun. Faiku e pyeti se çfarë sëmundje ishte kjo; mos ishte saraxha ose ndonjë sëmundje tjetër ngjitëse apo çka?

“As s'ka saraxha, as varrë të keqe, as s'ka varrë ngjitëse”, tha doktori, kjo është pasojë e një ndrydhjeje të damarit, dhe ai nuk shërohet pa shpërthyer diku tjetër, por me këto ilaçe do të shërohet.

Tashmë kishin kaluar tri javë qëkur kisha ardhur në spital, më saktësisht 23 ditë. Nga biseda e Faikut me doktorin, nuk arrita ta kuptoja pse ai, doktori, nuk e kishte kundërshtuar vendimin tim.

Doktori edhe një herë ma shikoi dorën, bëri edhe një fotografi rëntgeni. E shkroi një letër dhe ia dha Faikut. E kishte porositur që të paraqitesha te një mjek në Prishtinë dhe se nuk do të kisha probleme të mëtejme. Derisa po e shikoja dorën e lidhur, iu drejtova edhe njëherë Faikut: - Faik, kofsh turk, më nxjerr prej këtu, se do të më vdesë djali. Më mirë të më vdesë në shtëpi, sesa këtu. – Nuk jam turk, ma ktheu Faiku, por shqiptar dhe qeshi me thënien time “kofsh turk”.

Pak pa perënduar dielli, Faiku rregulloi dokumentacion për lëshimin e spitalit dhe u nisëm drejt qytetit. Me ne ishte edhe djali i axhës, Tefikut e Faikut, Salihu i Mulla Ibrahimit.

Ishte bërë tepër vonë për të zënë trenin për Bujanoc. Ajo natë duhej kaluar në Beograd, por Faikun e kishte kapur një brengë. Të më çonte në hotel, ishte e kushtueshme, ai nuk kishte para. Atëherë m'u drejtua: Oj Naxhije, a bën që sonte të flesh në atë dhomën ku po fle unë me shokët e mi. Ata punëtorët le të shtrojnë në një qosh e ti të flesh në një qosh tjetër.

Çka, thashë, ti veç më nxjerr prej këtu, se unë në një strehë fle, vetëm të dal prej këtu. Pas pak arritëm në banesën e tyre. O Zot, ku kishin banuar Faiku e vëllai tjetër, Tasini, dhe të tjerët. Tasini nuk ishte momentalisht aty; ishte në Kosovë. Çfarë mjerimi?! Kur hymë brenda, punëtorët kishin qenë duke ngrënë darkë. Pas darke u mbledhën të gjithë ata në një qoshe: Salihu, Aliu i Muhaxhirëve, Sherifi i Breznicës (vëllai i Rexhijes), na e lëshuan mua e Faikut një vend nga dritarja. Sa qe nata e lume djalin e mbajta në krahë, kurse Faiku u mbështet pak, se ishte lodhur në punë.

Të nesërmen u zgjua Faiku e hipëm në një vagon për të dalë te “brzi” për të ardhur në Bujanoc. Çka është ai “brzi” nuk e dija unë. E Faiku e zuri njëfarë, ku ta di unë çka ishte ai tren, por jo të hipnim nga duhet, po prej prapa, madje fshehurazi. Nuk e di a ishte ai ndonjë tren i punës a çka ishte, por unë hipa disi aty, edhe pse barkun e kisha sa një kosh (isha shtatzënë me foshnjën e ardhshme - Xhevdetin); ani, thonë e qet fëmijën nga lëvizje të pakontrolluara. Po lëre, ore, pasha Zotin, kur kam zbritur prej trenit, duhej si shpejt e shpejt, e kërceva hop e bum prej së larti. E ja, sot, Xhevdeti si ujk.

Nejse, hipëm në atë “brzin”, a si po i thonë, e erdhëm para mëngjesit në Bujanoc. Ishte shumë herët dhe duhej të pushonim diku. Hajde e shkuam te

dada Cevë, (Selvija - motra e Musahut). Ajo ishte e martuar në Tërrnoc me Xhafer Sylejmanin. Isha lodhur për ato tri javë sa qëndrova në spital. Thosha, vetëm ta nxjerr djalin nga spitali, edhe në vdektë rrugës, dert së kisha. Kur shkuaam te dada Cevë, ata e kishin pas thyer duhanin e po ngjisnin në varg. Atje koftë, ma kapi dada Cevë djalin në dorë e m'u drejtua: uh, Naxhi, sahati mos ta nxëntë. Kjo e preku shumë Faikun, saqë iu mbushën sytë lot. Qysh, oj dadë, po thua kështu?! - i thashë. Dadës, ishalla në shtëpi të gjallë nuk e çon, përsëriti edhe një herë thënien e mëhershme! Me ne ishin edhe Sherifi i Breznicës e Aliu i Muhaxherve, si dhe kushëriri, Salihu. Të gjithë erdhën me ne. Ata nuk donin që Faiku të ishte i vetëm në këtë dhembje, sepse supozonin se djali mund të vdiste qysh rrugës, pa mbërritur në shtëpi. Pushuam pak, kurse ato gratë na përgatitën shpejt e shpejt edhe ushqim, madje kishin pjekur edhe kokrra të misrit me sheqer dhe na shtruan në sofër. Ende ishte herët, madje unë doja që sa më herët të arrija në shtëpi. Isha e gatshme edhe në këmbë të udhëtoja. Por jo, ata e kishin një gomar me të cilin do të vija unë në Rogoçicë, kurse të tjerët në këmbë. Na e dhanë edhe një djalë me vete që do ta tërhiqte e më pas ta kthente gomarin në shtëpi. Ai djali ishte memec, emrin e ka pasur Osman, prandaj dada Cevë m'i thoshte ato fjalë, që edhe një herë m'u përsëritën në kokë: "Nuk po të them halla që po ta dua të keqen për djalin, por me t'u çua, ka për të mbetur sikur djali im. Ma mirë le të vdesë e të hiqet prej dore. Ti nënë je, më tha, por si djali im të mbetet, pa gojë..."



*Nga e majta: Sanije Sulçiqi – Kallaba (bashkëshortja e Hafëz Kallabës) me vajzën Fetije Kallaba – Ismajli, në Roganë më 1969*

U nisëm prej Tërrnoci, unë hipur, bashkë me djalin në krah, mbi gomar deri mbi Hodonoc. Si sot më duket kur bënte shaka Sherifi me mua: “aaa nusja e Tefikut, shumë mirë: prej Beogradit me tren e prej trenit n’magar”.



*Njëra nga shtëpitë e Hafëz Kallabës, ku banonin Nazmiu e Hyseni me familjet e veta. Baba Hoxhë kishte edhe një Odë për mysafirë në veri të kësaj shtëpie. Kjo foto është e vitit 1983, kur pritej të rrënohej kjo shtëpi.*

Akoma pa lindur dielli arritëm në Rogoçicë. Të tjerët ishin zgjuar, kurse baba Hoxhë pasi e falte namazin e sabahit kthehej në shtëpi dhe e bënte edhe një sy gjumë. Ne hymë nga hyrja tjetër. Mua më kishte kapur uria, desh vdiqa urie. Nona Sanije erdhi e ma mbushi koritën me ujë, e futa djalin në të. Ishte i lodhur si të ishte i vdekur. Ndërkaq, unë thashë: ma sillni pak bukë. “Uh, kuçka e thiut, djali po vdes e ti edhe bukë po kërkon”, më bërtiti nona Sanije (vjehrra). Thashë, vallha, bre nonë, a e ke shti n’koritë, ishalla n’koritë vdes.

Veç bjerma do bukë ta ha, se kam vdekur urie, dhe vazhdova: a e solla të gjallë, a po e sheh të gjallë, po!... E, ajo mua çka s’më tha. Këto fjalë as baba Hoxhë nuk i priti mirë, por u përmbajt. Ndërhyri Faiku për ta zbutur situatën: O babë, mos ta zgjasim më shumë. Kjo është lodhur shumë, por sillna diçka të hamë e pastaj ju tregojmë për krejt rrjedhën e rastit. Na kthyen bukë e lëng derisa u ngopëm me Faikun.

Mua më vinte marre, por Faiku pyeti se ku ishte Tefiku. Thanë se ishte në Kopërnice, s'kishte ardhur fare; se Ekremi ishte në shkollë atje; çka i bën: evlat ky, evlat ai.

Në mbrëmje, pasi hëngrën darkë, kunatat: Xhyherja e Hatixhja shpejt e shpejt ma rregulluan dhomën. E vendosëm edhe një koftor e po rrimë aty. Atë natë erdhi Tefiku, për pushim të fundjavës. U mërzit fort për djalin, por nuk jepej.

Dukej qartë që djali numëronte orët e fundit të jetës. Ishte i lodhur sa s'ka më. Erdhën gratë e mëhallës, aba Rabë e aba Lalife. Ne po e ruanim djalin kur do të vdiste. Atë ditë, derisa po jepte ky shpirt, lindi Beqiri, djali i vëllait tim, Rasimit. Rasimi e kishte porositur Arifin e Dalipit, për të na treguar për djalin. Sa keq, u humba; nuk u kujtova t'ia jepja Arifit një peshqir ose ndonjë para për atë sihariq. Më kishte tronditur vdekja e djalit - Nijaziut pa e parë fare. Derisa po e ruaja unë djalin, baba Hoxhë më porositi: “unë po shkoj te xhamia”, në anën tjetër nona Sanije tha: “edhe unë po shkoj me mjelë buallicën, por me vdekë djali e mos me na bëza duke dhënë shpirtin, ti mos na prit”. Në kuzhinë kunata - Xhyherja po e ulte një bukë misri dhe e bënte gati për pjekje. Nga lodhja e tepërt, sapo e kam mbështetur kokën në kaptinën (kapësen) e djepit që ta shihja duke dhënë shpirt, se si m'u mbyllën sytë e më kishte zënë gjumi. Paj, të ishte i huaji, thotë njeriu, ia ka pasur inat ose nuk është brengosur sa duhet, por jo, djali më kishte vdekur para syve, pa e parë duke e dhënë frymën e fundit.

Në atë moment ka hyrë Myrvetja e axhës Islam brenda dhe ka bërtitur: oj inxhe, paska vdekur djali moj! Si e trullosur çova kokën e i thashë: shuaj, të lutem, mos kallëzo, se më mbyt baba Hoxhë. Pasha këtë nimet, m'i qittë sytë e mos luajtsha nga vendi, nuk u bëra merak që më vdiq djali, por vjen baba tash e më mbyt, çfarë i them atij. Veç kur u ktheva, nona Sanije që ish duke e mjelë buallicën bërtiti: Çka u bë, bre, a vdiq djali, a? Baba sapo hyri dhe më shikoi: çka u bë, bre bijë, babës? - O babë, pasha Zotin së pashë, më kishte zënë gjumi, po ta them të drejtën. Xhyherja në anën tjetër i tha: - o babë, pasha Allahun këtu kam qenë edhe unë, e kjo e ka pasur kryet përmbi djep, por e kishte zënë gjumi.

“Ani, ani”, tha baba Hoxhë e nuk më bërtiti. Nona Sanije pak më bërtiti, por edhe asaj ia tregova të drejtën”. Me dhembje të thellë, të dielën e 7 dhjetorit 1952, në praninë e familjarëve të ngushtë, Nijaziun e varrosëm afër vëllait të tij, Rexhepit, rrëzë mesit të murit verior të tyrbes.

## Foto e dokumente nga arkivi familjar



*Nëna Naxhije u dhuroi vazhdimisht për qafime fëmijëve, nipave e mbesave të veta*



*Nëna Naxhije në ditët e fundit të jetës së saj pranë djemve: (nga e djathta) Xhevdeti, Reshati, Selamiu dhe Elhamiu*





*Rasim Shabani (vëllai i Naxhijes) ndonëse në pleqëri të thellë, ai kishte kujtesë të madhe për shpjegimin e historisë së familjes së tij, dhe jo vetëm*



*Në periudhën e përgatitjes së këtij libri, nga prindërit Tefiku e Naxhija ende janë në jetë (nga e djathta) Xhevdeti, Selamiu, Reshati, Elhamiu dhe Drita (foto e shkrepur më 6.1.2018)*



*Rolanda, Tefiku, Reshati dhe Dea*



## VIII

# **Retrospektivë që do harruar**

*Çfarë kishe pasur dëshirë që nga historia e familjes sate të hidhje në shportën e harresës?*

**Kema:** Në secilën shoqëri ka situata që, pa dëshirën tuaj, të vendosin në anën e fajtorit, sidomos ata që nuk kanë aftësi ta lexojnë gjuhën e shtigjeve të gjata. Prandaj, në situata të tilla detyrohesh të qëndrosh oportunist. Këtë qëndrim do ta hidhja në shportën e harresës dhe do të investoja në kurajën qytetare. Dhe, kjo arrihet vetëm duke lexuar dhe duke përvetësuar përvoja të shteteve të zhvilluara. E, në këtë pikë, familja Kallaba nuk ka ngecur asnjëherë.

*Ka ndonjë situatë më konkrete nga e kaluara e familjes sate që do të dëshiroje vërtet të kalohej në harresë?*

**Kema:** Sigurisht që po. Dukurinë nga tregimi i radhës do ta hidhja në harresë të pakthim. Pra, pikërisht këtë rrëfim nuk po e tregoj për mburrje, por për të dëshmuar një dobësi të pararendësve të mi, e që duhet harruar. Prandaj, e kam titulluar:

## **Një ngatërresë që nuk duhej të ndodhte**

Salih Ramadan Kallaba kishte qenë një burrë zotni, por edhe shumë i lidhur me familjen dhe me krejt fshatin. Në pleqërinë e tij, e kur ishte ditë me diell, ai merrte një postiqe berri dhe rrinte kryesisht nën hijen e një lis-qarri të moçëm e me kurorë të madhe afër odës së tij. Shpesh, kur kalonte ndonjë kalimtar, ose ndonjë plak i katundit, i ofronte ujë për freskim ose e luste edhe për të pirë ndonjë kafe. Ishte i respektueshëm, por edhe dinte të respektonte të tjerët. Një ditë prej ditësh, teksa po e dridhte një cigare nën hijen e qarrit, pranë tij po kalonin nja dy burra të Bllatës. Ishte Dan Bllata me një të afërm. Ata e përshëndesin Salihun, e ky, që ish duke dredhur një cigare i drejtohet Danit, “Hajde e dredhe ni duhan, o Dan Bllata”. Dani u afrua, e drodhi cigaren, e falënderoi dhe brofi, paksa nervoz, në këmbë. “Kadal, he burrë, çka je sëkëlldis, dhe kah ia ke mësyë kështu?” - iu drejtua mixha Salih. Dani, me një zë paksa të egër, i thotë: “E kam ni punë te rrudhantë, se m’kanë shti n’bela e s’mund t’ua fali”. Mixha Salih, qysh

kishte qenë këmbëkryq e disi i kërrusur, drejtohet e ia kthen Danit me ters: “Po ti, a e di që unë jam një vëlla me rrudhantë, e sa për atë bela mundesh me krye me mue, pa pasë nevojë me shkue n’mahallë të epër!” Dani i merr këto fjalë me shumë seriozitet e ia drejton gishtin mixhës Salih: “Atëherë, pra, të koftë për hair belaja ty, o Salih Kallaba!” “Për hair m’koftë, o Dan Bllata dhe ule atë gisht di me t’thanë“, ia kthen Salihu dhe nxjerr kutinë e duhanit për ta dredhur edhe një cigare.

Salih Kallaba kishte pas qenë burrë azgan, por edhe Dan Bllata nuk ia kish pas lëshuar udhën fare. Pas një kohe, një natë vonë, vjen Dani me disa burra e duan ta sulmojnë Salihun në shtëpi. Atë mbrëmje te mixha Salih kish pasur mysafirë; në konak kishte qenë një dost i tij prej Berivojce, - Hysen Berivojca. Dani me shokë e shohin se para shkallëve kishte pasur shumë këpucë dhe kishin pritur goxha një kohë rreth bregut të lumit. Dikur vonë dalin mysafirët, që kryesisht ishin kushërinj të afërm, për të shkuar në shtëpitë e tyre. Brenda ishin marrë vesh që të nesërmen të dalin te arat rrëzë zabelit për ta prashitur misrin. Salihu del në prag të derës, i përshëndet dhe u thotë: “Nesër jeni argatë te Zabeli, e mos pritni me ju zanë dreka”. Dan Bllata, kur e dëgjon këtë porosi të Salihut, u drejtohet kushërinjve të vet: “Lene, se ket punë e kryejmë nesër te Zabeli“, dhe shkojnë edhe ata në shtëpi.

Të nesërmen, djemtë e Salihut: Islami, Ibrahim, Rexhepi e Shefkiu, bashkë edhe me kushërinj, po prashitnin te “Ara Osmanit” afër Zabelit. Në shtëpi, Salihu me vëllain, Aliun, e mikun Hysen Berivojca kishin pirë kafet e mëngjesit dhe po pinin cigare e po bënë muhabet. Ndërkohë hyn Metihja, gruaja e Salihut e po e pyet atë se kush ua çon drekën argatëve te Zabeli. Salihu i thotë që ta bëjë gati dhe se bashkë me Hysenin duan të dalin që ta shohin pak fushën dhe e marrin me vete. Ashtu edhe ishte bërë. Pasi falin namazin e drekës, i shalojnë kuajt, marrin edhe pushkët me vete, pastaj e ngarkojnë bukën në duqe dhe nisen për tek ara.

Nga ana tjetër, te Zabeli tashmë kishte ardhur Dan Bllata me burrat e vet dhe po pritnin momentin që, kur të afrohen argatët nga mali, t’i sulmojnë. Dani e sheh se nga fundi i arës po vinte edhe Salihu me mysafirin dhe ngutet që t’i sulmojë më shpejt. E zbraz një breshëri dhe një plumb e godet në këmbë Hysen Berivojcën. Atëherë Salihu gjuan me armë drejt malit; gjuajnë edhe Islami e Ibrahim, kurse Rexhepi niset duarthatë drejt zabelit. Kur e sheh Dan Bllata



vrapimin e Rexhepit të ri, u drejtohet të vetëve: mos shtini në këtë djalë të ri, se qenka trim i madh, dhe largohen drejt Bllatës.

Tani belaja kishte marrë edhe më shumë peshë, sepse Salihut i ishte plagosur mysafiri i shtëpisë. Kallabët po pritnin një moment që ta merrnin hakun. Kështu, pas disa muajsh dikush e sheh se Dani i veshur me tirq e me plis të bardhë në kokë kishte kaluar andejpari dhe kishte shkuar diku në drejtim të Zarbicës, në një dasmë. Atëherë këta organizohen që të nesërmen, kur të kthehet këtejpari, t'ia zënë pritën dhe ta vrasin. Mirëpo, duke u kthyer Dan Bllata me shokun e vet po bisedonin për muhabetin që e kishin përjetuar si mysafirë, ndërkaq shoku e komplimenton për xhamadanin dhe plisin që po i rrinin kaq bukur. Këtë dëshirë të shokut të tij Dani e shfrytëzon shumë mirë dhe, pak para se të mbërrijnë te fusha e Tyrbes, i thotë shokut të vet që t'i ndërrojnë veshjet e sipërme. Ashtu dhe ishte bërë. Duke e pasur parasysh edhe belanë me Salihun, Dani e shmang rrugën për nja dyqind metra më në veri. Salihu me djem i kishte zënë pritën Danit dhe e dinin që ai dallohej për nga veshja e tij me xhamadan dhe plis. Meqë ai tashmë kishte shmangur rrugën, këta nuk e njihnin nga fytyra, por vetëm në bazë të veshjes, shtien drejt këtij. E plagosin plisbardhin. Dani me shokun e tij vazhdojnë të ikin, kurse Salihu mjaftohet me plagosjen dhe nuk e ndjekin më tutje. Dhe, kështu i lënë të shkojnë, por pa ditur dredhinë e Danit. Më vonë kishin kuptuar realitetin, mirëpo kishin ndërhyrë paria dhe i kishin pajtuar. Meqë këto familje edhe para kësaj belaje kishin pasur marrëdhënie të mira, më vonë kishin kaluar mirë, madje pas nja tre brezash edhe ishin miqësuar me njëri-tjetrin.

*Storje interesante!?*

**Kema:** Po, ishte një rrëfim interesant, që tregon gatishmërinë për të rënë në bela për bashkëfshatarin e vet, mirëpo, megjithatë, unë do të doja që këso situatash të mos përjetojnë familjet shqiptare, porse të mbizotërojnë arsyeja dhe mirëkuptimi.

*Ka edhe raste të tjera sikur ky?*

**Kema:** Fatkeqësisht, kanë ndodhur edhe dy-tri raste të këtilla që lidhen me mbrojtjen e dinjitetit të familjes, por si dukuri do t'i hidhja në harresë të pakthyeshme.

Atëherë, po ia shtoj edhe një dukuri që kisha dashur po ashtu të hidhet në shportën e harresës. Fjala është për moslejimin e femrave për ta përcjellë anëtarin e ngushtë të familjes dhe pjesëmarrjen e barabartë me meshkujt në varrim. Në këtë kontekst po jap një përkthim, nga Ditari im, me rastin e varrimit të kushërirës, Hanumshahe Islam (Kallaba) Masurica.

E shtunë, 19 nëntor 1994

### **In memoriam: Hanumshahe Kallaba Masurica**

Sot paradite më njoftuan për vdekjen e dadës Humë, vajza e axhës së babait tim, e bija e Islamit, gruaja e Mulla Muharrem Masuricës; nëna e Kadrushit, Ilmijes, Fehimit, Byles dhe Savdullahut me vendbanim në Koretin.

Ndonëse isha me rrufë dhe me terapi mjekësore, u pikëllova shumë dhe mora forcë e u ngrita nga shtrati dhe, pasi mora një antibiotik "Pentrexil", nga Prishtina shkova në Koretin, për t'ia dhënë lamtumirën e fundit, duke marrë pjesë në ceremoninë e varrimit.

Në orën 11:55 kufoma ishte ekspozuar në hyrje të oborrit të Savdullahut dhe filloi, si zakonisht, përsëritja lamtumirëse me të vdekurin. Përsëritja bëhej me ndalimin e përsëritësit skaj kufomës dhe nga kjo pozitë ndonjëri sillte dorën me parallërë tri herë mbi kokën e saj të zbuluar, duke filluar nga e majta në të djathtë, ose nga e djathta në të majtë; ndonjëri qëndronte vetëm në pozitë gatitu. Çështje e vërteta, edhe unë, kur më erdhi radha, u ndala para kufomës, qëndrova për disa sekonda gatitu, duke e shikuar dadën Humë në sy, të cilët paksa i kishin mbetur të hapur; përfytyrova kalimthi jetën e saj, prejse kisha filluar ta njihja. Prej aty kufomën e morëm në duar unë, baca Qemajl, Savdullahu, Isa e të tjerë dhe ashtu e sollëm gjer te xhamia, ku do t'i kryheshin



*Hanumshahe Kallaba – Masurica (1907 - 19 nëntor 1994)*

edhe disa ceremoni fetare - falja e xhenazes. Së bashku me meshkuj, në oborrin e xhamisë, erdhën edhe disa femra, ndër to kishte edhe gra të martuara. Po në këtë përbërje, pas faljes së xhenazes, ata që kishin abdes, kufomën e hipëm në një traktor dhe shkuam te varrezat e fshatit. Në të hyrë në varrezat e rrethuara me tel, kolona e njerëzve të shumtë u ngushtua, dera e hyrjes ishte vetëm një metër e gjysmë e gjerë.

Imami i fshatit, Mulla Mehmet Morina, të cilin e shoqëruan edhe Mulla Mehmet Dërmaku me të birin - Feridin, me këmbëngulje ndaluan hyrjen e femrave në varreza. Një gjest i tillë më preku shumë, sepse, apriori, sipas mendimit tim, iu bë një padrejtësi vajzave dhe mbesave të së ndjerës. Tashmë femra shqiptare ka dëshmuar se ka forcë që, së bashku me meshkuj, ta kapë edhe armën e të shkojë në luftë, pa iu trembur syri, e të mos flasim për pjesëmarrje në varrimin e prindit.

Këtë gjest, imami i fshatit, Mulla Mehmet Morina, u përpoq që, para të pranishmëve, rreth 300 veta, ta arsyetonte duke u mbështetur në parimet islame, sipas të cilave qenka e ndaluar rreptësisht pjesëmarrja e femrës në ceremonialin e varrimit.

Duke pasur parasysh shekullin kur po jetojmë, shekulli XX, nivelin e qytetërimit relativisht të përparuar të femrës shqiptare, unë, Xhevdet Tefik Kallaba, nuk mund të pajtohesha me një gjest kaq injorues dhe të prapambetur të imamit konservator, madje edhe kryetar i Kryesisë së Bashkësisë Islame në Dardanë. Me këtë rast kërkova fjalën dhe iu drejtova të pranishmëve: “Përshëndes të pranishmit që erdhën për ta varrosur këtë nënë. Sot, pra, po ndahemi nga kjo nënë, për virtytet dhe kontributin e së cilës mund të flitet gjerë e gjatë, por unë po i cek vetëm tri kontribute të pamohueshme:



*Hanumshahja duke dredhur cigaren*

- Kontributi i parë i saj është se kreu obligimet ndaj kombit, duke shkolluar fëmijët e vet në nivel profesorësh e arsimtarësh;
- Kontributi i dytë i saj është se, si grua imami që ishte, kreu obligimet fetare ndaj banorëve të këtij fshati për aq kohë sa jetoi në këtë fshat;
- Dhe kontributi i saj i tretë, edhe si nënë, arriti t’i edukojë fëmijët e vet dhe brezin e tyre.

Prandaj, të mos u lejohet bijave dhe mbesave që ta ndajnë dhembjen dhe t’ia bëjnë bashkërisht përcjelljen e fundit, është sa ide e vjetruar, po aq edhe realitet i hidhur. Kjo flet për “dorën e fortë” të meshkujve ndaj gjinisë femërore.

Ndërkohë, të gjithë pjesëmarrësit, pa fije respekti, gjatë ceremonisë së varrimit, qëndronin mbi varret e njerëzve të vdekur.



## IX

### **Intervistë me vetveten - Xhevdet Kallaba**

“ Le të jetë ky libër dëshmi kohe dhe gjurmë në kujtesë. ”

---

*Xhevdet Kallaba*





*Xhevdet Tefik Kallaba*

*Pyetje: Çfarë mund të thuash për fëmijërinë tënde?*

**Përgjigje:** Vlerësimi është gjithmonë subjektiv, sepse varet nga krahasimi. Nëse krahasohem me një shtresë të varfërish, atëherë unë kam pasur një fëmijëri të shkëlqyer, por nëse krahasohem me fëmijët tjerë të rajonit ose të botës së zhvilluar, natyrisht, fëmijëria ime do të kishte lënë edhe shumë për të dëshiruar. Në planin e kujdesit familjar, mund të them se kam qenë i privilegjuar, falë faktit që dy vëllezër para meje kanë vdekur në moshë mes një e tre vjeç. Për besëtytët arsyetimi do të ishte: aq kanë pasur për të jetuar, Zoti e ka shkruar ashtu. Por, nga këndvështrimi im i moshës së pjekur ka pasur edhe faktorë të tjerë që kanë kontribuar që jeta e tyre të ishte aq e shkurtër. Ta zëmë, në kohën kur kanë lindur Rexhepi e Nijaziu, dy vëllezërit e mi, 1948 e 1950 dhe kanë vdekur në moshë mes një e dy vjeç, nëna ime ka qenë shëndetdobët, për më tepër që është dashur të jetojë në një bashkësi familjare me kërkesa të mëdha, si një nuse e re në një familje të madhe. Përkujdesja ndaj fëmijëve nga babai im ka munguar mjaft, për të mos thënë skajshmërisht, si rrjedhojë e angazhimit të tij për të krijuar karrierë në fushën e arsimit. Si pasojë e atij përjetimi, pas vitit 1949 babai e ka marrë me vete edhe nënën time kudo që ka shkuar në shërbim si mësues. Kështu edhe kujdesi ndaj meje ka qenë më i madh dhe më me përkushtim.

*Pyetje: Çfarë të ka mbetur në kujtesë nga fëmijëria e hershme?*

**Përgjigje:** Kujtimet e para që i kam qartë të regjistruara në mendjen time janë nga mosha trevjeçare; pra, mbaj mend udhëtimin me qerre të nuses nga Rogana për në Breznicë, kur është martuar axha im, Hyseni (1956). Si fëmijë duhej t'ia hidhja nuses qiçrat (leblebiat) mbi vellon; ishte ky një adet i kohës.

Pastaj më kujtohet, pothuajse në hollësi, një situatë e pazakontë nga mosha pesëvjeçare.

Ishte kohë e pushimeve verore. Babai kishte mbaruar mësimin në Geraj (Aligeraj) të Preshevës dhe na kishte sjellë në Roganë. Atë verë të vitit 1958 ishte planifikuar edhe një dasmë për axhën tim, Tasinin. Martohej me Feime Agajn, vajzën e Selimit nga Hogoshti. Kishim shumë miqësi nga e gjithë Anamorava dhe Lugina e Preshevës, prandaj kishim ftuar shumë mysafirë.

Derisa burrat prisnin mysafirët dhe gostitnin ata që tashmë kishin ardhur, ne, një grup fëmijësh, po luanim në fushën sipër shtëpive. Vetëm nga lagjja jonë kishte mjaftueshëm fëmijë, saqë nuk kishim nevojë për fëmijë nga lagjet e tjera. Pas një loje në fushë, se kujt iu kujtua që të shkonim në Katushnicë, nja dy kilometra larg shtëpisë, për ta parë rrugën që po shtrohej. Donim ta përjetonim edhe zallin e gjallë, që ishte në perëndim të rrugës Roganë - Hodonoc, nga ana e lumit. Në fakt, ajo ishte vetëm një ligatinë ku vazhdimisht kishte ujë, porse ne na këshillonin që të mos ecnim andej, sepse mund të na përpinte zalli i gjallë. Kështu, kishim frikë të hynim andej, por edhe ishim kureshtarë. Këmbët na zhyteshin deri në gjunjë, pastaj bërtitnim duke kërkuar ndihmë nga njëri-tjetri për t'i nxjerrë jashtë. Kështu, arritëm deri te lumi i Katushnicës që rridhte nga shpatet e Karaçevës. Nuk kishte shumë ujë, porse ishte i pastër si loti dhe bashkohej disa qindra metra më tutje me lumin e Hogoshtit. Mbi atë lumë parashihej të ndërtohej një urë, por fillimisht ishte në plan shtrimi i rrugës nga Katushnica deri në hyrje të Hodonocit. Prej aty, rreth 300 metra në drejtim të Hodonocit, rruga ishte e mbuluar me gurë të mprehtë, mbi të cilët pritej të shtrohej një zhavorr paksa më i imët e pastaj edhe zalli. Për asfaltimin e saj as që bëhej fjalë. Në stom të rrugës pamë një xhip që ishte ndalur. Në të nuk kishte njeri. Prapa xhipit ishte një vend për vendosjen e rrotës rezervë, si dhe një mbajtëse e metaltë. Bëmë një marrëveshje që të kacavareshim dhe i dhamë besën njëri-tjetrit që të mos lëshoheshim deri në hyrje të Hodonocit, duke llogaritur se xhipi nuk mund të lëvizte shpejt. Më të moshuarit ndër ne ishin Fadili e Hasani, që ishin nga gjashtë-shtatë vjeç. Pas pak erdhi shoferi, e drodhi një duhan e pastaj ndezi xhipin dhe u nis. Nuk ia mori mendja se ne do të ngjiteshim aq shpejt prapa xhipit, saqë edhe nuk na vërejti fare. Pas nja dhjetë metrash hymë në rrugën e shtruar me gurë të madhësisë prej shtatë-tetë centimetrash. Nga dridhjet e mëdha të makinës filluam të rrëshqitnim. Të gjithë u rrëzuan përtokë. Vetëm unë mbeta i kacavarur, por mbahesha fort për mbajtësen e rrotës rezervë. Dëshiroja t'i qëndroja besnik fjalës së dhënë. Megjithatë, pas nja tridhjetë metrash, nga tronditjet e mëdha të xhipit, më rrëshqitën këmbët. Mbahesha vetëm në duar, derisa këmbët më shkonin zhargas përtokë, më mirë të them, mbi gurët e mprehtë. E dija se në hyrje të Hodonocit udha ishte e shtruar me zall të imët. Lufta ime ishte, si të qëndroja deri atje e pastaj të lëshohesha që të mos e lëndoja fytyrën. Ndërkohë më pa një pylltar. Bërtiti e fishkëlleu sa munda, por shoferi i xhipit nuk u ndal. Fëmijët e tjerë, si: Fadili, Faruku, Nagibi, Hasani e të tjerët ishin alarmuar. Njëri prej tyre kishte shkuar në shtëpi për t'i njoftuar për ngjarjen. Disi arrita të qëndroja deri

në Hodonoc, porse isha rraskapitur. Atje u lëshova. Fytyra m'u mbush me zall. Kur fshiva ballin, pashë se duart m'u mbushën me gjak. Më pas ktheva sytë nga gjunjët, të cilët ishin mbuluar me gjak. Shoferi i xhipit as që më kishte vërejtur. Më kujtohet se si erdhi një i moshuar dhe më kapi në krah. Isha i llomitur, por e ndjeva atë zotërinë se si e shau shoferin. Ndërkohë arriti edhe dikush nga fëmijët. Pyetjes së atij zotërisë se i kujt isha unë, ata njëzëri iu përgjigjën: ne jemi të kallabëve të Roganës. Nuk e di se kush e kishte organizuar një qerre me kanata, që tërhiqej nga një pendë qe dhe më hipën në të. Së shpejti e vërejta axhën tim, Faikun. U tmerrua kur pa plagët e mia, por disi mundohej të më ngushëllonte, duke thënë: “pasje shpëtuar, pasje shpëtuar”! Unë nuk nxirra zë nga goja, edhe pse kisha dhembje të mëdha. Kisha frikë në mos po më dëgjonte babai dhe do të më ndëshkojë. E luta axhën Faik që të mos i tregonte babait. Ai më siguroi se babai nuk do të më prekte me dorë. Çështje e vërteta, babai ishte i zënë me mysafirë. I kishin treguar, por ai kishte vazhduar muhabetin me mysafirët, sikur të mos kishte ndodhur gjë. Natyrisht ai e dinte se unë tashmë isha nën përkujdesje të axhës, të nënës e të shumë grave që kishin ardhur për dasmë. Më zbritën nga qerrja. E gjithë pjesa e poshtme e trupit tashmë ishte e mbuluar me gjak. Nëna më përqafoi, më mbështolli me pështjellakun e leshtë. Me zë të vogël, por sikur në dënesje lëshoi fjalët: “Uh, e mjera unë, m'u paska çallamitë (sakatosur) djali”. Shpejt i kishin treguar edhe babës hoxhë. Pas një pastrimi, plagët tashmë dukeshin qartë. Baba hoxhë e kishte porositur nënën që gjithë pjesën e poshtme të trupit të ma lyente me të kuq të vezës. Gratë mblodhën shpejt disa vezë dhe plagët m'i mbuluan me të kuqtë e vezëve dhe më mbështollën me një çarçaf të shtratit. Ashtu i mbështjellë qëndrova deri të hënën, kur nëna me agën Nazmi më dërguan me qerre në ambulancë, që ishte në fshatin e afërm, në Muçivërc. Më duket se dy herë në javë vinte mjeku nga Dardana në Muçivërc. Mjeku urdhëroi një infermiere që të ma largonte çarçafin e shfrytëzuar si fashë. Kur e pa gjendjen time, iu drejtua nënës: “Kush ju ka thënë që ta lyeni djalin me të kuqtë e vesë”? Nëna, paksa e frikësuar i tregoi se ishte këshillë e babës hoxhë. Mjeku ishte serb dhe iu drejtua agës Nazmi: “E, halal mu vera, on mora da je veoma pametan čovek” (I lumtë, ky njeri duhet të jetë shumë i mençur). Ai më mbështolli edhe një herë, duke e porositur nënën time që të vazhdojë të më lyejë edhe disa ditë me të kuqtë e vesë. Kishte thënë se të kuqtë e vesë ia shëron plagët dhe nuk lejon që të mbeten shenjat e tyre. Ashtu edhe kishte ndodhur. Më vonë lëkura ishte rigjeneruar në atë masë, sa që nuk vëreheshin fare gjurmët e plagëve.

*Pyetje: Si fëmijë ke qenë edhe më tutje i privilegjuar, apo kur janë lindur edhe të tjerët dashuria e prindërve ka kaluar tek ata?*

**Përgjigje:** Disi kam përshtypjen se edhe më tutje kam qenë i privilegjuar, pasi kam qenë më dinamik dhe më i imponuar. Ndërkohë babai im ishte transferuar në Pogradjë. Më kujtohet, pas një viti, kur në moshën gjashtëvjeçare, më ra të regjistrohem në klasën e parë, në Pogradjë. Babai m'i pati blerë një palë pantallona që kishin edhe një xhep të vockël përpara, vetëm për para të vogla. Gjithmonë e kisha atë xhep plot me para. Më kishte për qejfi edhe dhëndri ynë nga Pogradja, Rabbit Rexhepi, i cili vazhdimisht më jepte ndonjë monedhë, ose njësoj bënte edhe Kema, kur vinte nga Ferizaji. As atje nuk isha i rehatshëm. Kur ishte moti i nxehtë, shkoja shpesh në lumin Morava, bashkë me fëmijët e fshatit, sidomos me Shefketin, Sylën e Vehbiun, që i kisha shokë të klasës, por edhe me të tjerë më të mëdhenj, si Nazimi, Avdiu, Shabani etj. Aty mësova të notoj, por edhe të zë me dorë peshq.



*(Nga e majta) Elhamiu, Xhevdeti dhe Selamiu në Pogradjë, më 1960*

*Pyetje: Ke edhe ndonjë evokim nga ajo kohë?*

Kam, natyrisht, por më me dëshirë do t'i ruaja për ndonjë libër tjetër të evokimeve nga fëmijëria. Sidoqoftë, po e rrëfej një situatë kur isha shtatë vjeç.

Babai im sapo kishte ardhur nga Pogradja për të punuar mësues në Koretin. Banonim te Hysen Basha dhe lumin e kishim afër. Nuk e dija as si quhej, por nëna vazhdimisht më porosiste që të mos shkoja i vetëm te reka (lumi). Më kujtohet që, njëherë, babai ia tërhoqi nënës vërejtjen që të mos thoshte reka, porse lumi, - sepse ashtu është më drejt të thuhet, thoshte ai. Herë pas here babai më merrte me vete për të peshkuar. Vazhdimisht më këshillonte që të mos afrohesha shumë te stomi, jo se ia trembja peshqit, porse mund të rrëshqitja në



*Ekremi (arsimtar) me  
Xhevdetin nxënës i kl. VII  
në Koretin, 19 maj 1966*

lumë, i cili mjaftueshëm ishte i thellë që të më merrte me vete. Gjithherë bëja kujdes. Një ditë prej ditësh, pa lajmëruar fare në shtëpi, shkova te lumi. Atje takova edhe disa fëmijë, që ishin më të moshuar se unë. Lumi ishte i kthjellët si loti. Në të kishte edhe shumë peshq. Ishim kureshtarë që të përcillnim lëvizjet e tyre në formate kuadratesh. Më të vegjlit vinin nga cekëtina, kurse të mëdhenjtë dilnin nga thellësia e ujit, që kishte bërë vend nën stomin ku qëndronim ne. Ishte një parakalim i vërtetë i peshqve. Edhe ne ishim të qetë, nuk i pengonim fare. Në vitet e pastajme, pra, edhe sot e kësaj dite, sa herë që shtetet e ndryshme transmetojnë parakalime ushtarake ose sportive, ma kujtojnë atë ditë të parakalimit të peshqve, sikur atë ta bënin me skenar dhe me ndonjë regjisor. Kur ndokush prej nesh, me pahir a me qëllim, gjuante ndonjë gur në lumë, peshqit shpejt futeshin në strehimoret e tyre dhe, pas pak, sërish dilnin



në grupe. Disa metra më larg, para lagjes së kovanëve dhe para shkollës, disa banorë serbë kishin vënë duaj kërpit në lumë për ta ndarë kërpit nga tershliku. Tershlik i thoshim kërcellit të bimës së kërpit e që më vonë mësova se fjala ishte për “kanabis sativa”. Atje e kishim më të lehtë afrinë me peshqit, të cilët, shpesh, edhe mund t’i zinin me dorë. Edhe këtë fakt, përse me kaq lehtësi mund t’i preknim ose t’i zinin peshqit me dorë, e mësova më vonë, - ata trulloseshin nga ndikimi i kanabisit.

Nga pozita e diellit dukej të ishte bërë pasdite e vonë, kurse në veri tashmë ishte shfaqur një re e madhe shiu. Shokëve u propozova që të bënim edhe një lojë me peshqit dhe filluam t’i fusnim duart nën duajt e kërpit, i cili ishte i tëri në ujë. Ishte kënaqësi e papërshtetshme kur zinin peshqit, por kurrsesi t’i nxirrnim jashtë, sepse na rrëshqitnin nga duart. Ndërkohë, papritmas, na bërtiti një kalimtar i moshuar, duke na përkujtuar se në malësi ka rënë shi dhe se niveli i lumit, për çdo çast, mund të rritej. U ngutëm të dilnim në breg, dhe për një çast rrëshqita nëpër gurët e lëmuar. Shtrati i lumit, në atë pjesë, ishte i gjerë dhe niveli i ujit nuk kalonte mbi gjunjët e mi, mirëpo nga rrëshqitja më doli njëra çizme nga këmba. Vrapova disa metra pas saj që ta merrja, por hapësira e ujit sa vinte e ngushtohej, kurse lumi bëhej më i shpejtë. Kisha frikë edhe të shkoja më tutje ngase thellësia tashmë kishte mbuluar barkun tim. Vendosa të dilja nga uji në stom dhe të pajtohesh me humbjen e çizmes. I gjithë ai gëzim i lojës me peshq m’u bë vrer. Tani kisha frikë të shkoja edhe në shtëpi, por kisha frikë edhe të qëndroja jashtë, sepse isha lagur qull. Kur hyra në shtëpi, pashë nënën tek po gatuate. I tregova për çizmen dhe fillova të qaja. - “Kuku, paska me t’myt baba jot”, tha ajo dhe përqendrimi i saj ishte te bërja gati e bukës, ngase e kishte hallin e vet, që të mos e vononte bukën kur të kthehej nga shkolla. I frikësuar, shfrytëzoja shpërqendrimin e saj dhe u futa në paradhomën ku i mbanim turshitë e ku ishin nja dy-tri fuçi me lakra. U fsheha pas tyre dhe po prisja. Pas pak erdhi babai nga shkolla. Vëllezërit, Elhamiu e Selamiu, ishin të ulur në kanape, ndërkaq Drita sapo ishte lindur dhe ishte e lidhur në djep. Ekremi, si zakonisht, ishte në shkollë, në Prishtinë. Me të hyrë në kuzhinë, babai kishte vërejtur mungesën time dhe po e pyeste nënën se ku isha. - Tash sa ishte këtu, tha ajo dhe nxori një tepsi me pite nga shporetia. Aga sërish me një zë të rreptë pyeti për mua, kurse nëna doli të më kërkonte në oborr. Pas pak hyri brenda. Gjithë ditën ka luejt te reka, bile ia kishte marrë uji njëren çizme, dhe i thashë se ka me t’mytë baba jot. Kur e dëgjoi nga këtë bisedë, iu drejtua nënës: po si e mby, moj, unë djalin tim për një çizme, me rëndësi është që atë nuk e ka

marrë uji e sa për çizme ka sa të duash në dyqan. Me gjasë ishte kjo një metodë e tij që ta zbuste brengën time. Kjo më bëri që të çlirohesh nga ai presion dhe, nga gëzimi, fillova të qaja me zë.

- Po, a këtu je bre kodosh a, m'u drejtua aga dhe erdhi e më mori për dore. Nëna tashmë kishte kthyer sofrën, kurse aga më mori në prehër dhe kërkoi që t'ia rrëfeja mënyrën e humbjes së çizmes. Unë i tregova fill e për pe se si e kisha kaluar gjithë ditën; i shpjegova sidomos për peshqit te stomi, ku edhe ai shpesh zinte peshq me grep. Pastaj edhe lojën me peshq te grumbulli i kërpit, e më pas edhe se si, duke dalë nga lumi, më doli çizmja nga këmba, të cilën u përpoqa ta merrja, porse kisha frikë të shkoja më poshtë ku uji ishte më i rrëmbyeshëm. – Të lumtë, biri im, më tha. Ti paske pasur një ditë fatlume, por më së shumti po më pëlqen mençuria jote që nuk ke vrapuar pas çizmes, sepse më poshtë do të kishte qenë me rrezik.

Sidoqoftë, ky komunikim i tij me takt pedagogjik, si dhe porosia që në të ardhmen të bëja më shumë kujdes dhe të mos rrëmbehesha nga situata të rrezikshme, bëri që unë vërtet të jem më i vëmendshëm, jo vetëm për veten time, por edhe për vëllezërit e mi më të vegjël.



*Foto me nxënësit e kl. VIII në vitin 1966/67, në shk. fillore „Vëllazërim Bashkim“ në Koretin. Xhevdeti i treti në rendin e dytë nga e djathta*

Së shpejti filluam të ndërtonim një shtëpi. Nga ajo kohë sikur humba privilegjet e të përkëdhelurit me para xhepi. Me gjasë, as babai nuk kishte më para, si përpara. Nga klasa e dytë e deri në përfundim të gjimnazit, banoja në Koretin. Aty kisha krijuar një rreth shokësh shumë më të gjerë sesa në Roganë. Shkolla e Koretinit kishte një bashkëpunim të mirë me shkollat e tjera, sidomos me atë të Roganës e të Përlepticës. Vazhdueshëm shkëmbenim programe kulturore-artistike, bënim gara sportive, shkëmbenim shfaqje dramash, organizonim shëtitje të përbashkëta njëditore, që shoqëroheshin me lojëra sportive, këngë e vallëzime etj. Ndonëse në shkollën fillore isha nxënës shembullor, në shkollën e mesme e pata lëshuar mësimin. Nuk e di, mbase ishte edhe ndikimi i rrethit. Shumë nxënës nga Koretini kishim probleme me serbët e Berivojcës, të cilët na ngacmonin kur kalonim nëpër fshatin e tyre për të shkuar në gjimnazin e Dardanës. Ishte edhe një luftë për dominim mes të rinjve serbë nga Dardana dhe të rinjve shqiptarë të fshatrave përreth. Shpesh ndodhte që edhe të ziheshin të rinjtë shqiptarë nga Koretini me të rinjtë serbë nga Dardana, sidomos në orët e vona para ose pas shfaqjeve të filmave në sallën e kinemasë, në Dardanë. Ndonjëherë tagrin e atyre ngatërresave e paguanim ne më të vegjlit, kur kalonim nëpër Berivojcë, derisa, së shpejti edhe Berivojca filloi të banohej me shqiptarë. Ishim më të preokupuar me ngatërresat sesa me mësimet.

Nga mesi i viteve '60 edhe Dardana, përditë e më tepër, popullohej me shqiptarë.

### **Pyetje: Do t'i shpjegosh një për një ato kujtime?**

Përgjigje: Kam shumë kujtime edhe nga ajo periudhë, por do t'i ruaj si evokime për ndonjë libër tjetër, enkas për kujtimet.

### **Pyetje: E pastaj?**

Përgjigje: Nga dëshira për të studiuar akademinë e filmit, viti 1971 më kishte gjetur në Zagreb. Pata përgatitur recitimin artistik të vjershës "Krvava bajka" (Përralla e përgjakshme) të shkrimtares Desanka Maksimoviq. Ngado që shkoja e recitoja më vete, madje edhe me ndryshim tonaliteti dhe me ndjeshmëri të

theksuar ndaj pushkatimit të nxënësve të Kragujevcit. Nuk e dija nëse ishte përzgjedhja e duhur, sepse nuk kisha parakonsultuar ndonjë aktor me përvojë. Thjesht, ishte një ide imja që të paraqitesha me atë poezi. Me t'u paraqitur në Fakultetin e Arteve në Zagreb, sekretarësja më refuzoi, me arsyetimin se duhej ta njihja gjuhën kroate. I thashë që flas serbokroatisht. – Nuk mjafton, më tha. Aktori i akademisë filmike të Zagrbit duhet ta njohë mirë dialektin e këtushëm, shtoi ajo. I zhgënjyer nga ky injorim, nuk u ktheva fare në Kosovë. Për, pothuajse, dy muaj rresht frekuentova të gjitha fshatrat e Zagorjes, që të mësoja sa më shumë kroatishten dhe dialektin kajkav, që të paraqitesha në afatin e gushtit. Ndonjëherë bëja punë krahu, sa për bukën e gojës, dhe vazhdimisht ndërtoja imagjinatën për regjistrim në akademi - drejtimi i aktrimit.



*Në stacionin e trenit të Cyrihut (Zvicër) me Nevzad Sadikun (djathtas), 1973*

Kur u paraqita në afatin e gushtit, po e njëjta sekretarëshë më tha se, që nga ai vit (1971), qe hapur shkolla e lartë e teatrit në Prishtinë dhe më sugjeroi që të provoja të regjistrohesh në Prishtinë. Mendova se sërish po tallej me mua dhe dëshiron vetëm të më largojë. Nuk isha edhe shumë këmbëngulës, ashtu siç nuk kam qenë, ta zëmë, më vonë edhe në Cyrih të Zvicrës, kur pretendoja të regjistroja linguistikën, më 1973.

Pas dy ditësh kam udhëtuar nga Zagrebi për në Cyrih, ku kam qëndruar plot dy vjet. Asnjëherë nuk kam punuar ndonjë punë të rregullt, duke menduar vazhdimisht për kthimin në Kosovë. Mirëpo, vazhdimisht kam mësuar gjermanisht, natyrisht në modelin autodidakt. Tentimi për t'u regjistruar në fakultetin e gjuhës gjermane kishte rezultuar po ashtu pa sukses, si pasojë e mungesës së sponsorit. Në rubrikën e formularit të aplikimit për regjistrim: - Kush t'i mbulon shpenzimet e studimeve? - unë shënova emrin e babait tim dhe profesionin e tij.

Pas kërkesës të një pasqyre bankare të të ardhurave të babait tim, u kuptua se ai jeton në Kosovë. Arsyetimi i refuzimit ishte mosplotësimi i kushtit të mbulesës së shpenzimeve për shkollim, në shumë prej dyzet mijë frangave zvicerane. Kështu, u ktheva në Kosovë, kreu shërbimin ushtarak dhe u punësova në Radiotelevizionin e Prishtinës, për të përfunduar studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjilan, pa shpëputje nga puna.

Punësimi në Televizion ishte edhe një ëndërr imja, ndonëse vendimi ishte i ngutshëm. Babai im kishte përherë probleme me ulcerën në lukth. Një sëmundje që shpesh e sillte në spital. Nga e njëjta sëmundje kishte qenë edhe shkrimtari Fahredin Gunga nga Mitrovica. Që të dy ishin pacientë të bashkëfshatarit tim Dr. Shaban Gecit. Me gjasë, babai im i kishte rrëfyer Fahredinit për dëshirën time për botën e filmit e të televizionit. Pas kthimit tim nga shërbimi ushtarak, e vizituam një ditë Fahredinin. Ia shfaqja edhe dëshirën për punësim në Radiotelevizion. – “Tashmë është dhjetori dhe koha e studimeve ka përfunduar, por kjo nuk do të thotë që vitin e ardhshëm, krahas punës, të mos studioj në Prishtinë”, shpreha një këmbëngulje për punësim. “Grua, më jep një lugë sodë bikarboni”, iu drejtua bashkëshortes së vet, Dritës. Me dorën e djathtë mori gotën me sodën e tretur dhe e piu, derisa me të majtën mbante barkun shtrënguar. Ata nuk kishin fëmijë dhe m'u drejtua si të isha djali i tij: “Shiko, Xhevdet, ti je ende i ri dhe më mirë është të regjistrohesh në fakultet e punën

e gjen kur të duash. Ja, sivjet është hapur edhe drejtimi i gazetarisë dhe mund të intervenoj që të regjistrohesh, ani se ka kaluar afati i regjistrimit”. Duke e ditur edhe gjendjen financiare në familje, më shumë parapëlqejja punësimin e menjëhershëm dhe, disi, kisha një vetëbesim se edhe gjatë punës mund të studioj. Doja t’i bëhesha babait një krah i fortë financiar, sidomos për faktin që Elhamiu ishte tashmë në studime e së shpejti pritej që të studionin edhe Selamiu e Drita. Pas ofertës së Fahredinit, se punës mund t’ia filloja menjëherë, ngase RTP-ja sapo kishte filluar punën e pavarur në studion e Prishtinës, dhe se do të ketë nevojë për shumë punëtorë profilesh të ndryshme, unë u deklarova që të punësohem. Ashtu edhe u bë. Në konkursin e parë të fillimshkurtit 1976 u punësuam një numër i madh punëtorësh në Shërbimet e përbashkëta programore, si dhe në redaksi të ndryshme, si p.sh. të arsimit, të muzikës, të filmit, dokumentare etj. Mua, vetë Fahredini më kishte sistemuar në Shërbimin e Koordinimit të skemës programore, ku edhe i përgjigjesha drejtpërdrejt Zyrës së Kryeredaktorit, post të cilin e ushtronte Fahredin Gunga. Punën e fillova më 12 shkurt 1976, ndërsa më 25 nëntor 1975 pati filluar puna e pavarur (nga TV Beogradi) e Televizionit në Prishtinë.



*Me kolege e kolegë nga viti 1983 në RTP. Nga e djathta: Xhevdet Kallaba, Bellka Murseli, Shukrije Shabani, Fadile Berisha, Hamdi Selmani, Abdullah Gashi (ulur)*



Të punosh në një institucion siç ishte RTP-ja, për më tepër në gjuhën shqipe, më dukej edhe si një veprimtari atdhetare. Nuk kursehesha aspak që puna të bëhej sa më mirë. Krahas punës, vazhdimisht mësoja edhe gjermanisht, por lexoja edhe anglisht, frëngjisht e italisht, ngase në mendjen time planifikoja udhëtime nëpër Evropë. Thënë realisht, gjatë punës vëreja edhe mangësi njohurish nga shkolla e



*Me kolegë të TVP-së 18.1.1988*

mesme dhe fakulteti, të cilat dita-ditës më duhej t'i kompensoja, duke lexuar literaturë përkatëse, sidomos nga gjuha dhe letërsia shqipe, por edhe nga letërsia botërore. Më kujtohet që, në rastin e parë që m'u dha, pata blerë disa komplete të autorëve shqiptarë si dhe kompletin e shkrimtarit Xhek London, këtë të fundit në serbokroatisht. Nga ky i fundit më pati pëlqyer fort romani “Martin Idn”, “Ari”, “Beli oçnjak”, “Ljudi sa ponora” etj.

Nga ana tjetër, dëshira e babait që t'ua mundësojë të gjithë fëmijëve shkollimin superior u bë barrë për të, por edhe për mua. Që nga viti i parë i punësimit në RTP nuk jam liruar nga kreditë e njëpasnjëshme për ta ndihmuar veten dhe familjen.

Si njohës i rrethanave dhe jetës rinore në Perëndim, pothuajse çdo pushim vjetor e kam kaluar në shëtitje nëpër ish-Jugosllavi ose gjithandej Evropës: në Zvicër, në Gjermani, në Itali, në Angli, në Francë, në Spanjë, e deri në Poloni e në Turqi, dhe kryesisht autostop. Edhe këtu nuk do të zgjatem, me shpresë që aventurat e mia nëpër Evropë të zënë vend në një roman të veçantë.

Gjatë asaj periudhe kam qenë mjaft aktiv në fushën e sportit; ta zëmë jam marrë me atletikë, karate, bodibilding etj. Kam qenë njëri ndër themeltarët e klubit të bodibildingut në Prishtinë, bashkë me Idriz Humollin, Mithat Krasniqin, Besim Halilin e shumë të tjerë. Është interesant të përmend se nga edukimi i babait më ka munguar djallëzia, gjë të cilën në RTP e kam parë më konkretisht, dhe për fat të keq edhe ndër intelektualë, sidomos në luftën e posteve. Por, sa i përket luftës për një program të pavarur shqip, të paimponuar nga redaksia e Beogradit, këtë

e kam vërejtur te shumica e redaktorëve dhe gazetarëve, sidomos në redaksinë e arsimit, të muzikës, të filmit, të sportit e të asaj dokumentare.



*Nga e majta: Besim Halili, Mithat Krasniqi, Idriz Humolli, Xhevdet Kallaba (ulur), 1980*

Pas ndërprerjes së punës në Radiotelevizionin e Prishtinës, më 1990, kam qëndruar kryesisht në Roganë, por edhe kam lëvizur për ndonjë punë të përkohshme, sa për mbijetesë, në Zvicër.

*Pyetje: Ke edhe ndonjë situatë pas largimit nga puna që do ta veçoje?*

**Përgjigje:** Ishte 12 shkurti i vitit 1990, kur milicia e kishte marrë në paraburgim Reshatin, si pjesëmarrës të demonstratave antijugosllave, të organizuara në fshatrat e Dardanës, e sidomos ato në Roganë. Natyrisht, ndër organizatorët e

kësaj demonstrate ishte edhe Reshati. Pasdite, bashkë me Selamiun shkuam në Dardanë, në mos po merrnim ndonjë informacion rreth burgosjes së Reshatit, mirëpo, përveç njoftimit për arrestim, asgjë tjetër nuk kuptuam.

Ishte kohë dimri dhe dielli perëndonte herët, kështu që mbrëmja na zuri në Dardanë. Një kohë e kaluam tek aga Kemë, duke e qarë hallin e Reshatit. Në mendje më sillej vërdallë rasti i xhaxhait Ilmi, dyzet e gjashtë vjet më parë; e kishin ftuar në bisedë informative, dhe kurrë nuk ishte kthyer i gjallë; e kishin masakruar argatët e po këtij sistemi.

Rreth orës 18:00 u nisëm për në Roganë me veturën time "Opel kadet". Aga Kemë mbeti të vinte më vonë. Qarkullimi natën ishte paksa i pasigurt dhe i trishtueshëm. Pakkush preferonte qarkullimin pas rënies së muzgut. Nuk kishte orë policore, mirëpo qarkullimi megjithatë nuk preferohej. Rrugës për në shtëpi pamë dy patrulla të milicisë. Ngisja me kujdes dhe nuk na ndalën askund. Sapo kaluam Domorocin drejt Hodonocit, pas kthesës së parë, për pak sa nuk u përplasa me një shtyllë elektrike gjysmë të rrëzuar, e cila daljen e kishte deri te gjysma e rrugës. Filxhanët që mbanin telat përçues kishin rënë në një lartësi deri rreth dy metra mbi tokë. Frenova shpejt, por veturën mezi arrita ta ndalja nja dy-tri metra pasi kalova nën shtyllë, që i bie, po të ishte vetura më e lartë do të ndeshesha me shtyllën. Ngadalë vazhdova edhe disa metra përpara dhe u ktheva prapa për ta parë gjendjen e krijuar. Nuk e di nëse ishte ndonjë subversion ose dëmtim rasti. Sidoqoftë, mendja më iku tek autobusi i radhës që do të nisej në orën 19:00 nga Gjilani e që kryesisht bartte nxënës të shkollave të



*Roganë, 1989 Xhevdeti me Nexhmijen dhe fëmijët:  
Graniti, Dafina, Blerina dhe Petriti*

mesme. Me atë autobus udhëtonin nxënës nga Hodonoci, Rogana, Muçivërci, Breznica, Karaçeva, Dajkoci etj. Pastaj, më vonë do të vinte edhe aga Kemë me Fikrijen dhe Enliratin.

Nga vetura ime nxora trekëndëshin paralajmërues dhe e vendosa nja 50 metra para shtyllës së rrëzuar për ta shmangur ndonjë aksident të mundshëm. Nga zgjatja e telave vazhdimisht dilnin shkëndija zjarri. Çdo moment mund edhe të këputeshin telat e rrymës dhe dëmi të bëhej edhe më i madh. Isha i vetëdijshëm për rrezikun, por edhe për përgjegjësinë qytetare që më takonte. Në arën skaj rrugës serbët nuk i kishin bartur duajt e misrit. E porosita Selamiun që të merrte disa duaj misri e t'i vendoste nja 50 metra larg vendrrezikut, në drejtim të Hodonocit. Pas pak, nga drejtimi i Gjilanit, erdhi një veturë. E ndala dhe e njoftova për rrezikun. E pyeta shoferin se ku po shkonte. “Në Shipashnicë të Epërme”, më tha. E luta që të ndalej në stacionin e Milicisë në Muçivërc dhe t'i njoftonte për situatën tepër të rrezikshme në Domoroc. Çështë e vërteta as milicët nuk parapëlqenin udhëtimin natën. Ishin në ankthin e demonstratave nga shqiptarët. Pakënaqësitë shpreheshin në çdo formë. Vetëm nja treqind metra nga këtu, te vendi i quajtur “Karma”, ishte një parullë e shkruar mbi asfalt - “Kosova Republikë”. Gjatësia e parullës ishte rreth 70-80 metra. Edhe qëndrimi ynë ishte i pasigurt, sepse mund të binim pre e ndonjë shantazhimi të paramenduar nga bashkëkombësit tanë të arsyeshëm, por assesi nuk mund të pajtoheshja që ta lija situatën kështu të rrezikshme për autobusin, lartësia e të cilit do të ndeshej drejt në telat e rrymës që ishin me tension. Pas nja gjysmë ore arriti nga Muçivërci një xhip i milicisë. Ua sqarova situatën. Më falënderuan, por njëkohësisht njëri nga milicët më tha: “A po e di se në çfarë rreziku je edhe ti, sepse kjo mund të jetë vepër e irredentistëve shqiptarë, e ata nuk qajnë hallin pse humb dikush jetën në këtë situatë të krijuar”. Isha i inatosur në milicinë që ma kishin burgosur vëllain, por edhe përgjithësisht për sjelljen e tyre, ndaj i thashë se kjo është vetëm një dëmtim i rastit i kësaj shtylle, sepse ato janë njëzet e më shumë vjet të vjetra, zhvendosa temën.

Brenga ime ishte autobusi me nxënës, që sa nuk kishte arritur dhe se nuk desha të largohesha pa u siguruar që është ndalur rryma. Milici thirri bazën me tokivoki dhe i luti që ta njoftonin Elektrokosovën në Gjilan që ta ndalnin rrymën dhe të vinin për ta evituar dëmin. Ata sikur e përfunduan punën e tyre, por unë nuk mund të largohesha derisa nuk isha i sigurt për ndërprerjen e rrymës. Telat ende lëshonin shkëndija zjarri që nënkuptonte rrezikun e vazhdueshëm,

sado që unë e kisha lënë trekëndëshin paralajmërues rreth 50 metra larg shtyllës. Nuk kisha frikë as nga ndonjë shantazh ose pusi (pritë) e mundshme e ndonjë bashkëkombësi timin. Fundja, vetja ime nuk ishte aq e rëndësishme në krahasim me 50-60 nxënës të rinj në autobus. Dhe, kështu, prita edhe një kohë derisa u binda se rryma ishte ndërprerë. Lashë trekëndëshin aty dhe u nisëm me Selamiun për në shtëpi. Kur arritëm në shtëpi, aga Kemë tashmë kishte ardhur përmes rrugës nga Kopërnica.

Të nesërmen, bashkë me Elhamiun, kishim planifikuar të shkonim për në Shkup ose Ohër që të prisnim ndonjë udhëtar që vinte nga Zvicra, sa për të fituar ndonjë para. Për mua ishte hera e parë, kurse Elhamiu e bënte këtë punë taksie më shpesh. Rrugës mendoja ta merrja trekëndëshin, por, kur arrita në vendngjarje, pashë se ende nuk e kishin sanuar dëmin. Kështu, e lashë trekëndëshin dhe vazhdova rrugën për në Shkup. Aty kuptuam se moti ishte me mjegull dhe se aeroplanët që do të vinin nga Zvicra do të aterronin në Ohër. Vazhduam rrugën për në aeroportin e Ohrit. Me të kthyer nga Ohri, dikur vonë në mbrëmje, shtylla ishte drejtuar nga punëtorët e KEK-ut, ndërsa trekëndëshi nuk ishte më aty. “S’ka lidhje”, thashë në vete, nëse kam arritur ta shpëtoj vetëm një jetë njeriu, atëherë nuk më dhimbset gjithë ajo sakrificë, e trekëndëshi jo se jo.

*Pyetje: Si jetoje pa të ardhura, me çka merreshe?*

**Përgjigje:** Nga nevoja për mbijetesë, fillova të merrem me instalime të ujit dhe ngjitje pllakash në banjë, punë të cilën e mësova nga mjeshtrit që punonin gjatë ndërtimit të shtëpisë sime, në Roganë. Por, edhe sa punoja në Radiotelevizionin e Prishtinës, shpesh merrja pushim pa pagesë, nga një deri në tre muaj, dhe shkoja në Zvicër për të punuar punë krahu, sa për të rezervuar para për pjesën tjetër të vitit.

*Pyetje: Ke ndonjë evokim nga ajo periudhë?*

**Përgjigje:** Po, ishte vera e vitit 1990. Me veturën time “Opel” shkova për të punuar në Zvicër. Banoja te miku im, Nexhmedin Hoti. Ai, shpesh, më

mundësonte që t'i bashkohesha ndonjë projekti të tij për punën e molerit. Merrte jashtë punës së tij të rregullt lyerjen e ndonjë banese, e cila duhej kryer gjatë fundjavës. Kështu, unë i bëja punët përgatitore gjatë javës, ndërkaq punët finale i kryenim të shtunën e, ndonjëherë, edhe të dielën. Fitimi ishte i lartë, ishte punë që paguhej mirë. Përveç kësaj, unë nuk paguaja banimin, e besa as ushqimin, sepse këtë ma mundësonte Dini, kështu e quaja unë Nexhmedinin. Pastaj ndonjëherë punoja edhe në rregullimin e ndonjë kopshti e punë të ngjashme.

Kjo punë “në të zezë” ishte e mundimshme dhe me rreziqe, sepse nuk kisha sigurime në rast aksidenti në punë, por as leje pune. Sidoqoftë, fitimet në Zvicër i investoja në mirëmbajtje të familjes, por edhe të shtëpisë në Kosovë. Synim imi ishte edhe hapja e një zyre informimi në Roganë. Kështu, gjatë atij qëndrimi, në një shitore të gjërave të përdorura, bleva dy makina shkrimi (një “IBM” dhe një “Olimpia”), si dhe dy aparatura për leximin e kasetave të diktafonëve.

Ndërkohë, në Zvicër kishte ardhur edhe vëllai im, Elhamiu. Pas disa ditësh qëndrimi, vendosëm të ktheheshim në Kosovë. Nga Dini pata një kërkesë. Meqë atë vit ai bënte bashkimin familjar, ta koordinoja udhëtimin tim për ta ndihmuar bashkëshorten e tij, Nizajeten, bashkë me fëmijët, që t'i pritja në Shvarcah (Schwarzach) të Austrisë dhe ta kaloja në trenin që shkonte prej aty për në Cyrih. Miku im tjetër, Xhemali, e kishte pasur për vizitë babanë e tij për disa muaj. Ndërkohë ai ishte sëmurrur dhe nuk i përballonte dot qëndrimin në Zvicër, kërkonte me ngulm që të kthehej në Kosovë. Me aeroplan nuk kishte mundësi. Xhemali më kërkoi, nëse do të ishte e mundur që ta merrja babanë e tij me veturë. “Natyrisht, por më duhet një jastëk dhe një batanije”, i thashë. Dhe, një pasdite u nisëm bashkë me Elhamiun dhe mixhën Esat. Udhëtimi duhej bërë nëpër Austri, për të arritur në mëngjes në Shvarcah. Ashtu dhe u bë. Në Shvarcah arritëm pak para kohës së caktuar. Së shpejti erdhi edhe treni nga Beogradi, i cili duhej të vazhdonte për në Muni, ndërkaq udhëtarët për Cyrih detyroheshin të merrnin një tren tjetër. Derisa Elhamiu qëndronte me mixhën Esat në veturë, unë u angazhova që ta ndihmoja Nizajeten me fëmijët për të hipur në trenin për Cyrih. Mbasi i akomodova ata në tren, vazhdova rrugën për në Villah, Jesenicë, Zagreb, Beograd e në drejtim të Roganës.

Rreth orës 24:00 arritëm në Bujanoc. Mixha Esat kishte vazhdimisht probleme me frymëmarrje, saqë kisha frikë se do të vdiste rrugës. Pas pak, arritëm në



postbllokun të “Çezma e Eminit”, i cili ishte zhvendosur nga Crepi pas një incidenti kohë më parë, kur milicia e kishte vrarë gastarbajterin Islam Morina nga Topanica, me punë të përkohshme në Litau të Lucernit, që ishte nisur për në Zvicër. Për vrasjen e Islamit ishte organizuar një protestë e madhe prej mijëra qytetarëve, më 5 shkurt 1990 përpara Komitetit Komunal në Dardanë. Të gjithë protestuesit ishin nisur nga Topanica me arkivolin e Islamit në një traktor dhe kishin ndaluar në oborrin e shkollës fillore të Dardanës. Rrugës për në Dardanë kishte shumë forca policore, pati kërcënime edhe me aeroplanë ushtarakë, të cilët fluturonin vetëm disa qindra metra mbi kortezhin prej më shumë se një kilometër. Krejt këtë ngjarje pata arritur ta regjistroja pikërisht me një kamerë amatore, të cilën e pata marrë në shtëpinë e Dinit. E bëra këtë parantezë për ta rrëfyer këtë ngjarje, për shkak të bisedës që do të pasonte, tani, pas disa muajsh, në postbllokun e zhvendosur disa kilometra nga Crepi në drejtim të Bujanocit, që tashmë njihet edhe si kufi shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.



*Nexhmedin R. Hoti (1949 – 2012)*

Një milic në uniformë dhe një inspektor kishin ndezur një zjarr, flaka e të cilit ndriçonte një hapësirë prej rreth pesëdhjetë metrash katrorë. Milici më ndaloi, duke m'i kërkuar dokumentet e makinës dhe të udhëtimit. Më pyeti se ç'kam edhe në bagazh. Ia dhashë dokumentet dhe i thashë se në bagazh kisha disa rroba personale dhe disa dhurata që i kisha marrë nga familjarët në Zvicër. Bisedën ia kaloi inspektorit, i cili po ashtu pyeti se çfarë kam në bagazh. Serbishtja ime e rrjedhshme zhvendosi muhabetin tjetërkund, saqë ai tha: mbylle bagazhin. Pyeti edhe se ku punoja dhe prej nga e dija kështu kaq mirë serbishten. I thashë se isha rreth katërmëdhjetë vjet punëtor televizioni dhe se serbishten e kam mësuar në shkollë, ngase, si në fillore, po ashtu edhe në gjimnaz shumë lëndë mësimore i kemi pasur serbisht, por që kam lexuar edhe

literaturë jugosllave e botërore në gjuhën serbe. Atëherë m'u drejtua: - "Vidim da si pametan čovek, hoćeš mi reči istinu na jedno pitanje?" (Po e shoh se je një njeri i mençur, a do të ma thuash të vërtetën për një pyetje?). Vetë me vete u mendova, i ndjeri, Islami, nuk kishte folur fare, ia kishin dorëzuar dokumentet e udhëtimit dhe më pas ia kishin shkrepur një rafal prej automatiku, po unë tani si të veproja? Për një moment m'u kujtua porosia e babait tim: thuaje të vërtetën, edhe pse ndonjëherë ajo të kushton, por vetëm ashtu je vetvetja. – Po, i thashë, varet se çfarë më pyetni! E, ai ma parashtrroi pyetjen: "Zašto je ovolika mržnja medju albancima i srbima, zašto je toliko demonstracija albanskih studenata i albanskog naroda protiv države Jugoslavije?" "Përse gjithë kjo urrejtje mes shqiptarëve dhe serbëve, përse gjithë këto demonstrata të studentëve dhe të popullit shqiptar kundër shtetit jugosllav?" Në shpejtësi e formulova një fjali në kokën time dhe i thashë: po, unë do të përgjigjem me një fjali të vetme, dhe nëse ju nuk më kuptoni me këtë fjali, ne do të flasim gjithë natën dhe sërish do të vijmë te po kjo përgjigje, që unë do t'ju them tani. "Da čujem - ta dëgjoj", shprehu kureshtjen e tij të madhe. E, unë i thashë: Për këtë që po ndodh tani, fajtoje është gjenerata e kaluar, pra babai im dhe babai juaj, të cilët nuk i kanë zgjidhur problemet më 1945, se kush ku e ka vendin, se kujt çfarë i takon etj., kurse, nëse, tani, unë gaboju ndaj jush, ose ju gaboni ndaj meje, këtë do ta paguajë fëmija juaj dhe fëmija im, pra, brezi i ardhshëm. "Do të bisedoja edhe më gjatë për këtë temë", shprehu gatishmërinë për ta zgatur muhabetin inspektorit, por unë ia kujtova fillimin e bisedës, duke i thënë: po, unë ju thashë se po përpiqem të them të tërën me një fjali, dhe këtë sapo e bëra.

Nuk e pritja se do të pajtohej me kaq, por, megjithatë, më uroi natë të mirë e rrugë të mbarë. Hyra në veturë dhe u nisa duke i struktur krahët në pritje të ndonjë breshërie automatiku, por jo, plumbat i kishin harxhuar në Islamin e ndjerë, ndjesë pastë! Me gjasë, do të kishte qenë ndonjë inspektor nga Vojvodina, se po të ishte nga këta inspektorët lokalë, shtrenjtë do ta kisha paguar atë përgjigje. Sidoqoftë, kisha pasur dëshirë që ta takoja atë inspektor, në kohë paqeje, për të biseduar shtruar për këtë logjikë të politikëbërjes në Ballkan.

## Një protestë me rastin e viktimës - Islam Ruzhdi Morina

Në emër të Këshillit për varrim, të cilit i printe prof. Isa Morina, tekstin protestues e lexoi Dilaver Kryeziu.

Qytetarë të KSA të Kosovës, terrori që po bëhet mbi kombësinë shqiptare vitet e fundit është i papresedan. Jemi dëshmitarë të rënieve të viktimave të pafajshme. Njerëzit po vriten në rrugë, nëpër oborre e nëpër shtëpi. Nëpër vende të punës po rrihen, duke marrë lëndime të rënda trupore prej organeve të sigurimit të ashtuquajtura

– Njësi speciale. Terrori dhe represioni që po bëhen mbi qytetarët e Kosovës janë të pashembullta në botën civilizuese. Madje kështu terrori e represioni nuk



bëhet në vendet e Perëndimit të cilat po zhvillohen me hapa gjigandë në shekullin e 21-të. I dënojmë tërë këto terrore. Shoku - vëllai ynë, daja Islam Ruzhdi Morina është vrarë në rrugë në mes të Konçulit dhe të Dheut të Bardhë, duke shkuar në Zvicër për të punuar për kafshatën e gojës, për të punuar dhe siguruar një jetë më të mirë, një jetë të cilën e dëshirojmë të gjithë. Një lutje në emër të prindit, në emër të Këshillit për varrim: ju lus të gjithë juve që erdhët së bashku me ne deri këtu ku e kishim qëllimin që të kthehemi në vend, ta varrosim të ndjerin ashtu siç erdhëm. Njëherësh shoku kryetar Raif Ramabaja, kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Komunës sonë dëshiron me dy-tri fjalë ta shprehë ngushëllimin e tij.

**Diskutimi i Raif Ramabajës:** Qytetarë, në emër të strukturave shoqëro-politike shprehim ngushëllime dhe dhembjen për këtë rast që ka ndodhur në afërsi të fshatit Konçul. Po ndërmerren dhe do të ndërmerren të gjitha masat nga organet kompetente që ky rast deri në fund të ndriçohet dhe ndaj fajtorit, pra, të merren edhe masat përkatëse ligjore. Por, edhe në këtë rast, ju lus që në mënyrë dinjitoze dhe njerëzore, pa kurrfarë problemi, pa kurrfarë ekscesi, ashtu siç keni ardhur, të ktheheni, sepse kjo mos t'ju sjellë juve probleme të padëshirueshme, dhe kështu edhe viktima nuk e ka merituar dhe nuk e meriton. Prandaj, ju lus si qytetarë që edhe rrugës duke u kthyer, pra, mos të bëni kurrfarë problemi dhe kurrfarë ekscesi. Pra, ashtu siç keni ardhur edhe të ktheheni dhe të kryhet ky varrim në mënyrë dinjitoze.

*Pyetje: Me të kthyer pas atij udhëtimi, çfarë bëje në Kosovë?*

**Përgjigje:** Gjatë asaj periudhe kam qenë i papunë, por jo edhe i paangazhuar. Përveç aktivitetit në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut – Dega në Dardanë, jam marrë edhe me regjistrimin filmik ose organizimin e shumë manifestimeve kulturore-artistike e sportive në Roganë e më gjerë.

Çdo aktivitet e kam bërë me shpenzime personale. Dhe, kur një ditë, kolegu nga KMDLNJ, Ramiz Arifi, më bëri një pagesë prej 50 markave gjermane, në emër të aktivitetit në Këshill, të cilat ishin ndarë nga qendra, u preka shumë. Me keqardhje paratë, por të merituar, i mora, ngase nuk kisha kurrfarë të ardhurash tjera. Ky moment kishte shënuar edhe një kthesë në jetën time. Vendosa të largohesha nga Kosova dhe të kërkoja punë kudo në botë, vetëm e vetëm që të mund ta mbaja familjen. Menjëherë i bëra një shkresë Kryesisë së KMDLNJ-së dhe ia dorëzova kolegut, Shefik Sadikut, që ta përcillte më tutje në shoqatë. Shkresa kishte këtë përmbajtje:

### **Kryesisë së KMDLNJ-së dega në Dardanë**

Të nderuar kolegë,

Me keqardhje ju bëj me dije se përkohësisht detyrohem të ndahem prej jush.

Rraskapitja materiale që shkakton rraskapitjen mendore, e cila gjithsesi reflektohet me rënie rapide në veprimtarinë time, në cilësinë e anëtarit të Kryesisë së KMDLNJ-së, Dega në Dardanë, më detyroi të marr rrugën e gurbetit, me shpresë se në një të të ardhme të afërt, sa sështë vonë, të këndellem dhe të jem më frytdhënës, si në vendin e sipërpërmendur, ashtu edhe në familje e më gjerë.

E thjeshtë është fjala gurbet, por kur e zbërthen të duket det, prandaj, me arsye duhet t'i ruhemi gurbetit njësoj sikur ai që nuk di të notojë në det. I keq është gurbeti, por më i keq është ai që s'ka kurrfarë mileti.

Megjithatë, unë detyrohem të marr rrugën e kurbetit dhe syhapur t'i bie detit.

Të nderuar kolegë, kjo shkresë nuk konsiston në një dorëheqje nga veprimtaria

ime e sipërshënuar kudo që gjendem dhe nga prizmi në të cilin, në momente të caktuara, më imponohet kjo veprimtari.

Se, që nga viti 1990, nuk kam kurrfarë të hyrash materiale në familje, përpos huamarrjeve të pareshtura dhe të kamatuara, këtë mbase e dini edhe ju të gjithë. Veprimtaria përmes firmës private në vitet 1992/93 ishte punë e dështuar, mashtrim i vetvetes dhe i të tjerëve, por sëpata pret nga tehu e jo nga qyta (tuni) dhe unë në këtë katrahurë të ngarkesës financiare më duhet të dal në anën e tehut për ta prerë këtë bllokadë.



*Letra drejtuar Kryesisë së KMDLNJ  
në Dardanë, më 24.4.1996*

Prandaj, konsideroj se keni mirëkuptim për largimin tim.

Duke uruar punë të mbarë në veprimtarinë tuaj, përzemërsisht ju përshëndes!

***(Xhevdet T. Kallaba, Roganë, më 24 prill 1996)***

*Pyetje: Dhe, çfarë ndodhi më tutje?*

**Përgjigje:** Shita veturën “Opel” për dy mijë marka dhe shkova në Shqipëri, prej nga vazhdova për në Zvicër.

Nga ato dy mijë marka, në tregun e Roganës, bleva atlete për fëmijë, në vlerë prej 40 markash dhe paratë e tjera i mora me vete. Çështë e vërteta, jashtë kufirit kishim të drejtë t’i merrnim vetëm deri në një mijë marka. Kështu, unë fsheha në xhepin e vogël të pantallonave një bankënotë njëmijëshe, kurse 960 marka

i deklarova në kufi. Milici kujdestar pyeti se çfarë kam për të deklaruar. - I thashë, asgjë, përveç mantelit dhe parave të lejueshme. Kontrollloi mantelin dhe në të gjeti dy videokaseta. - “Çfarë janë këto”, më pyeti? - Kaseta me program muzikor, i thashë. “Po paratë e tjera, ku i ke fshehur”, vazhdoi pyetjen pas skuqjes sime kur i gjeti kasetat. Pas insistimit të tij që të nxjerr gjithçka nga xhepat, erdha në situatë kur u desh ta nxirrja edhe bankënotën prej një mijë markash. “Eh, sada smo u redu, podji za mnom” (eh, tani jemi në rregull, eja pas meje), më tha. Në zyrë shkroi një letër që m’i mori paratë, dhe më tha se mund të ankojem në Beograd që të m’i kthejnë sërish paratë e konfiskuara. - “Në rregull”, ia ktheva, dhe vazhdova në autobus. U ula në karrigen e parë nga dera, ofshava një herë, mora frymë thellë dhe në vete qesha. Ata që ishin pranë meje u mërzitën fort për ato para që m’i morën, ndërkaq unë isha i lumtur që milici u mashtrua pas parave e nuk insistoi t’i kontrollonte kasetat, të cilat, sipas kutit momental të matjes së gjërave, do të më çonin drejt në burg. Në ato dy kaseta kisha të regjistruar një material në shkollën e muzikës në Gjilan, me profesorin e muzikës Selman Vokshi dhe kolegët e tij që evokonin kujtime për punën e z. Vokshi. Aty ishte e recituar “garda krutane” e Kolë Jakovës dhe shumë tregime për sjelljen e pushtetit serb në Gjilan dhe Kosovë. Nga ai material, para se të shkoja në Shqipëri, u ndala në Kumanovë, në TV Hana, dhe bashkë me redaktorin Avdullah Thaçi montuam deri në mëngjes dy emisione narrative-muzikore, të cilat janë transmetuar më vonë në atë televizion, kurse për TVSH, në Tiranë montova një lajm prej rreth tre minutash për aktivitetin kulturor në Gjilan. Natyrisht, në Radiotelevizionin e Prishtinës, që ishte nën masat e dhunshme serbe e me shqiptarët e larguar, një emision i tillë do të cilësohej me përmbajtje nacionaliste dhe nuk do të transmetohej.

Emigrimi në Zvicër ishte një odise e vërtetë, që nuk harrohet lehtë, qëndrimi atje edhe më i paharrueshëm.

*Pyetje: A mund ta përshkruash aktivitetin tënd gjatë qëndrimit në Zvicër?*

**Përgjigje:** Periudha e vitit 1996-2000 në jetën time shënohet si periudha e një strehimkërkuesi shqiptar në Zvicër, i cili përditshmërinë e vet, në vazhdimësi, do t’ua kushtojë bashkatdhetarëve që punojnë e jetojnë në Zvicër, që nga gjysma e dytë e viteve ‘60 të shekullit XX. Dashuria për njerëzit, modestia dhe sinqeriteti



kanë qenë virtyte që më kanë bërë të afërt e përafrues me njerëz moshash dhe gjinish të ndryshme. Përvojën e gjatë në Televizionin e Prishtinës si koordinator programi, tashmë, do ta jetësoja në një institucion vullnetar të krijuar nga një plejadë patriotësh shqiptarë, të grumbulluar rreth një strumbullari të quajtur, fillimisht klubi e më vonë Bashkësia Shqiptare “Përparimi” në Cyrih. Aktiviteti prej gazetari ose artikullshkruesi, por edhe si sekretar dhe ndërmjetës kulturor në BSH “Përparimi”: gusht 1997 - gusht 1999 ka lënë gjurmë në jetën kulturore të kësaj “koshereje” shqiptarësh, që ka rrezatuar dinjitet dhe respekt te popullata vendore zvicerane. Qindra publikime gazetares nga aktivitete kulturore, politike e sportive brenda kulmit të kësaj bashkësie, e të shoqëruara me fotografi e videofilmime, janë dëshmia më e mirë për kujdestarinë time të kësaj periudhe historike.

Brenda kulmit të BSH “Përparimi”, tashmë, mbaheshin takime e tubime të shpeshta të fshatrave e të shoqatave të ndryshme nga vendi i tyre i origjinës. Kishte edhe themelime të reja të shoqatave, krejt kjo me qëllim që Kosova të ndihmohej gjithandej.

Shumë rogas, punëtorë të përkohshëm në Zvicër, u takuan më 18 korrik 1998 për të diskutuar format e ndihmës për Kosovën, në këtë gjendje lufte. Po të njëjtën ditë u morëm vesh për themelimin e një shoqate të fshatit për koordinimin e aktiviteteve këtu në Zvicër, por edhe në shtete të tjera të Evropës.

Në vazhdim po jap procesverbalin nga ky takim i rogasve.

*Procesverbal nga mbledhja e jashtëzakonshme e bashkëfshatarëve të fshatit Roganë dhe Fshatit të Ri, mbajtur më 18 korrik 1998*

*Rendi i ditës:*

- 1. Njohja me situatën aktuale në Kosovë dhe në Komunën e Kamenicës*
- 2. Caktimi i një grupi punues për këtë mbledhje*
- 3. Diskutim rreth realizimit të aksionit: Gjithçka për pavarësinë e Kosovës – Komuna e Kamenicës në mbrojtje të Republikës së Kosovës*

*Të pranishëm 26 rogas dhe tre të tjerë.*



Kryesia e SHH „Sejdi Kryeziu“ në Cyrih, 26 korrik 1998

*Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Xhevdet Kallaba, i cili, pasi kërkoi që martirët e Kosovës të nderohen me një minutë heshtje, të pranishmëve u foli edhe për situatën në Kosovë, përkatësisht në Komunën e Dardanës (Kamenicës).*

*Ai tha se Kosova po përjeton çastet më të rëndësishme të një rilindjeje, ndonëse populli i Kosovës po ballafaqohet me një varfëri të imponuar nga okupatori serb, ndërkaq Bashkësia Evropiane dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë janë bërë të shurdhër ndaj granatimeve të ushtrisë fashiste serbe. Sidoqoftë, vazhdoi Xhevdeti, popullata e Kosovës është më e gatshme se kurrë më parë që të luftojë për pavarësinë dhe për krijimin e shtetit të vet, me ç`rast, pa dyshim, kontribut të madh dhe të domosdoshëm duhet të japë edhe diaspora shqiptare, e cila gjithnjë e më tepër po bëhet më e shumtë në Evropën Perëndimore, si pasojë e përndjekjeve të shqiptarëve nga okupatori serb. Ai gjithashtu njoftoi të pranishmit me rolin dhe pozicionin që ka Komuna e Dardanës dhe fshati Roganë në mbrojtje të Republikës së Kosovës. Duke e ndërlikur edhe aktivitetin e fshatrave të tjera të kësaj komune, ai dha në shqyrtim propozimin për mundësinë e grumbullimit të një fondi financiar në nivel të komunës, me qëllim të një preventive kundër*

*ndërhyrjes brutale të ushtrisë serbe në këtë rajon të Kosovës. Xheveti paraqiti dy mundësi të këtij aktiviteti. 1) Mjetet materiale të grumbullohen në konton e Shoqatës Humanitare „Kitka“ të Dardanës, 2) Të themelohet një shoqatë në nivel të fshatit, e cila do të emërtohej „Rogana“ ose „Sejdi Kryeziu“. Shuma që parashihej të grumbullohej, fillimisht, ishte 500 - 1000 SFr.*

*Pas aprovimit të rendit të ditës, u caktua grupi punues në këtë përbërje: Xhevet Kallaba, Sabri Kryeziu, Nazmi Foniqi, Naim Kryeziu dhe Hamdi Kryeziu.*

*Duke u ndërlidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, Sabri Kryeziu tha se në Zvicër punojnë rreth 185 veta nga Rogana, kështu që ky fshat mund të kontribuojë në shumë lëmenj, prandaj unë propozoj që të themelohet një shoqatë në emër të fshatit dhe të emërtohet me emrin e patriotit tonë „Sejdi Kryeziu“. Kjo shoqatë duhet, paralelisht, të funksionojë edhe në Roganë.*

*Haki Kryeziu tha se është mirë që të themelojmë shoqatën e fshatit, kurse mjetet materiale do t'i dedikojmë kudo që të jetë nevoja në Kosovë. Duke parë rëndësinë e mbledhjes, mendoj se propozimi i kryesuesit që mbledhja të zgjatë 90 minuta nuk është i arsyeshëm, gjë që unë propozoj që mbledhja të zgjatë më tepër. Ky propozim u aprovua nga kryesuesi dhe nga të pranishmit.*

*Themelimin e një shoqate të fshatit e propozoi edhe Xhevat Kryeziu, i cili shtoi se disa anëtarë të kryesisë së shoqatës sonë do të takohen me kryesinë e shoqatës „Kitka“ dhe do të merren vesh për aktivitetin e mëtejshëm.*

*Qemajl Kryeziu tërhoqi vërejtjen për mundësinë e bllokimit të parave, me ç'rast kërkoi një kujdes më të madh.*

*Naim Kryeziu elaboroi mënyrën e themelimit dhe të funksionimit të shoqatave në Zvicër.*

*Sabri Kryeziu propozoi që nga ky kuorum të propozohet një grup ose t'i besohet kësaj kryesie të punës, që për javën tjetër të përgatitet një referat shoqëruar për jetën dhe veprën e Sejdi Kryeziut dhe vetëm më pastaj të themelohet shoqata, e cila do ta ketë edhe kryesinë e vet.*

***Nazmi Foniqi** foli në emër të tij dhe të bashkëfshatarëve të Fshatit të Ri, me ç'rast*

*tha se ne jemi përcaktuar që në këtë kohë të jashtëzakonshme veprimtarinë tonë ta realizojmë përmes shoqatës “Kitka”, duke mos e lënë anash as shoqatën e fshatit.*

*Rreth këtij aktiviteti një arsyetim e dha **Sevdai Thaqi**, aktivist në nivel komunal. Ai tha se aktivitetin tonë duhet ta përqendrojmë në tri pika bosht. 1) Në mobilizimin tonë fizik, 2) Në çështjen materiale, si element i domosdoshëm për situatën momentale, dhe 3) Në çështjen e informimit (propagandës). Situata është mjaft e ngutshme, kështu që duhet të veprojmë shpejt. Duhet të përqendrohemi në kryesinë, e cila do të udhëheqë këtë fond dhe në momentin e duhur të derdhen mjetet aty ku duhet.*

***Bajram Sylaj**, aktivist në nivel komunal, gjithashtu dha një arsyetim rreth këtij aktiviteti. Duke u pajtuar me diskutimin e Xhevdetit dhe me atë të Sevdaiut, ai shtoi se çështja materiale në terren është mjaft e dobët, kurse aktivistë ushtarakë të komunës sonë, sot, ka edhe në vijën e frontit, të cilët veprojnë në UÇK dhe se nuk ka forca të ndara, siç pretendohet të thuhet. Është me rëndësi se çdo ushtar që hyn në luftë, paraprakisht, aftësohet ushtarakisht.*

***Xhevat Kryeziu** shprehu një skepticizëm për Fondin e Trepërqindëshit, i cili vepron vite të tëra, ndërkaq rezultati nuk është i lakmueshëm. Unë personalisht kam hequr dorë që ta ndihmoj atë fond, prandaj ndihmën time financiare e kam drejtuar te Fondi “Vendlindja thërret”.*

***Bajram Rrudhani** sugjeroi që 500 franga nuk mjaftojnë për këtë situatë të krijuar.*

***Naim Kryeziu** propozoi që 500 franga të derdhen në fondin e shoqatës “Kitka”, kurse për shoqatën e fshatit të mblidhet fond tjetër.*

***Qemajl Kryeziu** tha se gjatë kohë na ka munguar konstituimi i Parlamentit të Kosovës. Konstituimi i Parlamentit të Kosovës, pa dyshim, është një akt historik dhe ky akt duhet respektuar. Të gjithë duhet ta ndihmojmë Fondin e Qeverisë, i cili këto ditë dedikoi disa miliona franga për Kosovën, kështu që unë e përkrah këtë fond të qeverisë.*

*Në fund u konkludua që të thirret një mbledhje për datën 26 korrik ‘98, me ç`rast do të themelohet Shoqata “Sejdi Kryeziu”.*

*Përgatitjen teknike të statutit dhe të hapjes së kontos do ta kryejë Naim Kryeziu, kurse përgatitjen e referatit për jetën dhe veprimtarinë e Sejdi Kryeziut e merr përsipër Sabri Kryeziu. Lajmërimin e bashkëfshatarëve përmes shtypit shqiptar të këtushëm do ta bëjë Xhevdet Kallaba.*

*Cyrih, më 18 korrik 1998, Procesmbajtës: Xhevdet Kallaba dhe Naim Kryeziu*



*Nga e djathta: Xhevdet Kallaba, Sadri Ramabaja, Vesel Frangu me rastin e përrurimit të librit të Ukshin Hotit “Filozofia politike e çështjes shqiptare” në Siebnen të St. Gallenit, më 24 nëntor 1996*

Duke pasur parasysh valën e madhe të strehimkërkesve shqiptarë, gjatë verës së vitit 1999 jam angazhuar në themelimin e Këshillimores për shqiptarë “Info shqiptare”, pranë Organizatës së Azilit në Cyrih. Nevojën e azilkërkesve për informacione nga situata në vendlindje, por edhe nga rrjedhat e politikës së azilit në Zvicër, e kam shuar duke themeluar dhe duke qenë kryeredaktor i gazetës mujore po me të njëjtin emër - “Info shqiptare”. Paralelisht me gazetën, kam punuar për Organizatën Internacionale për Migracion (IOM) si dhe në kthimin vullnetar të shqiptarëve të Kosovës në vendlindje, duke i asistuar ata në aeroportin e Cyrihut. Në arkivin tim gjenden 32 mijë emra kosovarësh të kthyer vullnetarisht në Kosovë (korrik '99 - korrik 2000), për t’u kthyer edhe vetë, vullnetarisht, më 31 korrik të vitit 2000.





*IOM mbante takime të rregullta (çdo të martë) me Zyrën e Informimit në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së. Nga e majta: Xhevdet Kallaba, Vala Peshku-Sopjani, Shemsi Syla, përfaqësuesi i KFOR-it, Agron Muja*

Nga shtatori i vitit 2000 e deri më 31 mars 2004 kam vazhduar të punoj për Organizatën Internacionale për Migracion, në Prishtinë, si asistent në Zyrën e Informimit Publik. Përvojën e fituar në gazetari, me theks të veçantë në Zyrën e Informimit, nga viti 2002 e kam zbatuar edhe në Zyrën e Informimit Publik të TMK-së (Trupave Mbrojtëse të Kosovës). Po ashtu, nga viti 2001 deri më 2008 kam qenë kryeredaktor i revistës “Gjahtari”, që ka qenë organ i Federatës së Gjahtarëve të Kosovës. Bashkë me redaktorin Rabbit Rexhepi si dhe një grup gazetarësh nga terreni, kemi trajtuar çështje jetësore që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe zhvillimin e faunës në Kosovë.

Një sërë aktivitete të mëvonshme në relacion Kosovë-Zvicër bëjnë që unë të isha një promotor i një bashkëpunimi kulturor ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës, e që do të çmohet lart nga të dyja palët.

Në vitin 2005, bashkë me ish-kolegun e Këshillimores për kthim, z. Jan Poldervaart, kam botuar librin dokumentar “Kosovë-Zvicër-Kosovë”, versioni gjermanisht, i cili nga autoritetet zvicerane është trajtuar si një dokument-dëshmi kohe.





*Xhevdet Kallaba gjatë përurimit të librit Kosovë-Zvicër-Kosovë, 30.6.2005 në Cyrih*

Me rastin e përurimit të këtij libri kryetarja e Departamentit Social të Cyrihut, zonja Monika Shtoker (Stocker) kishte nënvizuar: “Ju falënderoj për librin, të cilin sot po ia prezantoni opinionit publik... është një dëshmi kohe, një dokument kohe, një pjesë e historisë së kohës, një pjesë e Evropës dhe një pjesë e Zvicrës... Ai që e lexon këtë antologji, nuk mund të qëndrojë neutral... që të gjithë jemi brenda kësaj drame evropiane në përfundim të shekullit të 20-të e që na shqëron si sfidë edhe më tutje në shekullin e 21-të”.

Këtë libër e kam përkthyer dhe e kam botuar edhe në gjuhën shqipe, në prill të vitit 2007. Po këtë vit kam marrë një nismë për bashkëpunimin e korit të shkollës së muzikës në Gjilan me korin e shkollave fillore të Cyrihut. Një vit më vonë, pas një javë ushtrimesh të përbashkëta në kampin muzikor në Magliaso të kantonit Tesin - Zvicër, 35 fëmijë nga Gjilani e Cyrihu do të takohen në një kor të përbashkët për të shfaqur tri koncerte: Në Cyrih, në Cug (Zug) dhe në St.Gallen, në udhëheqje të dirigjentëve Adhurim Rasimi dhe Wolfgang Shady.

Një ekip filmik zviceran, i kompanisë HesseGreutert Film AG, dokumentoi gjithë projektin e korit. Të rinjtë e të dy koreve, nga Zvicra dhe nga Kosova, u shoqëruan nga një ekip pedagogësh socialë nga të dy shtetet. “35 nxënës që paraqisnin një kor, por dy botë, dëshmuuan para producentëve si dhe te regjisori Poldervaart, por edhe para shikuesve të tri koncerteve në Zvicër, se komunikimi

ndërkulturore bashkon zemrat mes dy popujve; u dëshmuar se kontakti dhe njohja e ndërsjellë, sidomos shkëmbimi i përvojave ndërmjet të rinjve, janë përcjellësi më i mirë i mesazhit të një populli te populli tjetër”.

Me qëllim që të regjistroj kohën në të cilën po jetojmë, në vitin 2006 kam regjistruar gjithë fshatin Roganë, personat dhe ekonomitë familjare, dhe kam nxjerrë tre numra të periodikut “Inforogana”. Për keqardhje, ky periodik është ndërprerë për shkaqe materiale, por që ka lënë gjurmë në historikun e fshatit dhe të komunës së Dardanës.

Vazhdimësinë e bashkëpunimit kulturor të Kosovës me Zvicrën e kam kultivuar edhe në vitin 2009, duke mundësuar vizitën studimore të grave parlamentare të Komunës së Dardanës. Kështu, nga 24 – 30 maj 2009 parlamentaret e Kuvendit Komunal të Dardanës qëndrojnë në Zvicër dhe vizitojnë tri nivele parlamentesh. Më 25 maj ato ishin pjesë e punimeve të Parlamentit kantonial të Cyrihut. Ishte hera e parë në histori që në hollin e ndërtesës historike të Parlamentit të Kantonit të Cyrihut, krahas flamurit zviceran, të valonte edhe flamuri i shtetit të Kosovës. Me këtë rast, kryetarja e parlamentit kantonial, zonja Esther Hildebrand, organizoi një debat dyorësh për të shkëmbyer përvojat politike me gratë parlamentare nga Dardana.

Po të njëjtën ditë parlamentaret nga Kosova (Dardana) u pritën edhe nga kryetari i parlamentit komunal të Usterit, z. Martin Bornhauser për të qenë pastaj edhe pjesë e punimeve të kuvendit të Usterit.

Më 28 maj 2009 parlamentaret nga Dardana vizituan ndërtesën imponante federale (Bundeshaus) me ç’rast ndoqën edhe sesionin e punimeve të Parlamentit Federal. Më pastaj ato u pritën në një sallë të veçantë nga nënkryetarja e Parlamentit Federal, zonja Paskal Bruderer, dhe nga miku i shqiptarëve, parlamentari i Partisë së të Gjellbërve, z. Ueli Leuenberger.

Në vitin 2010 jam bërë pjesë e udhëheqjes së projektit “Kosovambient song”. Bashkë me zonjën Barbara Kohler - Beglinger, menaxhere kulturore e këngëtares dhe artistes zvicerane Aleksandra Prusa, kemi realizuar 10 koncerte (6 në Kosovë dhe 4 në Zvicër).

Në këmbim të një bashkëpunimi të drejtpërdrejtë me popullatën e Kosovës,

fëmijët nën moshën 18-vjeçare, dhe me kompozitorët kosovarë, këngëtarja dhe artistja zvicerane Alexandra Prusa, bashkë me grupin e saj “Broken Dreams”, ka shtjelluar projektin “Kosovambient Song”. Me këtë ajo u jep mundësinë fëmijëve në Kosovë që të shprehin dëshirat e tyre lidhur me ambientin, në të ardhmen. Fëmijët kanë shprehur dëshirat e tyre për mjedisin ku jetojnë, me nga një fjali të vetme, të cilat, pastaj, janë kompozuar nga kompozitorë kosovarë dhe janë kënduar në gjuhën shqipe (18 këngë), në gjuhën turke (1 këngë) dhe në gjuhën serbe (1 këngë) nga Aleksandra Prusa, në përcjellje të grupit “Broken Dreams” nga Lucerni i Zvicrës. Përveç koncertit të parë, të gjitha koncertet edhe i kam moderuar vetë.

Në vitin 2010 kam punuar librin dokumentar “Rrugëtimi i Qendrës Kulturore Shqiptare në Zvicër”, kryetar i së cilës ishte heroi Agim Ramadani, e në të cilin paraqitet një monografi e aktivitetit të një plejade krijuesish e veprimtarësh në Zvicër. “Duke e trajtuar veprimtarinë e QKSH-së, nuk pretendoj të përmbledh gjithë veprimtarinë e mërgatës shqiptare. Mirëpo, kjo formë e përfshirjes së aktiviteteve të mërgatës shqiptare, mbase, duhet të shërbejë për intelektualët e kohës që të ndërmarrin një projekt gjithëpërfshirës të prezantimit kronologjik të jetës dhe të veprimtarisë së mërgatës shqiptare në Zvicër, që nga mesi i viteve ‘60, duke lënë kështu një hallkë lidhëse mes brezash të mërgatës shqiptare në Evropën Perëndimore”, thuhet, mes të tjerash, në parathënien e këtij libri.

Nga prilli i vitit 2012 kam filluar me një projekt të ri të bashkëpunimit Kosovë-Zvicër, duke organizuar vizita për pedagogët socialë, mësuesit zviceranë e të tjerë në shtetin e Kosovës. “Gjatë takimeve dhe bisedave me zviceranë, sidomos me personelin arsimor, kam ardhur në përfundim se shumë prej tyre ose nuk e njohin fare Kosovën, ose kanë informacione krejtësisht të gabuara. Madje, disa syresh, në mendjen e tyre kanë perceptime negative për popullin e Kosovës. Duke e parë këtë mangësi informacionesh, kam ndërmarrë një hap fare konkret, që të organizoj udhëtime dhe vizita studimore nëpër Kosovë dhe Shqipëri. Me këtë rast vizitorët nga Zvicra njihen më për së afërmi me institucione shkollore e akademike, me institucione sociale e shëndetësore, vizitojnë vende e njerëz, njihen me trashëgiminë kulturore-historike të popullit shqiptar, si dhe me bukuritë natyrore të Kosovës”.

Po ashtu, nga viti 2012-2018 kam qenë korrespondent nga Kosova për platformën elektronike “albinfo.ch”, redaksia e së cilës gjendet në Lausanne, me

ç' rast kam ndjekur aktivitetet e delegacioneve zvicerane në Kosovë, për të cilat ishte e interesuar redaksia, por edhe trajtoja tema që lidhin këto dy shtete.



*Xhevdeti në Federatën e Gjahtarëve të Kosovës ishte kryeredaktor dhe themlues i revistës “Gjahtari” (2001 – 2008), Prishtinë, 20 dhjetor 2001*

Natyrisht, në këtë kapitull, nuk është përfshirë i gjithë angazhimi im në fushën e kulturës e të letërsisë, por shpresoj që në arkivin tim, në të ardhmen, të mund të punojnë studentë e studiues dhe kronistë të kohës, duke shfletuar materiale të shumta arkivore e sidomos qindra orë filmime dhe mijëra fotografi të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të dhe fillimit të shekullit të 21-të.

Sa për ilustrim, po jap një tekst nga një ligjëratë, mbajtur më 5 dhjetor 1998 në një tubim të aksionit: Komunat e Zvicrës bashkërisht “Gemeinden Gemeinsam Schweiz” (GGS).

GGS u themelua më 1992 dhe sot përmbledh rreth 150 komuna zvicerane, 45 komuna kishtarë dhe mbi 1.000 individë<sup>46</sup>. Aksioni ka për qëllim ndërtimin e partneriteteve ndërmjet komunave multietnike të ish-Jugosllavisë me komunat në Zvicër për të mirën e demokracisë lokale dhe për të drejtat e njeriut. Tani ekzistojnë 15 partneritete të këtilla. Qëllimi i ligjëratës ishte njoftimi më i drejtpërdrejtë i aktivistëve zviceranë me situatën e shqiptarëve të Kosovës nën regjimin okupator të Serbisë.

<sup>46</sup> Shënime nga gjendja e GGS më 5 dhjetor 1998.

## Unë besoj në një bashkëpunim të mirë

*Ligjëratë nga Xhevdet Kallaba, Bernë, 5 dhjetor 1998*

«Të nderuara zvicerane, të nderuar zviceranë, së pari dua t'ju falënderoj që unë, tash më tepër se dy vjet, mund të jetoj i sigurt në Zvicër. Atedheun tim e kam lëshuar me arsye të shëndoshë. Isha punëtor në Televizionin e Prishtinës dhe një ditë, së bashku me 1.300 punëtorë të tjerë, përnjëherë u përjashtuam nga puna. Ishin, pra, punëtorët medialë njëri nga grupet profesionale që u morën në shënjestër politike. Kërkoj mirëkuptim nga ju që problemet në atedheun tim tani e ngarkojnë edhe Zvicrën.



*Xhevdet Kallaba gjatë ligjërates në Bernë, më 5.12.1998*

Më duhet të them se personalisht u pranova fare njerëzisht dhe ndershëm në Qendrën e pranimit në Bazeli. Faleminderit! Si intelektual, shfaqja dëshirën që të sistemohesha në ndonjë qytet të madh si Bazeli, Cyrihu ose Berna. Mirëpo, dëshira ime nuk u mor aq seriozisht dhe udhëtimi im i parë në Zvicër më shpuri në luginat e Glarusit. Mendova se ma kishin bërë me qëllim. Ndërkohë pata fatin që të transferohesha nga Glarusi në Cyrih. Aktivitetin tim profesional e kisha orientuar nga Cyrihu, me ç'rast ndihmesa ime për diasporën dhe dialogu ndërkulturor ishte vlerësuar nga të tjerët.

Mendoj se, për sa i përket krizës së Kosovës, nuk janë përfillur sa duhet organizatat shqiptare dhe instancat politike. Po e përmend këtu veçanërisht Marrëveshjen zvicerano-jugosllave në Zvicër lidhur me kthimin e refugjatëve shqiptarë të Kosovës, në vjeshtën e vitit 1997. Në të ardhmen do të dëshiroja që të merret më seriozisht dhe të dëgjohet edhe zëri i mendimtarëve të ndryshëm të shqiptarëve të Kosovës, i organizatave dhe i udhëheqësve politikë.

## Jepni mundësinë për të rinjtë tanë që të shkollohen për jetë

Rinia nuk është përgjegjëse për krizën e tanishme në Kosovë. Ata nuk kanë çfarë të bëjnë. Ata janë të hidhëruar dhe ndërkohë nuk shohin absolutisht kurrfarë perspektive jetësore në vendlindje. Ky është shkaku përse këtu janë kaq shumë shqiptarë të rinj nga Kosova. Le t'ua japim mundësinë që, ata, këtu të mund të punojnë, të vazhdojnë kualifikimet e tyre ose të shkollohen. Nga kjo, me siguri, do të përfitojë edhe vetë Zvicra. Me siguri që do të ketë më pak probleme sociale sapo të kuptojnë këta të rinj se do të trajtohen më seriozisht, se do të përkrahen, se nuk do të lihen mënjanë.

Zonja e zotërinj, nga këta të rinj, më vonë, do të varet e ardhmja e Kosovës. Për një identitet të shëndoshë të këtyre të rinjve është më se i rëndësishëm inkurajimi për gjuhën dhe për kulturën amtare. Si pakicë e përndjekur nga Jugosllavia, nuk marrim kurrfarë përkrahje nga përfaqësuesit jugosllavë në Zvicër. Kjo, fatkeqësisht ndodh edhe në atdheun tonë.

Pjesa dërrmuese e diasporës shqiptare në Zvicër nuk qëndron financiarisht mirë. Prindërit nuk mund t'i përballojnë harxhimet shtesë për mësimin e gjuhës dhe kulturës amtare. Në kantonin e Cyrihut vetëm një e treta e fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë ndjekin mësimet në gjuhën amtare. Do të ishte shumë e dëshirueshme mbështetja financiare dhe investimi në ardhmëninë e rinisë sonë.



*Xhevdet Kallaba - dy vjet angazhim vullnetar në BSH „Përparimi“ – Cyrih. Foto, mars 1998*



## **Një fjalë për mediet zvicerane**

Shqiptarët nga ish-Jugosllavia janë grupi i dytë për nga numri i të huajve në Zvicër. Mirëpo, asnjë grup në mediet zvicerane nuk ka imazh më të keq sesa ne. Me vite të tëra është raportuar kryesisht për delinkuentët kosovarë, ndërkaq prapavija në atdhe ose gjendja dhe mospërfillja e shqiptarëve këtu në Zvicër nuk është ndriçuar aspak. Këtë pasqyrë e ka ndryshuar paksa, tani, lëvizja aktuale e arratisjes nga Kosova në Zvicër. Në të ardhmen do të dëshiroja një raportim më objektiv dhe të vazhdueshëm për atdheun tonë dhe për komunitetin tonë në Zvicër. Ne jemi tatimpagues këtu dhe të shumtën e rasteve nuk kemi punë që paguhet mirë.

## **Fëmijët e mi më me dëshirë do t'i edukoja vetë**

Unë punoj në Cyrih, në Bashkësinë Shqiptare “Përparimi” dhe kam një shoqërim të përditshëm me rininë dhe me njerëz të rinj nga Kosova. Mund t’ju them, zonja dhe zotërinj të nderuar, se më dhemb që nuk mund t’i edukoj vetë fëmijët e mi. Ata janë në Kosovë dhe unë si azilkërkues nuk kam të drejtë për bashkim familjar. Qysh nga largimi im para plot dy vjetësh nuk e kam parë familjen time. Herë pas here kontaktoj përmes telefonit. Djali im i madh tani është 16 vjeç dhe ai ka nevojë shëmbëlltyrën e babait të vet. Pritja për vendimin e azilit po zgjatet shumë! Ka edhe shumë azilkërkues të tjerë që janë në situatën time. – Kjo është e dhembshme.

Në situatën e tanishme, ku kaq shumë njerëz vijnë nga Kosova në Zvicër, propozoj që këta njerëz të strehohen te të afërmit e tyre ose diku në afërsi. Jam i bindur që Zvicra do të ketë përfitime nga ky gjest, sepse të afërmit e tyre, që tashmë janë të integruar në Zvicër, do të jenë instruktorët më të mirë për të sapoardhurit. Në traditën tonë të afërmit e moshuar respektohen nga të rinjtë dhe të moshuarit kanë ndikim te ta.

## Ndihmat humanitare

E di se Zvicra tashmë po e ndihmon me të madhe atdheun tim në çdo pjesë të tij. Janë këto organizata shtetërore, por ka edhe aso private dhe organizata bamirëse. Për këtë, ne të gjithë i jemi mirënjohës Zvicrës. E dimë se edhe me mijëra njerëz bëjnë një jetë të papëlqyeshme. Nga Bashkësia Shqiptare “Përparimi” gjer më tani kemi dërguar 60 tonelata dërgesa bamirësie, si: veshmbathje, batanije, artikuj ushqimorë e higjienikë etj. Mirëpo, në situata të këtilla nevoja është e madhe dhe na duhet një përpjekje e përbashkët.

Gjithashtu, më duhet t’ju them: ne po presim që së shpejti të kthehemi në një atdhe paqësor dhe mendoj se sërish do të kemi nevojë për ndihmën tuaj. Ne vetë nuk kemi mjete financiare për të rindërtuar aq shumë fshatra të shkatërruara që të mund të jetojmë sërish në to. Gjithashtu, edhe ekonomia, arsimiti e shëndetësia kanë nevojë urgjente për ndërtim. Tashmë që, këtu në Zvicër, mund të zhvillohen partneritete me firma, me organizata bamirëse shtetërore, por edhe me persona privatë, gjatë kthimit në atdhe, të sigurohet një bashkëpunim sa më efikas.

Ju falënderoj për vëmendjen tuaj. “Unë besoj në një bashkëpunim të mirë”.

*Pyetje: Ke edhe diçka për të shtuar për biografinë tënde?*

**Përgjigje:** Natyrisht, kam edhe shumëçka për të evokuar nga jeta dhe veprimtaria ime, por pjesën tjetër do ta paraqes në një libër të vetëm, ose në disa libra.

Prandaj, këtu dhe do t’i jap fund këtij libri me shpresë që lexuesi të ketë një pasqyrë rreth familjes Kallaba, e cila, shpresoj të ketë lënë dhe do të lë gjurmë në kujtesën e popullit tim, për të mirën e kombit e të atdheut, në çdo periudhë.

## Foto e dokumente nga arkivi familjar



*Roganë, korrik 1992 - Gjatë një aksioni vullnetar për rregullimin e një fushe sporti (nga e majta): Agimi, Hekurani, Mrika, Izeti, Xhevdeti, Graniti dhe Naimi*



*Në kohën e lirë, gjithherë ka pasur lojëra me filxhanë, me letra dhe lojëra të tjera popullore. Nga e djathta: Nexhati, Esati, Muzaferi, Fatmiri, Selamiu, Jetullahu*



*Roganë, 2004 - Ekremi dhe Fikrija në mesin e familjes së Xhevdetit dhe të Dritës*



*Gjilan 24.5.2003 nga e djathta- Abdylaziz Veseli, Mehmet Gjevori, Rexhep Hoxha, Xhevdet Kallaba, Blerim Rexhepi*





*Xhevdeti gjatë një incizimi në ekspozitaën e piktorit Sylë Muja në Cyrih, 22.2.1997. Një fjalë rasti nga kuratori i ekspozitës, gazetari Xhemal Ahmeti*



*Xhevdeti me shkrimtarin Vehbi Skenderi në St. Gallen të Zvicrës, 11 maj 1997*



*Nga majta: Zejdi e Lutfije Ismajli, Hida Halimi dhe Xhevdet Kallaba, në Panairin e librit në Gjenevë, më 2 maj 1997*



*Xhevdet Kallaba, Shaip Latifi (majtas) dhe Shaip Beqiri gjatë udhëheqjes së manifestimit letrar në kuadër të Javës kulturore në BSh "Përparimi" në Cyrih, 24-30 nëntor 1997*





*Nga e djathta - Xhevdet Kallaba dhe Agim Ramadani, Birmensdorf (CH), korrik 1997 gjatë një interviste rreth ekspozitës së Agimit*



*Në Mynsingen (CH) 1.6.1997 me Hasan Kadriun e Gani Sylën në një aktivitet të mërgatës*



*Xhevdeti gjatë një interviste me drejtorin e Universitetit Popullor Shqiptar në Gjenevë, z. Ueli Lojenberger (Leuenberger), korrik 2000*



*Përjetime të shumta e mallëngjyese të Nexhmijes me fëmijët gjatë qëndrimit 54 muajsh të Xhevdetit larg familjes*



*Me 80-vjeçaren, Fatime Kallaba Thaqi e cila më furnizoi me shumë materiale rreth së kaluarës së familjes Kallaba, sidomos për shënimet për trugun familjar, që pritet të shkruhet në një libër më vete (foto: 31.3.2005)*



*Gjatë udhëtimit për Zvicër me parlamentaret e Komunës së Dardanës (24.5.2009)*



*3 maj 2022 me Rexhep Rifatin në Ferizaj*



*Kafe e muhabet përherë për miqtë e mirë. Nga një vizitë e Mithat Krasniqit në Roganë*






*Gjilan, 2005 - Pamje nga një takim miqësor: (nga e majta) Xhevdet Kallaba, Selman Vokshi, Xhavit Hajdari*



*Vanesa, Agnesa, Enveri, Eminja dhe Orgesi*



*Xhevdeti me Sevdai Thaqin e Blerim Shabanin (djathtas) në panairin e librit në Gjenevë, maj 2000*



*Hannes Heiden, Xaver Koch dhe Shefki Popova në vizitë familjes së Xhevdetit, dhjetor 1999 në Roganë*





*Xhevdeti e Nexhmija me nënën Naxhije 3.10.1983 në Ferizaj*



*Me anëtarët e ansamblit Vatra nga Bylahu, Lenzbug 30.8.1997*





*Kunatat (nga e majta):  
Nexhmija, Makfirja dhe Sheribanja*



*Ismeti, Drita, Fiona, Fationa, Fatmiri*



*Hana, Ari, Erta, Eroida dhe Visari*



*Mimoza, Vetoni dhe Maela*



*Prishtinë, 9 maj 2001 - Trajnimi i oficerëve të informimit të TMK-së nga Klaus Hacenbyler (Hatzenbühler) dhe Xhevdet Kallaba*



*Me djemtë, Granitin dhe Petritin (djathtas) gjatë një pushimi, pas një ecjeje dimërore në Krenidell, më 6 janar 2019*



*Xhevdeti e Nexhmija pjesëmarrës në Kongresin e Tretë të Lidhjes Shqiptare në Botë, mbajtur në Shkup, më 21 tetor 2018*



*Betimi, Dafina, Dreni, Liza dhe Rexhepi*



*Selamiu, Sheribanja, Endrini dhe Rilindi*



*Tamara, Orinti dhe Layrin*



X

**Pasardhësit e Hafëz Shefki Kallabës -  
Shkollimi dhe profesioni i tyre**



“

Paqja, dituria  
e shpëtimi  
qofshim mbi ju,  
o pasardhësit  
e mi! Besimi  
në Zot dhe në  
vetvete është  
fitorja vetë!

”

---

*Hafëz Shefki Kallaba*

Duke pasur vullnet të madh për nxënie, që nga moshën gjashtëvjeçare (1895) e deri në moshën 19-vjeçare (1909), Hafëz Shefki Kallaba vizitoi mësues e shkolla të ndryshme, për t'iu njohur edhe zyrtarisht dhjetë vjet shkollim nga pushteti i kohës në medresenë e pareformuar. Po kështu, edhe shumica e pasardhësve të tij, synim parësor patën dhe kanë shkollimin superior. Nga gjithsej 191 anëtarë të familjes së tij të ngushtë (pasardhës të tij), më 31 maj të vitit 2022, jetojnë 154 persona moshash dhe gjinish të ndryshme, kurse 37 rezultojnë të vdekur.

Çështje e vërteta, unë jam në përgatitje e sipër të një libri për trungun e familjes Kallaba, duke filluar nga anëtarët-pasardhës, Haxhi Rama me vëllain Sejdiun dhe djemtë e vet, Salihun e Aliun, të lindur në shekullin e 18-të. Natyrisht, kam shënuar edhe rrënjët e tyre, për aq sa kam arritur të mbledh informacione. Flitet për babanë e Ramës (Ramadanit), Selimin, që kishte lënë edhe Sejden - vëllanë

e Ramadanit, pastaj babanë e Selimit, Islamin, dhe babanë e Islamit, Rexhepin, që ka edhe një vijë tjetër gjenealogjike të disa kushërinjve të familjes Kallaba në Roganë. Është për keqardhje që nuk kam arritur të shkoj më thellë në historikun e familjes, por, të paktën, e kam vënë një bazë për studim të mëtutjeshëm, qoftë për gjeneratat pararendëse, qoftë për këto pasardhëse. Ka qenë një punë e mundimshme të grumbullohen të gjitha këto shënime, sidomos për faktin që në gjenealogji i kam përfshirë të dy gjinitë, që të mund të korrespondojnë mes vete pasardhësit e rreth dhjetë brezave, ku përfshihen qindra meshkuj e femra. Shpresoj që, në të ardhmen, të dalë sërish ndonjë vullnetar dhe ta vazhdojë ndërtimin e trungut familjar. Kjo do t'i bënte nder gjithë familjes Kallaba, dhe jo vetëm.

Për këtë libër jam ndalur vetëm te familja e ngushtë e pasardhësve të Hafëz Shefki Kallabës, për të pasqyruar aspektin arsimor. Nga lista e të regjistruarve, deri më 31 maj 2022, janë gjithsej 188 pasardhës të Hafëz Shefki Kallabës nga dy bashkëshortet e tij: Hanumshahe Shabani nga Krenidelli dhe Sanije Sylçiçi nga Dobërçani.

Vlen të përmendet se nga 37 persona të vdekur, deri në kohën kur po shkruhet ky libër, 25 kanë qenë të moshuar, kurse 12 kanë qenë fëmijë, prej një muajsh deri në tre vjeç.

Nga kjo pasqyrë shihet se Hafëz Kallabën e karakterizon angazhimi i tij i vazhdueshëm për zhdukjen e analfabetizmit, kështu që, përveç disa grave, të martuara në familjen e tij, dhe vajzës së madhe - Sabrijes, që kanë qenë analfabete, të gjith(a)ë të tjerët kanë qenë të shkolluar(a). Nga të gjallët, sot është vetëm një grua (mbi 80 vjeçe) analfabete, kurse gjashtë me shkollë fillore, 29 me shkollim të mesëm, ndërsa 70 persona janë me shkollim superior (shkolla të larta deri në magjistra) fushash të ndryshme. Ndërkaq, rreth dyzet të tjerë janë në shkollim e sipër në nivele të ndryshme.

Njësoj kanë vepruar edhe vëllezërit e tij: Islami, Ibrahimimi e Rexhepi, si dhe pasardhësit e xhaxhait të tij - Aliut. Prandaj, me të drejtë, familja Kallaba njihet si ihtarë e nxënies dhe mësimdhënies.



Në vazhdim pason pasqyra statistikore e pasardhësve të Hafëz Shefki Kallabës dhe niveli i shkollimit të tyre; gjendja më 31 maj të vitit 2022:

Numri i përgjithshëm, përfshirë Hafëz Kallabën dhe dy gratë e tij: Hanumshahe Shabanin nga Krenidelli dhe Sanije Sylçiqin nga Dobërçani është: Meshkuj 78 ose 40.8% dhe femra 113 ose 59.2% - gjithsej 191.

**Pasqyra shkollore:**

Pa shkollim (12 kanë vdekur si foshnja)	24
Me shkollim fillor	12
Me shkollim të mesëm	34
Me shkollim të lartë/Bachelor	20
Me fakultet	35
Me master	16
Fëmijë parashkollor	14
Në shkollim fillor	17
Në shkollim të mesëm	3
Në shkollim universitar	16
Gjithsej	191

**Gjendja martesore:**

Femra të martuara në familjen e Hafëz Kallabës	46
Femra të martuara nga familja e Hafëz Kallabës	31

**Pasqyra e të vdekurve:**

Të rritur	25
Femra	13
Meshkuj	12

**Fëmijë prej njëmuajsh deri në tri vjet**

Femra	4
Meshkuj	8

Numri i grave (nuseve) të vdekura	10
Numri i bijave të vdekura	3

**Gjithsej të gjallë nga pasardhësit e Hafëz Kallabës  
(gjendja – 31 maj 2022):**

Meshkuj 57 (37%) / femra 97 (63%) / gjithsej 154

**Të rritur: Viti i lindjes deri më 1981**

Meshkuj 19 (32%) / femra 40 (68%) / gjithsej 59

**Të rritur: Viti i lindjes prej 1982 -2003**

Meshkuj 24 (40%) / femra 36 (60%) / gjithsej 60

**Fëmijë: Viti i lindjes prej 2004 - 2008**

Meshkuj 0 / femra 2 / gjithsej 2

**Fëmijë: Viti i lindjes prej 2009 – 2015**

Meshkuj 7 (41%) / femra 10 (59%) / gjithsej 17

**Fëmijë: Viti i lindjes prej 2016 – 2021**

Meshkuj 9 (57%) / femra 7 (44%) / gjithsej 16

## SHKURTESAT:

OTH	- Organizata Themelore
LK	- Lidhja Komuniste
KK	- Kuvendi Komunal
UDB	- Unutrashnja Drzhavna Bezbednost (Sigurimi i Brendshëm Shtetëror)
QAMO	- Qendra e Arsimit të Mesëm të Orientuar
UÇK	- Ushtria Çlirimtare e Kosovës
NDSH	- (Organizata) Nacional Demokratike Shqiptare
SHBA	- Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SKOJ	- Savez Komunističke Omladine Jugoslavije
LRKJ	- Lidhja e Rinisë Komuniste e Jugosllavisë
LKJ	- Lidhja Komuniste e Jugosllavisë
LKS	- Lidhja Komuniste e Serbisë
SPB	- Sekretariati i Punëve të Brendshme
p.e.s	- para erës sonë
KR	- Kosova Republikë
RSFJ	- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
QSHM	- Qendra e Shkollave të Mesme
SHKSHSHK	- Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova
NATO	- North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut)
LDK	- Lidhja Demokratike e Kosovës
OZN	- Odeljenje za zaštitu naroda (Departamenti për Mbrojtjen e Popullit)
PR	- Partia Republikane
APJ	- Armata Popullore Jugosllave
ATSH	- Agjencia Telegrafike Shqiptare
XIM	- Xehërorja e Industrisë së Metalurgjisë
ZKM	- Zyra e Kryeministrit
UÇK	- Ushtria Çlirimtare e Kosovës
LDB	- Lufta e Dytë Botërore
RTP	- Radio Televizioni i Prishtinës
KMDLNJ	- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

IOM	- International Organisation for Migration (Organizata Internacionale për Migracion)
TMK	- Trupat Mbrojtëse të Kosovës
AG	- Aktien Gesellschaft (Ndërmarrja e Aksioneve)
QKSH	- Qendra Kulturore Shqiptare

### **TERMA TË HUAJ**

AUK	- American Education in Kosova (Edukimi amerikan në Kosovë)
Mantik	- Logjikë
Akaid	- besim
Islam sarf	- etimologji
Meharixhi huruf	- fjalëshqiptim
Mulla xhamia	- nivel shkollimi i kohës
Ilmi fikhu	- jurisprudencë, është shkencë që bazohet në fjalët e Zotit dhe peygamberit Muhamed alejhi selam
Hixhri	- do të thotë data e Muhamedit alejhi selam kur ka udhëtuar prej Mekës në Medinë
Mejtep	- Shkollë fillore, ku jepej edhe mësimi i fesë për besimtarët myslimanë

## Shënime për autorin



Xhevdet Kallaba ka lindur më 3 mars 1953 në fshatin Kopërnice, Komuna e Dardanës. Rrjedh nga një familje intelektualësh. Babai i tij, Tefik Kallaba, ishte mësues, i cili më 1948 i pari hapi shkollën fillore në Busavatë. Pastaj punoi mësues në Kopërnice, Hogosht, Geraj të Preshevës, Pogradje dhe Koretin. Ndërkaq, gjyshi, Hafëz Shefki Kallaba, ishte hoxhë i njohur në Roganë, Anamoravë e Kosovë (pjesëmarrës i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, shtator 1943, si dhe anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Jugosllavisë me seli në Sarajevë).

Xhevdet Kallaba ka mbaruar Akademinë Pedagogjike në Gjiilan, drejtimi Gjuhë dhe letërsi shqipe, si dhe ka studiuar Gjuhën gjermane në Prishtinë. Nga viti 1976 – 1990 ka punuar koordinator dhe lektor në Radiotelevizionin e Prishtinës. Ka qenë anëtar i Kryesisë në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kamenicë.

Më 1996 emigron në Zvicër. Gjatë qëndrimit në Zvicër ka vepruar si gazetar në të përditshmen “Bota sot”. Gjatë viteve 1997-1998 ka qenë sekretar (me punë vullnetare) i Bashkësisë Shqiptare “Përparimi” në Cyrih. Më 1998 -2000 themelues dhe udhëheqës i Këshillimores për azilkërkuesit shqiptarë në Kantonin e Cyrihut dhe kryeredaktor i gazetës mujore për refugjatë „InfoSHQIPTARE“.

Më 1999-2000 bashkëpunëtor i Organizatës Internacionale për Migrim (IOM) me seli në Bernë - Zvicër; asistimi në kthimin vullnetar të refugjatëve kosovarë nga Zvicra në Kosovë.

Nga shtatori i vitit 2000 e deri më 31 mars 2004 asistent multimedial në “Programin e IOM-it për trajnimin e TMK-së”, në Kosovë.

Prej vitit 2001 – 2008 kryeredaktor i revistës kosovare për gjueti „Gjahtari“.

Më 2005 bashkautor i librit gjermanisht “Kosovo - Schweiz - Kosova” dhe përkthyes i këtij libri me titull “Kosovë - Zvicër - Kosovë”, në vitin 2007.

Në vitin 2006 – 2007 botues i periodikut „InfoROGANA“ (tre numra).

Më 2007 kryeredaktor i librit të Xhevat Ismajlit “Veprimtarët shqiptarë të muzikës artistike në Anamoravë”.

Më 2007 - 2008 bashkudhëheqës i projektit kulturor dhe filmit dokumentar zviceran “Korichor”.

Më 2008 redaktor i revistës “Tung” - edicioni në Zvicër.

Më 2009 udhëheqës i projektit “Vizita studimore e 12 parlamentareve nga Kamenica në Zvicër”.

Më 2009-2010 bashkudhëheqës i projektit “Kosovambient song” – Dëshira për natyrën në të ardhmen – i këngëtares dhe artistes zvicerane Aleksandra Prusa.

Më 2010 autor i librit dokumentar “Rrugëtimi i Qendrës Kulturore Shqiptare në Zvicër”.

Më 2010 përkthyes i librit nga shqipja në gjermanisht i autorit Sylë Arifi - Shteti i Kosovës një realitet i ri ndërkombëtar” (Der Staat Kosovo eine neue Internationale Realität).

Prej prillit 2011 deri më 31 janar 2012 asistent i Programit të IOM-it “Beautiful Kosova”, me seli në Gjilan.

Nga viti 2012 korrespondent nga Kosova për platformën elektronike “albinfo.ch” - redaksia në Zvicër.

Po nga viti 2012 merret me turizëm, duke sjellë vizitorë nga Zvicra në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

Më 2021 autor i librit “Çerekshekulli i Ansamblit “Vatra” në Bylah – Cyrih.

Më 2021 redaktor i tre librave të autorit dr. Xhavit Hajdari (“Kujtime e rrëfime jetësore”; “600 barsoleta, anekdota, fjalë të urta popullore dhe tregime”; “Ditari në kohë pandemie”).

Më 2021 redaktor i librit me humor e poezi në gjueti të autorit Rabbit Rexhepi.

Më 2021 autor i librit “Përjetësi” - në kujtim të Ibrahim H. Kryeziut.

Më 2022 autor i librit “KALLABA - gjurmë në kujtesë”.







